

# ENVER HOXHA

VEPRA

61



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË**



**ENVER HOXHA**



**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANE KQ TE PPSH**

# **ENVER HOXHA**

**V E L L I M I**

**61**

**MARS 1977 — QERSHOR 1977**

**SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»  
TIRANË, 1988**



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 61-TË

*Shkrimet që përmban ky vëllim i Veprave të shokut Enver Hoxha i përkasin periudhës mars-qershor 1977. Një pjesë prej tyre botohen për herë të parë.*

*Ideja qendrore që spikat në këto shkrime është intensifikimi i përpjekjeve për zbatimin e vendimeve historike të Kongresit të 7-të të Partisë. Çështja shtrohej që puna drejtuese të përsosej më tej, me synimin që njerëzit të bëheshin të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e madhe, të cilën e kërkonte arritja e objektivave, si dhe të ngrihej më lart niveli i organizimit dhe i kontrollit. Këto kërkonin që Partia, si kurdoherë, të ishte në ballë të punëve, të revolucionarizohej jeta e brendshme e organizatave-bazë të saj, të rriteshin më shumë fryma luftarake dhe roli pararojë i komunistëve.*

*Me një drejtim efektiv të organeve shtetërore e të ekonomisë dhe të organizatave të masave nga ana e organeve dhe e organizatave të Partisë, do të arrihej mobilizimi total i kapaciteteve fizike e mendore të punonjësve e të kuadrove për realizimin e tejkalimit e planeve në të gjithë treguesit. Për këtë, porosiste shoku Enver Hoxha, duhen shfrytëzuar drejt mundësitë e mëdha të krijuara nga rendi socialist, rezervat e brendshme që u sigurojnë ekonomisë burime plotësuese, shtetit më shumë të ardhura, popullit më tepër mallra.*

Duke përsëndetur Kongresin e 8-të të BPSH, udhëheqësi i dashur i Partisë dhe i popullit theksonte se përmbushja me sukses e detyrave kërkon «të punohet kudo me frymë revolucionare e disiplinë proletare, me rendiment e cilësi të lartë, që të realizohen të gjitha normat e punës, që të mbrohet e të forcohet pareshtur prona e përbashkët dhe në çdo fushë e nga kushdo të zbatohet një regjim i rreptë kursimi».

Në tërësinë e problemeve ekonomike të trajtuara në vëllim theksi vihet te puna për shtimin e prodhimit industrial e bujqësor. Krahas detyrës për të nxjerrë prodhime me cilësi të mirë dhe me kosto të ulët, nënvizohet se është e nevojshme të luftohet fenomeni negativ i njëanshmërisë dhe i globalizmit në zbatimin e planeve. Në aktivin e Partisë të rrethit të Vlorës dhe në mbledhjen e Byrosë Politike më 17 qershor 1977 tërhiqet vëmendja për luftë kundër koncepteve e praktikave të njëanshmërisë në industri dhe në bujqësi. Ndërsa orientohet për të intensifikuar prodhimin e dritërave të bukës e për të krijuar më shumë rezerva, vihet si domosdoshmëri kryerja mirë e detyrave nga çdo sektor tjetër i bujqësisë dhe jepen këshilla të vlefshme për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë, sidomos për mbarështimin e lopës, pa lënë pas dore bagëtitë e imëta.

Arritja e objektivave të caktuar nga Partia kërkon te t'u kushtohet rëndësia e duhur, ndër të tjera, edhe sektorit financiar në ndërmarrjet industriale e në kooperativat bujqësore, forcimit të rregullit e të kontrollit në çështjet e administrimit dhe të ruajtjes së pronës socialiste. Në vëllim theksohet nevoja që të aktivizohen

më me efikasitet grupet e kontrollit punëtor e fshatar, që këto të veprojnë të organizuara dhe në mënyrë kompetente, të harmonizuara me format e tjera të kontrollit.

1. Nga zbatimi konkret i direktivave do të gjykohej sa ishin përvetësuar mësimet e Kongresit të 7-të të Partisë. Duke vënë në dukje arritjet në këtë aspekt, shoku Enver Hoxha shtronte me forcë detyrën e madhe të ngritjes së mëtejshme të nivelit ideopolitik të punonjësve, të rritjes së aftësive profesionale e të kulturës së tyre. Në disa mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH ai ndalet në format e përshtatshme të punës që duhej të përdornin Partia dhe organizatat e bashkimeve profesionale e të rinisë. Midis të tjerash vlerëson rolin e madh nxitës të edukimit me patriotizmin e me trimërinë, me dashurinë për gjuhën e për kulturën e popullit tonë.

Nga analiza dhe demaskimi që i bëhet në disa materiale të vëllimit veprimtarisë komplotuese të grupeve armiqësore, midis të tjerash, del mësimi kurdoherë aktual për të mprehur vigjilencën revolucionare, për të qenë të papajtueshëm me armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm, me çdo shtrembërim e qëndrim liberal, për ta zhvilluar me konsekuencë luftën e klasave.

Shoku Enver Hoxha tërheq vëmendjen që të mbahen gjithmonë gati si armët politiko-ideologjike, ashtu edhe ato të zjarrit. Që njerëzit tanë të përvetësojnë idetë marksiste-leniniste dhe Artin Ushtarak të Luftës Popullore, udhëheqësi i Partisë nënvizon nevojën e një përgatitjeje të gjithanshme luftarake dhe të forcimit të disiplinës proletare në stërvitjet ushtarake. Në këtë

kuadër, mësim dhe porosi jepen edhe për përsosjen e veprimtarisë së shkollave të lira ushtarake, për rritjen e rolit udhëheqës të Partisë në terren dhe në ushtri.

Siç del edhe në shkrimet e kësaj periudhe, plotësimin e detyrave në çdo fushë shoku Enver Hoxha e shikonte të lidhur ngushtë me situatat ndërkombëtare. Në vëllim afirmohet edhe një herë vija e drejtë e Partisë së Punës të Shqipërisë, mbrohen me vendosmëri parimet marksiste-leniniste dhe luftohen teorizimet e revizionizmit modern e të Partisë Komuniste të Kinës, në veçanti. Fjala e mbylljes në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH përmban një analizë të thellë dialektike të ngjarjeve në botë, të objektivave dhe të detyrave që kanë komunistët. Në vazhdim të tezës së Kongresit të 7-të për luftë në të dy krahët, kundër imperializmit e revizionizmit, autori thekson disa çështje kardinale lidhur me qëndrimin e papajtueshëm që duhet mbajtur ndaj armiqve më të egër të popujve, dy superfuqive, ndaj imperializmit dhe revizionizmit modern. Në tehun e kritikës së rreptë e parimore vihet edhe revizionizmi kinez. Duke bërë të qartë rrezikshmërinë e këtij oportunizmi të ri, shoku Enver Hoxha shtron përpara anëtarëve dhe kuadrove të Partisë të ndjekin me kujdes situatat dhe, me luftë të vendosur kundër predikimeve antimarksiste të udhëheqjes kineze, të mbrojnë haptazi nga çdo shtrembërim teorinë fitimtare të proletariatit.

Edhe materialet e këtij vëllimi përbëjnë një burim tjetër njohjeje me vijën e politikën e drejtë të Partisë sonë dhe me kontributin e madh teorik e praktik që ka dhënë shoku Enver Hoxha. Mësimet dhe detyrat që dalin prej tyre do të nxitin më tej masat punonjëse, të

*udhëhequra nga komunistët, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave në rritje të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit.*

*Vëllimi është i pajisur me tregues.*



# KINA SYNON TË BËHET SUPERFUQI

Shënime

5 mars 1977

Që Kina është në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kjo për ne nuk ka asnjë dyshim. Duket se mes këtyre dy vendeve ekziston një marrëveshje e fshehtë për luftën e tyre të përbashkët kundër social-imperializmit sovjetik. Pra, Kina, që ka ndërtuar strategjinë e saj, ose më mirë të themi që e ka ndryshuar strategjinë e saj, nuk ka llogaritur interesat e revolucionit botëror, të çlirimit të popujve, por ka llogaritur forcimin e saj si një shtet i madh socialimperialist. Në këtë pirosti të dy këto shtete synojnë të arrijnë në dobësimin e socialimperializmit sovjetik. Kjo politikë e Kinës shprehet edhe në përpjekjet që bën ajo që të gjithë komunistët, partitë marksiste-leniniste dhe lëvizjet nacionalçlirimtare në botë ta konsiderojnë socialimperializmin sovjetik jo vetëm nga ana strategjike, por edhe nga ana taktike, si armikun kryesor, ose si të vetmin armik që duhet luftuar me çdo kusht.

Kina ka marrë dhe po merr ndihma nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga vendet e tjera kapitaliste të botës, si nga ato të Evropës, ashtu edhe nga

Japonia. Këto ndihma, sidomos tash në fillim, janë ndihma ushtarake. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në radhë të parë, i kanë dhënë Kinës ordinatorë të fuqishëm dhe do t'i japin edhe të tjerë më vonë. Vetëm se në kursin prokinez Shtetet e Bashkuara të Amerikës i ngadalëson çështja sovjetike, sepse nuk dëshirojnë që sovjetikët të acarojnë qëndrimet ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo do të thotë se **imperializmi amerikan kërkon të mbajë në dorë «edhe shkopin, edhe karotën»**. Dhe karotën ndaj Bashkimit Sovjetik ai nuk e ka ndalur, i ka dhënë kredi të mëdha. Dihet se këto kredi të mëdha Bashkimit Sovjetik nuk i jepen pa interes nga ana e imperializmit amerikan. Me këto kredi ky synon disa qëllime të caktuara dhe, në radhë të parë, që Bashkimi Sovjetik të mos jetë agresiv kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo nuk do të thotë se midis socialimperializmit sovjetik dhe imperializmit amerikan nuk ka kontradikta. Jo, midis tyre ekzistojnë kontradikta, bile të mëdha, të cilat ne duhet t'i shfrytëzojmë. Por nuk mund të themi se mes këtyre dy superfuqive nuk ekzistojnë marrëveshje dhe mirëkuptime. Kjo është faza e ndarjes së botës, e ndarjes së tregjeve. Pra, ka ashpërsim në marrëdhëniet mes tyre, por ka edhe ujdi; ndryshe nuk kuptohet gjithë kjo ndihmë e madhe që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të gjitha shtetet e tjera kapitaliste i japin Bashkimit Sovjetik, shtete që, siç thotë Kina, po kërcënohen dita me ditë nga një sulm i befasishëm dhe i rrufeshëm i ushtrisë sovjetike.

Bashkimi Sovjetik, siç thonë vetë kinezët, mban në kufi me Kinën afër një milion ushtarë. Të mbash një



milion ushtarë sovjetikë në kufi me Kinën do të thotë të dobësosh frontin evropian, të cilin Kina e konsideron si frontin më të rrezikshëm në rast të ndonjë sulmi nga ana e sovjetikëve.

Strategjinë e saj, autor i së cilës është Mao Ce Duni, Partia Komuniste e Kinës kërkon ta adoptojnë të gjitha partitë komuniste marksiste-leniniste dhe popujt e botës. Kjo është njëlloj si ajo që bënë Hrushovi dhe hrushovianët, të cilët kërkonin të na impononin neve tezat teorike, politike, ekonomike dhe ushtarake të Kongresit të 20-të etj. për forcimin e socialimperializmit sovjetik. Të njëjtën gjë po bën tash edhe Kina në mënyrë antimarksiste dhe për qëllime jorevolucionare, për interesat e shtetit të madh kinez. Pikërisht për të tilla qëllime kërkon ajo t'u imponojë marksistë-leninistëve në botë një strategji të re që, në mënyrë evidente, nuk mund të quhet strategji revolucionare.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur vendosën t'i japin Kinës kredi në armatime, në industri dhe në drejtime të tjera, llogaritën jo vetëm leverdinë e madhe financiare, por edhe fitimet e mëdha politike, sepse Kina, me peshën e saj, me influencën e saj, bën një propagandë në favor të imperializmit amerikan, duke e paraqitur atë si një fuqi joagresive. Me këtë Kina bën që popujt, të cilët vuajnë nën thundrën ekonomike dhe ushtarake të imperializmit amerikan, të mos e shohin këtë shtypje, ose ta pranojnë atë përpara një rreziku tjetër të madh. Mirëpo ky, rreziku tjetër i madh, nuk është më i vogël nga ai rrezik që u ka hipur kaliboç në kurriz popujve të kontinenteve të ndryshme. Është edhe për këtë arsye që imperializmi amerikan

e financon dhe do ta financojë Kinën edhe në të ardhmen. Derisa kjo ecën në mbështetje të interesave imperialistë dhe hegjemonistë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, derisa Kina e acaron konfliktin e vet me Bashkimin Sovjetik dhe në këtë drejtim Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpiqen që kontradiktat e Kinës me Bashkimin Sovjetik t'i thellojnë, pikërisht ndihma e imperializmit amerikan shërben si benzinë për këto kontradikta. Është për këtë arsye që ne themi se lufta, siç mund të zhvillohet në Evropë, mund të zhvillohet edhe në Azi, pse ajo është pjellë e imperializmit dhe e socialimperializmit. Socialimperializmi sovjetik është një fuqi që ndjell luftën, që përgatit luftën, ashtu sikundër janë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që njëlloj përgatitin luftën.

Kina është pleksur në veprimet e këtyre dy superfuqive, për të arritur në caqet që ka vendosur për t'u bërë edhe ajo një superfuqi. Natyrisht këtej rezultojnë edhe përpjekjet e saj për të nxitur një luftë të tretë botërore. Kjo luftë nuk dihet se ku do të pëlcasë me këtë rrugë që ka marrë Kina, do të pëlcasë në Evropë apo në Kinë. Sidoqoftë Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të nxjerrin gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve.

Në qoftë se Kina do të ishte një vend me të vërtetë socialist, i udhëhequr nga doktrina marksiste-leniniste, dhe do të bënte një politikë revolucionare, atëherë ajo do të luftonte në të dy krahët, kundër të dy shteteve imperialiste. Por në fakt ajo ecën në rrugën e kundërt. Me aleancën që po bën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina nxit luftën mes saj dhe Bash-

kimit Sovjetik, midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pse e them këtë? Se aktualisht ne mund të gjykojmë se janë të dyja superfuqitë që luftojnë për pozita hegjemoniste në botë, që luftojnë për tregje, për të thithur pasuritë e popujve të tjerë, por në këtë rrugë ku ka hyrë Kina, edhe ajo nuk do të mungojë të bëhet një partner i tretë i këtyre qëllimeve dhe i kësaj politike.

Si marksistë-leninistë, ne nuk duhet të ndjekim rrugën kundërrevolucionare dhe antimarksiste të Kinës, por të ndjekim rrugën tonë revolucionare marksiste-leniniste. Duke luftuar për këtë rrugë, ne kemi mbrojtur marksizëm-leninizmin, pastërtinë e tij, kemi mbrojtur interesat e popullit tonë, interesat e popujve të tjerë, çlirimin e tyre dhe jemi përpjekur të minojmë luftën imperialiste atomike që mund të shpërthejë mes këtyre tre partnerëve, të cilët luftojnë për hegjemoni, duke u mbështetur te njëri-tjetri. Mbështetja e këtyre shteteve te njëri e tek tjetri është kurdoherë në dëm të revolucionit botëror, të vendeve socialiste dhe të çlirimit të popujve.

Ne, si marksistë-leninistë, jemi kundër luftërave imperialiste, grabitqare, të shpërthyera qoftë nga socialimperialistët sovjetikë, qoftë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë nga Kina, e cila po transformohet në një fuqi të madhe socialimperialiste. Prandaj, si marksistë-leninistë, ne do të luftojmë kundër këtyre luftërave grabitqare, se të tilla luftëra janë kurdoherë në dëm të interesave të lartë të popujve, të çlirimit të tyre, të pavarësisë dhe të vetëvendosjes së tyre; ato janë në dëm të triumfit të revolucionit dhe të socia-

lizmit në botë. Prandaj, duke qenë kundër luftërave grabitqare, ne jemi kundër fuqive agresive, jemi kundër atyre që aspirojnë të bëhen superfuqi, jemi me popujt të cilët duhet t'i nxitim që luftërat t'i pengojnë dhe, në qoftë se nuk arrijnë dot këtë objektiv kryesor, atëherë t'i kthejnë këto në luftëra çlirimtare. Aktualisht aleanca e marksistë-leninistëve dhe e patriotëve demokratë e përparimtarë në çdo vend qëndron në unitetin e tyre kundër luftënxitësve imperialistë dhe socialimperialistë. Rrugë tjetër nuk ka, strategji tjetër nuk ka.

Kina botën e ndan në tri dhe zhduk çdo diferencë klasore të brendshme, por edhe të jashtme, për arsye se ajo është larguar nga lufta e masave popullore kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, për arsye se strategjia aktuale kineze konfondon qëllimet e shtetit me interesat e masave popullore të shtypura e të shfrytëzuara nga ky shtet i borgjezisë reaksionare. Për Kinën ekzistojnë vetëm shtete që mbështetin politikën dhe strategjinë e saj, të cilat konsistojnë në luftën kundër një armiku të vetëm, socialimperializmit sovjetik, dhe në pushimin e luftës kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo do të thotë që Kina predikon paqen shoqërore vetëm e vetëm që kjo paqe shoqërore t'i shërbejë strategjisë së saj, që synon të forcojë pozitën dominuese të Kinës në të ashtuquajturën botë të tretë dhe të ruajë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga goditjet që mund t'i bëjnë popujt ose drejtpërdrejt, ose tërthorazi, duke goditur grupet kapitaliste në fuqi në shtetet e së ashtuquajturës botë të tretë, që janë të lidhura ngushtë me imperializmin amerikan. Kurse për shtetet

që janë nën sundimin e Bashkimit Sovjetik, Kina ësh-të krejt e çinteresuar; ajo i ka futur popujt e këtyre vendeve në një thes me grupet revizioniste moderne dhe kapitaliste, që janë në unitet të plotë mes tyre dhe që i shtypin këta popuj. Kjo do të thotë se Kina nuk bën diferencime, nuk shikon interesat e këtyre popujve, qoftë të vendeve të ish-demokracisë popullore, qoftë të shteteve të tjera kapitaliste, por që janë nën influencën sovjetike. Kina i identifikon me pushtetin e borgjezisë këto vende dhe me vijën hegjemoniste të udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik.

Pra, ndarja e botës në këtë mënyrë, siç po e bëjnë kinezët, ka për qëllim të shuajë luftën e masave popullore për të shkundur zgjedhën e kapitalit vendas dhe të kapitalit të huaj. Kjo nuk mund të jetë një vijë revolucionare marksiste-leniniste, derisa injoron luftën revolucionare të masave punonjëse kundër kapitalit shtypës, derisa Kina nuk mbron revolucionin dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve.

Të marrim një shembull, Birmaninë. Kina duhet të ketë marrëdhënie diplomatike me Birmaninë e U Ne Vinit, por jo në këto forma kaq të ngushta, siç po vepron. Ajo i quan marrëdhëniet me Birmaninë të përjetshme, jashtëzakonisht të afrueshme, kurse, nga ana tjetër, në Birmani, siç dihet, ka një lëvizje të forcave nacionalçlirimtare popullore, të udhëhequr nga Partia Komuniste e Birmanisë, e cila me forcat e saj lufton në xhungla dhe nëpër male në kushte jashtëzakonisht të vështira kundër forcave reaksionare shtypëse të Ne Vinit. Ky bën sulme dhe vret komunistët e patriotët. Vetë sekretari i përgjithshëm i Partisë Komu-

niste të Birmanisë ra në këto luftime. Por a është e drejtë dhe marksiste-leniniste që gjatë kësaj kohe Kina të ekzaltojë lidhjet e saj me Birmaninë e Ne Vinit dhe pikërisht te ky Ne Vin të dërgojë për vizitë miqësore gruan e Çu En Lait, që i hedh lule këtij xhelati të popullit birman? Ja, kështu i kupton Kina këto marrëdhënie me shtetet kapitaliste, kështu i nënvleftëson ajo marrëdhëniet e saj dhe ndihmën që duhet t'u japë popujve që luftojnë kundër klikave reaksionare që i shtypin e i shfrytëzojnë deri në palcë.

Prandaj «bota e tretë» për Kinën është aleanca me qeveritë e shteteve të kësaj së ashtuquajture botë e tretë dhe jo aleancë e miqësi me popujt e këtyre vendeve. Kina nuk mbështet aspak aspiratat e këtyre popujve, aspirata që janë në kundërshtim të hapët dhe në luftë me udhëheqjet në këto vende, sepse këto udhëheqje janë kapitalizmi në fuqi.

Në shtypin dhe në radion kineze as që shikohet një mbrojtje, qoftë e vogël, e lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve, nuk flitet e nuk shkruhet për demonstratat e fuqishme të proletariatit në të gjitha vendet kapitaliste, nuk flitet për luftën që bëjnë partitë marksiste-leniniste në këto vende. Jo, një propagandë e tillë është zhdukur nga faqet e shtypit kinez. Ky qëndrim mbështet strategjinë e Kinës që t'u japë të kuptojnë shteteve kapitaliste dhe imperializmit amerikan se Kina i ka pushuar luftën revolucionare dhe ndihmën ndaj popujve që luftojnë për çlirim. Nga ana tjetër, mashtrimi dhe demagogjia e Kinës konsistojnë në atë që ajo hiqet pikërisht sikur është revolucionare, sikur ndihmon revolucionarët dhe partitë marksiste-leninis-

te, gjë që nuk është aspak e vërtetë. Në fakt, Kina ndihmon vetëm ata elementë dhe ato grupe të ashtuquajtura marksiste-leniniste, që u këndojnë hosana politikës dhe strategjisë kundërrevolucionare të saj. Pra, në këto kushte, në asnjë mënyrë nuk mund të thuhet se vija politike dhe ideologjike e Partisë Komuniste të Kinës është e drejtë, revolucionare dhe marksiste-leniniste. Ajo ka hyrë në një rrugë pa krye, në një rrugë kundërrevolucionare. Prandaj ne, me propagandën dhe me qëndrimet tona, duhet të theksojmë vijën e vërtetë marksiste-leniniste që konsiston në mbrojtjen e fuqishme të lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve, të partive të vërteta marksiste-leniniste dhe të të gjithë njerëzve demokratë përparimtarë që luftojnë kundër shtypjes së kapitalit vendas edhe kapitalit kozmopolit.

Kina duket sikur i mbështet vendet e «botës së tretë». Mbështetje u bëhet pozitive të qeveritarëve të këtyre shteteve, duke përfshirë edhe ata qeveritarë që janë të lidhur me imperializmin amerikan, ose me të gjitha shtetet borgjezo-kapitaliste që kundërshtojnë socialimperializmin sovjetik. Por nga pozitat revolucionare, në interes të popujve, Kina nuk bën asnjë hap përpara, përkundrazi, po bën hapa prapa.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 444*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 444*

**ATDIIEU MBROHET JO VETËM KUR PËRGATITEMI  
USHTARAKISHT, POR KUR JEMI TË FORTË  
EDHE POLITIKISHT, IDEOLOGJIKISHT  
DIJE EKONOMIKISHT**

*Fjala në aktivin e Partisë të rrethit të Vlorës<sup>1</sup>*

**21 mars 1977**

Shokë dhe shoqe,

Ju përshëndes dhe ju uroj që ky aktiv i organizatës së Partisë të rrethit të Vlorës t'i kryejë me sukses punimet dhe ta kuptojë sa më thellë problemin me shumë rëndësi të mbrojtjes së atdheut, që u shtrua këtu nga sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit tuaj, shoku Gaqo Nesho. Jam i bindur, ashtu sikundër edhe ju, se njohuritë që keni për këtë problem, veçanërisht për çështjet ushtarake, ju do t'i zbatoni në jetë, gjë që do ta forcojë edhe më shumë mbrojtjen e atdheut tonë socialist.

---

1. Aktiv i kushtua gërshetimit të punës së organeve e të organizatave të Partisë në terren dhe në ushtri për kuptimin dhe për zbatimin e detyrave të mëdha në fushën e mbrojtjes.



Unë kam ardhur këtu në Vlorë për të pushuar ca ditë, mbasi nga natyra ky vend është shumë i bukur dhe, siç dihet, era e detit e gjallëron njeriun. Pikërisht kjo është një nga arsytet që ju shoh të gjithë të skuqur e plot shëndet, sido që midis jush ka dhe shoqe e shokë nga brendësia e territorit të rrethit. Por fryma heroike e Partisë dhe fladi i pastër i detit tonë të mrekullueshëm i përtërijnë edhe shokët e malësisë kur vijin këtu.

E lexova para se të vija raportin që u mbajt këtu dhe, në përgjithësi, jam i informuar si për punën e frytshme që keni bërë, për sukseset që keni arritur, ashtu edhe për të metat e rritjes që ekzistojnë në këtë sektor me rëndësi kaq të madhe. Unë nuk asistova dot në diskutimet që bëtë ju për këtë problem, por shoku Gaço më vuri në dijeni se ato ishin diskutime të mira dhe s'ka arsye pse të mos qenë të tilla.

Kongresi i 7-të i Partisë hapi perspektiva të mëdha për komunistët dhe për gjithë popullin tonë. Ai bëri bilancin e fitoreve të arritura gjatë 5 vjetëve që kaluan dhe nga gjithë kjo eksperiencë e madhe që është grumbulluar, formuloi në mënyrë sintetike direktivat për të gjitha fushat e aktivitetit ekonomik, shoqëror, kulturor, të mbrojtjes etj. Për çdo problem jetik të vendit vija e Partisë sonë kurdoherë ka qenë e qartë, marksiste-leniniste. Kuptimi dhe zbatimi i kësaj vije përfaqësohen nga rezultatet e mëdha që janë arritur, nga të cilat Partia dhe populli ynë kanë mësuar dhe kanë nxjerrë eksperiencë të vlefshme, por ata kanë mësuar edhe nga të metat e boshllëqet në punë.

Në këtë zhvillim që është arritur gjatë viteve të

pesëvjeçarit të kaluar, të cilin Kongresi i 7-të i bëri analizën, janë zgjeruar njohuritë, janë thelluar më tej pikëpamjet marksiste-leniniste dhe është rritur hovi revolucionar i kuadrove, i masave, i punëtorëve, i kooperativistëve, i inteligjencies, i rinisë dhe i grave të mbarë vendit tonë. Tash të gjithë kanë një pjekuri më të madhe në kuptimin e problemeve. Ky kuptim ndikon në realizimin e mëtejshëm të detyrave dhe në arritjen e fitoreve të reja e më të mëdha për popullin. Për këto arsye materialet e Kongresit të 7-të të Partisë janë një udhërrëfyes për të gjithë, ato duhen studiuar thellë dhe çështjet teorike, teknike e politike që pasqyrohen në to duhen lidhur me jetën dhe me detyrat konkrete që ka gjithsecili përpara për të kryer.

Tezat dhe zbatimi i detyrave që shtrohen në raportet e Kongresit tonë të 7-të nuk duhen studiuar dhe nuk duhen kuptuar në mënyrë të veçuar nga vija e përgjithshme e Partisë. Te ne, jo vetëm te komunistët, por edhe në masat e popullit, nuk duhet të ketë njeri që të mendojë se «mua më intereson vetëm një problem, ai me të cilin merrem çdo ditë». Ky nuk është një kuptim i drejtë dhe i thellë i asaj që kërkon Partia. Të mos harrojmë se Partia është në udhëheqje, në pararojë. Kjo kërkon që të gjithë komunistët të jenë në dijeni të vijës së përgjithshme të saj, sepse secili vetëm kështu mund ta zgjidhë më mirë edhe problemin e veçantë, për të cilin është ngarkuar me përgjegjësi.

Për këtë arsye Byroja Politike vendosi që për punimin e materialeve të Kongresit të 7-të të Partisë të mos zbatojmë metodën që kemi ndjekur në kongreset e mëparshme, sipas së cilës të deleguarit, që nuk ishin

të shumtë, dërgoheshin për këtë qëllim në rrethe dhe në bazë. Si në çdo çështje, edhe në këtë punë, kurdoherë duhet të mbajmë parasysh se gjithçka ecën përpara, është në dinamizëm. Kështu, kësaj radhe u përpoqëm të gjenim një metodë të atillë që të gjithë komunistët të përfshiheshin jo vetëm në dëgjimin e plotë të materialeve, por edhe të merrnin pjesë në diskutimin e tyre, me qëllim që problemet e shtruara në Kongres të ekspozoheshin sa më drejt dhe të rriheshin thellë. Ekspozimi i tyre u mendua të bëhej nga kuadro që zotërojnë mirë jo vetëm vijën e Partisë, por edhe specialitetin dhe që janë në gjendje ta lidhin si duhet teorinë me praktikën. Kjo që po praktikojmë tash është një formë pune shumë më e mirë se ajo e para dhe, siç po na informojnë shokët, ka dhënë e po jep rezultate. Por rezultatet e saj do t'i shohim më mirë më vonë.

Ne e kemi parasysh se me një të lexuar ose edhe me disa mbledhje apo konferenca, nuk mund të mendojmë se kemi arritur të përvetësojmë thellë e mirë tërë atë sintezë të madhe të punës që bëri Kongresi i 7-të i Partisë për zhvillimin e vendit në pesë vjetët e ardhshëm, por mendojmë se këto konferenca janë një fillim i mirë i një veprimtarie që do të pasohet me mbledhje dhe me studime të tjera të frytshme. Kjo ka rëndësi, se, kur e fillon mirë një punë, të tjerat që vijnë pas saj do të ecin po aq mirë. Prandaj vijën e shtruar në Kongresin e 7-të të Partisë duhet ta bëjmë të njohur.

Këtu, në këtë aktiv, ju morët në shqyrtim dhe analizuat punën që kenë bërë deri tashti për problemin e

mbrojtjes. Por këtë problem të madh unë mendoj se duhet ta kuptoni gjerë, jo vetëm në drejtim të përgatitjes ushtarake të punonjësve tanë. Natyrisht, kjo është një anë me shumë rëndësi, pse përgatitja e mirë ushtarake e njerëzve ka për qëllim kryesor mbrojtjen e atdheut nga një agresion i mundshëm imperialist ose socialimperialist. Por çështja e mbrojtjes së atdheut nuk duhet të konceptohet ngushtë, pse ka dhe një çështje tjetër me rëndësi të madhe, siç është ajo e forcimit ekonomik-shoqëror të vendit, që lidhet dhe ndihmon, gjithashtu, forcimin e fuqisë mbrojtëse të atdheut. Pa një atdhe të fortë ekonomikisht dhe me njerëz të ngritur në një nivel përherë e më të lartë politik dhe ideologjik, pa një popull të kulturuar dhe të ndërgjegjshëm për të mbrojtur deri në fund fitoret e arritura dhe për të korrur fitore të reja në të ardhmen, puna përgatitore për mbrojtjen e atdheut nuk do të ishte e plotë. Pra lufta për forcimin ekonomik të vendit është, gjithashtu, një detyrë tjetër jashtëzakonisht e madhe, sa edhe ajo e para që ju morët sot në studim në këtë aktiv.

Por edhe këto të dyja vetëm nuk janë të mjaftueshme, pse kemi edhe një detyrë tjetër me rëndësi për të kryer — të çajmë rrethimin imperialisto-revizionist. Për këtë të bëjmë më tepër përpjekje, duke mobilizuar të gjitha forcat. Atdheu ynë gjeografikisht gjendet i rrethuar nga armiq të shumtë, ndaj themi se duhet të luftojmë si në rrethim. Puna që bën Partia jonë, influenca e ideologjisë së saj dhe lufta që zhvillojmë për ngritjen e ekonomisë, për ngritjen e nivelit politik, ideologjik e kulturor të njerëzve dhe për forcimin ushtarak të vendit rrezatohen edhe jashtë vendit e të gjitha këto

bëjnë që rrethimi imperialisto-revizionist të dobësohet.

Siç e shikoni, çështja e mbrojtjes së vendit është mjaft komplekse, ashtu siç janë komplekse dhe formojnë një të tërë të gjitha detyrat që na ka vënë përpara Kongresi i 7-të i Partisë neve komunistëve dhe popullit. Prandaj duhet t'i kuptojmë thellë të tëra këto probleme, të ecim frontalisht në rrugën e zgjidhjes së drejtë të tyre dhe të korrим fitore të reja për popullin. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, të integrosh çështjen e mbrojtjes në të gjitha problemet e vendit. Mbrojtjen e atdheut duhet ta kemi kurdoherë parasysh në të tri këto drejtime, pse kështu ajo do të kuptohet më mirë e më thellë, gjë që do të bëjë të mundur të arrijmë rezultatet që dëshirojmë.

Njerëzit tanë duhet ta dinë dhe të jenë të ndërjegjeshëm përse duhet që ne ta forcojmë mbrojtjen. Këtë është e domosdoshme ta forcojmë se liria e atdheut socialist është çështja më kryesore, pse masat tonë punonjëse dita-ditës po derdhin djersë për ngritjen e ekonomisë së vendit me forcat e veta, me mendjen e me vigjilencën e tyre, për ta bërë jetën më të lumtur e më të begatshme. Atëherë të gjitha fitoret që masat i kanë arritur dhe i kanë realizuar vetë, duhet edhe t'i mbrojmë. Këtë nuk mund ta presim nga askush tjetër që të na e bëjë. Edhe përpara, në kohë shumë më të vështira për të, populli ynë ka luftuar dhe ka fituar i vetëm, ai nuk ka pasur miq dhe, kur them që nuk ka pasur miq, këtu nuk e kam fjalën për masat e gjera të popujve të tjerë, por për shtetet dhe për qeveritë që drejtonin jetën e këtyre popujve, të cilat në asnjë kohë

nuk kanë qenë mike të Shqipërisë, përkundrazi, ato kanë dashur që vendin tonë ta mbanin nën skllavërinë e tyre ose ta hiqnin prej hunde.

Ky pësim i së kaluarës na është bërë një mësim i madh dhe aktualisht Partia jonë, me fitoret e mëdha që janë arritur, ka bërë që i madh e i vogël të na ta kuptojnë drejt problemin e mbrojtjes. Kjo do të thotë që, për të fituar mbi armiqtë që mund të na sulmojnë, të tërë duhet të stërvitemi.

Askujt të mos i shkojë në mendje se situatat ndërkombëtare shkojnë duke u zbutur. Jo! Ato gjithnjë e më shumë po komplikohen. Armiqtë e popujve dhe të revolucionit, imperialistët, revizionistët modernë dhe oportunistët e rinj, po organizohen dhe po armatosen; ata përgatiten kështu për një luftë të re, e cila, në qoftë se nuk ndalet nga popujt, me komunistët në krye, do të pëlcasë. Në një eventualitet të tillë, natyrisht, komunistët dhe popujt nuk mund të pajtohen me luftën grabitqare imperialiste, atyre u bie detyrë që ta kthejnë këtë në një luftë të drejtë çlirimtare.

Lidhur me luftën që po përgatitet dhe për të cilën Partia jonë është kurdoherë vigjilente, së pari, kërkohet të ndiqet zhvillimi i situatave në botë, nga të cilat lypset të nxirren konkluzione se si duhet vepruar kur të arrijë momenti i rrezikut. Duke e mbajtur vazhdimisht ngrihur vigjilencën, duke ndjekur me kujdes e vëmendje zhvillimin e ngjarjeve, Partia dhe populli ynë do të mund të marrin me kohë masat që të mos gjenden në befasi përpara forcave të armikut, të cilat as duhen mbivlerësuar, as duhen nënvleftësuar.

Për ruajtjen e lirisë, të pavarësisë së atdheut dhe të fitoreve të arritura gjatë ndërtimit të socializmit, ne duhet të përgatitim një forcë të pamposhtur, që konsiston në stërvitjen qysh tash të të gjithë popullit ushtar. Kjo do të thotë të punojmë, të përgatitemi dhe të organizohemi kundër çdo armiku për të zhvilluar një luftë të madhe popullore deri në fitoren e plotë mbi të. Neve na është dashur të gjenim format më të përshtatshme, të gjenim rrugën më të mirë për edukimin dhe për organizimin e njerëzve tanë, të cilat të ishin në përputhje me rrethanat kombëtare dhe ndërkombëtare; të gjenim atë mjet edukimi ushtarako-politik masiv sikundër është Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore, i bazuar në teorinë e marksizëm-leninizmit, në praktikën revolucionare të popullit tonë e sidomos në praktikën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, si dhe në eksperiencën luftarake revolucionare të popujve të botës e në zhvillimin e strategjisë dhe të taktikave të luftërave të tyre çlirimtare. Mbi këtë bazë Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror formuluan Tezat e Këshillit të Mbrojtjes dhe përcaktuan format dhe rrugët për përgatitjen mbi bazën e këtyre tezave të të gjithë popullit ushtar, si dhe të kuadrove që do të udhëheqin forcat tona ushtarake në betejat e mundshme.

Për organizimin e kësaj force të madhe, ne, sikundër e dini, jemi frymëzuar nga tezat e Leninit. Në analizat që ka bërë Komiteti Qendror ka arritur në përfundimin se, në kushtet kur në vendin tonë socializmi ka triumfuar, janë krijuar premiset për të kaluar në organizimin e Shkollës së Lirë Ushtarake.

Ne jemi marksistë, jemi dialektikë, prandaj kurrë

nuk duhet të themi se një vendim që është marrë, pa varësisht se është i drejtë nga ana e përmbajtjes së tij ideologjike dhe politike, nuk lyp perfeksionim. Jeta, zhvillimi, ecja përpara na bëjnë që, pa ndërruar parimin, ta përmirësojmë më tej atë që kemi vendosur, ta bëjmë më të përshtatshme në kushtet e reja që krijohen. Me këtë dua të them se Partia, si në terren edhe në ushtri, duhet t'i ndjekë me kujdes e me vëmendje të pandërprerë shkollat e lira. Organizim për organizim nuk ka dhe nuk mund të ketë te ne. Organizimi ka një qëllim dhe për sa i përket organizimit të shkollave të lira, qëllimi i madh i tyre është të edukohet ushtarakisht mbarë populli.

Rëndësi të madhe kanë këtu përmbajtja e programit të punës së shkollës së lirë, lëndët që zhvillohen në të, qofshin këto lëndë teorike ushtarake, lëndë politike, qofshin stërvitjet e ndryshme që parashikohet të bëhen, sidomos stërvitjet ushtarake. Në qoftë se instruktorët tanë të ushtrisë dhe të Partisë i kuptojnë në një shkallë kaq të gjerë rëndësinë e mbrojtjes së atdheut dhe stërvitjen politike e teknike të njëzëre që marrin pjesë në Shkollën e Lirë Ushtarake, pa dyshim rezultatet do të jenë shumë të mira. Prandaj këta instruktorë duhet ta shikojnë çështjen me seriozitetin më të madh dhe të mos lënë në programet e këtyre shkollave gjëra të panevojshme.

Stërvitjet duhet të bëhen në përshtatje me ngritjen ideologjike, politike dhe ushtarake të efektivit të shkollës, prandaj të vihet në dukje dhe të pastrohet çdo gjë që ka të bëjë me një rutinë të sëmurë e të panevojshme. Në qoftë se kuadri që kemi në Shkollën e



Lirë Ushtarake i ka parasysh të gjitha këto probleme, atëherë programi i saj do të jetë me të vërtetë edukues, një program me karakter krijues i një ushtrie të fortë popullore, që do të dijë të zbatojë si duhet, drejt e në çdo rrethanë direktivat e Komitetit Qendror të Partisë dhe Tezat e Këshillit të Mbrojtjes.

Kjo kërkon që përgatitjes së kuadrove që ngarkohen të japin mësim në shkollat e lira ushtarake, nga ana e Partisë dhe e Komandës (se tani ne kemi krijuar edhe kurse speciale për këtë qëllim), t'i vihet kujdes më i madh. Çdo gjë në këtë drejtim duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të Partisë dhe, kur themi nën kontrollin e Partisë, kuptojmë organizatën e Partisë, si në ushtri, edhe në terren. Kjo për arsye se ushtria jonë nuk është vetëm një ushtri e kazermës, po një ushtri që shtrihet në të gjithë territorin. Në shkollat e lira pleksen të tëra organizatat, të cilave u vihet një detyrë e madhe dhe e njëjtë: të stërvitin mirë popullin me artin tonë ushtarak dhe ta bëjnë të aftë për mbrojtje.

Prandaj, në qoftë se ekziston prirja (dhe unë e di se për shkollat e lira ushtarake ekziston) që kuadrot e ushtrisë të përpiqen t'ua lënë gjithë barrën kuadrove të terrenit, ose ka edhe raste që kuadrot e terrenit t'ua lënë barrën atyre të ushtrisë, në të dyja këto raste, kur shihen neglizhenca të tilla, të bëhen edhe kritika në drejtim të njëri-tjetrit, duke kërkuar që si ushtarakët dhe kuadrot e terrenit të merren si duhet me stërvitjen e efektivitet të shkollave të lira. S'ka si bëhet ndryshe; të dyja palët, domethënë edhe komanda ushtarake, edhe komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të

terrenit, me një fjalë ushtri dhe terren së bashku, është e domosdoshme të bashkëpunojnë, të marrin pjesë aktivisht në këtë punë. Sikundër e dini vetë, ka edhe raste kur ndonjë komandant i repartit ushtarak i lan duart nga shkolla e lirë, ku stërviten rezervistët e repartit të tij, dhe këtë punë me shumë përgjegjësi ia lë vetëm zëvendësit të vet. Ky nuk është një kuptim i drejtë marksist, ashtu siç na mëson Partia, i këtij problemi të madh.

Interesimi i komandantit, i shtabit dhe i oficerëve të tjerë të komandës së repartit nuk duhet të përqendrohet vetëm te reparti i tyre. Ushtria e rregullt, siç thashë përpara, shërben si bërthamë dhe ka rëndësinë e vet, por komandanti dhe shtabi i repartit kanë rreth tyre një tjetër ushtri të tërë të madhe, e cila është shumë më e gjerë nga ai reparti i zakonshëm, rreth të cilit është gjithë ushtria e kohës së luftës e territorit që mbulon, janë forcat vullnetare, rinia e shkollave. Me të tëra këto forca duhet punuar që të përgatiten, të stërviten, të edukohen. Pra, komandantët e reparteve, të ushtrisë së rregullt duhet të punojnë të gjithë për përgatitjen e reparteve që komandojnë, pse kjo, siç i thonë, është skeleti i ushtrisë sonë, që do t'u japë frymëzimin e vet, siç dëshiron dhe na mëson Partia, të gjitha reparteve të kohës së luftës. Kjo do të thotë që ata nuk duhet ta neglizhojnë Shkollën e Lirë Ushtarake.

Duke e parë kështu problemin, komandanti i repartit duhet me detyrë të marrë pjesë në zhvillimin e mësimave në shkollën e lirë, të marrë pjesë në mbledhje të ndryshme, të dëgjojë kur njerëzit diskutojnë, kur u përgjigjen pyetjeve, të asistojë, gjithashtu, edhe

në stërvitjet që bëhen dhe jo vetëm kaq, ai të mos qëndrojë larg njerëzve që stërviten, por të marrë pjesë edhe vetë, ashtu siç merr pjesë kuadri ynë oficer në stërvitjen e repartit që drejton.

Kështu, komandanti i një njësie të ushtrisë së rregullt duhet ta konsiderojë shkollën e lirë njëlloj si repartin e tij, pse qëllimi i madh i Partisë është që efektivin e shkollës së lirë ta ngrejë në nivelin e reparteve ushtarake, ku ushtarët që kryejnë detyrën e shërbimit të rregullt ushtarak qëndrojnë dhe përgatiten brenda një periudhe kohe të caktuar. Vetëm kur të arrijë në një shkallë të tillë niveli ushtarak, politik dhe ideologjik i njerëzve që marrin pjesë në shkollën e lirë, atëherë do të krijohet situata që thamë. Të tëra, edhe repartet e rregullta, edhe shkollat e lira etj., shkrihen në këtë ushtri të madhe me të gjitha format e organizuara në reparte të ndryshme.

Në stërvitje, shoqe dhe shokë, duhet të përqendrohet kujdesi i gjithë Partisë, i të gjithë kuadrove tanë. Të bëhet kujdes që stërvitja asnjëherë të mos thjeshtësohet. Kryesorja është që të mësohet përdorimi i pushkës, i mitralozit, i topit, i bombës e i çdo arme apo mjete tjetër, se me ta do të luftohet, me ta do të vritet armiku. Por si në çdo gjë, edhe për sa u përket armëve, ne duhet të kuptojmë edhe politikën, strategjinë dhe taktikën e tyre. Kjo ka rëndësi të madhe, pse gjithë këto armë që kemi nëpër duar, së pari, të bëhemi të ndërgjegjshëm që t'i përdorim mirë, prandaj nuk lejohet që të mos i dimë të gjitha karakteristikat e secilës prej tyre. Çështja tjetër është të dimë edhe se si t'i përdorim ato dhe përdorimi i tyre mësohet në shkollë. E gjithë

kjo punë bën pjesë në shkencën tonë luftarake, të cilën ju do ta gjeni në të gjitha programet, si të reparteve të ushtrisë së rregullt, ashtu edhe të shkollave të lira ushtarake. Strategjia dhe taktikat e shumëllojshme të luftës, sidomos ato që zhvillohen në variante të ndryshme sipas situatave e rrethanave, duhet të mbahen kurdoherë parasysh. Taktikat duhet të jenë të organizuara e të koordinuara, me qëllim që t'i shërbejnë strategjisë sonë të madhe luftarake. Të gjitha këto çështje, natyrisht, do të mësohen dhe duhet të mësohen në shkollë edhe teorikisht, edhe në zbatimin praktik të tyre, ashtu siç kemi bërë vazhdimisht.

Ne kurdoherë jemi përpjekur për ta mësuar teorinë, prandaj të mos kemi frikë prej saj. Partia jonë vazhdimisht ka ngulur këmbë në këtë çështje, se nuk e kuptonim sa duhej. Tani teorinë e kuptojmë më mirë dhe luftojmë ta zbatojmë gjithnjë e më shumë e më mirë në jetë. Po kështu nuk duhet t'i trembemi edhe teorisë së artit ushtarak, ndaj t'i futemi ta mësojmë dhe me siguri do ta kuptojmë si duhet, si nëpërmjet shkollave, ashtu edhe nëpërmjet lojcrave stërvitore që bëjmë vazhdimisht, nëpërmjet ushtrimeve. Rëndësi ne duhet t'i vëmë teorisë, por t'u vëmë edhe ushtrimeve në terren, në kushte sa më të ndryshme e të vështira, duke pasur kurdoherë parasysh sikur armikun ta kishim përpara. Në këtë drejtim të punojë mirë koka e gjithsecilit. Partia në çdo punë, në çdo sektor, nuk dëshiron që njerëzit të jenë automatë, ajo ka nevojë për njerëz që të gjykojnë me kokën e tyre, të kenë imagjinatë, të realizojnë përnjëherë ç'duhet bërë dhe të japin pa vonesë mendimin atje ku duhet. Kështu është puna

edhe me njerëzit tanë në ushtri. Kjo nuk përjashton zbatimin si duhet të urdhrit nga ana e secilit. Urdhri jepet mirë dhe drejt kur ekziston një gjykim i shëndoshë jo vetëm nga komanda, me të cilën efektivi është lidhur, por kur komanda merr edhe mendimin dhe ka parasysh eksperiencën e atyre që drejton. Ju e dini ç'punë e madhe bëhet edhe në ushtri për zbatimin e një vendimi që dërgohet nga lart për t'u zbatuar. Nëse vendimi është i drejtë, i zbatueshëm dhe me një efekt të madh, kjo ndodh se për përgatitjen e tij ka punuar mendja e të gjithë juve dhe jo vetëm e një apo e dy vetave.

Kjo mund të ngjasë vetëm në një ushtri popullore të drejtuar nga një parti marksiste-leniniste, e cila u ngul mirë në kokë njerëzve teorinë e marksizëm-leninizmit, i pajis me njohuri ushtarake, ekonomike e kulturore, i bën ata të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që kanë dhe i vë në rolin kryesor, në rolin që ata vetë duhet ta luajnë. Atëherë rezultati i kësaj pune do të jetë i mirë dhe i rrufeshëm. Këtë veti nuk mund ta kenë ushtritë e vendeve kapitaliste e revizioniste. Imperialistët dhe socialimperialistët mund të kenë, dhe në fakt kanë, armë më moderne e më të përsosura se tonat, megjithatë Partia na mëson që të mos u trembem armëve të tyre. Por këtë mësim të Partisë sonë mund ta kuptojnë vetëm ata që janë marksistë-leninistë dhe një popull si ky yni, që ndërton socializmin, të tjerët e kanë të vështirë ta kuptojnë. «Shqiptarët janë të marrë», mund të thonë për ne njerëz në vendet kapitaliste e revizioniste, por ne s'jemi të marrë, ne gjykojmë me një logjikë të hekurt, sepse shtetet kapitaliste e revizio-

niste mund të kenë me të vërtetë armë më të përsosura, por atyre u duhet, së pari, të përballojnë armët tona dhe, së dyti, të përballojnë vullnetin e hekurt e të pamposhtur të një populli, i cili është i qartë politikisht, është i brumosur ideologjikisht me shkencën marksiste-leniniste, i stërvitur mirë ushtarakisht dhe i fortë ekonomikisht, pra në gjendje që të përballojë çdo situatë dhe njëkohësisht t'i shkaktojë armikut dëme kolosale. Ne kemi një forcë të madhe, që është forca e pa-shtershme e popullit, kemi strategjinë dhe taktikën e luftës sonë popullore, nga e cila tmerrohen imperializmi dhe revizionizmi modern.

Çështja tjetër është se ne jemi në tokën tonë, në atdheun tonë që e njohim me pëllëmbë, dhe bëjmë një luftë të drejtë, ndërsa imperialistët dhe revizionistët bëjnë një luftë grabitqare; morali i ushtrisë së tyre është një moral mercenarësh që i bën të thyhen porsa gjejnë përpara një mur të tillë të çeliktë mbrojtës, siç janë njerëzit e përgatitur të ushtrisë sonë, të zotë nga ana e taktikave ushtarake, të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, që dinë përse luftojnë dhe çfarë mbrojnë.

Njerëzit tanë e dinë se lufta jonë i shërben mbrojtjes së atdheut, por ajo i shërben edhe çështjes së çlirimit të popujve të tjerë. Një frymëzim të tillë nuk e kanë dhe nuk mund ta kenë armiqtë tanë, ata nuk e kanë dhe nuk mund ta kenë këtë forcë të madhe që kemi ne, për arsye se bëjnë një luftë grabitqare, synojnë të vijnë ta robërojnë popullin tonë, të na shkelin vendin, kurse ne bëjmë një luftë të drejtë, se mbrojmë vendin, të cilin e njohim në çdo qoshe.

Këtu ka rëndësi teoria, po ka rëndësi, gjithashtu,

që këtë teori ta zbatojmë në praktikë. Kjo bëhet nëpërmjet rregullave e formave të zakonshme mësimore, pōr edhe jashtë tyre, në jetë, në terren. Edhe me këtë plotësohet më mirë edukimi apo stërvitja ushtarake e njerëzve tanë. Po jua shpjegoj pak shkurtimisht këtë çështje.

Aktualisht, me organizimin që kemi bërë, në mbarë vendin tonë, me të dëgjuar thirrjen e Partisë, njerëzit, sipas detyrave që u janë ngarkuar në rast lufte, zënë përnjëherë vendet e caktuara me kohë, gjë që s'e bëjnë dot të tjerët. Pastaj këtë vend ne e dimë ku e kemi, se jemi përgatitur. Qysh tani duhet të punojmë që ta njohim vendin me pëllëmbë. Për këtë nuk mjafton koha e stërvitjes, prandaj, që ta plotësojmë këtë boshllëk, Partia nxit dhe organizon ekskursionet e rinisë. Djem e vajza shëtisin nëpër kodra, nëpër male e fusha, ku edhe dëfrenë, edhe marrin ajër të pastër e kaliten fizikisht, pastaj si njerëz të një vendi që kanë detyra të mëdha mbi supet e tyre, mbi të cilët rëndon veçanërisht çështja e mbrojtjes së atdheut, ata plotësojnë me kujdes edhe atë që s'e kanë mësuar dot akoma as në teori, as gjatë stërvitjeve. Shikoni me kujdes kudo ku hidhni këmbët, i këshillon njerëzit tanë Partia, vëreni dhe fiksoni në mendje se këtu afër ka një kodër, më tej ndodhet një bregore, diku kalon një përrua i vogël, ku ka një krua etj., etj. Të gjitha këto njohuri janë të domosdoshme dhe shërbejnë për të plotësuar atë boshllëk që nuk e sigurojmë dot në shkollë. Ato ndihmojnë edhe për zhvillimin e iniciativës së çdo luftëtari, të skuadrës, të togës etj. Kur, për shembull, skuadra merr urdhër nga komandanti i batalionit që të

sulmojë për t'i marrë krahët armikut, luftëtarët që e përbëjnë skuadrën e dinë që diku aty pranë ka një bregore, që më tej ndodhen një llogore ose një përrua, një shkëmb, një shtëpi etj. dhe atëherë me kokën e tij komandanti i skuadrës, së bashku me shokët që ka me vete, ndërton planin më të përshtatshëm se si t'ia marrë krahët armikut në vendin që i është caktuar dhe ta asgjësojë. Një gjë të tillë ai mund ta studiojë edhe në hartë, dhe kjo nuk përjashtohet, por ka raste që jo çdo gjë pasqyrohet në harta, pastaj është shumë më mirë ta kesh shkelur pëllëmbë për pëllëmbë vendin që do të mbrosh në kohë rreziku, ta kesh parë me sy, sesa ta imagjinosh veprimin që do të kryesh duke u bazuar në hartë... Kështu duhet të punojë secili për ta njohur vendin, sepse atëherë do të dijë ta zbatojë si duhet dhe me përfitime të mëdha direktivën e Këshillit të Mbrojtjes, kur të marrë një urdhër luftarak, dhe do ta kryejë atë me sukses, pa humbje dhe me dëme të mëdha për armikun, do të dijë të ketë iniciativë dhe të përgatitë sulmin dhe kundërsulmin në kushte më të favorshme.

Për këtë qëllim Partia ka marrë masa edhe në drejtim të fortifikimeve. Ato janë, gjithashtu, një armë tjetër e fuqishme, se plotësojnë atë që ka thënë Partia: «Fusha dhe bregdeti të bëhen si edhe malet një gardh i pakapërcyeshëm për armiqtë». Dhe në këtë rrugë po shkojmë. Kjo detyrë tash është duke u realizuar, po plotësohet në mënyrë të kënaqshme dhe do të plotësohet krejtësisht e në kohën e duhur, sepse për kryerjen e saj janë marrë të gjitha masat, është parashikuar që fortifikimet të jenë të gatshme brenda afateve të caktuara, për të përballuar çdo eventualitet. Kështu, në gjithë



këtë proces edukimi, si njohja e terrenit, ashtu edhe puna për përgatitjen e fortifikimeve luajnë një rol të madh në përgatitjet për mbrojtjen e atdheut. Ne e kemi të qartë që planet dhe armët e armikut kanë për qëllim të thyejnë vullnetin e popullit tonë dhe të na vrasin sa më shumë njerëz. Objektivi ynë është diametralisht i kundërt: duke kalitur një vullnet të çeliktë të njerëzit tanë, t'i bëjmë ata të aftë që ta dëmtojnë sa më shumë armikun dhe ne të kemi sa më pak humbje në njerëz.

Strategjia dhe taktikat tona janë të tilla që, gjatë përgatitjeve që bëjmë për stërvitje, për njohjen e terrenit dhe për fortifikimin, të kemi parasysh që të mos mbyllemi në fortifikime. Jo, ne në çdo operacion do të lëvrijmë e do të manovrojmë jashtëzakonisht shpejt, do t'u biem si rrufe armiqve dhe nuk do t'i lejojmë të vënë këmbët në truallin e vendit tonë. Këtu qëndron forca jonë, prandaj t'u kushtojmë rëndësi edhe fortifikimeve, për ndërtimin e të cilave, natyrisht, barra më e madhe i është caktuar ushtrisë, por në këtë drejtim duhet të ndihmojnë dhe po ndihmojnë kudo edhe masat e gjera të popullit.

Duhet të realizohen në kohë, gjithashtu, edhe punimet e vendstrehimeve, të cilat shërbejnë për mbrojtjen e popullit, por edhe të ushtrisë. Në këtë drejtim ka rrethe që janë mirë, ka të tjera që këtij problemi nuk i kanë vënë sa duhet rëndësi dhe janë prapa.

Çdo detyre që na ngarkon Partia t'i kushtojmë rëndësi që ta kryejmë plotësisht dhe në kohën e caktuar. Kështu qëndron puna edhe me fortifikimet. Që këto të ndërtohen në kohën e parashikuar, kërkohet, në radhë

të parë, një organizim i shëndoshë. Prandaj drejtuesit e Partisë, të shtetit dhe të ushtrisë në rrethe duhet t'i koordinojnë punët me shumë kujdes dhe gjatë përpjekjeve për kryerjen e tyre të mos harrojnë për asnjë çast që punonjësit tanë bëjnë sakrifica, ata lodhen gjatë 8 orëve në punë, plus kësaj u duhet të përballojnë edhe detyra të tjera të rëndësishme, siç janë ato që kanë lidhje me mbrojtjen e vendit, dhe për këtë qëllim punojnë një çikë më tepër se koha e zakonshme. Kjo nuk do të thotë që nga mungesat tona të organizimit t'i mërzhim orë e çast njerëzit, t'i bëjmë ata që të harxhojnë kohën vend e pa vend. Kështu, kur ne kemi forca të lira në një kooperativë dhe këto nuk i mobilizojmë si duhet, kur bashkë me kooperativistët nuk shfrytëzojmë mirë edhe të gjitha mjetet dhe veglat e punës të kooperativës, nuk është aspak e drejtë t'u bëhet thirrje punonjësve të qytetit të lënë punën, të lënë detyrat që kanë dhe të vënë të punojnë në fshat. Një gjë e tillë nuk duhet lejuar dhe pikërisht këtu ka të bëjë shumë çështja e organizimit.

Detyrat e mbrojtjes janë të shumta dhe ne ato duhet t'i kryejmë deri në një. Në këtë rrugë që na ka caktuar Partia kemi arritur e do të arrijmë rezultate akoma më të mëdha dhe atëherë armiqtë nuk kanë çfarë të na bëjnë. Armiku i ndjek përgatitjet që bëjmë ne për mbrojtjen, mirëpo, kur jemi të përgatitur, dihet që ai e ka zor të guxojë për të vepruar kundër nesh. Vetëm në momentin kur kontradiktat midis imperialistëve dhe socialimperialistëve do të jenë thelluar në pikën ekstreme; kur të plasë një luftë e përgjithshme, atëherë ai do të orvatet të sulmojë edhe Shqipërinë, se të guxojë të

bëjë një luftë të pjesshme kundër vendit tonë socialist, siç mund të bëjë kundër një vendi tjetër, që nuk i vë asnjë rëndësi problemit të mbrojtjes, nuk e ka të lehtë. Këtë ne nuk e themi për mburrje dhe nuk e flemë mendjen se s'mund të na bëjnë edhe një luftë të pjesshme. Faktet janë fakte, armiqësia e shteteve që rrethojnë atdheun tonë ka qenë dhe është e madhe, armiqtë tanë të jashtëm nuk janë zbutur ndaj nesh, por çështja është se jemi forcuar ne. Edhe kur ne ishëm më pak të fortë nga sa jemi sot, prapë ata s'kanë mundur të na bënin dot gjë, pse e kanë provuar që, kur kanë bërë tentativa për të na sulmuar, u jemi përgjigjur në mënyrë të rrufeshme, i kemi goditur, i kemi shpartalluar dhe ata janë detyruar të tërhiqen. Sidomos tash që gjendja jonë është shumë më e fortë, armiqtë e shohin qartë që, në qoftë se do të orvaten të futin dorë në truallin tonë, ne do t'u mbërthejmë krahun dhe do t'ua shtypim kokën. Pastaj armiku e mendon se mund të tentojë të hyjë në «valle», po nuk e di si do të dalë. Dhe të jetë i bindur që do të dalë pa pendë.

Rruga që na ka caktuar Partia për mbrojtjen e atdheut, është një rrugë e drejtë. Ushtrinë tonë e shpëtuam nga ajo veprimtari armiqësore dhe shkatërrimtare që zhvillonte grupi tradhtar i Beqir Ballukut. Tashmë është likuiduar ajo situatë e sëmurë që kishin krijuar armiqtë. Kjo punë u bë nga Partia, nga kuadrot, nga populli ynë. Të tërë e kuptuan rrezikshmërinë e kësaj bande, e likuiduan atë dhe tash ushtria, kuadrot e saj, që kanë qenë kurdoherë të devotshëm e besnikë për mbrojtjen e vijës së Partisë sonë dhe për çështjen e popullit, e kanë marrë si duhet në dorë punën në ushtri

dhe çdo ditë e më mirë i kuptojnë e po i kryejnë detyrat.

Çështja tjetër që përmenda në fillim lidhur me mbrojtjen e atdheut ka të bëjë me forcimin e ekonomisë. Ndërtimi i socializmit në vendin tonë po ecën me vrull. Në këtë drejtim nuk mendoj të zgjatem në rezultatet e arritura, pse këto ju i dini të gjitha, dini se si Partia e ka udhëhequr me zgjuarsi popullin për arritjen e objektivave dhe ju vetë, shoqe dhe shokë, keni qenë, jeni dhe vazhdoni të jeni në krye të punëve për realizimin e detyrave.

Kongresi i 7-të i Partisë caktoi detyra të tjera të mëdha për zhvillimin e industrisë, për përparimin e mëtejshëm të bujqësisë, për ndërtimin e veprave të reja të rëndësishme etj. Ne kemi arritur suksese të pamohueshme në të gjithë sektorët e ekonomisë sonë popullore, por duhet të njohim se kemi pasur dhe kemi mundësi të bëjmë edhe më shumë. Ne mund të shënojm fitore të tjera, në qoftë se do të kishim shfrytëzuar si duhet ato mundësi të mëdha që na ka krijuar ndërtimi i socializmit, në qoftë se do t'i kishim kuptuar si duhet problemet dhe punën do ta kishim organizuar në mënyrë më të përsosur. Në këtë drejtim, pra, kemi rezerva të mëdha, që në të ardhmen duhet t'i shfrytëzojmë plotësisht, por kemi edhe të meta, hasim edhe vështirësi të ndryshme që duhet medoemos t'i kapërcejmë.

Në drejtim të ekonomisë të kemi parasysh, së pari, të luftojmë që jeta e popullit të përmirësohet vazhdimisht çdo ditë e çdo vit, prandaj duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që planet të realizohen e bile të tej-

kalohen. Krahas kësaj të kemi parasysh edhe çështjen e dytë, po aq të rëndësishme, që të krijojmë rezerva. Kryerja me sukses e detyrës së parë, realizimi dhe tejkalimi i planeve, shkon tok me ngritjen e vazhdueshme dhe me forcimin e nivelit politiko-ideologjik të punonjësve tanë. Të gjithë e kemi të qartë se populli, kur shikon që vija e Partisë, politika e saj e drejtë i sjellin atij ngritjen e pandërprerë të mirëqenies së vet materiale dhe shpirtërore, e bëjnë atë të lumtur e të gëzuar, ai është një mijë herë i bindur se nuk ka rrugë tjetër më të mirë se kjo e socializmit, në të cilën e udhëheq Partia, prandaj lufton me të gjitha forcat që të punojë edhe më shumë, të ecë akoma më përpara, të mos kënaqet me atë që ka arritur. Atij i hapet perspektiva, i bëhet më e qartë dhe mendon se ku ka qenë dhe ku po shkon. Ai ka pasë menduar përpara për të siguruar disa kërkesa të vogla, kurse sot ka arritur në një nivel të tillë mirëqenieje që as mund ta ëndërronin paraardhësit tanë. Shikoni, pra, se çfarë mundësish kanë krijuar mendja dhe duart e njerëzve të popullit, të cilët ndiejnë kështu një kënaqësi të madhe në jetë, kënaqësi personale dhe familjare, e lidhur kjo me kënaqësinë në masë të të gjithë popullit.

Thashë pak më përpara që ne duhet të krijojmë edhe rezerva. Derisa populli ynë e ka kuptuar domosdoshmërinë e përgatitjes ushtarake dhe të stërvitjes për mbrojtje, atëherë duhet punuar në të njëjtën kohë që edhe prapavijat e ushtrisë të jenë të forta, në mënyrë që populli gjatë një lufte eventuale t'i ketë të siguruar sendet e nevojshme të jetesës, në mos në atë nivel si në kohë paqeje, të ketë gjërat e domosdoshme që të

ushqehet. Pra, të mendojmë se do të na duhet të ushqejmë një ushtri të madhe prej qindra mijë vetash që do të luftojnë në tërë këtë sistem të luftës popullore, si dhe gjithë popullin, prandaj, për të përballuar këto detyra kaq të mëdha, duhet ta zhvillojmë ekonominë në një mënyrë të tillë që, krahas plotësimit të nevojave korrente të përditshme, të krijohen edhe rezerva.

Ne duhet të krijojmë dy lloje rezervash: ato për kohën e luftës dhe ato që na duhen për zhvillimin e pandërprerë të ekonomisë, për zhvillimin e mëtejshëm të mjeteve të prodhimit. Po nga dalin gjithë këto rezerva? Nga djersa, nga puna e popullit tonë. Asnjëri të mos mendojë se këto situata na janë krijuar nga kreditë që na kanë dhënë. Jo, kreditë janë një ndihmë fare e vogël në krahasim me investimet e brendshme. Përballë gjithë asaj pune të madhe që kanë bërë dhe po bëjnë mendja e duart tuaja, shoqe dhe shokë, mendja dhe duart e popullit tonë, që ka ndërtuar gjithë këto vepra të mëdha gjatë më se tri dekadave, kur është derdhur çurg djersa e punonjësve tanë, ndihma e huaj është shumë e vogël. Investimet e bëra për ndërtimin e gjithë këtyre veprave që i shërbejnë ekonomisë sonë, janë nxjerrë nga populli, nga kursimet e nga administrimi i mirë që u ka bërë atyre ai dhe që kapin shuma kolosale.

Në këtë drejtim krijimin dhe shtimin e shumicës dërrmuese të mjeteve të prodhimit e bëjmë ne vetë, me forcat tona. Po mund ta kryenim ne këtë detyrë, në qoftë se nuk do të realizonim planet që kemi pasë vendosur në kongreset e Partisë? Jo, nuk mund ta kryenim. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për këtë plan

pesëvjeçar. Ne as rezerva nuk mund të krijojmë, as popullin nuk mund ta kënaqim, as zhvillimin e mjeteve të prodhimit nuk mund ta realizojmë pa u mobilizuar totalisht për realizimin e planeve.

Pra, shoqë dhe shokë, këto detyra duhen kryer me kujdes dhe ashtu siç na mëson Partia, se janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Kur punëtori punon në torno, Partia e mëson: «Shiko, shoku punëtor, gjatë përpunimit të detalit bëj kujdes dhe mos nxirr shumë ashkla, mos bëj shumë firo; gjatë harxhimit të lëndës së parë përpiqu që çeliku e trashë të cilësisë së lartë ta përdorësh vetëm për ato vegla ndërrimi për të cilat duhet përdorur ai lloj çeliku. Disa pjesë ndërrimi të dorës së dytë kërkojnë çelik të një marke tjetër më pak të kushtueshme, që, natyrisht, edhe atë do ta sjellë shteti, por duhet të bësh kujdes që të mos e harxhosh pa vend, ta kursesh deri në gram in e fundit. Duhet të mendosh se, duke bërë të gjlthë si ti nga një kursim sado të vogël gjatë punës në torno etj., u shërbehët kështu interesave të përgjithshëm, në radhë të parë, mirëqenies së popullit, kontribuon edhe ti për krijimin e rezervave dhe për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, si rrjedhim, punon njëkohësisht edhe për të mirën tënde dhe të familjes. Në këtë vështrim Interesi i përgjithshëm përputhet me atë të veçantin, pra edhe me interesin tënd personal».

Në të gjitha këto drejtime duhet të thellohemí akoma, të reflektojmë, të mësojmë dhe të mobilizohemi me të gjitha forcat në punë. Kurrë të mos mendojmë se e kemi përvetësuar plotësisht zanatin, kurrë të mos mendojmë se me një dhe me dy konferenca ua kemi bë-

rë plotësisht të qartë masave punonjëse vijën e drejtë të Partisë në të gjitha aspektet e saj. Jo. Punimi i materialeve të Kongresit të 7-të nuk mund të mbarojë as me një apo me dy konferenca, as me pesë aktive, pse, për rrënjosjen e tyre në mendjen e punonjësve tanë, duhet të punohet vazhdimisht me vite të tëra.

Në çdo punë t'u referohemi teorisë së Partisë sonë, praktikës së saj revolucionare, sepse, duke vepruar kështu me vendosmëri, është bërë e mundur të arrijmë në këto ditë të bukura që po jetojmë. Ka njerëz që e studiojnë me këmbëngulje teorinë e Partisë, ka të tjerë që e studiojnë atë më pak, po ka edhe nga ata që nuk e studiojnë fare. Duhet bërë përpjekje që këto ndryshime në drejtim të nivelit të njerëzve tanë të zbuten. Me këtë nuk dua të them se duhet dhe do të mësojnë të tërë njësor. Ata që e kanë një çikë më me zor këtë punë, të marrin kurajën e mundimin dhe të thellohen në çështjet teorike, në politikë dhe në teknikë, se kohët vijnë të atilla, shoqe dhe shokë, që çdo gjë duhet ta presim vetëm nga duart dhe nga mendja jonë dhe duart e mendja e secilit, të bashkuara në një të vetme, bëjnë e duhet të bëjnë shumë gjëra.

Më përpara çuditëshim dhe gëzoheshim shumë kur shihnim punëtorët tanë që bënin diçka, por tash ata nxjerrin nga duart e tyre punë të perfeksionuara, bile shumë të perfeksionuara e të ndërlikuara. Lidhur me këtë dua t'ju sjell një shembull. Ne kemi në vendin tonë rëra bituminoze në sasi të mëdha. Tradhtarit Koço Theodhosi, i cili ka pohuar me gojën e vet se asnjëherë nuk ka qenë me Partinë, se që nga koha e luftës e vazhdimisht ka qëndruar në pozitat e armikut të Partisë, ne,



të shqetësuar, i kishim bërë vazhdimisht pyetjen: Do t'i shfrytëzojmë apo nuk do t'i shfrytëzojmë rërat bituminoze nga të cilat mund të nxirren deri 10 për qind bitum? «Është e pamundur, nuk mund të shfrytëzohen», na përgjigjej ai dhe ngulte këmbë se vetëm në Kanada ekzistojnë të tilla rëra bituminoze dhe shfrytëzimi i tyre atje bëhet nëpërmjet një procesi shumë të ndërlikuar që ne nuk mund ta zbatojmë. Mirëpo punëtorët dhe inxhinierët tanë ka afro një vit që e zgjidhën këtë problem, sado të ndërlikuar që na e paraqiste ky armik. Ata kanë ngritur impiantin, i cili tash ka filluar nga shfrytëzimi i rërave bituminoze. Ky nuk është ndonjë impiant aq i ndërlikuar, sa të të zbardhen leshrat e kokës, siç e paraqiste çështjen Koço Theodhosi. Punëtorët tanë, me mendjen dhe me zotësinë e tyre, e ndërtuan atë tashmë dhe po punojnë të ngrenë edhe nja katër apo pesë impiante të tjera të tilla për shfrytëzimin në një shkallë më të gjerë të kësaj pasurie, të rërave bituminoze. E solla këtë shembull për të treguar që mendja e njerëzve tanë, e frymëzuar nga vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë, mund të konceptojë e të realizojë shumë gjëra të mira për popullin. Kështu vendi ynë do të zhvillohet e do të ecë gjithnjë e më përpara nga ana ekonomike.

Rëndësi të jashtëzakonshme për ekonominë tonë ka veçanërisht bujqësia. Ne arritëm një sukses të madh siç vjet me prodhimin e bukës në vend. Por, siç thotë fjala e urtë popullore, me një lule nuk vjen behari. Prodhimi i drithërave të bukës në vendin tonë duhet të ecë çdo vit përpara, që jo vetëm të plotësojmë nevojat vjetore të popullit, por të krijojmë edhe rezerva drithërash.

Gati shumica e shteteve të botës importojnë sot bukë, ndërsa Shqipëria, që përpara vuante për bukë, e prodhon vetë në vend gjithë sasinë e drithit që i nevojitet. Kjo ka bërë përshtypje të madhe në botë. Natyrisht, ka edhe të tillë që thonë: «Kështu flasin shqiptarët», «kjo është propagandë». Por ne shqiptarët themi se kjo është e vërtetë e jo një propagandë boshe. Dhe këtë e provojmë edhe me fakte: Kohët e fundit hodhëm në tregun italian 40 000 tonë drithë. Ne nuk e kemi hallin tek ajo se çfarë do të thonë të tjerët, tymi të na ecë drejt. Çështja është që t'i shtojmë më tej sukseset e arritura. Prodhimi i drithërave është problem kyç për ekonominë tonë popullore dhe, që të mund ta realizojmë vazhdimisht këtë detyrë të madhe, është e domosdoshme të ndjekim rrugën e zhvillimit intensiv të bujqësisë dhe këtë rrugë popullit tonë ia mësoi Partia. Tash duhet të bëjmë përpjekje që ta konsolidojmë këtë fitore dhe planet për prodhimin e drithërave në vend t'i tejkalojmë, me qëllim që të përballojmë nevojat e ngutshme, të shtojmë edhe rezervat. Prandaj në këtë drejtim të bëjmë kujdes të veçantë edhe në të ardhmen.

Krahas punës për rritjen e prodhimit të drithërave, duhet të kryejmë mirë detyrat edhe në gjithë sektorët e tjerë të bujqësisë, shoqe dhe shokë, sepse nuk po i realizojmë si duhet planet që kemi vendosur. Kështu nuk po i kryejmë ashtu siç porosit Partia detyrat në sektorin e blegtorisë, nuk po i realizojmë, gjithashtu, kurdoherë as në atë të bimëve industriale dhe as në atë të pemëtarisë dhe të perimeve. Në këto drejtime jo vetëm nuk po i kryejmë si duhet detyrat, por edhe kur ndodh që planin e realizojmë në ndonjë lloj bime të ve-

çantë, nuk merren masat e duhura deri në fund për ta futur prodhimin në depo. Kështu, për mungesë organizimi, megjithëse vjet u prodhua shumë panxharsheqeri, shokët e Korçës, që nga ish-kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit e deri tek ata të kooperativave që e rritin këtë bimë, nuk kishin marrë masat e nevojshme, dhe, si pasojë, një sasi jo e vogël panxhari na u kalb. Pikërisht për këtë arsye shkarkuam dhe disa kuadro të këtij rrethi që ishin përgjegjës kryesorë për këtë pakujdesi të madhe. Kjo bimë është shumë e rëndësishme, pse populli ka nevojë dhe kërkon sheqer. Pavarësisht nga kriza ndërkombëtare që ka prekur gjithë botën, këtë vit në plan kishim parashikuar t'i jepnim çdo njeriu më shumë sheqer, por nga mungesa e organizimit na ngjasin edhe gjëra të tilla, që, natyrisht, nuk janë aspak të mira.

Realizimit të planeve të bujqësisë edhe në drejtimet e tjera që përmenda, duhet t'i vëmë rëndësi të madhe, se çështja nuk është vetëm që me këtë do të kursejmë bukën, për të cilën duhet të bëjmë çmos që ta ekonomizojmë, natyrisht pa lënë barkun bosh. Organizimi i njeriut kërkon shumëllojshmëri ushqimesh, pra, veç bukës, ai ka nevojë edhe për produkte të tjera, si për qumësht, mish, zarzavate, fruta, për të gjitha. Në qoftë se do të bëjmë përpjekje që këto prodhime t'i sigurojmë në sasi të planifikuara, mirëqenia e popullit do të ngrihet. Tani ne kemi më tepër vegla e pajisje bujqësore, më tepër kuadro dhe eksperiencë etj., prandaj janë mundësitë të prodhojmë më shumë bimë industriale, më shumë ullinj, agrume, fruta e perime. Në këto kushte mund të zhvillojmë më tej edhe industrinë e lehtë

e ushqimore dhe, nëpërmjet prodhimeve të kësaj industrie, të kërkuara aq shumë në tregjet e jashtme, të çajmë rrethimin që kemi përpara. Një nga faktorët që ndihmon për të çarë rrethimin, është edhe rritja e eksportit tonë. Por më parë duhet të prodhojmë, që të eksportojmë edhe prodhime të freskëta, edhe të përpunuara. Pastaj që të eksportojmë nuk do të thotë që të lëmë mangët nevojat e popullit. Jo, në të dyja këto drejtime ne duhet të ecim njëkohësisht përpara, se njëra pa tjetrën nuk mund të bëjë.

Ne nuk mund të rrojmë në autarki, por, kur gjithë bota kapitaliste e revizioniste, që qëndron rreth e qark nesh, në mënyrë koncentrike, është zhytur në një krizë të madhe të përgjithshme, krizë ekonomike, financiare e valutore, krizë shpirtërore, krizë organizimi dhe në një kaos të madh politik, vendi ynë, një vend i vogël socialist, që udhëhiqet nga Partia e Punës, rron në një mënyrë të tillë që jo vetëm papunësi nuk ka, por bukën e bën vetë, gjithë nevojat e tjera i plotëson në mënyrë të kënaqshme, çmimet e mallrave, të cilat në të gjitha vendet kanë vajtur në qiell, në Shqipëri nuk ngrihen, përkundrazi, disa herë ulen etj. Të gjitha këto të mira në vendin tonë janë plumba për armikun. Kur prodhojmë jo vetëm për plotësimin e nevojave të popullit, por edhe për eksport dhe mbushim disa tregje perëndimore me domatet tona dhe me prodhime të tjera, atëherë në popujt e këtyre vendeve krijojmë ide të ndryshme nga ç'propagandojnë armiqtë tanë për Shqipërinë. «Nga vijnë këto prodhime?», — pyesin atje njerëzit. «Vijnë nga Shqipëria», — është përgjigjja. Po, shoqe dhe shokë, ato venë atje nga Shqi-

përia, natyrisht në atë masë sa venë, por, po të eksportojmë edhe ca më shumë, do të kemi fitime të shumanshme, se kështu shtohen edhe mundësitë që të importojmë nga jashtë mallra e pajisje që na duhen për të përmirësuar akoma më tepër ekonominë, për ta çuar edhe më përpara zhvillimin e saj, por njëkohësisht çajmë edhe rrethimin dhe krijojmë në vendet e tjera të botës një opinion të shëndoshë për gjendjen e mirë që ka siguruar socializmi, zbatimi i vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë në vendin tonë. Të gjitha këto çështje lidhur me zhvillimin e ekonomisë sonë ne duhet t'i kemi kurdoherë parasysh, prandaj na vihet detyrë që çdo gjë të kryhet mirë dhe për këtë është e domosdoshme të punojmë vazhdimisht pa u lodhur që t'i ngremë njerëzit politikisht.

Në lidhje me çështjen e planit kam edhe disa vërejtje për të bërë. Këto nuk janë posaçërisht për ju, por janë vërejtje të përgjithshme për disa probleme të pazgjidhura akoma dhe që i preokupojnë shumë Komitetin Qendror të Partisë dhe Qeverinë. Çështja është, shogë dhe shokë, se si global në lekë në disa degë të ekonomisë plani realizohet, kurse në cilësi dhe në zëra nuk realizohet kurdoherë. Ky problem ngrihet vazhdimisht çdo ditë, çdo muaj në propagandën dhe në leksionet që bëjmë, por në praktikë nuk po gjen zgjidhjen e duhur. Kjo është një e keqe e madhe, e cila, në rast se nuk i dalim me kohë përpara, mund të na kthehet në një sëmundje kronike, që të na mbytë ekonominë. Një realitet i tillë nuk kuptohet si duhet nga disa drejtues të ekonomisë, pse, po të kuptohej, do të

merreshin masa të rrepta kontrolli, organizimi, normimi, planifikimi, si dhe masa të përshtatshme financiare, që kërkon një ekonomi e planifikuar dhe e centralizuar. Të gjitha këto masa që përmenda, shumë herë merren të shkëputura, prandaj ato nuk i vijnë në ndihmë dhe në funksion si duhet njëra-tjetrës. Në këtë drejtim ekziston spontaneiteti, i cili lind çrregullimin dhe disbalancimin, shtur disiplinën shkencore, teknologjinë e prodhimit, ngjall te disa punonjës ndjenjën e fitimit më shumë nga sa i japin shoqërisë, krijon te drejtuesit dhe te punonjësit indiferentizmin ndaj kërkesave të planit. Udhëheqja ekonomike e ndërmarrjes këto sëmundje të rënda përpiqet t'i maskojë, duke synuar të arrijë vetëm realizimin e planit si global në lekë dhe me këtë të thotë «dola faqebardhë», por në realitet ka dalë me faqe të zezë, pse populli nuk gjen në treg atë që i duhet, ka mungesa në disa drejtime, stoqet e mallrave shtohen, ka mallra që prishen, dëmtohen e nuk i blen kush dhe të gjitha këto ndodhin pikërisht në një kohë kur lënda e parë për prodhimin e tyre është konsumuar dhe të ardhurat e punonjësve e fondi i pagës janë kapërcyer.

Një gjendje e tillë, në rast se nuk merren masa serioze për ta ndrequr, çon në një rrugë pa krye. Ka njerëz që mendojnë: «Hajde, oburra të tejkalojmë normat, të fitojmë sa më shumë!» dhe me këtë u duket se i bëjnë mirë vetes, duke marrë disa lekë më tepër, të cilat me siguri do t'i lënë në një anë tjetër, në qoftë se, siç bëjnë të parët, do të veprojnë edhe ata që prodhojnë, fjala vjen, këpucë. Këpucët që njeriu blen në dyqan, duke u prodhuar nga punëtorët tanë, kur nuk e ka-

në parasysh cilësinë e parashikuar, me siguri do të shqepen brenda muajit, atëherë ç'fitoi ai që i bleu? Asgjë nuk fitoi, përkundrazi, humbi e kështu me radhë mund të themi për çdo mall që duhet të blejmë dhe atëherë futemi në një rreth vicioz.

Partia na mëson të prodhojmë mirë, shpejt dhe me çmim të lirë, se interesi vetjak i secilit sigurohet brenda interesit të përgjithshëm. Askush të mos lakmojë të tejkalojë normën jashtë rregullave dhe në dëm të cilësisë, pse kështu shkaktohen çrregullime, prandaj duhet të merren masa serioze.

Po kush duhet t'i marrë këto dhe çfarë masash duhen marrë? Kuptohet, këto do t'i marrin dhe duhet t'i marrin Partia e pushteti nga lart e deri në bazë. Ata duhet të edukojnë teorikisht dhe praktikisht punonjësit që të kuptojnë mirë se ç'është planifikimi te ne. Shumë mendojnë se e dinë këtë gjë, po nuk është kështu. Ne duhet t'i edukojmë se si të bëhet dhe si të zbatohet ky planifikim.

Që të zbatohen këto masa, njerëzit tanë, pa u kërkuar që të jenë virtuozë, duhet të njohin politikën ekonomike. Ka rëndësi, shoqe dhe shokë, që të bëhen, dhe në fakt bëhen, shumë konferenca, por duhen bërë edhe konferenca me karakter ekonomik, me qëllim që të kuptohet politika ekonomike e Partisë. Dhe tash ne kemi njerëz që mund ta bëjnë një gjë të tillë, të ngarkohen ata me këto probleme dhe t'u shpjegojnë masave sa më qartë, sa më thjeshtë, po jo ta kryejnë këtë punë duke kopjuar librat e të tjerëve dhe pastaj të venë t'u flasin punëtorëve të rinj me terma të rëndë. Prandaj të mendojmë si t'i ngremë njerëzit në atë nivel që

ta kuptojnë drejt politikën ekonomike të Partisë dhe politikën e atij malli që prodhon secili mund ta kuptojë, në qoftë se ka njerëz dhe preokupohen këta që t'ia shpjegojnë. Pa njohur politikën e asaj që nxjerr nga duart e veta, punëtori nuk do të dijë ta prodhojë si duhet dhe do t'ia shkelë cilësisë.

Secili duhet të njohë mirë edhe teknologjinë e prodhimit në vendin ku punon dhe këtë jo vetëm ta mësojë, por edhe ta kontrollojmë si e mëson, si e zbaton, çfarë prodhimi nxjerr. Kështu, të nxjerrim konkluzione për zbatimin dhe kontrollin e normave, të cilësisë, të asortimenteve, për zbatimin e ligjeve, të urdhëresave dhe të rregullores që vë kufijtë e planit dhe të prodhimit.

Këto janë rrugët kryesore për realizimin e planeve. Po i zbatuam në rregull, punët do të na ecin gjithnjë e më mbarë, po i neglizhuam, po i zbatuam shkel e shko, me siguri që nuk do të na venë mirë. Prandaj në këto drejtime na duhet të reflektojmë thellë dhe të marrim masa të gjithanshme organizative dhe edukative.

Prirja e dënueshme e udhëheqjes së një ndërmarrjeje, qoftë kjo shtetërore ose partie, që përpiqet të dalë «faqebardhë» përpara udhëheqjes shtetërore dhe të Partisë më lart, pa e realizuar planin në të gjitha të dhënat e tij, duhet luftuar rreptësisht, pse kjo është një nga burimet e shthurjes dhe të fillimit të mashtrimit. E ç'na duhen vezët që prodhohen me një çmim prej 1,70 lekë kokrra nga kooperativat bujqësore të rrethit tuaj, kur vetë shteti i prodhon ato shumë më lirë dhe i shet me 80 qindarka? Kësaj i thonë të dëm-



tosh shtetin dhe interesat e popullit, sepse, në qoftë se shteti do të subvencionojë vezët e prodhuara me kosto të lartë, atëherë ç'duhet të bëjmë për ta përballuar këtë shpenzim? Të ngremë çmimin e vezës nga 80 qindarka në 1 lek apo të mos i japim fare popullit vezë? As njërrën, as tjetrën nuk mund t'i lejojmë dhe nuk do t'i lejojmë të bëhen!

Prandaj drejtuesit e ndërmarrjeve tona duhet të bëjnë kujdes në këtë drejtim, pse kjo nuk është një tendencë me pasoja të dëmshme vetëm lokale. Mosrealizimi i planit në një ndërmarrje bën që të çalojë prodhimi edhe në shumë ndërmarrje të tjera në shkallë republike që kanë lidhje e kooperojnë me të. Pra një anomali e tillë ndikon negativisht në shkallën e gjithë ekonomisë sonë kombëtare.

As për fajin tuaj dhe as për fajin tonë nuk po vihet në shfrytëzim uzina e polivinilkloridit këtu në Vlorë. Ju e dini pse ngjet kjo. Mirëpo nga përfundimi dhe nga vënia në shfrytëzim e kësaj fabrike në kohën e parashikuar varet furnizimi me lëndë të parë i tri-katër fabrikave të tjera, siç është ajo e prodhimit të artikujve prej plastmase në Lushnjë, ajo e telave të bakrit në Shkodër etj. Ne kishim planifikuar që uzina e PVC-së të hynte më përpara në prodhim, por ajo nuk u vu në shfrytëzim në kohën e planifikuar dhe, si rrjedhim, s'ka lëndë të parë me se të punojë uzina për prodhimin e telave prej bakri; nga kjo as plani i eksportit të telave nuk do të realizohet në kohë e kështu me radhë. E solla këtë si shembull për të treguar se si nga realizimi i planit në një ndërmarrje varet realizimi i tij zinxhir edhe në shumë ndërmarrje të tjera.

Të gjithë, i madh e i vogël, çdo forum, që nga baza dhe deri lart, duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e madhe personale dhe kolektive që kanë për kryerjen e detyrave. Të gjithë kanë kompetenca në sferën e punës së tyre dhe këto kompetenca ata duhet t'i marrin, të mos i lëshojnë, vetëm se duhet t'i zbatojnë drejt, jo në formë shablloni, jo në formë rutine ose në rrugën burokratike. Në qoftë se nuk punohet dhe nuk mendohet kështu për këtë çështje, ta kemi të qartë se do të humbë përgjegjësia, do të shturet disiplina dhe do të zbehet kontrolli, nuk do të dallohet dhe nuk do të bëhet e qartë kush ka merita dhe kush është ai që ka faj, faji bëhet kështu qyrk dhe nuk e vesh njeri.

Kompetencat dhe zbatimi i tyre nuk janë të kufizuar në kuadrin e një ndërmarrjeje; zbatimi ose jo i tyre shkakton realizimin ose mosrealizimin e detyrave në hallkat e tjera. Pra kompetencat janë të ndërlikuara që nga baza e deri lart, në kuptimin që të gjithë duhet t'i zbatojnë ato në sferat dhe në harmonizimin e tyre. Të tërë kanë të drejtë të lavdërohen, kur e meritojnë, dhe të kritikohen nga të gjithë, kur bëjnë gabime. Baza duhet t'i kërkojë llogari udhëheqjes kurdoherë dhe pa frikë. Këtë na e ka lejuar Partia. Po të veprojmë ndryshe në këtë çështje, do të bëjmë gabim, por edhe udhëheqja ka të drejtë t'i kërkojë llogari bazës. Ti je punëtor, shok, por duhet të realizosh detyrën dhe jo pse je punëtor të mendosh se do të të falin Partia dhe klasa punëtore kur gabon ose kur nuk realizon normën, kur nxjerr prodhim me cilësi të dobët etj. Një gjë e tillë nuk duhet të ndodhë në asnjë mënyrë. Çdo punëtor duhet të jetë shembull në të gjitha drejtimet, ndryshe

punët nuk do të na ecin mirë, nuk do të ketë as demokraci, as disiplinë proletare, as centralizëm demokratik, as disiplinë teknike dhe financiare, ashtu siç e kërkon Partia.

Kam përshtypjen dhe dëshiroj të vë në dukje se sektorit financiar në ndërmarrjet tona nuk i jepet rëndësia e duhur dhe, kur përmend ndërmarrjet, me këtë kam parasysh jo vetëm ndërmarrjet industriale e bujqësore, por edhe kooperativat bujqësore. Kësaj ane nuk i jepet rëndësia e duhur as nga udhëheqja e ndërmarrjes, as edhe nga vetë nëpunësit specialistë të ngarkuar me llogarinë. Kjo është një çështje mjaft preokupante. Akoma ka disa drejtues që anën financiare nuk e konsiderojnë si një nga pjesët më të rëndësishme të planit, si një vëzhgues, studiues dhe kontrollues të administrimit të pasurisë së ndërmarrjes, të ecjes përpara ose të prapambetjes së saj. Jo, sektori financiar nuk kontrollon shumë gjëra në ndërmarrjet tona, ai vetëm regjistron hyrjet dhe daljet në mënyrë formale, sa për të qenë defterët në rregull, kurse këta defterë, në fakt, janë në rregull vetëm atëherë kur mjetet valutore, si në hyrje edhe në dalje, pasqyrojnë realitetin e realizimit të planit jo vetëm në global, por edhe në asortimente, edhe në cilësi, edhe në kosto.

Ulja e koston ka një vlerë reale, po llogaritjet e prodhimit gjatë të gjitha proceseve nga kalon ky, bëhen në mënyrë formale dhe kështu lejohet të prodhohen mallra të panevojshme e me defekte, të cilat nuk drejtohen te konsumatori, po mbeten stoqe. Kësaj nuk i thonë ulje kostoje, kështu gënjejnë veten, shoqe dhe shokë.

Kam, gjithashtu, përshtypjen se udhëheqjet e ndërmarrjeve nuk konsultohen sa duhet me financierët, bile, sipas përshtypjes sime, këta i nënvleftësojnë, nuk i përfillin fare. Në sektorët ekonomikë kuadri financiar është, si i thonë, vrima e fundit e kavallit, në vend që ai të jetë nga më kryesorët. Është e domosdoshme që edhe financieri të marrë mirë në dorë kompetencat e tij dhe të mos lejojë as drejtorin, as sekretarin e Partisë të ndërmarrjes që të bëjnë ndonjë hap jashtë vendimeve e rregullave financiare në fuqi. Po u bënë lëshime nga financieri, kjo do të thotë që të shkelet ligji dhe në këtë rast, natyrisht, duhet të merren masat e duhura kundër shkelësve.

Partia duhet t'u japë rëndësi këtyre kuadrove, sepse janë këta që bëjnë e duhet ta bëjnë mirë kontrollin që theksova më parë. Pikërisht se ka disa përgjegjës të pandërgjegjshëm që duan t'i shpëtojnë kontrollit, prandaj edhe e nënvleftësojnë dhe nuk e përfillin anën financiare. Ne nuk e përdorim kurdoherë llogarinë si një levë të rëndësishme të ekonomisë. Kjo vjen se as kuadrot drejtues, as financierët vetë nuk e kuptojnë si duhet këtë çështje dhe në korrelacion me ligjin e vlerës, të kërkesës dhe të ofertës; ata nuk kanë kurdoherë parasysh perspektivën e evadimit, të rikuperimit të fondeve, tatimet, amortizimet etj.

Unë nuk ua vë si pyetje, po ju lutem secili le t'i përgjigjet vetes: në gazetën «Zëri i popullit», «Bashkimi» etj. kurdoherë vazhdojnë të shkruhen artikuj të ndryshëm për probleme me karakter teknik, financiar, ekonomik etj., etj., po vallë lexohen dhe shfrytëzohen këta artikuj për të përmirësuar punën? E marrin mun-

dimin, ta zëmë, teknikët dhe financierët e sektorëve të ndryshëm, nga të cilët kemi boll nëpër ndërmarrjet tona, që, kur botohet një artikull (dhe çdo ditë ka nga një apo nga dy të tillë) që flet për gjendjen në sektorë të ndryshëm, të mbledhin për 10 minuta grupe punëtorësh, t'ua shpjegojnë përmbajtjen e tij dhe t'ua lidhin me gjendjen në ndërmarrje? Me siguri ata do të jenë përnjëherë në gjendje ta konceptojnë dhe ta lidhin përmbajtjen e artikullit me gjendjen në repartin e tyre, bile të japin edhe shembuj, se janë vetë financierë, kur shohin, fjala vjen, që normat në ndërmarrjen e tyre tejkalohen me shumë lehtësi 20 për qind dhe e dinë çfarë rrjedhimesh ka kapërcimi i tyre në një shkallë kaq të lartë dhe të propozojnë çfarë duhet bërë. Vallë bëhet një gjë e tillë? Jo, nuk bëhet veçse rrallë, në vend që këtë punë ta praktikojmë kudo, vazhdimisht, çdo ditë, pse absolutisht është e nevojshme, bile shumë e nevojshme dhe shumë më frytdhënëse sesa të mblidhen njerëzit dhe t'u mbahet një referat i përgjithshëm për këto probleme të rëndësishme ekonomike. Të mbledhësh 600 veta dhe të vijë atje një konferencier me një letër të përgatitur që të thotë disa gjëra në përgjithësi, pa i lidhur konkretisht me gjendjen e ndërmarrjes, kjo në shumë raste nuk është një punë me fryt, kësaj i thonë «ku ishe, hiç gjëkund». Jo, problemet në ndërmarrje janë të shumta, njerëzit kërkojnë sqarime, prandaj Partia duhet të mendojë dhe ta organizojë mirë këtë punë.

Partia dhe shteti ynë na i kanë krijuar të gjitha mundësitë. Tash ne kemi një eksperiencë prej disa dekadash, kemi edhe materiale teorike dhe teknike, nuk jemi më «kalamanë» apo të paditur, pa eksperiencë, si

në vitet e para pas Çlirimit. Atëherë ishim me të vërtetë në vështirësi të mëdha, gjuhë të huaja njerëzit tanë nuk dinin, manuale, që t'ua jepnim në dorë për të mësuar shkencën dhe teknikën, nuk kishim. Për këtë arsye u shtrua me forcë problemi që njerëzit tanë të mësonin gjuhë të huaja, që të kuptonin teknikën dhe teknologjinë e prodhimit etj., se nuk kishim si të bënim ndryshe. Aktualisht kemi manuale me rëndësi të madhe, që i kanë përpiluar vetë mjeshtrit, shkencëtarët, profesorët, deri edhe shumë nga punëtorët tanë. Tash ne e kemi të shkruar nëpër libra eksperiencën e tyre të madhe, e cila duhet të përdoret, të shfrytëzohet konkretisht në shkallë të gjerë, se ka rëndësi të madhe.

Është fakt se bilancet mezi arrihet të bëhen në fund të vitit, kurse ato të 6-mujorit as që studiohen si duhet dhe nuk bëhen objekt diskutimi, as merren masa efikase për të ndrequr situatën. Duke vepruar në këtë mënyrë ministritë, ndërmarrjet dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve nuk e kanë dhe nuk mund ta kenë në dorë si duhet situatën. Ekziston parulla se «plani është ligj dhe përpara tij duhet qëndruar si përpara ligjit», që do të thotë se duhet ta realizosh atë. Kjo është shumë e drejtë, por në brendësi këtë plan si e specifikon secili në sektorin e vet, e specifikon drejt apo jo? Lidhur me këtë çështje lexoja një raport të një kryetari komiteti ekzekutiv, i cili qafej se Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore nuk i specifikonte zë për zë të gjitha nevojat e popullit të rrethit të tij, në mënyrë që industria e këtij rrethi të mund t'i prodhonte. Jo, në asnjë mënyrë nuk mund të veprohet dhe nuk duhet të veprohet ashtu

si mendon ai. Kur rrethi e ka bërë planin, atëherë komitetit ekzekutiv, seksionit të tregtisë, seksionit financiar u bie detyra të specifikojnë dhe të parashikojnë të gjitha ato që i nevojiten popullsisë dhe këto t'ia dërgojnë pastaj ministrisë, e cila, si i mbledh kërkesat nga të gjitha rrethet, cakton proporcionalisht për secilin kuotat në atë masë që ka mundësi dhe ua njofton rretheve. Në qoftë se për të gjitha ato që kishte specifikuar rrethi (dhe atij i bie që ta specifikojë) qenë parashikuar se do të duheshin, ta zëmë, 10 milionë lekë dhe ministria nuk ka aq, po cakton, fjala vjen, 8 milionë, atëherë prapë rrethit, në bazë të nevojave që ka dhe në qoftë se këto nevoja të popullit i ka ndjekur me kujdes një për një, i bie detyrë ta ndryshojë atë shifër dhe të heqë nga plani mallrat e tepërta, ato që s'janë shumë të domosdoshme ose ato që janë me shitje të ngadalshme. Rrethi të mos rispecifikojë vetëm mallra me vlerë të madhe që të realizohet plani shpejt në global, por ato mallra për të cilat ka nevojë më shumë populli, dhe në sasi, në cilësi e me kosto të ulët. Kështu duhet vepruar dhe jo të gjejmë rrugën më të lehtë e të gabuar.

Pra, ka rëndësi çështja se si e specifikon vetë rrethi këtë plan, si e kupton, se nuk ka kush ta specifikojë tjetër. Këtëj rrjedhin pastaj konsekuenca në zbatimin e planit. Vë planifikuesi në planin e ekonomisë dhe të shpërndarjes atë që i duhet ekonomisë së popullit apo nuk e vë? Që këtu fillon e keqja, se kjo punë nuk bëhet mirë. Përgjegjësia në lidhje me planin nuk qëndron vetëm te realizimi, por që në planifikimin e tij.

Metoda jonë e planifikimit është e drejtë, prandaj, po të zbatohet mirë, do të bëhen më pak gabime, dhe

do të kemi kështu më pak telashe, por kjo nuk zbatohet kurdoherë si duhet. Organet drejtuese të planifikimit në rreth e në ndërmarrje në planifikim shikojnë vetëm interesin e ngushtë të ndërmarrjes dhe të rrethit, ato planifikojnë me rezerva, bëjnë kërkesa materiale mbi normativë, kërkojnë forca pune dhe fonde pagash të tepërta, priren të prodhojnë sa më pak asortimente dhe me cilësi sa më të ulët, që të jenë brenda. Ato thonë se gjoja planifikojnë duke pasur parasysh realitetin e vitit të mëparshëm, por në planifikim nuk shikojnë kurdoherë drejt përmirësimit. Viti i mëparshëm disa herë u shërben atyre për t'u dalë përpara të papriturave, po vetëm për veten e tyre, jo për mbarë ekonominë në përgjithësi. Kështu, meqë «plani është ligj», për të qenë «në rregull» dhe pa pasur parasysh cilësinë, fillohet të prodhohet keq nga ndërmarrjet, të cilat nuk mendojnë që mallrat e tyre të prodhuara me cilësi të dobët mbeten stoqe. Ato nuk mund ta ndryshojnë planin, se është ligj, nuk mund ta ndryshojnë linjën, se duhet të bëjnë një linjë të re, nuk mund të prodhojnë mallra të cilësisë së mirë, se duhet material importi, thonë. Këto gjëra nuk i eliminojnë që në planifikim, por edhe gjatë kohës që punohet për realizimin e planit nuk e zbatojnë si duhet këtë plan që është ligj.

Organet qeveritare, duke filluar që nga ministrinë dhe deri tek organet e pushtetit e të ekonomisë në rrethe, punën duhet ta kontrollojnë si duhet në këtë drejtim. Gjithashtu është e domosdoshme të kombinohen mirë për këtë qëllim puna e Partisë me atë shtetërore, edukimi politiko-moral i punonjësve me atë teknik dhe me atë të prodhimit. Bëhen shpesh mbledhje



dhe shpjegohen e shpjegohen gjatë çështjet, megjithatë një gjë e tillë nuk ka sa duhet efikasitet, se nuk bëhen mirë koordinimi dhe zbatimi që thashë më parë.

Ne tash kemi përgatitur kuadro të shumtë, të shumëllojshëm e të niveleve të ndryshme. Kjo është një ushtri e madhe njerëzish me kokë, me dije dhe politikisht të ngritur. Duhet t'i mobilizojmë totalisht kapacitetet mendore dhe fizike të këtyre njerëzve, se janë ata që mendojnë, që krijojnë, që prodhojnë, jeni ju, shoqe dhe shokë. Të gjithë këta janë njerëz të klasës, bij dhe bija besnike të popullit, që me luftën e tyre, të udhëhequr dhe të edukuar nga Partia, bëjnë mrekulli. Çështja është që këta të drejtohen në mënyrë që të punojnë edhe më mirë. Për këtë qëllim del e nevojshme që puna dhe drejtimi i ekonomisë të organizohen në një nivel më të lartë. Këtë e kërkojnë situatat dhe për t'ia arritur kësaj janë të gjitha mundësitë, lypset vetëm t'i shfrytëzojmë më mirë këto mundësi të mëdha që na janë krijuar.

Problemet e mbrojtjes ushtarake dhe ato të zhvillimit të ekonomisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën; zgjidhja e plotë e tyre krijon mundësi për sigurimin e së ardhmes së vendit tonë. Kjo e ardhme ka lidhje edhe me atë që përmenda në fillim, me çarjen e rrethimit imperialisto-revizionist.

Për sa i përket çarjes së rrethimit në fushën ekonomike dëshiroj të vë në dukje se ajo është një detyrë e madhe për vendin tonë dhe për revolucionin botëror. Ne e kryejmë këtë detyrë duke demaskuar imperializmin, socialimperializmin, reaksionin dhe kapitalin bo-

tëror, por e kryejmë edhe duke mbrojtur si kurdoherë me vendosmëri e me konsekuencë marksizëm-leninizmin, duke mbrojtur e duke ndihmuar me të gjitha mundësitë partitë e vërteta marksiste-leniniste që udhëheqin dhe duhet të udhëheqin revolucionin botëror dhe që mbështetin luftërat e drejta nacionalçlirimtare që bëjnë popujt e botës. Ky është një problem kyç me rëndësi të madhe.

Partia jonë, që në krijimin e saj, e ka mbrojtur, e ka zbatuar dhe vazhdon ta zbatojë me këmbëngulje, me guxim, me heroizëm, me drejtësi dhe pa hezitim marksizëm-leninizmin. Janë pikërisht këto cilësi që e kanë bërë Partinë e Punës të Shqipërisë një parti të fortë, që ka fituar respektin e thellë, simpatinë dhe dashurinë jo vetëm të revolucionarëve dhe të marksistë-leninistëve në botë, por edhe të elementëve liridashës e përparimtarë në shkallë të gjerë. Kjo simpati, ky respekt dhe kjo dashuri, që ekzistojnë aktualisht në botë për një parti të vogël, siç është Partia jonë e Punës e Shqipërisë, kanë ardhur si rrjedhim i vijës së saj të drejtë politiko-ideologjike, i qëndrimeve të saj konsekuente dhe të palëvizshme, që udhëhiqen nga vija e saj marksiste-leniniste, i realizimeve të saj në fushën ekonomike etj. Sa më i fortë të jetë rrezatimi i kësaj vije të drejtë të Partisë sonë në botë, në radhët e partive marksiste-leniniste, të masave revolucionare, të njerëzve përparimtarë e të të gjithë dashamirëve të vendit tonë, aq më të forta bëhen pozitat e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe aq më mirë do ta çajmë ne rrethimin imperialisto-revizionist.

Partia jonë prej kohësh ka lëshuar parullën «Të punojmë, të jetojmë dhe të luftojmë si në rrethim», ajo vazhdimisht është udhëhequr dhe udhëhiqet nga parimi i madh i mbështetjes në forcat e veta. Por vija e Partisë nuk është që të qëndrojmë në këtë situatë rrethimi, por të bëjmë përpjekje, të luftojmë me këmbëngulje për çarjen e çdo rrethimi e bllokade imperialisto-revizioniste. Në frontin ekonomik rrethimi çahet me luftë e me përpjekje për shtimin e prodhimit, me nxjerrjen e mallrave me cilësi të mirë dhe me kosto sa më të ulët, me pakësimin e importit dhe rritjen e eksportit etj. Në frontin politik dhe ideologjik Partia jonë asnjëherë nuk ka qëndruar pasive ndaj ngjarjeve. Ajo, duke e udhëhequr popullin tonë në rrugën e drejtë të socializmit, në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit, ka vepruar vazhdimisht me vendosmëri dhe në mënyrë aktive. Kështu ka vepruar ajo kundër revizionizmit jugosllav, kundër revizionizmit sovjetik dhe kundër të gjithë revizionistëve modernë dhe oportunistëve të çdo kallëpi. Dhe kjo vijë e drejtë, kurdoherë konsekuente, e Partisë e ka bërë atë të përballojë me sukses çdo rrethim. Veprimet e veta, momentet e qëndrimeve të saj, Partia, duke u bazuar në dialektikën marksiste-leniniste, i ka vënë mirë në dukje, i ka bërë të qarta për të gjithë, pavarësisht se ç'mendonin dhe ç'thoshin armiqtë tanë.

Kur Partia luftonte me ashpërsi kundër revizionistëve jugosllavë, ju e dini se armiqtë tanë propagandonin që shqiptarët janë «gramafoni i sovjetikëve», gjë që nuk ishte aspak e vërtetë. Ne kurrë nuk kemi qenë gramafoni i sovjetikëve, por kemi mbështetur me të gjitha forcat tona vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë

Bolshevike që udhëhiqte marksist-leninisti i madh, Josif Visarionoviç Stalini, vijë që përputhej plotësisht me vijën e Partisë sonë. Si një parti marksiste-leniniste e pavarur Partia jonë kurdoherë ka menduar me kokën e saj dhe ka vepruar drejt. Jeta vërtetoi se vija e Partisë sonë kundër revizionistëve jugosllavë ka qenë e drejtë. Titistët e tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe Jugosllavinë e kthyen në një vend kapitalist, e shitën tek të huajt. Sot tri të katërtat e ekonomisë jugosllave janë në duart e kapitalit të huaj, prandaj Jugosllavia ka një pavarësi formale. Shumë shtete hiqen si të pavarura, por në fakt ato janë të varura, mbasi ekonomia e tyre i është nënshtruar kapitalit të huaj.

Kur ne i shpallëm luftë me ashpërsi e vendosmëri revizionizmit hrushovian dhe qëndruam pa u përkulur, armiqtë tanë, edhe kësaj radhe, thanë se Partia e Punës e Shqipërisë është «gramafoni i Kinës». Por ne nuk ishim gramafoni i Kinës, ne jemi marksistë-leninistë dhe Partia jonë, duke mbrojtur në atë kohë Partinë Komuniste të Kinës, mbronte pastërtinë e marksizëm-leninizmit nga një rrymë e madhe dhe e fortë revizioniste, që kishte ardhur në pushtet në Bashkimin Sovjetik. Dhe të gjitha ato që tha Partia jonë kundër revizionistëve hrushovianë, tërë lufta, veprimet, ideologjia dhe propaganda e saj, u vërtetuan plotësisht nga jeta.

Partia jonë ka bërë e vazhdimisht do të bëjë edhe në të ardhmen një luftë të paepur kundër të gjitha atyre partive, grupeve ose elementëve të veçuar, që nuk do të qëndrojnë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste. Ajo nuk mund të bëjë kurrë aleancë me partitë revizioniste oportuniste. Është më mirë të mbetesh dy veta,

si Libknçhti, dhe të qëndrosh me proletariatin revolucionar, ka thënë Lenini, sesa të pranosh, qoftë edhe për një çast, idenë e bashkimit me Çheixen dhe me Cere-telin<sup>1</sup>. Kështu mendon e vepron edhe Partia jonë, ajo nuk do të bashkohet kurrë me ata që tradhtojnë marksizëm-leninizmin ose që përpiqen ta shtrembërojnë atë.

Strategjia e Partisë sonë ka mbetur vazhdimisht e pandryshuar. Kjo nuk është një strategji dogmatike, por revolucionare, që bazohet në një analizë marksiste-leniniste të situatave. Kur një parti nuk udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi, ajo nuk mund të ketë një strategji të qartë e të vendosur, nuk do të dijë, gjithashtu, të ndjekë me kujdes zhvillimin e situatave ndërkombëtare, të shohë kontradiktat që ekzistojnë mes shteteve kapitaliste, mes rrymave të ndryshme në gjirin e borgjezisë në fuqi dhe t'i përdorë ato në interes të revolucionit, të klasës punëtore dhe të popullit që shtypet. Zhvillimet e situatave në botë janë mjaft të komplikuar dhe çështja e madhe për të cilën luftojmë është dëmtuar shumë nga kompromiset tradhtarë, por edhe nga tendencat «majtiste».

Një parti marksiste-leniniste e sprovuar duhet të dijë të përfitojë nga kontradiktat e kundërshtarëve të saj, por duhet të ruhet që të mos bjerë, as në teori, as në praktikë, në batakun e oportunitizmit të djathtë apo të majtë. Taktikat e një partie marksiste-leniniste du-

---

1. Udhëheqës menshevikë. Pas Revolucionit Socialist të Tetorit u bënë pjesëmarrës dhe krerët më aktivë të kundërrivolucionit antlsovjetik.

het t'i shërbejnë një strategjie të qartë, një objektivi të qartë, që do të arrihet me një luftë frontale, të vendosur e konsekuente, luftë edhe me zigzage, por këto zigzage të jenë të menduara drejt, që t'i shërbejnë çështjes së revolucionit proletar dhe jo armiqve të tij.

Partia jonë në qëndrimet e saj politike, ideologjike e praktike është udhëhequr kurdoherë nga mësimet e Leninit. Ajo, në çdo kthesë të historisë së luftës sonë, ka ditur të zbatojë drejt teorinë marksiste-leniniste në lidhje me aleancat me klasa e me korrente të ndryshme që paraqiteshin. Partia dinte të binte në ujdi, qoftë edhe të përkohshme, me tendenca politike ose me njerëz që mund të ecnin edhe për njëfarë kohe me të në luftën për çlirim e për ndërtimin e socializmit. Por këto marrëveshje kurdoherë janë bërë në interesin e çështjes së çlirimit dhe të fitores së revolucionit.

Kështu ka vepruar dhe vepron Partia jonë edhe në arenën ndërkombëtare. Ajo ka parasysh se shumë shtete, të vogla e mesatare, kanë edhe kontradikta me superfuqitë ose me shtete të tjera imperialiste. Ne, duke i njohur këto kontradikta, i shfrytëzojmë, por kurdoherë në interesin e revolucionit dhe të socializmit, në interesin e popujve të këtyre shteteve dhe jo të sundimtarëve, që në të shumtën e rasteve janë në kundërshtim me popujt e tyre. Partia jonë nuk harron për asnjë çast se në këto vende e në këto shtete ekzistojnë kontradikta të thella antagoniste midis të shtypurve dhe shtypësve, midis proletariatit dhe borgjezisë. Këto kontradikta nuk duhet t'i mbulojmë e t'i shuajmë nën pretekstin se gjoja duhen bërë edhe marrëveshje ose kompromise. Marrëveshje ose kompromise tradh-

tare dhe të pabesa ndaj çështjes së revolucionit dhe të proletariatit nuk duhet lejuar të bëhen, ato duhet të dënohen, kurse marrëveshje ose kompromise në frymën e teorisë sonë dhe të mësimëve të Leninit, që të dish t'i ruash, t'i forcosh, t'i kalitësh, t'i zhvillosh taktikën dhe organizimin revolucionar, ndërgjegjen revolucionare, vendosmërinë, gatishmërinë e klasës punëtore dhe të pararojës së saj të organizuar, të partisë komuniste, janë, në rrethana të caktuara, të nevojshme dhe të mundshme.

Të morosh dhe të zbatosh një vijë të tillë marksiste-leniniste është e drejtë. Të bashkohesh me armiqtë e betuar të revolucionit ose me parti të shitura të kapitali dhe të borgjezia, ky është një kompromis i dënueshëm. Lenini i ka shpjeguar të gjitha këto çështje në veprën «Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm». Partia jonë i zbaton me rigorozitet dhe me pjekuri të madhe këto mësimë të vyera të mësuesit tonë të madh.

Dihet se marksizëm-leninizmi nuk është një dogmë, por një shkencë, që, po ta kuptosh dhe ta zbatosh si duhet, është si një busull që të orienton drejt dhe shpejt në çdo situatë. Në qoftë se këtë mjet kaq të vlefshëm dikush e shtrembëron, atëherë shikimi i tij me siguri do të jetë i gabuar dhe strategjia që do të përpunojë nuk ka si të jetë e drejtë, ai do të detyrohet ta ndryshojë atë sipas koniunkturave dhe një strategji e tillë e ndërtuar mbi këto baza nuk mund të jetë në interes të revolucionit botëror e të luftërave nacionalçlirimtare të popujve, bile as në interesin e vetë atij shteti që e ndërton këtë strategji të bazuar në analiza jomarksiste. Në këto rre-

thana, bashkë me strategjinë, ndryshohen, natyrisht, edhe taktikat. Kurse Partia jonë qëndron në pozita të palëkundshme në këto çështje dhe në analizën e situatave ndërkombëtare ajo asnjëherë nuk ka gabuar.

Pikëpamjet e veta Partia e Punës e Shqipërisë, si një parti marksiste-leniniste, e pavarur, i ka thënë kurdoherë haptazi dhe qartë për të gjithë. Kush është dakord me të, ca më mirë, kush ka mosmarrëveshje, ose pikëpamjet e tij nuk përputhen me ato të Partisë sonë, është detyrë për cilindo që ato të shtrohem i t'i diskutojmë dhe të shpjegohejmë. Kjo është rruga që na mëson marksizëm-leninizmi. Partia jonë nuk bëhet kurrë vegël e askujt, as që mendon t'u shërbejë interesave të veçantë koniunkturalë të politikës së njërit dhe të tjetrit; ajo mendon dhe është kurdoherë në shërbim të popullit të vet, të socializmit në Shqipëri, në shërbim të revolucionit botëror dhe në ndihmë të luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

Partia jonë vëzhgon dhe ndjek me kujdes ku janë rreziqet për revolucionin dhe për popujt. Këtë synojnë përpjekjet e saj me analizat që bën ajo për t'u orientuar drejt në qëndrimet dhe në luftën e saj. Ne jemi vazhdimisht në luftë, dhe deri në ndërtimin e komunizmit në shkallë botërore vazhdimisht në luftë do të jemi. Kjo na vë detyrën të zbulojmë dhe të njohim ku janë miqtë dhe ku janë armiqtë tanë e të popujve dhe në këtë rrugë mund të na orientojë drejt vetëm një analizë e bazuar në marksizëm-leninizmin. Tjetër ideologji nuk mund të na udhëheqë, pse do të na orientonte në rrugë të gabuar. Prandaj situatat ndërkombëtare ne duhet t'i analizojmë kurdoherë në dritën e marksizëm-leninizmit.



Partia jonë, si më përpara edhe në Kongresin e saj të 7-të, theksoi se armiqtë kryesorë të popujve janë dy: imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, pse këta kërkojnë të rindajnë botën, të skllavërojnë popujt. Rindarja e botës mes dy superfuqive çon në thellimin e kontradiktave midis tyre, gjë që sjell luftërat imperialiste dhe luftën botërore. Çdonjëra nga të dyja superfuqitë lufton të sigurojë tregje në kurriz të superfuqisë tjetër, por sidomos në kurrizin e popujve. Prandaj Partia jonë mbron tezën që lufta duhet të drejtohet në të dy krahët kundër të dyja superfuqive, edhe kundër imperializmit amerikan, edhe kundër socialimperializmit sovjetik dhe kjo, mendojmë ne, është një tezë e drejtë. Teza tjetër e drejtë, që lidhet me këtë strategji, është ajo që na mëson Lenini se, që të luftosh imperializmin, duhet të luftosh edhe revizionizmin, të luftosh oportunizmin, të luftosh njëkohësisht edhe kapitalizmin brenda në shtetin tënd. Po nuk i luftove të gjithë këta armiq, nuk mund të shkosh drejt revolucionit dhe ta çosh atë deri në fitore, në vendosjen e diktaturës së proletariatit, për arsye se armiqtë e jashtëm janë të lidhur edhe me ata të brendshmit.

Tradhtari i Partisë dhe i popullit tonë, Beqir Balluku, nuk ishte i vetmuar, ai, si një armik që punonte brenda vendit, ishte lidhur edhe me armiq të jashtëm të vendit tonë. Pra popujt, kudo, nuk mund të luftojnë me sukses as kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, pa luftuar në të njëjtën kohë edhe të gjitha ato udhëheqje kapitaliste, revizioniste e reaksionare që sundojnë mbi ta, për arsye se këto shtete, në një mënyrë ose në një tjetër, janë të

lidhura me aleanca, me anë kredish dhe me shumë forma të tjera me të dyja superfuqitë. Atëherë çfarë duhet të bëjmë? Teza e Partisë sonë është të luftojmë kundër tyre.

Ne komunistët, si internacionalistë, mbështetim tezën që revolucioni nuk eksportohet. Ne përkrahim kudo popujt dhe komunistët e vërtetë marksistë-leninistë, partitë e tyre edhe grupimet e mëdha revolucionare, që luftojnë për çlirimin politik dhe shoqëror të tyre. Kjo është rruga jonë. Pse e bëjmë ne këtë? Këtë e bëjmë që të shkatërrojmë përpjekjet e dy superfuqive dhe të kapitalizmit botëror për skllavërimin e popujve, e bëjmë që lufta grabitqare imperialiste të mos arrijë të pëlçasë.

Ne jemi kundër luftërave imperialiste grabitqare, por në të njëjtën kohë përkrahim luftërat e drejta çlirimtare të popujve, prandaj nuk mbajmë pozitat e sehirxhiut ndaj luftërave të drejta, por propagandojmë në favor të tyre dhe i mbështetim ato. Do të ishte gabim të nxitnim shpërthimin e një lufte botërore ose të themi se socialimperializmi sovjetik është më i rrezikshëm dhe se ai e vetëm ai dëshiron të bëhet luftë, se imperializmi amerikan nuk qenka për luftë, sepse është më i dobët dhe për këtë arsye kërkon ruajtjen e statukuosë. Ne nuk mund ta pranojmë këtë tezë dhe e gjykojmë si oportuniste, që nuk e favorizon prishjen e planeve të luftërave grabitqare. Imperializmi, socialimperializmi dhe kapitali botëror e kanë në gjak luftën, ata duan tregje, luftojnë për shtypjen e popujve dhe, derisa është kështu, atëherë ne duhet t'i luftojmë të tërë këta armiq. Prandaj të mbështetësh një tezë të tillë,

sipas së cilës rreziku popujve dhe socializmit u vjen vetëm nga Bashkimi Sovjetik e jo edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të thotë të udhëhiqesh nga pikëpamje oportuniste, revizioniste. Partia jonë nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, ajo është me tezen se duhet të luftohen të dy këta armiq.

Partia e Punës e Shqipërisë pikëpamjet e veta i shtroi drejt dhe hapur në Kongresin e saj të 7-të. Midis të tjerave, ajo vuri në binarë të drejtë edhe çështjen e analizës së botëve. Tash disave u ka hipur një mani që të numërojnë botët, «bota e parë», «bota e dytë», «bota e tretë» e të tjera emërtime të kësaj natyre, që s'kanë asgjë të përbashkët me analizën marksiste-leniniste të kontradiktave të sotme dhe që fshehin përmbajtjen klasore të shteteve. Ato çojnë në zbutjen e luftës klasore, në injorimin e rolit vendimtar që luan proletariati, në injorimin e revolucionit. Nga një përfytyrim i tillë numerik i botës ka dalë teza sipas së cilës «bota e tretë» qenka bërë sot forca kryesore lëvizëse e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Natyrisht, kjo nuk është leniniste.

Lenini nuk ka thënë kurrë që ekzistojnë tri botë. Por, duke e parë botën me syrin e revolucionarit proletar, ai ka thënë se sot në botë ka dy botë: bota e vjetër — kapitalizmi, që është zhytur në konfuzion, i cili nuk do të tërhiqet vetiu, dhe bota e re, që po rritet, e cila është akoma shumë e dobët, por që do të rritet, sepse ajo është e pathyeshme. Nga pikëpamja klasore kjo është e kuptueshme. Lenini, bile edhe Kominterni e më vonë Stalini, kanë bërë edhe klasifikime të shteteve, në vende të zhvilluara kapitaliste, vende më pak

të zhvilluara, vende koloniale e të shtypura etj. Por ky klasifikim, e sidomos konkluzionet që nxirrnin prej tij, nuk kanë të bëjnë fare me ndarjen e botës më trish, siç e përmenda më parë.

Lenini, Kominterni dhe Stalini klasifikonin vendet e sistemit kapitalist. Ata nuk e kanë përfshirë në këtë ndarje Bashkimin Sovjetik, ku ishte bërë revolucioni. Dhe as Lenini, as Kominterni e as Stalini nuk mund ta vinin shtetin socialist të kohës së tyre në një radhë me ndonjë grup të shteteve e vendeve të sistemit kapitalist. Pse e them këtë? E them, sepse trajtimi në baza leniniste i këtij problemi të madh nga Partia jonë nuk u pëlqen udhëheqësve kinczë. Këta e shtrojnë problemin sikur ekzistojnë disa botë. Ata e kanë ndarë botën në tri dhe përfshijnë në këtë ndarje edhe Kinën, të cilën e konsiderojnë si shtet të «botës së tretë». Ne themi se një pikëpamje e tillë nuk është e drejtë, ajo është antimarksiste, oportuniste, revizioniste.

Duke klasifikuar shtetet e sistemit kapitalist, Lenini, Kominterni dhe Stalini nxorën konkluzione lidhur me zhvillimin e revolucionit proletar, me detyrat që shtroreshin para proletariatit botëror si forca vendimtare e revolucionit etj. Ata asnjëherë nuk konfonduan popujt me sundimtarët, nuk konfonduan klasat e vendin e tyre në shoqëri. Kurse mbrojtësit e tezës së sotme për «tri botët» nuk bëjnë fjalë për revolucionin proletar, por për pavarësi kombëtare, ata konfundojnë klasat, popujt e sundimtarët e ndryshëm.

Edhe Titoja, nga ana e vet, reklamoi botën e «të paangazhuarve», ku, në fakt, bëjnë pjesë të njëjtat shtete, që gjoja përfshihen në «botën e tretë» në këtë

organizim, pa qenë organizim, në këtë «shtëpi pa çati dhe pa direkë». Tash kanë dalë edhe rumunët, që po flasin për organizimin e një «bote» tjetër, «botën e vendeve në zhvillim».

Pra, kanë dalë shumë teorira për «botën e tretë», «botën e të paangazhuarve», «botën e më pak të zhvilluarve», «botën e të varfërve dhe të të pasurve» etj. Na bëhen kështu shumë botë, por të gjitha këto janë në kundërshtim me mësimet e Leninit.

Partia jonë në analizat e saj kurdoherë niset nga kriteri klasor. Nga kjo pikëpamje ka vende kapitalisto-borgjeze, ku përfshihen edhe vendet revizioniste, ka edhe vende socialiste, ka borgjezë e ka proletarë, ka shfrytëzues e të shfrytëzuar. Pse e thekson këtë gjë Partia jonë? Sepse nga pikëpamja klasore nuk mund e në asnjë mënyrë nuk duhet të konfondohen popujt me sundimtarët e tyre, aspiratat për çlirim të popujve e aspiratat për revolucion të proletariatit të një vendi ose të shumë shteteve kapitaliste me ato të klikave që sundojnë në vendet e së ashtuquajturës botë e tretë.

Në çdo vend kapitalist ekzistojnë klasa antagonistë dhe kontradikta të mëdha e të papajtueshme klasore. Edhe në vendet që thuhet se bëjnë pjesë në «botën e tretë» kontradiktat antagonistë klasore midis proletariatit dhe borgjezisë janë shumë të mprehta. Në mes të shtypurve, proletarëve dhe fshatarësisë punonjëse, nga njëra anë, dhe kapitalistëve që sundojnë atje, nga ana tjetër, nuk ka e nuk mund të ketë pajtim. Prandaj të mbështetësh pa rezerva politikën e vendeve të së ashtuquajturës botë e tretë, t'u bësh thirrje popujve e revolucionarëve që të bashkohen me klikat sunduese,

me mbretin e Arabisë Saudite apo me fashistin Pinoçeti të Kilit, sepse gjoja kështu e kërkojnë interesat e luftës kundër të dy superfuqive dhe interesat e revolucionit, kjo nuk është leniniste, nuk është politikë klasore proletare. Tezën e «botës së tretë» Partia jonë e kritikon, edhe sepse të flasësh që Shqipëria dhe Kina janë vende të «botës së tretë», do të thotë të futesh në një llum ku zhduket çdo ndarje klasore. Marksistë-leninistët e shtrojnë pyetjen kështu: me kë je, me mbretin e Arabisë Saudite apo me popullin arab, me proletariatin e këtij vendi? Udhëheqësit kinezë nuk e bëjnë këtë dallim, ata i vënë në një plan si proletariatin e fshatarësinë, ashtu edhe klikat shfrytëzuese. Por ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë të shuhen luftërat nacionalçlirimtare, të lihet në plan të tretë e të katërt revolucioni, sepse, sipas teorisë së «botës së tretë», popujve u bëhet thirrje që të bashkohen me udhëheqjet e shteteve të tyre gjoja për t'u rezistuar imperializmit e socialimperializmit. Kjo nuk është marksiste. Partia jonë nuk mund të pranojë një pikëpamje dhe qëndrim të tillë. Por si të bëjë, vetëm të mos e pranojë këtë pikëpamje dhe ta mbajë të mbyllur pa e deklaruar botërisht? Jo, në asnjë mënyrë! Pikëpamjen e vet Partia jonë e shpall në mënyrë që vija e saj të bëhet e qartë, ta marrin vesh të gjithë ç'mendon, dhe tash ka ardhur një situatë që veshët e njerëzve kudo mbahen ngritur për të dëgjuar çfarë thotë Partia e Punës e Shqipërisë për këtë apo për atë problem.

A janë antiimperialistë sundimtarët e klikat në fuqi të vendeve të «botës së tretë»? Lenini e Stalini pikërisht nga klasifikimi që u bëjnë vendeve të sistemit

kapitalist dhe nga analiza e kontradiktave na mësojnë se nuk duhet të mbështetet pa kushte as borgjezia nacionale antiimperialiste e jo më klikat fashiste e reacionare, që janë të lidhura me një mijë fije me imperialistët amerikanë e me socialimperialistët sovjetikë. Ku i kanë bazat dhe mbështetjen e tyre jashtë vendit Shtetet e Bashkuara të Amerikës, te proletariati dhe te fshatarësia e vendeve të tjera? Jo, s'i kanë atje, po te klikat që sundojnë në këto vende, te borgjezia e madhe, te Pinoçetët e pasardhësit e Frankos, te shahu i Iranit e te fashistët e Brazilit etj. Këtyre klikave, për t'i mbajtur në këmbë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës u japin ndihma, armë, kredi etj., që të sundojnë e të shtypin popujt e vendeve të tyre dhe, në rast agresioni, t'i përdorin ata si mish për top për interesat e imperialistëve. Imperializmi dhe socialimperializmi i ndihmojnë këto klika pikërisht për të krijuar dhe për të forcuar pozitat e tyre në luftën që bëjnë për hegjemoni botërore.

Partia jonë, si kurdoherë, edhe në Kongresin e saj të 7-të, i analizoi drejt këto çështje; ajo i vuri mirë pikat mbi i nga ana teorike, politike dhe praktike. Për këtë qëndrim nuk u ka ardhur mirë disa njerëzve dhe disa partive, por u ka ardhur mirë shumë partive që qëndrojnë pa u lëkundur në pozita marksiste-leniniste, u ka ardhur mirë proletariatit botëror dhe gjithë njerëzve përparimtarë dhe revolucionarë në botë. Është kjo arsyeja që materialet e Kongresit të 7-të të Partisë sonë kanë bërë një jehonë të madhe dhe janë shtypur në shumë gjuhë të botës. Ato janë duke u punuar në masat e punëtorëve, në ato të fshatarësisë dhe të stu-

dentëve të shumë vendeve kapitaliste. Raportet e Kongresit të 7-të të Partisë sonë janë botuar në Greqinë fqinje dhe po lexohen në shkallë të gjerë nga masat e punëtorëve e të studentëve grekë, si në universitetin e Janinës e gjetkë. Në shtypin grek janë botuar shumë artikuj që u bëjnë jehonë punimeve të Kongresit të 7-të të Partisë sonë. Edhe në Turqi, gjithashtu, studiohen materialet e Kongresit të 7-të. Kudo në botë kërkohen këto materiale, për arsye se njerëzit gjejnë në to të vërtetën, që mbrohet me vendosmëri nga një shtet dhe nga një parti e vogël si jona. Gjithë këta njerëz, që i lexojnë materialet tona, shohin se kjo vijë e drejtë, që e ka ngritur Shqipërinë në një pedestal të lartë, ka dhënë rezultate që janë në favor të popullit, të klasës punëtore dhe të fshatarësisë sonë.

Jashtë ka tash një interesim të madh për vendin tonë, për Partinë tonë, për shkrimet, për rezultatet e arritura, për ngjarjet e ndryshme e transformimet revolucionare në jetën tonë socialiste. Njerëzit kudo në botë duan të dinë sa më shumë për vendin tonë dhe ne, me sa kemi mundësi, po bëjmë një propagandë më të gjerë, që vendi ynë të njihet gjithnjë e më mirë, sepse njohja e rezultateve që kemi arritur në të gjitha fushat bën që të dobësohet rrethimi imperialisto-revizionist. Sa më shumë të forcohet opinioni i shëndoshë në favor të vendit tonë, natyrisht, aq më të vështirë do ta kenë të veprojnë kundër nesh armiqtë imperialisto-revizionistë, për faktin se ne jemi në gjendje dhe të vendosur deri në fund të shpartallojmë çdo akt armiqësor të tyre, pse brenda vendit është krijuar një mur mbrojtës i pathyeshëm. Veç kësaj, armiqtë tanë



nuk do të gjejnë dot mbështetje në opinionin e jashtëm, siç gjenin në kohët e kaluara, pse sa kohë shkon, aq më e qartë bëhet vija e Partisë sonë në botë, aq më shumë forcohen e bëhen të paprekshme pozitat e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Vetë jeta, vetë ekperiencia tregojnë se idetë e drejta marksiste-leniniste që ndjek dhe mbron me besnikëri Partia jonë, përqafohen nga marksistë-leninistët e vërtetë dhe nga njerëzit përparimtarë në të gjithë botën.

Në drejtim të parimeve ne askujt nuk i bëjmë lëshime, as Partisë Komuniste të Kinës, pavarësisht se me Kinën jemi miq dhe aleatë. Por miq dhe aleatë jemi dhe do të qëndrojmë vetëm në rrugën marksiste-leniniste. Kurrë dhe në asnjë mënyrë Shqipëria socialiste nuk i ka shitur parimet. Është e vërtetë që Kina na ka dhënë disa ndihma ekonomike, por s'duhet harruar që edhe ne i kemi dhënë asaj një ndihmë të madhe politiko-morale. Ne e kemi mbështetur atë në Bukuresht e në Moskë kundër revizionistëve hrushovianë, e kemi mbështetur politikisht në një moment kur ajo kishte mbetur e vetmuar gjatë viteve të Revolucionit Kulturor. Vetë Mao Ce Duni ka deklaruar botërisht se Kina ka një mik për kokë që i është gjendur në kohët më të vështira të jetës së saj. Ne nuk bëjmë kurrë lëshime dhe nuk do të ecim në asnjë rrugë tjetër veç asaj marksiste-leniniste. Këtë ta kenë të qartë të gjithë.

Për disa mosmarrëveshje që kemi me Partinë Komuniste të Kinës Komiteti ynë Qendror ka vënë në korent gjithë Partinë. Si një Parti marksiste-leniniste që jemi, mosmarrëveshjet tona me shokët kinezë kemi

dashur t'i sqarojmë midis dy partive, por nuk kemi mundur, për arsye se ata vetë nuk kanë dashur. Ka kohë që ne u kemi shkruar atyre, u kemi dërguar letra, u kemi propozuar për t'i biseduar së bashku në rrugë partie dhe për t'i sheshuar mosmarrëveshjet. Pra, si marksistë-leninistë, nuk kemi qëndruar mënjanë, e kemi bërë tonën dhe divergjencat kurdoherë i kemi mbajtur brendapërbrenda. Në asnjë dokument ne nuk e kemi sulmuar Kinën publikisht, përkundrazi, kemi folur mirë për të. Udhëheqësit kinezë na akuzojnë tash sikur ne paske- mi sulmuar Kinën tërthorazi, sikur në Kongresin e 7-të të Partisë paskemi shpallur vijën tonë kundër tyre. Po të gjithë e dinë se vija jonë nuk është shpallur në Kongresin e 7-të, këtë vijë Partia jonë e ka përpunuar dhe e ka ndjekur prej kohësh. Kundër «botës së tretë» ne kemi folur që në vitin 1960, kurse përfaqësuesi i Republikës Popullore të Kinës, Ten Hsiao Pini, ka folur vetëm para tre vjetësh në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku deklaroi botërisht se Kina bën pjesë në «botën e tretë». Kështu këtë botë ne nuk e kemi kritikuar kur foli Ten Hsiao Pini, po shumë kohë më përpara. Pra, në Kongresin e 7-të nuk kemi atakuar Kinën, aty ne vetëm afirmuam vijën tonë.

Është e qartë se vija jonë nuk përputhet me vijën e Partisë Komuniste të Kinës për disa çështje, për të cilat, siç thashë, ne kemi trokitur shumë herë në portën e udhëheqësve kinezë që të bisedojmë, dhe për këtë kemi dokumente, po nuk kanë dashur ata të bisedojnë me ne. Pastaj pse ta ndjekë pas Partia jonë Kinën për «botën e tretë», le ta ndjekë po të dojë ajo Partinë tonë,

e cila asnjëherë nuk e ka ndryshuar strategjinë e saj, siç ka bërë Partia Komuniste e Kinës.

Në Kongresin e 8-të të kësaj partie më 1956 është thënë «të mobilizojmë të gjitha forcat tona për të luftuar armikun kryesor, imperializmin amerikan, dhe të qëndrojmë fort në aleancë me Bashkimin Sovjetik». Por, më vonë, kur u bë Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste të Kinës, Mao Ce Duni ndërroi strategji dhe lëshoi thirrjen «të mobilizojmë të gjitha forcat, t'i drejtojmë këto për luftë në të dy krahët, si kundër imperializmit amerikan, ashtu edhe kundër socialimperializmit sovjetik, pse vetëm kështu do të fitojë revolucioni» etj., etj. Ne ishim dakord me këtë vijë.

Por, kur u bë Kongresi i 10-të i Partisë Komuniste të Kinës, përsëri ndërroi strategjia nga ana e udhëheqësve kinezë. Në këtë kongres vetëm Bashkimi Sovjetik u cilësua si armiku kryesor, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo, sepse, sipas tyre, këto na qenkan dobësuar. Po si mund të themi se janë dobësuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kur i kanë dhënë 20 miliardë dollarë kredi Bashkimit Sovjetik dhe përsëri vazhdojnë t'i japin, për të mos folur për kreditë e tjera? Mundet një vend ekonomikisht i dobët të japë të tilla kredi? Prandaj themi ne se nuk është aspak e vërtetë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë dobësuar jo vetëm ekonomikisht, siç propagandon Kina, po as nga ana strategjike dhe as nga ana e armatimeve ato nuk janë më të dobëta se Bashkimi Sovjetik.

Udhëheqësit kinezë thonë se Bashkimi Sovjetik do të sulmojë Evropën, kurse ne themi se ai mund ta sulmojë edhe Evropën, po mund të sulmojë edhe Azinë,

se atje, dhe pikërisht në kufijtë me Kinën, ka përquendruar një milion ushtarë, një numër të madh mjetesh të tjera luftarake dhe bombash atomike. Ne mendojmë se, që ta sulmojë Bashkimi Sovjetik Evropën, do të thotë të sulmojë NATO-n, pra edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që bëjnë pjesë në të. Prandaj shtrojmë pyetjen: është vallë më lehtë për Bashkimin Sovjetik të sulmojë NATO-n dhe Evropën, apo të sulmojë Kinën? Kinezët thonë se Bashkimi Sovjetik nuk i sulmon, se ai do të sulmojë më parë në Perëndim dhe, meqenëse strategjia e Kinës është e tillë që parashikon një sulm sovjetik kundër Evropës, ajo u predikon proletarëve, patriotëve, elementëve përparimtarë, partive marksiste-leniniste, partive revizioniste, partive socialdemokrate që të bashkohen të tërë në një front kundër Bashkimit Sovjetik. Një pikëpamje dhe qëndrim i tillë është antileninist. Kjo të drejton në rrugën e shuarjes së luftës kundër imperializmit, në nxitjen e luftës grabitqare, në përpjekjet për të bindur njerëzit sikur lufta mes Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të NATO-s është në prag të shpalljes, gjë që edhe mund të ngjasë, po në një rast të tillë ç'duhet të bëjmë? Në të tilla rrethana ne duhet të punojmë për ngritjen e ndërgjegjes politike të popujve, sepse lufta imperialiste bëhet në kurriz të tyre. Neve na vihet detyrë t'i ngremë popujt kundër imperialistëve që duan të shpërthejnë luftën, t'i pengojmë ata në planet e tyre. Kina, në të kundërtën, u thotë popujve të bashkohen dhe të hidhen vetëm kundër Bashkimit Sovjetik, se ai do t'i sulmojë. Jo, Partia jonë nuk mendon kështu, ajo u bën thirrje popujve të Evropës të ngrihen, të bashkohen dhe të forcojnë soli-

daritetin me njëri-tjetrin në luftën kundër imperializmit amerikan, kundër socialimperializmit sovjetik dhe kundër kapitalizmit që i shtyp brenda në vendet e tyre. Dhe këtë Partia jonë nuk ia thotë vetëm Evropës, por edhe popujve të Bashkimit Sovjetik, edhe popujve të vendeve të ashtuquajtura demokraci popullore. Kjo është rruga e drejtë, ndryshe zhduket kufiri klasor i luftës.

Ne komunistët shqiptarë, shokë dhe shoqe, kemi bindjen se kemi ndërtuar një politikë e një strategji të drejtë marksiste-leniniste dhe në bazë të marksizëm-leninizmit studiojmë, konceptojmë, organizojmë punën dhe realizojmë detyrat tona. Këtë gjë e bëjmë hapur, në dritën e diellit. Këtu qëndron forca e marksizëm-leninizmit, të gjithë e shohin dhe e kuptojnë politikën tonë dhe kanë të drejtë të japin mendimet e tyre për të.

Ne konstatojmë që brenda vendit mbarë populli ynë është i lidhur si mishi me thoin me Partinë, pse ai ka parë që Partia mendon e punon vetëm për popullin. Kjo do të thotë se komunistët janë e duhet të jenë si kurdoherë në ballë të luftës, në ballë të sakrificave, deri edhe të sakrificës më të lartë, në çdo rast që do ta kërkojnë nevojat e atdheut.

Jashtë, gjithashtu, është zgjeruar shumë influenca e Partisë sonë. Kjo është një influencë me baza të forta, gjë që ka shumë rëndësi dhe na jep shpresa se ajo do të ndihmojë të kapërcehen si të tjerat edhe vështirësitë që po i krijon tash lëvizjes marksiste-leniniste botërore oportunizmi i ri që po ngrihet. Ashtu si në kohën e revizionizmit titist, më vonë në atë të revizionizmit hrusho-

vian, edhe tash oportunitizmi i ri që po ngrihet s'ka dyshim që do t'i sjellë pengesa dhe vështirësi çështjes së revolucionit dhe lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve, do të shkaktojë përçarje në këtë lëvizje. Por marksizëm-leninizmit nuk mund t'i vihen pengesa, ai do t'i kapërcejë këto, sepse përfaqëson ato dëshira, ato ideale të klasës punëtore dhe të popujve që i kanë vënë vetes detyrën të çlirohen dhe të ecin drejt rrugës së ndërtimit të një jete të lumtur e të begatshme.

Ne shikojmë se në të gjithë botën po bëhen greva e demonstrata masive dhe ndeshje të mëdha klasore. Fashizmi në Itali dhe gjetkë ka filluar jo vetëm të mëkëmbet, por edhe të veprojë. Proletariati i të gjitha vendeve kapitaliste shikon se as partitë revizioniste, as partitë e kapitalit nuk janë në gjendje ta përballojnë këtë krizë të rëndë, që përshkon vendet e tyre, dhe këtë kaos të madh ku janë futur. Në këto situata ai i ka kthyer sytë drejt atyre shkëndijave që i tregojnë në errësirë rrugën e vërtetë të luftës për shpëtim. Këtu qëndron edhe rëndësia e influencës që kanë fituar Partia jonë dhe materialet e Kongresit të saj të 7-të në botë.

Politika e drejtë dhe qëndrimet e vendosura të Partisë sonë u kanë imponuar edhe shteteve kapitaliste që të mbajnë një qëndrim më korrekt ndaj vendit tonë. Në mes këtyre shteteve ka edhe kontradikta, po Partia jonë di si t'i shfrytëzojë këto kontradikta, pa shkelur parimet dhe pa harruar kurrë dinakërinë e kapitalizmit botëror, të imperialistëve e të socialimperialistëve, si dhe tendencat agresive të disa qarqeve të shteteve fqinjje të afërta. Këto situata ne duhet t'i kemi kurdoherë parasysh në politikën dhe në qëndrimet tona, në më-

nyrë që të çajmë me sukses rrethimin edhe në këtë drejtim.

Për shembull, nga pozitat thellësisht armiqësore që mbante Greqia deri dje ndaj Shqipërisë, tashti marrëdhëniet e saj tregtare dhe diplomatike me vendin tonë janë normale, bile, siç theksova më lart, shkruhen shumë artikuj pozitivë për Kongresin tonë të 7-të. Dhe duhet pasur parasysh se këta artikuj flasin në favor dhe jo në disfavorin tonë. Kjo ka bërë që veprimtaria armiqësore e vorioepirotëve, që ushqejnë pretendime tokësore ndaj vendit tonë, të errësohet. Kush e bëri këtë? Këtë e bënë përparimet e arritura në vendin tonë, forcimi i pozitave të brendshme dhe ndërkombëtare të Shqipërisë, politika e zgjuar që ndjekin Partia dhe Qeveria jonë.

Ne e dimë ç'është titizmi, si e kemi luftuar dhe si e luftojmë atë. Edhe në Kongresin e 7-të u fol haptazi kundër revizionizmit jugosllav, po titistëve u është bërë faqja shollë, janë pa skrupull. Ata duan vetëm të bëjmë nga një çikë tregti dhe ne jemi dakord të bëjmë tregti, por në çështjet ideologjike luftën do ta vazhdojmë. Titistët kanë eksperiencë në marrëdhëniet me vendin tonë, ata e kanë kuptuar prej kohësh që në fushën ideologjike Shqipëria nuk e ul polemikën dhe nuk do ta ulim kurrë, pasi ne bëjmë një luftë të pandërprerë për mbrojtjen e parimeve të marksizëm-leninizmit.

Për sa i përket fqinjës së përtejdetit, Italisë, atje njerëzit nuk dinë ku kanë kokën. Në Itali është me të vërtetë një kaos i madh. Në këtë vend po zhvillon një veprimtari të madhe fashizmi.

Marrëdhëniet tona me botën arabe kanë qenë dhe janë kurdoherë të mira, sepse ne i kemi mbrojtur vazh-

dimisht, në rrugë të drejtë marksiste-leniniste interesat e popujve arabë, natyrisht, jo ata të klikave borgjeze kapitaliste në fuqi që sot kthehen këtej, nesër andej, një herë me Bashkimin Sovjetik, një herë tjetër me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nesër, pasi të derdhet përsëri gjithë ai gjak i popullit arab, janë gati të puqen edhe me Izraelin. Ndoqa mbrëmë në televizor intervistën me drejtorin e një ndërmarrjeje izraelite që prodhon bomba atomike, pse Izraeli edhe bomba atomike prodhon dhe ka shumë të tilla, ai prodhon edhe acroplanë të modeleve të fundit amerikane. Drejtorin e pyetën nëse këto bomba që prodhon mund t'ia shesë edhe ndonjë vendi arab, dhe ai u përgjigj se po. Ja, kështu bëjnë kapitalistët. Kurse ne mbrojmë interesat e popujve, prandaj nuk duhet t'i konfondojmë këta interesa me ata të klikave. Por në ato raste kur udhëheqësit e këtyre shteteve luftojnë me të vërtetë dhe mbrojnë interesat e popujve, atëherë ne jemi edhe me ata.

Situatat për ne janë shumë pozitive, ato i analizoi drejt Kongresi i 7-të i Partisë, i cili pati sukses shumë të madh dhe po u jep një hov të mëtejshëm ndërtimit të socializmit dhe forcimit të situatës së brendshme dhe të jashtme të vendit tonë.

### Të rrojë Partia!

*Botuar për herë të parë, me disa shkurttime, në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 190*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## **NJERIU I EDUKUAR NGA PARTIA E BËN VENDIN KOPSHT TË LULËZUAR**

*Nga biseda me kuadro dhe punonjës të ndërmarrjes  
bujqësore «Rinia» si dhe me një grup kuadrosh e  
kooperativistësh të kooperativës bujqësore të bashkuar  
të Dukat-Tragjasit të rrethit të Vlorës*

**23 mars 1977**

*Pasi u përshëndet me pjesëmarrësit në këtë takim,  
të cilët e pritën me brohoritje e duartrokitje të vazh-  
dueshme, pranë tarracave të gjelbëruara me agrume e  
ullinj, udhëheqësi i dashur i Partisë dhe i popullit zhvi-  
lloi këtë bisedë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** E keni zbukuruar dhe me të vërtetë e keni bërë të mrekullueshme këtë pjesë të bregdetit. Të gjithë ju shikoj me shëndet të mirë, me faqe të kuqe e trup të kalitur dhe, mbi të gjitha, të gëzuar. Kjo është një kënaqësi e madhe për Partinë.

Më parë se të shkëmbejmë disa mendime së bashku, shokët tuaj drejtues le të më thonë diçka për punën kaq të mirë që keni bërë dhe për rezultatet që keni arritur.

**SHOKU GOGO VJERO<sup>1</sup>:** Sot ndiejmë një gëzim të madh që midis nesh, punonjësve të ndërmarrjes bujqësore, jeni ju, i dashur shoku Enver. Nga zemra ju falënderojmë për këtë vizitë që na bëtë këtu së bashku me shoqen Nexhmije.

Ndërmarrja jonë është e re, këtu punojnë shumë të rinj e të reja dhe këtë tipar dallues të kësaj ndërmarrjeje e shpreh edhe emri që ajo mban: «Rinia».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Rroftë rinia!

*Pastaj shoku Gogo Vjero e vuri në dijeni shokun Enver Hoxha për shtrirjen e ndërmarrjes, për llojet e agrumeve që kultivoheshin, si dhe për punën e madhe e rezultatet e kënaqshme të punonjësve.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Fshati juaj, Vunoi, merr prodhime më të mira në agrume, prandaj të ka sjellë Partia ty këtu, në ndërmarrjen bujqësore «Rinia», që t'i organizosh dhe t'i mësosh të rinjtë e të rejat të marrin po aq prodhime të mbara, siç marrin kooperativistët e Himarës e të Vunoit; domethënë t'u ngjallësh atyre dashurinë për pemën, që çdo rrënjë t'i bëjnë shërbimet e nevojshme. Në këtë drejtim ju po veproni shumë mirë.

**SHOKU GOGO VJERO:** Edhe në rendimentin e qumështit, veçanërisht nga dhitë, ndërmarrja jonë ka pasur përmirësime. Është arritur të merren 77 litra qumësht për çdo dhi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kush është ky shoku këtu përpara?

---

1. Në atë kohë drejtor i ndërmarrjes bujqësore «Rinia».

**SHOKU GAQO NESHO:** Është xha Kozmai, shoku Enver, Hero i Punës Socialiste.

**SHOKU ENVER HOXHA:** O... o, hajde këtu, xha Kozma! Po si të kam, more xha Kozma? Si je me shëndet? Hajde, ulu këtu pranë.

**SHOKU KOZMA NESTURI:** Të rrojë Partia me shokun Enver Hoxha në krye!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Xha Kozmai, të dashur shokë, është miku im i vjetër, miku im dhe i Hysniut. Më fal, ti shoku drejtor, se të ndërpreva, por xha Kozmai, ky plak punëtor, specialist në rritjen e agrumeve dhe besnik i vlljës së Partisë, e meritonte ndërprerjen e bisedës, t'i ngrihemi në këmbë dhe ta nderojmë. Është besnik edhe i ulla të xha Kozmai.

*Pasi shoku Gogo Vjero foli për sistemimet dhe taracimet në kodrat e Jonufrit, si dhe për prodhimet e mbara të agrumeve, në vazhdim të bisedës shoku Hasan Gjoni<sup>1</sup> informoi për arritjet dhe përpjekjet e kooperativistëve për të realizuar detyrat që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Nga Dukati je ti?

**SHOKU HASAN GJONI:** Jo, jam nga Tragjasi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të pyeta nga je, sepse në Dukat kam pasur shumë miq. Kam pasur edhe një mik, një burrë të moshuar që shkruante poezi, prandaj desha të di jeton apo nuk jeton. Më kujtohet një ditë, kur shkova së bashku me të te mulliri i fshatit. Atje qëndruam ca duke biseduar, po kur pushuam, ai qëndroi

---

1. Në atë kohë sekretar i byrosë së Partisë të kooperativës bujqësore të bashkuar të Dukat-Tragjasit.

duke bërë poezi dhe bënte poezi të flakta. Po të jetë gjallë, i bëni shumë të fala nga unë.

Tani dëshiroj t'ju them nja dy fjalë. Shokët drejtues që folën, na njohën me punën, me jetën, me sukseset, si dhe me perspektivat që hapen përpara jush në planin e gjashtë pesëvjeçar. Më vjen keq vetëm për diçka: ju më shikoni mirë këtu ku jam, dua edhe unë t'ju shoh më mirë, prandaj, ju lutem, uluni, shoqe dhe shokë, uluni kryesisht që të mos lodheni.

Kam pasur një dëshirë të madhe t'ju takoja ju punonjësit e ndërmarrjes bujqësore «Rinia» dhe, në mënyrë të veçantë, ju kooperativistët e Dukat-Tragjasit. Siç e përmendi edhe drejtori i ndërmarrjes suaj, në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare kam qenë në këto anë. I mbaj mend mirë ato ditë, kur Partia më dërgoi në këtë krahinë për të bashkuar forcat tona në luftën për likuidimin e grupit fraksionist të Sadik Premtes. Më kujtohet fare mirë kur së bashku me Hysniun zbritëm përtej malit dhe atë natë fjetëm në Mazhar, në shtëpinë e Sherif Hasanit, të cilit, ju lutem, i bëni shumë të fala nga unë.

Të nesërmen zbritëm nga mali i Tragjasit. Në të zbritur, siç e dini më mirë nga unë, se jeni banorë të këtyre anëve, ka një shpellë, dhe pikërisht atje te një stan ndodheshin barinjët. Ishte një kënaqësi për mua dhe për Hysniun që, para se të zbritnim poshtë në fshat e të bashkoheshim me popullin për të luftuar e për të shpartalluar përfundimisht fraksionin e tradhtarit Sadik Premte, barinjët na dhanë për të pirë dhallë prej kosi dhie. (Me këtë dua të them se tradita e rritjes së dhisë në këto male kreshnike është e vjetër dhe

mund të merret rendiment në qumësht sipas eksperiencës së Lezan Pislit.)

Kur arritëm në fshat, pamë se gjithë populli i Tragjasit e i Dukatit ishte mbledhur e po na priste. Kishin ardhur njerëz edhe nga Vlora. Atje ne folëm për rrezikshmërinë e veprimtarisë së Sadik Premtes dhe të disa të tjerëve.

Dëshiroj të theksoj, shoqe dhe shokë, se, kur ia bëmë të qartë popullit veprimtarinë e ndyrë të atij fraksioni dhe i thamë mendimin e Partisë, njerëzit gjatë gjithë kohës thërrisnin: «Partia mbi të gjitha! Partia mbi të gjitha!». E tillë ishte ndjenja e patriotizmit të populli i kësaj krahine.

Si rezultat i gjithë punës e i luftës që u bë, fraksioni i «Xhepit» u likuidua. U përpoqën disa elementë të tillë si Hysni Lepenica, Tahir Hoxha e të tjerë si këta që ta dëmtonin Partinë, por qëllimit nuk ia arritën. Unë i kam takuar dhe kam biseduar shtruar me ta, jo këtej, por matanë Vjosës, prapa maleve. Kam qëndruar nja dy ditë dhe net me ta për t'i bindur, u kam folur se ishin në rrugë të gabuar, por ata ngulnin këmbë në pikëpamjet e tyre të shtrembra. Hysni Lepenica ishte një ballist, por dyfekun e përdorte mirë dhe njëkohësisht ishte mbrojtës i flaktë i Sadik Premtes.

Qëllimi i Partisë që na ngarkonte për t'i takuar dhe për të biseduar me të tillë njerëz, ishte që këta të ktheheshin në rrugën tonë të drejtë. Ne e dinim fare mirë që Tahir Hoxha ose dhe nja dy a tri veta që shkonin pas tij, përpiqeshin ta gënjenin popullin heroik të Tragjasit, duke intriguar lloj-lloj gjërash, por nuk ia arritën dot. Edhe populli i Dukatit ishte dhe është patriot, por tradh-

tarçt atje nuk pushuan asnjëherë së intriguari. Partia punonte që në atë kohë për demaskimin e këtyre elementëve, të cilët përpiqeshin të mbanin popullin në errësirë dhe me intrigat e tyre synonin ta përçanin, të dobësonin unitetin e tij rreth Partisë. Populli i Dukatit u bashkua me Partinë, se nuk kishte rrugë tjetër, veç asaj të armiqve, të cilët Partia, pushteti dhe populli i demaskuan, i shpartalluan dhe i likuiduan.

Ndërmarrjen tuaj «Rinia» e kam parë vazhdimisht kur kam ardhur në Vlorë. Ju kam parë ju, të rinj e të reja, që u qepeshit këtyre kodrave si bletët punëtore që dalin tash nga zgjojet dhe u qepen luleve të portokalleve. Mund të bëjmë edhe një çikë poezi sot që jemi këtu, në një vend kaq të bukur. Pra, sa herë që vija në Vlorë, shikoja me qindra e me mijëra të rinj e të reja, të ardhur nga të katër anët e Shqipërisë, që punonin pa u lodhur në kodrat këtu rreth e qark. Me punën dhe vrullin tuaj rinor, ju, këto kodra të bregdetit të Vlorës, të mbuluara më parë me ferra e me shkurre, i transformuat në kopshte të lulëzuara, ashtu siç janë transformuar kodrat e Lukovës, të Ksamilit etj. në rrethin e Sarandës.

Një gjë e tillë flet për forcën e madhe të rinisë e të popullit tonë, për një kuptim të thellë të mësimeve të Partisë, vija e së cilës i frymëzon dhe u shumëfishon forcat mendore e fizike për arritje më të mëdha. Çdo ditë e më shumë rritet besimi i popullit në drejtësinë e vijës së Partisë. Kjo e ka burimin në atë që Partia qysh kur u themelua ia bëri të qartë popullit vijën e saj. Vija e Partisë ishte çlirimi i popullit dhe krijimi, si të themi, nga hiçi i një jete të lumtur për të, i një jete

të lirë e të begatshme në një shtet socialist. Kjo vijë e Partisë gjatë gjithë kohës është zhvilluar në mënyrë dialektike dhe u krijua kjo jetë e lumtur në vendin tonë, që na e kanë zili shumë popuj në botë. Na kanë zili për të keq armiqtë e popujve, po na kanë zili për të mirë popujt dhe miqtë e Shqipërisë, për të cilët ajo është bërë shembull frymëzimi. Kush e udhëhoqi popullin drejt kësaj jete të lumtur? E udhëhoqi kjo Parti e klasës punëtore, Partia jonë e Punës, e cila ka ndjekur vazhdimisht një vijë të drejtë ideologjike dhe politike.

Kjo ka rëndësi të madhe, sepse Partia, që në vitet e para pas Çlirimit të vendit, njohu dhe analizoi drejt, politikisht dhe ideologjikisht, problemet, pastaj mori masa për zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë, duke filluar që nga ndërtimi i fabrikave e deri te mirërritja e agrumeve dhe e ullinjve. Ajo diti, mbi të gjitha, t'ia bënte të qartë popullit se e vetmja rrugë për çlirimin e tij jo vetëm nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, por edhe nga gjithë mbeturinat e paragjykimet e vjetra që e mbanin të ndrydhur dhe e pengonin të ecte përpara, ishte besnikëria ndaj Partisë dhe zbatimi me vendosmëri i direktivave të saj.

Ashtu si gjatë kohës së luftës, edhe sot, Partia ecën në një vijë të drejtë për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Kur ndjek me vëmendje këtë histori të madhe të Partisë dhe të popullit tonë, shikon se sot janë bërë ndryshime kolosale në krahasim me të kaluarën. Këto ndryshime dëshmojnë për besnikërinë e popullit ndaj Partisë e vijës së saj dhe për vënien në jetë të direktivave të saj. Por sa herë që bëjmë fjalë për këto ndryshime të mëdha, në radhë të parë duhet të sho-

him ndryshimet në botën e brendshme të njerëzve tanë, të cilët, të kalitur e të edukuar nga Partia, kanë zbuluar vendin me duart e tyre.

Të gjithë ju e dini se bujqësia ka rëndësi të jashtëzakonshme, ajo përbën bazën e zhvillimit të ekonomisë, kurse industria e drejton këtë zhvillim. Partia i ka kushtuar dhe do t'i kushtojë vëmendje shumë të madhe bujqësisë, për ta kthyer atë në një bujqësi intensive. prandaj të mos lëmë toka djerrë, por të hapim edhe të reja, që të prodhojmë sa më shumë, sa më mirë dhe me kosto sa më të ulët.

Zhvillimi i bujqësisë është një problem sa i madh, aq edhe i koklavitur. Kur themi i koklavitur, nuk do të thotë i pazgjidhshëm, përkundrazi, ai është plotësisht i zgjidhshëm. Për këtë të jemi të bindur që të gjithë, veçanërisht të jeni të bindur ju, të rinjtë dhe të rejtat, pse, po të na pyesni ne më të moshuarit si ka qenë më parë Shqipëria dhe si është bërë tash, nën drejtimin e Partisë, atëherë çdo gjë do t'ju duket plotësisht e mundshme për t'u bërë. Por edhe ju brezi i ri, kur të arrini në moshën tonë, do të thoni me njëri-tjetrin: «Si u bë kështu kjo Shqipëri kaq e bukur! Kur ne punuam në Jonufër, vërtet e zbukuruam, por tani, shiko ç'bukuri kanë marrë kjo pjesë e bregdetit të Vlorës dhe i gjithë vendi ynë!». Kështu do të thoni se Shqipëria me siguri do të bëhet gjithmonë e më e bukur, nën udhëheqjen e kësaj Partie.

Për çdo vit e për çdo pesëvjeçar bujqësia jonë do të marrë një zhvillim më të madh. Shqipërisë i duhet një bujqësi e përparuar në të gjitha drejtimet, për ta bërë jetën e çdo familjeje të lumtur. Sigurimi i mirë-



qenies ekonomike në familje ka rëndësi të madhe, pse, duke pasur një nivel të mirë jetese, luftohet më lehtë kundër çdo mbeturine të së kaluarës, njeriu bëhet më i ndërgjegjshëm politikisht dhe ideologjikisht dhe i kupton më lehtë gjithë të mirat që gëzon. Pra, edukohet e transformohet njeriu më parë dhe pastaj ky njeri, i edukuar nga Partia, transformon tokën, u bën shërbimet e nevojshme bimëve, merr prodhime të bollshme dhe e bën vendin kopsht të lulëzuar.

Ne kemi rezultate në bujqësi, të cilat, megjithëse janë të mira, nuk duhet të na kënaqin asnjëherë. Ka rezerva të mëdha në bujqësi që ne duhet t'i kërkojmë, t'i zbulojmë dhe t'i shfrytëzojmë. Për t'ia arritur këtij qëllimi na del detyrë të punojmë shumë, duke shfrytëzuar në mënyrë racionale të gjitha forcat tona mendore dhe fizike. Kur them forcat mendore, kam parasysh faktin që të tërë njerëzit tanë duhet të mësojnë dhe të bëhen me shkollë, dhe, kur them të vëmë në shfrytëzim gjithë forcat fizike, nënkuptoj jo vetëm njerëzit, por edhe faktorët e mjetet që disponojmë, që nga eksperiencia e mirë e deri te makineritë e ndryshme bujqësore. Të gjitha këto t'i shfrytëzojmë në mënyrë të tillë që të zbulojmë dhe të vëmë në përdorim të shoqërisë të gjitha ato pasuri e rezerva që akoma janë të pazbuluara.

Këtë vit kemi pasur arritje të kënaqshme në prodhimin e drithërave. Kjo është një fitore e madhe, që duhet ta konsolidojmë e ta çojmë më përpara, sepse përderisa shikojmë që në disa prej brigadave tuaja arrihi të merrni deri në 110 kuintalë misër për hektar, atëherë sa kuintalë drithëra mesatarisht duhet të marrim

në toka të ujitura e të plehëruara kaq mirë dhe në një kohë kur kemi gjithë këta kuadro me arsim të lartë e të mesëm, si dhe një punëtori e fshatarësi të kualifikuar? Sigurisht, po t'u bëjmë të gjitha shërbimet, do të marrim më shumë sesa mesatarja që kemi arritur deri tani. Ky rezultat e turbullon kokën e disa reaksionarëve jashtë, sepse u duket çudi, kurse kokën tonë nuk e turbullon, përkundrazi, ne mendojmë dhe luftojmë për arritje më të larta. Ne u themi atyre: Mos u çuditni kaq shumë, njihuni me historinë e popullit tonë dhe do të shikoni se në luftërat e tij për çlirim e pavarësi ai ka luftuar dhe nuk është përkulur kurrë ndonjëherë, por nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik ishte prapa dhe i varfër. Në ato kohë kështu ndodhte, po sot që populli ynë ka në duar fuqinë, pushtetin dhe udhëhiqet nga Partia e Punës, e cila di të gërshetojë mirë eksperiencën e madhe të punonjësve tanë me marksizëm-leninizmin, ai është në gjendje të bëjë me të vërtetë mrekulli.

Masat e gjera të fshatarësisë kooperativiste me punën e tyre i tejkalojnë parashikimet e planifikimit dhe të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë lidhur me drithërat. Kështu dëshiron Komiteti Qendror. Parashikimet e tij dhe planet e ekonomisë bazohen në eksperiencën e popullit, në të dhënat konkrete dhe kur populli i tejkalon, ai ndien një kënaqësi të madhe, sepse shikon të materializuar forcën e ideologjisë dhe të politikës së Partisë. Në këtë mënyrë Partia bëhet më e fortë dhe me guxim thotë: Në qoftë se unë qëndroj në ballë të punës, në ballë të luftës dhe ndjek një politikë të drejtë, këto realizime do të jenë më të mëdha.

Qëllimi i Partisë është ky dhe vetëm ky: mirëqenia e popullit dhe konsolidimi i pavarësisë së atdheut, i fitoreve të socializmit e të komunizmit, ndihma për revolucionin botëror e për popujt e tjerë në botë që janë të varfër, të shtypur dhe të skllavëruar. Kjo është arsyeja që realizimet tona jo vetëm ngjallin një entuziazëm të madh te komunistët dhe te mbarë populli ynë, por ato gjithashtu forcojnë në ta besimin se e vetmja ideologji që i frymëzon për të arritur rezultate të tilla, është marksizëm-leninizmi.

Ne duhet të bëjmë kujdes që të arrijmë rezultate të larta jo vetëm në drithërat e bukës, por edhe në degët e tjera të bujqësisë, sepse edhe ato kanë po aq rëndësi sa dhe gruri e misri për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit. Populli ka nevojë për të gjitha llojet e produkteve bujqësore e blegtorale, pra jo vetëm për bukë, por edhe për mish, gjalpë, qumësht, vezë, si dhe për të gjitha perimet e frutat. Toka e kësaj krahine është e përshtatshme t'i prodhojë e t'i shtojë të tilla prodhime kaq të nevojshme për jetën e njeriut. Por në këtë drejtim duhet organizuar mirë puna, duke luftuar konceptet që i pengojnë njerëzit për zhvillimin e këtyre degëve të bujqësisë. Sigurisht, këto koncepte nuk janë aq të forta për t'u luftuar, sepse nuk është më ajo kohë kur varfëria dhe shtypja e feudo-borgjezisë e detyronin fshatarin tonë të mjeruar që, me ato palo qe që kishte e me atë parmendë të shkretë prej druri, të mos prodhonte gjë tjetër veçse pak misër, por dhe këtë ia rrëmbente beu ose agai. Tash është kohë tjetër.

Një nga degët e bujqësisë, të cilën ju e doni në mënyrë të veçantë, se e keni në gjak dhe kujdeseni për

të, është blegtoria. Ja, po të pyesësh dukatasin apo tragjasasin, do të thotë: «Në të gjitha malet e Shqipërisë, nga jugu në veri, gjyshërit tanë kanë qenë çobanë e bujq». Kjo flet për një traditë të mirë të të gjithë popullit tonë, po kështu edhe të popullit të kësaj kra-hine, flet për dashurinë që ushqenin të parët tuaj për blegtorinë dhe mendoj se duhet ta forcojmë një dashuri si kjo.

Për zhvillimin e blegtorisë Partia ka dhënë direktiva të qarta, por nganjëherë ato nuk kuptohen si duhet nga të gjithë. Ajo ka porositur që të zhvillojmë lopën, se rritja dhe mbarështimi i saj kanë rëndësi të madhe, por Partia nuk ka udhëzuar ndonjëherë që numri i bagëtive të imëta të bjerë, të pakësohen dhentë e dhitë, përkundrazi, ajo këshillon që, kudo ku ekzistojnë kushte, të shtohen bagëtitë e imëta, jo vetëm në numër, por sidomos të bëhen përpjekje për të marrë prej tyre prodhime më të larta në qumësht, mish e lesh. Ashtu si punëtori në fabrikë, që punon në torno me një plan të caktuar, bile bën përpjekje të prodhojë edhe mbi planin dhe t'i nxjerrë veglat me cilësi të mirë, kështu duhet të përpiqet edhe ai kooperativist, që ka në duart e tij një tufë delesh apo dhish, një bllok të tërë pemësh frutore etj., t'u bëjë atyre të tilla shërbime dhe t'i shfrytëzojë ato intensivisht që të japin sa më shumë prodhime.

Bujqësia jonë duhet të zhvillohet në të gjitha drejtimet si një konvejer i pandalshëm. Sigurisht, që të realizohet kjo, duhet punuar. Për këtë ju këshilloj të bëni studime shkencore për tokën, për klimën e krahinës etj., sepse vetëm në këtë mënyrë, duke u mbështet-

tur edhe në eksperiencën tuaj, ju do të arrini të përcaktoni drejt, për shembull, se çfarë lloje bimësh bujqësore duhet të mbillni. Dhe në këtë fushë ne kemi bërë hapa përpara.

Shteti ynë investon me qindra milionë lekë për të mbjellë agrume, ullinj, pemë frutore, dhe këto në blloqe të tëra. Zhvillimi i pemëtarisë ka një rëndësi të madhe, gjithashtu, edhe për eksportin tonë. Prandaj e theksoj se duhet luftuar kundër koncepteve të tilla që ekzistojnë te disa njerëz, si: «Ç'na duhen, fruta janë», «të shikojmë grurin dhe misrin, pa lëri ato».

Sot lexova një artikull të gazetës «Zëri i popullit», ku thuhej se, që të parandalohen sëmundjet e zemrës, duhet të bëhet kujdes që në fëmëni për shëndetin e njeriut, sepse qysh atëherë mund të fillojnë disa sëmundje të saj, shkaktarët e të cilave janë bajamet, reumatizmi, infeksionet e ndryshme etj. Kështu, në qoftë se prindi shikon që bajamet i infektohen shpesh fëmijës, e çon te mjeku dhe ia operon; në qoftë se shikon që i dhembën këmbët, nuk duhet ta zvarritë gjendjen, po të konsultohet me mjekun dhe të veprojë si ta këshillojë ai. Këta shembuj i përmenda për të bërë krahasim, se edhe për bimën duhet kujdes i madh që në fillim e gjatë gjithë zhvillimit deri në pjekjen e prodhimit. Ja, për shembull, le të ndalemi pak për ullirin, që është një pemë e vjetër shumëvjeçare. Shikoni xha Kozmanë me sa vëmendje dëgjon kur flitet për ullirin! Atij i duket sikur po rinohet dhe e dini pse? Sepse ulliri «thotë»: «Unë jam më i fortë se njeriu. Ju njerëzit, edhe në socializëm, mund të arrini të jetoni e shumta deri 90 vjet, kurse unë rroj me shcekuj». Po të

futeni në pyjet e vjetra të ullinjve të Vlorës, do të shikoni ullinj me trup të dredhur, të përdredhur e të rrjepur, por fletët ama, i kanë të gjelbëruara dhe, kur u bie drita e diellit, ato ndrisin dhe ullinjtë fillojnë të lidhin kokrra. Anaksagora, filozofi i vjetër grek, i thoshte Perikliut: «Në qoftë se do dritë, mbill ullinj, se pa ullinj nuk ka dritë!».

Prandaj, shokë, në qoftë se kufizoheni me një punë të tillë sa t'ia gërmoni një çikë tokën ullirit rreth e rrotull, kjo është, si të thuash, vetëm një përkëdheli e vogël për të. Në qoftë se e punon si duhet kurorën e ullirit, e plehëron dhe e ujit mirë, atëherë ulliri ta shpërblen mundin. Lëre pastaj në qoftë se e krasit mirë më vonë, atëherë e bën atë të të japë kokrra akoma më shumë. Ulliri «thotë»: «Mos më goditni me shufër, se kështu nuk prodhoj». Po pse të mos i goditësh me shufër degët e ullirit, kur vjen koha të vjelësh prodhimin? «Sepse unë, «thotë» ulliri, lëshoj gjethe të reja çdo dy vjet dhe në fund të çdo gjetheje të re kam edhe një syth të vogël, që është ulliri i ardhshëm. Në qoftë se ti më godet me shufër, sythi i vogël nga i cili unë do të çel lulen e ardhshme e më vonë do të lidh kokrrën, bie në tokë. Prandaj më shkund, se, kur më shkund, sythi nuk më dëmtohet, kështu që vitin tjetër do të kesh ullinj njëlloj, në mos edhe më shumë se vitin e kaluar». Po si mund të kemi prodhim ullinjsh aq sa edhe vitin e kaluar? Te ne ulliri një vit prodhon, një vit nuk prodhon, do të thoni ju. «Jo, «thotë» ulliri, unë mund të prodhoj çdo vit, sepse natyra e ka rregulluar punën në mënyrë të tillë që prodhimi im mund të stabilizohet në qoftë se bëni kujdes, në qoftë se nuk

ma vritni me shufër «foshnjën» që do të më lindë, lulen e ardhshme».

Unë mendoj, edhe xha Kozmai besoj që mendon kështu, se që në vitet e para nuk mund të presësh prodhime nga ulliri. Ai do të fillojë të japë kokrra, por më vonë, pasi të ketë marrë forcën e duhur dhe pasi t'i jenë bërë shërbimet e nevojshme gradualisht, do ta rritë rendimentin. Por xha Kozmai na këshillon kurdoherë se bimës, që të marrë atë forcë dhe të prodhojë më shpejt e më mirë, duhet medoemos t'i bëhen shërbimet në kohë.

Ulliri «thotë»: «Ore njerëz, pse më kushtoni kaq pak kohë, vetëm gjysmë ose një ditë-punë në vit? Kaq sa bëni ju për mua, është pak. Po të më shërbeni më shumë, unë mund të mos ju jap 20 për qind, por edhe 28, edhe 30 për qind vaj». Pra, duhet bërë më shumë, punë për ullirin. Vaji i tij është jashtëzakonisht i mirë për shëndetin e njerëzve. Nga historia e vjetër që kam lexuar, ja ç'm'u kujtua tash: Kur spartanët shkuan të luftonin në Termopile kundër Darit, populli doli me poçe me vaj dhe u jepte ushtarëve të pinin vaj që të bëheshin të fortë e ta mundnin kundërshtarin. Dhe është fakt që spartanët, megjithëse në numër shumë të vogël, rezistuan në betejën e madhe të Termopileve.

E theksoj se është e domosdoshme t'u bëhen të gjitha shërbimet e nevojshme edhe bimëve të tjera bujqësore, edhe bagëtive. Që të kemi një bujqësi intensive, që të konsolidojmë më tej fitoret e arritura në këtë degë të ekonomisë, kanë një rëndësi të dorës së parë njohja, përvetësimi dhe zbatimi i shkencës agroteknike dhe i eksperiencës së përparuar. Njerëzit mësojnë nga

praktika, se kjo ka rëndësi, pasi prej saj del teoria, dallin ligjet e shkencës për agroteknikën etj., por njerëzimi e pasuron vazhdimisht eksperiencën edhe nëpërmjet teorisë.

Për këtë qëllim në vendin tonë, përveç instituteve të larta, janë hapur edhe shumë shkolla të mesme bujqësore me dhe pa shkëputje nga puna, për të përgatitur njerëz të mësuar për bujqësinë. Ja, shoku juaj tha se në Dukat është hapur një shkollë e mesme bujqësore pa shkëputje nga puna. Përveç shkollave të mesme bujqësore, kemi ngritur edhe një Institut të Lartë Bujqësor në Tiranë dhe një tjetër në Korçë, ku përgatiten kadro me arsim të lartë: agronomë, veterinerë, zooveterinerë, specialistë për ullirin, pambukun, lulediellin etj. Këshillat e këtyre njerëzve që kanë mbaruar shkollën e lartë apo të mesme, si dhe të punëtorëve të specializuar të bujqësisë, t'i dëgjojmë me kujdes dhe për ta të kemi respekt të madh. Këta specialistë zotërojnë një thesar, të cilin e kanë për detyrë ta vënë në shërbim të përparimit të bujqësisë, ndaj t'i mësojnë kooperativistët dhe punëtorët e ndërmarrjeve bujqësore që t'i vënë në zbatim mësimet e tyre, duke i qëndruar punës në kokë derisa të arrihet në rezultatin e dëshiruar. Është e domosdoshme ta mësojnë mirë të gjithë, kooperativistë e punëtorë të ndërmarrjeve bujqësore, shkencën agroteknike, sepse kështu do të shtohen prodhimet për të gjitha bimët bujqësore, do të shtohen prodhimet blegtorale etj. dhe jeta e popullit do të përmirësohet akoma më shumë. Jam i mendimit se kemi nevojë të madhe për këtë njohje, përvetësim dhe zbatim të shkencës agroteknike e zooveterinare, për zgji-



dhjen me sukses të një vargu problemesh që shtron intensifikimi i bujqësisë në vendin tonë.

Ne po punojmë dhe do të punojmë vazhdimisht që jo vetëm të përgatitim kuadro me arsim të lartë e të mesëm, por ta kemi gjithë fshatarësinë tonë kooperativiste të ngritur nga ana profesionale. Sigurisht, në radhë të parë, ne luftojmë t'i kemi këta kuadro dhe gjithë fshatarësinë të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, sepse vetëm në këtë mënyrë fshatarësia do të mund t'i bëjë të sajat shkencën e teknikën dhe të gjithë do të dinë t'i vënë në zbatim për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Ne vëmë re me kënaqësi se populli ynë i zgjuar është i etur të mësojë dhe kjo është një anë shumë pozitive e tij.

Pra, tendenca kryesore e përgjithshme te ne është ecja përpara. Njerëzit studiojnë, reflektojnë e krijojnë dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Ne kemi sot me dhjetëra mijë punonjës të mrekullueshëm, të talentuar, që krijojnë, prodhojnë jo në mënyrë të thjeshtë, por të jashtëzakonshme, punonjës që tejkalojnë normat dhe parashikimet. Ç'e bën të mundur një gjë të tillë? Këtë e bën ngritja e tyre politike dhe ideologjike, në radhë të parë, besimi i madh që kanë te ky pushtet i klasës punëtore dhe te Partia jonë e Punës që e udhëhoq popullin drejt një jete gjithnjë e më të lumtur.

Çdo porosi e direktivë e Partisë është realizuar dhe do të realizohet kurdoherë e më mirë. Për këtë kemi bindje të plotë. Ç'gëzim i madh është për Partinë kur shikon se midis gjithë këtyre rezultateve janë arritur suksese edhe në dy çështje të rëndësishme.

Së pari, rinia jonë kooperativiste nuk mendon më

të largohet nga fshati, ku ka lindur e është rritur, për të shkuar në qytet. Ajo e ka të qartë se fshati ynë ka ndryshuar, është zbukuruar dhe me punën e mendjen e saj punon që ta zbukurojë akoma më shumë. Të rinjtë dhe të rejat e fshatit e kanë kuptuar mirë politikën e Partisë në këtë drejtim, prandaj janë të vendosur të qëndrojnë në fshat. Dhe ky është një sukses i madh që kemi arritur. Në të kaluarën njerëzit nga Bregdeti, nga Zagoria, nga Lunxhëria, si dhe nga shumë krahina të tjera malore të vendit tonë, merrnin rrugën e hidhur të kurbetit. Pse iknin nga vatrat e tyre gjithë këta njerëz? Iknin për të gjetur punë, se s'kishin si të jetonin, fshati nuk u siguronte punë, beu dhe agai nuk mendonin për ta. Kurse sot në vendin tonë ka punë kudo, për të gjithë njerëzit.

Së dyti, sukcesi tjetër i madh që ka arritur Partia është se ajo ka mundur t'ua bëjë të qartë të rinjve e të rejave të qytetit që të shkojnë për të punuar e për të jetuar në fshat. Dhe rinia e qytetit shkon në fshat vullnetarisht jo vetëm se e ndien që kjo është një detyrë patriotike, por edhe se në fshat jeta është e bukur, e lumtur, e begatshme si edhe në qytet. Ja, këtu shikojmë se të gjithë këta punëtorë e punëtores të ndërmarrjes bujqësore «Rinia», rreth tre mijë veta, kanë ardhur të tërë nga qyteti i Vlorës dhe punojnë në këtë vend kaq të bukur.

Nuk e di nëse e keni parë filmin e kinostudios «Shqipëria e re» për Ksamilin. Ai është një film shumë i bukur. Më parë në Ksamil kishte vetëm gurë, shpella, ferra dhe derra të egër, kurse tash ai është mbushur me portokaj e limonë. Dhe mes luleve e portokajve atje

është ngritur një qytezë e bukur. Këtë film ua kemi dërguar edhe ambasadave tona që ta shfaqin për miqtë. Të gjithë janë habitur kur e kanë parë dhe kanë thënë: «Ç'është ky vend kaq i bukur te ju?». Shokët u kanë shpjeguar atyre se këtë që patë e ka bërë populli, e ka bërë Partia, e ka bërë rinia jonë.

Edhe një herë dëshiroj t'ju theksoj se është kënaqësi e madhe për ne kur shikojmë të rinjtë e të rejat e qytetit të vijnë për të jetuar dhe për të punuar së bashku me motrat dhe me vëllezërit e tyre fshatarë. Një fitore e tillë nuk mund të arrihej me urdhra dhe me dekrete, por me punë sqaruese dhe bindëse. Akoma kanë qytete të rinj e të reja që nuk janë aq të bindur për të shkuar në fshat, jo se kanë frikë nga puna në bujqësi, por, si punë e re që është për ta, kjo i bën të ngurrrojnë. Megjithatë, ne shprehim bindjen se ky ngurrim i tyre nuk do të vazhdojë shumë.

Këtu në breg të detit bëhet një jetë e mirë, e bukur dhe e lumtur. Ato që shikon në qytete, sot i gjen kudo në fshatrat tona. Mua më kanë thënë se Dukati e Tragjasi në fushë kanë nga një shtëpi kulture shumë të mirë, bibliotekë etj. ashtu si në qytet, pa folur këtu për ambientet e tjera socialkulturore, si shkolla, shtëpi lindjeje, infermieri, dyqane etj. Por, të thuash të drejtën, këtë ajër të pastër, këtë pamje të mrekullueshme nuk e gjen në qytete. Për këtë arsye Partia ka marrë masa që qendra e qytetit të Vlorës, aktualisht qyteti i ri, të ndërtohet sa më pranë detit, të cilin njerëzit duhet ta duan, se ajri që vjen andej është shumë i shëndetshëm. Pra nga ajri i detit përfitoni jo vetëm ju të rinjtë dhe të rejat që jeni këtu, por edhe banorët e

qytetit, sigurisht edhe ata në brendësi të territorit, megjithëse ca më pak se ju.

Fshati socialist zbukurohet çdo ditë e më shumë midis pemëve dhe arave, prandaj të shkosh të jetosh atje, është me gjithë mend diçka e mrekullueshme. Ju të Dukatit keni një grup të mirë në fshat. Ai ka lënë nam sidomos me një këngë labe, që e këndon një grua, në të cilën thuhet: «Kur më merr malli për tinë, dal e shikoj Shqipërinë...». Fjalët e kësaj kënge janë shumë të bukura. Të tërë duhet të interesohemi për ekonominë, për bujqësinë, për politikën, por edhe për kulturën. Ne duhet t'i japim rëndësi të madhe edhe përparimit të artit dhe të kulturës popullore. Ju drejtuesit e Partisë këtu e keni detyrë dhe duhet të luani një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Të mos e lini pas dore çështjen e argëtimit të kooperativistëve, po fjalën e kam këtu për një argëtim të kulturuar. Ky është absolutisht i domosdoshëm për të gjithë. Disa nuk e kuptojnë drejt këtë çështje; organizimi i një argëtimi të tillë shton dhe shumëfishon forcat e njerëzve në punë, zbukuron ndjenjat dhe lehtëson lodhjen fizike ose mendore të tyre. Prandaj organizimi i argëtimit të kulturuar nuk duhet të jetë diçka e rëndomtë dhe monotone, se monotonia nuk e heq lodhjen fizike dhe mendore. Krijimi i një ambienti krejt të ndryshëm nga ai ku ke punuar për tetë ose dhjetë orë me radhë, ka rëndësi të madhe. Kështu që njerëzit, të cilët merren me këtë problem, duhet të jenë edhe ekzekutues, por dhe krijues.

Partia do të luftojë, siç e keni parë dhe ju në vendimet e Kongresit të 7-të, që niveli i jetesës në fshat të ngrihet sa më parë që të jetë e mundur dhe ndryshi-

met midis fshatit e qytetit gradualisht të vijnë duke u ngushtuar. Këto ndryshime nuk do të ngushtohen vetvetiu, por duke punuar vazhdimisht mirë. Në këtë drejtim janë marrë një varg masash qysh përpara se të mbledhë Kongresi i 7-të i Partisë dhe «gërshëra» midis qytetit dhe fshatit, siç e thonë ekonomistët, do të ngushtohet çdo vit e më shumë, me qëllim që fshati ynë socialist të mos dallojë prej qytetit nga pamja e jashtme, por sidomos nga pikëpamja e jetesës së njerëzve.

Unë do t'ju këshilloja që, qoftë ju punëtorë dhe punëtorë të ndërmarrjes bujqësore «Rinia», qoftë ju shoqe dhe shokë të kooperativës së Dukat-Tragjasit, të punoni akoma më me ngulm për prodhime më të shumta dhe më të lira. Shembuj të një pune të lavdërueshme do të gjeni kudo në Shqipëri, por të mos largohemi nga Vlora, të hedhim sytë këtu rreth e qark. Nga eksperiencia e më të mirëve ju duhet të përfitonit. Prandaj në dobi të punës do të jenë edhe ballafaqimet tuaja me kultivues të përparuar të bimëve bujqësore. Kështu, për shembull, ballafaqime të vlefshme do të jenë edhe ato që mund të bëni me kooperativistët e Himarës, sepse ata janë marrë me rritjen e ullirit dhe të agrumeve, tregojnë kujdes të veçantë për to, por tash nuk lënë pas dore as kujdesin për bagëtitë e imëta dhe për perimet që i mbjellin nën portokaj, duke u treguar kështu nikoqirë të mirë edhe në shfrytëzimin e tokës së paktë që kanë. Në mënyrë të veçantë, për sa i përket përvojës së tyre për agrumet dhe ullinjë, ju duhet të mësoni me vëmendje e këmbëngulje dhe ta ndiqni atë edhe teorikisht.

Kështu duhet vepruar edhe për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë. Hidhni një çikë sytë në Kuç, në Mesaplik dhe kudo ku të ketë blegtori më të zhvilluar se te ju. Përse në kooperativën e Dukat-Tragjasit t'i kenë delet e racës dhe më të përmirësuar se ju të ndërmarrjes bujqësore? Keni ju scdër revolucionare apo jo? Sigurisht që po. Vallë ju nuk e doni delen sa edhe ata? Sigurisht që e doni, por çështja qëndron këtu, që kur t'i viheni një pune, siç është ajo për përmirësimin e racës, kësaj t'i veni deri në fund, duke luftuar konceptet e vjetra që pengojnë ecjen përpara në këtë drejtim. Cilat janë konceptet që frenojnë zhvillimin dhe ecjen tonë përpara? E dimë, për shembull, që çobani ka përvojë të madhe në punët e blegtorisë dhe preferon t'i ndërzejë delet me deshtë e racës që ka në kope. Por ai duhet ta kuptojë edhe teorinë e ndërzimit artificial, e cila mbështetet në ndërzimin natyral me deshtë e racës, por bëhet në mënyrë më të përparuar dhe më të sigurt. Si rezultat i kësaj, duke hedhur poshtë konceptet frenuese, pas një kohe ai do ta ketë kopenë e vet me dele që do të japin më shumë lesh, qumësht etj. Kemi arritur në vallë suksese në këtë drejtim? Po, kemi arritur, bile në kope të mëdha, por këtë situatë duam që ta krijojmë kudo.

Shokëve të Partisë në aktivin e Vlorës u thashë gjithashtu se jo vetëm prodhuam bukën për vete këtë vit, por hodhëm edhe në tregun italian 40 000 tonë drithë. U bë zhurmë në gazetatat e Italisë e bënin pyetje e komente ç'po ndodh kështu në Shqipëri. Shqipëria që vuante nga uria, tani jo vetëm prodhon gjithë drithin që i nevojitet, por edhe eksporton, e pikërisht në një

kohë kur shumica e shteteve nuk kanë e janë të detyruara ta blejnë bukën, kudo që mundin të gjejnë treg. Më në fund këto gazeta në Itali shkruajnë: Shqiptarët kanë ditur si të sigurojnë farërat e zgjedhura, kanë blerë të tilla farëra, kanë mësuar t'i trajtojnë ato në mënyrë shkencore dhe, si përfundim, kanë arritur rezultate të mëdha në drithëra.

Një sukses të tillë duhet ta korrin jo vetëm në drithëra, por edhe në blegtori, edhe në pemëtari, edhe në bimët industriale e në perime. Këtë porosi të Partisë duhet ta mbajnë mirë parasysh.

Dy nga faktorët kryesorë për të ecur përpara janë kuptimi politik e ideologjik i të gjitha problemeve dhe organizimi i mirë i punës. Këta kanë rëndësi të madhe, sepse kuptimi thellë politikisht dhe ideologjikisht i problemeve do të na udhëhojë drejt në çdo punë, që nga punët e mëdha të popullit deri në punët e brendshme të familjes, pasi kjo është themeli i shoqërisë sonë. Prandaj, në qoftë se në familje kemi njerëz të lidhur ngushtë, që e duan njëri-tjetrin, atëherë dashuria nga familja kalon në fshat dhe që këndej në të gjithë vendin, krijohet kështu ai unitet i fortë e i çeliktë për të cilin flet ditë e natë Partia.

Ky unitet e ka bërë gjithmonë të fortë popullin tonë, shokë. Ekzistenca e unitetit në popull që në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe më përpara saj, gjatë luftërave kundër rreziqeve që kanë kërcënuar Shqipërinë, e ka bërë popullin shqiptar të mendojë e të luftojë si një trup i vetëm për liri e pavarësi. Ishte rezultat i këtij uniteti, mendimi dhe veprimi, që Plaku i Vlorës, Ismail Qemali, arriti më në fund të ngrinte flamurin

e ta shpallte Shqipërinë të pavarur. Ngritja e flamurit në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, ishte kurorëzimi i gjithë përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të popullit tonë për liri e pavarësi. Patriotët, të udhëhequr nga Ismail Qemali, e realizuan këtë dëshirë të madhe të popullit tonë këtu në Vlorën tuaj heroike dhe mbarë populli ynë ndjeu me të vërtetë t'i shpërthente dufi që i ziente në kraharor për shekuj me radhë. Ishte pikërisht kjo dëshirë për liri e pavarësi që u forcua akoma më shumë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia. Tash uniteti ynë është i çeliktë për arsye të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë, për arsye të politikës së saj të drejtë, si brenda vendit, ashtu edhe jashtë ndaj popujve, ndaj proletariatit, por edhe ndaj armiqve.

Marksizëm-leninizmi për ne nuk është thjesht një parullë, por është ajo ideologji që Partia, populli dhe klasa jonë punëtore e kanë studiuar dhe e kanë futur thellë në shpirtin dhe në mendjen e tyre. Kjo ideologji është bërë aq e nevojshme për ta sa ç'është edhe gjaku për jetën e njeriut. Partia përpiket që ky gjak jetëdhënës, që është ideologjia e Marksit dhe e Leninit, të jetë gjithmonë i pastër në damarët e trupit. Gjaku i pastër e bën trupin e njeriut të shëndoshë, ideologjia marksiste-leniniste e pastër e bën socializmin të triumfojë dhe të ecë drejt shoqërisë pa klasa, drejt komunizmit.

Prandaj ta kuptojmë thellë dhe ta zbatojmë drejt në çdo fushë ideologjinë e Partisë. Pse duhet vepruar kështu? Sepse në shoqërinë tonë ka akoma mbeturina të vjetra në ndërgjegjen e njerëzve, të cilat janë, si të thuash, ferra të vogla që ende na çjerrin këmbët. Ato



duhet medocemos të luftohen e të zhduken, duke ndjekur një rrugë të drejtë kundër tyre. Kontradiktat tona me bartësit e këtyre mbeturinave në shumicën e rasteve janë kontradikta joantagoniste, janë kontradikta në gjirin e popullit. Por te ne, në shoqërinë socialiste, dalin edhe elementë që hyjnë në luftë me Partinë, e në këtë rast kemi të bëjmë me kontradikta antagoniste. Në vendin tonë socialist ekziston diktatura e proletariatit, shteti i shumicës kundër pakicës, i cili lufton e shtyp pa mëshirë gjithçka që pengon triumfin e plotë të socializmit.

Në Kongresin e 7-të të Partisë u diskutua Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Kështu u afirmua edhe një herë vija e drejtë e Partisë gjatë gjithë këtyre dekadave. Kjo vijë e pushtetit të diktaturës së proletariatit ka dhënë rezultate madhështore dhe ka ndihmuar të kryhen transformime të mëdha te njerëzit tanë. Kushtetuta jonë është nga më demokratiket në botë. Ajo merret si shembull dhe studiohet me interesim nga komunistët dhe njerëzit përparimtarë të shumë vendeve, sepse ata që luftojnë kundër kapitalit, shohin të pasqyruar në të rrugën që duhet të ndjekë edhe populli i tyre. Nga ky shembull ata marrin forcë e besim dhe thonë: «Kush e krijoi këtë situatë? Populli shqiptar, një popull i vogël». Atëherë ata reflektojnë: «Pse ne, që jemi një popull më i madh se populli shqiptar, të mos e realizojmë një gjë të tillë?». Për këtë situatë e për këto ndryshime ata nuk mësojnë vetëm nga dokumentet, nga librat e revistat e ndryshme për vendin tonë që shpërndahen në vendet e tyre. Me qindra e me qindra miq vijnë dhe vizitojnë çdo vit Shqipërinë.

Që nga vendet më të largëta vijnë te ne njerëz për të marrë eksperiencë, për të parë çfarë bëhet në Shqipëri. Nga shumë vende të Afrikës vazhdimisht kërkojnë të vijnë njerëz në vendin tonë. Dhe të kuptohemi, ata nuk janë të gjithë komunistë, por janë njerëz përparimtarë, patriotë të popujve dhe të vendeve të tyre, që dëshirojnë ta vizitojnë Shqipërinë, sepse në këtë vend të vogël, në gadishullin e Ballkanit, shohin një shtet socialist, ku në fuqi është diktatura e proletariatit dhe ku jeton e përparon një popull që po përballon me sukses armiq të tillë të fuqishëm, siç janë imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik e gjithë reaksioni botëror, duke qëndruar i patundur dhe i patrembur prej tyre. Ky qëndrim të gjithë i çudit. Si është e mundur, thonë norvegjezi, spanjoli e të tjerë, të ngjasë një gjë e tillë? Një popull i vogël, një Republikë Popullore Socialiste e vogël të nxjerrë shpatën kundër gjithë këtyre forcave kapitaliste dhe imperialiste? Shqiptarët nuk e njohin frikën, vazhdojnë të thonë ata, dhe arrijnë në përfundimin se, po të kishin frikë, shqiptarët nuk do të ndesheshin me të tillë armiq. Atëherë vënë gishtin në kokë dhe thonë: Po pse nuk kanë frikë shqiptarët? Se janë trima. Por edhe ne jemi trima, prandaj si ngjet një gjë e tillë? Ne u themi atyre: Vërtet jeni trima dhe populli kurdoherë është trim, vetëm se ai duhet udhëhequr drejt. Pastaj ka rëndësi ideologjia që frymëzon popullin. Në qoftë se populli frymëzohet nga marksizëm-leninizmi, atëherë ai me të vërtetë nuk e njeh frikën.

Marks i thoshte: «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Kjo parullë e madhe i bën thirrje proleta-

riatit botëror që të shtrëngojë kudo fort radhët, në mënyrë që armiku të mos gjejë asnjë të çarë dhe të gjithë si një trup i vetëm të ecin përpara dhe të shtypin armiqët. Në përputhje me këto mësimë mendon dhe vepron populli shqiptar, prandaj tok me të janë proletariati botëror, janë të gjithë popujt e botës që luftojnë për liri, pavarësi e çlirim shoqëror.

Shoqe dhe shokë, duke e parë me këtë sy situatën, del se Shqipëria nuk është një vend i izoluar. Ne jemi të rrethuar prej shtetesh që drejtohen nga klika imperialisto-revizioniste, por popujt e këtyre vendeve dhe gjithë popujt e botës janë me ne, opinioni përparimtar botëror është me Shqipërinë. Ne duhet të luftojmë, të punojmë dhe të jetojmë si në rrethim e ta çajmë rrethimin imperialisto-revizionist.

Një realitet i tillë e bën vendin tonë shembull për njerëzimin. Në botë ka njerëz të ndershëm, trima, që respektojnë trimin dhe njeriun e ndershëm. Prandaj, një Shqipëri socialiste, që mobilizohet, që lufton dhe krijon një jetë të lumtur, fiton respektin dhe dashurinë e të tjerëve dhe forcon besimin për rrugën e drejtë që ndjek. Ne frikë nuk kemi, se frika e dobëson shtetin, e dobëson njeriun, po frikë kanë vetëm ata që nuk i kuptojnë problemet, që nuk kuptojnë zhvillimin e situatave.

Partia jonë, shteti ynë, të gjithë ju i kuptoni situatat. Ju e kuptoni drejt kur themi se duhet prodhuar më shumë, se puna duhet organizuar më mirë, se problemi i mbrojtjes duhet parë gjithmonë me seriozitetin e duhur, kur themi që të bëhen transhe dhe që tërë populli të ndihmojë në ndërtimin e fortifikimeve. Mbrojtja e

atdheut është një detyrë mbi detyrat që duhet të na bëjë t'i vihemi punës me të gjitha forcat për ta kryer me sukses, se vetëm kështu do të konsolidojmë fitoret tona.

Një pjesë nga ju ishit të vegjël dhe nuk ju kujtohet, kurse të moshuarit e mbajnë mend mirë që, në vitin 1961, kur ne dëbuam sovjetikët që këtej, nga ky gji i mrekullueshëm i atdheut, të cilin kërkonin ta pushtonin, ata i kishin akoma në dorë nëndetëset, megjithëse të gjitha ishin tonat. Kur hrushovianët u përpoqën t'i rrëmbenin, nuk arritën t'i merrnin të tëra. Për këtë qëllim erdhi këtu një nënkomandant i flotës sovjetike, i cili menjëherë hipi trupat mbi nëndetëse dhe i vuri ato në pozita luftarake. Por, në të njëjtën kohë, edhe ne dhamë urdhër t'i lëviznim bateritë tona në Karaburun, në Sazan dhe në kodrat rreth Vlorës. Atëherë ata, të zënë si miu në çark, u detyruan me bisht në shalë të largoheshin.

Armiqtë, shoqe dhe shokë, kurdoherë t'i luftojmë pa mëshirë. Ata janë të shumtë dhe të shumëngjyreshëm. Armiq, në radhë të parë, janë gjithë kapitalistët që përpiqen dhe luftojnë të mbajnë në skllavëri popujt, t'i shfrytëzojnë e t'u pijnë gjakun. As që u priset puna kapitalistëve që populli vuan, që nuk ka të hajë e nuk gjen punë. Ka disa ditë që me dhjetëra mijë studentë në universitetet e Romës e të Bolonjës në Itali janë ngritur duke protestuar. Po përse protestojnë ata? Sepse, sa mbarojnë universitetin, nuk kanë bukë të hanë, se nuk gjejnë punë. Por dhe shumë studentë, që duhet të vazhdojnë mësimet, nuk i lejojnë mundësitë, se i grijnë taksat.

Pra, në radhë të parë, armiq janë imperialistët, me imperialistët amerikanë në krye. Armiq të tjerë po aq të rrezikshëm janë edhe ata që e kanë mbështetjen në kapitalizëm dhe që janë vetë kapitalistë, revizionistët sovjetikë. Këta janë tradhtarë të marksizëm-leninizmit, që e kanë kthyer Bashkimin Sovjetik në një vend agresiv, luftënxitës. Tok me këta, armiq të popujve janë edhe gjithë ato klika sunduese të çdo shteti ku sundon kapitali vendës në kurriz të popujve. Prandaj ne jemi kundër të gjithë këtyre lloj armiqve, me të cilët duhet luftuar vazhdimisht. Kjo luftë bëhet me propagandë e agjitacion, që popujt ta kuptojnë ku është shpëtimi i tyre dhe rruga që duhet ndjekur. Atyre që duan të na dëgjojnë, ne u tregojmë se cila ka qenë dhe është vija e Partisë sonë që na çoi në çlirimin e popullit nga shtypja e shfrytëzimi dhe se sukseset tona janë arritur në luftë të pamëshirshme kundër armiqve të të gjitha ngjyrave.

Në këtë luftë që ne po bëjmë, është e kuptueshme se kemi edhe kundërshtarë, të hapët dhe të fshehtë. Kundërshtarët e fshehtë janë armiq të këqij, të egër, dinakë dhe të rrezikshëm. Të tillë kundërshtarë janë revizionistët modernë, sepse ata maskohen me marksizëm-leninizmin. Revizionistët nuk janë marksistë; ata dhe shokët e tyre, oportunistët e të gjitha llojeve, s'kanë asgjë të përbashkët me marksizmin, se janë pjelellë e kapitalit. Këta ne i kemi armiq dhe janë të rrezikshëm, sepse gënjejnë masat e popujve, të cilëve u thonë se nuk duhet të luftohet kundër klikave sunduese në vendet e tyre. Kjo është njëlloj sikur të na thoshin neve në kohën e Zogut ose të okupacionit të mos

luftonim mbretin apo fashizmin, të rrinim të qetë. Për ne është e qartë se me një gjuhë të tillë flasin vetëm oportunistët. Po si të mos luftonim ne kundër shtypësve?! Të mos luftojmë, thonë revizionistët dhe oportunistët, se fitorja arrihet edhe me rrugë paqësore, duke siguruar shumicën e votave në parlamentet borgjeze. Me ndihmën e deputetëve të shkohet në socializëm!!

Pikërisht kjo është rruga që oportunistët u predikojnë popujve për t'u çliruar nga shtypja dhe nga shfrytëzimi. «Bashkohuni me të gjitha partitë e kapitalit, ju, proletarë, mos u hidhni në greva e në demonstrata. Ju, partitë komuniste marksiste-leniniste, bashkohuni me partitë revizioniste dhe kështu tok, së bashku dhe me policinë, dhe me ushtrinë e kapitalit, shkoni në socializëm!», këtë predikojnë oportunistët. Kurse për marksistë-leninistët e vërtetë është e qartë si drita e diellit se në qoftë se nuk i luftojnë të gjithë këta armiq, që janë të lidhur me imperializmin amerikan dhe me socialimperializmin sovjetik, atëherë krijohen situata ku populli shtypet dhe e paguan me gjak dhe me sakrifica të pallogaritshme. Kjo është arsyeja që ne duhet t'i shkatërrojmë planet e këtyre armiqve. Shkatërrimi i tyre bëhet vetëm me luftë të vendosur. Si mund të kurorëzohet me fitore kjo luftë? Përgjigjja është: Duke shtrënguar radhët fort dhe duke përvetësuar thellë e duke ndjekur ideologjinë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Klasikët tanë kanë thënë se njerëzit që janë në luftë duhet të bëjnë edhe aleanca, por këto aleanca kurrë të mos çojnë në humbjen e personalitetit të partive komuniste, kurrë të mos errësojnë

qëllimet e vërteta të tyre dhe aspiratat e popujve e të klasës punëtore.

Kujtoni historinë e Partisë sonë. Partia jonë ka bërë aleanca me persona dhe grupe njerëzish që nuk ishin komunistë. Unë ju thashë që kam biseduar me njerëz si Tahir Hoxha e Hysni Lepenica, Fasli Frashëri, Lumo Skëndo, Ali Këlcyra e të tjerë krerë të reaksionit. Pse i bëmë këto përpjekje për aleancë me ta? Sepse ne donim t'i tërhiqnim edhe ata në luftën tonë, por kur pamë se një gjë e tillë nuk u realizua, kur ata u bashkuan me tradhtarët e okupatorët, atëherë u drejtuam pushkën. Këto përpjekje për aleanca nga ana jonë ishin të drejta, por nuk patën rezultat.

Aleancë e vërtetë, e shëndoshë, ku u konkretizua vija e Partisë sonë, ishte ajo që u realizua në shtator të vitit 1942 në Konferencën e Pezës dhe që u shpreh me krijimin e Frontit Nacionalçlirimtar, në atë organizatë të madhe të të gjithë popullit, të udhëhequr nga Partia. Në këtë front bënin pjesë të gjithë ata që ishin për çlirimin e atdheut dhe krijimin e një jete të re.

Ky front i gjerë, me kalimin e viteve, u forcua, u kalit dhe u bë një armë e fuqishme në dorë të popullit. Organizatën e Frontit Demokratik ne duhet të vazhdojmë ta forcojmë, ta bëjmë sa më të gjallë e demokratike. Anëtarët e saj në mbledhjet që organizon ky, duhet të flasin dhe të japin mendimet e tyre pozitive për mbarëvajtjen e punës në bllok, në lagje, në fshat, të kritikojnë të metat që vënë re dhe të kenë parasysh se kritika nuk dëmton, përkundrazi, ajo ndihmon në përmirësimin e punës. Kuptohet, këtu është fjala për kritikë objektive, të shëndoshë e parimore. Në qoftë

se nuk kritikohen ata që gabojnë, atëherë punët me siguri do të çalojnë. Në qoftë se nuk dezinfekton pemën e mollës, mikrobet do të shtohen dhe trupi i saj do të krimbet i tëri. Prandaj sëmundjet duhen luftuar me kohë. Edhe të tilla sëmundjeve që na kanë mbetur nga e kaluara, u duhet gjetur ilaçi. Jeta ka vërtetuar se kritika dhe autokritika janë ilaçi më i mirë për luftimin e tyre. Partia, gjithashtu, na mëson se kritikën duhet ta përdorim vazhdimisht për korrigjimin e të metave, se kurrë nuk duhet të heshtim kur vëmë re që një njeri nuk punon mirë, por ta kritikojmë, dhe, në qoftë se nuk korrigjohet menjëherë, me siguri ai do të korrigjohet herën tjetër.

Partia jonë mbështetet e gjen forcë në unitetin e popullit të bashkuar në Frontin Demokratik. Me këtë unitet të fortë e me një tog realizimesh në shumë fusha, ne do të vemi ballëlart në zgjedhjet e 3 prillit.

Zgjedhjet te ne, shoqe dhe shokë, kanë rëndësi të madhe, sepse ato nuk janë formale. Nuk është fjala vetëm sa të marrim fletën e votimit, ta futim në kuti dhe të dalim me 99,99 për qind. Rëndësia e zgjedhjeve qëndron në të kuptuarit e faktit se në këshillat dhe në gjykatat tona popullore ne duhet të zgjedhim njerëz nga më të mirët, nga më besnikët, nga më të ndershmit, që të marrin drejtimin dhe t'i kryejnë një për një detyrat që u ngarkon populli. Në këtë mënyrë populli është i gatshëm të udhëhiqet nga këta njerëz që vetë i zgjedh, t'i dëgjojë ata, por edhe ata ta dëgjojnë atë dhe kështu të gjithë së bashku të realizojmë detyrat e mëdha që na vë Partia përpara. Pikërisht këtu qëndron rëndësia e madhe e zgjedhjeve në vendin tonë. Sistemi i zgjedh-



jeve te ne është nga më demokratikët në botë, se populli ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet që nga organet më të ulëta të pushtetit e deri te më të lartat.

Shumica nga ju jeni të rinj dhe nuk e keni jetuar kohën e Zogut. Edhe atëherë bëheshin «zgjedhje» dhe ata që dilnin deputetë për në parlament i quanin «ballarë të kombit», por ata mbronin vetëm xhepat e tyre. «Ballarët e kombit» as që mendonin ndonjëherë për popullin që vuante nën sundimin e egër të Zogut. Pra, nga këta do të priste populli t'i mbroheshin interesat, të çlirohej e të jetonte i lirë?! Kurrën e kurrës! Kështu ndodh në vendet kapitaliste e revizioniste, mbasi borgjezia që ka fuqinë në dorë, vë në përdorim të gjitha mjetet për të përjetësuar sundimin e saj, duke i privuar masat e gjera të popullit nga të drejtat më elementare.

Ja, para pak kohësh u bënë zgjedhjet në Indi, populli i së cilës u ngrit e protestoi kundër regjimit në fuqi. Gjatë këtyre ngjarjeve atje u vranë me qindra veta në përpjekje me policinë e Indira Gandit, klika e së cilës, megjithatë, nuk fitoi në këto zgjedhje, prandaj u detyrua të japë dorëheqjen. Po kush është Indira Gandhi dhe kush është ai që erdhi në fuqi pas dështimit të saj me turp? Edhe Desai që u bë kryetar i qeverisë indiane, është, si edhe Gandhi, një nga pasanikët më të mëdhenj të Indisë. Se mos do të mendojnë të tillë njerëz për popullin? Në asnjë mënyrë jo. Ata mendojnë dhe do të mendojnë si e si të pasurohen më shumë. Prandaj, pavarësisht se u ndërruan «qetë», gjendja e popullit atje mbeti njëlloj, e mjeruar. Në Indi njerëzit, nga më të mjeruarit e botës, janë ata që i quajnë «të

paprekshëm», por India është një nga vendet më të prapambetura të globit, ku vdesin me qindra mijë e me miliona në vit, veçanërisht kur bën thatësi e madhe. Ndryshimi në qeverinë e Indisë u bë për interesin e klasave sunduese, domethënë për interesin e bandës së Gandit dhe të Nehruit ose të Desait me tarafin e tij, që fitoi në zgjedhjet e këtij viti. Pra, zgjedhjet në vendet kapitaliste janë krejtësisht formale, ato kanë vetëm një qëllim: të forcojnë pushtetin borgjez shtypës e shfrytëzues.

Ajo që i karakterizon zgjedhjet tona është përmbajtja e thellë socialiste, revolucionare. Zgjedhjet, në një shoqëri si kjo jona, thellojnë më shumë demokracinë socialiste. Njerëzit që do të zgjedhim në votimet e 3 prillit janë nga bijtë dhe bijat më të mira, që ne vetë i kemi propozuar. Nga ata, si zgjedhës ne kërkojmë që të zbatojnë drejt politikën e Partisë, të organizojnë prodhimin, të japin drejtësi në rrugën e Partisë, në të mirën e popullit, jo vetëm të dënojnë, por edhe t'i edukojnë njerëzit. Sa më pak dënime administrative, aq më mirë do të jetë, dhe sa më tepër punë edukative e politike të bëhet me njerëzit, aq më të fortë do të bëhen atdheu dhe pushteti ynë. E tillë është vija e Partisë sonë. Pse ndodh e do të ndodhë kështu te ne? Sepse njerëzit zhvillohen politikisht. Politikë nuk bëjnë vetëm komunistët, vetëm shokët që kemi zgjedhur të drejtojnë në Front e në organizatat e tjera, por politikë bën dhe duhet të bëjë çdo njeri. Dhe kështu ndodh në realitet. Për shembull, kur shikoj shokun që qoftë edhe për një gjë të vogël nuk e ka drejt mendimin, atëherë duhet t'i them: «Shok,

nuk është mirë kështu si mendon dhe si vepron ti». Në këtë rast, kjo që bëj unë është politikë. Pra politikë nuk është vetëm kur flasim kundër imperializmit dhe revizionizmit. Ne gjithmonë do të flasim kundër armiqve të tillë të rrezikshëm dhe kundër gjithë reaksionit botëror, por politikë bën njeriu edhe kur shikon diçka që nuk ecën te fqinja ose te shoku që ka afër, të cilit ia shpjegon me durim se ajo që ka bërë nuk është e mirë, nuk i shërben shoqërisë, dhe në atë mënyrë nuk duhet të veprojë më. Një qëndrim i tillë ka rëndësi të madhe. Partia në këtë fushë po e zhvillon vijën e saj, e cila po jep vazhdimisht fryte.

Për mua është një kënaqësi e madhe që erdha sot te ju, ju pashë, ju fola, ndoshta një çikë gjatë e mbase dhe ju lodha, por të më falni, sepse çdo ditë e çdo muaj nuk takohemi dot. Zërin po, gjithmonë jua kam dëgjuar për mirë dhe zërin e mirë tërë jetën, sa të rroj, kështu dëshiroj t'jua dëgjoj.

Partia ka bindjen e plotë se ju populli i Vlorës heroike do të vazhdoni të keni suksese akoma më të mëdha në punën tuaj të shumanshme e të frytshme. Ne jemi në dijeni që shumë tregues të planit i keni realizuar. Ju jeni një pjesë e popullit tonë nga më luftarakët, nga më energjikët, nga më të qartët politikisht. Prandaj kam bindjen se këto detyra të mëdha që ju vë Partia përpara për të gjitha këto çështje, që nga ato ekonomike, politike, ideologjike, kulturore, fëmbrojtjes etj., të gjitha do t'i plotësoni me nder.

Të rrojë Partia! Të rrojë rinia! Të rrojë ushtria! Qofshi të gjithë të gëzuar e me shëndet!

Tani të shkojmë të gjithë atje në rrëzë të kodrës e të bëjmë një fotografi së bashku.

*Botuar për herë të parë, me disa shkurtime, në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 246*

*Botohet sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## ME PUNË MUND TË REALIZOHEN DETYRA ME TË MËDHA

*Nga biseda me disa shokë të byrosë dhe sekretarët  
e Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës*

26 mars 1977

*Gjatë kthimit nga Vlora për në Tiranë shoku Enver Hoxha u ndal në qytetin e Lushnjës, ku u takua dhe bëri një bisedë me disa shokë të byrosë dhe sekretarët e Komitetit të Partisë të rrethit.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet, shokë, jeni mirë të gjithë? Për grurin nuk po ju pyes si e keni, se e pashë rrugës kur vija dhe m'u duk i mirë.

Para se të ktheheshim në Tiranë, i thashë shoqes Nexhmije: Meqenëse do të kalojmë nëpër Lushnjë, pse të mos qëndrojmë pak, sa të piqemi me shokët, të cilët të na vënë në dijeni shkurtimisht për gjendjen në rreth?

Në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të datës 9 mars për disa probleme të qarkullimit monetar, ju kishit paraqitur një material, ku pasqyrohej puna e Partisë dhe e pushtetit në rrethin tuaj lidhur me këtë problem të rëndësishëm. Në mbledhje u mor

një vendim për këtë çështje. Unë e lexova raportin tuaj, ai m'u duk i mirë, sepse kishte edhe kritikë. Atje bëhej një analizë e thellë e punës dhe e të metave që janë vënë re në problemet financiare dhe në tërheqjen e parave nga shteti. Duke e parë raportin tuaj nga ky kënd vështrimi, mendoj se ju i kishit pasqyruar këto çështje delikate pak më drejt se shokët e Partisë të rrethit të Korçës, raporti i të cilëve m'u duk se nuk ishte aq real. Problemet në të trajtoheshin në mënyrë të sipërfaqshme dhe të metave u jepej një lustër e jash-tme. Me sa duket, shokët e Komitetit të Partisë të Korçës kërkojnë që gjithë punët të marrin fund me hapjen e ekspozitave të ndryshme. Korçarët kanë qenë të kujdesshëm në këtë drejtim dhe, natyrisht, ekspozitat janë një nxitje për prodhime me cilësi të mirë, sipas shijeve të konsumatorit dhe në përputhje me kërkesat e moralit tonë socialist. Por shqetësimi i shokëve të rrethit të Korçës nuk duhet të jetë vetëm ky, domethënë ekspozimi i disa kamploneve të prodhimeve të industrisë së lehtë, për të cilat bëhet fjalë në këtë raport. Rëndësi të madhe ka që artikujt e ndryshëm të prodhohen në sasi të mëdha, që të plotësohen kërkesat e konsumatorëve, dhe eksperiencën për këtë ata e kanë.

*Shoqja Lenka Çuko e vuri në dijeni shokun Enver Hoxha për punën që bëhej në rrethin e Lushnjës për studimin, zbërthimin dhe për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë. Në vazhdim folën edhe shokë të tjerë. Shoku Enver Hoxha drejtoi disa pyetje:*

Desha të di si janë punuar temat për Kongresin e 7-të të Partisë dhe gjatë zbërthimit të tyre ka pasur

diskutime, debate e rrahje mendimesh apo jo? Ju folët për pusin e naftës që u zbulua kohët e fundit. Mund të na thoni sa naftë dha ky pus në debit? Si mendojnë specialistët, kanë lidhje këto shtresa gaz e naftëmbajtëse të kësaj zone me zona të tjera? Çfarë mendohet të bëhet për shfrytëzimin e naftës?

Sa fasule morët vjet nga sipërfaqja e tokës që mbollët bashkë me misrin? Sa hektarë tokë keni për të mbjellë sivjet me foragjere dhe ç'rendimente merrni? Keni studiuar literaturë për drenazhimet që bëhen në rrethin tuaj dhe në ç'përfundim është arritur? Ju keni një furrë «Hoffman» për prodhimin e gëlqeres, dua të di sa është prodhimi vjetor i saj dhe a u jepni rretheve të tjera nga ky prodhim. Po me lëndën e drurit për ngrohje si jeni? Janë bërë studime në rrethin tuaj për të prodhuar soba me vajguri? Shokët e Ministrisë së Tregtisë kanë ardhur ndonjëherë këtu t'i bisedojnë shtruar problemet me ju? Keni ankesa për programet e shkollës e për kalueshmërinë e nxënësve? Si organizohet puna prodhuese në shkolla?

*Pasi dëgjoji përgjigjet e këtyre pyetjeve, e mori fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Është më se e nevojshme që të vërtetohet nëse zbatohen në jetë direktivat e vendimet e Partisë apo jo dhe si zbatohen konkretisht ato e vendimet e marra nga organizatat-bazë, sepse vetëm atëherë kuptohet nëse janë përvetësuar thellë detyrat që caktoi Kongresi i 7-të i Partisë. Të shihet në mënyrë konkrete, për shembull, se si i kanë zbatuar organizatat-bazë mësimet e Partisë në luftën kundër shfaqjeve burokratike, me të cilat ndeshen në veprim-

tarinë e tyre të përditshme, si kanë punuar ato për forcimin e pareshtur të diktaturës së proletariatit, si e kryejnë konkretisht luftën për uljen e kriminalitetit, për forcimin e këshillave popullorë e të tjera çështje si këto, të cilat përfshihen të gjitha në temën e parë për diktaturën e proletariatit, që ju e keni punuar.

Tani që jemi në fushatën e zgjedhjeve të këshillave dhe gjykatave popullore, duhet të punojmë për ngritjen ideopolitike të masave, me qëllim që të kuptohet rëndësia e madhe që kanë zgjedhjet në shoqërinë tonë socialiste. Në organet e diktaturës së proletariatit duhet të zgjidhen punëtorë dhe të tjerë njerëz nga më të mirët e më të devotshmit për t'i kryer me nder detyrat që do t'u ngarkohen. Në këtë punë sqaruese e bindëse, që duhet të bëjë Partia, problemet të shtjellohen duke u mbështetur te Kushtetuta, te nenet përkatëse të Ligjit tonë të ri Themeltar, ku pasqyrohen edhe çështjet e pushtetit të diktaturës së proletariatit. Partia na mëson që masa të shprehë hapur mendimin e saj për ata që do të rizgjidhen ose që do të zgjidhen për herë të parë në organet e pushtetit. Një veprim i tillë është i mirë edhe për arsye se ka disa gjëra që udhëheqja nuk i di, dhe kjo është e kuptueshme, kurse zgjedhësit, masa, i dinë dhe në takime të tilla ata thonë ç'mendojnë për secilin. Në këtë mënyrë sigurohen rezultate më të mira, sepse në udhëheqje të organeve të pushtetit zgjidhen persona që e meritojnë me të vërtetë të jenë në to.

Për sa i përket naftës, gjeologët dhe specialistët gjatë punës së tyre duhet të bëjnë kujdes të madh nga ana teknike. Ata ne duhet dhe t'i inkurajojmë, por edhe t'u kërkojmë që t'i studiojnë mirë problemet, sepse



sabotimet e armiqve në sektorin e naftës mund t'i bëjnë ata të tremben e të mënjanohen nga puna. Ja, në Vlorë më thanë se ka pasur kontradikta me specialistët e qendrës në lidhje me shpimin. Prandaj në këtë drejtim të tregohemi të kujdesshëm, që specialistët të mos ndrydhen. Ne duhet të kemi parasysh se specialistët tanë nuk janë të këqij, përkundrazi, i kemi të mirë. Ja, këto suksese që thoni ju, janë një inkurajim për të gjithë dhe në mënyrë të veçantë për ata, prandaj duhet t'i përdorim e t'i aktivizojmë me kujdes. Që duhet t'u kërkohet më shumë, duhet. Kur duhet t'i kritikojmë, t'i kritikojmë, por njëkohësisht t'i inkurajojmë që të forcojnë besimin në forcat e veta. T'i thërresim në konsultime, të dëgjojmë mendimin e tyre, por njëkohësisht t'u hapim horizonte, që të punojnë më me kurajë e me disiplinë më të fortë tekniko-shkencore.

Çështja është se këto zona ku po shpojmë, kanë qenë koncesione të anglezëve, të cilët në vitet 20 të shekullit tonë kishin pozita të rëndësishme në botë për naftën. Në kohën e qeverisë së Fan Nolit anglezët si zonë naftëmbajtëse në Shqipëri zgjodhën pikërisht këto anë dhe mendoj se nuk vepruan kot. Ata qenë të bindur se do të gjenin naftë. Ambasadorit që ishte atëherë në Shqipëri anglezët i dhanë titullin «sër». Ky titull u jepej atëherë nga qeveria angleze vetëm atyre që i siguronin Britanisë së Madhe burime pasurish, si naftë etj. Por në këtë zonë anglezët nuk arritën të bënin shpime, megjithatë ata ia dhanë Italisë. Italianët, duke mos pasur eksperiencën e anglezëve, nuk shpuan këtu puse për naftë, ata shpuan vetëm në Kuçovë (sot Qyteti Stalin). Edhe në Libi, që tash njihet si një vend me burime të

mëdha naftë, siç e dimë të gjithë, italianët sa kohë e kishin nën sundimin e tyre, nuk i zbuluan dot shtresat e pasura naftëmbajtëse. Prandaj të mos arrijmë në konkluzionin e nxituar e të dëmshëm se, meqë nuk shpuan puse italianët në këtë zonë, gjoja nuk ka naftë, përkundrazi, këto janë zona naftë, bile në tërësi gjithë vendin ynë është zonë naftëmbajtëse.

Ka rëndësi që specialistët, pavarësisht se janë mobilizuar për të realizuar detyrën e studimit me imtësi të vendeve ku do të shpojnë, nuk duhet të harrojnë edhe studimin e thellë të formacioneve të tokës sonë. Kjo përbën një detyrë jashtë punëve të tyre të përditshme e të drejtpërdrejta, por është e domosdoshme të kryhet, se ka disa probleme, si ai i shtresave gjeologjike, për të cilat specialistët thonë se janë formacione të ndryshme, apo ai i thyerjeve të ndryshme gjeologjike, që ata duhet t'i studiojnë e t'i vërtetojnë për gjithë vendin. Vetëm po të bëhet studimi gjeologjik i një zone në mënyrë shkencore, atëherë krijohen mundësi për të bërë punime speciale.

Ne kemi një nëntokë të pasur, por ish-ministri i Industrisë e i Minerave, tradhtari Koço Theodhosi, nuk e kishte vënë fare ujin në zjarr për studimin e përgjithshëm gjeologjik shkencor të nëntokës sonë. Koço Theodhosi kërkonte që shpimet për naftën, për kromin, për bekurin e për të tjera minerale me vlerë që ka nëntoka jonë, të bëheshin të veçuara dhe pa pasur të tëra këto si bazë studimin e përgjithshëm gjeologjik. Mirëpo çdo mineral i marrë në veçanti, për kërkimin dhe zbulimin konkret ka gjeologët e vet të specializuar, që e njohin mirë gjeologjinë e tij, por ka edhe çështje që i për-

kasin sferës së gjeologjisë së përgjithshme. Dhe, meqë udhëzimet e Koço Theodhosit ishin ashtu siç thashë, kam mendimin se, në përgjithësi, për gjeologjinë e vendit tonë shkëmbimi i eksperiencës në mënyrë të studiuar nuk është bërë. Prandaj edhe ti, shoqja Nexhmije, në referatin që po përgatit rreth orientimeve që caktoi Kongresi i 7-të për zhvillimin e shkencave, duhet ta vësh në dukje këtë çështje.

Specialistët tanë e kanë bërë hartën gjeologjike të Shqipërisë, por duhet të kemi parasysh se ajo është bazuar edhe tek të dhënat e të tjerëve, tek «të shquarit» e huaj. Për më tepër hetimi i veprimtarisë së Koço Theodhosit ose i ndonjë tjetri që merrej drejtpërdrejt me gjeologjinë, ka nxjerrë se disa të dhëna, që janë përdorur për hartën gjeologjike të Shqipërisë, nuk janë reale. Kjo do të thotë se edhe në punën për përgatitjen e kësaj harte ka pasur sabotime. Në fushën e kërkimeve gjeologjike çështja e njohjes së terrenit ka rëndësi të madhe dhe, lidhur me këtë, po kaq rëndësi ka edhe çështja se si orientohen kuadrot që punojnë në këtë fushë. Puna e gjeologëve është tamam si ajo e oficerëve, që luftojnë duke mbajtur përpara hartën topografike. Sigurisht, harta për oficerët ka rëndësi të madhe, se jo të gjithë e njohin Shqipërinë me pëllëmbë, por rëndësi të madhe ka gjithashtu edhe njohja konkrete e terrenit nga secili. Që të dyja këto rrugë, edhe njohja nëpërmjet hartës, edhe shkelja me këmbë e terrenit, kanë rëndësi të madhe për ushtarakët. Kështu është puna edhe me gjeologët e rinj. Në qoftë se këta do të orientohen gabim nga mjeshtrat, nuk do të arrihen rezultatet që presim,

ashtu siç nuk mund të fitojnë ushtarët në luftë kur orientohen gabim nga oficerët.

Partia dhe pushteti, që nga ministria e deri tek organet shtetërore në bazë, duhet të merren seriozisht me këto probleme dhe ta drejtojnë mirë punën, si për organizimin e nxjerrjes së mineraleve, ashtu edhe për të gjitha çështjet e tjera. Është, gjithashtu, e nevojshme që ata të udhëheqin specialistët me orientime sa më të bazuara, t'u hapin një horizont më të gjerë nga ai që mund të kenë marrë në shkollë, në mënyrë që çdo specialist të jetë në gjendje të bëjë përgjithësisht jo vetëm për disa puse, por për të gjitha puset. Mjetet dhe aparaturat që disponojmë janë të reja dhe relativisht të mjaftueshme në kushtet tona. Megjithatë, për studimin në kuptimin e vërtetë shkencor të shtresave gazmbajtëse dhe naftëmbajtëse, në krahasim me shumë vende, ne jemi prapa. Shtetet e tjera të botës kanë aparatura elektronike shumë të ndjeshme, që ne nuk jemi në gjendje t'i blejmë, se kushtojnë me dhjetëra milionë dollarë. Veç kësaj, as na i jep njeri, prandaj na vihet detyrë që ato mjete dhe aparatura që kemi, t'i vëmë si duhet në përdorim, të marrim prej tyre maksimumin e mundshëm të të dhënave, të bëjmë klasifikimin e tyre dhe të informojmë për këto të dhëna shkencore gjithë institucionet që merren me studimin dhe me kërkimin e nëntokës, domethënë të bëjmë komunikimin shkencor.

Për këtë qendrat e kërkimeve e të studimeve gjeologjike bashkë me Ministrinë e Industrisë dhe të Minerave duhet të bëjnë komunikimin shkencor jo vetëm të veçantë, por edhe të përgjithshëm. Ky lloj komunikimi është më se i domosdoshëm, sepse njohuritë, dijet

e të dhënat për naftën institutet kërkimore shkencore si dhe njerëzit që punojnë në to i kanë vetëm në një drejtim. Mungesa e këtij komunikimi ka krijuar mundësi që në praktikë të bëhen kërkime, për shembull, për krom, po në këto kërkime nuk është parë se çfarë gjë tjetër ka në shtresat që i janë nënshtruar kërkimit e që janë zbuluar. Kështu ka ndodhur edhe kur shpojme për të kërkuar e për të gjetur naftë. Të mos harrojmë se kemi hapur shumë puse, mirëpo në të gjitha këto raste nuk kemi mbajtur të dhëna ekzakte as për shtresat e ndryshme të naftës. Dhe kur për naftën nuk e kemi bërë një gjë të tillë, kuptohet pastaj se sa mund ta kemi bërë këtë për mineralet e tjera që shoqërojnë naftën. Të tilla shënime duhen mbajtur medoemos në çdo kërkim e shpim, sepse, kur zbulon naftë në një vend, atje mund të ketë pasur, përveç saj, edhe minerale të tjera ose të dhëna që paraqesin shumë interes për studime e kërkime në të ardhmen. Ndërsa ne deri tani jemi interesuar vetëm për një mineral dhe nuk jemi përpjekur për të bërë përgjithësimë nga të dhënat që na kanë dalë në të gjitha pikat ku kemi bërë kërkime, për të parë në shkallë republike nëse atje ku kemi shpuar ndodhen minerale të tjera, por jemi kufizuar vetëm në atë drejtim për të cilin kemi bërë shpimin.

Këtë praktikë pune nuk duhet ta lejojmë më. Prandaj e theksoj edhe një herë se për këtë qëllim është e rëndësishme që specialistëve t'u hapim horizont, t'i ndihmojmë ata në mënyrë të veçantë në fushën konkrete ku punojnë, por edhe për gjeologjinë e përgjithshme dhe, mbi këtë bazë, të konkludojmë edhe për çë-

shtje konkrete e për probleme më të gjera dhe të komunikojmë në mënyrë shkencore.

Unë nuk e kam ndjekur rregullisht revistën shkencore që nxjerr Universiteti i Tiranës, por, nga sa kam mundur të shoh, në të ka studime të përgjithshme.

Sidoqoftë, ne duhet të jemi optimistë dhe këtë optimizëm na e shton fakti që pusët e zbuluara edhe në rrethin tuaj na japin shenja premtuese. Ne do ta realizojmë planin e nxjerrjes së naftës, gjë që ka rëndësi të madhe, dhe për këtë duhet që pusëve ekzistuese t'ua zgjatim jetën, por të luftojmë që të zbulojmë edhe vendburime të reja. Këto duhet të jenë dy drejtimet ku duhet të synojmë vazhdimisht në të ardhmen.

Mendoj se të gjithë ju i njihni shumë mirë problemet, prandaj shpreh bindjen se do t'i realizoni me sukses detyrat e caktuara nga Partia. Vitin e kaluar patët edhe disa vështirësi të natyrës, që ndikuan në mosrealizimin e të gjithë zërave. Këtë vit, megjithëse planin e keni më të madh, parashikoni të realizoni shifrat e vitit 1978. Kam besim se edhe planin e vitit 1980 ju do ta realizoni përpara afatit. Jam i bindur se një gjë e tillë do të arrihet nga ju, sepse shoh që në popull ka optimizëm, kurajë dhe besim. Këtë besim ne duhet ta forcojmë duke realizuar dhe duke tejkaluar planet, në mënyrë që populli të bindet se me punë mund të realizohen detyra më të mëdha.

Një të tillë besim duhet të kemi dhe për suksese e realizime në sektorët e tjerë të bujqësisë, në blegtori, në radhë të parë, por edhe në pemëtari. Këtë gjë ua thashë dhe shokëve të Partisë të rrethit të Vlorës. Çështja kryesore që dëshiroj t'ju a theksoj është: të mobili-

zohet Partia, dhe me këtë dua të them që ajo të jetë në ballë të luftës e të punës për realizimin e të gjitha detyrave. Medoemos duhet të ndodhë kështu, sepse nuk është e drejtë që vetëm t'u caktojmë detyra kooperativistëve e t'u kërkojmë zbatimin, por t'i përvishemi edhe vetë punës të parët e bashkë me ta t'i kryejmë plotësisht detyrat.

Po flas këtu për detyrat e kooperativistëve, se ju problem kryesor ekonomik në rreth keni bujqësinë. Por Partia dhe pushteti të caktojnë detyra dhe t'u kërkojnë zbatimin e tyre edhe organeve të pushtetit administrativ, të propagandës, organeve që ushtrojnë kontroll, organeve të tregtisë, të financës, të komunales etj. Në punën që bëjnë drejtuesit e gjithë këtyre organeve me masat punonjëse të fshatarësisë kooperativiste jo vetëm që duhet t'u thonë atyre të kryejnë këtë apo atë detyrë, po edhe vetë drejtuesit e këtyre organeve duhet të jenë korrektë në kryerjen e detyrave ndaj kooperativistëve, sepse ndryshë këta kanë të drejtë t'u thonë: «Kryeni dhe ju detyrat tuaja, se nuk jeni në rregull», dhe në qoftë se nuk ua thonë, për mendimin tim bëjnë gabim. Kur ne nuk realizojmë detyrat që kemi në plan, për shembull, për furnizimin e fshatarësisë kooperativiste me mallrat e ndryshme që ajo ka nevojë, kooperativisti mund të mos na thotë gjë dhe, siç thashë, kjo është e gabuar, por ama, tek ai shkaktohet pakënaqësi, gjë që reflektohet pastaj në qëndrimin e tij ndaj punës. Ja, si the ti, shoqja Lenka, kur morët masa e hodhët në treg mallra për të cilat kooperativistët kishin nevojë, ato u blenë, nuk mbetën stoqe në dyqane. Kështu duhet të veprohet edhe për çështjet e tjera dhe në përgjithësi

duhet të merren masa nga ana jonë që t'i kryejmë mirë detyrat ndaj fshatarësisë kooperativiste.

Për sa i përket zhvillimit të industrisë në rrethin tuaj, kjo është e lidhur me vënien në shfrytëzim të uzinës së PVC-së në Vlorë, e cila besoj se do të inaugurohet nga mesi i muajit të ardhshëm dhe juve do t'ju vijë pastaj rregullisht lënda e parë, polivinilkloridi, i nevojshëm për këtë industri. Deri tani edhe për Fabrikën e Plastmasës në Durrës e sillnim nga jashtë lëndën e parë, kurse këtej e tutje kjo do të sigurohet nga Uzina e PVC-së në Vlorë.

Në këtë çështje ka rëndësi të madhe plani i furnizimit, sepse marrja e masave në kohë dhe parashikimet ekzakte për ato çka duhet të prodhohen parandalojnë krijimin e mallrave stoqe, gjë që nuk është e mirë për ekonominë tonë socialiste. Ministria përkatëse duhet të tregojë kujdes që të mos krijohen stoqe, por edhe fabrika që prodhon, të mos qëndrojë pasive në këtë drejtim, se për të nuk ka rëndësi vetëm të prodhojë që të realizojë planin. Jo! Kjo nuk mjafton. Ne duhet të prodhojmë artikuj që të hyjnë në përdorim menjëherë, ndaj të kujdesemi që çdo fabrikë të ketë preokupacion për të nxjerrë sasinë e prodhimeve sipas planit, sipas nevojave që ka ekonomia jonë për to etj. Kësaj i thonë të shqetësohesh për fatin e prodhimeve që dalin nga çdo ndërmarrje dhe një gjë e tillë duhet të shërbejë si stimul në fabrikë për prodhime në sasinë e duhur dhe me cilësi të mirë.

Unë mendoj se në fund të 6-mujorit ose në fund të vitit, kur fabrika apo ndërmarrja bën bilancin e realizimit të planit, duhet ta analizojë edhe këtë problem të



rëndësishëm. Drejtuesit dhe punëtorët e fabrikës, si të thuash, duhet t'i hajë meraku për mallrat që prodhojnë, duke organizuar edhe kontrole nga ana e tyre në ato rrethe ku shkojnë mallrat që prodhojnë, për të parë nga afër si është gjendja e tyre. Kur shohim se me prodhimet që na nevojiten për një kohë të shkurtër na janë mbushur raftet, se nuk kërkohen më nga konsumatorët, atëherë si prodhues ne duhet t'i themi dikasterit përkatës që nga ky mall nuk duhet të prodhojmë më, sepse kudo janë krijuar stoqe, prandaj është e domosdoshme që në këto kushte të ndërrojmë drejtimin e prodhimit. Duhet të veprojmë kështu sapo vëmë re këtë situatë e jo të presim gjithmonë fundin e vitit për të ndryshuar drejtimin e prodhimit.

Siç u tha këtu, te ne prodhohen lule plastmase që kërkoheshin shumë nga një vend, i cili tani nuk na i blen më. Mirëpo me këto lule, ngaqë vazhdon prodhimi i tyre, janë mbushur depot plot, pavarësisht se na duhet më apo nuk na duhet ky artikull, sepse drejtuesit e ndërmarrjes e të dikasterit që merren me këtë punë, në mënyrë formale e burokratike e justifikojnë një gjendje të tillë duke thënë: «Nuk mund ta ndërpresim prodhimin e luleve, se na mbeten punëtorët pa punë», ose «Për të bërë ndërrimin e linjës së këtij prodhimi duhen tre-katër muaj kohë, gjatë së cilës s'kemi ku t'i çojmë punëtorët, prandaj s'na mbetet tjetër veçse të vazhdojmë prodhimin e luleve». Por e vërteta është se, po të bëhen punët në rregull, çdo gjë do të ecë përpara dhe as punëtorët nuk do të mbeten pa punë, në rast se do të kooperohet me kohë me ndërmarrje apo me fabrika të tjera.

Ka fabrika, dhe në rastin konkret si kjo e plastmasës te ju, ku nuk është aq e vështirë të ndërrohet procesi i prodhimit. Natyrisht, për këtë duhet njëfarë kohe, por kjo nuk do të thotë se, meqë u dashka kjo kohë, fabrika të vazhdojë të prodhojë gjithë vitin ato që prodhonte më parë e që tani po mbushin raftet, dhe, çka është akoma edhe më keq, të vazhdojë të prodhojë të tilla edhe vitin tjetër. Të veprosh kështu, do të thotë të ecësh kuturu, të mos e shikosh problemin me syrin politik. Pse është vepruar kështu nga shumë drejtues të prodhimit, depot tona janë mbushur, për shembull, plot me bojë vaji, saqë kjo sasi do të mjaftonte për 20 vjet. Kështu krijohen vështirësi të mëdha për ekonominë, se jo vetëm që bllokon kot shumë mjete materiale e monetare, por nuk di ku ta çosh gjithë atë prodhim stok. I thuhet atëherë, për shembull, Kukësit apo Tropojës: merre ti këtë apo atë sasi boje vaji. Jo, nuk e marr, i përgjigjen ata ndërmarrjes përkatëse të tregtisë në qendër, se nuk më duhet. Po duhet ta marrësh, i thotë ajo, dhe, si rezultat i gjithë kësaj «merre — nuk e marr», i jepet Tropojës kaq shumë bojë vaji, sa të lyhet tërë qyteti me të. Prandaj drejtuesit e punonjësit e fabrikës për problemet që kanë të bëjnë me mallrat që prodhojnë, duhet t'ia bëjnë të qartë mendimin e tyre jo vetëm Ministrisë së Industrisë, por edhe asaj të Tregtisë, në mënyrë që të koordinohet mirë puna e të mos ndodhin të tilla raste si me bojën e vajit.

Kur ju të gjithë flitni me kaq hollësi për problemet e rrethit, të cilat i njihni mirë, zor se ju dallon dot njeri se kush është nga Lushnja e kush është nga Korça, apo ndonjë rreth tjetër. Shoqja Lenka është vendöse,

por e kam fjalën për Miti Rrapon<sup>1</sup> dhe për Petrit Nikon<sup>2</sup> që janë bërë si vendës. Kështu ndodh kur punon për shumë kohë në një rreth, se secili nga ju të dy ka më se 10 vjet që shërben këtu.

Lushnja është një rreth me natyrë të bukur, edhe bujqësia me të cilën merret më shumë popullsia e saj është profesion i bukur. Kuadro e specialistë për degë të ndryshme të ekonomisë ka edhe vetë rrethi tani, megjithatë nevojat për ta janë gjithmonë në rritje, prandaj edhe shpërndarja e tyre duhet të bëhet në bazë të kritereve të shëndosha. Çështjen e përgatitjes, shpërndarjes dhe përdorimit të specialistëve, veçanërisht të atyre me arsim të lartë e të mesëm, do ta analizojmë në mbledhjen e Byrosë Politike që do të bëhet muajin e ardhshëm<sup>3</sup>. Tani që do të kthehem në Tiranë, do të studioj për këtë dhe për problemet e tjera që do të analizohen në mbledhje.

Bëra një pyetje për rritjen e derrit. Pse e bëra këtë? Sepse, nga sa di unë, shteti i subvencionon ndërmarrjet bujqësore për prodhimin e mishit të derrit dhe ky subvecionim vazhdon të bëhet që kur mua akoma nuk më ishin zbardhur flokët.

Vajta njëherë te një fshatar këtej nga anët tuaja. Mbjaj mend se djali i tij më dha një mësim të mirë për punën e rritjes së derrave. Në atë kohë ne shtronim me forcë çështjen e mbarështimit të derrave, flitnim

1. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Lushnjës.

2. Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Lushnjës.

3. Shih në këtë vëllim, f. 129.

vazhdimisht për zhvillimin dhe për përhapjen e tyre, por e vërteta është se në praktikë nuk zbatoheshin plotësisht ato që thoshim. Djali i këtij fshatari më tha se edhe ai kishte derra në shtëpinë e tij dhe rritja e tyre i kushtonte atij pesë herë më lirë nga sa i kushtonte ndërmarrjes bujqësore. Sidoqoftë, sivjet kemi besim se do t'i realizoni detyrat dhe jemi të bindur se do t'ju dëgjojmë zërin e mirë.

Kisha edhe diçka: Vëmë re se në disa raste çështja e parimit mbi të cilin mbështetet prona kooperativiste atakohet, se ka kooperativistë që me bagëtitë e tyre dëmtojnë pronën e kooperativës, mirëpo kur dënohen për këtë, ankohen dhe thonë: «Malli ynë është edhe toka e kooperativës, se ajo është pronë e grupit, dhe në qoftë se nuk na lini t'i kullotim këtu bagëtitë, atëherë këta dhen apo dhi që na janë lënë në bazë të statutit, ku t'i kullotim?». Ata flasin kështu sepse në oborrin kooperativist dëshirojnë që të kenë të mbjellë edhe presh, domate, ndonjë pemë, ca misër etj., etj., kështu që s'kanë se ku të shkojnë me bagëtinë. Pra, që të mos ndodhin të tilla fenomene, duhet menduar e planifikuar që ushqimi i bagëtive të rregullohet me anën e foragjereve.

Partia në kooperativë dhe udhëheqja e saj duhet t'i kuptojnë, t'i analizojnë mirë dhe të punojnë për zgjidhjen e drejtë të këtyre problemeve. Me durim dhe këmbëngulje, ashtu siç na porosit Partia, t'i bëhet e qartë çdo kooperativisti se ai punon dhe prodhon për vete. Gjithashtu, të punohet në mënyrë intensive në kooperativë, si për bimët e tjera, edhe për foragjeret, e mbi këtë bazë të ekonomizohet një copë tokë për bagëtitë e oborreve të kooperativistëve, sepse kjo në fakt është

përsëri e kooperativës. Prandaj çështja duhet parë në këtë mënyrë: të tërë ne që jemi, për shembull, në kooperativë kemi bagëti dhe kështu shtrohet që të kemi të gjithë kush lopën e kush dhentë. Mirëpo toka ku e kullos bagëtinë është e kooperativës dhe me të drejtë për këtë më dënojnë, se dëmtoj pronën e të gjithëve. Po ku t'i kullos atëherë këto bagëti? — pyet fshatari. Prandaj thashë më lart që udhëheqja në kooperativë duhet t'i zgjidhë me kujdes detyra të tilla, se kanë rëndësi.

Për ata që dëmtojnë pronën vihen edhe dënime; mbi këtë bazë shkaktohen edhe pakënaqësi të kooperativistët. Partia nuk është për këtë rrugë, prandaj vazhdimisht porosit që të jemi të matur, të kujdesshëm dhe të punojmë për zgjidhjen e problemeve, që puna të mos çalojë në këtë apo në atë drejtim. Në radhë të parë duhet të jenë korrektë vetë drejtuesit në kooperativë, sepse ai që i jep dënimin një kooperativisti për dëmin që ka bërë me bagëtitë, duhet të mos jetë përlyer asnjëherë vetë me të tilla gjëra, ndryshe linden mosbesimi, pakënaqësia, komprometimi, grindja etj. Është e vërtetë që këto gjëra ekzistojnë, por detyra jonë është të luftojmë që t'i zhdukim dhe çdo nevojë për kooperativistët ta plotësojmë në rrugën që na mëson Partia, që gjithmonë të ketë një atmosferë të gëzuar e revolucionare në fshatin tonë kooperativist.

Lidhur me ndihmën që duhet t'ju jepet, mendoj që, kur bëni mbledhjet e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, kërkoni t'ju vijë shokë të dikastereve, të marrin pjesë në analizat që bëni këtu si rreth, sepse kjo ndihmon në zgjidhjen e shpejtë dhe në kohë të problemeve që ju dalin. Edhe shokë të Kryemi-

nistrisë mund të vijnë në seksionet e komitetit, si në atë të bujqësisë, të financës e në të tjerat, që ta kenë dhe ata gjendjen, si të thuash, në pëllëmbë të dorës.

U kënaqëm shumë nga biseda që bëmë së bashku. Tani do të më falni se duhet të shkojmë. Ju urojmë, shokë, suksese në punë për realizimin e gjithë këtyre detyrave të rëndësishme që na ka ngarkuar Partia. Mbetshi me shëndet! Mirupafshim!

*Botuar për herë të parë,  
me ndonjë shkurtim, në  
librin: Enver Hoxha, "Ra-  
porte e fjalime 1975-1977",  
f. 275*

*Botohet sipas shënimeve të  
mbajtura në këtë takim, që  
gjenden në AQP*

# PËRGATITJA E KUADROVE KA NJË RËNDESI TË JASHTËZAKONSHME PËR ZHVILLIMIN E VENDIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

6 prill 1977

Jam dakord me diskutimet e shokëve, të cilat janë shumë më reale nga sa na paraqitet gjendja në këtë raport. Unë shikoj se preokupacioni i tyre është më tepër jo për mungesën e orientimeve për shkollat, por për kualifikimin dhe për shpërndarjen si duhet të kuadrove. Më duket se ky është një preokupacion i drejtë. Siç na thuhet, për përgatitjen e raportit që po shqyrtojmë janë bërë studime të shumanshme, ku ka marrë pjesë një numër i madh kuadrosh drejtues të sektorëve të ndryshëm, që kanë lidhje me edukimin dhe me shpërndarjen e kuadrove. Pra, supozohet që raporti është një dokument konkluziv dhe se çdo konkluzion që jepet është i bazuar në të dhëna konkrete. Shoku Simon Ste-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për përgatitjen, shpërndarjen dhe përdorimin e kuadrove.

fani mori si shembull gjendjen konkrete të këtij problemi në një sërë ndërmarrjesh të kryeqytetit. Kur evidencohet gjendja, atëherë të vijnë edhe mendime për të gjykuar nëse e kemi pasur orientimin të drejtë apo jo, e kemi bërë mirë shpërndarjen e kuadrove apo jo, kemi apo nuk kemi kuadro dhe nëse nuk kemi sa duhet të përgatitim akoma etj. Këtyre të dhënave konkrete këtu, në Byronë Politike, natyrisht, ne as që mund t'u hyjmë një për një, por duhet të marrim vendime të karakterit të përgjithshëm, të cilat t'u korrespondojnë konkluzioneve e të dhënave, dhe t'i hapim rrugë realizimit të vendimeve që kemi marrë ose që do të marrim.

Që të përcaktohet drejt në baza sa më shkencore përgatitja e kuadrit, si sasi dhe si specialitet, njerëzit që kanë punuar për këtë çështje më parë duhet të bëjnë rregullimet e mundshme, shumë të nevojshme dhe urgjente për rishpërndarjen e kuadrove në çdo ndërmarrje. Ata, para së gjithash, të njohin mirë gjendjen dhe nevojat për kuadro. Pa e ditur dhe pa e bërë këtë, nuk mund të ecet.

Mendoj që, më parë se t'u kalonte komisioneve, kjo punë duhej kryer nga çdo ministri në bazë të një kriteri shumë rigoroz. Këtu u tha se dikasteret nuk interesohen sa duhet për çështjen që ngremë. Ky është një gabim, për arsye se përgatitja e kuadrove ka një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e vendit dhe dikasteret duhet ta dinë mirë këtë. Por, sipas konstatimeve dhe diskutimeve që u bënë, del se ato nuk e njohin mirë situatën.

Përgatitja e kuadrove kërkohet të bëhet me kriteretë të shëndosha studimi dhe jo me një mendjelehtësi të



palejueshme. Pasi ta bëjmë këtë studim, atëherë mund të caktojmë drejt sa kuadro me arsim të lartë ose të mesëm na duhen, në çfarë dege dhe në sa vjet lypset t'i përgatitim, duke pasur parasysh edhe skartimet, mungesën e zotësisë të disave, daljen në pension e të tjera arsye.

Duhet parë po ashtu çështja e shpenzimeve për përgatitjen e kuadrit. Kjo, përveç arsimit të përgjithshëm, nuk është mbajtur kurdoherë parasysh në të gjitha kategoritë e shkollave. Shpenzimet për përgatitjen e kuadrove ne i bëjmë, i ndjekim deri në njëfarë shkalle, por, kur këta mbarojnë shkollat, konstatojmë çrregullime të dënueshme, mbasi shumë prej tyre ndërrojnë profil si pa gjë të keq. Kjo na ndodh sepse çështja nuk ka qenë studiuar mirë, kështu që shumë arkitektë, për shembull, bëhen inxhinierë ndërtimi, në një kohë kur qahemi se na mungojnë arkitektët dhe nuk ka kush na i bën projektet që i kemi të shumta.

Ne përgatitim mekanikë dhe të tjerë kuadro me arsim të mesëm të këtij karakteri, por nuk mbajmë parasysh si duhet nevojat, prandaj, kur ata mbarojnë shkollat, nuk dimë ç't'i bëjmë dhe ka raste që i dërgojmë në fshat për të punuar me kazmë. Një përgatitje e tillë pa kriter e kuadrove nuk merr parasysh as nevojat e ekonomisë, as shpenzimet, as vendet ku do të çohen ata. Ne do të vazhdojmë të përgatitim kuadro me arsim të lartë dhe të mesëm, por aq sa i duhen çdo sektori dhe jo më shumë.

Zhvillimi i ekonomisë kërkon kualifikimin dhe perfeksionimin e vazhdueshëm të kuadrove me arsim të lartë e të mesëm. E kam fjalën këtu për specializimin

pasuniversitar, që ka filluar, por nuk bëhet me atë ritëm dhe me atë kualitet që kërkohet. Ne lypset të krijojmë mundësinë që të gjithë kuadrot t'i rritin, t'i perfeksionojnë dijet në punë dhe në jetë. Në këtë drejtim duhet të bëjmë një punë të vazhdueshme politike, pse kjo nuk kuptohet mirë nga të gjithë kuadrot. Disa mendojnë se kanë marrë arsim e kulturë për t'u bërë «funksionarë» dhe këtë ide e shfaqin në forma të ndryshme.

Problemi vihet që, me të gjitha format të përgatitimit kuadro, por të caktojmë edhe rrugët se ku do t'i shpiem këta. Vende për të punuar ka kudo, por, së pari, duhen luftuar paragjykimet e njerëzve dhe secili kuadër të shkojë atje ku është puna, e cila e kërkon atë të mësuar, të kulturuar dhe të kualifikuar. Po e shtjelloj pak këtë ide. Në qoftë se një kuadër atje ku është caktuar kualifikohet jo që të ngrihet medoemos në një gradë më të lartë, por me qëllim që të nxjerrë një punë me cilësi gjithnjë e më të mirë, kjo do të thotë se jemi në rrugë të drejtë dhe ky njeri duhet të vazhdojë të kualifikohet. Kjo është një çështje politike, që s'duhet ngatërruar me mentalitetet.

Të marrim çështjen e pagës. Kuadri te ne shpërblehet sipas vendit ku punon dhe ngrihet në qoftë se ka zotësi e në qoftë se disponohen vende, pse në një vend të caktuar nuk mund të vihen dy veta. Në qoftë se kuptohet kështu çështja e marrjes së arsimit të lartë ose të mesëm, puna do të na ecë mirë, por, në qoftë se çështja e mësimit do të shikohet për të fituar një gradë ose për të zënë një post të caktuar, baras me një kuadër që ka mbaruar shkollën me shkëputje nga puna, atëherë do të na dalin pengesa. Thuhet se ai që mbaron uni-

versitetin pa shkëputje nga puna ka praktikën, por këtë praktikë do ta fitojë edhe ai që mbaron shkollën e lartë me shkëputje. Ky bazën e diturive shkencore e ka më të plotë, më të zgjeruar, pra ekziston një diferencë.

Çështjes së studimit dhe të kualifikimit, në përgjithësi, ne nuk duhet t'i vëmë kufizime, por të përcaktojmë drejt sa kuadro i duhen shtetit të përgatitë për një sërë punësh kryesore, të tjerët pastaj të mësojnë me shpenzimet e tyre, por duke u dhënë edhe ndihmë nga shteti, pse e lyp nevoja që çdo njeri ta kryejë punën siç duhet, në mënyrë të kulturuar, prandaj e ka për detyrë të ngrejë nivelin e dijeve.

Ka shumë probleme për këtë çështje, të cilat duhen shikuar. Këto që them, mund të jenë të drejta, por mund t'u bëhen edhe ndryshime. Sidoqoftë, çështjet kërkojnë të studiohen, më duket mua. Kështu, duhet parë, siç u propozua këtu, nëse është vallë i mjaftueshëm seleksionimi që bëjmë aktualisht, duke u nisur nga notat, apo do të na duhet të vendosim konkurse për pranimin e studentëve në shkollat e larta. Mendimi im është se forma që kemi aktualisht për pranimin e studentëve në universitet është, në përgjithësi, e drejtë, më e gjithanshme, dhe në kushtet e sotme, kur ka akoma diferenca të ndjeshme në nivelin arsimor të nxënësve që ndjekin shkollat e mesme të rretheve të ndryshme, konkursi nuk do të favorizonte të rinjtë e disa zonave, ku shkollat, jo për faj të tyre, janë më të dobëta.

Në kuadrin e problemit që diskutojmë lypset të studiohet edhe çështja e përgatitjes së mësuesve me shkollë të lartë. Ne tash kemi mundësi të nxjerrim më

shumë prej tyre dhe të perfeksionojmë ata që janë me shkollë pedagogjike, prandaj propozoj që gradualisht ta zvogëlojmë numrin e mësuesve që janë vetëm me shkollë të mesme pedagogjike. Në të ardhmen, mendoj unë, të rritet numri i mësuesve me shkollë të lartë në shkollat 8-vjeçare. Kjo, më duket, është një çështje që duhet të studiohet, të studiohen shifrat, të studiohen edhe përgatitja e mësuesve, koha dhe shpenzimet për këtë qëllim. Për sa u përket orientimeve të shkollave, ato janë të caktuara. Si në çdo sektor tjetër edhe këtu vihet çështja e perfeksionimit të punës.

Një çështje preokupuese për ne është edhe ajo e nxënësve që mbarojnë 8-vjeçaren dhe që akoma nuk mund të futen në punë, pse, në bazë të ligjit, u duhen edhe dy vjet të tjerë që të rriten, pastaj të punojnë. Por është e papranueshme që të kemi dy tipa shkollash 8-vjeçare, një për qytetin e tjetrën për fshatin. Prandaj të gjejmë forma të përshtatshme për ta zgjidhur çështjen se me çfarë do të merren të rinjtë e moshës 14 dhe 15-vjeçare në qytete, me qëllim që të luftojmë prirjen e rrugaçërisë të disa prej tyre. Ata që janë të paaftë për të vazhduar shkollën e mesme ose të tjerë që kanë arsye ekonomike, siç është rasti kur në familje janë shumë fëmijë, duhet të organizohen në shkolla apo në kurse 1-2-vjeçare, ose të pranohen si nxënës në ekonomi. Sigurisht, këtu kërkohet të shikohet edhe ana ekonomike e vendeve të punës, e mësimi dhe e kostos.

Siç theksova më lart, është për t'u kritikuar tendenca e përdorimit joracional dhe jo të drejtë të disa kategorive kuadrosh, për të cilën diskutuan edhe shkollat. Është e vërtetë se Komisioni i Planit të Shtetit,

ku ka punuar armiku Abdyl Këllezi, nuk e ka shikuar drejt këtë problem, por fajin nuk duhet t'ia ngarkojmë vetëm Komisionit të Planit të Shtetit. Këtu përgjegjësi kanë edhe ministritë, edhe Partia, sepse kjo e bën politikën e kuadrit dhe nuk duhet ta lejonte një gjendje të tillë. Përgjegjësi, pra, kemi të tërë në këtë çështje dhe jo të lajmë duart. Prandaj, kur kërkohen dhe kur përgatiten kuadro, Partia të jetë shumë vigjilente në këtë çështje. Ajo jo vetëm të shqyrtojë propozimet dhe të vendosë për to, por të ndjekë edhe përgatitjen e kuadrove, të studiojë nevojat për ta dhe të japë orientimet se si duhet të bëhet kjo punë. Deri tani kuadrot nuk janë shpërndarë në mënyrë racionale, bile ata janë përgatitur edhe pa kritere, jo për arsye të sistemit, por se këto nevoja janë plotësuar pa studime, në mënyrë të shkëputur, duke dhënë herë-herë disa urdhra, herë duke u bazuar në disa shifra të pjesshme etj. Nga që është vepruar kështu, disa dalin me mendimin që duhen përgatitur më shumë inxhinierë ndërtimi e të mbyllim degën e arkitekturës; ka nga ata që mendojnë se duhet të mbyllet dega e rrymave të dobëta, për arsye se kemi shumë kuadro të këtij sektori, një tjetër hedh mendimin të mos mbyllet, pse, sipas tij, nuk kemi kuadro; bëhen propozime që të përgatitim më shumë njerëz për degën e fizikës, si shkencë me perspektivë, të tjerë thonë se nuk kemi ku t'i vëmë edhe ata që kanë mbaruar. Në të gjitha këto ka edhe çështje objektive, por fakt është se për kuadrot dhe për nevojat që kanë sektorët për ta nuk është menduar dhe vazhdohet të mos mendohet akoma me seriozitetin e duhur. Prandaj këtë çështje duhet ta zgjidhim.

Kam mendimin se, po të bëhet një studim i kujdesshëm për të parë si janë shpërndarë kuadrot, ku punojnë, për çfarë kanë mësuar dhe për çfarë janë ngarkuar, do të shohim se kemi një kontingjent të mirë, me të cilin mund t'i plotësojmë shumë më mirë nevojat e sektorëve të ndryshëm dhe atëherë do të jemi më mirë në gjendje të gjujkojmë se në ç'drejtim e për ç'sektor do të na duhet të forcojmë përgatitjen e kuadrove dhe në cilin pesëvjeçar etj.

Në përgjithësi materiali që na është paraqitur jep disa orientime për të vendosur, por mua më duket se një problem i tillë duhet të studiohet më mirë dhe mendoj se nuk është aq e ngutshme sa të vendosim që në këtë mbledhje. Unë nuk kam ndonjë propozim konkret, edhe shokët, gjithashtu, nuk dolën me orientime e me propozime që të bëjmë këtë apo atë, për arsye se problemi duhet studiuar më thellë, pavarësisht se të gjithë u përpoqën që të ngriheshin mbi nivelin e materialit mbi të cilin u diskutua, e të merrej shkas prej tij për të dalë në disa vendime. E mira është që të rikthehet ky material, me qëllim që të studiohet akoma më thellë problemi, të merren njohuri më të sakta, duke u mbështetur në dokumente më konkrete për çdo përcaktim, dhe të jepen për Byronë Politike orientime konkluzive si dhe projekti mbi të cilin të mund të gjujkojmë dhe të vendosim. Por jo të futemi ne në hollësira, pse po të hyjmë në hollësira, nuk kemi si dalim, mbasi këtu, në Byronë Politike, nuk jemi në gjendje të dimë me saktësi gjendjen e kuadrove, ngritjen cilësore të tyre, orientimet që ata kanë marrë në praktikë, nevojat e çdo di-

kasteri e të çdo ndërmarrjeje, pse është bërë një politikë jo e drejtë e shpërndarjes së kuadrit etj.

Si konkluzion, edhe një herë them se këto çështje që u ngritën këtu, në Byro, të studiohen nga shokët. Edhe në raport thuhet që të shikohen ku janë kuadrot, orientimet, shpërndarja dhe rishpërndarja e tyre. Ne duhet të kemi parasysh edhe anën shoqërore në shpërndarjen e kuadrove, se automatikisht nuk mund t'u themi përnjëherë mijëra njerëzve të marrin lekat në krahë dhe, oburra, të ikin andej e këtej, kur konstatojmë se rrethet, siç u tha këtu, megjithëse i kanë direktivat, tregojnë ngathtësi në sistemimin e kuadrove të transferuar. Kjo çështje është më parë politike, pastaj teknike. Nuk është e rregullt që t'i vejë rrethit një kuadër i qarkulluar, për të cilin ai me siguri ka nevojë, e megjithatë të mos e përfillë. Prandaj duhet kujdes. Këtë studim ta bëjmë pa u ngutur, por të mos e zgjatim dhe shumë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Rapporte e fjalime 1976-1977», f. 292*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për Partinë» (Përmbledhje veprash), vëll. 3, f. 356.*

# REZULTATET E PUNËS EDUKATIVE TË ORGANIZATËS SË BASHKIMEVE PROFESIONALE T'I SHOHIM NË PRAKTIKË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

6 prill 1977

Partia duhet të preokupohet për organizatat e bashkimeve profesionale, se ato çojnë vijën e Partisë në masat punonjëse, në klasën punëtore, në nëpunësit, në inteligjencien dhe i mobilizojnë ato të kryejnë si duhet detyrat që i ngarkohen gjithsecilit. Për këtë arsye Partia duhet të jetë në krye të punës për t'u dhënë ndihmën e duhur bashkimeve profesionale. Unë nuk them se Partia s'e ka dhënë këtë ndihmë dhe se bashkimet profesionale nuk i kanë zbatuar detyrat e ngarkuara, por ndihma që Partia u jep atyre kërkohet të jetë më e kualifikuar dhe e specializuar. Përveç orientimeve të forumeve të Partisë, dhe duhet thënë se këto orientime jepen në përgjithësi, vetëm sa komunikohen dhe nuk

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për disa probleme që dalin në fushën e edukimit të klasës punëtore, si dhe rreth tezave të raportit të Kongresit të 8-të të BPSH.



bëhet thellim në to, edhe organizatat-bazë të Partisë duhet t'i udhëheqin më mirë organizatat e bashkimeve profesionale. Kjo realizohet, përveç të tjerave, edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të komunistëve në veprimtarinë dhe në mbledhjet e këtyre organizatave, gjë që ka rëndësi. Po të mos veprohet kështu, ato do të fishken. Kur flasim për kryerjen e detyrave nga ana e bashkimeve profesionale, në radhë të parë, këto detyra duhet t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë drejt komunistët. Këta e kanë për detyrë që për të gjitha problemet të jenë në pararojë për të mobilizuar dhe për të qartësuar punëtorët e nëpunësit kudo ku punojnë. Kështu duhet kuptuar edhe termi levë e Partisë. Kjo nuk është një frazë. Çdo komunist duhet të jetë në pararojë, dhe unë, ti, secili komunist, si anëtarë të bashkimeve profesionale, me të dalë nga mbledhja, duhet të vihem në ballë të luftës.

Bashkimet profesionale kanë bërë një punë të mirë për edukimin e punonjësve dhe në këtë drejtim kemi suksese. Ato e kanë kryer në njëfarë shkalle të kënaqshme detyrën që u është ngarkuar. Por të meta ende ekzistojnë; këto u vunë mirë në dukje dhe përsëri mund të evidencohen edhe të tjera. Natyrisht, ne kërkojmë dhe duhet të kërkojmë më shumë nga organizatat e Partisë, nga komunistët dhe nga bashkimet profesionale. Është e nevojshme të kërkojmë më shumë për zbatimin drejt dhe në mënyrë të përpiktë të orientimeve politike, ideologjike, ekonomike, organizative, ushtarake që jep Partia, e cila vetë duhet të shkundet nga rutina, nga burokratizmi dhe nga një punë shkel e shko.

Për edukimin e punonjësve janë caktuar forma që

i shërbejnë organizimit të punës nga ana e Partisë për organizatat e masave dhe veçanërisht për bashkimet profesionale. Këto forma organizimi dhe edukimi përfshijnë gjithë punonjësit, komunistët dhe kuadrot, prandaj dobësitë që vihen re rrjedhin pikërisht nga kuptimi i cekët i problemeve, nga shpjegimi i përciptë i direktivave si dhe nga organizimi i dobët i punës për t'i kryer këto detyra. Prandaj mendoj se këtu duhet thelluar shumë kjo çështje.

Në raportin që na ka paraqitur Presidiumi i Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, u bëhet analizë si anëve pozitive, ashtu edhe të metave të punës së organizatave të bashkimeve profesionale, por të metat theksohen më tepër. Këtë nuk e konsideroj normale, për arsye se, në përgjithësi, në raportet që na paraqiten, nuk duhet të na vijnë vetëm anët e zeza të problemit, por edhe sukseset. Dhe bashkimet profesionale, siç e theksova më lart, kanë pasur suksese në edukimin, në ngritjen ideologjike, në forcimin e moralit komunist të punonjësve etj.

Por, krahas sukseseve, ka edhe të meta, për të cilat duhet të jemi të ndërgjegjshëm se përgjegjësia bie në udhëheqjet e organizatave të bashkimeve profesionale, që nga kreu e deri në fund. Mendoj se shokët e zgjedhur në këto forume nuk janë pa eksperiencë dhe pa aftësi. Ata i njohin mirë problemet dhe u janë futur këtyre, vetëm se kanë vendosur disa forma pune burokratike, të cilat nuk i lejojnë të zhvillojnë kapacitetin e tyre dhe të zënë rrënjë në punën që bëjnë për sqarimin e masës në përgjithësi me direktivat e Partisë, pastaj edhe në forma të tjera të përshtatshme për të

udhëzuar dhe për të sqaruar grupe të veçanta për probleme specifike, pa lënë mënjanë, më në fund, edhe agjitacionin individual me njerëzit, i cili nuk bëhet sa duhet dhe si duhet. Në gjithë këtë veprimtari ka formalizëm, burokratizëm, rutinë dhe indiferentizëm.

Indiferentizmi është shumë i rrezikshëm. Kjo do të thotë që direktivat e shtruar në mbledhjet e përgjithshme të organizatës së bashkimeve profesionale nuk bëjnë efektin e duhur dhe, kur mbaron mbledhja, në përgjithësi, dilet me mendimin sikur nuk është thënë gjë, sikur nuk është bërë gjë, kurse në praktikë, në jetë, bëhen gabime që dëmtojnë interesin e përgjithshëm, interesat e planit, moralin proletar etj. Në këtë drejtim nuk shihet një reagim i fortë, i shëndoshë e revolucionar për t'i luftuar këto shfaqje negative atje ku ngrenë krye, në format e në mënyrat si shfaqen dhe për të sqaruar elementët që veprojnë në këtë rrugë të gabuar.

Njerëzit punojnë dhe, në jetë, gjatë punës për zbatimin e detyrave që u janë caktuar, mbajnë qëndrime të drejta ose të gabuara. Bashkimet profesionale, për të gjykuar me sy kritik veprimtarinë e çdo punonjësi, duhet të njohin anët e mira dhe anët negative të tij. Të parat t'i bëjnë shembull, kurse ata që nuk punojnë dhe nuk veprojnë mirë, si dhe anët e dobëta të jetës së tyre, t'i kritikojnë dhe të shërbejnë edhe këto si shembull për të mësuar e për të përfituar të gjithë.

Kurdoherë Partia ka theksuar nevojën e kuptimit drejt të interesit të përgjithshëm, që ai të vihet mbi gjithçka, kurse interesi vetjak t'i nënshtrohet të përgjithshmit. Në këtë drejtim nuk mund të themi se nuk ka përparime, por është me të vërtetë shqetësues fakti,

kur shikojmë, për shembull, që në vitin 1976 janë vërtetuar shumë raste deficitesh dhe suficitesh, ose humbje të konsiderueshme të ditëve të punës. Këto tregojnë se bëhet një punë e dobët me masat punonjëse, se ka elementë që po deklasohen, që dëmtojnë e shpërdorjnë pasurinë e përgjithshme të popullit, që shkelin disiplinën shtetërore në punë, që nuk e konsiderojnë akoma punën si një detyrë të dorës së parë, si një faktor të rëndësishëm që shërben për mirëqenien e tyre, për forcimin e atdheut tonë socialist, por edhe për edukimin e vetes së tyre. Të tillë njerëz, si pa të keq, mungojnë në punë dhe dëmtojnë prodhimin.

Dy çështje duhet të na tërheqin vëmendjen këtu: ose për planin përdoret një fuqi punëtore e tepërt dhe orët e humbura nuk ndikojnë negativisht në realizimin e tij, ose mungojnë shumë punëtorë dhe kështu plani nuk realizohet ose punohet shkel e shko.

Të gjitha organet e Partisë, të shtetit dhe organizatat e masave është e domosdoshme të thellohen si duhet në problemet që u dalin përpara dhe jo të nxitohen në caktimin e detyrave në mënyrë të sipërfaqshme, të cekët, sepse kështu nuk i edukojnë mirë punonjësit. Të udhëhiqemi nga parimi që mbledhjet të mos jenë as të shumta, as të gjata, por ato të jenë sa më efektive. Kemi ne mundësi t'i bëjmë mbledhjet të tilla? Po, kemi, prandaj duhen ndërruar stili e metoda e punës dhe shembullin në këtë drejtim duhet ta japë Partia që ta ndjekin edhe levat e saj.

Organizatat e masave kanë detyrë të interesohen shumë për prodhimin, në mënyrë që të realizohet plani në të gjithë zërat, siç porosit Partia. Mirëpo në këtë

drejtim shohim të meta serioze, të cilat rëndojnë në kurrizin e punëtorëve. Në fakt janë vetë një numër punëtorësh dhe punonjësish që i shkaktojnë këto çrregullime e deficite. Prandaj, në qoftë se nuk bëhet i qartë ky dëm, veprime dhe mosrealizime të tilla do të vazhdojnë në kurriz të ekonomisë dhe të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Është e domosdoshme që bashkimet profesionale të interesohen për edukimin e gjithanshëm të punonjësve. Mua më çudit fakti që akoma një numër i konsiderueshëm punëtorësh punojnë në procese pune me kategori më të larta se kategoria vetjake. Ne kemi marrë vendime për këtë çështje, kemi caktuar edhe afate, brenda të cilave duhet të kishte marrë fund një situatë e tillë, por më duket se në këtë drejtim po ecet pa një shqetësim të dukshëm, si nga ana e Partisë ashtu edhe nga ana e bashkimeve profesionale.

Rezultatet e punës edukative të organizatës së bashkimeve profesionale t'i shohim në praktikë, në jetë. Mirëpo jeta na tregon se disa njerëz në punë shfaqin të meta të theksuara, prandaj kërkohet që të vendoset një disiplinë e ndërgjegjshme proletare në punonjësit. Në këtë drejtim ka lëshime të dënueshme, por ta kemi të qartë se këto shkaktojnë jo vetëm humbje materiale, po prishin edhe ndërgjegjen e njerëzve. Punonjësit tanë duhet të kuptojnë se të jesh i disiplinuar do të thotë të luftosh me konsekuencë për çështjen tonë, për çështjen e socializmit. Ata ta kenë të qartë se interesi i përgjithshëm e kërkon që në të gjitha punët të veprojnë me një disiplinë të fortë e të ndërgjegjshme dhe të mos bëjnë lëshime; të kuptojnë gjithashtu se jeta e tyre duhet të

jetë plot përpjekje e heroizma të mëdha dhe, në fakt, njerëzit tanë kurdoherë kanë bërë të tilla. Por, në qoftë se nuk vazhdohet të punohet me heroizma, në qoftë se nuk vazhdohet të kuptohet se duhen bërë sakrifica për realizimin e detyrave që na caktohen, për realizimin e planeve që kanë një synim të madh — ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, atëherë nuk do të kemi sukseset që presim. Prandaj bashkimet profesionale, me Partinë në krye, të luftojnë kundër mentalitetit të atyre që orvaten të punojnë sipas qejfit dhe jo sipas rregullave e normave që ka caktuar Partia dhe që janë në fuqi në shoqërinë tonë socialiste.

Sot kërkohet të punohet më seriozisht për ngritjen e ndërgjegjes së punonjësve tanë. Kjo nuk mund të arrihet vetëm me leksione filozofike. Edhe këto janë të domosdoshme të bëhen, por ndërgjegjja duhet të shfaqet në punë, prandaj në punë e sipër të shikohet nëse e kanë bërë efektin e tyre leksionet teoriko-politike dhe a kryhen nga çdo punonjës detyrat personale e shoqërore me një ndërgjegje të atillë që kërkon ndërtimi i socializmit. Po të shikohen çështjet kështu me një vigjilencë revolucionare të vazhdueshme nga ana e organizatave të bashkimeve profesionale, po të shikohet interesi i përgjithshëm, në radhë të parë e nga gjithsecili, dhe në bllok të luftohen shfaqjet e dëmshme mikroborgjeze, të jemi të bindur se, duke i vënë përpara kritikës së rreptë ata që spekulojnë dhe thyejnë normat e disiplinën në punë, që kanë frikë nga puna, por që përpiqen të marrin sa më shumë nga shoqëria, do t'u jepet një mësim i mirë dhe ndërgjegjja e tyre do të shënojë hapa përpara. Nga ana tjetër, edhe shembulli i atyre

që i kryejnë detyrat, që bëjnë sakrifica për interesin e përgjithshëm të socializmit e mbrojtjen e atdheut, i atyre që janë këmbëngulës për mbrojtjen e lekut të popullit, për prodhimin e mallrave me cilësi të mirë dhe në kohën e duhur, për uljen e kostos, me një fjalë i të gjithë atyre që kuptojnë se vetëm duke realizuar me ndërgjegje dhe plotësisht detyrat përmirësohet jeta e tyre dhe konsolidohen fitoret e socializmit, duhet të bëhet i njohur kudo nga bashkimet profesionale. Kjo sepse shembujt e njerëzve të pararojës ndikojnë pozitivisht për edukimin e punonjësve tanë. Prandaj është një detyrë e madhe e bashkimeve profesionale dhe e udhëheqjeve të tyre që këto probleme të mëdha t'i thellojnë dhe të organizojnë punën në një mënyrë të atillë që rezultatet e mira të jenë më të mëdha, më të dukshme nga sa kanë qenë deri tash.

Ndërgjegjja e njerëzve duhet të kalitet në punën e përditshme dhe Partia e bashkimet profesionale të përqendrojnë gjithë veprimtarinë e tyre pikërisht në zhvillimin konkret të aktivitetit të njerëzve në punë e në shoqëri. Këndej e vetëm këndej mund të nxjerrim konkluzione më të shëndosha të një pune edukative dhe të efektshme, të një organizimi më të mirë dhe më të përsosur të punës. Këndej mund të nxjerrim edhe leksionet më të përshtatshme dhe me efekt, që do të shërbejnë për edukimin e njerëzve. Partia na mëson që teorinë ta lidhim ngushtë me praktikën dhe që nga praktika e punës, nga qëndrimet e sjelljet e njerëzve dhe nga rezultatet e kësaj pune mund të nxjerrim mësim, që t'i kthejmë në këshilla dhe në orientime për ta çuar punën më përpara.

Pikërisht për këtë arsye bashkimet profesionale nuk duhet të bëjnë një punë të cekët. Me hedhjen e një parulle nga një kolektiv punonjës të mos mendojnë se ka mbaruar gjithë puna e tyre. Jo, parulla më parë kërkohet të jetë e menduar mirë politikisht, ideologjikisht, organizativisht dhe, pasi të jetë formuluar e zbatuar në bazë të këtyre vendimeve, atëherë të shikohen rezultatet.

Këtu shokët diskutuan e dhanë plot mendime. Në dëshirojmë që Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale t'i studiojë të gjitha këto që t'i shërbejnë për hartimin e raportit që do t'i paraqitet Kongresit të ardhshëm të Bashkimeve Profesionale. Unë jam dakord me tezat, vetëm ka rëndësi formulimi i raportit. Të kemi parasysh që ky Kongres përfaqëson një datë të shënuar në lëvizjen e klasës punëtore dhe të punonjësve tanë, prandaj rekomandoj që të përgatitet mirë dhe me seriozitetin më të madh. Të merren masa që të përgatiten mirë edhe delegatët që do të vijnë në Kongres për të diskutuar për problemet e mëdha që shtron ndërtimi i socializmit, për zbatimin sa më mirë të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë, për të zhdukur të metat në punë dhe për të vënë në dukje sukseset dhe anët e mëdha pozitive të punonjësve, të klasës punëtore në radhë të parë dhe të komunistëve, të cilët qëndrojnë në pararojë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 301*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për Bashkimet Profesionale» (Përmbledhje veprash), f. 596*



# IDETË E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT JANË IDE TË RILINDJES E TË KONSOLIDIMIT TË KOMBIT SHQIPTAR

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

6 prill 1977

Jam dakord me relacionin që na është paraqitur dhe me përmbajtjen e tij lidhur me festimin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme historike. Kur themi për ta festuar, duhet të kemi parasysh që para çdo gjëje të përcaktojmë qartë qëllimet dhe objektivat që ka ndjekur e që dëshironte të arrinte Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Kjo çështje ka karakter të rëndësishëm historik, pse është fjala për një ngjarje me rëndësi politike dhe organizativo-ushtarake në historinë e popullit tonë, e cila ka ndodhur 100 vjet përpara, domethënë kur atdheu vazhdonte të ishte nën sundimin e Perandorisë Osmane dhe rrezikohej seriozisht të copëtohej, siç u copëtua.

Si nga ky material, ashtu edhe nga ç'kam lexuar,

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për festimin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

më është krijuar përshtypja se ekzistojnë tendenca të identifikimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me periudhën e Rilindjes. Mua më duket se këto janë dy çështje të veçanta, pavarësisht se lidhen me njëra-tjetrën. Lidhja Shqiptare e Prizrenit është një ngjarje historike, kurse Rilindja është një periudhë, është një epokë e tërë revolucionare demokratike e historisë sonë, e luftërave për liri, pavarësi e unitet kombëtar, e zhvillimit të letërsisë, të arteve, të gjuhës, me një fjalë të etnisë, që na mohohej jo vetëm nga Perandoria Osmane, por edhe nga të gjitha vendet e tjera, veçanërisht nga shtetet e mëdha të Evropës.

Në radhë të parë mendoj që trajtimi i çështjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhet të përbëjë objektin e një studimi marksist-leninist të periudhës dhe të ngjarjeve që përgatitën kushtet për formimin e Lidhjes. Veprimet që u ndërmorën në Prizren, si dhe ana politike, ideologjike, organizative ushtarake e kulturore e Lidhjes duhet të analizohen në frymën marksiste-leniniste. Mendoj që në asnjë mënyrë të mos qëndrojmë në studimet e bëra më parë, pa i analizuar këto, çështjet t'i shtrojmë drejt në kuadrin historik të asaj kohe. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme. Asnjë gjë nuk duhet të na pengojë që ta shpjegojmë drejt historikisht dhe në baza shkencore këtë ngjarje, që, sipas mendimit tim, ka të bëjë jo vetëm me letërsinë, me artet, me kulturën, por kryesisht me luftën për pavarësinë e vendit, me ruajtjen e tërësisë tokësore dhe të unitetit kombëtar, me ekzistencën e popullit shqiptar si komb i lirë, me krijimin e një shteti kombëtar autonom, për të cilët luftohej atëherë.

Tendenca e historiografisë zyrtare jugosllave është që karakterin e vërtetë dhe objektivat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit t'i lërë në mjegull ose të kalojë vetëm në çështjet e Rilindjes. Ne nuk duhet të biem në këtë gabim. Rilindja ka luajtur një rol me rëndësi vendimtare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare, por mbledhja që u bë më 1878 në Prizren nuk është e tërë Rilindja, as kurorëzimi i saj, siç duan të thonë disa. Jo. Lidhja Shqiptare e Prizrenit është pjesë e Rilindjes, një nga kulmet e saj, por në asnjë mënyrë e tërë Rilindja. Për sa i përket luftës për çlirim dhe për pavarësi kundër Perandorisë Osmane, për ruajtjen e unitetit dhe të zakoneve të veta, populli shqiptar ka luftuar edhe përpara Rilindjes, prandaj këtu vihet çështja që këtë ngjarje të madhe ta shohim në dritën e materializmit historik, në kuadrin e ngjarjeve historike, politike, ideologjike, kulturore dhe ushtarake të atyre kohëve, këtu e 100 vjet përpara. Nuk duhet të kuptohet sikur Lidhja Shqiptare e Prizrenit është një ngjarje e lidhur vetëm me popullin shqiptar të Kosovës. Qëllimet dhe lufta e saj ishin çështje jetike për të gjithë Shqipërinë. Kjo mbledhje mund të bëhej edhe në një vend tjetër, fjala vjen në Shkodër, në Durrës apo në Vlorë. Ka arsytet e saj që ajo u bë në Prizren. Prandaj, në analizën që do t'i bëjmë kësaj ngjarjeje, nuk duhet të biem në gabimin që këtë problem ta kufizojmë, ta minimizojmë, siç ka bërë historiografia e huaj dhe jona para Çlirimit.

Ne duhet t'i kundërvihemi historiografisë jugosllave, e cila nuk do ta interpretojë drejt këtë ngjarje të rëndësishme. Kjo është e kuptueshme. Historianët e regjimit titist jugosllav, shovinizmi serb dhe elementët

që i shërbejnë atij aktualisht, as janë në gjendje, as kanë predispozicionin ta trajtojnë këtë ngjarje historike në vërtetësinë e saj dhe në rrugën marksiste-leniniste, mbasi nuk janë marksistë-leninistë. Ata do ta trajtojnë këtë çështje në rrugën që i intereson politikës hegjemoniste jugosllave, domethënë asaj politike shkombëtarizuese që ndiqet ndaj popullsisë shqiptare që jeton në Kosovë dhe në vise të tjera në Jugosllavi. Prandaj do t'i shtrembërojnë qëllimet e vërteta të Lidhjes.

Në materialet që do të përgatiten me këtë rast, mendoj të kihen parasysh ngjarjet dhe periudhat e asaj kohe, idetë, pikëpamjet politike dhe ideologjike, si dhe qëllimet e ruajtjes së tërësisë tokësore e të unifikimit të kombit tonë brenda kufijve të tij etniko-gjeografikë, të krijimit të shtetit kombëtar shqiptar, dhe këto të analizohen në dritën e shkencës marksiste-leniniste.

Mendoj që duhet të mënjanohen «ekzaltimet nacionaliste», se ka nga studiuesit të tilla prirje dhe pikëpamje «demokratike borgjeze» të vjetruara që janë dukur në analizat e kësaj ngjarjeje historike. Për këtë ngjarje ne shkruajmë historinë e vërtetë dhe jo një histori të sofistikuar, të kastisur, si i themi ne në Gjirokastrë, shtrëngo këtu, lësho atje. Në këtë analizë dhe në shtruarjen e vërtetë të problemit nuk duhet të nisemi nga koniunkturat aktuale, por duhet vënë mirë në dukje qëllimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në ato kohë, sepse kjo Lidhje, siç e thashë më parë, është një ngjarje e madhe historike, është rrjedhim i një lufte të gjatë me armë e me përpjekje për autonominë, për tërësinë tokësore, për gjuhën, për traditat e kombit tonë

e të tjera. Kjo ngjarje gjen frymëzim të madh në Rilindjen, në këtë periudhë të lavdishme të historisë patriotike e kulturore të popullit, e cila edhe vetë e ka burimin dhe frymëzimin në luftërat çlirimtare të tij për mbrojtjen e kombit në të gjitha aspektet.

Kurdoherë e kemi përmendur Rilindjen në shkrimet tona dhe e kemi cilësuar me terma të vërtetë, por mendoj se është e nevojshme që kësaj periudhe t'i bëhet një analizë më e thellë historike, filozofike e kulturore, pse është një lëvizje e re luftarake-patriotike, kulturore-artistike, që u zhvillua në gjirin e popullit shqiptar në një periudhë kur luftohej për konkretizimin e aspiratave të tij kombëtare, për shkrimin e gjuhës sonë, për lëvrimin e saj dhe për përhapjen e diturisë e të shkencës së asaj kohe në masat e gjera të popullit.

Nuk jam dakord me mendimin e disa njerëzve tanë të artit e të kulturës, ose edhe të disa studiuesve, që Rilindja jonë fillon me Naum Veqilharxhin ose me veprimtarinë e Naimit e të Samiut. Jo. Natyrisht, duhet të përcaktohet fillimi i periudhës së Rilindjes, por kjo fillimin e vet nuk e ka as te Veqilharxhi, as edhe te Naimi. Naum Veqilharxhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Jani Vretoja, Vaso Pasha e të tjerë patriotë si këta janë një plejadë e tërë njerëzish përparimtarë që kanë luftuar në një periudhë të ndryshme nga ajo para Rilindjes, kur gjuha, letërsia, kultura e popullit tonë ishin në amulli ose vegjetonin në errësirën e madhe mesjetare. Lufta, mendimet, shkrimet e tyre janë pjesë përbërëse e Rilindjes.

Të marrim shembullin e lëvizjes së madhe kulturore dhe artistike që u zhvillua në Evropë në shekullin

e 15-të e të 16-të, që edhe atë e quajnë Rilindje. Kjo lindi në kundërshtim me errësirën mesjetare. Rilindja në Evropë u frymëzua dhe u influencua nga antikiteti greko-romak dhe, natyrisht, nuk mund të mendohet që këtë periudhë e hapi papa Juliusi i 2-të, ose që kjo periudhë fillon me shkrimet e punimet e Makiavelit, të Pietro Bembo, të Ariostos, të Donatelos apo të Mikelanxhelos e të të tjerëve në Itali, me Montenjin në Francë dhe me gjithë një plejadë shkrimtarësh e poetësh të mëdhenj të kësaj periudhe që quhet Rilindje.

Edhe te ne Rilindja është një periudhë e tërë, gjatë së cilës idetë e reja politike, kulturore i kundërviheshin errësirës mesjetare në të cilën ishte mbajtur populli ynë. Prandaj ajo quhet Rilindje, sepse njerëz të shquar të artit, të shkencës, të gjuhës, të filozofisë përparimtare dolën dhe luftuan, ata u përpoqën për zhvillimin e përparimin e popullit tonë dhe kishin për objekt unitetin e kombit shqiptar në një shtet të lirë dhe të pavarur.

Luftërat çlirimtare të popullit tonë kanë një traditë më të lashtë se periudha e Rilindjes. Kështu, edhe përpjekjet politike, ideologjike, organizative, luftarake e diplomatike të shqiptarëve, që u konkretizuan me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, e cila nuk arriti të realizonte qëllimet e saj, ishin një vazhdimësi e luftërave dhe e përpjekjeve çlirimtare të mëparshme. Prandaj idetë, përpjekjet politike, ideologjike dhe diplomatike, si dhe organizimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhet të paraqiten ashtu siç janë, si një lidhje e bashkim i të gjithë shqiptarëve, që rronin e luftonin në atdheun e tyre të pushtuar nga Perandoria Osmane, për unitet

kombëtar, për ruajtjen e tërësisë tokësore dhe për formimin e shtetit autonom shqiptar. Në këtë drejtim ne mund të themi se idetë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit janë ide të Rilindjes e të konsolidimit të kombit shqiptar.

Prandaj mendoj që për këtë problem duhet të punohet seriozisht. Studimi i kësaj çështjeje nuk duhet lënë vetëm në dorën e disa specialistëve e historianëve. Është e domosdoshme që edhe shokët e Komitetit Qendror, me shokun Ramiz në krye, të interesohen veçanërisht për trajtimin e historisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të ideve dhe të pjesëmarrësve, të qëllimeve dhe të objektivave të saj. E theksoj këtë sepse vetëm kështu do të arrijmë në një studim të shëndoshë dhe jo në një studim ku të ketë vetëm rreshtime faktesh, emrash dhe të mos nxirren konkluzione të shëndosha marksiste-leniniste.

Në projektprogramin e festimit të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit vë re se parashikohet të botohen shumë materiale që, natyrisht, duhet t'i përgatitim me kujdes. Të punohet mirë dhe seriozisht për tërë këto që parashikohen në projektprogram, që të mos dalim me punime të çala. Që të realizohen mirë këto, duhet të formohen komisione që të ndjekin punën. Ndjekja e punës nga çdo komision nuk konsiston vetëm në atë që të shohë nëse u krye kjo detyrë apo nuk u krye. Rëndësi ka, në radhë të parë, të shihet si po kryhet ajo, a po kryhet mirë, në rrugën e Partisë, në frymën e marksizëm-leninizmit? Po të jetë kështu, atëherë mund të themi se detyra është kryer, ndryshe nuk mund të konsiderohet si e tillë.

Të mos harrojmë se popullit shqiptar do t'i japim me këtë rast një dokumentacion historik marksist-leninist për një periudhë luftërash dhe përpjekjesh që çuan në mbledhjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Njëkohësisht ne nuk duhet të mos mendojmë edhe për shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë e të Malit të Zi, të cilët të shikojnë me këtë rast metodën dhe stilin e analizave marksiste-leniniste për të tilla çështje të rëndësishme, por edhe ekzistencën e tyre si komb, si pjesë e kombit shqiptar, të shikojnë luftërat e tyre në unitet me gjithë shqiptarët për një Shqipëri të lirë e të pavarur, kurdoherë në kuadrin e asaj periudhe. Konsideratat aktuale, natyrisht, duhet të kihen parasysh, që të mos biem në kundërshtim me vijën e Partisë. Prandaj të kemi kujdes që ta shkruajmë si duhet historinë e kësaj periudhe. Në qoftë se historiografia jugosllave e trajton ndryshe këtë ngjarje, kjo është puna e saj, në qoftë se ka dhe do të ketë kontradikta me të në trajtimin e këtij problemi, ne kemi për detyrë të mbrojmë të vërtetën historike dhe të demaskojmë çdo shtrembërim e falsifikim të saj.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verball i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*



## KUSH E DO ATDHEUN, DUHET TË MËSOJË EDHE SI TA MBROJË ATË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 prill 1977

Dëshiron ndokush nga shokët t'u bëjë pyetje shokëve ushtarakë që kemi thirrur për këtë çështje në mbledhjen e sotme? Pastaj, shokët e ftuar, mbasi t'u përgjigjen pyetjeve që mund t'u bëhen, në qoftë se dëshirojnë, le të shtojnë ndonjë gjë që e gjykojnë të nevojshme ta thonë.

Kisha një pyetje: Raportet që na keni paraqitur janë kolegjiale, domethënë janë hartuar edhe nga ushtarakë që merren thjesht me specialitetin ushtarak, edhe nga ushtarakë që janë punonjës partie në ushtri, apo vetëm nga këta të fundit?

*Pasi u dhanë përgjigje për pyetjet dhe folën disa shokë të pranishëm në mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:*

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për punën e Partisë në njësi dhe në reparte për forcimin e disiplinës dhe të rregullit ushtarak në luftë kundër shfaqjeve të liberalizmit.

Jam dakord me diskutimin e shokut Hekuran [Isai], i cili, në mënyrë analitike dhe shumë të drejtë, foli për disa të meta që duken akoma në ushtri, veçanërisht në kuadro të saj. Ai dha mendime të drejta se si duhet ta forcojmë situatën atje. Sigurisht që gjendja në ushtri ka ndryshime të mëdha në krahasim me të kaluarën dhe po shkon vazhdimisht duke u forcuar, megjithatë asnjëherë të mos ketë vetëkënaqësi nga sukseset e arritura, shfaqjet negative të kapen menjëherë, të analizohen dhe të dilet kurdoherë me konkluzione e me vendime të drejta për edukimin e atyre që i bartin.

Duke u bazuar në të dhënat që na japin raportet e paraqitura për këtë mbledhje, si dhe diskutimet e shokëve, del se në ushtri, përveç sukseseve që janë të dukshme, ekzistojnë akoma të meta e dobësi. Duke i pasur parasysh këto, organizatat e Partisë ose komisarët duhet ta vënë vazhdimisht dhe rregullisht në korent Komandën e Përgjithshme jo vetëm thjesht për ato që ndodhin nëpër njësi e reparte, por edhe për shkaqet e këtyre ndodhive, ndryshe Komanda nuk do ta njohë dot mirë gjendjen e efektivit. Kjo nuk ngatërron aspak lidhjet e organizatës së Partisë në ushtri me Komitetin Qendror.

Si në shkencat ekzakte, ku kërkohet një disiplinë rigoroze, edhe në ushtri duhet të ekzistojë një disiplinë e tillë. Partia ka theksuar që disiplina në ushtri të jetë e ndërgegjegjshme. Me këtë të kuptojmë që zbatimi i urdhrave dhe i vendimeve të kryhet në interesin e çështjes, në interesin e detyrës së lartë ushtarake që Partia i ka ngarkuar gjithsecilit. Nuk mund të lejohet liberalizëm në çështjet ushtarake.

Që të kuptohet thellë rëndësia e kësaj detyre, para së gjithash, është e domosdoshme të ndihet thellë dashuria për atdheun socialist. Kjo dashuri qëndron mbi të gjitha. Prandaj, po të jetë e kristalizuar si duhet ajo, kryerja e detyrës ushtarake vihet në rendin e ditës nga çdo qytetar, si një nga detyrat kryesore, zbatimi me përpikëri i së cilës mbron atdheun nga rreziqet e mundshme. Lenini porositte që çdo institucion i një vendi socialist të mos pushojë së dhëni ndihmë dhe vend të parë ushtrisë.

Kuadrot tanë dhe gjithë njerëzit që stërviten në ushtri për t'u përgatitur për mbrojtjen e atdheut, duhet të kuptojnë se kryejnë një detyrë të lartë, që është njëkohësisht edhe art e shkencë. Po ta kuptojmë kështu këtë çështje, atëherë të jemi të ndërgjegjshëm se, ashtu si çdo art, edhe ushtria ka një teori, ka edhe një disiplinë në zbatimin e kësaj teorie. Në çdo shkencë ka po kështu një teori, e cila zbatohet me një disiplinë shkencore, por disiplinë shkencore lypin, gjithashtu, edhe arti e shkenca ushtarake. Plus kësaj, që kjo disiplinë të jetë me të vërtetë ashtu siç kërkohet, te njerëzit tanë lypset të ngrihet ndërgjegjja, të cilën e formon vazhdimisht Partia nëpërmjet një edukimi sistematik ideologjik dhe politik. Të mos harrojmë mësimin e Leninit, sipas të cilit ushtria duhet të jetë e rregullt dhe shumë e disiplinuar; ose ne do të formojmë një të tillë ushtri, thoshte ai, ose do të shkatërrohem.

Kur flasim për thyerjen e disiplinës, kjo nuk duhet kuptuar si diçka e thjeshtë, nëse u veshe mirë apo u veshe keq, nëse u largove nga reparti me leje apo ike pa leje. Të gjitha këto gjëra caktohen në rregulloret

ushtarake dhe ato duhet të zbatohen pa lëshime, por, kur flasim për disiplinën ushtarake, me këtë duhet të kuptojmë kryesisht çështjen e edukimit të njerëzve tanë me shkencën dhe me artin ushtarak. Në studimin e në zbatimin e kësaj shkence dhe të këtij arti kërkohet çdo ditë një disiplinë e ndërgjegjshme shkencore. Kjo do të thotë që të hapësh veshët mirë kur shpjegohet mësimi, që këtë mësim ta thellosh e ta zgjerosh dhe pastaj ta zbatosh si duhet në praktikë. Një disiplinë e tillë është e njëlllojtë si për kuadrot, edhe për ushtarët. Edhe kuadrot mësimin duhet ta thellojnë dhe ta japin mirë, po edhe ushtarët duhet të bëjnë shumë përpjekje që ta përvetësojnë dhe, së toku, kuadro dhe ushtarë, ta zbatojnë atë si duhet. Këtu hyn edhe çështja e disiplinës. Të dyja palët duhet të jenë rigorozë, të mos i bëjnë lëshime njëri-tjetrit, por i pari, kuadri, duhet të shpjegojë qartë dhe t'i kërkohen shpjegime suplementare, po të jetë nevoja, kurse i dyti, ushtari, t'i përvetësojë mirë mësimet që i jepen dhe t'i kërkohet, gjithashtu, llogari për kuptimin dhe për zbatimin e tyre me rreptësi, pa lëkundje, pa oportunitizëm.

Këtu nuk hyn fare çështja e prepotencës dhe e arrogancës. Për të zbatuar të gjitha këto që thashë më sipër, kërkohet rigorozitet i madh. Që ushtarët dhe kuadrot t'i kuptojnë mirë ato që mësojnë, të mos lejohet liberalizëm. Çdo shtrëngim, çdo rigorozitet në kërkesa, nuk mund të quhet arrogancë dhe prepotencë, prandaj është e domosdoshme që këto të kuptohen mirë, pse në ushtri sidomos nuk mund të lejohet asnjë lëshim në zbatimin e tyre.

Puna dhe edukimi nga ana e Partisë në ushtri janë

shumë të gjerë, të shumanshëm, të thellë dhe nuk duhen konsideruar si probleme vetëm të mbledhjeve, ku ndonjëherë diskutohen si çikërrima. Në radhë të parë, kuadrot të vihen përpara përgjegjësish, se prej tyre nuk kërkohet një punë burokratike, por të zotërojnë si duhet artin dhe shkencën ushtarake.

Kuadrot ta kuptojnë mirë këtë detyrë dhe ta kenë të qartë se arti dhe shkenca ushtarake nuk përvetësohen në një kohë shumë të shkurtër dhe pa mundime, pa përpjekje e sakrifica. Studimi i cekët nuk të çon në rrugë të drejtë, po në një rrugë formale e pa rezultate. Kështu edhe edukimi i ushtarëve, që këta kuadro kanë nën varësinë e tyre, në kushte të tilla do të jetë një edukim i sipërfaqshëm dhe nga kjo do të rezultojë që, në momentet vendimtare, ushtria jonë, në vend që të jetë e edukuar në nivelin e kërkuar, që ta zotërojë dhe ta zbatojë si duhet artin ushtarak, do të veprojë në mënyrë të përciptë. Po që se kuadrot nuk e kuptojnë drejt këtë çështje, ata dhe shtabet ku bëjnë pjesë nuk do të japin urdhra dhe nuk do të jenë në gjendje të marrin vendime të sakta. Kështu këta urdhra dhe vendime ose do të bien në vesh të shurdhër, pse nuk do të kuptohen, ose do të kuptohen përciptazi dhe njerëzit që do t'i zbatojnë nuk do të jenë të qartë.

Partia na mëson që urdhrat dhe vendimet të zbatohen deri në një, mirëpo në raport flitet edhe për raste kur ato nuk zbatohen si duhet. Moszbatimi i urdhrat, si në rastin e oficerit që u përmend këtu, flet për pikëpamje dhe qëndrime anarkiste, që nuk lejohen te ne dhe ca më tepër në ushtri. Në qoftë se të gjithë urdhrat futen në kallëpin e pikëpamjeve të atij oficeri

që kritikua, atëherë ne nuk do të kemi ushtri siç e kërkon Partia dhe nuk do ta përballojmë dot armikun. Në ushtri nuk lejohet të diskutohet urdhri, siç mund të diskutohet një çështje tjetër me masat e popullit. Ushtria nuk ka «demokraci masash» për sa i përket zbatimit të urdhrit. Ai që e merr urdhrin, duhet ta zbatojë patjetër, por që ky urdhër të jetë me të vërtetë i plotë dhe i zbatueshëm, kjo varet, në radhë të parë, nga kuadrot që e japin dhe që mbajnë përgjegjësi për këtë. Diskutimi i urdhrit bëhet që ky të zbatohet sa më mirë dhe jo që të mos zbatohet. Atij mund t'i bëhet një përmirësim taktik anësor, por jo në të gjitha rastet.

Duhet të kuptojmë mirë se ushtria jonë është një ushtri e popullit, një ushtri e diktaturës së proletariatit, dhe se vetë kjo diktaturë lyp disiplinë të fortë në zbatimin e saj. Shteti ynë zbaton teorinë e marksizëm-leninizmit, që, siç na mëson Marksi, është një teori luftarake. Prandaj, kur flet Partia për mësimin e teorisë në ushtri, nuk duhet kufizuar vetëm në leksionet thjesht teorike pa adresë, por këto leksione t'u shërbejnë njerëzve për t'u thelluar në teorinë dhe në artin ushtarak. Vetëm kështu kanë vlerë mësimi dhe teoria.

Arti dhe shkenca jonë ushtarake janë nga më modernet, pse i kemi ndërtuar në bazë të teorisë marksiste-leniniste, pse strategjinë dhe taktikën e ushtrisë sonë i kemi ndërtuar në përshtatje me qëllimet e larta për mbrojtjen e atdheut, se i kemi bazuar, në radhë të parë, në eksperiencën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare dhe të të gjitha luftërave që ka bërë populli ynë në të kaluarën, duke marrë parasysh edhe strategjinë e taktikat e armikut. Prandaj këto përcaktime të Par-

tisë e këtë eksperiencë ne duhet t'i thellojmë si shkencë dhe ta përdorim këtë jo në mënyrë shabllone, por në mënyrë të përpiktë, domethënë me zgjuarsi dhe me efikasitet, për t'i shkaktuar armikut humbje të mëdha, kurse ne vetë të kemi sa më pak humbje që të jetë e mundur dhe të mos i lëmë asnjë pëllëmbë tokë armikut. Me një fjalë, ta thyejmë armikun në të gjitha përpjekjet e tij, në të gjitha sulmet e tij, të thyejmë epërsinë që mund të ketë ai në armatime dhe në njerëz.

Kjo do të arrihet në qoftë se ne nxjerrim konkluzione nga shkenca dhe përvoja ushtarake e ushtrive të huaja, por, në radhë të parë, ne duhet të mësojmë nga shkenca dhe nga përvoja e ushtrisë sonë. Prandaj, si kuadrot edhe ushtarët, gjatë shërbimeve të tyre, në të gjitha drejtimet, duhet të mos jenë automatë, por të mendojnë për perfeksionimin e mësimëve dhe për zbatimin e tyre sa më mirë në praktikë, domethënë në stërvitje dhe në shërbim.

Armatimet që ne kemi sot në dorë janë moderne dhe përbërjen e përdorimin e tyre në fushën e betejës duhet t'i mësojmë mirë. Njohuritë për to përbëjnë një pjesë të shkencës sonë ushtarake. Po t'i përvetësojnë mirë këto, kuadro dhe ushtarë, atëherë do të dinë t'i përdorin me precizion ato mjete e armatime që kemi dhe do të dinë të përballojnë me to armatimet edhe më moderne që kanë armiqtë.

Prandaj thellimi në teori nuk shtrohet vetëm për të studiuar strategjinë dhe taktikat, po edhe për të studiuar e për t'u perfeksionuar në aparaturat, duke filluar nga pushka më e thjeshtë deri te makina luftarake më e ndërlkuar. Partia duhet t'ua bëjë të qartë

kuadrove dhe ushtarëve se ngritja e nivelit të tyre politik, ideologjik e ushtarak, thellimi i tyre shkencor në këto çështje forcojnë besimin dhe mprehin vigjilencën e vendosmërinë e tyre. Është e ditur se në luftë kërkohet vendosmëri e madhe. Me vendosmëri nuk duhet kuptuar vetëm që të jesh trim, po ta kesh edhe kokën plot, të kesh iniciativë në zbatimin e drejtë të urdhrave, mbasi kjo situatë krijon dhe nxit iniciativën e shëndoshë në zbërthimin dhe në zbatimin e urdhrit apo të direktivës. Kuadrot dhe ushtarët ta kuptojnë se një veprim i tillë është në kundërshtim me metodat e vjetra, pra ai është në kundërshtim me nënshtrimin ndaj teorive dhe praktikave të të huajve, që na kanë pasqyruar mbeturina edhe në fushën e ushtrisë.

Prandaj puna e Partisë, shokë, është mjaft e komplikuar, e lidhur ngushtë me realitetin dhe me të gjitha shërbimet në ushtri, që nga dhënia e mësimit e deri te zbatimi i tij në praktikë. Ajo nuk i duron rutinën dhe cektësinë. Prandaj, në radhë të parë, është e domosdoshme të bëhen të ndërgjegjshëm kuadrot, se disa nga ata kanë prirje liberale në punë, në stërvitje, në sjellje. Partia në ushtri duhet të organizojë një edukim të shëndoshë, pse të jesh liberal do të thotë të heqësh dorë nga lufta e klasave në ushtri, të bësh lëshime në zbatimin e ligjeve dhe të normave që ka vendosur Partia. Një gjë e tillë do të thotë ta lësh ushtrinë të dobët përballë ushtrive mercenare dhe gjakpirëse të kapitalistëve dhe të revizionistëve modernë.

Arroganca dhe prepotenca e elementëve armiq që dënuam, po kështu edhe e disa kuadrove të tjerë që nuk vepronin me ndërgjegje të plotë në rrugën e Partisë,



nuk konsistonte në kërkesën e llogarisë për zbatimin si duhet të planeve e të detyrave ushtarake dhe të direktivave të Partisë për zhvillimin, organizimin e stërvitjen ushtarake. Jo. Arrogancën dhe prepotencën e tyre elementët armiq e zhvillonin për të fshehur pikërisht këtë dobësi, këtë menefregizëm, këtë liberalizëm që tregonin në punë. Ata ishin arrogantë dhe prepotentë, pse donin që njerëzit t'i hidhnin lule injorancës së tyre dhe, me të tilla veprime të dënueshme nga Partia, kërkonin të ruanin pozitën.

Aktualisht, nga i madh e i vogël duhet të kuptohet mirë se kërkesa e llogarisë, për vendosjen e disiplinës së rreptë proletare në mësim dhe në zbatim, është e domosdoshme në ushtri. Ata njerëz që këtë disiplinë dhe këto kërkesa i quajnë arrogancë ose prepotencë, nuk janë në rregull, ata mund të thonë sa të duan se janë me Partinë, mund të thonë se janë për një ushtri moderne, për një ushtri popullore, por, në fakt, duke pasur pikëpamje të tilla në kokë, nuk janë për një ushtri të fortë, por duan ta bëjnë punën në ushtri shkel e shko dhe të largohen prej saj. Njerëzit si këta nuk i konsiderojnë çështjet ushtarake dhe edukimin ushtarak si një nga detyrat më të rëndësishme që na vihet përpara dhe që është e lidhur ngushtë me mbrojtjen e atdheut. Kush e do atdheun, duhet ta mbrojë atë dhe, që ta mbrojë, nuk mjafton vetëm dëshira, por duhet edhe të mësojë se si ta mbrojë. Në momentin më të rrezikshëm atdheu nuk mbrohet duke qenë liberal, duke mos zbatuar urdhrat e drejtë, të menduar e të peshuar mirë, ose duke i diskutuar ata. Prandaj Partia duhet të punojë që të gjithë t'i kuptojnë thellë këta urdhra e rregullore, t'i

futin në zemër, t'i bëjnë pjesë të pandara të ndërgjegjes së tyre dhe t'i zbatojnë me përpikëri të madhe. Nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që urdhrat të shkelen. Në ushtri ne duhet të jemi rigorozë më tepër se në çdo sektor të zhvillimit të vendit tonë, për arsye se ushtria përgatitet për momentet e rrezikshme, kur luhet fati i atdheut.

Një gjë me rëndësi dëshiroj të theksoj më në fund, që Partia në terren duhet të zgjedhë për të dërguar në shkollat ushtarake nxënës nga më të mirët, më besnikët, më të zgjuarit dhe komandat në shkollat ushtarake duhet të punojnë që këta t'i stërvitin dhe t'i edukojnë më së miri. Partia në ushtri t'i ndjekë me kujdesin më të madh kuadrot e rinj, të cilët t'u futen thellë e seriozisht studimeve ushtarake, ushtrimeve, të zbatojnë si duhet shkencën dhe teorinë ushtarake. Duke kuptuar drejt teorinë marksiste-leniniste dhe mësimet e Partisë sonë, mos e harroni këtë gjë, shokë, mos e merrni si një çështje të lehtë rutine, si një çështje burokratike. Kuadrot e vjetër, për aq kohë sa do të punojnë akoma në ushtri, duhet të japin maksimumin e tyre dhe të vazhdojnë të mësojnë që ta japin këtë maksimum në shkallën dhe në lartësinë që kërkon Partia.

*Botuar për herë të parë, me ndonjë shkurtim, në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 311*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

## PROPAGANDËN DHE EDUKIMIN T'I MATIM ME REZULTATET

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 prill 1977

Evidencimi i natyrave të ndryshme të thashethemeve, mërive, zënkave, shpifjeve e rrahjeve, që disa herë shkojnë deri në krime, është një aspekt i punës së Partisë dhe i organizatave të masave në frontin ideologjik. Por nuk mjafton vetëm t'i evidencojmë këto shfaqje, lypset edhe t'i klasifikojmë, të shohim origjinën, natyrën e keqe të tyre, dhe në bazë të kësaj analize të dalim me konkluzione e të organizojmë punën propagandistike dhe edukative.

Për luftën kundër shfaqjeve të tilla është e nevojshme të organizohet propaganda, e cila mund të jetë e përgjithshme, por mund e duhet të jetë edhe e veçantë për një problem të caktuar në një fshat ose në di-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për punën e Partisë lidhur me luftën kundër thashethemeve, grindjeve e mërive dhe shkaqet ideopolitike e shoqërore të tyre.

sa fshatra, në një lagje qyteti, në një fis, në një familje ose në një individ.

Për këto çështje kemi folur vazhdimisht. Me këtë s'dua të them se nuk është nevoja të flasim më. Këto shfaqje janë pasqyrim i luftës së klasave në popull dhe përbëjnë ato kontradikta joantagoniste që ne duhet t'i kuptojmë, t'i zbërthejmë dhe t'i ndreqim, por, që të ndreqen, duan punë, durim, edhe pjekuri.

Në radhë të parë, vetë anëtarët e Partisë çështjen e luftës së klasave duhet ta kuptojnë jo në vija të përgjithshme, por në thelbin, në gjerësinë e në thellësinë e saj, domethënë të kuptojnë dëmin që u sjellin këto shfaqje unitetit të Partisë, socializmit. Në qoftë se ato nuk kuptohen mirë nga vetë komunistët, në radhë të parë, nuk mund të thuhet se do të bëhet një punë e saktë, që nga themeli, për zhdukjen e tyre. Nuk duhet të kemi iluzione se thashethemet, meritë, zënkat do të zhduken shpejt e fare nga gjiri i shoqërisë sonë pa një punë të dendur e të vazhdueshme politike. Ato janë mbeturina të vjetra të mentalitetit të pronës private dhe interesi vetjak ekziston akoma. Kur të gjithë njerëzit e vendit tonë socialist të kuptojnë se interesi i tyre është i lidhur ngushtë me interesin e popullit, atëherë ata do të reflektojnë thellë për veprimet, për aktet, për fjalët e tyre, domethënë do të reflektojnë për marrëdhëniet që duhet të ekzistojnë midis njëri-tjetrit, që këto të jenë dashamirëse.

Duhet ta kuptojmë natyrën e njerëzve. Në punë dhe në jetë jo të gjithë janë gjakftohtë, që t'i gjykojnë kurdoherë drejt çështjet. Partia na mëson të mos ngutemi, por edhe në rast se ngutemi, e kemi për detyrë që më

vonë të reflektojmë thellë e drejt dhe të dalim me autokritikë të shëndoshë. Ata që mbajnë qëndrime të gabuara në jetë dhe në punë, kundër njerit ose tjetrit, po të reflektojnë drejt dhe me zemër të hapët, qoftë para se të veprojnë ose pas veprimit, mund të zhdukim keqkuptimet dhe të rivendosin harmoninë atje ku kjo është prishur.

Shpifjet, zënkat, meritë, që rrjedhin nga mbeturinat mikroborgjeze, nuk shfaqen vetëm te njerëzit meskinë, të pangritur ideologjikisht e politikisht, sepse ka edhe nga ata që, megjithëse janë të ngritur, në punë bëjnë gabime, hatëre, sillen me arrogancë e prepotencë dhe shkaktojnë tek të tjerët pezmatime e pakënaqësi, që elementët më të infektuar me vese i nxitin për të krijuar një situatë të sëmurë. Prandaj nuk duhen nënvleftësuar qëndrimet e gabuara të disa nëpunësve e komunistëve, në radhë të parë nga organizatat-bazë, nga shokët e komiteteve të Partisë, por t'i analizojnë dhe t'i gjejnë shkaqet e këtyre qëndrimeve, pse përndryshe do të veprojnë në mënyrë të njëanshme, nuk do të zhdukim burimin e këtyre shfaqjeve.

Edhe specifikat e veçoritë që kanë rrethet, zonat apo krahinat e ndryshme, janë faktorë që luajnë rolin e vet në shfaqjen e grindjeve e të mërive e në shkallën e përhapjes së tyre. Për shembull, për një zonë mund të thuhet se grindjet e meritë nxiten më tepër nga puna armiqësore e armikut të klasës, kurse në një tjetër ato ushqehen edhe nga mendjemadhësia e theksuar që duket në disa banorë të saj. Këto karakteristika nuk duhen nënvleftësuar, por të njihen e të mbahen

parasysh në luftën kundër grindjeve, mërive e thashe-themeve.

Ne nuk duhet t'i mbrojmë ata njerëz që gabojnë, si ata që janë në Parti, ashtu edhe të tjerët. Nga materialet që na dërgojnë, konstatojmë se në disa organizata-bazë ekzistojnë thyrje uniteti. Kjo vjen për shkak se ka komunistë ose elementë të paorganizuar në Parti, që mbajnë pa të drejtë anën e njërit apo të tjetrit ose atë të fisit. Në rast se ka të tillë komunistë, që nuk e kuptojnë këtë problem të madh si aspekt të luftës së klasave dhe nuk janë në gjendje të gjykojnë e të mbajnë qëndrime të drejta ndaj kontradiktave joantagoniste në gjirin e popullit, ne duhet të dalim me konkluzionin që bëhet një punë e dobët ideopolitike brenda në organizatën-bazë të Partisë.

Këtu u tha se ka raste që shokë komunistë, megjithëse i njohin probleme të tilla, janë në pozita pritëmerie dhe kërkojnë ndërhyrje nga organet drejtuese në rreth ose në qendër. Mua më duket se nuk veprojnë kështu të tërë anëtarët e Partisë, prandaj pak raste s'duhet të përgjithësohen. Nuk është e drejtë të mendohet se, meqë anëtarët e Partisë në fshatin tonë qenkan në pozita të tilla që nuk mund ta zgjidhin problemin, ne s'e ngremë fare atë. Masat duhet t'i ngrenë problemet në Parti dhe jo siç u tha këtu që, kur duken fenomene të mërive në fshat, ndodh që gratë u drejtohen shoqeve komuniste për të zgjidhur problemet e tyre. Kjo nuk është tërësisht e mirë dhe ndihma që kërkojnë ato nuk është e plotë, pasi të drejtat e tyre nuk i mbrojnë vetëm gratë, por e tërë Partia, prandaj ato duhet të drejtohen tek organizata e Partisë. Nuk

duhet të lejojmë që te një shoqe që kërkon një të drejtë, të kultivohet mentaliteti i gabuar se ajo duhet t'ia qajë hallin medoemos një komunisteje. Të drejtën ajo ta kërkojë te Partia.

Rastet e thyerjes së unitetit të mos i nënvleftësojmë, për arsye se ato mund të kthehen edhe në kontradikta antagoniste. Dënimi i njerit ose i tjetrit pa të drejtë, moszgjidhja e problemit në rrugën që porositi Partia, e bëjnë njeriun të pakënaqur, e hedhin në anën e atyre që janë në opozitë të heshtur, por subversive, me pushtetin tonë popullor e me Partinë dhe e kthejnë atë në një objekt të armikut.

Aktivizimi i njerëzve në punë konkrete shërben si ilaç për të shëruar këto shfaqje dhe është mjeti më i efektshëm. Të gjitha ngjarjet që zhvillohen te ne shërbejnë për edukimin klasor të njerëzve tanë dhe në këtë drejtim kemi suksese të mëdha. Puna e Partisë i edukon njerëzit, i tërheq ata jashtë rrjetave të intrigantëve, të dembelëve, të të pakënaqurve. Ka plot forma pune që mund të përdoren. Një festival i këngëve dhe i valleve, siç na thuhet këtu në raport, bën një efekt të madh për edukimin politik, ideologjik dhe artistik të popullit, ndihmon të lulëzojnë ndjenjat e njerëzve; por çështja është se mbeten akoma boshllëqe të mëdha, që duhet t'i plotësojë një propagandë e zgjuar e Partisë, e organizuar, e dozuar sipas shfaqjeve dhe sipas gjendjes që paraqitet.

Punimi i materialeve të Kongresit të 7-të të Partisë po lë gjurmë të thella në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Ai po ngjall jo vetëm entuziazmin në masat, por rrit edhe pjekurinë e vigjilencën e tyre, krijon një ve-

ndosmëri të madhe në njerëzit tanë për realizimin e detyrave dhe forcon bindjen tek ata për vijën e drejtë të Partisë.

Kur flasim për diktaturën e proletariatit, shtrohet çështja që të marrim në analizë të herëpashershme gjendjen konkrete edhe të veprimtarisë së armikut. Dhe kur them të armikut, kam parasysh edhe të këtyre shfaqjeve, sepse shumë shfaqje nga këto që po analizojmë, degjenerojnë në krime dhe njerëzit që i kryejnë, kalojnë në gjyqë. Me keqardhje mund të themi se konstatojmë në mjaft raste deficite dhe suficite. Pse ngjasin gjëra të tilla? Ngjasin sepse nivoli i atyre që merren me administrim mallrash dhe parash është i ulët, por edhe ndërgegjja e tyre është e prishur. Kjo duhet të na bëjë të reflektojmë thellë për të punuar akoma më tepër në këtë drejtim. Konstatojmë, gjithashtu, se ka raste që përpara gjyqeve dalin të rinj, të cilët kryejnë akte vagabondazhi. Të gjitha këto sjellje e veprime janë aq të dënueshme, shokë, sa që jemi detyruar të marrim masa. Të tilla sjellje shkaktojnë jo vetëm vështirësi për Partinë, por dhe mëri mes njerëzve, që arrijnë deri edhe në krime.

Nuk mund të kuptohet, as të lejohet, që në qytetet dhe në fshatrat tona të ketë familje që të mos flasin me njëra-tjetrën. Kur ka të tilla familje, kjo do të thotë se në to asnjëri nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të ngrejë zërin edhe t'u thotë të tjerëve: «Ku po shkojmë? Çfarë sjelljeje dhe çfarë morali është ky që për një çështje të vogël, që mund të vemi shoqërisht e vëllazërisht ta zgjidhim, mbajmë mëri me njëri-tjetrin? Mëria midis nesh kalon pastaj në platforma akoma më



të gjera, se, për arsyeën e familjes sime, futet në mëri i tërë fisi». Atëherë ne mund të themi se këta njerëz nuk rrojnë në botën tonë socialiste, por në botën që ka përënduar, në atë botë ku këto probleme zgjidheshin me hakmarrje, me rrahje, me vrasje. Kjo ndodhte se nuk ekzistonte pikërisht një forcë politike dhe ideologjike, siç është kjo e Partisë sonë, që t'i sqaronte njerëzit, dhe se ligjet e gjykatat nuk ua zgjidhnin drejt këto probleme shoqërore, përkundrazi, ua zgjidhnin padrejtësisht, në favorin e atyre që ishin fajtorë. Ne e kemi të qartë se regjimet e atëhershme antipopullore mbronin agallarët e bejlerët. Ishte kjo klasë atëherë që shtypte të tjerët, që poshtëronte, turpëronte dhe shfrytëzonte njerëzit.

Tash Partia, përpara disa shfaqjeve të tilla, duhet të vërë pyetjen: Si mund të ekzistojnë situata të tilla, qofshin këto edhe të pakta në numër, dhe çfarë masash urgjente, të thella e të vazhdueshme duhen marrë, që gjëra të tilla të mos ekzistojnë më? Kur dëgjon të ndodhin ngjarje të tilla, njeriu mendon dhe thotë: «Ç'efekt po bën puna e Partisë, ç'efekt po bën puna e organizatës së rinisë dhe e asaj të gruas? Ç'efekt bën puna e organizatave të bashkimeve profesionale?». Janë pyetje të natyrshme këto. Efekti i punës së Partisë dhe i levave të saj në njerëzit që kryejnë akte të dënueshme është shumë i vogël, prandaj mburrja dhe gjithë ajo propagandë që po na bëhet nëpër raporte, nuk janë plotësisht reale. Propagandën dhe edukimin t'i matim me rezultatet. Kudo ku shikohet të ndodhin të tilla shfaqje, duhet të dilet në konkluzionin se propaganda e Partisë, puna e saj edukative për bindjen dhe

edukimin e njerëzve çalon, për arsye se nuk i vihët rëndësia e duhur kësaj pune kapitale, sepse nuk e organizojmë atë në mënyrë të vazhdueshme, që, porsa të shfaqet një e keqe, të demaskohet në mënyrë të gjithanshme, t'i shkulen rrënjët që e shkaktojnë.

Komitetet e Partisë duhet të jenë vigjilente, që të mos bëjnë gabime, të mos bien në pozitat e fisit që mban mëri, ta zëmë, në një fshat ose në një tjetër. Përkundrazi, ato duhet ta marrin seriozisht problemin dhe ta zgjidhin jo në mënyrë të sipërfaqshme ose oportuniste, por t'i venë deri në fund, me qëllim që t'i bindin njerëzit e veçantë ose të grupit se, bie fjala, nuk e kanë drejt që zihen dhe t'i këshillojnë të ecin në rrugën e mirë për ta dhe për kolektivin.

Në qoftë se komunistët dhe komitetet e Partisë tregohen të butë dhe oportunistë ndaj disa kërkesave të njerëzve të papjekur ose të elementëve me pretendime të mëdha, qofshin këta njerëz të veçantë, qofshin në grupe, atëherë të jemi të sigurt se problemin jo vetëm nuk e kemi zgjidhur, por e kemi komplikuar.

Po na thoni se ka njerëz që u bëjnë biografite të tjerëve. Kjo duhet të na preokupojë. Jo t'u themi këtyre që të mos bëjnë biografite e të tjerëve, po këto t'i bëjnë drejt, të flasin edhe për të mirat që kanë njerëzit, por edhe për të metat e tyre. Ne konstatojmë që në këto biografi që bëjnë disa, mund të ketë në ndonjë rast edhe shpifje, edhe ekzagjerime, por midis tyre ka edhe vërejtje për të meta. Atëherë çfarë të bëjmë për këto të meta të njerëzve, t'i mbulojmë? A kërkojmë ne që ai që e bën këtë biografi të ketë koncepte të drejta për të gjitha problemet? Atëherë, në rast se nuk i ka të tilla,

duhet të punojmë që t'i ndreqë, por, në radhë të parë, lypset të kemi koncepte të drejta ne vetë. Kështu do të bëjmë që të metat e atij personi, të cilit i bëhet biografia, të vihen mirë në dukje, se disa herë nuk vihen si duhet, mbahet hatër, qëndrohet në mënyrë oportuniste ndaj tij.

Shokë, problemi që diskutojmë ka të bëjë me luftën e klasave, me unitetin e popullit e të Partisë, prandaj është një problem i përhershëm e me rëndësi të madhe për Partinë. Thashethemet, mëritë, hatëret nuk paraqiten kudo në një formë dhe me të njëjtin intensitet, prandaj duhet të dimë të zhvillojmë një propagandë të vazhdueshme, të zgjuar dhe të diferencuar. Këtë propagandë ta bëjë vetë organizata-bazë e Partisë dhe jo vetëm komiteti në rreth. Të mos mendohet se komiteti i Partisë i rrethit do t'i zgjidhë të tëra problemet. Në rast se organizata-bazë e fshatit, e ndërmarrjes, e shkollës apo e lagjes etj., nuk i analizon këto çështje me një pjekuri të madhe, me vendosmëri marksiste-leniniste, me një sjellje të kulturuar e me një taktikë të zgjuar për t'i zgjidhur, atëherë nuk mund të thuhet se ajo ka bërë një punë të pastër dhe konsekuente, dua të them të vazhdueshme, por një punë shkel e shko, që merret në studim vetëm kur ndonjë ngjarje krijon situata të vështira.

Çështja nuk është që të shkojnë njerëzit në gjyq. Ne luftojmë që ata të mos shkojnë fare në gjyq, por t'i zgjidhin këto çështje në rrugë partie dhe në një frymë të shëndoshë shoqërore. Në këtë punë është e domosdoshme të mobilizohen si duhet të gjitha organizatat e masave.

Këto që përmenda s'është hera e parë që ne i themi, por tani ka ardhur koha të thellohemi edhe më tepër në çdo problem duke e marrë në mënyrë të veçantë. Thellimi, mendoj, duhet të bëhet nga organizata-bazë e Partisë, sipas direktivave që ka dhënë vazhdimisht Komiteti Qendror, pse ajo i di më mirë rrënjët e fajit, opinionet dhe veprimet e njerit e të tjetrit, lidhjet në mes tyre. Pastaj le t'i hedhë të gjitha këto në balancë, të japë mendimin e qartë dhe të marrë vendimin më të përshtatshëm.

Organizatave të Partisë u rekomandoj që këtë problem të mos e heqin kurrë nga vëmendja e tyre dhe, kur analizojnë çdo çështje, të shohin anët e mira, por edhe të metat. Çdo gjë ta zgjidhin me urtësi, me gjakftohtësi, me drejtësi. Në të metat të ndalemi dhe t'i analizojmë e të dënojmë prirjet e këqija në karakterin e njerëzve që veprojnë gabim. Të vëmë, gjithashtu, në dukje edhe anët pozitive, karakteristikat e mira të njerëzve tanë, të cilat përbëjnë një forcë kolosale dhe përfaqësojnë moralin tonë komunist.

*Dotuar për herë të parë, me ndonjë shkurtim, në librin: Enver Hoxha, "Raporte e fjalime 1976-1977", f. 320*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

## UNITETI I PUNËS SHITETËRORE ME PUNËN E PARTISË JEP REZULTATE TË MIRA

Shënime

14 prill 1977

Puna e Partisë në dikastere ka një rëndësi të madhe dhe duhet thelluar, pse ka dobësi, ka edhe kuptime të ngushta.

Organizatat e Partisë atje të kenë kujdes që anën shtetërore dhe atë të Partisë të mos i shohin dhe të mos i zhvillojnë të shkëputura. Këto dy anë janë pjesë përbërëse të një pune të vetme të përbashkët në drejtimin e zbatimit të detyrave shtetërore me një frymë të lartë partie. Vendimet e marra nga ana shtetërore duhet të jenë të drejta. Organizimi i zbatimit të këtyre detyrave të jetë sa më i përsosur dhe zbatimi i tyre të bëhet në frymën revolucionare të Partisë. Në qoftë se e shtrojmë dhe e kuptojmë punën kështu, atëherë uniteti i punës shtetërore me punën e Partisë do të jetë i plotë dhe rezultatet pa dyshim do të jenë të mira. Por, në qoftë se këto çështje ndahen në mënyrë burokratike, atëherë puna në dikastere do të çalojë dhe, siç po konstatojmë, arrihet në një konkluzion, sipas të cilit nuk mund të ecet përpara në punën e dikasterit pa marrë

më parë për çdo gjë aprovimin e organizatës-bazë të Partisë. Asnjëherë nuk është thënë një gjë e tillë. Vendimet që merr dikasteri nga ana shtetërore duhet t'u përgjigjen direktivave të Komitetit Qendror dhe vendimeve të Qeverisë. Këto duhet t'i përqafojnë të gjithë punonjësit në dikaster, të organizuar ose jo në Parti. Organizata e Partisë t'i edukojë ata që t'i zbatojnë drejt në jetë, të bëjë kritika, kur vërtetohen gabime, dhe të mbështetë iniciativat e mira.

Natyrisht, në procesin e zbrërthimit dhe të zbatimit të direktivave duhet të evitohet rreziku i një pune të nxituar, rreziku që direktivat të trajtohen vetëm në aspektin teknik dhe administrativ, duke neglizhuar anën e përmbajtjes së tyre ideopolitike. Shpjegimin e kësaj përmbajtjeje, që është kryesorja, pa të cilën nuk mund të zbatohen si duhet direktivat, kërkohet ta bëjë Partia. Organizata e Partisë në dikaster nuk bën një punë të izoluar me një apo me dy njerëz, por me gjithë kolektivin e ministrisë, nga ministri deri te daktilografistja, me qëllim që secili të kuptojë përmbajtjen ideologjike e politike të direktivës dhe këtë të mos e zbatojë në mënyrë dogmatike. Kjo mënyrë shikimi është e drejtë. Po të veprohet ndryshe, atëherë do të vërchet patjetër një paralelizëm në tematikat e organizatës-bazë të Partisë dhe të aparatit shtetëror, do të ketë dublime në punën për ndjekjen dhe zgjidhjen e problemeve dhe do të lihen mënjanë aspektet ideopolitike të direktivës.

Një gjë e tillë është e palejueshme, përkundrazi, duhet të bëhet punë e kualifikuar, si nga ana teknike, ashtu edhe nga ana ideopolitike, dhe të krijohet ai unitet i nevojshëm për zbatimin e plotë të direktivës e të

detyrave. Në qoftë se kjo çështje kuptohet si duhet, atëherë do të evitohet marrja me probleme të vogla dhe të çastit që vërehet mjaft herë në punët e ministrisë, do të mbahet parasysh gjerësia e problemit, zgjidhja e tij e drejtë, nuk do të merren kompetencat e organeve më të ulëta ose të vartësve dhe nuk do të lihen drejtimi kryesor dhe interesimi për perspektivën e problemeve.

Drejtuësit kryesorë në dikastere të ushtrojnë kompetencat që kanë. Ata duhet të dinë të ndajnë mirë punën mes tyre dhe me vartësit. Në organizimin e çdo ministrie brendapërbrenda degëve, drejtorive etj. përcaktohet kjo ndarje pune, po ashtu përcaktohet mirë edhe ndarja e punëve midis ministrisë dhe ndërmarrjeve ose komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Prandaj puna të zhvillohet brenda këtyre caqeve, pa u marrë kompetencat të tjerëve, por edhe ministria të mos merret me çikërrima dhe të mos humbasë pamjen e detyrës kryesore dhe atë të perspektivës.

Që të forcohet puna në dikastere, duhet absolutisht që çdonjëri që punon atje të marrë përgjegjësinë dhe ta kryejë detyrën brenda kompetencave të tij. Në qoftë se dikush atje gabon, atëherë të bëjë autokritikë, të merren masa që të ndreqet dhe jo t'ua lëshojë të tjerëve përgjegjësinë, ose herë tjetër të konfondohen kompetencat dhe të mos mbahet përgjegjësia apo të konfirmohet në rrugë të gabuar. Të gjitha këto janë të dënueshme në punën shtetërore dhe në çdo punë tjetër. Në qoftë se aparatet shtetërore kërkojnë për çdo çështje të marrin kurdoherë aprovimin nga organizatat e Partisë, një kuptim i tillë i punës së tyre është i gabuar. Asnjëherë Partia nuk ka thënë se për çdo

problem të dikasterit duhet të marrë vendim organizata-bazë e Partisë. Kjo do të thoshte që organizata-bazë e Partisë atje të ishte kurdoherë në mbledhje permanente, gjë që nuk është e mundur. Ka direktiva për të cilat diskutohet dhe merret vendim në organizatën-bazë, por ka edhe të tilla për të cilat ajo nuk ka pse të mblidhet e të vendosë, sepse këto direktiva janë dhënë nga instanca më të larta se organizata-bazë, e cila në këtë rast ka për detyrë të organizojë, të udhëheqë e të ndjekë mirë punën për zbatimin e tyre, domethënë, të bëjë të ndërgjegjshëm gjithë kolektivin që ta realizojë mirë direktivën. Kjo është një detyrë e organizatës-bazë, pastaj, kur të kryhet detyra ose gjatë punës për zbatimin e saj, duhet të ushtrohet kontroll, të kritikohen dhe të ndihmohen ata që nuk plotësojnë detyrat. Këtë rol duhet ta luajë organizata-bazë e Partisë.

Një çështje që është shtruar për punën e dikastereve është që atje jo vetëm problemet t'i shikojnë kurdoherë thellë, por edhe punonjësit e tyre të lidhen ngushtë me bazën, t'i zgjidhin asaj problemet që varen nga dikasteri dhe t'i japin ndihmën e kualifikuar që kërkohet për realizimin e planeve ose të direktivave që marrin nga lart. Këtë dikasteret e bëjnë, po e bëjnë me shumë të meta. E meta kryesore është se personat që vënen nga dikasteri në rreth ose në bazë nuk përfaqësojnë atje unitetin e punës dikasteriale, por shkojnë, marrin kontakt me një ose me dy drejtorë dhe harrojnë të hedhin një sy të përgjithshëm edhe në problemet e tjera që dalin në bazë. Ky është një shikim i ngushtë i drejtimit dikasterial. Natyrisht, në bazë duhet të vesh i



përgatitur për një problem, të cilin duhet ta thellosh deri në fund, por kjo nuk ekskludon që ta shikosh këtë problem në marrëdhënie edhe me faktorët e tjerë që kanë lidhje me drejtoritë e tjera të dikasterit, por edhe me dikastere të tjera.

Organizatrat e Partisë në dikastere të mos mendojnë se janë likulduar plotësisht pasojat e punës armiqësore ose gabimet e vërtetuara më përpara. Jo, duhet ngulur këmbë që këto gabime në dikastere të spastrohen e të mos përsëriten më. Atje kanë ardhur shokë të rinj nga baza, nga qendrat e punës. Duhet kuptuar se këta shokë kanë eksperiencë, por nuk kanë eksperiencën e drejtimit në shkallë të lartë, prandaj organizatrat e Partisë e çdo dikasteri dhe kuadrot që kanë një eksperiencë të gjatë në dikaster duhet t'i ndihmojnë fuqimisht këta shokë që ta marrin mirë punën në dorë, të kenë iniciativë, të studiojnë dhe të mendojnë kur i zbatojnë direktivat, të kërkojnë llogari dhe të jenë të disiplinuar. E gjithë kjo është një edukatë ideopolitike, por edhe një edukatë tekniko-organizative. Këtë të mos e harrojmë pa ua thënë shokëve të rinj që punojnë në dikastere.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NË PRODHIMET PËR EKSPORT KRYESORE MBETET CILËSIA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

25 prill 1977

Në Ministrinë e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore ka pasur të meta dhe çrregullime, sidomos në ndjekjen e realizimit të planeve të prodhimeve, të cilësisë së mallrave, të paraqitjes së tyre etj. Ja, për shembull, të marrim këtë të fundit, çështjen e ambalazheve. Kemi vite që e shtrojmë dhe vazhdohet akoma të na përsëritet. A do të marrim masa serioze që mallrat tona të ambalazhohen mirë? Nuk themi që ato të ambalazhohen si jashtë, se ka prej tyre që i ambalazhojnë bukur, por brenda janë pa cilësi, kurse mallrat tona janë të mira, se i zgjedhim, por edhe ambalazhin duhet ta kenë të përshtatshëm. Prandaj të mos na thuhet vazhdimisht

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zbatimin e direktivave të Partisë për zhvillimin e tregtisë së jashtme, përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e mallrave për eksport, importimin në kohë të mallrave të domosdoshme, përmirësimin e bilancit valutor dhe rritjen e rezervave të devizës së lirë».

se po shikohet kjo çështje e të mbetemi përsëri në ambalazhet që kemi.

Siç u përmend këtu, arkat e ambalazhit për prodhimet bujqësore dëmtohen shumë, sidomos ato që bëhen prej kartoni. Thuhet se kjo gjë do të rregullohet, por mund të bëhej edhe më parë. Këtë nuk e zgjidh dot me autokritika. Shokët përkatës të na thonë si mendojnë të veprojnë e të caktojmë afate konkrete.

Kisha diçka për ambalazhin e cigareve. Unë e kam lënë duhanin, po më duket se cigaret jashtë nuk shiten të gjitha në kuti prej kartonçine. Në kuti të tilla vënë ato luksozet, kurse të tjerat, mundet që gabohem, janë kështu si tonat, me ambalazhe të buta.

Rëndësi ka, gjithashtu, çfarë lloj cigaresh vihet në kuti, sepse kështu nga jashtë kutia që bëjmë ne është e bukur. Mua më duket se cigaret në kuti të tilla kalojnë kudo, por ato me cilësi të dobët nuk kalojnë. Kutitë, kur mbushen, duhen kontrolluar me kujdes, që të mos ndodhë që ato të kenë të shkruar një markë të caktuar, kurse cigaret brenda të jenë të një marke tjetër.

Duhet mbajtur mirë parasysh ku priset cilësia e duhanit, në cilin proces dhe në ç'vend, a priset ai gjatë tërheqjes apo duke qëndruar në depo të papërshtatshme. Ndërmarrjet e grumbullimit ta tërheqin në kohë dhe ta mbajnë mirë duhanin në depot e tyre, sepse ndodh që grumbulluesi vë kapelen mbi sy dhe nuk interesohet fare për punën që ka bërë kooperativisti.

Letra e cigareve ndonjëherë është me vrima. Përse të ndodhë kështu? Këtu është fjala për kualitetin.

Ku mbahet kjo letër që dëmtohet dhe bëhet me vrima? I shikoni ju shokë të ministrisë këto gjëra? Në qoftë se duam prodhime me cilësi të mirë për eksport, lypset që edhe lënda e parë të jetë e mirë.

Pra, t'i shtrojmë drejt problemet këtu në Byronë Politike, të flasim konkretisht për to e jo në përgjithësi. Konstatoj se problemet disa herë nuk shikohen si duhet një e nga një, po na flitet për gjëra të përgjithshme. Ja, u tha këtu, për shembull, se për eksportimin e cigareve jashtë, na duhet të sigurojmë kartonçinë të fortë etj., etj., por si do të sigurohet ajo, si do të prodhohen kutitë e cigareve me të, nuk thuhet asgjë konkrete.

Kush i bën këto etiketa?<sup>1</sup> Më të bukura se këto kërkon ju, shokë të ministrisë? Kur prodhohen të tilla, pse e ngrini problemin e etiketimit? Çfarë etiketash më të mira mund të bëhen? Mua këto më duken të pëlqyeshme. Rëndësi ka si vendosen ato, se ndodh që etiketat ngjiten mbrapsht ose shtrembër. Shkelje të tilla të mos lejohen. Në këto raste të mos llogariten në normë etiketat e vëna keq. Megjithëkëtë, nuk mund të thuhet se disa reklamime mallrash janë bërë për punë etiketash. Në prodhimet për eksport kryesore mbetet cilësia.

Këtu u tha se vazhdohet të bëhet tregti duke korresponduar me letra. Korrespondenca do të vazhdojë edhe në të ardhmen, por puna është që të mos mbetemi vetëm tek ajo dhe jo çdo gjë të bëhet vetëm me shkresa. U tha, gjithashtu, se në praktikë nxirren shumë

---

1. Është fjala për disa lloj etiketash për reçel, komposto, plje etj.

pengesa artificiale dhe burokratike, të cilat duhen luftuar dhe evituar. Kur kohët e fundit u organizua një kontroll punëtor në ndërmarrjet e tregtisë së jashtme, iu tha shokëve që do të shkonin jashtë, të merrnin me vete edhe disa kampionatura, ndërsa ata u përgjigjën: «Nuk i marrim dot, se janë voluminoze», sikur do t'i mbanin në kurriz.

Këto çështje që diskutuam t'i zbatojmë, se për të tëra ramë dakord.

*Dotohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## PROPAGANDA PËR BOTËN E JASHTME ËSHTË NJË PROBLEM I MADH PARTIE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 prill 1977

Si jeni me shëndet e me punë, shokë<sup>2</sup>, mirë? Komiteti Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme bën një punë të efektshme për njohjen e vendit tonë jashtë. Tash më duket se po lëvizet një çikë më tepër, dhe njohja e interesi i të huajve për vendin tonë po rriten vazhdimisht. Ti, shoku Javer, mund të na flasësh për këto probleme, se je specialist i tyre. Na thuaj si i kemi miqtë nga të katër anët e botës, si janë lidhjet me ta dhe ç'mund të bëjmë për t'i forcuar akoma më shumë e për ta bërë edhe më të njohur vendin tonë jashtë.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për disa probleme të propagandës për botën e jashtme.

2. U drejtohet shokut Javer Malo, në atë kohë kryetar i Komitetit Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme, dhe të ftuarve të tjerë në këtë mbledhje.

*Pasi dëgjoi diskutimet e disa shokëve të pranishëm në mbledhje, shoku Enver Hoxha tha:*

Ne duhet të bëjmë akoma më shumë lidhur me propagandën për botën e jashtme, prandaj mendoj që të gjitha propozimet e paraqitura këtu, të cilat janë plotësisht të drejta (por që nuk mjafton vetëm t'i quajmë të drejta), sektori i propagandës në aparatet e Komitetit Qendror të Partisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me shokët drejtues të Komitetit Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme, t'i shqyrtojnë një nga një dhe, tok me detyrat që do të dalin, të punojnë për t'i vënë në jetë.

Edhe ne këtu në Sekretariat të mendojmë që problemeve t'u jepet zgjidhje në mënyrë serioze, duke krijuar edhe një komision për këtë qëllim. Atyre që do të merren me zgjidhjen e këtyre problemeve t'u krijohen mundësitë që punën ta bëjnë mirë, të mos e lënë zvarrë dhe neglizhencat pastaj t'i justifikojnë duke përmendur shumë «arsye», që vazhdimisht i kemi dëgjuar, si, fjala vjen, «lind nevoja të mësojnë më shumë djem gjuhë të huaja», në një kohë kur nuk bëhet një shpërndarje e drejtë e studentëve që mbarojnë studimet ose «disa kuadro nuk specializohen pas universitetit» e të tjera si këto. Sigurisht, problemi i studentëve që mësojnë gjuhë të huaja është me rëndësi, por si ky ka edhe shumë të tjera që kërkojnë, gjithashtu, zgjidhje.

Mua më duket se propaganda për botën e jashtme është një problem i madh partie dhe qeverie. Materialet që përdoren në këtë propagandë ne duhet t'i përgatitim mirë, duke punuar seriozisht. Kur themi që

ATSH-ja të bëjë një zgjedhje më të imët të lajmeve për botën e jashtme, kemi parasysh që ajo është e domosdoshme të dijë kërkesat e të huajve. Ata që lexojnë vazhdimisht lajme të agjencive të huaja kanë eksperiencë dhe e dinë si duhet të formulohen ato. Ne konstatojmë, për shembull, se lajmet e përgatitura nga agjencia kineze HSINHUA nuk i lexojmë dot, ngaqë janë shumë të gjata, kanë lumë fjalësh. Por, ama, kur na vihen përpara lajme të shkurtra dhe të koncentruara, i lexojmë të tëra e mund të themi se nëpërmjet tyre formojmë një ide për ndodhitë në botë ose për pikëpamjet që ka rreth tyre opinioni në vende të ndryshme.

Prandaj, kur përgatitim lajmet tona për jashtë, të mbajmë parasysh që ato t'ua përshtatim kërkesave dhe shijeve të opinionit që i ndjek dhe që dëshiron t'i lexojë. Por mua më duket se këtë punë nuk mund ta bëjnë si duhet një apo dy punonjës të ATSH-së, sidomos në qoftë se punojnë në mënyrë automatike dhe rutine. Që kjo detyrë të kryhet në nivelin që kërkon aktualiteti, punonjësit përkatës t'i specializojmë në mënyrë që jo vetëm t'i regjistrojnë, t'i shtypin dhe t'i përkthejnë lajmet e huaja, po të nxjerrin edhe mësimet dhe të shfaqin mendime se si duhen përgatitur lajmet tona për botën e jashtme. Për këtë anë të çështjes të mendojmë më shumë, kurse për përgatitjen e lajmeve, ashtu si dhe për përkthimet, na nevojiten specialistë.

Propaganda është dy llojesh, mendoj unë. Ka një propagandë me nivel të lartë, e cila është më e koncentruar dhe destinohet për shtresat e njerëzve të mësuar, të intelektualëve, por është pastaj edhe propaganda tjetër, që neve na intereson më shumë — pro-



paganda për masat. Të dyja këto forma duhen përdorur e shfrytëzuar në propagandën tonë për botën e jashtme. Këtu të kemi kujdes që të mos na kalojnë fraza stereotipe e të panevojshme. Por që të arrihet kjo, duhet t'i specializojmë njerëzit tanë. Disa punonjës në qendrat e institucionet tona që merren me propagandë, janë mësuar me një praktikë pune që nuk i përshtatet asaj që kërkohet sot në propagandën për botën e jashtme. Këtë boshllëk ne duhet t'ua plotësojmë dhe t'i mësojmë si të punojnë, por më parë t'i përcaktojmë qartë çështjet.

Për shembull, kinostudios «Shqipëria e re», që prodhon filma, t'i japim orientim se çfarë kërkesash duhet të plotësojë filmi që prodhon ajo, që ai të ketë sukses dhe të pëlqehet edhe jashtë. Por, kur orientojmë, t'u kërkojmë punonjësve të këtij institucioni se çfarë kanë menduar edhe ata vetë më parë për këtë çështje. Ne duhet të dimë se në ç'mënyrë duhet përgatitur një film për Shqipërinë, që t'i tërheqë edhe spektatorët e huaj, pra ta pëlqejnë edhe ata. Kësaj do t'ia arrijmë duke marrë më parë edhe mendimin e shokëve që njohin kërkesat e publikut të vendeve të ndryshme. Veç kësaj, ne duhet të kemi caktuar mirë edhe mënyrën e paraqitjes artistike të bukurive të mëdha të ideve tona dhe të natyrës së vendit tonë. Prandaj e gjithë kjo punë nuk është diçka e thjeshtë.

Përveç filmave që përgatitim për njohjen e vendit tonë, të cilët propagandojnë vijën e Partisë, sukseset e arritura në ndërtimin e socializmit, forcën e moralit tonë të pastër proletar, bukuritë natyrore të vendit tonë, kinostudioja, mendoj, të nxjerrë edhe disa filma të veçantë, qofshin këta artistikë ose dokumentarë. E rë-

ndësishme është që prodhuesit e tyre, përpara se të fillojnë punën; të orientohen çfarë të paraqesin në këto krijime. Ta zëmë se në një film do të pasqyrojmë bukuri të vendit tonë, mirëpo më parë duhet menduar se çfarë do të paraqitet. Shikuesi i huaj ka bukuri të mëdha edhe në vendin e vet, prandaj është e domosdoshme që atij t'i tregohen disa gjëra të veçanta, që janë karakteristike tonat, të atilla që t'i tërheqin vëmendjen dhe të thotë: «Ja, në Shqipëri ekzistoka ky ose ai objekt që unë nuk e kam ditur!». Ai e di, për shembull, që Shambori<sup>1</sup> është një gjë e bukur, prandaj nuk ka asnjë arsye pse t'i tregosh diçka të ngjashme me të nga vendi ynë.

Ja, për shembull, kur u hap ekspozita e madhe në Paris, ku vendi ynë paraqiti në një pavijon të veçantë shumë eksponate etnografike, arkeologjike e të tjera të kësaj natyre, kjo ngjarje në Francë pati një jehonë të madhe, prandaj shkuan për ta vizituar pavijonin tonë edhe personalitete të larta. Po kështu mjaft të mira janë edhe albumet që kemi shtypur, të cilat janë pëlqyer shumë nga të huajt.

Pra problemet e propagandës për botën e jashtme t'i shqyrtojmë një nga një dhe të gjejmë rrugët e të marrim masa për t'i zhvilluar më tej mjetet tona për këtë qëllim.

Më parë, mendoj, duhen marrë masa që të përgatitim e të kualifikojmë njerëzit që do të merren me këtë punë, pastaj të sigurojmë materialet që do të na duhen. Është e domosdoshme të gjejmë format dhe

---

1. Qytet në Francë.

metodat më të mira dhe më efikase për t'i paraqitur prodhimet tona artistike në botën e jashtme. Të gjitha këto çështje që përmenda u përkasin propagandës e agjitacionit me shkrim, me filma, me radio e me televizion që duhet të bëjmë.

Veç këtyre, ka edhe drejtime të tjera në të cilat duhet të zhvillohet propaganda jonë. Këtu u përmend edhe çështja e kontakteve me njerëzit. T'i mbajmë afër dhe t'i shtojmë miqtë e Shqipërisë jashtë, sidomos ata njerëz që kanë autoritet, t'u bëjmë ftesë që të vijnë, t'i presim ngrohtë e t'i njohim me realitetin shqiptar, me ndërtimin e socializmit, me kulturën e lashtë dhe me kulturën e re socialiste të Shqipërisë etj. Disa nga miqtë tanë, kur largohen nga vendi ynë, shkruajnë artikuj ose bëjnë parathënien e ndonjë libri të botuar për ne. Dihet që, në qoftë se një libri ia bën parathënien një autoritet i njohur, për të interesohen rrethe të gjera lexuesish.

Për çështjen e kontakteve me njerëzit, që ngriti këtu Javeri, mendoj gjithashtu se ka të drejtë. Unë nuk dua t'i bëj atij komplimente, por e vërteta është se punën që ka bërë ai kur ishte ambasador në Francë, sidomos në drejtim të zgjerimit të kontakteve me të huajt, ne e kemi çmuar. Por është e nevojshme që kontaktet e njerëzve tanë jashtë të mos kufizohen vetëm në rrethet e disa elementëve të njohur, ndjenjat e mira të të cilëve ndaj Shqipërisë janë të ditura, çështja është që rrethi i të huajve që interesohen për vendin tonë të zgjerohet më tej, që të rritet gjithnjë më shumë numri i miqve e i dashamirëve të vendit dhe të Partisë sonë. Për t'ia arritur këtij qëllimi është e domosdoshme që

njerëzit tanë jashtë të luftojnë, së pari, shumë më tepër për zhvillimin dhe zgjerimin e kulturës e të njohurive, gjë që është një kusht me rëndësi të madhe për të fituar audiencë në rrethet e ndryshme të njerëzve me kulturë dhe me autoritet. Të zgjerosh kulturën nuk do të thotë të kesh njohuri enciklopedike, por të kesh dijeni të nevojshme për probleme të ndryshme, të jesh i azhurnuar në radhë të parë për çështjet politike, të kesh për to mendimin tënd të qartë në bazë të direktivave të Partisë. Një diplomat që nuk interesohet sa duhet për të lexuar, nuk mund të jetë i informuar në nivelin e kërkuar për të zhvilluar bisedime të frytshme me të huajt. Lëre pastaj kur nuk zotëron gjuhën e vendit ku është akredituar. E ngre çështjen e gjuhës si një mjet të domosdoshëm për diplomatët tanë, sepse, që të mund të futen në rrethet ku do të propagandohet Shqipëria, duhet absolutisht të njohin gjuhën e vendit.

Diplomatët tanë në takimet me të huajt duhet të shkojnë me idenë që ta bëjnë të huajin të interesohet për Shqipërinë, për sukseset e saj etj., t'i ngjallin atij kuriozitet. I huaji ka pikëpamjet e tij, prandaj që t'i ngjallësh kuriozitetin për vendin tonë, duhet ta njohësh me të dhëna interesante që ai deri në kohën e bisedës nuk i di.

Duhet pasur gjithashtu kujdes se, derisa në lidhjet me të huajt ne synojmë të arrijmë disa objektiva të caktuar, që dëshirojmë t'i realizojmë, është e nevojshme që diplomatët tanë të bëjnë një punë të zhdërvjellët, të kenë kontakte korrekte me të huajt.

E përsëris edhe një herë: ne duhet t'i studiojmë me imtësi këto çështje për të cilat diskutojmë, pse, në

qoftë se i shikojmë në përgjithësi, nuk do ta përmirësojmë dot punën siç duam. Në qoftë se sektori i jashtëm i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë do të merret vetëm me pritje e përcjellje dhe me lidhjet e partive marksiste-leniniste me Partinë tonë, puna e tij, e kufizuar brenda kësaj sfere, nuk do të na japë atë kontribut që duhet të japë në fakt. Nga konkluzionet që do të nxjerrë ky sektor, të na jepen mendime se ç'duhet bërë më tej.

Edhe shokët që punojnë në sektorin e jashtëm duhet të jenë me kulturë, të kenë horizont të gjerë, në mënyrë që të futen edhe në diskutime për probleme letrare, politike etj., dhe të mos mbeten në një sferë të ngushtë. Ata duhet të dinë të bisedojnë me miqtë për të mësuar ç'flitet në opinionin e vendeve të tyre lidhur me një apo disa probleme politike etj. Kjo punë ndihmon gjithë sektorin e propagandës, i cili, krahas punëve që varen prej tij, duhet të ketë shumë preokupacion edhe për propagandën tonë për botën e jashtme. Në këtë drejtim të bëjmë përpjekje për të arritur nivelin e kërkuar.

Sektorët përkatës në aparatit të Komitetit Qendror duhet të kontribuojnë që emisionet e radios sonë të jashtëm të jenë sa më të plota dhe interesante për dëgjuesit e huaj, të ndihmojnë me të vërtetë për propagandimin më të mirë të vendit tonë, duke dhënë mendime për çështje konkrete dhe, njëkohësisht, duke marrë edhe disa masa organizative për zbatimin e tyre. Për këtë duhet gjetur edhe kuadri i përshtatshëm, të cilit t'i hapen horizonte dhe të aftësohet për të zbatuar detyrat me përpikëri.

Propozimeve që u bënë këtu për përmirësimin e propagandës për botën e jashtme, mendoj t'u japim zgjidhje një nga një dhe në mënyrë pozitive. Natyrisht, ka çështje që janë vënë në rrugë, si për shembull, revistat që botojmë për jashtë e disa punë të tjera, por ato duhen perfeksionuar më tej. Lidhur me këto unë mendoj të mos kufizohemi vetëm me revistat «Shqipëria sot» dhe «Shqipëria e re»; i kemi mundësitë të nxjerrim edhe një revistë letrare që të dalë një herë në tre muaj, siç propozojnë shokët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve. Për të furnizuar me materiale këtë revistë, të bëhet jo zgjedhje e thjeshtë e teksteve, por një zgjedhje në rrugë parimore, në të të botohen shkrime të bukura, ashtu si i duan të huajt, dhe që, në të njëjtën kohë, paraqitin mirë letërsinë tonë, jetën e ne etj. Edhe cilësinë e botimit për këtë revistë ta perfeksionojmë. Pastaj duhen parë edhe çështja e kuadrit që punon për to, dalja në kohë e këtyre organeve, si dhe çështja e përkthyesve. Për këtë qëllim të specializojmë njerëz, që materialet e revistave jo vetëm të përkthehen mirë, por në to të mos kalojnë as gabime ortografike. Në nuk kemi specialistë të mbaruar për gjuhën frënge, për shembull, por duhet të përpiqemi të përgatitim specialistë, duke i vënë ata që kemi të merren me disa çështje specifike. Njerëzit tanë janë të zgjuar dhe mund të specializohen. Për këtë të organizohen edhe kurse të veçanta, të sjellim edhe ndonjë pedagog që të japë mësim gjuhe etj., me qëllim që t'i perfeksionojmë në këto drejtime, sepse na duhen për një qëllim të madh. Kjo është një detyrë që ne duhet ta kryejmë.

Për këto çështje që diskutuam ka gjëra që janë

në brazdë dhe na ecin, por që duhen përsosur më tej; ka të tjera që duhet t'i shikojmë dhe të vendosim; ka, më së fundi, edhe probleme që do t'i zgjidhim në perspektivë.

A jeni dakord, shokë? Keni ndonjë gjë tjetër? Ato që thamë këtu, si ju, shokët e Ministrisë së Punëve të Jashtme, edhe ju të Komitetit për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme duhet të interesoheni për t'i zbatuar.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# KËSAJ I THONË: TË HARROHET UJKU DHE TË LUFTOHET HIJA E TJ

Shënime

29 prill 1977

Me shokun Ramiz bisedova për një çështje që e quaj oportune dhe të rëndësishme. Duhet të shkruajmë një artikull teorik, thelbi i të cilit të demaskojë në brendi vijën oportuniste kineze në lidhje me të ashtuquajturën teori e tri botëve.

Aktualisht shohim se kinezët dhe adeptët e tyre kudo po e përdorin shumë tezën e «botës së tretë» për ta nxjerrë atë si një «teori të drejtë të luftërave nacionalçlirimtare» dhe me këtë, pa e zënë shprehimisht në gojë, po denigrojnë e atakojnë vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe të Kongresit të saj të 7-të, që e trajtoi posaçërisht këtë problem.

Duke u mbështetur në disa citate të Marksit dhe të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, të marra të shkëputura nga konteksti, ata përpiqen të shpjegojnë (po nuk shpjegojnë asgjë) teorinë e tyre të «botës së tretë» (e cila në fakt mohon revolucionin). Gjithashtu kinezët na akuzojnë ne si «dogmatikë, blankistë, që dëshirojmë të kapërcejmë etapat». Sipas tyre, shqiptarët nuk luf-



tojnë që popujt e botës të zhvillojnë më parë luftën nacionalçlirimtare, por përpiqen të shkojnë drejt e në thela: që popujt të luftojnë për revolucionin proletar.

Me fjalë të tjera, në këtë artikull ne, pa përmendur emrin e Partisë Komuniste të Kinës, duhet të demaskojmë pikëpamjet oportuniste që janë ngritur aktualisht prej saj për shuarjen e revolucionit. Kina nuk pajtohet me përcaktimin që i kanë bërë epokës sonë klasikët e marksizëm-leninizmit, të cilët thonë që, pas fitores së Bashkimit Sovjetik, pas fitores së Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, bota ka hyrë në epokën e revolucioneve proletare. Për Kinën njerëzimi «nuk rron në këtë epokë», ajo pretendon se jemi akoma në periudhën e revolucioneve demokratiko-borgjeze.

Pikërisht këtë çështje ne duhet ta shpjegojmë qartë në artikull. Pavarësisht se që nga vitet njëzet e deri tash bota ka pësuar transformime, se popujt e shumë vendeve të Afrikës, të Azisë dhe të Amerikës Latine, që Lenini i fuste në vende koloniale, tash kanë fituar njëfarë pavarësie politike, që në fakt është formale, ashtu siç janë formalë sovraniteti dhe liria e tyre, shtetet e krijuara të këtyre vendeve sot kanë hyrë nën zgjedhën e imperializmit amerikan e të fuqive të tjera kapitaliste të botës, mes të tjerëve edhe të social-imperializmit sovjetik, e këta popuj po shfrytëzohen në forma të tjera, që i quajmë neokolonializëm. Pra, këto shtete, të ashtuquajtura të lira, sundohen nga klika borgjezo-kapitaliste, të cilat në ujdi dhe në aleanca ekonomiko-politike me superfuqitë dhe me shtetet e tjera kapitaliste, shfrytëzojnë dhe shtypin popujt. Shumë nga këto shtete, që kanë fituar pavarësinë dhe që thuhet se

e kanë realizuar etapën e demokracisë borgjeze, nuk kanë bërë as reformat më elementare të kësaj etape, si për shembull, ndarjen e tokave, reformën agrare.

Ne duhet të shpjegojmë se, duke ekzistuar një situatë e tillë, partive komuniste marksiste-leniniste dhe proletariatit nuk mund t'u lejohet të qëndrojnë në kuartrin e statukuosë, domethënë që të mos luftojnë për revolucionin proletar. Por, kur flasim për revolucionin proletar, ky më parë duhet të përgatitet dhe, që të përgatiten për revolucionin proletariati dhe partia e tij, duhet të organizohen, të krijojnë aleancat me fshatarësinë dhe me borgjezinë e vogël e të mesme që kërkojnë çlirim, (kjo e fundit nga borgjezia e madhe kapitaliste) dhe, duke kaluar nga reforma të thella politiko-ekonomike, të dilet në revolucionin proletar. Proletariati dhe partia e tij nuk mund të bëjnë aleancë as me partitë e borgjezisë së madhe, që është në fuqi në shumë nga këto shtete të së ashtuquajturës botë e tretë, por as me ato parti të borgjezisë së vogël që qëndrojnë në pozita reaksionare. Partia komuniste marksiste-leniniste, partia e proletariatit, duhet ta ruajë kurdoherë pavarësinë. Kjo parti dhe proletariati i udhëhequr prej saj duhet të jenë në aleancë vetëm me atë klasë dhe me ato shtresa që synojnë e aspirojnë për revolucionin.

Kurse Kina, me vijën që ndjek dhe me qëndrimet që mban, i thotë stop revolucionit. Ajo profeson një revizionizëm të ri, që është një variant i revizionizmit modern, një formë oportuniste e theksuar e shtrembërimit të ideologjisë sonë marksiste-leniniste. Në thelb, në teori dhe në praktikë, ajo ka për qëllim ta pengojë e ta ndalojë revolucionin, të ruajë statukuonë e shteteve të

ashtuquajtura të lira dhe të pavarura, por në fakt të sunduara nga klikat e mëdha kapitaliste vendase, që janë në aleancë me imperializmin amerikan, dhe t'i ngrejë këto shtete në luftë kundër socialimperializmit sovjetik. «Lufta» e kësaj «bote të tretë», ku është futur edhe vetë Kina, bëhet, pra, në aleancë me imperializmin amerikan.

Kështu Kina, me ndihmën e imperializmit amerikan, duke u mbështetur tek ai dhe duke e hequr veten si anëtare të «botës së tretë», kërkon të ndalojë revolucionin dhe të fitojë kohë për t'u bërë edhe ajo një superfuqi. Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson një gjë e tillë, sepse Kina, duke ndjekur këtë vijë, jo vetëm që pengon revolucionin, shtrembëron ideologjinë marksiste-leniniste, por njëkohësisht i shërben ruajtjes së statukuosë, domethënë ruajtjes së tregjeve nga ana e imperializmit amerikan dhe nga borgjezia e madhe nacionale e çdo shteti, derisa edhe vetë ajo, duke u zhytur në këtë rrugë antimarksiste, antisocialiste, të arrijë të bëhet një superfuqi tjetër, që të balancojë të dyja superfuqitë.

Neve marksistë-leninistëve shqiptarë na bie detyrë ta shpjegojmë këtë vijë të Kinës dhe këtë shpjegim ta bëjmë duke u bazuar si kurdoherë te mësuesit tanë të mëdhenj Marks, Engels, Lenini dhe Stalini, të cilët këto çështje i kanë bërë shumë të qarta. Partia jonë jo vetëm në Kongresin e 7-të, por qëkurse u themelua, ka ecur e do të ecë sipas mësimeve të klasikëve tanë, i ka kuptuar drejt ato në teori dhe i ka zbatuar drejt edhe në praktikë.

**Partia jonë kurrë nuk është treguar dogmatike, në**

asnjë mënyrë ajo nuk është treguar blankiste; përkundrazi, kurdoherë ka ditur ta udhëheqë popullin në rrugën e revolucionit demokratiko-borgjez, në rrugën e Luftës Nacionalçlirimtare për t'i thyer dhe për t'i hedhur jashtë kufijve të atdheut okupatorët nazifashistë. Këtë Luftë të madhe Nacionalçlirimtare Partia jonë diti ta gërshetojë me parimet marksiste-leniniste, domethënë me kalimin nga etapa e revolucionit demokratiko-borgjez në ndërtimin e socializmit. Sa kohë vazhdoi etapa e revolucionit demokratiko-borgjez, kjo nuk ka rëndësi, sepse në kushtet tona u zgjidhën, në mënyrë të pleksur si kohë e si drejtime, si detyra të revolucionit demokratiko-borgjez, ashtu edhe të revolucionit socialist. Në vendin tonë rrethanat ishin të atilla që etapa e revolucionit demokratiko-borgjez u kapërcye shumë shpejt dhe Partia diti t'i shfrytëzojë kushtet e krijuara. Kushtet ishin pjekur, mbasi elementët borgjezë, të borgjezisë tregtare ose të feudalëve të vendit, të ne u lidhën me okupatorët, ata bënë kauzë të përbashkët me ta, u ngritën në luftë kundër popullit dhe lufta e popullit i përlau, kështu që revolucioni kaloi relativisht me lehtësi e shpejt nga një etapë në tjetrën.

Nëpërmjet këtij artikulli që do të shkruajmë duhet të sqarojmë opinionin botëror, dhe sidomos marksistë-leninistët, për këtë teori mashtruese që revizionistët kinëzë po përhapin nën maskën e marksizëm-leninizmit. Sipas tyre, meqë Kina gjoja është një vend socialist dhe Mao Ce Duni një «marksist-leninist i madh», atëherë çfarëdo që ka thënë ai, marksistë-leninistët e gjithë botës duhet ta ndjekin medoemos, pa fjalë. Këtë ne nuk e pranojmë.

Ne duhet t'ia bëjmë dhe ia kemi bërë analizën zhvillimit të socializmit në Kinë, për të parë çfarë socializmi po zhvillohet dhe çfarë formash po përdoren atje në këtë rrugë. Ne nuk kemi qenë dakord me pikëpamjet e Mao Ce Dunit që shumë kohë përpara, sidomos për atë që thoshte ai se «fshati duhet të rrethojë qytetin». Këtë pikëpamje të Mao Ce Dunit ne nuk e kemi pranuar kurrë si marksiste-leniniste, sepse me këtë Mao Ce Duni e konsideron fshatarësinë si klasën më revolucionare. Kjo është pikëpamje antimarksiste. Klasa më revolucionare e shoqërisë është proletariati, prandaj ky duhet ta udhëheqë revolucionin në aleancë me fshatarësinë, e cila është aleatja më besnike e proletariatit. Proletariati duhet ta fitojë këtë aleatë, të cilën borgjezia, nga ana e saj, përpiqet ta bëjë për vetë. Teoria e Maos shtjellohet edhe më tej. «Popujt e tri kontinenteve: të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine, — predikon Maoja, — duhet të bashkohen kundër dy kontinenteve të tjera, kontinentit të vjetër dhe atij veriamerikan», domethënë kundër Evropës dhe kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pra si derivat i teorisë së tij, Maoja ka pikëpamjen që duhet të mbështeten pa kushte të gjitha shtetet e këtyre tri kontinenteve, pa u bërë dallime klasore dhe diferencime regjimeve të ndryshme. Sipas tij, Evropa dhe Amerika e Veriut janë qyteti, janë proletariati, kurse tri kontinentet e tjera janë fshatarësia. Një teori e tillë është *aberrante*<sup>1</sup>, ajo nuk mban parasysh realitetin objektiv, zhvillimin materialist të historisë, nuk ka të qar-

---

1. Frëngjisht — jashtë arsyes, absurde.

të rolin e klasës punëtore, të proletariatit dhe të partisë së tij marksiste-leniniste, nuk ka parasysh revolucionin. Është pikërisht teoria e Mao Ce Dunit që nuk mban parasysh etapat e ndryshme nëpër të cilat duhet të kalojë zhvillimi i njerëzimit. Koncepti i Mao Ce Dunit, sipas të cilit «fshati të rrethojë qytetin», po nxjerr brirë aktualisht me teorinë e «botës së tretë». Fakt është se Mao Ce Duni derisa aktualisht me këtë e quan «botën e tretë» forca kryesore e revolucionit, likuidon në teori forcën e madhe revolucionare që çon përpara historinë — proletariatin botëror. Kjo është absurde.

Kjo «teori» ose «analizë» që i bëjnë aktualisht botës revizionistët kinezë, ndihmon pikëpamjet armiqësore, sipas të cilave «revolucionin ka humbur», «ky është në regres të madh» dhe ne tash nuk duhet të flasim më për revolucionet proletare, por të qëndrojmë duarlidhur dhe të duartrokasim e të ndihmojmë Mobutun e Zaires. Po Mobutu me shokë janë përfaqësues të borgjezisë së madhe të shitur, që është e lidhur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Francën e me kapitalistë të vendeve të tjera. Po Kina çfarë bën në këtë mes? Ajo mbron Mobutun me armë dhe me propagandë. Ja, këtë politikë bën ajo. Po është vallë i drejtë ky qëndrim? Jo, ky qëndrim nuk mund të jetë i drejtë. Përkundrazi, Kina, duke vepruar kështu, ia rëndon akoma më tepër zgjedhën popullit kongolez. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për vendet e tjera.

Prandaj artikulli që do të bëjmë, duhet të jetë i hartuar mirë, me përmbajtje shumë të lartë teorike e të zihen mirë të gjitha qoshet. Duke u bazuar në teorinë tonë marksiste-leniniste, të tregojmë se tezat e Kongre-

sit të 7-të të Partisë sonë janë të drejta, marksiste-leniniste, ato janë të bazuara në mësimet e klasikëve tanë dhe i përgjigjen realitetit objektiv të botës aktuale, të ndarjes së saj, të luftërave, të kontradiktave që ekzistojnë sot. Partia jonë i analizon thellë të gjitha këto situata dhe kontradikta, ajo di të përcaktojë dhe të përdorë taktika të drejta lufte, që kanë për objektiv të vetëm kryerjen e revolucioneve proletare dhe çlirimin e popujve.

Kongresi ynë i fundit i ka shpjeguar shumë mirë luftërat, si, fjala vjen, luftërat e popujve të Afrikës, të cilët kanë fituar njëfarë lirie ose pavarësie formale. Disa prej tyre e kanë fituar pavarësinë me armë, si Algjeria etj., kurse disa të tjerëve këtë «liri» dhe «pavarësi» ua «falën» imperializmi francez, imperializmi anglez etj. Këta, imperialistët, në fakt asgjë nuk u falin popujve, por me këtë «dhuratë» i mbajnë kurdoherë lidhur me shumë fije popujt e këtyre vendeve. Pra, në qoftë se pranojmë, dhe duhet të pranojmë, që popujt të tillë kanë arritur një «liri» të tillë që lejon shtypjen nga borgjezia dhe nga feudalizmi i egër vendas, atëherë ata duhet të ngrihen në luftë për lirinë e vërtetë. Kundër kujt duhet të luftojnë dhe çfarë lufte duhet të bëjnë këta popuj? Ata duhet të bëjnë luftë kundër klikave kapitaliste vendase, që janë në fuqi, që i shtypin, si dhe kundër kapitalistëve të huaj, imperializmit amerikan, imperializmit francez, imperializmit gjerman a portugez etj., e bashkë me ta edhe socialimperializmit sovjetik. Domethënë, në qoftë se flasim për luftë, ne duhet t'ua themi popujve, që shfrytëzohen nga kapitali i brendshëm dhe i jashtëm, se u duhet të luftojnë,

kurse Kina nuk u thotë një gjë të tillë. Partia jonë u shpjegon këtyre popujve që të luftojnë dhe kundër kujt të luftojnë, kurse Kina nuk u thotë gjë, as se duhet të luftojnë, as se kundër kujt duhet të luftojnë. Ajo u bën thirrje të luftojnë vetëm kundër socialimperializmit sovjetik, sepse ky synon hegjemoninë botërore dhe vë, me një fjalë, në rrezik hegjemoninë amerikane në botë. Ne u tregojmë popujve se si duhet ta organizojnë luftën, kush duhet ta udhëheqë këtë luftë, cilat janë parimet e kësaj lufte, cila duhet të jetë strategjia dhe taktika e luftës së këtyre popujve. Ndërsa Kina asgjë nuk u thotë popujve nga këto; përkundrazi, ajo u rekomandon të ndjekin një strategji të kapitalit dhe të përdorin taktika që i shërbejnë këtij kapitali, që ia zgjatin atij jetën, me një fjalë u thotë popujve të harrojnë ujkun dhe të luftojnë hijen e tij.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 471*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 471*



# PËR NJË ARTIKULL ME TITULLIN «TEORIA DHE PRAKTIKA E REVOLUCIONIT»

Teza

30 prill 1977

Kohët e fundit gazetatat e partive revizioniste të Belgjikës e të Francës kanë botuar artikuj që propagandojnë teorinë kineze të «tri botëve». Në këta artikuj, që me siguri nuk janë botuar pa dijeninë dhe pa nxitjen e revizionistëve kinezë, sulmohen si blankistë të gjithë ata që flasin për revolucionin proletar. Vetë kinezët riprodhojnë në shtypin e tyre çdo gjë që shkruhet e thuhet jashtë Kinës rreth kësaj teorie dhe e përhapin atë me bujë me anë të agjencisë HSINHUA. Është e qartë se jemi përpara një fushate të madhe të organizuar për çoroditjen e opinionit publik. Kjo është e dëmshme për marksizëm-leninizmin, prandaj e shoh të domosdoshme të përgatitim një artikull teorik, ku të shpjegojmë mirë e me argumente se e ashtuquajtura teori e tri botëve nuk është marksiste, përkundrazi, është antimarksiste, e rrezikshme për revolucionin dhe synon ta sabotojë atë.

Për këtë gjë bisedova sot me Ramizin për mendimet

e mia dhe për tezat e zgjeruara që kam përgatitur për një artikull të tillë.

Titulli i artikullit mendoj të jetë: «Teoria dhe praktika e revolucionit». Ai të synojë në:

— Hedhjen poshtë të teorisë së «botës së tretë».

— Të vërtetohet se ajo është teori e gabuar.

— Çdo gjë rreth «botës së tretë».

— Po deformohen Lenini e Stalini, deformohet Engelsi. Dhe kjo bëhet për të vërtetuar se vija e Partisë sonë gjoja është blankiste, dogmatike, që djeg etapat e revolucionit. Prandaj ne duhet ta mbështetim pikëpamjen tonë në tezat e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit.

— Duke ditur shtrembërimet e falsifikimet që revisionistët u bëjnë klasikëve, ne duhet të vëmë drejt të gjitha momentet teorike e praktike të revolucionit për të cilat flasin Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini (oportunistët i shtrembërojnë, ne t'i vëmë drejt). Të gjejmë edhe të tjera:

— Ç'donin Marksi e Engelsi që të realizonte proletariati me Manifestin?

— Ç'mendonte Lenini, pse e kundër kujt duhej bërë revolucionin dhe në ç'kushte mund të shpërthejë revolucionin (hallka më e dobët)?

— Marksi nuk e ka kritikuar si të parakohshëm revolucionin më 1848. Nuk e ka kritikuar Komunën. Marksi dhe Engelsi kanë dënuar Blankin, pse me teorinë e veta ai digjte etapat dhe ishte kundër nevojës së partisë e kundër aleancave.

(Në qoftë se ndjekim logjikën kineze, Lenini ç'duhej të bënte para paqes së Brestit? Sipas atyre Lenini duhej të bënte aleancë me pushtetin më të dobët ku-

ndër më të fortit (pra me Gjermaninë kundër Antantës). Por Lenini nuk u bashkua me Gjermaninë, bëri paqen, por ai ishte kundër Antantës dhe Gjermanisë. Lenini luftoi edhe Kerenskin.)

— Klasifikimi i vendeve nga Lenini është bërë për të përcaktuar revolucionin.

— Lenini luftërat e revolucionet nacionalçlirimtare i ka konsideruar si rezervë e revolucionit proletar.

— Këtu duhet të theksohet ekzistenca e kontradiktave në shtetet kapitalisto-imperialiste.

— Lenini flet për shtetet koloniale që nuk kishin bërë revolucione demokratiko-borgjeze.

— Që nga ajo kohë kanë ndodhur ndryshime të mëdha. Por tezat leniniste nuk ndryshojnë.

— Ç'janë shtetet e «botës së tretë»? Janë shtete me liri formale. Në fuqi atje janë lloj-lloj klikash, të lidhura në forma të ndryshme me kolonialistët e neokolonialistët (ç'janë neokolonializmi e kolonializmi?).

— A duhet të qëndrojmë në këtë statukuo? A duhet të themi të mos kapërcehen etapat se ndryshe bëhemi blankistë?

**Lenini:** Duhet të shkojë përpara revolucioni në këto shtete. Të vemi në revolucionin proletar apo të ndalemi në revolucionin demokratiko-borgjez?

— Edhe në Zaire shtrohet çështja e revolucionit proletar.

— Po në «botën e dytë» a nuk shtrohet çështja e revolucionit proletar? A nuk duhet përgatitur ky revolucion?

— Marksizëm-leninizmi u hap horizonte e perspek-

tiva popujve. Kjo nuk do të thotë ta bësh revolucionin në mënyrë joserioze.

— Rruga e mobilizimit revolucionar të popujve të çon kundër imperializmit e revizionizmit, ndryshe nuk luftohen imperializmi e revizionizmi.

Të hedhim poshtë tentativat për të analizuar situatat gjoja në mënyrë të re.

— Nëse jemi për luftë nacionalçlirimtare e për revolucion demokratiko-borgjez, kundër kujt do të zhvillohen kjo luftë e ky revolucion?

· Pra edhe kundër Mobutut e të tjerëve.

Atëherë ku konsiston «bota e tretë», që paraqitet si një gjë homogjene?

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 152*

## MENDIME PËR OPORTUNIZMIN E RI (REVIZIONIZMIN KINEZ)

Shënime

12 maj 1977

Ramizi më tha sot se kishte marrë projektdeklaratën e partive motra komuniste (marksiste-leniniste) të Italisë, të Gjermanisë, të Spanjës, të Greqisë dhe të Portugalisë...

I thashë që ta shikojmë këtë projektdeklaratë. Unë mendoj se oportunizmi i ri ose lloji i revizionizmit kinez, për të cilin bëhet fjalë në këtë dokument, lidhet pikërisht me ato probleme kapitale të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të cilat, në atë formë, tashmë dihet, i shtroi Kongresi i 7-të i Partisë sonë. Sipas pikëpamjes së Partisë sonë dhe të shumë partive marksiste-leniniste të Evropës dhe të Amerikës Latine, tezat tona janë të drejta. Ato kritikojnë e demaskojnë teoritë oportuniste revizioniste, veçanërisht të Partisë Komuniste të Kinës.

Mbrojtjen që i bëri marksizëm-leninizmit Partia jonë, në radhë të parë, dhe të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste, e kemi për detyrë ta çojmë më përpara. Këtë punë, natyrisht, duhet ta mbështetim si kurdoherë

në marksizëm-leninizmin dhe në situatat konkrete që zhvillohen në botë. Në asnjë mënyrë nuk duhet të humbasim perspektivën e revolucionit, por ta bëjmë të qartë domosdoshmërinë e hegjemonisë së proletariatit botëror, me pararojat e tij, partitë komuniste (marksiste-leniniste), në luftën kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik, kapitalizmit ndërkombëtar dhe kapitalizmit të brendshëm të çdo vendi në kontinente të ndryshme.

Përderisa akoma nuk kam lexuar projektdeklaratën, unë nuk mund ta them mendimin se si i kanë paraqitur këto çështje shokët e partive motra. Sidoqoftë, në artikullin që do të botojmë, për të cilin i kam dhënë tezat, vijën e Kongresit tonë ne duhet ta shtjellojmë pikërisht në një mënyrë të atillë që të ndihmojmë edhe Partinë dhe popullin tonë, por edhe shokët marksistë-leninistë në botë, partitë e tyre, si dhe gjithë popujt që kanë mundësi ose t'u bjerë në dorë artikulli ynë, ose ta dëgjojnë atë në radio.

Për Partinë tonë ka rëndësi që, me modestinë e saj, të thotë të vërtetën dhe këtë ta mbështetë në një analizë reale dialektike materialiste të gjendjes në botë, në mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit dhe të çarmatosë të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit, që nga imperialistët e deri te revizionistët kinezë apo të çdo ngjyre qofshin ata.

Shtruarja drejt e këtyre çështjeve të mëdha parimore nga Kongresi ynë i 7-të vërtetoi në teori dhe në praktikë drejtësinë e tezave të marksizëm-leninizmit për këto çështje. Një shtruarje e tillë e detyroi Partinë Komuniste të Kinës të bëjë përpjekje për të justifikuar

e për të mbrojtur tezat e saj të gabuara antimarksiste për strategjinë dhe për taktikat, të cilat deri në këtë kohë i paraqiste si marksizëm-leninizmin më të kulluar të epokës sonë.

Në të njëjtën kohë, shtruarja drejt e këtyre çështjeve nga Kongresi ynë e bëri Kinën të sulmojë, por të sulmojë duke shkelur normat. Siç e kam thënë edhe herë tjetër, në këtë drejtim ajo veproi në dy rrugë, prapa krahëve të Partisë sonë, për të denigruar tezat e Kongresit të 7-të, dhe haptazi, për të përçarë lëvizjen marksiste-leniniste revolucionare në botë, duke për-krahur grupimet antimarksiste, të ashtuquajtura maostiste, të cilat mbronin tezat e kinezëve.

Partia Komuniste e Kinës, pra, ndërmoi veprime për të mbrojtur tezën e vet ose strategjinë e saj rreth «botës së tretë si forca kryesore lëvizëse kundër socialimperializmit sovjetik». Kjo tezë antimarksiste kineze la në heshtje epokën e revolucioneve, për të cilën ka folur Lenini që në kohën e vet. Pra, teza e strategjisë kineze rreth «botës së tretë» mohon rolin revolucionar të proletariatit botëror, të partive marksiste-leniniste si pararoja të proletariatit botëror e të revolucionit proletar. Në vend të këtyre ajo ngre njëfarë bote të tretë pa kurrfarë përcaktimi, vetëm duke thënë se «Shtetet e botës së tretë janë në luftë kundër socialimperializmit sovjetik». Pra, strategjia kineze ka për bazë vetëm luftën kundër socialimperializmit sovjetik. Për ta kryer si duhet këtë luftë, ajo predikon një unitet joklasor të proletariatit me borgjezinë, të partive të proletariatit me partitë e borgjezisë kapitaliste, predikon unitetin me imperializmin amerikan, i cili ka kon-

tradikta të thella me socialimperializmin sovjetik. Këtë strategji, sidomos tash, pas Kongresit të 7-të të Partisë sonë, Partia Komuniste e Kinës ka dashur dhe është përpjekur t'ua imponojë gjithë marksistë-leninistëve, revolucionarëve dhe popujve të botës.

Kongresi ynë e trajtoi këtë çështje. Por neve përsëri na bie detyra që t'i shtjellojmë akoma më gjerë dhe më thellë tezat e drejta të Partisë sonë për këtë çështje. Me artikujt dhe me shkrimet tona teorike, ne duhet të sqarojmë lëvizjen komuniste ndërkombëtare se lufta kundër çdo deviacioni, kundër çdo armiku të marksizëm-leninizmit, pa i cilësuar me emër se cilët janë këta, bëhet e pamëshirshme. Do të vijë koha që kontradiktat për këto çështje të mëdha e parimore me ta do të ashpërsohen, dhe atëherë do të jemi të detyruar të përdorim edhe emra.

Aktualisht neve na duhet ta shtrojmë çështjen gjerë, gjatë dhe thellë për të vërtetuar drejtësinë e strategjisë së Partisë sonë dhe të taktikave të saj të ndryshme dhe të mos biem atje ku kërkojnë kinezët, domethënë të mos e shtrojmë çështjen se kush ka të drejtë, kinezët apo shqiptarët. Çështjen ne duhet ta shtrojmë kush ka të drejtë, ata që mbrojnë marksizëm-leninizmin, apo ata që nuk e mbrojnë, por e luftojnë atë. Kinezët, me sa duket, duhet të kenë, dhe në fakt kanë, tendencën që çështjen ta shtrojnë kush ka të drejtë, kinezët apo shqiptarët, pse kjo u leverdis atyre. Kjo do të thotë se ata mendojnë që pikëpamjet e tyre t'ua imponojnë të tjerëve duke u mbështetur në forcën «kolosale» të Kinës, me një fjalë në pikëpamjet



«marksiste-leniniste» të Mao Ce Dunit, për të cilat do të flas përsëri edhe më poshtë.

Mund të ketë dhe ka marksistë që, po t'ua shtrojnë kinezët çështjen kështu, do të mendojnë se arsyetimet e drejta e të shëndosha janë nga ana e shqiptarëve, por «Kina është Kinë, është një vend socialist me një potencial të madh ekonomik, njerëzor dhe ushtarak, si dhe me një influencë të madhe në botë, prandaj nuk duhet të dalim kundër Kinës», e të tjera arsyeime të kësaj natyre. Partia jonë, me qëndrimet e saj të drejta, Partinë Komuniste të Kinës duhet ta sjellë në debate ideologjike dhe në këtë fushë të demaskojë pikëpamjet e saj të gabuara. Vetëm nëpërmjet një lufte të tillë ideologjike, në rast se ka një shpresë, ne do të mund të ndihmojmë që Partia Komuniste e Kinës të shohë gabimet e saj. Në asnjë mënyrë nuk mund ta ndihmojmë Partinë Komuniste të Kinës ose ndonjë parti tjetër dhe as këto parti s'na ndihmojnë dot ne, në rast se nuk e hedhim debatin në platformën ideopolitike.

Kinezët do të përpiqen t'i ruhen një debati të tillë. Në fakt ata, edhe kur filluan luftën kundër revizionizmit hrushovian, ishin për shuarjen e polemikës. Kjo tendencë e tyre, për shuarjen e polemikës, tregonte se që në atë kohë kinezët nuk ishin të vendosur të luftonin devijimet që bëheshin nga teoria marksiste-leniniste dhe nga lufta për socializmin dhe komunizmin. Edhe aktualisht, kinezët, që janë autorë dhe udhëheqës të një rryme të re revizioniste në kushtet speciale të kësaj periudhe që shkaktoi tradhtia e revizionistëve hrushovianë, duan që të mos ketë polemikë. Pse? Sepse kjo i dëmton. Polemika zbulon para të gjithëve absur-

ditetet e tyre ideopolitike, prandaj ne duhet ta vazhdojmë polemikën parimore, e cila do të na çojë në kohën e duhur, të përshtatshme e dialektike, edhe në goditje më të hapëta.

Koha që ka kaluar nga Kongresi I 7-të, sido që është e shkurtër, vërtetoi drejtësinë e tezave të Partisë sonë për çështjen e «botës së tretë», vërtetoi, gjithashtu, edhe taktikat e gabuara antimarksiste të Partisë Komuniste të Kinës, të cilat synonin t'u impononin lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe popujve që luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar, strategjinë e tyre të «tri botëve».

Partia jonë ka qenë e pikëpamjes se, në situata të caktuara, mund të arrihet edhe në mbledhje shumëpartish dhe jo vetëm për mbledhje bilaterale. Këtë e ritheksoi edhe në Kongresin e saj të 7-të. Partia Komuniste e Kinës është kundër mbledhjeve të shumëpartive. Kjo ishte dhe është një taktikë e Partisë Komuniste të Kinës për arsye se, po të arrihet në një mbledhje të tillë, ka rrezik që strategjia e saj të atakohet. Prandaj, për të evituar këto mbledhje, Partia Komuniste e Kinës këtë taktikë e ngriti në teori. Kina është për vënien e tyre në gjumë nën hegjemoninë e Partisë Komuniste të Kinës. Qëndrimi i Partisë sonë u vërtetua se ishte shumë i drejtë dhe i dobishëm.

Mitingjet e organizuara nga disa prej partive marksiste-leniniste, qoftë në Gjermaninë Perëndimore, në Itali ose në Portugali e gjetkë, kanë bërë një efekt të madh në elementët revolucionarë. Ato u kanë dhënë komunistëve zemër e besim në forcën e partive të tyre, në forcën e marksizëm-leninizmit dhe kanë krijuar

mes tyre një unitet luftarak aq shumë të nevojshëm për lëvizjen komuniste ndërkombëtare në këto kohë të vështira, kur kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit dhe proletariatit janë ngritur forcat e egra të errësirës, të kapitalizmit dhe të reaksionit. Pra, teza e Kongresit tonë është e drejtë, teza e Partisë Komuniste të Kinës është e gabuar.

Marksistë-leninistët duhet të ruhen po ashtu nga taktika djallëzore e stërholluar që përdorin e mund të përdorin kinezët dhe adeptët e tyre, sipas së cilës partitë marksiste-leniniste të futen në një luftë shterpë mes tyre dhe të harrojnë luftën që duhet të bëjnë në krye të proletariatit e të popujve për përgatitjen e revolucionit dhe për çlirimin e popujve. Objektivat dhe përpjekjet e partive marksiste-leniniste duhet të synojnë në përgatitjen e revolucionit dhe në çlirimin e popujve, gjë që do të thotë se lufta e tyre duhet të jetë luftë kundër luftënxitësve imperialistë: imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe gjithë kapitalistëve të tjerë që janë të inkuadruar me njërin ose me tjetrën superfuqi.

Lufta e partive tona, si dhe polemika kundër deviatorëve të marksizëm-leninizmit, kundër ideologëve të borgjezisë, në asnjë mënyrë dhe në asnjë moment nuk duhet të shkëputet nga lufta kundër dy superfuqive dhe borgjezisë kapitaliste botërore. Kinezët, të cilët predikojnë unitetin e proletariatit me borgjezinë kapitaliste dhe me imperializmin amerikan kundër socialimperializmit sovjetik, në një kohë të favorshme për ta, fare lehtë do të kërkojnë ta devijojnë luftën tonë në një luftë shterpë.

Le të marrim shembullin e luftës së grupazheve para formimit të Partisë sonë. Këto bënëin gjoja një luftë ideologjike me njëri-tjetrin, por kjo ishte një luftë shterpë që nuk i shërbente as luftës kundër Zogut, as krijimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Kur filloi lufta jonë për të formuar Partinë, clementët grupashë dolën me tezën se nuk duhej formuar Partia, domethënë nuk duhej krijuar uniteti i komunistëve, pse në Shqipëri gjoja nuk ekzistonte proletariati dhe, meqenëse nuk ekzistonte proletariati, ne duhej ta prananim pushtimin italian, i cili, sipas këtyre elementëve, do të bënte investime, do të ndërtonte fabrika, do t'i zhvillonte minierat dhe atëherë ne do të kishim një proletariat. Vetëm atëherë, sipas tyre, shtrohej detyra e krijimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë, pararoja e proletariatit. Pra, për analogji, pikëpamja oportuniste e kinezëve për të sabotuar, nëpërmjet teorisë së «tri botëve», luftën revolucionare dhe unitetin e partive marksiste-leniniste, ka për qëllim t'i lërë në harresë, për një kohë, divergjencat e papajtueshme mes proletariatit dhe borgjezisë, mes shteteve të «botës së tretë» e atyre të «botës së dytë» dhe të predikojë që, të gjithë së toku, të luftojnë imperializmin sovjetik si «armikun kryesor», pastaj të mendojnë për revolucionin.

Revolucioni, sipas oportunistëve kinezë, do të bjerë si fiku i pjekur që bie nga dega. Edhe kësaj taktike djallëzore ne duhet t'i ruhem dhe ruajtja nga kjo taktikë konsiston në shtruarjen dhe në thellimin e tezave të drejta të Kongresit të 7-të të Partisë sonë.

Aktualisht kinezët në platformën ndërkombëtare bëjnë një luftë që disa herë të jep përshtypjen sikur

ata nuk janë të zotë. Kjo nuk duhet menduar kështu. Është e vërtetë se ata janë në vështirësi të mëdha, por budallenj nuk janë. Për rrugën revizioniste që kanë nisur, kinezët përpiqen të gjejnë ose të ndërtojnë strategjinë dhe taktikat e tyre. Për sa i përket strategjisë, kjo është përcaktuar nga ata, por në taktika akoma kanë ngurrime dhe pikërisht këto hezitime të tyre të lënë të mendosh se nuk janë të zotët. Por jo, ne nuk duhet të mendojmë kështu, përkundrazi, të mendojmë se ata janë në kërkim të taktikave të ndryshme për këtë ose për atë problem. Është pikërisht kjo që mund të të bëjë të krijosh një përshtypje të gabuar, e cila të vë në gjumë, prandaj po e theksoj këtë gjë.

Nga ana tjetër, duhet të kuptojmë se udhëheqësit aktualë kinezë që kanë marrë fuqinë në dorë, kanë nëpër këmbë probleme të vështira për të zgjidhur dhe për të likuiduar, gjë që nuk është aq e lehtë të bëhet brenda një kohe shumë të shkurtër. Nuk është aq e lehtë për ta që të përcaktojnë masat e përshtatshme për strategjinë që kanë vendosur, por që akoma nuk e kanë konkretizuar. Këtu duhet të kemi parasysh që kinezët nuk bëjnë atë që thonë. Në fakt ata ndryshe mendojnë dhe ndryshe veprojnë. Në një moment një çështje e shpjegojnë kështu, në një moment tjetër e shpjegojnë ndryshe. Nuk gjen në ta një logjikë e një analizë të shëndoshë të gjërave, të ideve, të problemeve, të zgjidhjeve të tyre, por shikon një eklektizëm të theksuar.

Ky eklektizëm i theksuar përfaqësohet nga Maoja, për të cilin nuk mund të themi se nuk ishte një teoricien e se nuk ka qenë një mendimtar. Ai ka qenë një

mendimtar dhe filozof, por jo filozof marksist-leninist. Gjatë gjithë jetës së tij Mao Ce Duni ka mundur të ndërtojë një teori, e cila huazonte nga marksizmi, dhe një praktikë që u përshtatej qëllimeve të tij. Ai thellonte disa mendime të mendimtarëve të mëdhenj, por u shtonte ose u adaptonte këtyre mendimeve edhe veprimet e mendimet e tij të veçanta jomarksiste dhe kështu arriti të krijonte një hibrid, që u quajt marksist-leninist, maocedunidenë, autori i së cilës, Mao Ce Duni, ishte një «marksist-leninist i shquar» që «e zhvillonte marksizëm-leninizmin në kushtet e Kinës». Mirëpo nuk është ashtu. Teoria e Maos është një amalgamë e mendimeve marksiste dhe idealiste borgjeze, të cilën rrethanat e nxorën si një variant të marksizëm-leninizmit purist, por që në fakt nuk ishte purist. Purist nuk do të thotë dogmatik, as sektar; maoizmi ishte një amalgamë oportuniste, një djathtizëm i teorisë marksiste-leniniste. Kina si një vend i madh, Lufta e Dytë Botërore, lufta nacionalçlirimtare dhe revolucionin kinez, i udhëhequr nga Partia Komuniste e Kinës dhe nga Maoja, ia ngritën këtij emrin si një teoricien marksist-leninist.

Tash udhëheqja aktuale kineze është në dilemë: Ta mbajë ngritur flamurin e Maos, apo ta rrëzojë këtë flamur dhe të ngrejë në vend të tij një flamur të ri. Në këtë çështje në udhëheqjen aktuale kineze duhet të ketë debate, përleshje e kontradikta të mëdha. Një nga ata që mendojnë se duhet mbajtur flamuri i Maos, është Hua Kuo Feni me gjithë grupin e tij, kurse Ten Hsiao Pini mendoj se është për rrëzimin deri në njëfarë shkalle të flamurit të Mao Ce Dunit, pse ky flamur

ka goditur shokët e miqtë e Tenit dhe këtë vetë. Për këtë arsye Ten Hsiao Pini nuk do të ecë plotësisht në rrugën dhe në mendimet e Mao Ce Dunit, teorinë e të cilit asnjë nga të dyja palët nuk e do, jo pse është një teori marksiste-leniniste, por se në atë grumbullim idesh, që thashë më parë, ka çështje që nuk u leverdisin. Por teoria e Maos ka edhe çështje që i leverdisin udhëheqjes së re. Kësaj i leverdis sidomos ajo që «idetë» e Mao Ce Dunit kanë një influencë në botë. Këtë ata duan ta ruajnë, me qëllim që të ruajnë dhe të shtojnë influencën e tyre për interesin e një shteti të madh kinez.

Në praktikë s'ka asnjë dyshim se udhëheqësit aktualë kinezë do të bëjnë devijime nga maocedunideja. Pikërisht këto devijime ata janë duke i studiuar dhe duke i zhvilluar. Për këtë arsye edhe ne duhet të ndjekim me vigjilencën dhe me kujdesin më të madh taktikat e kinezëve në luftën kundër marksizëm-leninizmit, në përpjekjet që bëjnë për të zbatuar vijën e tyre të gabuar, por që orvaten ta kalojnë si një teori marksiste-leniniste. Ne duhet të ndjekim me kujdes, gjithashtu, format dhe luftën e tyre për grumbullimin e njerëzve e të shteteve sipas orientimeve të tyre specifike dhe të mbajmë qëndrimet tona të drejta për çdo çështje.

Është detyra jonë t'u japim të kuptojnë partive marksiste-leniniste dhe atyre që kanë mundësi të na dëgjojnë se kjo është një luftë e madhe, për fitoren e së cilës Partia e Punës e Shqipërisë jep në mënyrë modeste kontributin e vet. Por duhet të jenë të qartë të gjithë revolucionarët, të gjitha partitë e vërteta

marksiste-leniniste për rrezikun që kërcënon revolucionin dhe mbarë botën nga një luftë bërthamore dhe nga një shtyrje në kalendat greke të revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

I thashë Ramizit se këto mendime, natyrisht, të koncentruara në formë teorike, duhet të përmbliidhen në artikullin që kam rekomanduar të bëhet. Po ashtu ne duhet ta demaskojmë me artikujt tanë vijën kineze si një vijë revizioniste, oportuniste, që i përngjet asaj të revizionizmit hrushovian, pjesë përbërëse e strategjisë së revizionizmit modern. Ne duhet t'i zbulojmë pikat kryesore të çështjeve ku pëрпиqen të mbështeten këta lloj revizionistësh për të shtjelluar strategjinë e tyre kundërrevolucionare.

Hrushovianët u mbështetën në çështjen e epokës së ashtuquajtur atomike, të rrezikut të madh të një lufte bërthamore. Natyrisht, për këtë ata u përgatitën dhe po përgatiten çdo vit e më shumë, por për demagogji nuk mohuan se ekziston epoka e revolucioneve, megjithëse teoria e tyre konsistonte pikërisht në shuarjen e revolucionit. Kjo është një pikë e tyre e përbashkët me maoistët. Për ta shuar revolucionin hrushovianët predikuan bashkëzistencën paqësore, paqen sociale, unitetin mes proletariatit dhe clementëve gjoja të majtë të borgjezisë për të marrë pushtetin në rrugët evolutive, demokratike, parlamentare etj. Nga ana tjetër, e gjithë kjo shërbente për forcimin akoma më shumë të Bashkimit Sovjetik si një fuqi socialimperialiste, për mbajtjen nën drejtimin e tij dhe nën maskën e Traktatit të Varshavës të të gjitha vendeve të ish-demokracisë popullore. Hrushovianët u përpoqën



t'ia impononin këtë vijë gjithë lëvizjes komuniste ndër-kombëtare. Tashmë ne i dimë të tëra peripecitë e kësaj pune.

Të vijnë tash te revizionistët kinezë. Edhe këta e mohojnë epokën e revolucioneve, bile nuk flasin as për revolucionet demokratiko-borgjeze dhe as për reformat që duhet të bëjnë demokracitë borgjeze. Përkundrazi, për t'u bërë superfuqi, revizionistët kinezë janë inkua-druar në të ashtuquajturën botë e tretë, të cilën e konsiderojnë si «forcën më të madhe lëvizëse të historisë së epokës sonë». Me një fjalë, ata i heqin vijë revolucionit, i heqin vijë proletariatit si hegjemon në revolucion, u heqin vijë partive marksiste-leniniste dhe luftojnë që pikëpamjet dhe strategjia e tyre të adoptohen nga të gjithë marksistë-leninistët në botë dhe, të tërë së toku, marksistë, reaksionarë, borgjezë, kapitalistë e revolucionarë, të bashkohen në një front me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të luftojnë socialimperializmin sovjetik.

Unë nuk do të zgjatem në këtë çështje, por dua të theksoj se ka shumë pika të tjera të përbashkëta midis revizionizmit sovjetik edhe revizionizmit kinez. Duhet të kemi parasysh që revizionizmi kinez po zhvillohet në një periudhë kur para tij revizionizmi modern sovjetik goditi rëndë në një pjesë të madhe të botës, në Bashkimin Sovjetik, pastërtinë e marksizëm-leninizmit, rendin socialist dhe e zëvendësoi me një rend fashist kapitalist. Megjithatë revizionizmi modern sovjetik vazhdon të maskohet me parullat leniniste. Kjo nuk do të thotë se revizionizmi sovjetik nuk është demaskuar plotësisht. Bota, popujt, revolucionarët dhe

marksistët e vërtetë shikojnë se Bashkimi Sovjetik është kthyer në një superfuqi që po ecën drejt hegjemonisë botërore në luftë me imperializmin amerikan, i cili, gjithashtu, lufton për hegjemoninë botërore.

Në këto situata po nxjerr krye revizionizmi kinez.

*Marrë nga libri:*

*Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare», (botim i brendshëm), nr. 9, f. 213*

# STUDIMET T'I NËNSHTROHEN NJË DISKUTIMI SHKENCOR

Shënime

18 maj 1977

Lexova një studim të një inxhinieri të naftës për zonat me presione anormale dhe për perspektivat naftëmbajtëse të tyre. Në këtë material ai thotë se ne jemi larguar nga zonat me presione anormale, në vend që të insistojmë në këto zona, ku, sipas tij, ka naftë në sasi kolosale dhe gaz pa hesap. Gjithashtu, në të thuhet edhe se ne kemi takuar në zona me presione anormale, bile kemi marrë edhe gaz. Inxhinieri flet kryesisht për bregdetin, por bën fjalë edhe për në thellësi të vendit, ku ndodhet nafta jonë.

Lidhur me këto ne, pa bujë, duhet të bëjmë një konsultë me gjeologë dhe me inxhinierë të naftës. Por të mos mblidhen 60-70 veta për ta diskutuar problemin, pse kjo, mendoj unë, nuk do të japë rezultate, por konsulta të bëhet me një grup më të vogël specialistësh seriozë dhe të rrihet ky problem, që, në fakt, nuk është i panjohur. Unë nuk jam shumë i bindur për atë që specialistët e naftës janë larguar nga zonat e presioneve të larta ose shumë të larta, në një kohë kur

i kemi mundësitë, i kemi sondat e nevojshme dhe mund të bëjmë kërkime në zona të tilla. Në këto kërkime, natyrisht, duhet një kujdes edhe më i madh. Por praktika tregon se edhe kur janë takuar të tilla shtresa me presion të lartë, për të cilat bën fjalë ky specialist, ka dalë ujë. Natyrisht, edhe ujë mund të dalë, por, sipas këtij specialisti, ne duhet të shkojmë edhe më thellë se uji, ta kapërcejmë shtresën e tij etj. Për këtë qëllim duhet shfrytëzuar literatura teknike e sotme dhe duhet mbështetur në të.

Sidoqoftë, ky studim ka rëndësi, e cila qëndron në atë që autori i saj shpreh disa pikëpamje, të cilat duhet të diskutohen. Ne duhet të bëjmë edhe disa shpime dhe të ngulim këmbë edhe në këto struktura me presione anormale, pse luftojmë pikërisht për nxjerrjen e naftës. Por vetëm se vërejtja ime është që ne nuk duhet të entuziazmohemi e të kalojmë në eufori nga disa propozime dhe të shkojmë me mendimin se, meqë një inxhinier dha një mendim të bazuar në literaturë, duhet të mendojmë se do të gjejmë patjetër naftë në sasi kolosale. Ne për këtë përpiqemi, të gjejmë një pasuri të tillë, por çështja është që të mos humbasim sensin shkencor e të jemi të kujdesshëm ndaj këtyre problemeve, të bëjmë studime, të bëjmë edhe kërkime, por të mos e shesim lëkurën pa vrarë më parë ariun. Pse e them këtë? Sepse na ka ngjarë që, kur në sektorin e naftës nuk kemi pasur sukses, se na sabotonin, na sillnin lloj-lloj teorish dhe na tororisnin me shpresa. Shpresa ne të kemi, po këto duhet t'i mbështetim shkencërisht, çdo gjë është e mundshme të ndodhë, po edhe çdo vërtetim është i nevojshëm të

bëhet. Pra, as skeptikë të mos jemi, por as të fluturojmë pa të dhëna gjeologjike dhe shkencore.

Zbulimi i naftës është mjaft i komplikuar dhe gjeologët e inxhinierët tanë kanë mendime për të. Çështja është që këto mendime të tyre të konkretizohen nëpërmjet studimeve, të dhënave e diskutimeve shkencore, të përcaktohen disa masa dhe, pasi të zbatohen ato, të shohim rezultatet e tyre.

Të mos harrojmë, për shembull, përvojën e hidhur që kemi në harxhimin e baritit, i cili përdoret vetëm për të kundërbalancuar presionin e gazit ose të naftës, pra, për të evituar çdo rrezik. Në qoftë se është përdorur bariti pa u studiuar më parë hedhja e tij, dua të them presionet e takuara (dhe të studioheshin këto presione pse ishin, nga ishin e ç'përfaqësonin), atëherë vërtetohet akoma më mirë edhe sabotimi që na kanë bërë armiqtë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# SHKENCA ETNOGRAFIKE TË BËHET NJË PASQYRË E SHKËLQYESHME E KULTURËS SONE POPULLORE

*Nga biseda gjatë vizitës në ekspozitën etnografike  
«Kultura popullore shqiptare»<sup>1</sup>*

23 maj 1977

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet, shokë, mirë? E di që po vij ca me vonesë për të vizituar këtë ekspozitë të bukur, por kam qenë i zënë me punë.

*Shokët Aleks Buda e Stefanaq Pollo e informuan shokun Enver Hoxha për punën që u bë për hapjen e ekspozitës etnografike dhe i dhanë shpjegime për objekte të ndryshme në stendat e në pavijonet e ekspozitës.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo është një punë me vlerë e me rëndësi të madhe.

Numri i simpatizantëve për etnografinë tonë është shtuar shumë. Një rol të madh në këtë drejtim luajnë

---

1. Kjo ekspozitë u hap me rastin e Konferencës së Studimeve Etnografike. Në të u pasqyrua një numër i vogël objekteve e ekspozitave në krahasim me atë pasuri shumë të madhe që është grumbulluar në popull e që arrin në rreth 27 000 objekte etnografike.

botimet dhe ekspozimet në këtë fushë, prandaj, sa më shumë të shtohet numri i këtyre, aq më i madh do të jetë edhe interesimi brenda dhe jashtë vendit për etnografinë e, në përgjithësi, për historinë e vendit tonë. Të huajt kanë një respekt të madh për ne dhe aktualisht në botë është krijuar një situatë shumë e favorshme për Shqipërinë, për historinë, për kulturën dhe traditat e saj. Disa nga botimet tona etnografike janë pëlqyer jashtëzakonisht dhe ka mjaft kërkesa për to. Mendoj se të tilla botime mund të konsiderohen si koleksionet më të mira në etnografi.

Ja, një banesë e tipit kullë që është në fotografi! Shikoni, ka gjë më të bukur se kjo? Bën shumë mirë Dritëro Agolli që vete tamam në këto qoshe e shtëpi, njihet nga afër me vendin, traditat e natyrën e pastaj, me origjinalitet të madh, shkruan poczi aq të bukura. Vendi ynë është i bukur, por këtë bukuri duhet ta njohësh, ta studiosh, që ta pasqyrosh me vërtetësi.

**SHOKU STEFANAQ POLLO:** Në stendën që është pak më tutje fshatrat i kemi të klasifikuara sipas qendrës së tyre. Diku në qendër të fshatit ka qenë rrapi, diku xhamia, diku kisha etj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Qendrat e fshatit kështu kanë qenë, me këto pamje që tani kanë mbetur në histori, si kishat dhe xhamitë, por nga ndërgjegjja jonë ato duhet t'i zhdukim plotësisht.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Në rrethanat e pushtimit osman, të dhunës, të padrejtësive e të terrorit, fshatrat largoheshin nga rruga e nga «hyqymeti», siç i thoshin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, kështu ka ndodhur, largoheshin edhe për shkak të pushtuesve.

Këtë kasollen e blegtorit e keni përgatitur mirë.  
Ju lumtë!

**SHOKU STEFANAQ POLLO:** Kjo pamje nga blegtoria, shoku Enver, shoqërohet edhe me fjalët e arta të Naimit:

«O, sa bukuri ka tufa, sa gaz bie bagëtia!», ndërsa këta tinguj që po dëgjojmë tani nga altoparlanti, janë regjistrime origjinale të bëra në kopetë e dhenve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë bukur! Ja, dëgjohen edhe të lehurat e Balos. Baloja në kohën e luftës na bënte goxha punë. (*Të qeshura.*)

**SHOKU ALEKS BUDA:** Këto lugë të drunjta në sofër të kasolles së bariut, të punuara e të gdhendura, i keni përmendur edhe ju, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne, Aleks, që jemi një çikë të moshuar, kemi ngrënë me lugë të tilla, kurse këta më të rinjtë, jo. Këta kanë përdorur dhe përdorin lugë prej alumini e të nikeluara. Ky këtu është helli.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Siç dihet, shoku Enver, kudo në vendin tonë karakteristikë është ndërtimi i shtëpive me mur guri. Një gjë e tillë tregon një traditë të lashtë mesdhetare, që është ruajtur mirë në popull, kurse po të shkosh brenda Ballkanit, si për shembull, në zonat sllave, vë re se karakteristikë është ndërtimi i banesave prej druri.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo gjë, besoj unë, është bërë edhe për shkak mbrojtjeje, edhe për çështje tradite. Pastaj, guri është i fortë, ruan edhe temperaturën e ngrohtë. Kjo shtëpi e ndërtuar me gurë duket tamam si një kështjellë e fortë.

Kur udhëtoj dhe shikoj fshatrat rrëzë maleve ose



fushave të gjelbëruara, them me vete: «Ja, atje dua të futem, të futem dhe të mos më gjejë njeri, të rri atje nja 15 ose 20 ditë!». (Të qeshura.)

Kurse këto janë djepe, në të cilat janë përkundur gjithë ata breza! Sa bukur janë punuar! O! Shiko, shiko sa bukur!

**SHOKU STEFANAQ POLLO:** Kjo është xhubleta, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sigurisht, ju e keni lexuar librin e Majanit, për vërtetësinë shkencore të të cilit nuk kam ndër mend të diskutojmë, por, në qoftë se e keni lexuar me kujdes, do t'ju kujtohet kur ai flet për një pjesë veshjeje etruske që e barazon me xhubletën tonë. Me të vërtetë ngjashmëria midis tyre është aq e madhe, sa të duket sikur ajo lloj veshjeje është një xhubletë e sotme, e prerë në kohët e atëhershme.

Kam lexuar diku në një shkrim se fustanella jonë ka qenë e gjatë dhe grekët e kanë shkurtuar. Bile tashti vonë edhe ne e kemi shkurtuar ca në krahasim me atë të kohëve të para. Aktualisht ekzistojnë te ne dy lloje fustanellash: të gjata dhe të shkurtra.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Fustanella jonë është dokumentuar historikisht qysh në kohë shumë të lashta; me emigracionin e madh të arbëreshëve ose arvanitasve, që u zhvillua në shekullin e 14-të, sidomos në ato zona ku u shtri kjo popullsi, u përhap edhe fustanella dhe prej këtej ajo pastaj kaloi më tej në Greqi. Kjo është arsyeja që fustanella jonë gjendet edhe te grekët, edhe në zona të tjera.

**SHOQJA NEXIMIJE HOXHA:** Kurse te ne ka

njerëz që mendojnë se këtë veshje e kemi marrë nga grekët.

*SHOKU ALEKS BUDA:* Po, po, kështu mendojnë. Ja, për shembull, ajo që ne e quajmë veshje të grave dropullite, në fakt është një veshje me rrënjë të lasha-ta në traditat etnografike shqiptare. Në vetë Greqinë ajo përdoret edhe në viset ku banojnë arvanitas.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Unë kam disa libra historikë të profesorëve të Athinës, të cilët ka kohë që janë shkruar. Në ta flitet për ne, dhe flitet me simpati të madhe, për rolin dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në Revolucionin e 1821-shit që u bë në Greqi. Në ta ka edhe dokumente që tregojnë se si Ipsilanti u bënte thirrje shqiptarëve: «Ngrihuni, shqiptarë, të bashkohemi kundër Perandorisë Osmane!».

I përmenda këto për të theksuar se në Greqi ka njerëz përparimtarë e të ndershëm. Kemi të dhëna se filmat tanë që janë shfaqur atje, janë pritur mirë. Në kinematë ku shfaqen ata, krijohet radhë e madhe njerëzish, që duan t'i shohin. Kjo, pa dyshim, është edhe një meritë e kineastëve tanë. Por unë mendoj se për studimet tuaja duhet të bëhen më shumë përpjekje që të njihen në botën e jashtme. Për këtë të përgatitim përkthyes të aftë e të mos presim që një punë të tillë ta bëjnë të huajt. Ne duhet të kemi përkthyesit tanë, me qëllim që veprat tona më të mira të përkthehen dhe të shtypen në vendin tonë. Kështu do të mund t'i bëjmë më të njohur zhvillimin, historinë dhe kulturën tonë në botën e jashtme.

Këto ditë lexova në «Zërin e popullit» artikullin e profesor Eqrem Çabejt që fliste për arbëreshët. Ishte

me të vërtetë një artikull shumë interesant. Të bën përshtypje fakti që vë në dukje Çabej në këtë artikull: të rinjtë arbëreshë të Universitetit të Kozencës janë më të hedhur e më aktivë për adaptimin e kulturës sonë të re, të gjuhës sonë të sotme në kulturën tradicionale arbëreshe. Atje po ndodh, në qoftë se mund të shprehem kështu, njëfarë rilindjeje, një përtëritje e gjallërim i dashurisë për mëmëdheun. Interesat e mëdhenj të vendit tonë kërkojnë që traditat e të gjitha tiparet e kulturës sonë popullore të ruhen jo vetëm te shqiptarët, por edhe tek arbëreshët, të krijohen tek ata një opinion i shëndoshë, një dashuri dhe respekt për Shqipërinë socialiste, për kulturën tonë, me qëllim që t'i kemi sa më afër.

Ja dhe Berati! Sa i bukur është! Si thoni ju? Shumë i bukur është! Por edhe Përmeti yt, Stefanaq, është i bukur.

Në qoftë se nuk gabohem, këtë lloj mulliri e ka pasë përdorur Mati. Mullinj me ujë kemi pasur që në ato kohë, kurse mullinj me erë ne nuk kemi pasur. Por ama edhe Don Kishot populli ynë nuk ka qenë. (Të qeshura).

Për kalldrëmin, Stefanaq, nuk mund të thuash që nuk është gjirokastrit, se duke ecur në këto rrugë në të ritë e mi, më janë grisur sa e sa herë këpucët dhe kisha gjetur belanë nga mëma: «More derëzi, më thoshte, i grise këpucët!». Dhe këpucët ne i kishim me proka, kaq të mëdha i kishim ato. (Të qeshura.)

Kurse këto kostume këtu i kemi të bukura shumë, tamam si piktura janë!

**SHOKU SPIRO SHKURTI:** Ne kemi mundur, sho-

ku Enver, të dokumentojmë rreth 140 lloje kostumesh të popullit tonë.

*SHOKU ENVER HOXHA*: 140 janë origjinale, se pastaj ka kombinime sa të duash, besoj. Natyrisht, ky fond duhet të përmirësohet, të përmirësohen kushtet e ruajtjes dhe të mbajtjes së tyre dhe nuk duhet të nisemi nga mendimi që këto nuk japin bukë. Objektet që dokumentojnë kulturën e popullit japin shumë bukë, ato përbëjnë një thesar me vlerë për kombin, prandaj duhet të ruhen me kujdesin më të madh dhe, me të parë që në to është shfaqur një molë apo ndonjë dëm-tues tjetër, ta luftoni menjëherë.

Po këto, Stefanaq, ç'janë?

*SHOKU STEFANAQ POLLO*: Këto janë anije, anije ulqinake.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Ndërtonte populli ynë të tilla anije?!

*SHOKU ALEKS BUDA*: Po, po, shumë zona të vendit tonë njihen si kantiere detare për ndërtimin e anijeve që në shekullin e 14-të, para pushtimit osman. Një zonë e tillë ka qenë edhe në grykën e Vjosës, një në Himarë, një në ishull dhe një tjetër ndodhej në fillim të grykës së Bunës.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Stalini më tha njëherë: «Ndërtoni anije ju?».

«Jo», i thashë.

«Po pse, — vazhdoi të më pyeste ai, — nuk keni pisha?».

«Kemi, — i thashë, — pyje të tëra, po anije nuk ndërtojmë». Kurse tashti mësoj që ne e paskemi pasur traditë ndërtimin e anijeve dhe çfarë anijesh pa!

Luftërat e njëpasnjëshme, mendoj unë, e detyronin popullin tonë të futej vazhdimisht në thellësi të maleve e të luginave dhe kjo bëri që ai ta braktiste dalngadalë ndjenjën e dashurisë për detin. Por detin, shokë, duhet ta duam, ta forcojmë dashurinë për të, dashuri që i ka rrënjët të thella në shekuj. Edhe në kohët tona ka rëndësi të madhe jetike për ne.

**SHOKU STEFANAQ POLLO:** Ky është një oborr gjirokastrit me shtëpi gjirokastrite.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Karakteristikë e shtëpive gjirokastrite është që këto janë të larta e të forta si kështjella. Pa hajde të ikim prej këtej, se mos na thoni që jemi «lokalistë». (Të qeshura.) Sidoqoftë, hajdeni të rrimë një çikë këtu, në minderet e kësaj dhome, hajdeni ju, Ramiz, Nexhmije, ejani të ulemi pak. Ambiente të tilla të ngjallin kujtime të bukura.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Populli ynë para shekullit të 15-të nuk ka pasur ato kushte të vështira primitive që kishte në shekullin e 17-të e të 18-të, kushte të tërheqjes e të luftës së vazhdueshme kundër pushuesit, që e primitivizuan jetën e tij të përditshme materiale, mënyrën e banimit etj., kushte që e shpunë deri atje, sa të rrijë në rrogë, por ama sjelljen, burrërinë e të tjera tipare si këto, ai i mbajti gjithmonë lart.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Bujarinë, burrërinë, mikpritjen, të gjitha këto tipare populli ynë i ka ruajtur dhe këtë nuk e themi vetëm se jemi bijtë e tij, por sepse kjo është një e vërtetë për të cilën jemi bindur akoma më shumë kur kemi pasur rastin të njohim popuj të tjerë. Në Francë kam vizituar fshatra të ndryshme, kam lexuar edhe për historinë e traditat e popujve të tjerë

dhe kam parë se sa lart qëndron populli ynë për sa u përket këtyre tipareve. Por edhe nga ana kulturore, dhe ju jeni më mirë në dijeni për këtë, në popullsinë fshatare të vendeve të tjera ekziston një prapambetje e madhe, megjithëse në përgjithësi ato janë vende të qytetëruara, ku shkenca, arti, kultura etj. kanë bërë përparime të mëdha.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Në ato vende ka zhvillim të madh, po edhe kontrastet janë të mëdha.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, ashtu është, janë vende me kontraste të theksuara në thellësi të tyre. Në zonat fshatare ka prapambetje të madhe në popull, në të gjitha fushat e zhvillimit të jetës.

*SHOKU ALEKS BUDA:* Unë mbaj mend që, kur kam ikur nga Austria më 1938, në një distancë jo më shumë se 80 km nga kryeqyteti, në zonën e Vjenës, shtëpitë ishin pa dritë elektrike.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ashtu është. Kurse ne brenda një kohe shumë të shkurtër e elektrifikuam gjithë vendin.

Thuhet që fshatarët tanë flinin tok me bagëtitë. Po edhe në Francë, në ferma, mos jetonte më ndryshe fshatari? Jo, tok me bagëtitë flinte edhe ai.

*SHOKU MANUSH MYFTIU:* Edhe në Romë ka pasur raste që në shtëpi, poshtë në pjesën përdhese ose në anën tjetër të saj, njerëzit mbanin bagëtitë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* (*Duke kaluar në pavijonin e artit popullor*): Mendoj që traditën e pikturës qeramike kemi mundësi ta zhvillojmë më tej. Edhe sot ne duhet të nxjerrim prodhime të bukura qeramike, siç i ka bërë populli ynë në të kaluarën. Për këtë del e

nevojshme që në shkollën artistike të krijohet një sektor i specializuar për këtë lloj pikturë. Në shkollat tona duhet të bëhen vizatime e piktura të tilla që të paraqesin jetën dhe kulturën e popullit. Ja, për shembull, vajzat e Kavajës, siç i kemi parë të gjithë, bëjnë vizatime shumë të bukura në qelq.

Të gjitha këto që shikojmë këtu, janë punime shumë të bukura. Ja dhe lahuta. Sa më pëlqen kur shikoj në televizor malësorët tanë që i bien lahutës, në të cilën është gdhendur aq bukur e me mjeshtëri të rrallë përkrenarja e Skënderbeut!

**SHOKU STEFANAQ POLLO:** Punimet në dru përfaqësojnë një nga degët e traditës sonë, atë të gdhendjes së drurit, e cila, meqë ushtrohej nga mjeshtrit dibranë, ka marrë emrin «shkolla e Dibrës».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Rri, mos e thuaj «e Dibrës», se u rritet mendja Xhelil Gjonit e Nexhmijes. *(Të qeshura.) (Duke treguar shoqen Nexhmije që po vizitonte ambientin ku ishin ekspozuar punimet e drurit):* Pa shiko Nexhmijen, u fut e të duket sikur s'ka ndër mend të largohet që andej. *(Të qeshura.)*

**SHOKU ALEKS BUDA:** Dibranët artin e punimit të drurit e kanë përhapur jo vetëm në gjithë Shqipërinë e në Greqi, por edhe rreth e qark saj, në Ballkan e në vende të tjera të botës, si për shembull, në Hungari.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mua më ka bërë përshtypje të madhe ikonostasi i kishës së Voskopojës, që patjetër e keni parë. Ai është me të vërtetë shumë i bukur. Ruhen mirë objektet artistike të kësaj kishe dhe ato të të tjerave, apo jo? Ato duhen ruajtur e mi-

rëmbajtur, se i përkasin thesarit të artit popullor antik e nuk janë më objekte fetare.

Unë nga Leusa kam kujtime të mira. A e dini nga më vijnë këto kujtime? Nga Epaminonda Bulka, se nga Leusa ishte. Nonda që njeri i mirë, i dashur, optimist dhe demokrat, pastaj ai bëri përparime dhe u lidh ngushtë me Partinë e me popullin. Kam fjetur në internatin e Korçës tok me të në një dhomë. Që në atë kohë Nonda bënte poezi të mira. Dritëroi ishte i vogël atëherë, mbase dhe nuk kishte lindur akoma. *(Të qeshura.)*

Me të tëra këto vegla të muzikës popullore, që shikojmë këtu të ekspozuara me kujdes, populli ka mbajtur e ka zhvilluar folklorin e tij brez pas brezi. Tash Partia i ngriti folklorin dhe muzikën popullore në një shkallë aq të lartë, sa jam i bindur që populli për këtë ndien një kënaqësi të jashtëzakonshme.

Ne i admirojmë edhe muzikën e huaj përparimtare dhe kompozitorët e mëdhenj të vendeve të tjera, sepse nuk jemi ksenofobë, por, në të njëjtën kohë, nuk jemi që kjo muzikë të errësojë muzikën tonë, të pengojë shfaqjen dhe zhvillimin e saj. Shumë nga kompozitorët tanë, të frymëzuar nga muzika jonë popullore, kanë bërë vepra të bukura.

Unë po i ndjek çdo mbrëmje me kënaqësi të veçantë Koncertet e Majit. Këngët popullore më pëlqejnë shumë, por edhe pjesët orkestrale nuk më pëlqejnë më pak. Më kanë kënaqur veçanërisht formacionet e mëdha orkestrale të fëmijëve, ekzekutimet në violinë e në vegla të tjera muzikore. Në një nga këto koncerte një violinist ekzekutoi një pjesë që me të vërtetë më preku. Ekzekutimi i tij më pëlqeu shumë, sepse bëjmë edhe



krahasime dhe vëmë re se sot te ne punohet mirë në drejtim të talenteve të reja.

Nuk flasim si kritikë në këtë apo në atë fushë të shkencës e të artit. Jo. Këtë punë ua lëmë specialistëve ta gjykojnë, por shprehim vetëm ndjenjat tona për të bukurën që shohim, që dëgjojmë dhe lexojmë.

*SHOKU ALEKS BUDA:* Meqenëse e prekët këtë çështje, shoku Enver, doja të thosha se në ekzekutimet e valleve tona ka dinamizëm, ka «zjarr», por mendoj se nganjëherë një gjë e tillë është e tepërt dhe jo karakteristike për vallet tona shqiptare.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Ashtu është, ka dinamizëm të tepërt që në fillim të valles.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mirë bërë, Aleks, që e the këtë; është një vërejtje e drejtë, prandaj shokët që janë këtu, duhet ta kenë parasysh. Të rinjve u pëlqejnë këto valle, por mua më pëlqen më mirë vallja myzeqare, se është një valle e shtruar. Më pëlqen, gjithashtu, devolliçja. Janë valle shumë të lezetshme këto, apo jo?

Akademia ka bërë një punë të mirë edhe për studimin e kulturës popullore. Tash ajo ka gjithë këta sektorë të ndryshëm që kanë arritur suksese, por jepuni një gjallëri dhe një hov të mëtejshëm, që të ecin akoma më përpara.

*SHOKU ALEKS BUDA:* Ku kemi qenë më 1948, kur hapëm muzeun e parë, të cilin e vizituat dhe ju, shoku Enver, e ku jemi tani!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Janë bërë përparime të mëdha. Vetëm një gjë dëshiroj, Aleks, që gjithë diturinë tënde ti ta lësh të shkruar e të sistemuar, që të

mund t'u shërbejë njerëzve tanë, pse kanë nevojë Shqipëria dhe populli ynë për diturinë e njerëzve më të shquar të shkencës së vendit tonë. Për këtë shokët e Akademisë duhet t'ju ndihmojnë me të gjitha mjetet dhe mundësitë ty dhe udhëheqës të tjerë të fushave të ndryshme të shkencës, se një gjë të tillë e kërkon zhvillimi i shkencave në vendin tonë socialist.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Tashti ne, punonjësit e shkencës, historianët, i jemi vënë punës për festimin sa më madhështor të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Përgatiteni festimin e kësaj ngjarjeje në një nivel të lartë shkencor. Ta bëni këtë gjë për vendin tonë, për historinë e popullit tonë dhe, kur them për vendin tonë, kam parasysh edhe vëllezërit tanë kosovarë. Duhet ta dinë mirë kosovarët historinë e vendit të tyre, të trajtuar në mënyrë marksiste-leniniste, pa i pëlqeka apo nuk i pëlqeka kjo ndokujt, neve aq na bën. Ne jemi marksistë-leninistë dhe e kemi shpallur botërisht politikën tonë proletare, si dhe qëndrimet tona. Kur shkruhet historia, ajo duhet të shkruhet ashtu siç është në të vërtetë.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit nuk u bë për të hedhur valle, as për t'u përqaftuar me serbomëdhenjtë. Në asnjë mënyrë! Prandaj ne do ta trajtojmë atë duke u nisur nga pozitat e shkencës historike marksiste-leniniste.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Ajo kishte ritëm pushke.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ritëm pushke që ç'ke me të. Prandaj edhe ju, Aleks, në punimet tuaja shken-

core kushtuar këtij përvjetori të madh, ta keni parasysh këtë.

(*Duke parë punimet artistike prej tekstili*): Të mahnit kombinimi i bukur i ngjyrave, harmonia e disenjove me shije kaq të hollë në këto punime. Shikoni këtë çorape, është me të vërtetë si një mozaik i bukur ngjyrash.

Është mirë dhe diçka e bukur që edhe vajzat tona të reja nëpër shkollatë mësojnë nga një çikë të qëndisin dhe të bëjnë punë të tilla artistike.

**SHOKU STEFANAQ POLLO:** Këtu kemi përgatitur një kënd të vogël për të treguar që tradita popullore në kushtet e socializmit të ne vazhdon të zhvillohet më tej. Të gjitha këto punime të artizanëve tanë sot flasin më së miri për këtë. Ja, përsëri motivi i shqiptonjës që ka qenë shumë i përhapur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Cili motiv i shqiptonjës është më i vjetër?

**SHOKU ALEKS BUDA:** Zor që ta thuash këtë, shoku Enver, sepse kjo i ka rrënjët popullore shumë të lashta. Në shumë popuj shqiptonja ka qenë simbol i forcës. Më vonë ajo është përdorur edhe si simbol shtetëror, si, për shembull, në Romë, në perandoritë lindore, të persëve etj. Pra, motivi i shqiptonjës, i përdorur si simbol force, është një karakteristikë e përgjithshme e të gjithë popujve që kanë jetuar që nga Evropa e deri në Azinë Perëndimore.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, ashtu është, ishte simbol i forcës në gjithë ato vende.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Te ne ky motiv njihet të paktën që nga mesi i shekullit të 14-të, kur e gjejmë

në flamurin tonë, dhe është e habitshme se e gjejmë me yll. Edhe Skënderbeu motivin e shqiponjës e kishte me yll, bile deri një shekull më parë e tillë ishte në përdorim.

**SHOKU STEFANAQ POLLO:** Si motiv popullor shqiponja u përgjithësua në shekullin e 19-të dhe u bë kështu motiv kombëtar.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Kjo është fotografia ku ju keni dalë në Dragobi, shoku Enver. Është një nga gjërat më të bukura që kanë bërë fotografët tanë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo fotografi është bërë atëherë kur kemi shkuar në Valbonë. Ai plaku me të cilin bisedoj, është një patriot i vjetër, shok i Bajram Currit. Pikërisht në momentin që na ka kapur aparat fotografik, ai, duke treguar tokat matanë kufirit, më tha: «Ja, dhe andej nga ajo anë e kishte zemrën trimi Bajram për të mbrojtur shqiptarët e Malit të Zi, që persekutoheshin nga kral Nikolla». Ky patriot, shokë, me disa grupe trimash të këtyre anëve, ishte bërë mbrojtës i flaktë i vëllezërve shqiptarë të Kosovës në atë kohë.

**SHOKU DRITËRO AGOLLI:** Me sa më kujtohet, shoku Enver, ai ju tha atëherë që «po të ndodhë ndonjë gjë, menjëherë merr flakë stralli».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po. Pastaj unë i thashë atij plaku të Alpeve se si luftojnë kosovarët për gjuhën, zakonet dhe të drejtat e tyre dhe plaku u gëzua shumë.

Po, po. Unë, shokë, mbeta shumë i kënaqur nga vizita këtu dhe për punën që keni bërë për përgatitjen e kësaj ekspozite ju përgëzoj nga zemra të gjithë ju,

udhëheqës të shquar të shkencës sonë, veçanërisht ju të etnografisë, pasi kjo është një shkencë me rëndësi të madhe.

Mendoj se në këtë ekspozitë ju i paraqitni denjësisht kulturën popullore, traditat e mrekullueshme të popullit tonë dhe jam i bindur se përpjekjet tuaja për t'i ngritur më lart këto tradita e për t'i vënë ato në shërbim të socializmit do të jenë akoma më të mëdha në të ardhmen. Në këtë mënyrë ekspozita etnografike do të bëhet më e plotë, më e pasur dhe shpjegimet rreth objekteve të saj do të jenë më të përpunuara. Për këtë ju do të keni vazhdimisht ndihmën e plotë të Partisë dhe kur themi të Partisë, domethënë edhe të ideologjisë së saj, marksizëm-leninizmit, edhe të njerëzve të Partisë, si edhe të shkencëtarëve si Aleksi, Stefanaqi e të shumë të tjerëve, të cilët janë kurdoherë të gatshëm për t'ju ndihmuar që shkenca etnografike të bëhet një pasqyrë e shkëlqyeshme e kulturës sonë popullore, ashtu siç ka qenë e shkëlqyeshme gjatë shekujve ndjenja liridashëse, luftarake dhe përparimtare e popullit tonë, e cila është materializuar aq bukur në këto vepra që ju i keni mbledhur nga të katër anët e Shqipërisë.

Unë ju uroj nga zemra që t'i shtoni akoma më shumë përpjekjet, për ta bërë këtë shkencë me të vërtetë një forcë të madhe propagandistike, në radhë të parë për popullin tonë, që ai të njohë e të ndiejë thellë rrënjët e shëndosha të kulturës sonë të zhvilluar e të trashëguar në shekuj. Në të njëjtën kohë kjo shkencë le të bëhet një mjet i fuqishëm i mbrojtjes së kësaj kulture. Të mos harrojmë se mbrojtja e kulturës lidhet

me mbrojtjen e popullit. Etnografia duhet të përparojë dhe të studiojë zhvillimin e kulturës popullore që nga kohët më të vjetra, prandaj kësaj shkence i duhet kushtuar vazhdimisht vëmendje e veçantë.

Përfitova mjaft nga vizita në këtë ekspozitë të etnografisë sonë dhe për këtë ju falënderoj. Është e natyrishe që, në luftë për të ecur përpara, ju do të hasni edhe vështirësi, por kurdoherë që do të gjendeni në vështirësi, unë dhe shokët e mi do të jemi të lumtur t'ju ndihmojmë, t'i studiojmë, t'i shikojmë ato çka ju pengojnë dhe të përpiqemi së toku për kapërcimin e tyre.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Na prekët thellë në zemër me këto fjalë e me këtë vizitë që na bëtë sot, shoku Enver. Na takon neve, punonjësve të shkencës, që t'ju falënderojmë shumë për nderin dhe kënaqësinë e madhe që na dha ardhja juaj këtu për të parë frytin e punës sonë. Fjalët tuaja janë një inkurajim i madh për ne dhe do të na nxitin për arritje të reja në të ardhmen. Ne kemi objektiva të mëdhenj në fushën e etnografisë, të cilët po përpiqemi t'i realizojmë. Veç të tjerash, duam të fillojmë ngritjen e muzeut të fshatit në natyrë. Këtë porosi na e keni dhënë me kohë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne kemi bërë gjithë këto qytete, disa prej të cilave krejt të reja, ndërtoam gjithë këto vepra madhështore dhe jo të mos ndërtojmë një fshat që i nevojitet muzeut në natyrë! Ta bëjmë, ta ndërtojmë pjesë-pjesë, por të kemi kujdes që të vëmë në të tamam eksponatet që duhen. Ja, bashkë me Ramizin, kemi folur e kemi biseduar për këtë çështje, por akoma s'është bërë gjë. Por si ai, edhe unë kemi faj për këtë problem, që s'e kemi konkretizuar e s'e

kemi parashtruar në organet përkatëse për ta përfshirë në planet e afërta.

**SHOKU ALEKS BUDA:** Parku i mrekullueshëm mbi Tiranën, në kodrat e liqenit artificial, do të ishte vendi më i përshtatshëm për të ndërtuar muzeun e fshatit në natyrë. Po marr shkas nga kjo, shoku Enver, për t'ju thënë se aty lart, në kodrat pranë liqenit artificial, do të ishte ndoshta vendi më i mirë për varrin e Naim Frashërit. Universiteti do të jetë te këmbët e Naimit, ndërsa fshati, natyra shqiptare me të gjitha karakteristikat e saj, do ta rrethonin trupin e tij. Prandaj mendoj se ky është një vend shumë i përshtatshëm për vendosjen e eshtrave të Naimit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë e keni menduar këtë gjë, shoku Aleks. Kjo është një ide shumë e bukur. Atje janë universiteti, parku ku venë çlodhen njerëzit, rinia e kalamanët, atje është amfiteatri i këngëve dhe i valleve të bukura, pra, atje të flejë Naimi, të shikojë ëndrrën e tij të realizuar, Shqipërinë «zonjë».

Naimi ishte një poet i madh dhe plot gjallëri, ai kishte mall të madh për popullin dhe dashuri të fortë për atdheun, për lirinë e kombit.

Tash që jemi para përgatitjeve për 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kini parasysh që në këtë punë të pasqyrohet gjithë fryma luftarake e rilindësve tanë, veçanërisht e vëllezërve Frashëri, e sidomos e Abdylit. Të tre ata kanë qenë njerëz të mëdhenj dhe kanë dhënë një kontribut të shquar në historinë e popullit tonë.

Mirë, atëherë mirupafshim!

**SHOKU ALEKS BUDA:** Ju faleminderit shumë,

shoku Enver! Ju paçim sa malet! Të na rroni për të mirën e Partisë e të atdheut dhe për përparimin e mëtejshëm të shkencës sonë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Falemnderit! Të rrosh sa më shumë që t'u shërbesh shkencës, atdheut dhe popullit tonë! Të gjithë ju të rroni për t'i shërbyer popullit!

Të rrojë Partia!

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 329*

*Botohet sipas shënimeve të mbajtura gjatë bisedës së zhvilluar duke vizituar ekspozitën, që gjenden në AQP*



# PËRSIËNDETJE DREJTUAR POPULLIT TË GJIROKASTRËS ME RASTIN E INAUGURIMIT TË QENDRËS MUZEALE DHE TË OBELISKUT

24 maj 1977

Motra dhe vëllezër të dashur gjirokastritë,

Të dashur nxënës dhe nxënëse, mësues dhe mësuese,

Ju flas<sup>1</sup> nga Tirana në pamundësi të gjendem me ju në këtë ditë të shënuar, me një kuptim të lartë dhe frymëzim patriotik, për të kujtuar së bashku ato kohë plot histori të lavdishme, plot luftëra, sakrifica dhe heroizma që kanë bërë prindërit dhe gjyshërit tanë, mësuesit dhe mësueset tona të nderuara, i gjithë populli i krahinës dhe i qytetit të Gjirokastrës. Por pavarësisht se ju flas nga Tirana, me zemër, me mend e me kujtesë jam atje, tok me ju, në mes të popullit tim, në sheshin e vogël ku, 60 vjet më parë, së bashku me shokët e mi të shkollës «Drita», vinim rrotull në oborrin e saj të vogël me abetare në duar, duke përsëritur mësimin. Pikërisht në atë shesh, njëra pas tjetrës,

---

1. Përshëndetja u dëgjua e incizuar në magnetofon.

u themeluan e zhvilluan veprimtarinë e tyre patriotike e kulturore një varg lidhjesh, shoqërih demokratike e klubesh patriotike, të cilat, së bashku me këngët dhe tregimet e nënës, qenë shkolla ime e parë e fëmijërisë dhe e rinisë së hershme, ku mësova të dua e të nderoj me gjithë shpirt këtë atdhe të shtrenjtë, këtë popull të lavdishëm, gjuhën tonë të bukur, traditat tona të shkëlqyera, kulturën tonë të lashtë e përparimtare dhe t'u kushtoja, si gjithë njerëzit tanë të ndershëm e patriotë, jetën time. Sot ai shesh i vogël, me pionierët e pionieret, më ngjet si fusha e Çajupit me trëndelinë, në mes të të cilit ngrihet një obelisk i madh, i madhërihëm, siç kanë qenë të gjithë ata trima të pushkës e të penës, që luftuan në kohë shumë të vështira kundër errësirës, okupimit, tiranisë, që ndoqën traditat heroike luftarake e liridashëse të të parëve tanë, që i mbajtën gjallë këto tradita, i çuan më tej dhe na i lanë trashëgim, na hapën neve rrugën, na kalitën me patriotizëm, na mësuan të mbanim kurdoherë në dorë hutën, të mësonim diturinë dhe të forconim dashurinë në mes nesh.

Sot në të moshuarit, kalamanët e atyre kohëve heroike, kur na mungonin edhe letra e lapsi dhe mezi gjenim abetaret me shkronjat e vjetra të alfabetit të Stambollit, të sjella fshehtazi në trasta nën pushkë dhe guna të dhirta të Çerçizit, të Bajos, të Mihalit etj., kujtojmë me nderim të madh ata burra trima e patriotë të flaktë, që zbritnin dhe ngjitnin rrugët e pazarit të Gjirokastrës. Kaq fort janë skalitur ata në mendjen dhe në zemrat tona, sa edhe tash na duket sikur i shikojmë ashtu siç ishin, të thjeshtë, të thinjur nga mosha

dhe nga hallet, por me sy që u ndritnin kur ne, të rinjtë dhe të vegjlit, i përshëndetnim me respekt.

Ne që përuleshim përpara xha Bajo Topullit, Idriz Gurit, Hasan Xhikut, Hysen Hoxhës, Hasan Sinos, Polo Meksit, Papapanos (plakut, priftit), Veli Hashorvës e të tjerëve, që u revoltuam kur katili Zog na vrau Avniun tonë, udhëheqësin e djalërisë, kur shokët tanë më të moshuar u nisën për të sulmuar Tiranën, ndiejmë një krenari të madhe për ata burra patriotë që na ndritën rrugën me armë dhe me penë, ndiejmë një krenari të veçantë, sepse kemi pasur privilegjin e madh t'i njihim nga afër, t'u kemi folur dhe të na kenë përkëdhelur kokën me ato duart e hekurta që kanë mbajtur dhe kanë shkrepur mauzerët dhe maliherët.

Sa shumë thesare të vyera ruan kjo kodër historike në mes të Gjirokastrës, vëllezër e motra! Aty është folur me pushkë e me penë për Shqipërinë, aty qëndronin krah për krah me luftëtarët e çetave patriotike mësuësit dhe nxënësit, në vatra si këto janë vënë themelet e para të shkollave që sot mbushin anembanë Shqipërinë; aty lindën skenat e para të teatrove amatorë dhe profesionistë; aty për herë të parë nënat dhe motrat tona u organizuan në shoqërinë «kundër Bastiljes», (burgut) më 1919 dhe shpallën hapur se do të luftonin kundër errësisës, prapambetjes, skllavërisë, në të cilat i kishin zhytur pushtuesit, regjimet antipopullore, kishat e xhamitë.

Shoqëritë dhe klubet patriotike, që u themeluan në këtë kodër, nuk lindën rastësisht dhe në një truall bosh. Ato ishin rrjedhim dhe vazhdim i drejtpërdrejtë i asaj veprimtarie të shquar e të gjithanshme, që kishin

zhvilluar për vite të tëra me pushkë e me penë shoqëritë, klubet dhe çetat patriotike të Rilindjes sonë Kombëtare, qenë, në të njëjtën kohë, pasurim dhe zhvillim i mëtejshëm sasior e cilësor i gjithë veprimtarisë së mëparshme të të parëve tanë të lavdishëm. Këto klube e shoqëri patriotike, që u hapën anembanë vendit, u bënë boshti i gjithë asaj lëvizjeje të fuqishme që i kishte vënë vetes si qëllim të fitonte pavarësinë e lirinë e atdheut, të luftonte për gjuhën e shkollën shqipe, për zhvillimin e përparimin e kulturës kombëtare, të muzikës, të teatrit e të folklorit tonë të mrekullueshëm, për demokraci, zhvillim e përparim shoqëror.

Armiqtë e brendshëm e të jashtëm i ndiqnin e i persekutonin patriotët tanë të nderuar, por më tepër se kaq ata nuk kishin ç't'u bënin. Patriotizmit tonë popullor, shpirtit liridashës, luftarak e përparimtar të njerëzve tanë, trimërisë dhe besnikërisë shqiptare armiqtë kurrë nuk ia ndalnin dot shpërthimin e nuk ua rrëzonin dot tiparet, sepse këto virtyte të larta kishin rrënjë shekullore dhe qenë shtrirë në mendjet dhe në zemrat e gjithë popullit.

Në emër të këtij patriotizmi buçiti kënga e mëmëdheut, e Andon Zako Çajupit, për truallin tonë të shtrenjtë e derdhën gjakun rrëke trimat e Selam Musa Salarisë në epopenë e Vlorës më 1920, për çështjen e madhe kombëtare shpërtheu në Paris koburja e revolucionarit demokrat Avni Rustemi, mu në zemër të tradhtarit Esat pashë Toptani.

Kemi qenë në moshë të re në atë kohë, të dashur motra dhe vëllezër gjirokastritë, por do t'ju them një

ndodhi trimash. Nuk e mbaj mend vitin, por ishte Dita e Flamurit, në kohën e regjimit të Zogut. Me shkollën vajtëm në atë copë vend para prefekturës së vjetër, që të moshuarit e mbajnë mend, atje ku sot është kinemaja. Te porta e madhe e prefekturës, në mes të kolonave, dolën prefekti, komandanti i xhandarmërisë dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Dhe prefekti, sa për të shkuar radhën, filloi të thoshte pak fjalë për Ditën e Flamurit, pastaj nisi të mburrte Zogun dhe regjimin e tij. Heshtje e madhe në të katër anët, s'kishte asnjë duartrokitje, por në këtë çast një zë i fortë u dëgjua nga turma: «Poshtë kusarët!». U bë katrahura, xhandarët vinin rrotull, prefekti dhe autoritetet u futën brenda. Ne, djemtë e shkollave, prishëm radhën dhe dëgjonim mësuesit të flitnin kokë më kokë: «Oh, më ju lumtë!». Turma jonë u hap përnjëherë dhe ne pamë të çante përpara, me kokën lart, me dorën në shpatë dhe me sharpën kuqezi hedhur në sup e krahëror, kapiten Idriz Gurin. Ishte ai, luftëtar i vjetër dhe shok i Çerçizit e i të tjerëve, që bërtiti: «Poshtë kusarët!». Idriz Guri zbriti rrugës, qëndroi në një tryezë këmbë mbi këmbë në kafenenë e «huqumetit» dhe porosi një gotë raki. Rreth e rrotull tij u mblodhën burra. Ne, djalëria, kishim zënë rrugën që çonte në klubin e rilindësve, që po inaugurohet sot, dhe qëndronim te shkallët e kovaçit armëndreqës, Aziz Budukut, përpara dyqanit të Zigurit, të xha Banushit dhe pritnim ç'do të ngjiste.

Nuk kaloi shumë kur u dëgjuan këpucët me proka të xhandarëve me një major në krye të tyre. Majori i Zogut çau me zor turmën, qëndroi përpara xha Idrizit dhe iu drejtua me zë të lartë: «Kapiten Idriz Guri,

kam urdhër të të arrestoj. Dorëzo shpatën!». Xha Idrizi, me mustaqc të thinjura dhe të dredhura në maja, u gua në këmbë, nxori shpatën dhe bërtiti: «S'e dorëzon kollaj shpatën Idriz Guri. Sprapsu, zoti major!». Ne filluam të thoshim: «Mbahu, xha Idriz!». Gjirokastritet, shokë të moshuar të xha Idrizit, rrethuan majorin e xhandarmërisë dhe njëri prej tyre i tha me zë të fortë: «Ik u thuaj atyre që të kanë dërguar se nuk arrestohet Idriz Guri. Ne po shkojmë të pimë te kafeja e Kuçukut, se kemi festë dhe, po të doni, ejani, por duhet të vini me një tabor xhandarësh». Majori i xhandarmërisë u shtang, u tremb, u zmbraps dhe u largua, kurse turma, me xha Idrizin në krye, mori rrugën e pazarit dhe ne të rinjtë u shkuam nga pas, duke kënduar këngën e Flamurit. Ahmet Zogu ia zhveshi xha Idriz Gurit rrobat e oficerit, por ai vazhdoi luftën e tij patriotike, me «bastunet» që ju i keni në muzeun e qytetit.

Të tillë ishin ata trima të pushkës e të penës që ne përkujtojmë dhe e bëjmë veprën e tyre të pavdekshme. Populli ruan si gjënë më të shtrenjtë kujtimin e përpjekjeve të tyre patriotike dhe Partia jonë e lavdishme e Punës i vuri ata në pedestal.

Në këtë truall të lavdishëm, në këtë lumë të pashtershëm patriotizmi e trimërie, në këtë shkollë të madhe të jetës u mësuan e u edukuan ata djem dhe ato vajza të popullit, që, më pas, në vitet e vështira të okupacionit fashist, u bashkuan rreth Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe u bënë mish e gjak i saj, u bënë heronj të lavdishëm të saj dhe të popullit.

Monumenti i bukur e kuptimplotë, që ju inauguroni sot, ngrihet mbi gjithë Gjirokastrën si një pish-

tar drite i pashuar kurrë. Atë e shikon kalaja krenare, e shikojnë lagjet, rrugicat, fusha dhe mali, e shikojnë Mashkullora dhe Qestorati me Libohovën, e shikojnë shkolla dhe shkollarët, mësuesit dhe mësueset e tyre, e shikon gjithë populli dhe lapidari i heronjve të Luftës Nacionalçlirimtare sikur i thotë nga bregu mbi urën e lumit: «Ja, edhe ne këtu jemi. Luftuam trimërisht me Partinë e komunistëve në krye dhe ramë në fushën e nderit me pushkë në dorë, sepse ashtu na kishit mësuar ju, nënat, baballarët, gjithë populli». Dhe tani djemtë e vajzat e tyre falënderojnë Partinë e Punës që e nxori Shqipërinë në dritë, se e çliroi përgjithmonë dhe e zbukuroi atdheun socialist, duke zbatuar në jetë moton e rilindësve: «Dituri, dashuri dhe hutë» dhe që në kohën e Partisë u bë: «Në njërin dorë kazmën, në tjetrën pushkën».

Në emër të Partisë, ju falënderoj dhe ju përgëzoj që vutë në vend fjalën e saj për ngritjen e një obelisku në kujtim të përjetshëm të mësuesve dhe të pedagogëve që punuan me guxim e me trimëri, që u burgosën, u torturuan dhe u vranë për të çelur shkollat shqipe, si në shumë anë të Shqipërisë, edhe në Gjirokastrë. Me respekt e mirënjohje të thellë dëshiroj të kujtoj me këtë rast mësuesit tanë të parë, patriotë të nderuar, si Thoma Papapano, Andrea Konomi, Ilia Dilo Sheperi, Asaf Çipi e më vonë një plejadë e tërë me Iljaz Hoxhën, Xhafo Poshin, Urani Rumbon, Rexho Muçin e të tjerë, të cilët, duke ndjekur rrugën e Koto Hoxhit e të Pandeli Sotirit, çelën, në truallin rreth kësaj kodre, me përpjekje të mëdha, shkollën shqipe «Liria» e më pas shkollën «Drita».

Prej punës dhe luftës së tyre, prej pasionit dhe zellit të madh të nxënësve të këtyre mësuesve patriotë, gjithmonë kanë mësuar e akoma më shumë duhet të mësojnë mësuesit, nxënësit dhe studentët tanë. Kurrë të mos harrojnë këta se pionierëve të parë të shkollës sonë u është dashur ta mbronin e ta përhapnin me vështirësi të panumërta e shpesh edhe me gjakun e tyre çdo germë të alfabetit shqip. Kurrë të mos harrojnë mësuesit e gjithë shkollarët tanë, që tani punojnë, përgatiten dhe edukohen në ndërtesa kaq të bukura e të pajisura me të gjitha kushtet, se mësuesve dhe nxënësve të shkollave të para shqipe, si «Liria» e «Drita», u mungonin edhe librat e kalemrat, pale mjetet e pajisjet e tjera mësimore, me të cilat janë të mbushura shkollat e sotme tonat. Ata kuptuan rëndësinë e shkollës amtare, rëndësinë e alfabetit, rëndësinë e librit, rëndësinë e diturisë. Pikërisht në ato kushte, në ato shkolla, që ngjanin si haure, nga radhët e atyre nxënësve që shkonin të mësonin, të shkruanin e të këndonin gjuhën e nënës, u edukuan e më pas u bënë mësues të nderuar djem të tillë të popullit, si Siri Shaploja, Aqif Selfoja, Emin Shtinoja, Sokrat Kutra e shumë e shumë të tjerë. Lufta e armatosur për t'u çliruar nga robëria e imperialistëve dhe e shkelësve barbarë nuk mund të ndahej nga lufta për alfabetin dhe për shkollën shqipe.

Krah për krah me këto përpjekje ecnin edhe këngët e popullit:

*Mu te qaf' e Peshkëpisë  
Lufton i bir'i xhixhisë*



*Me taboret e Turqisë,  
Balil-o, Balil nuri!*

*Sot është dita, shqipëtarë  
Të përpiqemi,  
Alfabetin ton' ta mbrojmë,  
Shpejt, o burrani!  
Shkronjat tona jan' të arta,  
Këto duamë.*

Dy këngë popullore, një refren i vetëm, i shenjtë:

*Shqipëri, atdhe i dashur,  
Ne s'të lëmë ty të varfër!...*

Jo rastësisht rreth e rrotull shkollës dhe klubit «Drita» janë grumbulluar klubet patriotike, jo rastësisht kërcenin valle rreth kolonës së klubit «Drita» Çerçiz Topulli, Hysen Hoxha, Thoma Papapano Çuçi, El-maz Boceja, Idriz Angoni me shokët e tyre. Jo rastësisht ne të rinjtë i këndonim atëherë së toku ato vjersha që përmenda më lart e shumë e shumë të tjera si ato me aq frymëzim luftarak e patriotik.

Çlirimi i atdheut nga okupatorët ishte i lidhur me fitoren e diturisë. Rilindësit tanë e konsideronin diturinë dritë, sepse me anë të saj do të shpërndahej errësira që kishte pllakosur popullin tonë gjatë shekujve, sepse ajo do t'i çonte lart ndërgjegjen dhe patriotizmin e shqiptarit, sepse ajo, e bashkuar me pushkën, do të konsolidonte pavarësinë e fituar dhe do të sillte përparimin dhe begatinë e atdheut.

Këtë rrugë e çoi me Luftën heroike Nacionalçlirimtare dhe me lavdi përpara Partia heroike e komunistëve shqiptarë, që diti aq mirë, aq drejt dhe me aq guxim e heroizëm të zbatonte marksizëm-leninizmin, këtë shkencë universale e të pagabueshme, në lidhje të ngushtë me traditat heroike, liridashëse dhe përparimdashëse të popullit shqiptar. Ja, pra, ç'vlera të mëdha ruan në vetvete veprimtaria e këtyre shoqërive, klubeve dhe lidhjeve patriotike e kulturore! Ja ç'punë të lavdërueshme keni bërë ju, vëllezër dhe motra, duke ngritur këtë qendër të re muzeale, e cila, krahas të tjerave, dëshmon më së miri se Gjirokastra jonë është qytet-muze, në radhë të parë, për historinë e saj të lavdishme patriotike e revolucionare, për luftërat dhe përpjekjet e pareshtura të bijve dhe të bijave të saj për liri e pavarësi, për gjuhën dhe për shkollën shqipe, për demokraci, zhvillim e përparim të gjithanshëm ekonomik e shoqëror!

Krahas muzeve dhe qendrave të tjera kulturore, kjo qendër e re do të jetë për brezat e sotshëm e të ardhshëm një shkollë e vërtetë e edukimit të patriotizmit e të trimërisë, të dashurisë për gjuhën dhe për kulturën tonë kombëtare, të respektit dhe të mirënjohjes së thellë për gjithë traditat e shquara dhe veprimtarinë patriotike revolucionare të të parëve tanë.

Duke u njohur me këto tradita të shquara të së kaluarës, brezat e sotshëm e të ardhshëm do të kuptojnë më mirë edhe vijën politike e ideologjike të Partisë, do të kuptojnë më mirë filozofinë e saj, sepse në mënyrë konkrete do të shohin që fjala dhe vepra e Partisë nuk janë diçka e shkëputur nga e kaluara e lavdishme e

popullit tonë; përkundrazi, ato janë vazhdim i mëtejshëm dhe pasurim i gjithanshëm i saj në brendi e në formë me ideologjinë marksiste-leniniste.

Përsëri ju kërkoi ndjesë që, jashtë dëshirës sime, nuk munda të vij sot aty për të festuar edhe unë bashkë me ju këtë ditë të shënuar, sikurse u zotova në përhëndetjen time me rastin e 50-vjetorit të shkollës «Asim Zeneli», por do të kem rast të vij të shikoj Gjirokastrën tonë të dashur, për të cilën më ka marrë aq shumë malli, të bisedojmë edhe për qendrën e re muzeale që po inauguroni, për të cilën ruaj aq shumë kujtime të fëmijërisë dhe të rinisë, veçanërisht për shoqërinë «Studenti», anëtar i së cilës kam pasur fatin të isha edhe vetë.

Përfitoj nga rasti, vëllezër e motra, t'ju uroj nga zemra për titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste», akorduar rrethit të Gjirokastrës pak kohë më parë. Populli i rrethit të Gjirokastrës e meriton plotësisht këtë titull dhe shpreh bindjen se me punë dhe me përpjekje të gjithanshme të gjithë, si një grusht rreth Partisë, do të punoni akoma më të vendosur, si mbarë populli ynë heroik, për ta bërë gjithnjë e më të bukur, gjithnjë e më të paprekshme Shqipërinë tonë socialiste, atdheun tonë të lavdishëm, për të cilin është derdhur aq shumë gjak nëpër shekuj.

Lavdi heronjve të popullit, të vjetër dhe të rinj!

Lavdi heronjve të pushkës, të punës dhe të penës!

Lavdi Partisë sonë të dashur!

Lavdi popullit tonë heroik!

Dalshi gjithmonë faqebardhë, vëllezër dhe motra  
të mia të Gjirokastrës!

Ju përqafoj

Juaji:

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 125 (8984), 25 maj 1977*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Letra të zgje-  
dhura», vëll. 1, f. 352*

# KONTROLLI PUNËTOR E FSHATAR, I DREJTUAR NGA PARTIA, NDIHMOM QË TË ZBULOHEN DHE TË KORRIGJOHEN TË METAT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

25 maj 1977

Pika e parë e rendit të ditës ka të bëjë me kontrollin punëtor dhe fshatar. Megjithëse koha është relativisht e shkurtër, patjetër puna e bërë ka nxjerrë një eksperiencë, ka dhënë rezultate të mira, por gjatë saj janë vërtetuar edhe të meta. Shokët që kemi ftuar këtu mund të na flasin për këtë problem, duke pasqyruar si anët pozitive, ashtu dhe të metat që janë vërtetuar.

Në vendimin e Byrosë Politike a ka ndonjë çështje të pasaktë që nuk kuptohet dhe që mund të jetë bërë shkas të krijohen koncepte jo të drejta në ndonjë rreth për kontrollin punëtor e fshatar? Ato që thu-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi zbatimin e vendimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH mbi forcimin e mëtejshëm të kontrollit të drejtpërdrejtë punëtor e fshatar».

hen, a zbatohen si duhet? Çfarë pengon në këtë drejtim? Përse ka ndonjë praktikë të gabuar, siç u përmend këtu?

Me sa kuptova unë nga njëri prej diskutimeve, në mjaft raste kontrolli punëtor zëvendëson punën e organeve të Partisë e të pushtetit në shumë drejtime, deri edhe në shpërndarjen e zarzavateve. Po kontrolli i Partisë si zhvillohet? Si zbatohet ky në bazë të normave që ka caktuar Partia? Na thuhet se zbatohet duke aktivizuar vetë shokët komunistë për punën që bëjnë në sektorin ku punojnë. Po çfarë i shikojnë ata shokut edhe vetes? Dua të di pse ka të meta në një ndërmarrje, kur atje ekziston kontrolli i Partisë, kur organizata-bazë interesohet për problemet. Ku konsiston kontrolli i Partisë? Thuhet se konsiston në realizimin e planit, në zbatimin e disiplinës etj. Po në qoftë se këto çështje në ndërmarrje i lihen kontrollit punëtor, po organizata-bazë e Partisë ç'bën?

Desha të di, gjithashtu, si funksionon kontrolli punëtor në ndërmarrje. Sa veta bëjnë pjesë në grupet e kontrollit? A ka në to edhe inxhinierë? Po llogaritarë? Grupi i kontrollit punëtor kur vihet në veprim, pasi i ka ezauruar të gjitha mundësitë organizata e Partisë dhe nuk ka arritur ta ndreqë situatën, apo sipas rastit? Po komiteti i Partisë në ç'rrethana i dërgon grupet e kontrollit punëtor? Në ndërmarrje apo në repartin ku dërgohet kontrolli punëtor nuk ka vetëm komunistë, por është edhe organizata e bashkimeve profesionale, ku bën pjesë tërë kolektivi. Pastaj atje ka edhe organizatë rinie, po mund të ketë edhe një këshill gruaje. Pra, vërtet mund të jenë pak komunis-

të, por janë edhe levat e organizatës-bazë, të cilat nuk mund të lihen mënjane. Përderisa ekzistojnë këto leva të Partisë, ato duhen vënë në lëvizje e jo t'u lihet puna vetëm atyre 11 vetave të grupit të kontrollit punëtor.

Është pozitive kur grupi i kontrollit punëtor ndihmon në zgjidhjen e problemit. Kjo tregon që organizata e Partisë i jep rëndësi kontrollit punëtor. Por atë punë mund dhe duhej ta bënte më mirë organizata e Partisë. Ndërsa kjo caktoi vetëm 11 veta, të cilët kontrolluan dhe raportuan se nxorën mjaft probleme. Por në qoftë se do të aktivizoheshin mirë dhe në kohë të gjitha levat e Partisë, ato gjëra që nxori kontrolli punëtor do të dilnin shumë më mirë dhe më parë. Sidoqoftë, hedhja në veprim e kontrollit punëtor, siç thotë Partia, është një masë e drejtë, por duhet parë se si përdoret ai.

Keni dalë ju<sup>1</sup> ndonjëherë të kontrolloni, për shembull, uzinën «Enver» ose furrat e tullave që nuk janë të varura nga ju? E kam fjalën këtu: në ndërmarrje keni një grup të kontrollit punëtor, ju ka thirrur ndonjëherë komiteti i Partisë dhe ju ka porositur që ky grup kontrolli të shkojë të kontrollojë një ndërmarrje tjetër? A keni ju vërejtje, kritika apo propozime për këtë problem, a mund të ndryshojmë gjëkafshë? Duhet bërë kujdes që grupi i kontrollit punëtor të mos na kthehet në një aparat të byrosë së Partisë ose të organizatës-bazë.

Po në sektorin e arsimit kush e bën kontrollin?

---

1. I drejtohet shokut Kujtim Cara, në atë kohë sekretar i byrosë së Partisë të kombinatit të materialeve të ndërtimit «Josif Pashko», i pranishëm në mbledhje.

Se grupin e kontrollit punëtor, siç doli këtu, e kemi pranë organizatës-bazë të Partisë. Kështu duhet t'i kemi grupet e kontrollit punëtor? A dërgohen këto grupe të kontrollit të klasës punëtore në institucionet e tjera, bie fjala, në universitet apo në ndonjë institucion tjetër kulturor e arsimor?

Këtu u tha se në rrethin e Beratit instruktimin e grupeve të kontrollit punëtor e bëjnë vetëm sekretarët e komitetit të Partisë. Pse të kuptohen kaq ngushtë direktivat e Komitetit Qendror? Jo një specialist, por më shumë duhet t'i instruktojnë pjesëtarët e grupit të kontrollit punëtor. Orientimi është që inxhinieri nuk duhet të bëjë pjesë në grupin e kontrollit punëtor, po ai duhet medoemos të instruktojë. Jo vetëm inxhinieri, por edhe financieri, edhe vetë punëtorët duhet të shkojnë të instruktojnë shokët e grupit të kontrollit punëtor. Mos i ngushtoni kështu në mënyrë shabllone dhe burokratike interpretimet e vendimit apo të orientimeve.

*Pasi shokët e pranishëm në mbledhje iu përgjigjën pyetjeve dhe diskutuan për përvojën e fituar, si dhe për disa probleme që dilnin lidhur me veprimtarinë e grupeve të kontrollit punëtor, shoku Enver Hoxha tha:*

Lidhur me këtë problem dëshiroj të flas edhe unë. Ato që do të shpreh i kemi diskutuar edhe me shokët sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë dhe kemi qënë dakord. Disa nga mendimet që do të parashtroj dhe që i kam formuluar, sigurisht, duke u bazuar edhe në raportin që na është paraqitur, kanë një sens kritik. Këtë e bëj edhe për arsye se ky, në qoftë se nuk gabohem, është i pari raport që na paraqitet për këtë pro-



blem me kaq rëndësi, prandaj rreth tij duhet të reflektojmë një çikë më thellë.

Diskutimet e të gjithë shokëve që morën fjalën, i konsideroj të vlefshme, shumë pozitive dhe mund të them se edhe ato kishin karakter kritik. Në to u vunë në dukje si eksperiencia e punës së mirë që është bërë, ashtu edhe dobësitë që vërehen për disa gjëra dhe që duhet t'i shikojmë e t'i ndreqim. Ky, mendoj unë, ishte objekti i këtyre diskutimeve.

Sipas pikëpamjes sime, raporti që i është paraqitur Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë për problemin e kontrollit punëtor e fshatar (theksoj edhe fshatar, sepse në diskutimet e shokëve nuk dëgjova asnjë të flasë për këtë kontroll, që do të thotë se ky mbetet me pikëpyetje), nuk është trajtuar mirë. Kjo gjë tregon se thelbi i problemit nuk është kuptuar si duhet. Shokët që kanë përgatitur raportin na thonë se janë bërë këto apo ato gjëra, se kanë parë këtë apo atë çështje, por nuk na thonë asgjë nga eksperiencia që ka dalë me të vërtetë nga kontrolli punëtor dhe fshatar, që ka vendosur Partia. Këtë mungesë të raportit mendoj se, deri në njëfarë shkalle, e plotësuan shokët e rretheve që raportuan këtu.

Nuk është një çështje burokratike që të na flitet për rezultatet e disa kontrolleve punëtore dhe fshatare, si dhe për disa drejtime me rëndësi të këtyre kontrolleve, për shembull, si janë ushtruar kontrollet, çfarë elementësh janë ata që bëjnë pjesë në grupet e kontrollit punëtor, a janë specializuar apo jo për këtë kontroll dhe si janë specializuar etj. Për këto çështje, e përsëris, nuk flitet gjë në raport, aty na thuhet vetëm konsi-

derata të përgjithshme dhe na përsëriten ato parime që ne i njohim, pse i kemi përpunuar në kushtet tona sipas mësimëve të Leninit, tek të cilat jemi bazuar kurdoherë.

Që grupet e kontrollit punëtor e fshatar të sjellin rezultate, komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të këshillave popullore të rretheve duhet të dinë t'i organizojnë, t'i aktivizojnë mirë, të dinë përse duhen përdorur dhe njerëzit që ngarkohen me këtë punë t'i instruktojnë mirë. Këtë çështje në raport nuk e shoh të vihet mirë në dukje, por nga përmbajtja e tij kuptohet që komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive nuk janë interesuar sa duhet për këtë problem.

Kontrolli punëtor dhe fshatar është kuptuar, si me thënë, në përgjithësi, në një formë rudimentare, akoma foshnjore. Mirëpo mua më duket se kështu siç po veprohet, ai nuk shërben si duhet për ato qëllime shumë të rëndësishme që e kemi ngritur.

Qëllimi kryesor i kontrollit punëtor, ashtu siç na mëson Lenini dhe duke gjykuar nga kushtet e arsytet përse e ngriti ai këtë kontroll, si ka udhëzuar të punojë etj., është të vihet rregull në çështjet e administrimit të shtetit të ri socialist dhe veçanërisht në administrimin e pronës socialiste. Kur flasim për ruajtjen e pronës shoqërore duke interpretuar Leninin, kemi parasysh faktin që, në kushtet e socializmit, këtë pronë janë përpjekur ta dëmtojnë elementë ose grupe njerëzish të degjeneruar. Po edhe ne kemi, gjithashtu, elementë me mbeturina të theksuara mikroborgjeze, që vjedhin, shpërdorojnë etj., duke dëmtuar bazën e shtetit popullor. Vjedhja apo shpërdorimi i pasurisë

socialiste nga ana e disa individëve, natyrisht, vë në dukje edhe karakterin negativ të personave që e kryejnë atë. Prandaj, çështja e ushtrimit të kontrollit për ruajtjen dhe administrimin e pronës socialiste lidhet edhe me një varg problemesh të tjera. Megjithatë s'është e thënë që kontrolli punëtor e fshatar të marrë formë dhe orientime derisa të shtrihet aq shumë, sa të kontrollojë çdo gjë e çdo sektor. Shembull konkret për këtë është rasti që u përmend këtu nga shokët: një grup i kontrollit punëtor ka shkuar të kontrollojë një organizatë-bazë partie dhe ka propozuar largimin e disa anëtarëve të saj nga ajo qendër pune, pa e shtruar çështjen fare në organizatën-bazë. Jo, shokë, në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar kështu kjo çështje.

Se çfarë dhe kush duhet kontrolluar nga punëtorët e fshatarët, për këtë nevojitet absolutisht orientimi i Partisë. Grupet e kontrollit punëtor e fshatar duhet të drejtohen medoemos prej saj, prandaj nuk mund të mendohet që vetë punëtorët të hyjnë e të dalin ku të duan, pa pasur orientime dhe porosi nga Partia. Dhe jo vetëm kaq, por me ata që do të bëjnë pjesë në një grup kontrolli punëtor e fshatar, pra, me kontrolluesit, është e domosdoshme të merren masa me kohë dhe të punohet që ata të edukohen, të stërviten, të bëhen specialistë për punën që do t'u ngarkohet, pra të instruktohen. Ndryshe do të thotë që çështja e kontrollit i lihet spontaneitetit dhe kështu ai do të shndërrohet në një objekt kurioziteti, muhabetesh e thashethemesh, në vend që të jetë, ashtu siç na mëson Lenini, një formë edukimi dhe mjet administrimi për punët shtetërore.

Udhëzimet që u jep Partia pjesëtarëve të grupit të kontrollit punëtor e fshatar, mendoj se duhet të jenë dy llojesh:

Llojin e parë ta përbëjnë udhëzimet politike dhe ideologjike, me anë të të cilave duhet t'u bëhet i njohur kontrolluesve ç'është kontrolli punëtor e fshatar, pse e ka krijuar dhe pse e ka rekomanduar atë Lenini dhe përse e ngre edhe Partia jonë, t'u shpjegohen vlerat, qëllimet politike dhe ideologjike të tij. Ky është njëri nga llojet e udhëzimeve.

Lloji tjetër është ai që ka për objekt punën specifike, e cila nuk mund të bëhet as brenda një dite dhe as nga një apo nga dy sekretarë të komitetit të Partisë. Çdo komitet partie ka në dispozicion shumë mjete dhe mundësi për t'i dhënë si duhet këto udhëzime.

Në qoftë se vetë komiteti i Partisë i rrethit e kupton drejt dhe e ka të qartë ç'është kontrolli punëtor, si duhet ta përdorë dhe ta orientojë ai këtë kontroll, atëherë me siguri do ta bëjë mirë edhe instruktimin specifik të elementëve që përbëjnë grupin e kontrollit, natyrisht, në përshtatje me problemet konkrete që do të kontrollohen. Komiteti i Partisë i rrethit e di se cilat kanë qenë dhe janë pikat më të dobëta në rreth, fjala vjen, në drejtim të administrimit shtetëror, konkretisht në çështjen e mbrojtjes së pasurisë socialiste, me të cilën gërshetohen edhe ana morale, edhe ana politike dhe ideologjike e njerëzve që dëmtojnë këtë pronë. Pra, komiteti i Partisë, krahas punës për edukimin ideologjik, politik e moral të punonjësve, bën edhe instruktimin specifik të kontrollorëve, duke i njohur këta me format e me mënyrat e dëmtimit të pronës socialiste,

të vjedhjeve, të shpërdorimeve etj. nga ana e njerëzve të pandërgjegjshëm e keqbërës.

Punën për edukimin politik e ideologjik, si dhe për forcimin e moralit proletar të njerëzit komiteti i Partisë e bën çdo ditë e çdo orë me Partinë dhe me masat punonjëse nëpërmjet organizatave-bazë. Kur fola lidhur me shtrirjen e kontrollit punëtor e fshatar, që nuk duhet kuptuar sikur ky mund të futet dhe të kontrollojë kudo, dhe se duhet të jetë Partia ajo që ta orientojë e ta udhëheqë kurdoherë drejt, kjo nuk do të thotë që pjesëtarët e grupit të kontrollit punëtor e fshatar t'i kuptojnë ngushtë detyrat dhe, pasi kanë marrë orientime e janë instruktuar, gjatë kontrollit, kur të shohin në një kolektiv të meta e dobësi të theksuara ose një sekretar organizate-bazë që nuk është në pozita luftarake e revolucionare, të mos i thonë këtij: «More, shoku sekretar, ç'bën ti këtu, përpara kësaj gjendjeje të palejueshme, po fle? Ne, si kontroll punëtor, do t'i flasim komitetit të Partisë edhe për ty, se konstatojmë që ti nuk po e kryen mirë detyrën si sekretar partie». Në një rast tjetër, kur disa komunistë nuk janë në rregull, anëtarët e grupit të kontrollit mund t'i thonë sekretarit: «Ne kemi ardhur këtu, shoku sekretar, për të parë si kujdeseni dhe si po e shfrytëzoni ju lëndën e parë, por, duke kontrolluar në këtë drejtim për të cilin jemi ngarkuar, kemi konstatuar që ky ose ai komunist i organizatës-bazë të Partisë që drejton ti, nuk qëndron drejt në këtë çështje, prandaj po të vëmë në dijeni si sekretar dhe po të themi që ti nuk ke qenë në krye të punëve dhe nuk i ke parë me kohë këto çrregullime». Pra, pavarësisht se ai është sekretar i organizatës,

njerëzit e kontrollit duhet t'ia vënë në dukje të metat që vërejnë.

Është e domosdoshme të instruktohen mirë pjesëtarët e grupit të kontrollit punëtor e fshatar, por kjo s'mund të bëhet brenda ditës. Nuk mund të përcaktohen as programe pune për këtë kontroll, si, për shembull, të parashikohet që brenda këtyre gjashtë muajve do të bëjmë këtë ose atë kontroll etj. Kontrolli shtetëror, po, ky punon me program pune, sepse Qeveria e cakton me kohë cilat ndërmarrje apo institucione duhet të kontrollojë, ajo vendos kohë më parë që kontrolli shtetëror duhet të kontrollojë, fjala vjen, anën financiare të tyre ose gjendjen e materialeve deficitare etj. dhe për këta objektiva cakton edhe afate se kur duhet ta ushtrojë kontrollin me funksionarët e vet. Ndryshe vepron komiteti i Partisë për kontrollin punëtor e fshatar; ai nuk mund të caktojë plane pune për këto kontrole, sepse kjo do të thotë t'ia humbasësh kontrollin befasinë, t'i paralajmërosh fajtorët që t'i fshehin fajet që kryejnë. Po mos vallë komiteti i Partisë duhet të veprojë në tym? Jo! Në asnjë mënyrë! Komiteti i Partisë, atje ku dalin probleme shqetësuese, ku i dhemb dhe kur mendon se është e nevojshme, e dërgon përnjëherë kontrollin punëtor e fshatar.

Kur e kemi ngritur çështjen e kontrollit punëtor e fshatar, kemi thënë se ai duhet të vihet nën drejtimin e Partisë dhe të frymëzohet prej saj. Në vendimin e Byrosë Politike të nëntorit të vitit 1975 thuhet: «... grupet e kontrollit punëtor e fshatar të ngrihen pranë organizatave-bazë ose byrove të Partisë në qendrat e punës dhe në kooperativat bujqësore, kurse në rrethe

pranë komiteteve të Partisë të rretheve». Termi i përdorur në këtë vendim duhet interpretuar drejt, duke u nisur nga qëllimi i Byrosë Politike, sepse, siç do ta shpjegoj më poshtë, interpretimi i gabuar i kësaj çështjeje, deri në njëfarë shkalle, e ka deformuar karakterin e kontrollit punëtor e fshatar. Fakti që grupet e kontrollit punëtor e fshatar janë ngritur pranë komiteteve të Partisë apo pranë organizatave-bazë, nuk do të thotë që ato janë organe të komitetit të Partisë, të byrosë apo të organizatës-bazë. Jo, një interpretim i kësaj natyre do të thotë se është kuptuar gabim çështja dhe, meqenëse është kuptuar gabim, domosdo që edhe do të veprohet gabim në praktikë e do të konfondohet kështu kontrolli i Partisë me kontrollin punëtor e fshatar.

Mirëpo të dy këto kontrole, sido që janë një kontroll i vetëm i klasës, dallohen nga njëri-tjetri, kanë sfera veprimi dhe kompetenca të ndryshme. Në qoftë se konfondohen, atëherë as kontrolli i Partisë nuk do të bëhet mirë, sepse Partia do të mbledhë mendjen, duke shkuar nga pikëpamja se punën që i përket kontrollit të saj, do ta bëjë grupi i kontrollit punëtor e fshatar. Dhe në fakt shembujt që na u dhanë këtu e argumentojnë këtë që thashë dhe tregojnë se disa herë në praktikë kanë ndodhur gabime të tilla.

Për shkak të konfondimit të këtyre dy kontroleve, ka ndodhur që kontrolli punëtor e fshatar të jetë shtrirë më thellë nga ç'duhet në disa çështje që përbëjnë sekret. Kështu, për shembull, ky kontroll është shtrirë edhe mbi ushtrinë. Me këtë që po them, nuk dua të atakoj atë që përmendi këtu një shok kur tha që jashtë

kohës së stërvitjes vajtën kontrollovan se si përdorëshin pajisjet ushtarake nga pjesëmarrësit në forcat vullnetare, se kontrole të kësaj natyre janë të drejta të bëhen, po jo të ushtrohet kontroll mbi njësitë ushtarake për çështje operative ose për probleme sekrete të policisë, të organeve të sigurimit, të hetuesisë e të tjera, deri edhe të organeve të Partisë. Prandaj të përcaktohet mirë e me kujdes nga Partia se ku duhet shtrirë ky kontroll dhe përse do të bëhet. Mua më duket se kontrolli punëtor e fshatar në disa sektorë është futur gabim dhe kjo është serioze, sepse dëshmon që nga vetë komitetet e Partisë ka moskuptim e mosinterpretim të drejtë të vendimeve e të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë për këtë çështje.

Ne nuk duhet t'u themi komiteve të Partisë për çdo problem edhe a-në edhe b-në, pra nuk duhet t'i porositim për çdo gjë me hollësi, por, në bazë të orientimit të përgjithshëm të dhënë nga Komiteti Qendror, secili duhet të mendojë vetë ku duhet të dërgohet kontrolli punëtor e fshatar etj., ndryshe është rrezik të shtrembërohet parimi leninist i Partisë për kontrollin punëtor e fshatar. Për këtë arsye mendoj që këto kontrole nuk po na punojnë kudo si duhet, ose disa japin rezultate, disa jo; ato që janë lidhur me komitetin e Partisë bëjnë diçka të mirë, kurse të tjerat, e kam fjalën për kontrollet punëtore e fshatare të bazës, për të cilat thuhet se janë pranë organizatave të Partisë, janë lënë pas dore, nuk përdoren, nuk japin llogari, nuk lënë gjurmë atje ku shkojnë dhe nuk kontrollojnë drejtuesit e ndërmarrjeve ose të ndonjë institucioni dhe të marrin vendime kundër fajtorëve.



Siç e kemi biseduar me shokët, grupi i kontrollit punëtor e fshatar mendoj të përbëhet nga një numër njerëzish sa ta gjykojë vetë komiteti i Partisë në bazë të nevojave që i dalin. Duke pasur kurdoherë parasysh qëllimet e kontrollit, pasi caktohen njerëzit që do ta përbëjnë dhe pasi bën me ta instruktimin e përgjithshëm që thashë, me gjykatësit, siç na ka mësuar Lenini, me prokurorët dhe deri me specialistët e çdo lloji, komiteti i Partisë i ndan ata pastaj në grupe sipas profileve. Me këto grupe ai punon vazhdimisht, duke zhvilluar me ta tema në drejtime të caktuara për ato probleme që preokupojnë në një moment të caktuar Partinë, të cilat ajo i ka në evidencë. Këta njerëz vazhdojnë në këtë mënyrë të edukohen, të specializohen.

Komitetit të Partisë i vijnë informata, fjala vjen, se në filan ndër marrje bëhen vjedhje, se në një vend tjetër ka dëmtime e prishje të pronës, se në një kooperativë bujqësore është djegur, për shembull, një stallë lopësh, kurse organizata-bazë e Partisë me organet e pushtetit atje flinin etj. Atëherë komiteti i Partisë i rrethit vlerëson situatën e krijuar, merr edhe mendimin e komitetit ekzekutiv, që është levë e Partisë për administrimin konkret të pasurisë shtetërore, dhe, përveç punës hetimore e asaj të prokurorisë, vendos ta dërgojë grupin e kontrollit punëtor e fshatar. Për këtë qëllim thërret njerëzit e caktuar në grupin e kontrollit, i vë në dijeni se në Baldushk, ta zëmë (po e marr këtë shembull konkret, se atje na ka ndodhur një ngjarje e hidhur), kanë ngordhur kaq lopë dhe është e qartë se atje ka sabotim nga elementi armik, kurse organizata-bazë e Partisë ka rënë në gjumë, dhe i porosit të

venë sa më parë si kontroll i klasës, kontroll i fortë i përbërë nga punëtorë të instruktuar e të specializuar qysh më parë për problemet e blegtorisë. Kështu, siç ju thashë, e mendojmë krijimin dhe përdorimin e kontrollit punëtor e fshatar, i cili kurdoherë duhet të jetë nën drejtimin e Partisë, por asnjëherë nuk duhet të kthehet në aparat të saj.

Një rast tjetër. Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës mund të informohet se në kombinatin «Josif Pashko» nuk ecin mirë problemet ekonomiko-financiare. Atëherë vendos të dërgojë atje një grup kontrolli punëtor të përbërë me punëtorë jo vetëm të një ndërmarrjeje, por të disa qendrave pune, fjala vjen me tre punëtorë të uzinës «Traktori», tre nga uzina «Dinamo», pesë nga një ndërmarrje tjetër etj., duke përfshirë këtu edhe një financier, dhe në krye të të gjithë këtyre cakton një njeri të ngritur politikisht. Pasi u flitet për problemin që e shqetëson komitetin e Partisë, pjesëmarrësit e këtij grupi kontrolli porositen të shkojnë në kombinatin «Josif Pashko» për të kontrolluar.

Edhe një rast tjetër. Komiteti i Partisë shikon se në një shkollë kanë dalë probleme shqetësuese, si për shembull, në drejtim të disiplinës, në drejtim të marrëdhënieve mësues-nxënës ose të ruajtjes dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve laboratorike etj. Edhe në këtë rast, ashtu si në rastin e kombinatit «Josif Pashko», dërgon në këtë shkollë një grup kontrolli me njerëz të përshtatshëm, që i ka përgatitur me kohë, dhe kështu me radhë vepron edhe për sektorë të tjerë. Pikërisht kështu e kuptoj unë organizimin dhe funksionimin e grupeve të kontrollit punëtor e fshatar dhe jo në ato

mënyra burokratike që vërehen disa herë në praktikë.

Nga raporti del se grupet e kontrollit pranë organizatave-bazë janë hallkat më të dobëta. Ç'do të thotë që këto kontrole janë hallkat më të dobëta? Kontrolli punëtor e fshatar duhet të jetë i efektshëm kudo, po veçanërisht i efektshëm duhet të jetë ai kontroll që është më shumë në kontakt me bazën, me hallet e njerëzve, me punën. Pse të thuhet atëherë se «çfarë kemi ne për të kontrolluar? Kontrole bëhen nga grupet e kontrollit punëtor e fshatar që varen nga byroja e komitetit të Partisë». Kjo do të thotë se edhe në këtë kontroll punëtor e fshatar masiv ne kemi futur burokracinë dhe hierarkinë, po, sipas mësimëve të Leninit, këto nuk na lejohen.

Çështja e drejtimit të kontroleve nga ana e Partisë nuk është kuptuar dhe aq drejt, më duket mua, sepse në raport nuk shoh që të përzihet fare komiteti ekzekutiv në këtë çështje. Edhe komiteti ekzekutiv duhet të merret patjetër me kontroll, sepse, siç e theksova, ai është levë e Partisë i ngarkuar pikërisht edhe me administrimin e pronës shtetërore etj. dhe nuk duhet menduar që në kontrollin punëtor e fshatar, meqë ky drejtohet nga Partia, komiteti ekzekutiv nuk mund të përzihet. Në asnjë mënyrë nuk mund të injorohet komiteti ekzekutiv në raste të tilla, duke u justifikuar me mendimin se anëtarët e grupit të kontrollit janë punëtorë. Po, bukur, le të jenë punëtorë, ata ne nuk i dërgojmë në kontroll vetëm sepse janë të tillë, por edhe sepse i njohin problemet e ndërmarrjes, janë në dijeni për dobësitë e saj dhe për ato që kanë vënë re, sipas kompetencave që kanë, ata vijnë i raportojnë komitetit

të Partisë; ndryshe, për sa u përket njohjes e zotërimit të gjendjes së punëve në rreth, komiteti ekzekutiv do të mbetet me gisht në gojë. Pse vetëm pesë instruktorë që ka komiteti i Partisë do ta informojnë këtë për gjendjen e punëve në të gjithë sektorët në rreth? Në asnjë mënyrë! Komitetin e Partisë e informojnë organizatat-bazë dhe byrotë e Partisë në bazë, po atë e informojnë edhe njerëzit e pushtetit. Këta i tregojnë se këtu ose atje puna nuk ecën si duhet dhe, megjithëse ka ndërhyrje edhe nga organizatat-bazë të Partisë, vazhdohet të mos merren masat e nevojshme etj. Me këtë dua të them se, kur lind nevoja për dërgimin e një kontrolli diku, si dhe për arsyen e marrjes së këtij vendimi etj., nuk duhet lënë mënjanë komiteti ekzekutiv.

Në vendimin që kemi marrë, kemi thënë që kontrolli punëtor dhe fshatar, ashtu siç e ka emrin, nuk duhet të përbëhet prej funksionarësh. Kjo anë kaq me rëndësi e çështjes as që përmendet fare në raport. Aty na thuhet se ka komitete partie që kundërshtojnë të marrin pjesë specialistë në këto grupe kontrolli. Se çfarë janë këta specialistë, nuk na thuhet gjë, por, në qoftë se këta janë nëpunës, atëherë nuk duhet të përfshihen, ndryshe s'jemi në rregull me çështjen e kontrollit punëtor e fshatar, kurse, në qoftë se janë punëtorë dhe ne kemi tash specialistë punëtorë, atëherë është e domosdoshme që këta të bëjnë pjesë në këto kontrolle punëtoresh dhe fshatare. Bile, kontrollet duhet të udhëhiqen prej tyre, prej specialistëve punëtorë. Ne nuk duhet të vëmë në krye të grupit të kontrollit një punëtor që mund të jetë njeri i vendosur, por që nuk ka haber

nga çështjet e sektorit që do të kontrollohet. Në krye të grupit të kontrollit punëtor duhet vënë një punëtor që të jetë edhe i vendosur, por njëkohësisht të jetë edhe specialist. Edhe sikur të ndodhë që pjesëtarët e grupit të kontrollit punëtor e fshatar të mos jenë specialistë, neve na bie detyrë t'i bëjmë ata specialistë, ndryshe këto kontrole do të jenë vetëm sa për emër, për llafe.

Kur themi që pjesëtarët e grupit të kontrollit punëtor e fshatar t'i bëjmë specialistë, çështjen e kam tek administrimi i pasurisë socialiste. Kështu Partia mund të marrë një tornitor të zotin nga uzina «Enver» dhe këtë ta bëjë specialist jo në zanatin që ka, se këtë ai e di, por e specializon, ta zëmë, në financë, dhe i thotë: «Shiko, në dyqane ka vjedhje dhe këto bëhen në këtë ose në atë mënyrë etj.». Duke ia treguar këto e duke e instruktuar për problemet financiare, këtë punëtor e specializon. Pra, nuk ka nevojë të specializojmë një njeri që është specialist, por të specializojmë një punëtor që është i përgatitur në një zanat të caktuar, për ta bërë të aftë edhe në një drejtim tjetër. Duke vepruar kështu, këtë punëtor Partia e bën të aftë të kontrollojë mbarëvajtjen e punëve shtetërore, e përgatit në mënyrë të tillë saqë, kur të vejë për kontroll, fjala vjen, në një shkollë, duke qenë punëtor, ai të ketë dijeni edhe për problemet shkollore.

Në raport kërkohet që në grupet e kontrollit punëtor e fshatar të tregohet kujdes për mbajtjen e rregullt të dokumentacionit, ku të përcaktohen gjendja, përgjegjësitë, masat që propozohen të merren dhe afatet e zbatimit të tyre etj. Edhe kjo çështje më duket se nuk është kuptuar drejt. Grupi i kontrollit punëtor

e fshatar duhet të raportojë, ai mund të marrë edhe masa në vend. Mund të gabohem dhe mbase nuk është kështu, por kontrolli nuk duhet të sjellë një burokratizëm me dokumentacione dhe këto dokumentacione t'i venë komitetit të Partisë, që ia dërgon pastaj administratës t'i kontrollojë, e cila në fakt as kontrollon gjëkafshë, bile kjo ka tendencën t'i fshehë gjërat. Prandaj mua më duket se të krijosh një pyll me dokumentacione për këto çështje do të thotë të ngresh një aparat të madh burokratik, meqenëse këtu flitet për dhjetëra mijë veta që veprojnë. Jo, shokë, kjo nuk është e drejtë dhe do të thotë se nuk është kuptuar mirë kontrolli punëtor e fshatar.

Kritikat, vërejtjet dhe masat që mendon ose që propozon të marrë grupi i kontrollit punëtor e fshatar duhet të rëndojnë mbi të gjithë ata që kanë gabuar, që kanë dëmtuar ose që kanë sabotuar. Prandaj këtu nuk ka pse të bëhet dallim mes kuadrove të thjeshtë dhe kuadrove drejtues. Në qoftë se ne i mësojmë punëtorët të respektojnë kuadrot drejtues edhe kur gabojnë, atëherë kontrolli punëtor nuk shërben për atë qëllim të madh që na mëson Lenini dhe për të cilin e kemi ngritur edhe ne.

Komiteti ekzekutiv ose seksionet e tij, natyrisht, duhet të kontrollohen nga grupe të kontrollit punëtor e fshatar dhe fajtorët të vihen përpara përgjegjësisë për ato çështje që kanë me të vërtetë përgjegjësi dhe fajë, po jo të vihen përpara përgjegjësisë edhe ata që nuk kanë fajë. Fajin ta mbajë kushdo që e kryen, qoftë përgjegjësi, qoftë drejtori, qofshin ata më poshtë tij, apo punëtorët e ndërmarrjes.

Veç kësaj, duhet të ruhem, gjithashtu, nga rastet që mund të na ndodhin, siç u tha në shembullin që na treguat, që kontrolli punëtor e fshatar u kthye në një mjet hakmarrës. Kontrollorët duhet të jenë punëtorë dhe tash ne kemi sa të duash punëtorë që janë në gjendje të kontrollojnë specialistin nëpunës, specialistin e bujqësisë etj.

Është e çuditshme se organizatat e masave, siç na raportohet (ose ka raste që nuk na raportohet fare), nuk merren me këtë çështje. Duket se ato ose nuk interesohen, ose nuk i bëjnë që të interesohen. Po është logjike të mos merren, në rast se veprohet dhe kuptohet në mënyrë kaq burokratike orientimi që ka dhënë Komiteti Qendror, që këto grupe kontrolli punëtor dhe fshatar duhet të frymëzohen e të drejtohen nga Partia dhe jo të krijohen si vartëse, si aparate të byrove ose të organizatave-bazë, dhe këtë rrugë, që nuk është e drejtë, ato po e marrin. Në qoftë se në praktikë nuk kuptohet dhe nuk zbatohet që këto grupe kontrolli të përbëhen nga punëtorë dhe nga kooperativistë, atëherë është e qartë që bashkimet profesionale dhe organizatat e tjera të masave në këtë detyrë të madhe do të mbeten, siç thotë populli, si «peshku pa ujë», pa përgjegjësi. Në realitet bashkimet profesionale janë ngarkuar nga Partia për të edukuar masat e punonjësve, që punët kudo të na shkojnë mirë, që në çdo vend të sundojë disiplina proletare, që kudo punonjësit të jenë të ndershëm e të disiplinuar dhe të krycjnë detyrat etj., etj. Atëherë, derisa bashkimet profesionale, organizata e rinisë, organizata e gruas janë leva të Partisë dhe u është ngarkuar një detyrë e tillë e madhe për të punuar me masat,

si është e mundur që ato të qëndrojnë jashtë drejtimit, udhëzimit e frymëzimit të grupeve të kontrolleve të përbëra nga punëtorë dhe nga fshatarë që bëjnë pjesë në këto organizata? Ky është një kuptim shumë i ngushtë i kontrollit punëtor e fshatar dhe bën të arrihet atje ku thamë, që grupet e kontrollit të kthehen në aparate të byrosë së Partisë. Deri edhe këtu, në aparatën e Komitetit Qendror të Partisë, pastaj, është e natyrshme, edhe në bazë, nuk janë kuptuar mirë orientimi, qëllimi dhe çështja e drejtimit të kontrollit punëtor e fshatar.

Duhet, pra, të merren masa në këtë drejtim, në radhë të parë, që të kuptohet mirë, pastaj edhe të përmirësohet, gjendja ekzistuese. Mund të kaloj në këtë çështje edhe një çikë më tutje. Kam përshtypjen që instruktimet që janë bërë lidhur me kontrollin punëtor e fshatar nuk janë kryer si duhet. Janë bërë shumë mbledhje për këtë problem, por konstatoj se organizatat e masave (të cilat janë krijuar apostafat që të ndihmojnë Partinë për t'i bërë të ndërgjegjshme masat që të mobilizohen drejt në vijën e Partisë, domethënë që kjo vijë të shpjegohet akoma më mirë në gjerësinë e saj nga levat) nuk e kanë të qartë këtë çështje, prandaj u rekomandoj shokëve të aparatit të Komitetit Qendror dhe drejtuesve të Partisë në bazë që ta ristudiojnë vendimin e drejtë të Byrosë Politike që është marrë për këtë problem të rëndësishëm dhe të reflektojnë mbi të. Por as vetëm kjo nuk është e mjaftueshme. Ata duhet të studiojnë veprat e Leninit ku ai flet për këto çështje dhe kështu ta thellojnë mendimin leninist në kushtet e vendit tonë, ndryshe do të ecet me metoda rutinë në një rrugë të gabuar.



Mënyra se si është vepruar me kontrollin punëtor e fshatar nuk them se nuk ka dhënë rezultate; ai ka vënë në dukje të meta e çrregullime që fshiheshin, pra ka sjellë gjëra të mira për socializmin, për ndërtimin e tij, por duhet njohur se nuk janë arritur ato rezultate që kërkojmë ne nga kjo mori njerëzish të organizuar, të cilët instruktohen, njihen dhe u jepet mundësi nga Partia të marrin pjesë në qeverisjen e vendit. Në këtë drejtim duhet shikuar rëndësia e madhe e këtyre kontrolleve punëtore dhe fshatare. Ky është kontroll i klasës punëtore, që duhet të veprojë i organizuar dhe në mënyrë kompetente, pse për këtë qëllim është ngritur; ai duhet të veprojë i harmonizuar me format e tjera të kontrollit (kontroll partie dhe shtetëror) që ekzistojnë, që ndihmojnë njëra-tjetrën, por nuk lejohet që kontrolli punëtor të marrë kompetencat e kontrollit të Partisë etj., etj. Të mos harrojmë se Partia është para-voja e klasës.

Në raport nuk shoh të jetë prekur edhe një çështje tjetër e rëndësishme, pjesëmarrja e punonjësve të drejtësisë, të gjykatave e të prokurorive në edukimin e njerëzve që përbëjnë grupet e kontrollit punëtor e fshatar. Këtë orientim dhe këtë këshillim për edukimin e gjithë kësaj mase kontrolluesish nuk na i rekomandon pa qëllim Lenini. Ky është një qëllim i madh, se punonjësit e drejtësisë, nga teoria dhe nga praktika e veprimtarisë së tyre, kanë eksperiencë dhe dinë mirë se si vepron elementi armik dhe keqbërës kundër pronës socialiste, kundër ligjeve të shtetit socialist, kundër ideologjisë dhe moralit proletar. Për këto arsye Lenini na rekomandon ta krijojmë kontrollin punëtor dhe fsha-

tar, t'i edukojmë dhe t'i specializojmë ata që bëjnë pjesë në këtë kontroll dhe ky të bëjë që punët të ecin kurdoherë më mirë.

Efektivitetin dhe rezultatet e kontrolleve punëtore dhe fshatare ne duhet t'i çmojmë me uljen e krimeve që vërtetohen në ekonomi. Kjo do të thotë se, pas ushtrimit të këtyre kontrolleve, ne duhet të konstatojmë që në mbrojtjen e pronës socialiste të ketë një përmirësim të dukshëm. Atje ku bëhen kontrole, duhet të vëzhgojmë me kujdes nëse ulet burokratizmi apo nuk ulet, zbatohen si duhet detyrat apo nuk zbatohen, ka disiplinë në punë apo nuk ka, bëhen hatëre apo nuk bëhen, vidhet apo nuk vidhet, dëmtohet ekonomia apo ndërtohet etj. Nga të tilla kërkesa duhet të orientohen komitetet e Partisë për të parë rezultatet e punës së grupeve të kontrollit punëtor e fshatar dhe në bazë të një analize të tillë të ndërtojnë punën edukative që duhet bërë.

E them këtë se kam përshtypjen që komitetet e Partisë çështjen e efikasitetit të kontrollit punëtor e fshatar nuk po e ndjekin për ta verifikuar dhe për të parë ndryshimet e arritura pasi janë realizuar vërejtjet e bëra nga kontrolli. Për një kontroll me efikasitet nxirren edhe detyra se në ç'drejtime duhet të përqendrohet edukimi i grupit të kontrollit punëtor e fshatar dhe çfarë lloji instruktimi duhet t'i bëhet atij në mënyrë specifike. Partia grupet e kontrollit punëtor e fshatar nuk duhet t'i dërgojë sa për t'i dërguar, por t'i dërgojë atje ku lind nevoja, duke u mbështetur në informatat e marra në vend nga organet e pushtetit ose nga organizatat-bazë të Partisë, që na vënë në dijeni se

këtu ose atje vërtetohen dobësi të shumëllojshme, që është e zorshme t'i ndreqin me punën e zakonshme, prandaj lind nevoja që komiteti i Partisë të dërgojë për këtë qëllim kontrollin punëtor e fshatar.

Këto vërejtje që bëra, shokë, nuk përjashtojnë aspak punën e mirë të komiteteve të Partisë dhe të Partisë në përgjithësi me grupet e kontrollit punëtor e fshatar që janë organizuar deri tashti, por sukseset e arritura janë vetëm fillimi. Qëllimi ynë është: ta forcojmë më tej kontrollin punëtor e fshatar, që të metat të korrigjohen pa vonesë.

Në qoftë se ka vërejtje për këto që shtrova, t'i bëjmë dhe ta plotësojmë kuadrin e çështjeve.

Si thoni ju, shokë të bazës, ne anëtarët e Sekretariatit të Komitetit Qendror e kemi parë drejt këtë çështje apo jo?

*(Të gjithë shokët u përgjigjën: «Drejt e keni».)*

Keni ndonjë vërejtje?... Nuk keni. Mirë, atëherë, mbaruam me këtë pikë.

*Botuar për herë të parë, me ndonjë shkurtim, në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 348*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

## ARMIQTË I MERITOJNË PLOTËSISHT DËNIMET QË U DHA GJYKATA POPULLORE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit  
Popullor të RPSSH<sup>1</sup>*

31 maj 1977

Tradhtarët e Partisë e të popullit, Abdyl Këllezi me Koço Theodhosin, na kanë paraqitur kërkesë për falje. Unë, si edhe ju, jam i mendimit t'ua refuzojmë dhe të pranojmë vendimin e drejtë dhe të merituar që u dha Gjykata Popullore këtyre armiqve të vjetër e të betuar të Partisë dhe të popullit tonë. Për njerëz të tillë komplotistë, sabotatorë, intrigantë e puçistë nuk duhet të ketë asnjë fije mëshire.

Mbarë populli ynë, tërë Partia, gjithë këta tradhtarë, si grupin e Beqir Ballukut, të Abdyl Këllezit dhe të Fadil Paçramit me shokët e tyre, i dënuan me urrejtje dhe ky ishte një dënim plotësisht i merituar. Këta elementë të degjeneruar, siç e vërtetuan katërcipërisht hetuesia edhe gjyqi, ishin që të gjithë të or-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutuan dhe u refuzuan kërkesat për falje të armiqve Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi.

ganizuar me një platformë dhe kishin një qëllim të përbashkët: të merrnin fuqinë në dorë me puç e «me masakra», siç e tha me gojën e tij tradhtari Abdyl Këllezi, ashtu siç tha më parë edhe Beqir Balluku, duke u shprehur se «nga dy vezë që përpiqen, njëra do të thyhet».

Në mënyrë të organizuar këta tradhtarë synonin të hidhnin në dorë udhëheqjen e Partisë, të merrnin frenat e pushtetit popullor dhe ta shndërronin Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë në një vend kapitalisto-revizionist dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, këtë Parti heroike, që çliroi popullin nga pushuesit e huaj dhe nga feudo-borgjezia e vendit dhe ndërtoi socializmin, ata donin ta kthenin në një parti fashiste. E gjithë kjo veprimtari e tyre, siç e vërtetuan Partia dhe gjyqi, siç e pohuan edhe vetë lirisht me gojën e tyre këta tradhtarë, zhvillohej e organizuar dhe në mënyrë të fshehtë, e lidhur po ashtu edhe me armiq revizionistë që janë në fuqi jashtë atdheut tonë. Ky ishte një komplot shumë i rrezikshëm, prandaj Partia dhe populli ynë, duke e zbuluar dhe duke e demaskuar atë, korrën një fitore të plotë.

Mjaft nga këta elementë, si Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi dhe të tjerë, pohuan se kanë qenë me kohë armiq të Partisë, të republikës sonë dhe të socializmit. Ata nuk kanë qenë dakord me vijën e Partisë dhe kurdoherë përgatitnin sabotimin e çdo gjëje që u vinte në dorë. Për një kohë këta elementë ditën të maskoheshin dhe të fshiheshin nën vrullin dhe entuziazmin e madh të Partisë dhe të masave punonjëse për të mbuluar veprimtarinë e tyre minuese, të cilën e mas-

konin me vijën e përgjithshme të Partisë, me «nevojën për forcimin e organizimit, për zhvillimin e ekonomisë, për studime më të thella e më të qëndrueshme në ekonomi, për përmirësimin dhe forcimin e ushtrisë, të arsimit, të kulturës» etj. Dhe deri në njëfarë shkalle ky manovrim nga ana e tyre vuri në gjumë disa kua-dro që vareshin nga ata, që vepronin shumë herë pa dashje, duke menduar se zbatonin vijën e Partisë. Megjithatë ky nuk mund të jetë një shfajësim nga ana e tyre, për arsye se Partia vijën e saj në çdo moment e ka shpjeguar dhe e ka sqaruar cila është, me se përbëhet, si duhet zbërthyer dhe si duhet zbatuar. Ajo ka thënë, gjithashtu, se zbatimi i kësaj vije duhet kontrolluar. Po të ishin në lartësinë e duhur kontrolli dhe vigjilenca revolucionare, këta tradhtarë do të ishin zbuluar e do të ishin demaskuar edhe më përpara.

Por duhet kuptuar se veprimtaria e këtyre armiqve u zhvillua gradualisht. Edhe vetë ata gradualisht arritën në tradhti. Degjenerimi i tyre, siç na mëson dialektika marksiste, u zhvillua hap pas hapi. Këta elementë të futur në Parti ishin vetëm të lyer e të mbështjellë me një cipë të hollë nga ajo edukatë marksiste-leniniste politike, ideologjike dhe morale, me të cilën mbrun Partia anëtarët e saj. Këta njerëz ishin të krimbur, me mbeturina të mëdha mikroborgjeze, të cilat u trashën dhe hynë në konflikt me Partinë. Ky konflikt ishte më parë joantagonist, por pastaj u bë antagonist. Kështu veprimtaria e tyre kaloi nga sasia në cilësi dhe, kur arriti ky moment, atëherë Partia, si kurdoherë, me vigjilencë dhe me prudencë të madhe, vuri dorë mbi ta dhe ua prishi planet.

Partia ka luftuar kurdoherë me vendosmëri kundër armiqve, të jashtëm e të brendshëm, të cilët nuk kanë qenë të butë në armiqtësinë e tyre. Partia gjithnjë i ka dërrmuar armiqtë e saj të brendshëm dhe përsëri do t'i dërrmojë edhe në të ardhmen, cilëtdo qofshin, të vetmuar ose me grupe, të lldhur ose të palldhur me armiqtë e jashtëm. Armiqtë tanë asnjëherë nuk do të kenë sukses në veprimtarinë e tyre armiqësore kundër Partisë, pse, natyrisht, këto pësime Partisë i bëhen mësim, i mprehin vigjilencën dhe shpatën e diktaturës së proletariatit për mbrojtjen e Republikës sonë Popullore Socialiste, për mbrojtjen e lirisë dhe të sovranitetit të atdheut, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit. Prandaj për të tillë elementë tradhtarë s'duhet të kemi asnjë mëshirë.

Por nga kjo punë armiqësore çdo njeri në vendin tonë duhet të nxjerrë mësim dhe konkluzione, të kuptojë thellë se si vepron armiku hapur, si vepron ai edhe i maskuar. Kur vepron hapur, është më kollaj ta zbulosh armikun, por, kur ai vepron fshehurazi, në qoftë se humbet vigjilenca, në qoftë se nuk bëhen mish dhe gjak i njerëzve tanë direktivat, mësimet, marksizëm-leninizmi që udhëheq Partinë tonë, atëherë, natyrisht, zbulimi i armikut bëhet më me vështirësi dhe veprimtaria e tij armiqësore shkakton dëme.

Kur Partia na mëson hollësisht se, përveç kontraktave antagonistë mes popullit dhe armiqve të tij, ekzistojnë edhe kontraktat joantagoniste, këto dy çështje me rëndësi të madhe gjithsecili duhet t'i kuptojë në brendinë dhe në gjerësinë e tyre filozofike dhe të dijë t'i dallojë me kohë në zhvillimin e jetës, në luftën

për jetën, për socializmin. Kur Partia na sinjalizon se në ndërgjegjen e njerëzve tanë ekzistojnë mbeturina mikroborgjeze të së kaluarës, të asaj filozofie prapanike, idealiste, metafizike, kjo do të thotë se njerëzit tanë në jetë, në punë dhe në luftë duhet kurdoherë të studiojnë në mënyrë kritike veprimtarinë e tyre dhe të shokëve që kanë rreth e rrotull dhe të bëjnë përpjekje që të ndreqen vetë, po të punojnë për të ndrequr edhe shokët, duke u treguar këtyre rrezikshmërinë e çdo shfaqjeje të huaj dhe duke u treguar po ashtu rrugën e drejtë që duhet të ndjekë secili për këtë ose për atë problem që e shikon gabim. Këtë Partia e ka theksuar dhe vazhdimisht e thotë çdo ditë në veprimtarinë e saj, në shkrimet e saj, në të gjitha dokumentet e saj, në konferencat dhe në kongreset e saj. Ta duash Partinë me gjithë zemër, do të thotë të zbatosh deri në fund direktivat e saj, do të thotë t'i kuptosh dhe t'i mësosh më parë mirë këto direktiva e t'i zbatosh në jetë, të jesh ekzigjent para së gjithash ndaj vetes në veprimet dhe në mendimet e tua, pastaj ndaj shokëve dhe shoqërisë. Me fjalë të tjera, duhet qëndruar drejt dhe korrekt përpara Partisë, përpara direktivave, mësimëve dhe teorisë së saj.

Disa njerëz vuajnë nga mendjemadhësia, nga foddullëku, mbivlerësojnë veten dhe punën e tyre dhe, kur bëjnë këtë, sigurisht, ata nënvleftësojnë të tjerët. Duke mos lëvizur nga pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre, të gabuara natyrisht, ata dalin edhe në konkluzione të gabuara, të cilat ose i mbajnë brenda dhe nuk i shprehin, dhe grumbullojnë kështu në veten e tyre një pakënaqësi që çdo ditë e më shumë rritet, ose i shprehin,



por në vend që këto të shprehen përpara Partisë, përpara opinionit të shëndoshë, shfaqen në rrethe intime, mes «shokësh» dhe krijohet kështu një sëmundje e rrezikshme, një shoqëri e sëmurë. Një shoqëri e tillë në baza të sëmura, grádualisht kalon pastaj në një opozicion, në fillim të vogël, që është akoma një kontraktë joantagoniste dhe, në qoftë se nuk braktiset kjo rrugë dhe Partia nuk ua zbulon, atëherë pikëpamjet e sëmura kthehen në një punë armiqësore dhe kontraktë bëhet antagoniste.

Zakonisht, kur zbulohet një veprimtari e tillë, njerëzit fajtorë deri në njëfarë shkalle vazhdojnë mbrojtjen e sëmurë. Por, kur elementët e infektuar vihen përpara fakteve e dokumenteve, atëherë këta dalin me dy pretendime: «Pse nuk na i tha Partia», ose «Partia të na e falë».

Kërkesa e parë, «Pse nuk na i tha Partia», është diçka e drejtë të thuhet, pse Partia, kur sheh një njeri që gabon, e ka për detyrë ta thërrisë dhe t'ia vërë në dukje gabimin dhe, në përgjithësi, mund të them se Partia e bën këtë detyrë me sukses. Por këta njerëz që gabojnë duhet të dinë se Partia vazhdimisht, nëpërmjet dokumenteve të saj të shumta, nëpërmjet fjalimeve, nëpërmjet rezolutave, nëpërmjet kongreseve, u ka thënë hapur të gjithëve se si duhet të qëndrojnë komunistët e patriotët përpara problemeve të jetës. Kjo është e para çështje.

E dyta, të tillë njerëzve Partia jo vetëm duhet t'ua thotë gabimet, por këta njerëz edhe vetë duhet të venë t'ia thonë më parë Partisë gabimet që kryejnë, bile e kanë për detyrë t'ia thonë, pse, në qoftë se nuk e bëjnë

këtë, atëherë fajin nuk ua ka Partia, kur ajo ua zbulon gabimet. Në këtë rast fajin e kanë vetë dhe ky faj rëndon mbi ta edhe më shumë, pse qëndrime të tilla nuk janë në rrugën e Partisë.

Për disa që mund të kenë opinione të kundërta për një problem ose për një problem tjetër, për një person ose për një person tjetër, çfarë na mëson Partia të bëjmë? Ajo na mëson që këto opinione duhet t'i shfaqim hapur në Parti, t'i diskutojmë, t'i rrahim. Ato mund të jenë të drejta, mund të jenë edhe të gabuara, personi që ka të tilla opinione mund të ketë të drejtë, po mund edhe të mos ketë të drejtë, mundet që ai akuzon pa baza, po mundet që kritikon edhe drejt, prandaj gjithçka duhet thënë haptazi në Parti dhe jo vesh më vesh, jo të krijohet një shoqëri e sëmurë, e cila e trashgabimin dhe gjithë ai mentalitet i sëmurë, që formohet si një çiban për një situatë të caktuar ose edhe në përgjithësi kundër vijës së Partisë, e çon njeriun në rrugë të gabuar.

Në të gjithë veprimtarinë e këtyre elementëve që tradhtuan Partinë, që tradhtuan ndërtimin e socializmit në vendin tonë, një proces i tillë shohim të jetë zhvilluar, të jetë trashur dhe të ketë kaluar në forma të rrezikshme. Shumë prej këtyre shfaqjeve, kur janë parë, u janë vënë në dukje qoftë Beqir Ballukut, qoftë Petrit Dumës, Hito Çakos, Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit, Fadil Paçramit, Kiço Ngjelës, Vasil Katit e shumë të tjerëve. Por është fakt se ata kanë bërë bisht, e kanë mashtruar udhëheqjen, kanë vazhduar në rrugën e tyre, kanë mbivlerësuar pikëpamjet e tyre dhe organizimin e fshehtë që po përgatitnin kundër Partisë dhe push-

tetit popullor, ata kanë mbivlerësuar gjithashtu edhe mbështetjen që mund t'u vinte nga jashtë për këtë veprimtari të tyre antiparti dhe antishtetërore.

Partia duhet të kuptojë se të tillë njerëz që janë ambiciozë e karrieristë, mendjemadhësia, prirjet karrieriste dhe ambicia nuk mund t'i mbajnë në rrugën e drejtë të popullit, të Partisë dhe të socializmit, pse të tëra çështjet ata i shohin nga këndi individualist, subjektivist, nga prizmi i interesit të tyre borgjez dhe jo nga ai i interesit proletar, i interesit të përgjithshëm të popullit dhe të socializmit.

Partia, siç e dimë, kurdoherë ka vepruar me durim të madh ndaj njerëzve që gabojnë, për arsye se ajo nuk udhëhiqet nga pikëpamje metafizike. Ajo njeh se njerëzit edhe gabojnë, dhe pra duhen ndrequr, duhen bërë përpjekje për t'i shpëtuar, dhe vetëm kur nuk ka asnjë mundësi që të shpëtohen, atëherë duhet të ndëshkohen. Kjo pjekuri marksiste-leniniste e Partisë sonë është vërtetuar gjatë gjithë jetës së saj.

Disa elementë të sëmurë mund ta quajnë këtë vijë të Partisë sonë sektare, ka të tjerë që mund ta quajnë të butë, oportuniste, por të dyja palët gabohen. Partia jonë është një parti parimore marksiste-leniniste, armike e sektarizmit dhe e oportunizmit. Durimi i Partisë për të shpëtuar njerëzit nuk mund të quhet aspak oportunizëm, ashtu sikundër ashpërsia e saj kundër armiqve dhe tradhtarëve nuk mund të quhet aspak sektarizëm. Kjo do të thotë se Partia jonë, që mbron interesat e popullit, të proletariatit, të socializmit, ecën drejt, prandaj të gjithë duhet të jemi të drejtë me të, të jemi korrektë në vlijën e saj, ta mbështetim

këtë vijë me të gjitha forcat tona, të jemi të ndershëm si populli, si komunistët, të jemi të vendosur, ashtu siç janë revolucionarët, siç janë komunistët.

Gjithashtu duhet të jemi të hapur e të singertë me Partinë dhe, kur them me Partinë, me këtë duhet të kuptojmë me gjithë Partinë, me vijën e saj në tërësi, me gjithë anëtarët e saj, me të gjitha forumet, që nga kongreset e Partisë dhe deri te komitetet, byrotë dhe organizatat-bazë. Nuk lejohet të jemi të singertë ose t'i fërkojmë krahët një personi ose tre personave dhe të tjerët të mos i peshojmë fare. Jo, nuk është kjo rruga e Partisë, gjithsecili ka vendin e vet dhe këtë vend ia jep Partia, gjykon Partia nëse ai që e ka këtë vend e meriton apo jo dhe përsëri Partia gjykon kur nuk e meriton.

Armiqtë që u dënuan me vdekje, si ata që u pushkatuan më parë, ashtu dhe Abdyl Këllezi me Koço Theodhosin, si dhe të tjerët që u dënuan me burgim, si Kiço Ngjela me Vasil Katin, të tërë pohuan fajësinë e tyre, intrigat e djallëzitetë e tyre, prandaj tash le t'i vuajnë dënimet që u dha drejtësia e madhe e popullit, le t'i vuajnë në të gjitha shkallëzimet që u ka caktuar gjyqi. Këto dënime ata i meritojnë plotësisht për veprimtarinë e tyre armiqësore dhe tradhtarë ndaj atdheut socialist, ndaj popullit dhe ndaj Partisë sonë të Punës.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*

## NIVELI I JETESËS SË KOOPERATIVISTËVE NGRIHET DUKE PUNUAR MË SHUMË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

1 qershor 1977

*Në fillim të këtij takimi shoku Hekuran Isai informoi për zhvillimin e mbledhjes së plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Krujës. Kur po diskutoheshin disa probleme të blegtorisë, e veçanërisht kostoja e lartë e prodhimit të mishit në disa ekonomi bujqësore, e mori fjalën*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Fakti që kostoja e mishit të derrit del shumë e lartë, është një problem që kërkon vëmendje. Përse del e lartë? Kjo ndodh sepse gjatë trajtimit të derrit nuk kujdesen sa duhet as për pjellshmërinë, as për peshën për çdo kokë. Por edhe kostoja e disa produkteve të tjera duhet të na tërheqë më shumë vëmendjen. Përveç shtimit të numrit të krerëve, mendoj se duhet parë edhe shpërblimi i rritësve të lopëve, të derrave e të bagëtive në përgjithësi, që ai të lidhet jo vetëm me numrin e krerëve, por edhe me prodhimin, sepse rritësi mund t'i ketë krerët që i kërkojnë, po i ka fare të dobët.

*SHOKU HEKURAN ISAI*: Mosrealizimet në prodhim kanë ulur edhe sasinë e paradhënieve të parashikuara për anëtarët e kooperativave bujqësore.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Kur prodhimi është i sigurt, shteti edhe qarkullimin monetar e ka të sigurt. Në qoftë se jepet një paradhënie prej 10 lekësh për ditë-punë, fjala vjen, dhe, në bazë të prodhimit, merren të ardhura më shumë, përsëri këto lekë personi nuk i harxhon të gjitha, një pjesë të tyre e kursen. Pra, ai nuk e harxhon të gjithë këtë shumë përnjëherë. Harxhimi i saj, në fakt, bëhet gjatë gjithë vitit. Siç thashë, ai nuk rri pa blerë diçka gjatë tërë kohës, prandaj me lekët e paradhënies për ditë-punë që i kanë caktuar, bën edhe ekonomi. Por, edhe po t'i caktohet më pak, ai prapë ka mundësi edhe të blejë, edhe të mbajë diçka prej saj, për ta përdorur më vonë. Pra, ndodh ajo që kemi thënë: kur paraja është e siguruar, njerëzit një pjesë e harxhojnë menjëherë, një pjesë të saj e shpenzojnë pjesë-pjesë dhe tjetrën e depozitojnë. Prandaj, lidhur me caktimin e masës së paradhënies duhet parë se ç'kritere ka. Në fakt, ajo duhet caktuar kështu: nga të gjitha të ardhurat që ka kooperativa, hiqen më parë fondet për investime dhe fondet e tjera të domosdoshme dhe me shumën që mbetet krijohet fondi i konsumit për pagë, që do t'u shpërndahet kooperativistëve për ditë-punë. Kjo, pra, tregon se sa fonde kanë mbetur për t'ua ndarë anëtarëve. Kjo është paga ditore dhe jo ajo që caktohet për t'u ndarë në fund të vitit. Pas kësaj i kërkohet shtetit nëse mund të japë ndonjë lek për këtë qëllim. Shteti, sipas rastit, mund të japë aq sa i ka mundësitë.

Për këtë sasi parash që mund të japë banka si kredi ne i kemi mundësitë t'i bëjmë llogaritë ekzakte. Për sa u përket fondeve që shpërndahen për pagimin e ditëve të punës në fund të vitit, nuk është e domosdoshme që shteti t'i këmbjë ato me mallra e me shërbime brenda një jave. Jo, sepse shteti ka krijuar edhe arkat e kursimit, dhe vetë, çdo njeri, si individ, përpiqet të heqë diçka mënjane, të vërë një çikë dhjamë, si i thonë fjalës. Por ka edhe nga ata që, në vend që t'i vënë kursimet e tyre në arkat e kursimit, i mbajnë në xhepa. Kjo nuk është e mirë. Prandaj arsyet që paraqitin në Krujë që shteti t'u japë kooperativistëve një paradhënie më të lartë etj., nuk janë shumë të shëndosha.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Lidhur me paradhënien, shoku Enver, ka një problem. Në kooperativat e tipit të lartë ndodh që kooperativistët marrin më tepër se të ardhurat që realizojnë me prodhimet që marrin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo nuk duhet lejuar të ndodhë më. E pse të marrin më tepër nga ç' meritojnë? Pse ia mbajmë paratë një punëtori, kur ai ka marrë diçka që nuk i takon? Në qoftë se punëtori nuk e realizon normën, atëherë do të marrë nën rrogë. Është kështu apo jo? Atëherë, ç'është ky favor që bëhet për kooperativat, qofshin ato edhe të tipit të lartë? Kooperativisti nuk ka të drejtë të marrë as edhe një për qind më shumë shpërblim nga sa i takon.

Unë kam mendimin që edhe përqindjen e kredisë shteti mund ta japë në bazë të prodhimeve që realizon kooperativa. Por ama jo të financojë shteti. Kjo çështje duhet parë, se shteti nuk mund të mbajë me para kooperativistët kur ata nuk prodhojnë për aq sa marrin.

Shikojini mirë këto probleme, sepse çrregullimet që po ndodhin në praktikë janë pasojë e shtrembërimeve të ligjeve e të orientimeve që janë dhënë. Këto të fundit duhet të zbatohen edhe në kooperativat e tipit të lartë. Çështja është këtu, mendoj unë, që nuk duhet të bëhen kooperativa të tipit të lartë ato kooperativa që nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme e, në radhë të parë, nuk kanë një prodhim të zhvilluar. Atëherë, për këto që tashmë janë bërë, lind pyetja: përse nuk prodhohet më shumë atje? Mos vallë, duke u krijuar mundësi të tilla pagimi, kjo ka ulur interesin për të shtuar prodhimin? Kooperativat e tipit të lartë duhet të dallohen, në radhë të parë, për prodhimin më të madh që duhet të japin e jo nga sasia e parave që marrin anëtarët e tyre, të cilat, siç po del, ka raste që ua jep shteti. Po ç'duhet atëherë kjo kooperativë e tipit të lartë, kur rezultatet janë të tilla? Pse ta realizojë planin kooperativisti, kur pagën e merr edhe duke punuar pak? Kujtojmë ne se fshatari u bë ashtu siç duhet të jetë, vetëm duke iu dhënë kooperativës titulli «Kooperativë e tipit të lartë»? Kjo praktikë që ndiqet nuk është aspak e drejtë dhe nuk duhen lejuar më të ndodhin të tilla deformime. Ligjet nuk duhen zbatuar në mënyrë mekanike.

Ne kemi vendosur që shteti të jetë pjesëtar në këto kooperativa dhe, nëse ai do të investojë, investimet caktohen nga vetë shteti në atë masë sa ka mundësi ai dhe restin e investon kooperativa. Investimet e shtetit kemi thënë që të mos konsiderohen si të kooperativës, por të jenë të shtetit dhe për to mbahen llogari më vete. Pra, të mbahet shënim që nesër shteti të dijë se sa ka dhënë dhe çfarë i takon të marrë. Edhe pagën



anëtarët e këtyre kooperativave do ta marrin në bazë të punës së tyre, pavarësisht se shteti ka bërë investime në to. Në rast se këto kooperativa nuk kanë fondet e tyre të garantuara të pagës, atëherë shteti u bën një favor dhe u jep paradhënie, por këtë nuk ua jep pa të drejtë kthimi. Ato duhet t'ia kthejnë këto fonde shtetit nga prodhimi që marrin. Në rast se nuk realizojnë prodhimin, atëherë duhet të marrin për ditë-punë më pak lekë nga sa që planifikuar. Kështu duhet të veprohet për këtë çështje.

Shpërblimi i punës në kooperativa dhe kreditimi nga ana e shtetit duhet të kuptohen drejt. Ekzistojnë kritere të studiuara për pagesat e ditëve të punës në këto kooperativa apo nuk ekzistojnë? Në fabrika janë vendosur normat dhe punëtori atje paguhet sipas realizimit të tyre. Prandaj edhe kooperativistët duhet të paguhen po ashtu sipas ditëve të punës. Punëtorit ia siguron shteti pagën, por në bazë të kritereve që përmenda, domethënë në bazë të prodhimit dhe të normës që ai realizon. Kooperativat e tipit të lartë ne i quajmë të tilla, që me punën e tyre ato t'u afrohen nga pikëpamja e rritjes së prodhimit ndërmarrjeve bujqësore. Prandaj themi që anëtarëve të këtyre kooperativave u sigurohet 80 për qind e pagës. Por kredia e dhënë për paradhëniet, do t'i rikthehet shtetit nga të ardhurat që do të marrë kooperativa prej punës së anëtarëve. Po të veprohet kështu, vitin tjetër nuk do të ngjasin më të tilla çrregullime si këto që po na thoni.

Duhet pasur kujdes që, edhe nëse kooperativa ia kthen kredinë e dhënë shtetit, këtë nuk duhet ta bëjë duke ulur fondin e akumulimit dhe fondin e investi-

meve. Në praktikë ka ndodhur që jo vetëm i ulin këto fonde, por kërkojnë nga shteti fonde suplementare, si për ujitje në formë shiu e të tjera. Atëherë shteti ka të drejtë t'u thotë se rregulli është që, më parë se të kërkojnë kredi, kooperativat krijojnë vetë rezervat e tyre për investime. Në qoftë se ato i kanë krijuar, atëherë edhe shteti ndihmon duke u caktuar fondet, si edhe planin se çfarë do të bëjnë kooperativat me këto fonde.

Duhet t'i mësojmë kooperativistët që të punojnë dhe të prodhojnë sa më shumë, ndërsa shteti do t'i ndihmojë me aq sa ka mundësi. Dhe ai i ka dhënë ndihma kolosale fshatarësisë kooperativiste. Prandaj kooperativisti, në fushë qoftë apo në mal, duhet të punojë që të shtojë prodhimet, dhe aq sa do të prodhojë aq edhe do të marrë, ky është parimi i madh i socializmit, sipas të cilit duhet ecur. Shteti do të ndihmojë kur ta shikojë të arsyeshme dhe me aq sa ka mundësi. Prandaj të bëhen mirë hesapet, për shembull, kur thuhet se duhet të shtohet fondi i pandashëm për investime. Këtë kooperativistët ta mendojnë mirë dhe kjo do t'i shtyjë që të punojnë për të marrë më shumë. Por që të marrin më shumë, është e nevojshme që kooperativat më parë të investojnë. Kjo bëhet e mundur kur në kooperativat punohet dhe shtohen prodhimet e të ardhurat dhe jo kur pritet vetëm t'u japë shteti. Derisa për klasën punëtore dhe për të gjithë të tjerët ne kemi rregulla të drejta për shpërblimin e punës, nuk mund t'i bëjmë favore në paga në ndonjë rrugë tjetër jo të drejtë fshatarësisë. Edhe në kooperativa shpërblimi duhet të bëhet në bazë të punës e të prodhimit të secilit. Vetëm me punë fshatarësia kooperativiste mund të

arrijë në një nivel më të mirë jetcse. Për këtë gjë po luftojmë, por kjo luftë të mos kuptohet shtrembër, se, në të kundërtën, zhvillohen ndjenjat mikroborgjeze të rehatisë, të zhvatjes më tepër nga sa i jepet shoqërisë. Të tilla prirje i shikojmë edhe në disa elementë të klasës punëtore. Prandaj puna politike këtu duhet të jetë në një nivel më të lartë. Parimet që kemi vendosur janë të drejta dhe në çdo çështje t'i kemi kurdoherë parasysh. Në qoftë se bëjmë ndonjë ndryshim në bazë të parimit, për ta zbatuar më mirë atë, dakord, por jo për ta zbatuar më keq e aq më pak për ta shkelur.

Këto çështje jo vetëm t'i shtrojmë, por kurdoherë të luftojmë që edhe t'i realizojmë e të mos mbeten varur. Kur në bazë ndeshet diçka që bie në kundërshtim me ato që kemi vendosur dhe nuk i jepet zgjidhje, atëherë problemi të çohet më lart. Por ato që mund të zgjidhen, le të zgjidhen drejt që atje në bazë. Për këtë të binden edhe shokët. Po qe nevoja, të rrihen mendime, të kritikohen konceptet e gabuara që mund të jenë shfaqur dhe gjërat të vihen në vend. Pastaj, pasi të jenë bërë të gjitha këto, raportohet lart: «Kishim këtë problem, të cilin e zgjidhëm në këtë mënyrë», ose, «na dalin këto probleme që kërkojnë zgjidhje» etj.

Prandaj të përpiqemi me sa të jetë e mundur që gjërat t'i shtrojmë drejt në bazë. Atje ku dalin të sqarohen problemet dhe të mos i lëmë të zvarriten. Ato probleme që nuk zgjidhen dot në bazë, duhet të vijnë këtu në qendër. Por mund të ketë edhe çështje të rëndësishme, për të cilat, edhe pse u zgjidhën në bazë, ne prapë duhet të vihemi në dijeni, të informohemi që

doli kjo ose ajo gjë dhe u zgjidh kështu ose ashtu, se mund të na shërbejë për të pasuruar eksperiencën që kemi.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar që gjendet në AQP*

## PSE SHKON TITOJA NË KINË?

Shënime

7 qershor 1977

Agjencitë e ndryshme të lajmeve shkruajnë se presidenti i Jugosllavisë, Josip Broz Tito, nga muaji gusht do të shkojë në Moskë e në Phenian, pastaj në Pekin. Këtë lajm e deklaroi nëpërmjet shtypit në Beograd ministri Italian i Punëve të Jashtme, Forlani, i cili u prit prej Titos. Po ashtu, e dha këtë lajm sot edhe agjencia jugosllave TANJUG. Vizita e këtij renegati në Pekin do të bëhet pikërisht në momentet e kthesës së madhe që ka marrë Kina drejt miqësisë së ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me gjithë botën tjetër kapitaliste kundër socialimperializmit sovjetik, për të cilin udhëheqja kineze trumbeton se është armiku kryesor dhe i vetëm i socializmit dhe i lirisë së popujve.

Titoja, pra, ky renegat i marksizëm-leninizmit, agjent i imperializmit amerikan dhe shërbëtor i borgjezisë kapitaliste botërore, do të pritet me entuziazëm të madh e me pompë nga një tjetër renegat i marksizëm-leninizmit, Hua Kuo Feni. Hua Kuo Feni ka nën sundim sot, deri kur nuk dihet, një popull prej 800 milio-

nësh, një kontinent të tërë, dhe renegati Tito, i cili është një dhelpër e vjetër, që di të manovrojë për të zhvatur kapitale dhe për të likuiduar socializmin, në Phenian dhe në Pekin do ta ndiejë veten si në shtëpinë e tij. Në Phenian, besoj, edhe Titoja do të çuditet me përmasat e kultit të mikpritësit të tij, kult që s'është parë e dëgjuar gjëkund as në kohë të kaluara, as në kohë të sotme, pale në një vend që quhet socialist.

Po edhe Hua Kuo Feni, i cili i zuri vendin Mao Ce Dunit, qëkurse fitoi puçi ushtarak që organizoi, ka filluar, gjithashtu, të bëjë një propagandë shurdhuese për të ngritur kultin e tij. Përveç të tjerave, dita me ditë jo një, po me dhjetëra delegacione të ndryshme venë në Kinë, disa për t'i bërë hosana këtij njeriu, disa të tjera për t'i bërë hosana pushtetit që ai vendosi, ose luftës që Hua Kuo Feni po zhvillon prej 8 a 9 muajsh kundër «katërshes», duke i quajtur «banditë», «kusarë», «kurvarë» e çfarë të duash. Në Kinë shkojnë grupe afa-ristësh të imperializmit amerikan dhe të shteteve të tjera kapitaliste për të bërë investime dhe për të siguruar tregje për mallrat e tyre.

Pra, mes këtyre të dyve, Hua Kuo Fenit dhe Kim Ir Senit, do të jetë edhe Titoja. Titos, Kina dhe Koreja i kishin mbetur pa vajtur, kështu ai po e realizon edhe këtë dëshirë. Në koleksionin e tij mungonin pikërisht pulla e Kinës dhe e Koresë, kurse pullat e Frankos dhe të Pinoçetit nuk i vuri dot, po edhe këto mund t'i vërë ncsër në albumin e tij të udhëtimeve për të zhvilluar intriga nën maskën e një politike të madhe botërore. Në fakt Titos s'duhet t'i hahet haku. Pavarësisht se është tradhtar i urryer, ai është një

element i zgjuar për intriga, për dallavere, për kombinacione dhe për shkombinacione. Prandaj vajtja e tij në Pekin nuk është një vizitë e thjeshtë, ajo është një vajtje për t'i treguar Kinës «madhështinë» e tij, për t'u treguar popullit kinez dhe Partisë Komuniste të Kinës: «Ja, unë jam ai që jam dhe udhëheqja juaj, kineze, u përul përpara meje. Meqenëse udhëheqja juaj është marksiste-leniniste dhe po përulet me ardhjen time në Pekin, kjo do të thotë se po përulet përpara një marksist-leninisti të madh, që i pari i bëri ballë Stalinit, po u bën ballë gjithë kapitalistëve botërorë, imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik» etj. Këto kërkon t'u thotë atyre Titoja.

Titoja shkon në Kinë, sigurisht, për të zhvilluar bisedime politike dhe ekonomike. Për sa u përket çështjeve ekonomike, Titoja ka shpresa të zgjidhë disa probleme të krizës që ka mbërthyer Jugosllavinë. Ky synim do të jetë në harkun e tij të shigjetave, por shigjeta tjetër e tij synon në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të grupit të Hua Kuo Fenit me imperializmin amerikan, jo se grupi i Hua Kuo Fenit nuk ka hyrë e nuk po zhvillon marrëdhënie të ngushta dhe miqësore që shkojnë duke u trashur me kapitalistët amerikanë, me koncernet dhe me trustet e mëdha amerikane, por një ndihmë e këtij agjenti amerikan mund t'u shërbejë edhe Uashingtonit, edhe Kinës.

Në Kinë Titoja do të japë e do të marrë premtime. Ai nuk shkon bosh as nga ana e sovjetikëve, as nga ana e imperializmit amerikan. Propozimet që do të bëjë, para se të vejë në Pekin, ai sigurisht do t'i ketë balancuar me të dyja superfuqitë, të cilat, natyrisht,

përpiqen të ndikojnë veç e veç dhe drejtpërdrejt në zhvillimin e ngjarjeve në Kinë, por edhe Titoja do të bëjë punën nga ana e vet.

Mendoj se puna e Titos në Kinë do të jetë në favor të imperializmit amerikan dhe në disfavor të socialimperializmit sovjetik. Këtë punë ai do ta bëjë, me siguri, në mënyrë të stërholluar, që do t'u vijë për hosh kinezëve, dhe këta do ta pranojnë me gjithë qejf. Në qoftë se Titoja do të çojë edhe nga ana e Brezhnjev-it propozime për një detantë me Kinën, pra për njëfarë ujdie, ose për fillimin e një ujdie midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, këtë Titoja do ta bëjë dhe i leverdis ta bëjë, se dëshiron me të madhe që të vazhdojë të luajë me tradhtinë e tij politikën e balancës mes imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, natyrisht, duke vënë ca kile më shumë nga ana amerikane.

Titoja do të marrë kapar nga të tria anët, nga dy superfuqitë e vjetra dhe nga superfuqia e re, që po ngrihet, që po «lycn me ar» shenjat e Republikës «socialiste» të Kinës. Pretendohet se Titoja do të vejë në Kinë si president i Republikës Federative të Jugosllavisë dhe jo si kryetar i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Kjo është një profkë, që shërben për të fshehur tradhtinë e udhëheqjes kineze, e cila nuk dëshiron ta zbulojë përnjëherë fytyrën e vet revizioniste. Ajo dëshiron të fshihet pas maskës së të ashtuquajturit marksizëm maoist, por realiteti është ndryshe. Vetë Maoja ka qenë pro Titos dhe kundër Stalinit, pavarësisht se ai ka deklaruar edhe të kundërtën, se Titoja është bërë i pandreqshëm dhe e vuri në një rang me



Hitlerin dhe me Hirohiton. Zëvendësit e tij, ose Hua Kuo Feni, të cilit Mao Ce Duni i paska thënë «tash që i more ti punët në dorë, po vdes i qetë dhe i sigurt», «e ndreqën» këtë renegat.

Është fakt se, me vajtjen në Kinë dhe në Kore, Titoja e ngre në arenën ndërkombëtare autoritetin e tij prej renegati. Kuptohet, ai e ngre këtë autoritet në botën e intrigave kapitaliste, në botën e skllavërimit të popujve, dhe ky titull atij do t'i mbetet.

Kurse Kim Ir Seni mendon që vajtja në Kore e Titos, të cilin e konsideron si njeri të madh, do t'i krijojë kredi edhe më shumë përpara popullit për të forcuar kultin e vet. Kim Ir Seni ka shumë shpresa tek Titoja dhe do ta presë atë me përzemërsi e me pompë të madhe, se e di që Titoja është i dërguari i Karterit, i amerikanëve. Kim Ir Seni dëshiron që të ketë lidhje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të vendosë marrëdhënie diplomatike me këtë vend, që ky ta zbutë qëndrimin e tij ndaj Koresë.

Sa për çështjen e unitetit ose të bashkimit të dy shteteve koreane ky është një problem që nuk zgjidhet tani. Por në qoftë se ky bashkim nuk do të bëhet në rrugën marksiste-leniniste, kuptohet se nuk do të jetë në favorin e socializmit.

Prandaj në Kore Titoja shkon për të bërë traktative mes imperializmit amerikan dhe Kim Ir Senit, se që të marrë kredi nga Koreja, në këtë vend nuk ekzistojnë kasaforta për Titon. Koreja është e krimbur për vete në borxhe, aq sa nuk është në gjendje t'i shlyejë.

Për sa i përket «botës së tretë», Kim Ir Seni prete-

ndon të jetë jo vetëm pjesëtar, por, mundësisht, edhe lideri i saj. Gjithashtu pretendon që në gjithë botën të përhapen me shpejtësi të madhe idetë «çuçe», domethënë idetë kimirseniste. Të gjitha këto pretendime nuk i prishin ndonjë punë Titos, i cili, siç e dimë, hiqet si lideri i «botës së paangazhuar», i «shteteve të paangazhuara». Në Phenian do të puthen të dy «liderët», siç janë të puthura edhe të dyja botët e tyre. Të dyja palët do të kenë bekimin kryesisht të imperializmit amerikan, por, në disa drejtime, edhe të socialimperializmit sovjetik dhe të atij kinez.

**Udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës tradhtoi. Edhe në Kore udhëheqja e Partisë së Punës të Koresë mund të themi se në ato ujëra është. Titoja po, dihet se është një tradhtar i vjetër. Kjo, natyrisht, është një e keqe e madhe që po i bëhet revolucionit, është një regres dhe një humbje e rëndë për marksizëm-leninizmin. Por kjo e keqe që po ndodh e që nuk varet nga ne, derisa po ndodh, ka edhe të mirën e saj dhe kjo e mirë është se këta njerëz, këto grupe, këto klika po demaskohen dhe marksistë-leninistët e vërtetë, revolucionarët, proletariati botëror që po vuan, që lufton e vritet nëpër demonstrata, nëpër greva, shikojnë se si shtypësit e tyre, kapitalistët, imperialistët dhe agjentët e vënë nga këta, që hiqen sikur janë komunistë, sikur janë marksistë-leninistë, po komplotojnë në kurrizin e revolucionit, në kurrizin e popujve. Kjo tradhti e madhe, pra, do t'u hapë sytë njerëzve dhe lufta kundër këtyre tradhtarëve nga ana e popujve dhe e marksistë-leninistëve do të zhvillohet në sasi dhe në cilësi. Do të vijë koha që në vende të ndryshme proletariati i çdo vendi, me par-**

tinë e vet të vërtetë marksiste-leniniste, do të godasë pushtetin e kapitalit.

Marksizëm-leninizmi nuk ka vdekur, as nuk është plakur, ai është kurdoherë revolucionar, është i ri, ai është forca lëvizëse e botës aktuale. Është revolucioni i udhëhequr nga proletariati ajo forcë e madhe që do të transformojë botën, dhe jo ajo lloj «botë e tretë» që e trumbetojnë Maoja dhe maoistët. Dje, në darkën që udhëheqësit kinezë dhanë për Nimeirin e Sudanit, Li Hsien Nieni tha, mes të tjerash, se «imperializmi dhe socialimperializmi nuk janë një forcë e madhe, por sot jemi ne, bota e tretë, forca më e madhe në botë». Çfarë do të bëjë kjo «forca më e madhe në botë»? Li Hsien Nieni, ky farë politikani i madh, nuk e shpjegoi, por me këtë «forcë të madhe» ai donte të thoshte se «në këtë botë të tretë jemi edhe ne kinezët, prej 800 milionë njerëzish, prandaj ne po ngrihemi në një forcë të madhe, dhe ju sudanezët e popuj të tjerë gjysmëkolonialë bashkohuni me ne, sepse ne do t'ju drejtojmë». Ky ishte kuptimi, me fjalë të tjera, i kësaj thënieje.

Pra, në këto kushte dhe situata të vështira për kapitalizmin dhe për imperializmin po lëvrijnë gjarpërinjtë antikomunistë e antimarksistë, si në Uashington, ashtu edhe në Moskë e në Pekin, ku ekzistojnë situata të vështira për klikat në fuqi. Ndryshime po bëhen kudo, lëkundje të mëdha po konstatohen dhe të gjitha këto ndryshime nuk flasin për forcën, por për kalbëzimin e imperializmit dhe për zëvendësimin e tij me socializmin.

Disfata që ka pësuar lëvizja komuniste ndërkombëtare, është e përkohshme. Duhet ngjitur mali, por

malin do ta ngjitë proletariati me flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Shë-  
nime për Kinën», vëll. II,  
f. 505*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Shënime për  
Kinën», vëll. II, f. 505*

## **TË MARRIM MASA TË MËTEJSHME PËR TË FORCUAR PUNËN DHE KONTROLLIN**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**17 qershor 1977**

Dëshiroj të bëj edhe unë<sup>2</sup> disa vërejtje për realizimin e planit të gjashtëmujorit të parë të këtij viti, duke u mbështetur në të dhënat që na jepen në raportin që do t'i paraqitet për shqyrtim Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë.

Punonjësit tanë, me komunistët në krye, janë mobilizuar për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 7-të dhe veçanërisht për të realizuar e për të tejkaluar planet ekonomike. Këto përpjekje, në përgjithësi, kanë dhënë rezultate të kënaqshme, pse puna është organizuar më mirë politikisht e organizativisht

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi plotësimin e pritshëm të planit të gjashtëmujorit të parë dhe mbi masat për të plotësuar planin vjetor», që do t'i paraqitej Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë.

2. Meqenëse shoku Enver Hoxha nuk merrte pjesë në këtë mbledhje, diskutimin e tij e lexoi shoku Ramiz Alia.

dhe ka një ngritje të ndjeshme në kuptimin ideologjik të problemeve.

Në bujqësi, veçanërisht, që është një sektor shumë i rëndësishëm i ekonomisë sonë, punët po na ecin më mirë. Edhe sivjet do të kemi një vit të mbarë bujqësor. Kjo rrjedh nga mobilizimi i organizatave të Partisë dhe i organeve të pushtetit në rrethe, i organizatave-bazë në kooperativat e ndërmarrjet bujqësore, nga puna e palodhur e punonjësve të bujqësisë, të SMT-ve, si dhe nga mobilizimi i punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë, të cilën e kemi forcuar e në krye të saj kemi sjellë kuadro që e njohin bujqësinë dhe janë shokë të vendosur e të ngritur politikisht. Natyrisht, janë bërë përpjekje për të shfrytëzuar edhe kushtet atmosferike, të cilat, në përgjithësi, kanë qenë të favorshme, megjithëse gjatë periudhës së mbjelljes së grurit koha e keqe na ka penguar. Por, pikërisht në ato kushte të vështira, u mobilizuan mirë punonjësit e bujqësisë, sidomos kooperativistët, gjë që ndihmoi të kapërcehen, bile me shumë sukses, pengesat dhe vështirësitë që na shkaktuan shirat e vazhdueshme. Kështu, sipas të dhënave paraprake, del që planin e grurit jo vetëm do ta realizojmë, por edhe do ta tejkalojmë.

Është viti i dytë që planin e grurit dhe në përgjithësi të drithërave po e realizojmë, pse edhe misri këtë vit paraqitet shumë mirë dhe, siç është theksuar në raport, do të marrim masa që edhe atij t'i bëhen të gjitha shërbimet e nevojshme, prandaj janë të gjitha mundësitë që planin ta tejkalojmë. Kështu na bëhen dy vjet rresht që drithërat kanë marrë një rrugë të mirë. Tash duhet të punojmë me këmbëngulje që kjo rrugë

të vazhdohet të ndiqet dhe Partia e gjithë punonjësit e bujqësisë ta kuptojnë mirë se është dashur të merren masa të gjithanshme, që nga punimi dhe kullimi i tokave, zgjedhja e farërave, mbjellja e hershme, ujitja, shërbimet e ndryshme dhe deri te korrja me kohë dhe pa firo. Në qoftë se këto detyra agroteknike, që janë njëkohësisht edhe politike e ideologjike, kuptohen thellë dhe kryhen gjithnjë e më mirë, nuk ka asnjë dyshim që prodhimi i drithërave të ne do të shtohet çdo vit.

Zgjidhja e problemit të drithërave, që është problemi kyç i bujqësisë, të na bëjë të mendojmë që, në këtë mënyrë, me këto ritme dhe me këtë shpejtësi, të përparojnë edhe degët e tjera të bujqësisë. Kjo na vë detyrën që ta organizojmë mirë punën edhe në këto drejtime, pse duhet të kemi parasysh ekzistencën e prires së njëanshme të kooperativistëve dhe të organizatave-bazë të Partisë në kooperativa bujqësore që, duke u justifikuar me interesimin që duhet të kenë vazhdimisht për drithërat, nuk u kushtojnë të njëjtin kujdes edhe sektorëve të tjerë.

Nuk qëndron çështja se mobilizimi e kujdesi për drithërat e bukës, e veçanërisht për grurin, janë të tillë sa të pengojnë Partinë dhe kooperativistët për t'u kushtuar vëmendjen e duhur sektorëve të tjerë, gjithashtu shumë të rëndësishëm të bujqësisë, siç janë blegtoria, bimët industriale, pemëtaria dhe hortikultura. Shërbimet që kërkohet t'i bëhen misrit, i cili, natyrisht, ka më tepër nevojë për mjete të mekanizuara dhe për forca pune, nuk mund ta justifikojnë këtë njëanshmëri në bujqësinë tonë, mbasi sipërfaqet që mbjellim me mi-

sër janë më të vogla nga ato të grurit. Prandaj, në rast se të gjitha shërbimet i bëhen misrit me kohë, në bazë të kalendarit agroteknik të caktuar, forcat tonë njerëzore, si dhe mjetet e mekanizuara, me një organizim më të shëndoshë, janë në gjendje të përballojnë me sukses edhe të gjitha detyrat e tjera që i vihen përpara bujqësisë.

Të mos harrojmë se vitin e kaluar nuk u arritën detyrat e planit të prodhimit të bimëve industriale, gjë që e vuri shtetin në vështirësi. Kjo ndodhi se për bimët industriale, veçanërisht për pambukun dhe për panxharin e sheqerit, siç shikohet edhe në raport, nuk u tregua kujdes. Për shkak të pakujdesisë së pajustificuar, vetëm në trajtimin e panxharit ne humbëm afro 2 000 tonë sheqer. Kështu na ndodhi edhe në bimë të tjera industriale, si në pambuk, për shembull, ku nuk e realizuam planin, po kështu edhe në bimët vajore. E njëjta gjendje ka rrezik të na përsëritet edhe sivjet, pavarësisht se e kryem më përpara në kohë mbjelljen e këtyre bimëve, në rast se nuk do të nxjerrim më sime nga mosrealizimet. Prandaj përfitimin që kemi nga mbjellja në kohë e bimëve industriale, ta kemi si një atu për shtimin e përparësive që duhet të bëjmë për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këto bimë, pse, në fakt, ishte pikërisht mungesa e shërbimeve që na shkaktoi mosrealizimin e planeve të tyre.

Një gjë e tillë po vazhdon të na ngjasë sivjet me perimet. Kjo vjen se akoma kooperativistët tanë nuk arrijnë të kuptojnë rëndësinë e madhe të perimeve, të cilat janë një ushqim po aq i domosdoshëm për popullin si edhe buka, mishi, qumështi, vezët etj. Sepse nuk



kuptohet vlera e tyre ushqimore dhe ekonomike, prandaj nuk bëhen përpjekjet që duhen për të realizuar detyrat në këtë drejtim. Siç del nga raporti, e njëjta gjendje ka vazhduar me perimet gjatë muajve të kaluar, sidomos në shkurt, mars dhe prill të këtij viti, kur në treg ka pasur mungesa të tyre, aq sa plani në tremujorin e parë u realizua vetëm 50 për qind. Edhe plani gjashtëmujor i perimeve nuk do të realizohet veçse në masën 75-80 për qind.

T'i hedhim tani një sy gjendjes së blegtorisë, që është bërë me të vërtetë problem shumë serioz. Në një vend si yni, që ka tradita të mira blegtorale, vëmë re një pjellshmëri të ulët të bagëtive: të lopëve 60-70 për qind, të deleve 70-75 për qind, dosat na japin vetëm 4-5 gica dhe këta shpesh ngordhin para se të arrijnë peshën mesatare. Na vjen shumë keq kur shohim që në rrethet e Dibrës, të Kukësit dhe të Pukës ngordhin deri në 20 për qind të viçave, 30 për qind, e bile më shumë, të qengjave, pa bërë fjalë për gicat, për të cilët nuk tregohet pothuajse asnjë kujdes. Atëherë si mund të flitet për realizimin e planit të mishit? Duhet të vazhdojmë të ecim në një rrugë të tillë? Na lejohet vallë ta neglizhojmë deri në këtë shkallë blegtorinë, për të cilën kemi marrë edhe masa që na kanë kushtuar shumë, duke sjellë me shumicë lopë dhe desh të racës e duke praktikuar prej kohësh ndërzimin artificial? Për këtë problem kaq të rëndësishëm kemi folur shpesh, kemi folur edhe për kontrollin që duhet të ushtrohet për zbatimin e detyrave, pse realizimi i planit të mishit është një problem i madh jetik për popullin dhe për ekonominë tonë socialiste.

Kam përshtypjen se jo kudo luftohet sa duhet për të zbatuar orientimet dhe porositë e Partisë për problemet e blegtorisë. Midis të tjerave, kemi theksuar se një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e blegtorisë është sigurimi i bazës ushqimore. Ne, në qoftë se nuk gabohem, kemi caktuar deri 100 000 hektarë tokë arë për këtë qëllim. Mirëpo çfarë ndodh? Nga rreth 100 kuintalë njësi ushqimore që duhen siguruar për çdo hektar, mezi merren 30-40 kuintalë, dhe këta në zonat fushore. Numërohen me gisht kooperativat bujqësore që kanë arritur të marrin 70-80 kuintalë njësi ushqimore për hektar. Çfarë do të bëjmë ne, shoqe dhe shokë? Do të vazhdojmë vetëm të qahemi për bazën ushqimore të bagëtive, apo do t'i përvishemi kësaj pune me seriozitetin më të madh dhe ta kryejmë plotësisht, ashtu siç po kryejmë detyrën për realizimin e planit të drithërave? Mendoj se janë të gjitha mundësitë të dalim nga prapambetja në këtë sektor kaq të rëndësishëm, prandaj të bëjmë kthesë dhe sa më parë.

Po pemëtarisë a do t'i futemi seriozisht? Në vendin tonë mund të rriten pothuajse të gjitha llojet e frutave dhe me cilësi të mirë. Ne kemi arritur mjaft suksese në zhvillimin e pemëtarisë. Ndërmarrjet bujqësore, sidomos, por edhe shumë kooperativa, kanë mbjellë blloqe pemësh, pse tashmë është krijuar bindja se vetëm me blloqe mund të realizohen synimet tona për këtë sektor. Megjithatë duhet pranuar se vazhdon një neglizhencë e dënueshme për sa i përket trajtimit të pemëve që kemi mbjellë. Në shumë vende drurët frutorë janë mbuluar nga barërat e këqija dhe shkurret, që s'i lënë të marrin frymë; atyre nuk u bëhen të gjitha

shërbimet e parashikuara agroteknike, nuk krasiten si duhet, nuk plehërohen etj., etj. Me një qëndrim të tillë, është e kuptueshme, nuk mund të na ecë pemëtaria. Kjo kërkon punë sistematike që të mund të bëhet një degë e fuqishme e bujqësisë sonë, për të mirën e popullit e të atdheut.

Dobësitë që përmenda tregojnë mungesë të theksuar disipline. Që bujqësia jonë të qëndrojë fuqimisht në binarët e një ekonomie socialiste moderne, për degët e saj kryesore, siç janë blegtoria, bimët industriale, pemëtaria, perimet etj., duhet të tregohet kujdes i madh dhe planet në të gjitha këto drejtime të realizohen.

Natyrisht, mosrealizimi i planit të perimeve, si dhe të mishit, të vezëve, të qumështit, të gjalpët e të frutave, bën që jo vetëm të mos i jepet popullit ajo sasi produktesh që është parashikuar për ushqimin e tij, jo vetëm të mos realizohet plani i eksportit që parashikohet, por edhe të krijohen vështirësi financiare, për arsye se punonjësve u mbeten shuma jo të vogla të hollash, që nuk mbulohen me mallra. Po të realizoheshin planet ritmiksht në të gjitha drejtimet, në treg do të kishte më shumë mallra dhe këto para do të shpenzoheheshin vazhdimisht çdo ditë.

Vështirësi financiare krijohen edhe nga stoqet e mallrave të tepërta ose me cilësi të dobët të prodhuara nga industria jonë. Për këto mallra që nuk shiten në kohë, ose është faji i tregtisë, ose industria prodhon jo në bazë të një plani të hartuar sipas nevojave dhe kërkesave të popullatës. Njerëzit dëshirojnë dhe presin të blejnë sende, si, fjala vjen, lavatriçe, që vërtet kush-tojnë shumë, por janë të nevojshme për ta. Atëherë,

derisa çështja qëndron kështu, pse nuk shiten ato që kemi prodhuar? Po kështu mund të themi edhe për radiot. Mallra të tilla që prodhohen me lëndë të parë importi, por që s'kanë cilësinë e duhur dhe nuk u përgjigjen kërkesave të tregut, ne i përplasim nëpër depo. Atëherë çfarë të bëjmë me to, të veprojmë siç propozohet, që miliona lekë vlera materiale t'i shkrijmë ose t'i vëmë në përdorim për qëllime të tjera? Jo, masa të tilla janë antiekonomike dhe në asnjë mënyrë nuk na lejohet t'i marrim.

Çështjet që përmenda tash në fund, Qeveria ka bërë mirë që i ka marrë në shqyrtim, por ajo t'i analizojë një nga një dhe të vendosë se çfarë do të bëhet për to, ç'rrugë do të marrin. Këtë problem ne e kemi diskutuar shumë herë në Byronë Politike, në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë dhe në instanca të tjera, prandaj t'i japim rrugëzgjdhje dhe të mos pajtohemi me prodhimin e sendeve të panevojshme ose me shumicë të cilat kërkojnë afat shumë të gjatë shitjeje ose na krijojnë stocqe. Kjo anomali fillon që me planifikimin dhe fshihet pastaj me realizimin e planit në global, me plotësimin e normave të pastuduara etj. Këtë çështje, që lidhet edhe me mungesën e ngritjes politike të punëtorëve, të drejtuesve të ndërmarrjeve dhe të vetë punonjësve të ministrive, e kam ngritur edhe herë të tjera, por më duket se në këtë drejtim duhet të bëhen akoma përpjekje të mëdha, ndryshe do të vazhdojë prodhimi i mallrave që nuk do t'i blejë populli, në një kohë që për to harxhojmë të holla dhe lëndë të parë shumë të vlefshme.

Këto të meta serioze Partia nuk duhet t'i lejojë të

ndodhin. Në qoftë se nuk u bëhet e qartë masave politike dhe ideologjike të rëndësia e problemeve, atëherë këto do të zgjidhen në mënyrë të njëanshme.

Njëanshmëria në drejtimin e ekonomisë mund të çojë në pasoja të rënda e të rrezikshme jo vetëm ekonomike, por edhe politike e shoqërore. Për njëanshmëri flasin rastet e mosrealizimit frontalisht të planit në bujqësi apo në industri, në tregti apo në komunikacion, shkëputja e treguesve të planit ekonomik nga realizimi i treguesve financiarë të brendshëm, rendja pas sasisë në dëm të cilësisë, rritja e fondeve të shpërndarjes e të shpërblimit në një pjesë kooperativash bujqësore mbi rezultatet e arritura në prodhim dhe në kurriz të akumulimit. Njëanshmëri ka edhe atje ku bëhen përpjekje për shtimin e prodhimit duke nënvleftësuar efektivitetin e shpenzimeve që kryhen, ku rendet pas metrazhit të shpim-kërkimit ose të punimeve minerare, pa zbuluar e pa dhënë rezerva gjeologjike e industriale për mineralet që kërkohen etj.

Sikurse shihet, fenomene negative të njëanshmërisë në zbatimin e planit dhe në metodën e drejtimit të ekonomisë ekzistojnë dhe dëmet e rreziqet që rrjedhin prej tyre nuk janë të vogla. Kjo shfaqje e huaj, me përmbajtje të thellë klasore, duhet të luftohet me forcë. Për këtë vetë Partia, në radhë të parë, të luftojë me vendosmëri dhe t'ua bëjë mirë të qartë të gjithëve se njëanshmëria në drejtimin e ekonomisë është liberalizëm ndaj disiplinës së planit, është orvatje për t'u hapur fushë të lirë veprimi fenomeneve të spontaneitetit dhe për të krijuar shpërpjesëtime dhe anomali të tjera,

është shmangie nga zhvillimi i planifikuar e proporcional i ekonomisë.

Aktualisht kjo shfaqje e rrezikshme në drejtimin e ekonomisë plekset me shfaqjet e globalizmit në planifikim e në zbatimin e planeve të zhvillimit tonë ekonomik e kulturor. Me gjithë përpjekjet që kemi bërë dhe përmirësimet që po vihen re, sidomos këto kohët e fundit, këtu lufta kërkohet të çohet më me vendosmëri përpara. Duhet të kuptohet mirë dhe thellë se globalizmi, si një aspekt mjaft i rrezikshëm i burokratizmit e i liberalizmit në ekonomi, si një drejtim në përgjithësi që bazohet në empirizmin dhe në praktikizmin e ngushtë, mohon shkencën dhe ligjet objektive të drejtimit të ekonomisë, denigron politikën ekonomike të Partisë.

Kjo luftë përbën aktualisht një problem të madh e të mprehtë politiko-shoqëror, sepse fenomenet e shfaqjet e huaja në drejtimin e ekonomisë nuk vlerësohen kurdoherë si shkelje e shtrembërime të politikës së Partisë, të parimeve dhe të normave të drejtimit tonë socialist, si prirje për të vënë interesat e ngushtë personale, lokalë apo dikasteriale mbi interesin e përgjithshëm. Lufta kundër këtyre fenomeneve e shfaqjeve negative do të zhvillohet me sukses kur Partia ta marrë më mirë në dorë punën dhe të mobilizojë masat e gjera punonjëse, e në radhë të parë klasën punëtore. Në të njëjtën kohë është e nevojshme që të marrim masa të mëtejshme për të përsosur metodologjinë e planifikimit dhe treguesit e planit, në mënyrë që të mbyllen shtigjet që lejojnë shfaqjet e globalizmit dhe të forco-

hen më tej puna e kontrolli nga organet shtetërore dhe nga ato ekonomike.

Për të gjitha sa thashë, është e domosdoshme që vendimet që marrim këtu në Byronë Politike ose në Plenum, të zbatohen absolutisht. Por që këto vendime të zbatohen drejt, është e nevojshme të zbrërthehen një nga një e të shpjegohen më parë politikisht, ekonomikisht, por dhe nga ana financiare, me qëllim që të kuptohet thelbi i tyre. E them këtë, pse shumë po abuzohet, fjala vjen, me çështjen e ditëve të punës në kooperativat bujqësore. Të hollat harxhohen, paga jepet, por puna që kryhet dhe cilësia e saj nuk janë në shkallën e duhur.

Ne e kemi lidhur prodhimin me pagën, me ditën e punës, por më duket se akoma më shumë duhet ta lidhim, bile në çdo sektor të bujqësisë. Në qoftë se nuk do ta bëjmë këtë, atëherë te punonjësit e bujqësisë nuk mund të krijohet ajo ndërgjegje e shëndoshë socialiste që do t'i nxitë për një punë rentabël, e cila të japë rendimentin e parashikuar. Të gjithë e kemi të qartë se është prodhimi ai që do t'ua përmirësojë jetën punonjësve të bujqësisë dhe jo dembellëku ose puna e bërë shkel e shko. Mundet që për një kohë kooperativistë të marrë, ta zëmë, një ditë-punë më shumë ose me vlerë më të lartë nga prodhimi, por kjo do të bjerë në kurriz të investimeve. Në qoftë se nuk sigurohen investime për riprodhimin e zgjeruar socialist në bujqësi, si në çdo sektor tjetër të ekonomisë popullore, atëherë nuk mund të ketë rritje të prodhimit, zhvillim të mëtejshëm të forcave prodhuese dhe mirëqenia e njerëzve, të cilën disa nuk e kuptojnë thellë, nuk do

të realizohet ashtu siç e kemi planifikuar. Për këtë, natyrisht, fajin nuk do t'ua ketë kush, por ata vetë. Partia duhet t'ua shpjegojë punonjësve të gjitha këto gjëra e njëkohësisht të organizojë mirë punën dhe kontrollin e zbatimit të detyrave. Ky kontroll të jetë vazhdimisht në rendin e ditës. Asnjë përjashtim të mos bëhet, asnjë familjaritet të mos lejohet, ndryshe dëmtohet ekonomia socialiste, si prona e përbashkët e të gjithë popullit, ashtu edhe prona e grupit.

Ne duhet të bëjmë kujdes, gjithashtu, për koston e prodhimeve. Shumë na kushton prodhimi i pambukut, i qumështit, i mishit, i vezëve, i frutave etj. Të mos harrojmë se ne i mbajmë stabël çmimet e tyre, por, që të vazhdojmë kështu edhe kur ato na kushtojnë më shumë, do të thotë se duhet t'i subvencionojmë. Mirëpo subvencionimi i tyre dhe i një sërë prodhimesh të tjera të disa ndërmarrjeve të rëndësishme industriale që prodhojnë mallra të konsumit të përditshëm për popullin, nuk është karakteristikë e një ekonomie të përparuar socialiste. Deri tashti ne e kemi shikuar, e kemi ngritur dhe kemi folur për këtë çështje, megjithatë përsëri vazhdojmë të kemi humbje në mjaft ndërmarrje dhe të subvencionojmë shumë prodhime që nuk ka asnjë arsye t'i subvencionojmë. Subvencionimi rrjedh për shkak të të gjitha atyre dobësive që thashë më lart, duke filluar që nga organizimi jo i mirë i punës e deri te mungesa e kontrollit, e lidhjes së pagës me normat, e ditë-punës me prodhimet, qoftë në ndërmarrjet shtetërore, qoftë në kooperativat bujqësore.

Në sektorin e ndërtimeve, nga të dhënat që jepen në raport, duket sikur janë bërë përmirësime. Këtë



unë nuk e mohoj, por duhet të jemi shumë kërkues dhe të organizojmë kontrollin e zbatimit me rreptësi të vendimeve. Mosrealizimi i planit të ndërtimeve në mjaft vepra vërtet është shkaktuar nga mungesat e makinerive dhe të pajisjeve që nuk kanë ardhur nga Kina, etj., por këtu duhen parë edhe mungesat e theksuara në organizim dhe në ndërgjegjen në punë të punonjësve tanë. Le të marrim vetëm një çështje që shtrohet në raport: shumë makineri që kanë në dorë Ministria e Ndërtimit dhe ndërmarrjet që varen prej saj, trajtohen keq dhe nuk vihen në shfrytëzim të plotë. Vallë na lejohet një qëndrim i tillë ndaj gjithë këtyre makinerive, që zëvendësojnë fuqinë e krahut, në një kohë kur kemi një klasë punëtore relativisht të madhe dhe disponojmë shumë uzina mekanike? Kjo nuk duhet të lejohet në asnjë mënyrë. Këtu ka një mungesë ndërgjegjeje deri edhe te mjaft elementë të klasës punëtore që i kanë në dorë këto pasuri të mëdha.

Partia e ka për detyrë të punojë pa u lodhur që klasa jonë punëtore të interesohet vazhdimisht dhe intësisht për makineritë me të cilat punon. Çdo punëtor makinën që ka në ngarkim ta mbajë me kujdes, në mënyrë që ajo të punojë për vite me radhë dhe me rendiment të lartë. Është e domosdoshme që, për interesat e ndërtimit të socializmit, dhe sidomos në rrethanat në të cilat gjendemi ne, këto makineri që i sjellim nga jashtë me devizë, t'i ruajmë si sytë e ballit. Deviza me të cilën i blejmë mallrat që importojmë duhet siguruar nga ne. Për këtë qëllim është e domosdoshme të punojmë që të rritim prodhimin, si për plotësimin e nevojave tona, ashtu edhe për eksport. Të gjithë e kemi

të qartë që, në qoftë se nuk eksportojmë, nuk kemi si të importojmë. Po të mos importojmë makineritë, pajisjet dhe mallrat, për të cilat ka nevojë ekonomia, punët do të na çalojnë. Nuk duhet të kemi shumë shpresa se do të na japë kredi Kina dhe se do të sjellim prej andej vinça, traktorë, pajisje e makineri të tjera të mëdha. Jo. Por të bëhet kujdes që traktorët që kemi aktualisht t'i shfrytëzojmë në mënyrë racionale dhe jo të vazhdojmë të kryejmë me ta të gjitha proceset e punimeve, duke përfshirë edhe ato që fare mirë mund të bëhen me qe, me forca pune ose me mjete të tjera të thjeshta.

Më bën veçanërisht përshtypje fakti se veprat e bonifikimit dhe të ujitjes janë prapa dhe për mungesë interesimi të mjaftueshëm ato nuk po na realizohen. Edhe për këtë problem ne kemi folur shumë herë, kemi kritikuar pakujdesitë, kemi marrë edhe masa, por unë mendoj që, në rast se do të vazhdojmë t'ia lëmë në varësi Ministrisë së Ndërtimit sektorin e bonifikimeve dhe të ujitjes, do të vazhdojmë të mbetemi në këtë situatë. Kjo ministri po e neglizhon këtë detyrë dhe mjetet e destinuara për bonifikime e ujitje i përdor shpeshherë në objekte të tjera. Prandaj do të ishte më e arsyeshme që këtë sektor ta vinim në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, duke i kaluar kësaj gjithë aparatit dhe makineritë që disponohen për bonifikimin e ujitjen dhe, për drejtimin e kësaj pune, të caktojmë në Ministrinë e Bujqësisë edhe një zëvendësministër. Dikasteri i Bujqësisë, me këtë sektor kaq të rëndësishëm që ka të bëjë me probleme që i takojnë atij drejtpërdrejt, do të dijë t'i kullandrisë më mirë makineritë që disponohen për

bonifikimet dhe ujitjen, mendoj unë, se është në gjendje të bëjë vlerësimin e tyre dhe të çmojë përfitimin e madh që do të ketë ekonomia jonë bujqësore nga përvetësimi sa më parë i tokave të përmirësuara dhe të ujitura. Kur ne i vëmë rëndësi dhe arrijmë të realizojmë planin e hapjes së tokave të reja në kodra e rrëpira, si të mos luftojmë që të realizojmë sa më parë veprat e bonifikimit dhe të ujitjes që kemi filluar në gjithë ato fusha, si në Durrës, në Hoxharë etj., ku do të fitojmë me mijëra e mijëra hektarë tokë? Mendoj se, me masën që propozoj të marrim, nuk do ta ngarkojmë Ministrinë e Bujqësisë aq sa kjo të mos jetë në gjendje të ndjekë detyrat e tjera të shumta që i janë ngarkuar, sidoqoftë, çështja e bonifikimit dhe e ujitjes është një nga detyrat kryesore të saj, prandaj them që këtë punë ta marrë vetë në dorë.

Konstatojmë se edhe Ministria e Industrisë dhe e Minerave nuk po i realizon kudo planct. Gjithë ato makineri që ka në dispozicion edhe ky dikaster, siç thuhet në raport, nuk po shfrytëzohen veçse në masën 80 për qind.

Spektori i minierave është me rëndësi të madhe për ekonominë tonë. Në raport janë shtruar mirë çështjet, si për minierat, ashtu edhe për sektorin e naftës, gjendja e prapambetur e të cilit duhet të na preokupojë seriozisht. Plani i zbulimit të vendburimeve të reja dhe i sigurimit të rezervave industriale të naftës këtë gjashtëmujor është realizuar 64 për qind, kurse ai i shpimeve 88 për qind. Pra, plani nuk po realizohet, gjë që na krijon vështirësi. Në Kongresin e 7-të të Partisë është folur posaçërisht për këtë problem të madh, gjë-

thashtu, e kemi trajtuar në shumë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike. Edhe Qeveria e ka marrë shpeshherë në studim, por gjendja nuk po lëviz si duhet. Prandaj, siç theksohet në raport, në sektorin e naftës kërkohet të bëhet medoemos një kthesë serioze. Kjo kthesë duhet të bëhet, së pari, në konceptet tekniko-shkencore të kërkimit e të shfrytëzimit të naftës, por edhe në metodat e zbatimit të të gjitha kërkesave të tjera.

Të gjitha këto që thuhën në raport për naftën dihen dhe janë të drejta, vetëm se duhen zbatuar. Punonjësve të këtij sektori mundet që diçka u mungon dhe këtë duhet ta zbulojë e ta zgjidhë Partia, e cila e ka për detyrë t'i ndihmojë si duhet njerëzit tanë që merren me këtë punë. Kur them Partia, kuptoj gjithashtu edhe organet përkatëse shtetërore, duke filluar që nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave e pastaj me radhë të gjitha ndërmarrjet e sistemit të naftës dhe udhëheqjet e tyre po ashtu, për arsye se po vazhdohet të mos zbulohen fusha të reja naftë. Gjendja në këtë sektor është shqetësuese. Prandaj, si baza, edhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave, këtë problem kaq të rëndësishëm që shtroi Kongresi dhe po e shtrojmë përsëri këtu, në Komitetin Qendror, duhet ta zgjidhin. Kjo u vë atyre detyrën që të marrin të gjitha masat, t'i bëjnë medoemos një analizë dhe kontroll sistematik punës së tyre, me qëllim që të sqarohet situata dhe së shpejti të kemi rezultate.

Në miniera po e realizojmë planin dhe kjo është një gjë shumë e mirë, por vihet re se plani realizohet kryesisht si global, pse, po të futesh në brendësi të punës

së minierave, zbulon shumë të meta, si në seleksionimin e mineraleve, në cilësinë e punimeve, në realizimin e planeve të kërkimeve etj. Këto duhet t'i kenë mirë parasysh si Ministria e Industrisë dhe e Minierave, ashtu dhe të gjitha ndërmarrjet që varen prej saj, me qëllim që të marrin sa më parë masa organizative dhe disiplinore, që çdo detyrë të realizohet si duhet dhe të mos lejohen neglizhenca. E theksoj këtë se të ardhurat nga minierat janë nga burimet më kryesore të ekonomisë. Me minierat ne sigurojmë të ardhurat më të mëdha nga eksporti dhe, në qoftë se dëshirojmë të eksportojmë me fitime, dhe sigurisht që të gjithë e dëshirojmë dhe për këtë luftojmë, atëherë të bëjmë kujdes për nxjerrjen e mineraleve si sasi, për trajtimin, për sigurimin e cilësisë së tyre, në mënyrë që, kur të venë në destinacion, të mos bëhen reklamime nga blerësit e huaj dhe të mos na krijohen stoqe. Duhet të dimë se reklamime bëhen për mallrat tona, ashtu sikurse u bëjmë edhe ne të tjerëve, kur nuk na dërgojnë mallra sipas marrëveshjeve që nënshkruajmë. Prandaj reklamimet të mos i shikojmë në mënyrë të njëanshme. Ashu siç krijohen stoqe të mallrave të ndryshme, po kështu grumbullohen edhe në minerale. Ne kemi humbje qoftë kur nuk nxjerrim minerale me cilësinë e parashikuar, dhe na mbeten stoqe, qoftë kur organet e tregtisë së jashtme nuk interesohen si duhet dhe sa duhet për t'i eksportuar ato që nga pikëpamja cilësore janë të standardeve ndërkombëtare. Prandaj në të dyja këto drejtime duhet të forcohet shumë puna.

Edhe në Ministrinë e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore duhet të bëhen përpjekje serioze që ndërmarrjet

në varësi të saj të nxjerrin prodhime të shumëllojshme, të mira dhe me çmime të lira. Sigurisht që kanë pasur gabime ministri i mëparshëm i këtij dikasteri dhe zëvendësit e tij, por të mos ua hedhim dy ose tre vetave tërë fajin, se përgjegjësi ka, gjithashtu, tërë aparati i kësaj ministrie dhe të tëra ato ndërmarrje që nuk realizojnë planin ose nxjerrin prodhime me cilësi të dobët. Përgjegjësi kanë edhe punonjësit e industrisë, të bujqësisë, të tregtisë etj. Është një kompleks i tërë ky, i cili duhet zgjidhur në mënyrë të drejtë dhe problemet të mos ndërlikohen. Prandaj udhëheqja e re e këtij dikasteri të nxjerrë mësim dhe planin ta hartojë mirë, në bazë të nevojave të vendit, duke i llogaritur saktë në natyrë sasi të prodhimeve dhe kërkesat e eksportit.

Nevojat e popullit duhet medoemos të plotësohen, por veç me mallra me cilësi të mirë dhe me çmim sa më të ulët dhe për mallrat e eksportit të bëhen përpjekje që të realizohen me cilësi shumë të mirë. Mirëpo nuk ngjet kurdoherë kështu dhe harxhojmë me vend e pa vend lëndë të parë. Kur ne importojmë pambukun nga jashtë me valutë, a na lejohet t'i kapërcejmë normativat në tekstile dhe në depot e kombinatit të tekstileve «Stalin», apo në atë të Beratit të na grumbullohen me mijëra metra copë kupon, për të cilat kemi thënë një mijë e një herë se ç'duhet bërë? Bile kemi orientuar në detaje deri atje sa të prodhohen me to veshje të brendshme për kalamanët. Megjithatë konsultojmë se këto stoke vazhdojnë të ekzistojnë akoma. Ka pasur një vendim të Komitetit Qendror të Partisë, të Byrosë Politike dhe të Qeverisë, që këto stoke të

futeshin në riprodhim të zgjeruar për të prodhuar me to mallra që kërkohen nga masat e popullit, por nuk janë bërë përpjekje për zbatimin e tij dhe këto mallra kanë mbetur në depo. Kjo nuk është e lejueshme!

Me këtë rast dëshiroj t'i këshilloj drejtuesit e Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore që të studiojnë sidomos çështjen e evadimit, të pakësimit gradual deri në eliminimin e stoqeve të mëdha që ekzistojnë nëpër depo të ndryshme. Të bëhen përpjekje që këto të futen në përdorim, të ndiqet me shumë kujdes cilësia e këpucëve, të mendohet që të vihet kontroll i fortë për përdorimin e lëndës së parë dhe jo të lejohej që të hidhen dhe, si pa gjë të keqe, të digjen mallrat stoqe, por të gjendet rruga e shitjes ose e ripërpunimit dhe e shpërndarjes së këtyre mallrave, po të ketë mundësi deri edhe e eksportimit të tyre. Kryesore është që të vendosen rregulla të rrepta dhe të zbatohen normativa teknike unike të harxhimit të materialeve, të cilat duhen studiuar shkencërisht në të gjithë sektorët e industrisë së lehtë dhe ushqimore.

Jam dakord që te ne të prodhohen edhe lloje bukësh e produktesh të tjera ushqimore me misër, që shokët e Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore na i sollën edhe këtu në aparatën e Komitetit Qendror për t'i parë, por, si për çdo lëndë të parë, edhe për misrin të bëhet kujdes, mbasi ai është një produkt që duhet kursyer.

Ekonomia jonë ecën me sukses përpara. Ajo po përballon dhe po çan në mënyrë të vendosur bllokadën dhe presionin e krizës ekonomiko-financiare të botës kapitalisto-revizioniste, gjë që flet qartë për drejtësinë

e vijës dhe të politikës ekonomike të Partisë. Këtë po e vërteton më së miri edhe kjo periudhë prej një viti e gjysmë lufte dhe përpjekjesh për realizimin e planit pesëvjeçar. Në kushtet kur rrethimi e bllokada borgjco-revizioniste vijnë gjithnjë duke u ashpërsuar, ne duhet të mendojmë me kohë, të studiojmë e të punojmë qysh tani për planin e ardhshëm pesëvjeçar, për t'u dalë përpara problemeve e vështirësive të rritjes dhe atyre që na krijojnë situatat. Kjo shtron nevojën që çdo rreth, ndër marrje e kooperativë të studiojë me kohë zhvillimin e vet perspektiv. Përgatitjes së planit të ri t'i shërbejnë edhe studimet e mjaft instituteve kërkimore-shkencore, nga të cilat duhet të na jepet çfarë vepërash të reja mund të ndërtojmë me forcat tona në pesëvjeçarin që vjen. Për këtë çështje të mendojnë e të punojnë edhe dikasteret qendrore dhe Komisioni i Planit të Shtetit. Me qëllim që kjo punë të bëhet sa më e organizuar dhe të japë efektet e dëshiruara, nga instancat përkatëse duhet menduar mirë edhe për bashkërendimin e punëve e të forcave.

Si të gjithë shokët që diskutuan, edhe unë jam i mendimit se kudo te ne vërehet një ndërgjegje e lartë e punonjësve tanë, e klasës punëtore, në radhë të parë, si dhe e fshatarësisë punonjëse etj., gjë që duket në realizimin e detyrave. Pavarësisht nga të metat që vumë në dukje, çdo vit ne kemi pasur realizime të mëdha në të gjithë sektorët, së pari në ngritjen politike dhe ideologjike të njerëzve tanë, vetëm se realizimet të mos na dehin dhe të mos na bëjnë ta flemë mendjen, sepse ato nuk janë të plota dhe siç kemi parashikuar. Realizimin e planit nuk po e arrijmë plotësisht në të gjithë



sektorët, prandaj të bëjmë përpjekje që problemet t'i kuptojmë mirë në tërësi e jo në mënyrë të njëanshme, dhe të marrim masa sqaruese e shpjeguese, pastaj edhe organizative e kontrolli, që çdo detyrë të realizohet plotësisht nga çdo kolektiv dhe individ.

Kam bindjen e plotë se Partia, si kurdoherë, do të mobilizohet mirë në këtë drejtim. Dhe, siç shohim, ajo i ka ngritur masat në këmbë, por duhet të bëjmë akoma më shumë përpjekje, pse përditë nevojat shtohen dhe, krahas kësaj, të mos harrojmë se gjithnjë e më shumë shtohet edhe kërcënimi i jashtëm kundër atdheut tonë socialist.

Punimet e Plenumit të Komitetit Qendror mendoj se do të na shërbejnë për t'u mobilizuar më mirë që planin ta realizojmë sipas vendimeve që janë marrë dhe, me përpjekje më të mëdha që do të bëjmë brenda gjashtëmujorit të dytë që na mbetet, jo vetëm të plotësojmë deficitet e krijuara, por janë të gjitha mundësitë që planin ta tejkalojmë.

Vërejtjet kritike, që bënë shokët, do të na shërbejnë që t'i kuptojmë më mirë hallet e vendit dhe të popullit, të shohim atje ku na dhemb dhe t'u gjejmë ilaçin mungesave, boshllëqeve e të metave që ekzistojnë, për t'i zhdukur ato, në të mirë të popullit dhe të socializmit.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# RINIA I JEP ATDHEUT JETË E GJALLËRI, PARTISË GJAKUN E RI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

17 qershor 1977

Në tremujorin e fundit të këtij viti do të mbahet Kongresi i 7-të i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë. Ky Kongres, si të gjitha kongreset e tjera të rinisë, ka një rëndësi të madhe për të tashmen dhe për të ardhmen e vendit tonë. Prandaj Partia duhet t'u kushtojë një vëmendje të veçantë dhe t'u japë një ndihmë të dendur, të thelluar e konkrete organizatës së rinisë dhe udhëheqjes së saj, me qëllim që ky Kongres të bëhet një ngjarje e shënuar në jetën e popullit tonë dhe veçanërisht të rinisë.

Kongresi i rinisë nuk është diçka formale ose vetëm manifestive, por është një ngjarje shumë serioze, pse ka për detyrë të përcaktojë vijën e qartë, mobili-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth raportit të paraqitur nga KQ i BRPSH «Mbi edukimin e rinisë në procesin e zhvillimit të luftës klasore dhe ndërtimin socialist të vendit». Ky diskutim i shokut Enver Hoxha është dëgjuar i incizuar.

zuese, marksiste-leniniste të brezit të ri, i cili luan një rol të rëndësishëm dhe vendimtar në ndërtimin e socializmit, në zhvillimin aktual të jetës së re. Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë luan një rol me rëndësi për edukimin e masave të gjera të rinisë dhe i përgatit ato që gradualisht të hyjnë në jetën aktive revolucionare në të gjitha fushat e veprimtarisë së atdheut tonë.

Masat dhe organizatat e rinisë janë porët frymëdhënëse, janë si mushkëritë e pastra të një trupi të shëndetshëm që i japin jetë e gjallëri atdheut, janë ato organe të fuqishme që forcojnë Partinë tonë, që i japin zemrës së popullit, Partisë, gjakun e ri. Dhe, kur flasim për gjak të ri, me këtë kuptojmë gjithë ata të rinj e të reja të klasës punëtore, të fshatarësisë e të inteligjencies, të edukuar me frymën dhe me ideologjinë marksiste-leniniste, me një disiplinë proletare, me sinqeritet, ndershmëri e trimëri, që janë karakteristika me vlerë të popullit tonë.

Për këtë arsye Kongresi i rinisë, dhe në përgjithësi të gjitha manifestimet e brezit tonë të ri, nuk duhet të shikohen vetëm nga ana e tyre manifestive. Manifestimi, ana e bukurisë dhe e gëzimit, është një karakteristikë e brezit të ri. Kjo është e domosdoshme për rininë, por nuk është vetëm kjo që duhet të karakterizojë manifestimet e saj. Bashkë me to, po ashtu te rinia jonë duhet të rrjedhë mendimi i pjekur i Partisë, të spikatin serioziteti i duhur në kryerjen e detyrave që i dalin asaj përpara, format dhe metodat që duhet të përdorë ajo për t'i vënë këto në jetë; duhet të spikatë mendimi krijues i të rinjve dhe i të rejave tona që po

edukon Partia në shkolla, në fabrika, në ushtri, në fshat e kudo. Në këtë mënyrë manifestimet e tyre bëhen me të vërtetë të gëzueshme, por edhe të frytshme. Të gjitha këto ngrenë moralin, dijen, inteligjencën, guximin dhe heroizmin jo vetëm të rinisë, por edhe të të gjithë popullit, pse një frymë e tillë përshkon edhe më të moshuarit, njerëzit e punës në uzina e në fabrika, punonjësit e arave, njerëzit e penës, dhe e tërë kjo gërshetohet në një harmoni të veçantë që nuk mund të ekzistojë veçse në një vend ku ndërtohet socializmi, në një vend që udhëhiqet nga një parti marksiste-leniniste, siç është Partia jonë.

Është e domosdoshme që rinia jo vetëm në Kongres, por edhe tash, para Kongresit dhe gjatë gjithë kohës, të udhëhiqet në punën e saj nga orientime të tilla. Në të gjithë veprimtarinë e saj, qoftë kjo veprimtari studiuëse, krijuese ose prodhuëse, në shkolla, në fabrika e në ara, nëpër aksionet e mëdha kombëtare e lokale, që ajo po merr vazhdimisht përsipër dhe po i kryen me sukses, rinia duhet kurdoherë të mbrohet dhe të kalitet me mësimet e marksizëm-leninizmit, me mësimet e Partisë sonë, që duhet medoemos të bëhen të kapshme prej saj. Duhet të mos lejojmë që te ne të ketë të rinj e të reja të cilët të mos e kuptojnë si duhet dhe sa duhet në gjerësinë dhe në thellësinë e saj ideologjinë marksiste-leniniste, teorinë e mësuesve tanë të mëdhenj. Ne duhet të bëjmë që teoria dhe praktika e Partisë sonë të kuptohen në zbatim e sipër. Praktika do t'u zhvillojë të rinjve mendimin e tyre krijues, aftësitë që ta përvetësojnë më lehtë teorinë marksiste-leniniste dhe këtë ta lidhin me jetën, me luftën e tyre të

përditshme. Pra, nga librat dhe nga praktika ata të arrijnë të kuptojnë thellë ligjet e teorisë sonë marksiste-leniniste.

Me fjalë të tjera, Partia e ka për detyrë që të sigurojë me një punë të tillë të ardhmen e vendit, socializmin, të cilin e ndërtojnë njerëzit, e mbrojnë njerëzit, e zhvillojnë dhe e shpicien kurdoherë e më përpara njerëzit. Por këta njerëz duhet t'i kenë vazhdimisht llërcët përveshur për t'i vënë gurët njëri mbi tjetrin, t'i mbërthejnë mirë midis tyre me llaç e me çelik dhe këtë punë t'ua lënë trashëgim brezave të rinj njëri pas tjetrit, që ata të ecin dhe të përparojnë kurdoherë të udhëhequr nga marksizëm-leninizmi, të cilin të dinë ta zbatojnë drejt në praktikë, në zhvillimin e shoqërisë socialiste. Kjo do të thotë që ata ta pasurojnë gjithnjë më tej marksizëm-leninizmin. Ky është një qëllim i madh që i vihet përpara Partisë sonë. Neve na bie detyra që këtë çështje ta mendojmë thellë dhe të bëjmë kujdes që mendimet e drejta të Partisë të nguliten në mendjen dhe në zemrat e brezit të ri.

Ashtu siç ka theksuar vazhdimisht Partia, si tash edhe në të ardhmen, ne duhet të përpiqemi që ta bëjmë rininë tonë të dijë se përpara, në jetë, kurdoherë do të ketë edhe vështirësi, pse lufta për ndërtimin e plotë të socializmit, lufta për mbrojtjen e atdheut socialist dhe të fitoreve të arritura, nuk mund të kurorëzohet me sukses pa u ndeshur dhe pa luftuar me armiqtë e brendshëm e të jashtëm. Lufta e klasave duhet të zhvillohet gjithmonë nga ana jonë në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit, në mënyrë që të mos jemi as sektarë, por të mos jemi as edhe oportunistë.

Ne duhet të dimë t'i zgjidhim drejt problemet e shumta që na dalin përpara, të dimë të dallojmë kontradiktat antagonistë mes popullit dhe armiqve, si dhe kontradiktat joantagoniste që ekzistojnë në gjirin e popullit. Zgjidhja e kontradiktave joantagoniste në gjirin e popullit është një detyrë e madhe, e koklavitur dhe e shumanshme. Por, që këto kontradikta të zgjidhen në favorin e socializmit dhe në disfavorin e armiqve të proletariatit dhe të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, duhen pjekuri dhe zgjuarsí. Kontradiktat joantagoniste që ekzistojnë në një larmi të madhe, në forma nga më të ndryshmet, në vende dhe në kohë të ndryshme, duhen vëzhguar, studiuar, duhen korrigjuar dhe shpjeguar me durim të madh, pse e tillë është natyra e tyre. Zotësia e Partisë dhe e rinisë është që këto kontradikta të dinë t'i zgjidhin si duhet, dhe, për t'ia arritur kësaj, siç e thashë më lart, duhet punuar për të fituar pjekuri marksiste-leniniste, e cila u krijon njerëzve atë *bon sens*, atë gjykim të shëndoshë, që i ndihmon për të përballuar e për të kapërcyer çdo vështirësi që mund t'u dalë përpara. Që tash Partia duhet ta zhvillojë një edukatë të tillë me brezin e ri, ajo duhet të bëjë që ky brez të aktivizohet në këtë luftë klasash, luftë me armiqtë brenda vendit dhe luftë kundër armiqve të jashtëm.

Në këtë drejtim Partia të ketë parasysh që rinia, puna me të, është mjaft delikate, prandaj ajo duhet të jetë vigjilente, pse armiqtë e klasës nuk punojnë vetëm për të sabotuar çdo gjë aktualisht, por ata luftojnë edhe për të minuar perspektivën. Në këtë drejtim një nga fushat e veprimtarisë së tyre është rinia. Ar-

mlqhtë e dinë se, në rast se arrijnë të influencojnë me jetën e tyre të shthurur mikroborgjeze dhe dekadente, me muzikën e tyre të çakërdisur dhe me veset e tyre të këqija te rinia, atëherë do të kalbet e ardhmja e popullit, do të degjenerohen filizat e rinj, ata që do të zënë vendet e të vjetërve dhe që duhot të mbajnë lart stafetën e socializmit. Duke pasur parasysh këtë, ne duhet ta bëjmë rininë ta kuptojë mirë e thellë, teorikisht dhe praktikisht, rëndësinë e diktaturës së proletariatit, të kuptojë se diktatura e proletariatit është ai mjet që u ka siguruar asaj dhe mbarë popullit të gjitha këto avantazhe, gjithë këtë jetë të lumtur, të begatshme e të kulturuar me një demokraci të gjerë, të shëndoshë dhe të drejtë.

Të punojmë që rinia të mos e kuptojë në mënyrë të përciptë diktaturën e proletariatit. Borgjezia përpiqet që ta cilësojë diktaturën e proletariatit si armiken e një «demokracie të gjerë», që gjoja ekziston në vendet kapitaliste. Në fakt në këto vende ekziston një demokraci formale, atje demokraci ka vetëm për të pasurit dhe jo për masat e gjera punonjëse, jo për proletariatin. Diktatura në vendet kapitaliste përbëhet nga forcat e armatosura dhe nga aparatet e tjera shtetërore shtrënguese të këtyre vendeve, të cilat sigurojnë rendin borgjezo-kapitalist, sigurojnë pasuritë e monopoleve nga lufta e proletariatit dhe e masave të tjera punonjëse të varfra të qytetit dhe të fshatit, që shfrytëzohen deri në palcë.

Të mos mendojmë se në rininë tonë kaq të pastër, kaq heroike dhe të papërtuar, të zgjuar dhe me kulturë, nuk zënë vend disa herë mbeturina mikroborgjeze,

nuk zënë vend disa herë influencat armiqësore të jashtme. Molla e kuqe duhet ta ruajë vazhdimisht ngjyrën e saj të bukur dhe, që të qëndrojë e tillë, që të mos zverdhet e të mos venitet, duhet të merren masa që brenda saj të mos futet krimbi gërryes. Të tillë duhet të jenë kujdesi dhe lufta jonë për brezin e ri, për të ardhmen e atdheut tonë, për atë të ardhme që luftojmë për ta siguruar me të gjitha forcat, për socializmin dhe për komunizmin. Prandaj në këto drejtime ne, me të gjitha format dhe në të gjitha instancat, në të gjitha uzinat, në kooperativa, në shkolla e kudo ku punon dhe mëson rinia, duhet të dimë të gërshetojmë edukatën politike, edukatën morale dhe edukatën ideologjike në një mënyrë të atillë që të nxjerrim në jetë një rini të kualifikuar e të përgatitur jo vetëm teknikisht, por, në radhë të parë, moralisht, politikisht dhe ideologjikisht të pastër e të shëndoshë.

Partisë i bie detyrë që rininë tonë, të lindur dhe të rritur në socializëm, por që ka marrë pjesë në këtë ndërtim madhështor që është realizuar në vendin tonë, me të gjitha mënyrat e mjetet ta vërë në dijeni për të kaluarën e popullit tonë, si për të kaluarën e errët ekonomike dhe politike të tij, por, gjithashtu, edhe për të kaluarën e ndritur, për traditat e tij patriotike dhe revolucionare. Duhet të punohet vazhdimisht dhe me të gjitha format që këto tradita patriotike revolucionare të popullit tonë në të gjitha fushat të skaliten në zemrat dhe në mendjet e të rinjve, t'i bëjmë ata që të rrojnë e të punojnë në realitetin socialist, por edhe ta çmojnë e ta duan këtë realitet, pse është vepra e gjakut dhe e djersës së tyre dhe e të parëve tanë, prandaj



edhe çdo hap që hedhim përpara bëhet shumë herë i vlefshëm. Është e nevojshme t'ia bëjmë të qartë rinisë që të mos harrojë asnjëherë se këto brazda janë të mbushura me gjakun, me djersën dhe me kockat e popullit tonë trim, punëtor e liridashës.

Partia me forma të shumta e të ndryshme duhet të ngjallë në mënyrë të vazhdueshme te rinia dashurinë për të mësuar dhe për t'u edukuar, dhe, që ky mësim të thithet prej saj me një zell, këmbëngulje dhe seriozitet të madh, rinia duhet të kuptojë qëllimin e madh të mësimin, i cili ndrit personalitetin e njeriut dhe i jep këtij një armë të çmueshme, që duhet ta përdorë si duhet në interesin e përgjithshëm të popullit, të atdheut e të socializmit. Ajo duhet të kuptojë se që t'i përdorësh mësimin dhe diturinë në shërbim të interesit të përgjithshëm, do të thotë që secili të shërbejë kudo ku ka nevojë atdheu dhe të punojë me vetëmohim, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, deri në sakrificën supreme, po ta lypë nevoja e popullit dhe e atdheut.

Nuk është e këshillueshme që rinisë çdo gjë t'ia bëjmë kurdoherë shesh me lule, edhe kur s'është shesh me lule, por të punojmë që ajo të kuptojë se «kopshti me lule», që të lulëzojë vazhdimisht, duhet të qëndrojë i pastër, «të ujitet», «të prashitet» dhe që kur t'i mbjellim «lulet», të kujdesemi për to. Rinia, gjithashtu, duhet të dijë se kundër atyre «luleve» ekzistojnë edhe vështirësi të rritjes, ekzistojnë edhe sëmundje e barëra të këqija që mund t'i infektojnë ato, ekzistojnë edhe «agjentë atmosferikë» që shumë herë, në qoftë se nuk kemi kujdes e nuk i ruajmë, e prishin «kopshtin me lule», i dobësojnë e i venitin «lulet» e rritura me aq

kujdes. Prandaj mbetet detyrë e përhershme që rininë ta njohim e ta mësojmë edhe me vështirësi, që ajo t'i kuptojë drejt, objektivisht dhe subjektivisht, këto vështirësi dhe të luftojë që t'i kapërcejë me sukses ato. Pikërisht këtu qëndron forca e një edukimi me të vërtetë marksist-leninist e revolucionar për rininë.

Partia organizatën e rinisë duhet ta ketë kurdoherë në patronazh, të ketë shumë kujdes që të mos e bëjë atë një organizatë sektare, por një organizatë luftarake masive. Pikërisht në këtë masivitet Partia t'i ushtrojë me forma të larmishme të gjitha ato që përmenda shkurtimisht më lart dhe shumë direktiva të tjera, që ajo ka dhënë vazhdimisht, kohë pas kohe, në mënyrë që tërë kjo masë e madhe e rinisë, e inkuadruar në organizatën e saj me një disiplinë të hekurt, të ndërjegjshme për detyrat që i ngarkohen, me një dashuri të madhe për t'u hyrë thellë detyrave dhe për t'i zbatuar ato drejt në jetë, të shkrihet në gjirin e popullit, të bëhet një me të, me të mirat, me gëzimet dhe me hallet e tij, të frymëzohet nga populli e ta frymëzojë popullin. Tamm këtë formë, këtë impuls, këtë mënyrë pune duhet t'u japë Partia organizatës së rinisë dhe të gjitha organizatave të tjera të masave.

Kur themi se rinia është e ardhmja e vendit tonë, Partia këtë duhet ta gjykojë thellë dhe ta vërejë me kujdesin më të madh. Kjo do të thotë që në vendet udhëheqëse, në vendet kyç të çdo sektori, të parashikohet që të vijë edhe të reja e të rinj të zotë, revolucionarë, besnikë e me kulturë, që gradualisht të marrin në dorë punët, të bashkëpunojnë ngushtë me moshatarët më të vjetër se ata. Këta të fundit, të vjetrit,

e kanë për detyrë që t'i mësojnë të rejat dhe të rinjtë, t'i përgatitin këta si zëvendësit e tyre, t'i trajtojnë me dashurinë, me ngrohtësinë e me kujdesin më të madh, duke zhdukur nga vetja mendjemadhësinë dhe ambiciet.

Të kemi kurdoherë besim te brezi i ri, te ky brez i shëndoshë që edukon Partia, të përpiqemi t'u japim të rinjve dhe të rejave tona gradualisht stafetën dhe të jemi të sigurt se ata do t'i kryejnë si duhet punët. Këta të rinj e të reja do të shohin se fjala e mendimi i Partisë është krijuar dhe i pashlyeshëm, është ajo forcë e madhe që e bën njeriun të zotin, që e pajis atë me virtyte të rralla në shërbim të atdheut.

Jam dakord me raportin që na paraqiti Komiteti Qendror i Rinisë për situatën në organizatë, për punët e rinisë në të gjitha aktivitetet shoqërore, ekonomike, arsimore, kulturore etj.

Në përgjithësi, ne mund të themi se rinia jonë ecën e vendosur në rrugën e drejtë që i ka caktuar Partia. Lufta dhe puls i rinisë ndihen fort në mbarë jetën e vendit tonë, ndihet ai puls që rreh nga një zemër e pastër dhe e shëndoshë, nga një trup plot me logjikë të shëndoshë, me dituri dhe me shkencë. Pavarësisht se ka edhe të meta në punën e rinisë, se ka edhe qëndrime negative të disa të rinj, dhe sigurisht kjo është lufta e zhvillimit e në këtë luftë shihen përpjekjet e të kundërtave, një gjë del qartë në pah nga kjo, se, me kalimin e kohës dhe me edukatën këmbëngulëse, disa nga të rinjtë tanë, që ngandonjëherë bëjnë ndonjë axhamillëk, siç thotë një shprehje popullore, puna e Parti-

së dhe e organizatës së rinisë i pjek ata. Kjo punë i bën këta të ndërgjegjshëm për veprimtarinë jo të drejtë që kanë zhvilluar për ndonjë çështje ose në një kohë të caktuar.

Pavarësisht nga kjo, detyra e organizatës së rinisë dhe e Partisë është që, sa të jetë e mundur, rininë ta mbajmë të pastër, ta ruajmë nga ndikimet e këqija. Dhe dihet se rininë do të mund ta ruajmë të paprekur nga ndikime të tilla, të huaja për shoqërinë tonë, jo duke e mbyllur brenda katër mureve, por duke e edukuar atë kudo që jeton, punon dhe mëson, me moralin e klasës, me ideologjinë e Partisë. Pra, në qoftë se me punën tonë bëjmë që të rinjtë e të rejat çështjet t'i shohin politikisht drejt, atëherë me siguri më pak shfaqje jo të mira do të kemi në masën e rinisë. Këto shfaqje jo të mira, duke i krahasuar me punën kaq të lavdërueshme të rinisë, nuk janë të shumta, megjithatë ato kurrë nuk duhen nënvleftësuar.

Jam po ashtu dakord me tezat e raportit që na ka paraqitur Komiteti Qendror i Rinisë për Kongresin që do të bëhet, dhe kam bindjen se ky raport do të ndërtohet në mënyrë të shëndoshë, i frymëzuar që nga fillimi e deri në fund nga vija marksiste-leniniste e Partisë. Në çdo kapitull të këtij raporti duhet të spikatë vija e drejtë e Partisë në të gjitha problemet që do të shtrohen, duhet të spikatë mbrojtja e shëndoshë revolucionare e kësaj vije, si në politikë, në teori e në praktikë dhe ajo t'i mobilizojë masat e rinisë me një entuziazëm të madh për t'i zbatuar këto direktiva dhe

këtë vijë në jetë, që të lulëzojë dhe të forcohet akoma më shumë atdheu ynë socialist.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 167 (9026), 13 korrik 1977*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për rininë»  
(Përmbledhje veprash), vëll. II,  
f. 460*

# SIIPATA E MPREHTË E DIKTATURËS SË PROLETARIATIT RA MBI ARMIQTË DHE U DHA DËNIMIN QË MERITONIN

*Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

17 qershor 1977

Ministria e Punëve të Brendshme na informon se morën fund proceset gjyqësore të grupeve tradhtare të Partisë dhe të popullit, Beqir Ballukut, Petrit Dumes, Hito Çakos, Fadil Paçramit, Todt Lubonjës, Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit, Këço Ngjelës, Vasil Katit e të tjerëve.

Siç u analizua në Plenumin e 4-t, të 5-të, të 6-të dhe të 7-të të Komitetit Qendror, kjo veprimtari armiqësore e fshehtë, jashtëzakonisht e rrezikshme dhe me një gjerësi mjaft të madhe në të gjithë sektorët e aktivitetit shoqëror të Partisë dhe të shtetit, u vërtetua plotësisht në hetuesi dhe nga gjykimet që u zhvilluan për secilin grup.

---

1. Këtë fjalim Byroja Politike e KQ të PPSH e dëgjoi të incizuar.

Këto hetime filluan që më 1974 dhe mbaruan më 1977, natyrisht me ndërprerje. Kjo kohë, që mund të duket e gjatë, u nevojiti për arsye të gjerësisë së punës armiqësore dhe të fshehtësisë me të cilën ajo u zhvillua, por edhe për arsye se armiqtë përplqeshin me të gjitha mjetet ta fshihnin veprimtarinë e tyre, ta minimizonin atë dhe të maskonin veprimtarinë e bashkëpunëtorëve. Partia u rekomandoi shokëve hetues që, për hir të shpejtësisë në hetime, të mos harronin cilësinë, se zgjatjen e afateve procedurale të hetimit do t'ua miratonte prokurori në bazë të ligjit, me qëllim që kjo kohë e mjaftueshme të përdorej për ta pasur sa më të qartë gjithë zhvillimin e punës armiqësore të kryer nga këto grupe elementësh tradhtarë. Dhe kështu ngjau.

Shokët hetues dhe trupi gjykues i dhanë dokumente të reja Partisë për ta plotësuar më tej zbulimin e madh shpëtimtar që Komiteti Qendror bëri në kohën e duhur. Çdo gjë është zbuluar nëpërmjet pyetjesh, përgjigjesh, shpjegimesh e kërkimesh, pa as më të voglin sforcim. Prandaj të gjithë armiqtë, që u gjykuan dhe morën dënimet përkatëse, duke përfshirë edhe ata që u dënuan me vdekje e u pushkatuan më parë, si Beqir Balluku, Petrit Dumja e Hito Çakoja dhe tani Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi, deponuan ato që kishin për të folur (pse me siguri ata kanë mbajtur edhe të fshehta). Ato që thanë armiqtë i pohuan me gojën e tyre pa asnjë shtrëngim. Sigurisht, ata kanë folur lirisht sepse janë ndodhur përpara provave të pakundërshtueshme dhe jo pse ishin penduar.

Armiqtë që demaskuam dhe që dënuam duhet të

njohim se kanë pasur një platformë të gjerë dhe precize në të gjitha drejtimet: një platformë politike, ideologjike, ushtarake, ekonomike, arsimore dhe kulturore. Në analizat që ka bërë Komiteti Qendror në plenumet e tij, të cilat u vërtetuan edhe nga hetuesia, janë vënë mirë në dritë lidhjet, orientimet, koordinimi i veprimtarisë së armiqve në të gjithë këta sektorë. Çështja del se këto grupe të ndryshme armiqsh s'ka asnjë dyshim që ishin një e tërë e vetme, të gjithë luftonin frontalisht në fronte të caktuara për të arritur në një konkluzion të njëjtë: në likuidimin e rendit socialist në Shqipëri, në likuidimin e Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe ky qëllim do të realizohej me puç e me masakra. Është tjetër punë nëse do të fitonin ose nuk do të fitonin.

Fakt është se Partia jonë ishte dhe është shumë e fortë, sa që i demaskoi e i dërrmoi këta armiq dhe ajo do të demaskojë e do të dërrmojë edhe armiq të tjerë të brendshëm që me siguri do të orvaten përsëri të kryejnë një vepër të tillë kundërrevolucionare të lidhur me armiqtë e jashtëm. Armiqtë kurrë nuk i hedhin armët, prandaj edhe ne armët duhet t'i mbajmë kurdoherë të mprehta dhe jo vetëm armët e zjarrit, por edhe armët politike, ideologjike, vigjilencën, vijën e Partisë dhe zbatimin e saj si duhet. Të gjitha këto armë janë shumë më të fuqishme nga metodat puçiste konspirative të komplotistëve, qofshin këta të brendshëm, qofshin të lidhur me jashtë. Por në çdo sektor ku këta kanë vepruar, duhet të studiohen me imtësi format dhe metodat që janë përdorur prej tyre, format dhe metodat politike, ideologjike dhe organizative, zbatimin



i tyre në jetë, puna për komprometimin e njerëzve etj.

Nuk duhet lënë pas dore dhe nuk duhet nënvleftësuar kjo eksperiencë e madhe që ka Partia. Luftërat kundër Partisë nga ana e fraksionistëve dhe e deviatorëve të ndryshëm, si të atyre që kanë vepruar në grupe të vogla, ose si ajo e grupit të Koçi Xoxes në lidhje me jugosllavët, kanë qenë mjaft të rrezikshme. Por unë mendoj se me këtë shtrirje e gjerësi, jo vetëm thjesht organizative, por edhe ideopolitike, edhe me ushtri, edhe me puç, që kishin organizuar armiqtë që zbuluam këta 3-4 vjetët e fundit, të cilët kishin gjetur metodat për ta zgjeruar gjithnjë e më shumë rrethin e tyre, kishin përdorur forma të përpunuara të degjenerimit që i shpiknin e i zbatonin vetë, por frymëzonin me to edhe të tjerë, nuk jemi ndeshur ndonjëherë tjetër. Prandaj Partia dhe gjithë punonjësit tanë kudo duhet të nxjerrin mësimë nga këto pësime, pse pësimi mund të kthehej në një rrezik të madh katastrofal për vendin tonë. Këtë nuk duhet ta neglizhojmë dhe ta harrojmë asnjëherë.

Ne pamë se grupi i Beqir Ballukut kërkonte të ndryshonte vijën e Partisë në ushtri, ta dobësonte ushtrinë tonë, të dobësonte stërvitjen e përgatitjen e saj, të pengonte fortifikimet, me një fjalë t'ua linte portat e vendit të hapëta armiqve, me të cilët ai ishte në lidhje.

Beqir Balluku ishte në lidhje me Abdyl Këllezin dhe me grupin e tij, që, në vrullin e madh të punës së Partisë dhe të popullit për zhvillimin e ekonomisë, deformonte direktivat, fuste ku të mundte dhe si të mundte teoritë revizioniste të vetadministrimit.

Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi me grupin e tyre kërkonin të arrinin qëllime të caktuara, të dobësonin ekonominë tonë socialiste, të përgatitnin terrenin për shndërrimin e saj në një ekonomi kapitaliste. Ata njëkohësisht përpiqeshin të dobësonin forcën e ekonomisë sonë, punuan me të gjitha mënyrat për sabotimin e nafsës, të nxjerrjes së mineraleve, të ndërtimeve dhe për harxhimin e shumave të mëdha në ato drejtime që nuk sillnin rendimentet e parashikuara.

Përveç këtyre, armiqtë përpiqeshin të krijonin në kuadrot pikëpamje euforie, njëkohësisht nxitnin tek ata veset mikroborgjeze që mund të ekzistonin te shumë prej tyre, si rehatinë, mendjemadhësinë, grumbullimin në institute të ndryshme, heqjen e tyre nga terreni e nga punët konkrete dhe krijimin me këtë mënyrë të një burokracie, e cila të mbyste situatën revolucionare që kishte krijuar Partia. I ngarkuar të punonte në këto drejtime, Abdyl Këllezi nuk harronte se duhej të lidhej ngushtë me veprimtarinë e puçistëve të ushtrisë, me Beqir Ballukun. Që të dy ishin dakord dhe e pohuan se grushti kundër Partisë dhe pushtetit do të jepej nga ushtria me puç e me masakra. Për t'ia arritur këtij qëllimi ata i akordonin veprimet e tyre edhe me Fadil Paçramin e me Todi Lubonjën. Kësisoj edhe këta të fundit nuk punonin të izoluar dhe përpiqeshin të krijonin atë shtresë të degjeneruar në masën e artistëve, të shkrimtarëve, të poetëve, të njerëzve të teatrit e të muzikës që të përfaqonin dhe të zbatonin artin dekadent perëndimor e revizionist, me qëllim që të kalbnin shoqërinë tonë me mënyrën e jetesës borgjezo-kapitaliste,

dhe e tërë kjo veprimtari ishte e koordinuar me atë të dy grupeve të tjera që përmenda më lart.

Veprimtaria armiqësore e këtyre armiqve ka synuar edhe degjenerimin moralo-politik të rinisë, tërheqjen e saj nga pozitat e shëndosha luftarake ku e ka vendosur Partia. Ata u përpoqën të shuanin nga shpirti i pastër i rinisë sonë dashurinë për atdheun, frymëzimin që ngjallin tek ajo mësimet e direktivat e Partisë dhe këtë e bënë që rinia të shmangej nga puna për ndërtimin e mbrojtjen e socializmit, që ajo të mendonte e të jetonte sipas mënyrave «moderne» dekadente të botës së çoroditur borgjeze e revizioniste. Qëllimi i fundit i përpjekjeve të armiqve ishte që, duke kultivuar te rinia prirjen për të jetuar në mënyrë të shturur, parazitare, individualiste, karrieriste, ta shndërronin atë nga rezervë luftarake e Partisë në kundërshtarë të saj, që ta kishin më të lehtë realizimin e veprës tradhtarë, sabotimin e ndërtimit të socializmit dhe kthimin e Shqipërisë në një vend kapitalist.

Puna e armiqve në këtë drejtim ka qenë e organizuar dhe e bashkërenduar me kujdes, por ata nuk ua arritën dhe nuk mund t'ua arrinin qëllimeve të tyre ogurzeza për ta shkëputur rininë nga Partia, sepse rinia jonë e ka provuar dhe e ndien orë e çast se Partia punon për ta bërë të ardhmen e saj sa më të lumtur, se qëllimet e Partisë nuk janë aspak të ndryshme nga interesat e rinisë.

Po arsimit? Në kuadrin e gjithë kësaj veprimtarie armiqësore ne zbuluam edhe çështjen tjetër, që ish-ministri i Arsimit e i Kulturës, Thoma Deliana, që më 1972 kishte shprehur mendimin se duhej prishur sistemi

I ri arsimor që ka pasë vendosur Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror qysh më 1969. Ky na pohoi se frymëzuesi kryesor kundër vendimeve të Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë, kundër riorganizimit të shkollës dhe vetë sistemit arsimor të vendosur te ne ka qenë Abdyl Këllezi, i cili, kur ishte kthyer nga Kina, i kishte folur për zhvillimin e shkollës atje me një «entuziazëm të madh», duke vënë në dukje sidomos «lidhjen e shkollës me prodhimin», çka donte të thoshte që shkolla e arsimit të përgjithshëm të detyrueshëm duhej të ishte jo dymbëdhjetë, por dhjetëvjeçare dhe i riu ose e reja, si të mësonte 10 vjet, mund të shkonte në universitet. Kjo shkollë dhjetëvjeçare, e organizuar gjoja sipas shembullit kinez, mendohej të shkrihej në uzinën, fabrikën ose në kooperativën bujqësore dhe drejtori i fabrikës, i uzinës ose kryetari i kooperativës të ishte në të njëjtën kohë edhe drejtor i shkollës, kurse brigadierët të ktheheshin në mësues e pedagogë. Kjo pikëpamje synonte që ne të mos kishim më as shkolla, as uzina, as kooperativa, por një anarki të bazuar në sistemin vetadministrues. Përveç kësaj, Thoma Deliana ishte në lidhje edhe me Beqir Ballukun, që, tok me Petrit Dumen, nuk kanë qenë kurrë dakord me sistemin arsimor që vendosi Komiteti Qendror. Këta kanë pasë biseduar me njëri-tjetrin për këtë çështje. Thoma Deliana pohon se shkolla jonë duhej të bëhej dhjetëvjeçare, për arsye se Beqir Balluku me Petrit Dumen stërvitjen e brezit të ri në shkolla brenda 4 muajve nuk e quanin të mjaftueshme, dhe jo vetëm kaq, por një sistem i tillë, një komponent i tillë i futur në shkolla, sipas tyre, e dëmtonte kontingjentin e ush-

trisë, për arsye se «i hante asaj dy ose tre kurà». Me këtë ata ishin për ushtrinë e kazermës, për një ushtri pretoriane, të vjetër e jo për një ushtri të përbërë nga gjithë populli i stërvitur në ato forma që kemi vendosur.

Teza për shkollën 10-vjeçare, siç del nga shqyrtimi i këtij problemi, është shtruar nga armiqtë jo «me qëllim që të ndihmojë në ngritjen e nivelit të përgjithshëm arsimor e kulturor të masave», as sepse kjo farë shkollë «do të ishte më e leverdishme dhe mund të përhapej më shpejt», apo sepse «do të lidhej me prodhimin, sipas eksperiencës kineze». Armiqve nuk po u përvëlohej zemra për shkollën kineze ose për ngritjen e nivelit arsimor të përgjithshëm të masave, por atyre u interesonte përkrahja e variantit për shkollën 10-vjeçare, sepse ky variant përkonte me tërë vijën e tyre revizioniste armiqësore, me sistemin e shkollës sovjetike dhe sidomos sepse, duke u shndërruar shkolla jonë nga 12 në 10-vjeçare, ajo do të zhvishej nga boshti i saj ideologjik marksist-leninist dhe nga lidhjet organike të mësimit me punën prodhuese dhe me edukimin fizik e ushtarak. Ja, pra, që edhe në arsim spikaste puna konspirative antimarksiste që ka zhvilluar Beqir Balluku me shtabin e tij për të hedhur poshtë Tezat e Këshillit të Mbrojtjes dhe për t'i zëvendësuar ato me teza të reja, me një fjalë për të realizuar grushtin e shtetit.

Gjithë këtë veprimtari armiqësore e zbuloi Komiteti Qendror, e zbërtheu Partia, e provoi në detaje hetuesia, prandaj të mos e harrojmë këtë mësim dhe këtë eksperiencë të madhe, por duhet theksuar se, pavarë-

sisht që kjo punë armiqësore ishte e madhe, në Parti nuk pati as më të voglën lëkundje, në popull gjithashtu nuk pati asnjë lëkundje. Përkundrazi, Partia u ngrit në këmbë, ajo u forcua, u kalit, u mbush me një energji e me një zemërim të papërshkruar kundër këtyre tradhtarëve që kërkon t'i dërrmojë. Mbarë populli ynë u ngrit në këmbë si një grusht i vetëm dhe nga të katër anët, në mbledhje të hapëta e në unitet me Partinë, i demaskoi këta tradhtarë dhe bëri thirrje që të lshim të pamëshirshëm kundër tyre. Prandaj edhe shpata e mprehtë e diktaturës së proletariatit ra mbi ta dhe u dha dënimin që meritonin.

Partia duhet të nxjerrë konkluzione nga këto procese. Ne konstatojmë se puna armiqësore kësaj here ishte e organizuar gjerësisht në ushtri, në ekonomi, në arsim e në kulturë dhe në drejtimin e brendshëm të Partisë. Frymëzimi i armiqve ishte revizionist, domethënë këta elementë komplotistë ishin njerëz të degjeneruar ideologjikisht, politikisht e moralisht dhe idetë e tyre në vetvete ishin revizioniste. Këta armiq jo vetëm e kishin koordinuar komplotin në ideologji, në politikë ose në transformime ekonomike, që kishin krejtësisht karakter sabotimi, dobësimi e degjenerimi për të marrë fuqinë në dorë të tyre, por ishin edhe të mbështetur e të organizuar nga jashtë. Ata kishin marrë edhe premtime nga jashtë dhe këto premtime i pohuan me gojën e tyre, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë. Ata pohuan edhe lidhjet që kanë pasur me jashtë, kryesisht me tri shtete revizioniste.

Borgjezia reaksionare, kapitalizmi ndërkombëtar, imperializmi dhe revizionizmi praktikojnë diversionin

dhe, për të na luftuar, përdorin elementët e tyre brenda vendit tonë. Armiqtë e jashtëm, në bashkëpunim me mbeturinat e klasave shfrytëzuese që ne i shtypëm në revolucion, si dhe me elementët e degjeneruar politikisht e moralisht, vazhdimisht kanë organizuar komplete. Grupe armiqësore kanë ekzistuar dhe janë asgjësuar edhe më parë, si grupi i Koçi Xoxes i lidhur me titistët jugosllavë dhe grupe të tjera, qofshin edhe të vogla, që kanë qenë të lidhura me armiqtë e jashtëm. Veprimtarinë kundër nesh ata e kanë zhvilluar në shumë mënyra, diku me thashetheme, diku me denigrime, diku me sabotime etj., për të arritur, më së fundi, deri në realizimin e një puçi, siç deshën të bënin tradhtarët që dënuam tash së fundi.

Veprimtaria e armikut të brendshëm është e lidhur me armikun e jashtëm. Armiqtë e brendshëm në fillim ndoshta organizohen edhe pa urdhra të drejtpërdrejtë të armiqve të jashtëm, por jeta ka provuar se organizimi i tyre është i lidhur me politikën dhe me qëllimet e armiqve të jashtëm. Në fillim këto lidhje ushqehen edhe nga mbeturinat e së kaluarës mikroborgjeze dhe, mbasandaj, marrin forma të reja dhe konkretizojnë edhe lidhjet me armiqtë e jashtëm.

Lenini na mëson se forca e armiqve të jashtëm nuk konsiston vetëm në forcën e kapitalit ndërkombëtar, por edhe në forcën e prodhimit të vogël. Për fat të keq, në botë është akoma shumë i përhapur prodhimi i vogël, i cili lind kapitalizmin dhe borgjezinë vazhdimisht, çdo ditë, çdo orë, në mënyrë spontane dhe në shkallë të gjerë. Sot te ne nuk ekzistojnë prodhues të vegjël, por ekziston mentaliteti i borgjezit

të vogël dhe ky mentalitet, kjo psikologji, krijojnë një rezistencë të atillë që, në qoftë se nuk e luftojmë politikisht e ideologjikisht, ajo e shtyn personin të ecë në një rrugë të kundërt me vijën tonë marksiste-leniniste. Po të analizojmë luftën e Partisë kundër veprimtarisë së armiqve të brendshëm, do të vërejmë se pikëpamjet e tyre janë gërshetuar dhe janë konsoliduar me pikëpamjet e me mbeturinat mikroborgjeze nga të cilat kanë lindur. Këtej del se Partia nuk mund të mendojë kurrë që ky mentalitet e kjo psikologji mikroborgjeze janë zhdukur nga mesi ynë dhe, duke i bërë qejfin vetes, të flejë mendjen.

Lidhjet dhe koordinimin e brendshëm me njëri-tjetrin të gjithë armiqtë i pohuan me gojën e tyre. Natyrisht, ata nuk pohuan që bënë mbledhje të fshehta, por mënyrat e bashkëpunimit dhe të kontakteve të përditshme, të maskuara ndërmjet tyre me kontakte pune, me shkëmbime mendimesh, gjoja për mbarëvajtjen e punës, kanë qenë një formë shumë e rrezikshme për të zhvilluar, për të organizuar, për të koordinuar dhe për të konsoliduar puçin që po përgatitnin dhe goditjen që do të jepnin kundër Partisë e shtetit të diktaturës së proletariatit në vendin tonë. Këto ata i pohuan dhe këtu Partia duhet të ketë vëmendjen.

Vëmendja e Partisë, domethënë vigjilenca e saj revolucionare, qëndron në mbikëqyrjen e rreptë për të zbatuar të gjitha ato norma që kjo ua mëson shokëve përditë. Këto norma synojnë vënien në jetë me përpikëri të vijës së Partisë në të gjithë sektorët, duke parë rezultatet e përgjithshme në zbatimin e direktivave, duke parë çfarë qëndrimesh mbajnë njerëzit, në



punë e në luftë ndaj direktivave të Partisë, si i kuptojnë dhe si i zbatojnë këto direktiva. Pra, komunistët duhet t'i ruajnë fort këto piketa të caktuara nga Partia për të kryer punët që u ngarkohen. Në këtë çështje kërkohet një edukatë e madhe, me qëllim që t'i bëjmë shokët e Partisë të jenë me të vërtetë revolucionarë. Me revolucionar unë kam parasysh atë komunist që e kupton direktivën dhe që lufton ta zbatojë atë me përpikëri, që kapërcen me këmbëngulje çdo vështirësi që i del përpara, që mobilizon masat rreth e rrotull vetes dhe i drejton ato si grup për kapërcimin e këtyre vështirësive, i edukon ato me frymën e drejtë të Partisë dhe, kur themi i edukon, nënkuptohet se i kritikon në mënyrë shoqërore kur bëjnë gabime, kur gabimet janë të vogla dhe ndodhin për herë të parë, por i kritikon edhe ashpër, kur ato janë të rënda apo përsëriten, i kritikon edhe në mënyrë individuale gjatë punës, por i kritikon edhe në organizatën-bazë, edhe në forume të tjera deri në nivelin më të lartë, në Kongresin e Partisë, kur nuk ndreqen.

Kjo nuk errëson në asnjë mënyrë dashurinë për shokun, respektin për atë që punon ose për atë që është më lart në përgjegjësi, dua të them për drejtuesit. Përkundrazi, një punë e tillë krijon një dashuri të shëndoshë, revolucionare dhe një respekt plotësisht të merituar nga të dy anët. Kjo punë duhet bërë edhe nga ai që e sheh realisht se si zhvillohet puna në bazë të direktivës dhe, sipas rastit, lavdëron një person kur punon mirë, ose kritikon atë apo ata persona që nuk qëndrojnë në vijë.

Është e domosdoshme për një revolucionar që të

mos krijojë dyshime pa baza për një njeri që gabon një herë. Por, nga ana tjetër, në rast se qëndron në mënyrë korrekte dhe revolucionare përpara direktivës dhe zbatimit të saj, pavarësisht pse ai punon që t'i korrigjojë shokët dhe gabimet që bëjnë, këto nuk i fshin krejtësisht nga kujtesa e vet. Këto ai nuk i mban në kujtesë për t'i pasur si armë për hakmarrje, por, në rast se gjatë punës, gjatë zhvillimit të jetës, konstaton se të tillë njerëz vazhdojnë të mos qëndrojnë në mënyrë korrekte përpara vijës së Partisë, atëherë mundet, duhet dhe e ka për detyrë t'i lidhë shfaqjet negative të përsëritura, e ka për detyrë t'ia vërë në dukje përsëri e përsëri shokut që vazhdon të gabojë, pa marrë parasysh se ai mund të hidhërohet ose të zemërohet. Revolucionari nuk trembet nga zemërimi i njerit ose i tjetrit, pse ai ka dhe duhet të ketë bindjen se lufton për mbrojtjen e atdheut socialist, të Partisë, të diktaturës së proletariatit, për pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Komunisti revolucionar e di se njerëzit në punë e sipër dhe në jetë bëjnë gabime, se edhe ai vetë bën gabime dhe duhet të korrigjohet nga të tjerët. Kjo është dialektike. Por ka gabime e gabime. Këto, edhe të vogla po të jenë, duhet të vihen në dukje nga ana e shokëve.

Partia e ka theksuar vazhdimisht rrezikshmërinë e madhe të burokratizmit. Elementët armiq që gjykuam dhe ndëshkuam me rreptësi, por me drejtësi, kanë përfituar nga burokratizmi, nga mungesa e kontrollit dhe e vigjilencës, kanë përfituar shumë edhe nga një kuptim i sëmurë i së ashtuquajturës hierarki, domethë-

në l funksioneve që Partia u ka dhënë njerëzve jo si privilegj, por për të kryer detyrat ndershme, me përpikëri dhe në rrugën marksiste-leniniste të saj.

Kur analizojmë punën armiqësore të këtyre elementëve, shohim se spikat kjo çështje: ata, natyrisht, flisnin në emër të tyre si udhëheqës, por flisnin si domos në emër të udhëheqjes kolegjiale kryesore të Partisë ose të shtetit dhe kjo është e rrezikshme. Pikërisht këtu shokët vartës nuk janë thelluar në mendimet ose në opinionet që këta njerëz ose çdo njeri u jep, domethënë nuk e kanë pasur atë shpirt të thellimit në problemet dhe atë zotësi që të kërkonin se një çështje që shtrohet, duhet edhe të zërthehet. Ky zërthim nuk mund të bëhet përnjëherë. Por, një shok që ka njëfarë eksperience dhe që e ka të qartë direktivën, përnjëherë dhe kryesisht shikon edhe anët e mira, edhe anët e këqija. Në anët e këqija ai duhet të ndalet, në mos në atë moment, por të mendojë qoftë edhe një çikë më vonë ose dhe gjatë zbatimit dhe, kur e shikon se nuk janë drejt, atëherë t'i vërë në dukje. Kjo gjë nuk bëhet sa duhet. Mua më duket se shokët duhet t'i mësojmë që ta bëjnë këtë gjë, pse çështja e zbatimit të direktivave dhe centralizmi demokratik lypin edhe thellimin në mendime për t'i zërthyer dhe për t'i zbatuar drejt e në mënyrë krijuese. Në qoftë se këtë nuk e bëjmë, atëherë ta dimë se jemi duke kryer një punë të çalë, rutinë, se veprojmë si automatë, besojmë për çdo gjë, qoftë kjo edhe e gabuar, që mund të na e thotë dikush nën petkun e udhëheqësit ose duke invokuar, pra, duke iu referuar edhe udhëheqjes kolegjiale kryesore të Partisë ose të shtetit.

Krahas me këtë, i rrezikshëm është edhe familjariteti. Për familjaritetin Partia kurdoherë ka folur dhe e ka vënë në dukje rrezikshmërinë e tij, por ky familjaritet shpeshherë shfaqet në forma të ndryshme, të mprehta, por dhe në forma të lehta. Edhe forma e lehtë e familjaritetit përmban në vetvete atë prirje që të çon në mungesën e vigjilencës, në zbutjen e gabimit ose të fajit të të afërmit, qoftë nga fisi, qoftë nga puna, qoftë nga lufta dhe, si pasojë, të bën të arrish në një konkluzion të gabuar, sipas të cilit s'është e domosdoshme t'i vihet në dukje gabimi ose faji shokut, të afërmit ose mikut, se ai e kupton dhe e njeh vetë, është njeri i mirë. Në këtë rast nuk diskutohet çështja nëse ky ose ai është njeri i mirë apo i keq, lidhur me një faj të vogël që ka kryer, çështja vihet që fajin e vogël është e nevojshme t'ia vëmë në dukje shokut, që atë ta bëjmë edhe më të mirë sesa është, që të ecë vazhdimisht në rrugë të drejtë e jo të gabuar, që të mos i trashen pikëpamjet, qëndrimet ose veprimet e gabuara jo vetëm atij që kritikohet, por edhe të tjerëve. Ai që kritikon duhet të jetë korrekt ndaj shokut, pse duhet të nisemi nga parimi i drejtë që, kush të kritikon, të do, kurse ai që të fërkon krahët, nuk të do. Vetëm se nuk është e domosdoshme që të bëhen kritika vazhdimisht, me rast e pa rast. Kritika të zhvillohet kur është rasti dhe vendi për të kritikuar.

Mendjemadhësia, fodullëku dhe prepotenca e elementëve armiq që dënuam u ka imponuar disa shokëve naivë mendime të gabuara dhe, me dredhi, me qëllim e me sistem, armiqtë, për disa veprime, kanë marrë edhe aprovimin e tyre. Kjo është bërë me paramendim

për komprometim. Gjithë Partia dhe ne jemi në gjendje, e bëjmë dallimin dhe është e domosdoshme që ky dallim të bëhet. Por, përveç autokritikave dhe kritikave që janë bërë, duhet vazhdimisht të analizojmë punën e mendimet tona dhe këto të na shërbejnë në të ardhmen. Të kuptojmë mirë se derisa këto ngjarje të rrezikshme u vërtetuan, do të thotë se diçka me rëndësi ka munguar te ne, qoftë në ngritjen ideopolitike, qoftë në ngritjen teknike, qoftë në tiparet morale të njerëve tanë. Kur them edhe morale, e kam fjalën në kuptimin, për shembull, të funksionit që na ka caktuar Partia, pse, për shkak të pozitave që u ka dhënë Partia, disa kuadro mund të kenë manifestuar një mendjemadhësi ose një siguri të tepruar në mendimet që japin, në veprimet që kryejnë, në aprovimet që bëjnë dhe në zërbërthimin e zbatimin e detyrave.

Armiqtë, në format që thashë më sipër, kanë gënjyer e kanë implikuar disa kuadro që ishin vartës të tyre. Prandaj këtu qëndron edhe rrezikshmëria e kësaj pune komplotuese, por edhe mungesa e kujdesit të veçantë të Partisë për edukimin e këtyre shokëve që kanë rënë pa dashje në këto faje e gabime. Ne duhet të mendojmë se njerëzit ndreqen, prandaj të luftojmë që gjithë këta shokë t'i ndreqim dhe do t'i ndreqim.

Partia ka një forcë të madhe edukuese për t'i spastruar gabimet e njerëzve, por për këtë duhet edhe t'i inkurajojë, t'u besojë, t'i ndihmojë dhe këta nga ana e tyre të përpiqen t'i evitojnë gabimet, të evitojnë nxitimin në dhënien e mendimeve. Kjo nuk do të thotë që të druhen, por të ecin me temp, si revolucionarë, të kenë besim se Partia nuk i shikon kurdoherë me

dyshim, përkundrazi, gabimet e tyre ajo i ka parë dhe ata ia kanë treguar. Tash Partia u thotë që të ecin përpara dhe ata kështu duhet të bëjnë, të ecin drejt përpara. Në qoftë se nuk do të veprojmë kështu, atëherë këta shokë do të druhen, do ta ndiejnë veten të dobësuar, do t'u mungojë ai hov revolucionar që duhet t'i karakterizojë si gjithë të tjerët, pse secili prej tyre do të mendojë dy gjëra: ose Partia ka dyshime, ose unë duhet të rezervohem që të mos gaboj. Por, të rezervohesh që të mos gabosh, do të thotë të mos punosh, të mos e kryesh si duhet detyrën e ngarkuar nga Partia. Kjo nuk shkon dhe kështu nuk duhet të ecet.

Të mos humbasim në asnjë moment vigjilencën dhe, duke qenë kurdoherë vigjilentë e të drejtë, t'i shohim me sy kritik punët tona. Kjo nuk do të thotë të dyshojmë vend e pa vend te çdo njeri, por të dyshojmë tek ata që janë armiq, tek ata që përsëritin fajet e gabimet dhe jo tek ata që gabojnë pa qëllim dhe që e kemi për detyrë t'i ndreqim.

Siç e shohim, në qoftë se Partisë dhe pushtetit u mungon vigjilenca, armiku kurdoherë organizohet për të goditur, në radhë të parë, udhëheqjen, Partinë, dhe për të marrë në dorë pushtetin, të cilin ai ka për qëllim ta shndërrojë në një diktaturë fashiste për të rivendosur pronën kapitaliste, për të shkatërruar rendin socialist në vendin tonë e për të krijuar dhe për të sjellë në fuqi borgjeznë e re, siç ndodhi në vendet revizioniste. Prandaj, shokë, duhet të jemi vigjilentë në të gjitha punët që kryejmë, të jemi të drejtë, të matur dhe të disiplinuar.

Disiplina e ndërgjegjshme revolucionare proletare

është shpëtimtare për një vend socialist si yni. Një disiplinë e tillë nuk mund të vendoset kurrë në një vend ku sundon borgjezia ose revizionizmi. Atje ku sundojnë revizionistët, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të ish-demokracisë popullore (për të mos folur për vendet borgjeze), ekzistojnë kaosi dhe këërbaçi. E njëjta situatë është edhe në Kinë.

Edhe më përpara vija e Partisë Komuniste të Kinës nuk ka qenë marksiste-leniniste, por një vijë eklektike, ku plekseshin shumë mendime të errëta e aspak të pastra, që çonin në shthurjen e rregullit e të disiplinës. Por tash, me ardhjen në fuqi të grupit revizionist të Hua Kuo Fenit, të këtyre djathtistëve dhe oportunistëve aleatë të imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit botëror, ne shohim në Kinë një kaos më të madh, ku po ngrenë krye korrente të ndryshme. Tani atje vihet re një mungesë e theksuar discipline në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore e shoqërore. Hua Kuo Fenit me shokë u gërthasin punëtorëve për disiplinë, por disiplinë atje nuk ka. Janë sigurisht punëtorët ata që mund ta vendosin disiplinën, por ata mund ta bëjnë këtë vetëm kur të shohin se e kanë fuqinë në dorë dhe ushtrojnë pushtetin e klasës nëpërmjet diktaturës së tyre e nëpërmjet udhëheqjes së një partie me të vërtetë marksiste-leniniste. Në Kinë nuk ekziston një parti e tillë; pra nuk mund të ekzistojë as një disiplinë e ndërgjegjshme proletare në radhët e punëtorëve dhe, në këto kushte, nuk mund të konsolidohet socializmi.

Partia jonë duhet të ketë parasysh se, megjithëse u prenë fijet e komplotit të madh e të rrezikshëm të armiqve kundër Partisë dhe vendit tonë, përsëri lypset

vigjilencë, sepse mund të krijohen rrjeta merimangash të reja, pse, ashtu si merimanga, edhe armiku, pasi ia prish rrjetën, përpiqet dhe e krijon përsëri. Ndaj ne duhet të jemi vazhdimisht zgjuar.

Dëshiroj të theksoj se Partia dhe të gjitha organet shtetërore janë ato që tok me popullin kanë krijuar në vendin tonë këtë realitet të palëkundshëm, të fortë e të çeliktë. Socializmin e ndërton vetë populli nën udhëheqjen e Partisë, por duhet të kuptojmë se Partia dhe gjithë populli kanë shumë detyra për të kryer, detyra të veçanta dhe detyra të përgjithshme.

Detyrat e veçanta të tyre janë të lidhura me detyrat e përgjithshme. Në qoftë se lihet mënjanë ose harrohet njëra, harrohet edhe tjetra, mosrealizimi i së parës dëmton të dytën, mosplotësimi i së dytës shkatërron të parën. Aparatet, qoftë të Partisë, qoftë të pushtetit, duhet të jenë kurdoherë në këmbë, puna dhe lufta e tyre të jenë të kombinuara mirë nën drejtimin e Partisë dhe gjithsecili të kryejë detyrën e të jetë vigjilent për të zhvilluar si duhet dhe në mënyrë të ashpër luftën e klasave me armiqtë e jashtëm e të brendshëm. Nuk duhet menduar prej askujt se këtë luftë e bëjnë vetëm Sigurimi i Shtetit dhe policia. Këtë e bëjnë gjithë populli, gjithë Partia, gjithë organet e pushtetit, gjithë njerëzit në çdo punë që janë, individualisht dhe kolektivisht. Kështu na mëson Partia të veprojmë, ndryshe nuk mund të ecet si duhet dhe atëherë ndërtimi i socializmit do të hasë në rreziqe, të cilat mund të jenë edhe të mëdha.

Partia jonë, në krye të popullit, në krye të klasës, me diktaturën e proletariatit, u ka bërë ballë të gjitha



furtunave dhe kurdoherë në mëngjes ka lindur i ndritur dielli në atdheun tonë socialist. Kështu do të ngjashë kurdoherë, prandaj ta ruajmë si sytë e ballit Partinë që na udhëheq e të zbatojmë me përpikëri, me ndershmëri, me vendosmëri, me heroizëm dhe me çdo sakrificë vijën dhe mësimet e saj, për të arritur qëllimin e saj të shenjtë, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në vendin tonë.

Eksperiencia e luftës sonë kundër armiqve duhet të studiohet thellë për të na u bërë mësim me vlerë të madhe, që të jemi të armatosur për luftëra e beteja të reja, se lufta e armiqve tanë të jashtëm dhe të brendshëm nuk ka pushuar dhe kurrë nuk do të pushojë.

Komunistët dhe popullin duhet t'i edukojmë me një frymë të tillë militante revolucionare, që të jenë njerëz të aksionit në jetë, të pjekur në politikë, të qartë në ideologji, të patrembur para vështirësive. Lufta për të mbrojtur Partinë dhe atdheun socialist të jetë në rendin e ditës.

Ne komunistët shqiptarë nuk duhet të harrojmë për asnjë moment rrethimin e egër kapitalist, që lufton të hedhë në erë shtetin tonë socialist. Ne, gjithashtu, nuk duhet të kemi kurrë as iluzionin më të vogël se shtetet kapitaliste që na rrethojnë dhe na luftojnë janë zbutur dhe e kanë ulur veprimtarinë e tyre kundër nesh. Jo, ata nuk e kanë zbutur dhe nuk do ta zbutin kurrë luftën e tyre të shumanshme kundër vendit dhe Partisë sonë. Prandaj ta forcojmë çdo ditë dhe nga çdo pikëpamje Republikën tonë Popullore Socialiste, shtetin e proletarëve.

Armiqtë e Partisë e të popullit tonë, që nga Beqir

Balluku e deri tek Abdyl Këllezi, e kishin nxitjen dhe mbështetjen te revizionistët e ndryshëm, të cilët donin që ta kthenin Shqipërinë në ato pozita politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake që kthyen Kinën, duke e përgatitur, siç bëjnë aktualisht, që ta ulin këtë në prehrin e kapitalizmit botëror.

Nga sa përmendëm, shokë, mund të shikojmë një gjë që, megjithëse nuk është karakteristikë e veçantë vetëm për ne, prapëseprapë, del mjaft interesante: Armiqtë që u dënuan ishin kundër diktaturës së proletariatit, ata u përpoqën të degjeronin sistemin tonë socialist, të zbutnin luftën e klasave që zhvillojmë në kundër armiqve, të likuidonin ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmit tonë shtetëror e shoqëror që mbështetet në parimin e centralizmit demokratik. Me fjalë të tjera, ata vepronin duke qenë plotësisht të ndërgjegjshëm në rrugën antileniniste. Lenini na mëson që diktatura e proletariatit është çështje themelore e marksizëm-leninizmit, pa të cilën nuk mund të arrihet ndërtimi i socializmit. Centralizmi absolutisht i nevojshëm dhe disiplina shumë e fortë e proletariatit, sipas Leninit, janë ndër kushtet kryesore për të mundur borgjezinë dhe për të shtypur çdo orvatje të saj kundër shtetit të diktaturës së proletariatit.

Për ruajtjen e diktaturës së proletariatit Partia duhet të bëjë kujdes, që t'i edukojë njerëzit teorikisht, por dhe praktikisht, që këta të mos jenë të ashpër, kur nuk është rasti për të qenë të tillë, dhe të jenë të rreptë, kur kundër diktaturës së proletariatit paraqitet me të vërtetë një rrezikshmëri, goftë kjo edhe filletare. Po ashtu komunistëve u bie detyra me rëndësi që

t'i mësojnë masat të mos i zbutin luftën e klasave dhe ashpërsinë kundër armiqve. Njerëzit tanë, e në radhë të parë anëtarët e Partisë, duhet të mos ushqejnë iluzionin se përpara sukseseve të panumërta që kemi korrur, nuk ka ndonjë rrezik në qoftë se bëhen disa lëshime në çështjet e mëdha parimore. Përkundrazi, çdo lëshim, qoftë edhe i vogël, në problemet kyç që kanë të bëjnë me diktaturën e proletariatit, ka pasoja tepër të rënda për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e atdheut dhe të Partisë.

Partia jonë kurdoherë duhet të ketë parasysh mësimet e Leninit, sipas të cillt diktatura e proletariatit është lufta më heroike dhe më e pamëshirshme e klasës së re kundër një armiku më të fuqishëm, kundër borgjezisë, rezistenca e së cilës dhjetëfishohet pas rrëzimit të saj.

Revizionizmi modern, atje ku ka marrë fuqinë në dorë, jo vetëm teorikisht, në fushën e propagandës, por edhe praktikisht e ka hedhur tej diktaturën e proletariatit, demokracinë më të thellë e më të gjerë për masat punonjëse, dhe e ka shndërruar atë në një diktaturë fashiste që mbron klasën e re borgjeze kapitaliste. Partitë revizioniste të vendeve kapitaliste kanë hedhur tej teorinë e Marksit e të Leninit për diktaturën e proletariatit dhe bëjnë orvatje të shumta që të bashkohen me borgjezinë për të përjetësuar diktaturën e saj.

Në këto kushte, sidomos pas tradhtisë që u vërtetua në Kinë, ne duhet të mendojmë se Partia dhe vendi ynë mbetën të vetëm për të përfaqësuar në praktikë teorinë dhe idetë gjëniale të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit. Duke përkrahur këto ide revolu-

cionare dhe duke mbrojtur, në bazë të tyre, shtetin tonë të diktaturës së proletariatit, ne u japim lëvizjes komuniste ndërkombëtare, proletariatit dhe mbarë botës shembullin e guximshëm se si duhet luftuar përpara rrezikut të madh të oportunizmit të djathtë, që po bashkohet me kapitalizmin botëror. Kështu ne do të tregojmë se edhe një vend i vogël si Shqipëria, me një parti marksiste-leniniste besnike deri në fund, si Partia e Punës, ka mundësi ta mbajë lart të papërlyer flamurin e ideve të revolucionit e të socializmit dhe të ecë përpara.

Lufta jonë duhet të konsistojë në forcimin e një lëvizjeje revolucionare, që të bëhet përfaqësuese e mendimit politik dhe ideologjik marksist-leninist që na mësojnë Marks, Engels, Lenini, Stalini, puna dhe jeta, lufta e pareshtur e Partisë sonë. Kjo luftë duhet t'i tregojë proletariatit botëror se Shqipëria socialiste ekziston, fiton dhe përparon, se ajo ka krijuar një situatë të shëndoshë për ndërtimin e socializmit, për arsye se është mbështetur në marksizëm-leninizmin, të cilin e ka mbrojtur dhe e ka zhvilluar në kushtet e vështira ekonomike, politike, ideologjike që i krijuan shumë armiq. Kjo fitore mund të konsiderohet si një sukses i madh në kushte të vështira jo vetëm për ne shqiptarët, por edhe për proletariatin botëror. Ne nuk i bëjmë këto deklaratë për të mburrur Partinë tonë, por i parashtrijmë si fakte të pakundërshtueshme, se realiteti është realitet.

Proletariati botëror është i interesuar të dijë e të gjykojë si u arrit një fitore e tillë, si u çimentua shteti i vogël socialist shqiptar, si u kalitën partia e komunis-

tëve shqiptarë dhe ndërgjegjja e këtij populli me një shpirt të thellë luftarak dhe me një frymë të theksuar revolucionare proletare. Duke gjykuar nga faktet, proletariati botëror fare lehtë del në konkluzionin e drejtë se Shqipëria fitoi dhe ecën përpara për arsye se Partia e Punës e Shqipërisë, duke i qëndruar besnike marksizëm-leninizmit, duke qenë e pjekur dhe e matur në veprime, duke bërë vazhdimisht sakrifica dhe duke luftuar heroikisht, diti të zbatojë me besnikëri vijën e saj të drejtë, diti të formojë e të ngrejë lart ndërgjegjen e klasës punëtore dhe ta shtrijë këtë në masat punonjëse, diti të organizojë e të lidhet ngushtë me masat e popullit, të fitojë zemrën e tyre e, tok me to dhe në ballë të tyre, të japë shembullin e punës, të luftës, të heroizmave e të sakrificës.

Shokët komunistë dhe proletariati kudo në botë, kur e studiojnë Historinë e Partisë sonë, me siguri arrijnë në përfundimin që ajo fitoi, fiton dhe do të fitojë për arsye se strategjia dhe taktika e saj kanë qenë të drejta dhe revolucionare në çdo kohë, në çdo situatë. Strategjia dhe taktika e Partisë së Punës të Shqipërisë nuk kanë qenë të lëkundshme e oportuniste, përkundrazi, në përcaktimin e tyre janë mbajtur kurdoherë parasysh interesat e klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të të gjitha masave të popullit tonë, por, njëkohësisht, janë mbajtur parasysh, gjithashtu, edhe interesat e revolucionit. Partia jonë ka ditur të analizojë si duhet gjendjen ndërkombëtare e të nxjerrë konkluzione të sakta prej saj.

Këtë punë po bëjnë edhe shokët tanë marksistë-leninistë anëmbanë botës, edhe ata po ecin në këtë

rrugë dhe janë të gëzuar që Partia e Punës e Shqipërisë mbron me besnikëri të madhe marksizëm-leninizmin dhe forcon shtetin e diktaturës së proletariatit. Neve na bie një përgjegjësi e madhe për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit nga elementët armiq të regjur në luftën kundër tij. Ne do ta mbrojmë doktrinën tonë marksiste-leniniste, duke e parë këtë çështje si një detyrë të lidhur ngushtë me mbrojtjen e interesave të lartë të popullit dhe të atdheut tonë socialist nga rreziqet që mund t'u turren dhe vazhdojnë t'u turren atyre. Këto rreziqe, siç ka theksuar shumë herë Partia, t'i parashikojmë dhe t'i vlerësojmë drejt, pra të mos i mbivlerësojmë, por as t'i nënvlerësojmë. Nga mbivlerësimi i rrezikut krijohet disfatizmi, nga nënvlerësimi vijnë mendjemadhësia, ndjenja e kënaqësisë me pak, mungesa e luftës për realizimin e detyrave, dobësimi i vigjilencës dhe venitja e atij hovi revolucionar që duhet të na karakterizojë orë e çast në punën e në jetën tonë.

Si konkluzion, mendoj se ne duhet t'ua mësojmë mirë komunistëve dhe popullit Historinë e Partisë. Komunistët dhe patriotët nuk duhet të kënaqen me një lexim të sipërfaqshëm të Historisë së Partisë, ku njihen me luftërat kolosale që ka zhvilluar ajo kundër deviatorëve të shumtë në gjirin e saj. Ata të studiojnë, që të dinë se deviatorët kanë përdorur metoda të ndryshme për ta përmbysur Partinë, por s'kanë mundur, pse edhe Partia ka qënë kurdoherë vigjilente për t'i zbuluar dhe për t'i dërrmuar.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## KINEZËT PO ZHVILLOJNË NJË PUNË AGJENTURORE

Shënime

18 qershor 1977

Ambasadori ynë në Kinë na lajmëron se kinezët kanë filluar të atakojnë studentët tanë me qëllim që këta të bëhen agjentë të tyre. Kjo ngjau me një studentin tonë në Universitetin e Pekinit, të cilit një pedagog i hodhi fjalë për një gjë të tillë. Studenti ynë lu përgjigj përnjëherë me indinjatë të madhe dhe u paraqit shpejt në ambasadë dhe raportoi për këtë që ndodhi. Kjo është një punë e poshtër, armiqësore. Këtë gjë ne e kishim parashikuar, prandaj kishim lajmëruar shokët e ambasadës që të merrnin kontakt me gjithë studentët, t'i këshillonin ata të ishin korrektë në mësim, në sjellje dhe në punë, por të ishin njëkohësisht edhe vigjilentë, të mbronin vijën e Partisë dhe atdheun e tyre socialist kundër çdo orvatjeje, e çdo natyre qoftë, kundër çdo provokacioni dhe kundër çdo përpjekjeje rekrutimi nga ana e kinezëve.

E tillë është miqësia «e ngushtë», «e pavdekshme» e të tjera dëngla që thonë kinezët në lidhje me ne. Ata janë jo vetëm hipokritë, por edhe armiq, derisa kalojnë në këtë shkallë në veprime kundër vendit tonë. Por ata

bëjnë edhe diçka tjetër. Në muhabet e sipër arrijnë sa të kërkojnë të mësojnë nga studentët tanë se ku u punojnë prindërit, sa veta ka secili në shtëpi, ç'punë bëjnë. Siç duket, ata formulojnë kartela për çdo shqiptar që vete në Kinë, me studime ose me punë. Po përse? Natyrisht, për të bërë një punë armiqësore sabotuese të vazhdueshme edhe në të ardhmen kundër vendit tonë. Këtë gjë kinezët e bëjnë edhe këtu, në vendin tonë. Në krye të agjunkturës së tyre është korrespondenti i HSINHUA-së. Ne kemi formuar bindje se punonjësit e ambasadës, deri te përkthyesit, nuk janë diplomatë të karrierës ose kuadro partie, por agjentë të sigurimit kinez. Këta, natyrisht, mbajnë lidhje me specialistët e tyre që punojnë në fabrikat dhe në objektet e tjera që po ndërtojmë, dhe këta inxhinierë për ambasadën kineze bëjnë, njëkohësisht, me siguri, edhe punën e informatorit.

Për sa i përket çështjes së ndërtimit të fabrikave e të uzinave që po ngremë me ndihmën kineze, ata paraqesin pengesa të mëdha, veçanërisht për kombinatin metalurgjik dhe uzinën e Ballshit. Uzina e Ballshit duhej të kishte mbaruar vite përpara, por ajo vazhdon të mos vihet në shfrytëzim për arsye të disa pjesëve jashtëzakonisht të vogla, për disa pompa, të cilat një herë i dërgojnë, pastaj i tërheqin, i dërgojnë prapë, i montojnë dhe i çmontojnë, duke thënë se «nuk jemi të sigurt, duhet të jemi të sigurt, pa t'i vendosim, jemi në prova për to» etj. Kurse për ndërtimin e kombinatit metalurgjik na nxjerrin një varg pengesash. Një listë të tërë i paraqiti të deleguarit tonë Ministria e Minierave e Kinës, duke i thënë se «ky objekt nuk mund të



livrohet në filan kohë, se nuk është vënë akoma në provë, se ky tash po vihet në provë, mirëpo prova nuk ka dhënë rezultate, se duhet provuar akoma» etj., etj. Kështu këta revizionistë të rinj duan të na i sabotojnë të dyja këto vepra kryesore. Edhe në Fierzë ngjet e njëjta gjë.

Ne kemi durim, por jemi të qartë se uzinat dhe fabrikat që na janë dhënë nga Kina, do të vihen me vonesë të madhe në shfrytëzim, në mos u ndalçin fare në mes të punës. Ndalja e tyre në mes do të jetë një skandal i madh për ta. Sidoqoftë, ata do t'i paguajnë këto dëme që po i sjellin ekonomisë së vendit tonë me vijën e tyre tradhtare dhe me sabotimet. Llogaritë e fundit ata do t'i paguajnë të gjitha.

Në Kinë zyrtarët: drejtorë, zëvendësministra, shefa të sektorëve, u qëndrojnë ftohtë si akulli njerëzve tanë. Kjo do të thotë se udhëheqja e Hua Kuo Fenit e ka vënë në dijeni gjithë aparatin kinez për qëndrimin që duhet mbajtur ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Kurse në popull ka njerëz pro nesh, që na duan me gjithë shpirt, që flasin në favorin tonë, ka edhe të tjerë që kanë frikë të flasin mirë, po nuk flasin kundër. Ka ambasadorë kinezë jashtë, që paraqiten aq të pacipë, aq të paturpshëm, sa të vjen ndot. Ata u thonë ambasadorëve tanë se «s'ka si miqësia midis Kinës dhe Shqipërisë; kjo do të rrojë përjetë, s'ka forcë që ta përçajë këtë miqësi; ne e duam Shqipërinë me gjithë shpirt» e të tjera dokrra të tilla. Por ata shkojnë edhe më tej në sjelljet e tyre hipokrite. Nga njëra anë, me Titon kanë lidhur një miqësi kaq të ngushtë, ideologjike, politike, ekonomike

e çfarë të duash; nga ana tjetër, për shembull, ambasadori kinez në Bukuresht bën demagogji përpara ambasadorit jugosllav, duke i hedhur dorën ambasadorit tonë dhe duke i thënë se «me Shqipërinë ne jemi të lidhur ngushtë, se jemi marksistë-leninistë, ne e duam njëri-tjetrin me një dashuri të sinqertë dhe s'ka forcë në botë që të na ndajë». Por edhe ambasadori jugosllav e luajti mirë rolin. Kur kinezi fliste për këto gjëra, ambasadori jugosllav linte të dukej se po i dridhej dora dhe mjekra, duke u hequr kështu se gjoja ishte shumë i prekur nga fjalët e kinezit, të cilat gjoja drejtoheshin kundër Jugosllavisë! Komedira!

Me rastin e largimit të ambasadorit kinez nga Italia, sikurse njoftojnë lajmet nga Roma, ishin ftuar një mori e madhe funksionarësh të lartë italianë. Ambasadori kinez qëndroi në një dhomë të veçantë me gjithë drejtorët dhe kryetarët e firmave të mëdha të koncerneve italiane si «Siderurgica», «FIAT», «ENI», «Montedison» etj.

Nga sa po duket, Kina është shndërruar dhe po shndërrohet në një vend kapitalist; ajo pranon bashkëpunimin me koncernet e botës kapitaliste, ose të «botës së dytë», siç e quan ajo. Nesër Kina do të pranojë të bëjë të njëjtën gjë edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kurse në platformën e luftës kundër Partisë sonë dhe kundër partive të vërteta komuniste marksiste-leniniste ajo ka zhveshur pallën. Kudo financon dhe grumbullon qelbësira, duke u vënë nga një titull «parti komuniste», «parti punëtore», «parti e çlirimit», «parti marksiste-leniniste». Të gjitha këto «parti» mbajnë avazin e Kinës për «botën e tretë», për bashkimin

me imperializmin amerikan dhe me monopolet e këtij vendi në «luftë të përbashkët frontale kundër social-imperializmit sovjetik». E gjithë kjo nuk është gjë tjetër veçse luftë kundër marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit, kundër socializmit për të arritur që Kina të bëhet një fuqi e madhe kapitaliste botërore.

Shpenzime të mëdha po bëhen në Kinë për pritje e përcjellje. Me qindra, për të mos thënë me mijëra, delegacione po vërshojnë atje nga të gjitha anët e botës kapitaliste. Me ta nënshkruhen kontrata të hapëta, por sigurisht nuk mungojnë të nënshkruhen edhe kontrata të fshehta, manipulohen qëndrime armiqësore politike dhe ushtarake kundër popujve të botës dhe këto Kina kërkon t'i maskojë me një frazeologji gjoja marksiste, por në fakt është qesharake. Këto veprime të qelbura ajo kërkon t'i spërkatë me gjylap, ose me *l'eau de rose*, siç thotë francezi.

Depërtimi i Kinës në Afrikë po bëhet dita-ditës më i hapët dhe kurdoherë ajo është një partner i «sinqertë», por jo i barabartë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Shtetet e Bashkuara kanë aq siguri në veprimet e Kinës, saqë e lënë të veprojnë, sepse veprimi i kinezëve, siç ngjau, për shembull, në Zaire, ose siç ngjet tash në Etiopi e gjatë, u shërben shumë amerikanëve.

Pra, bota thotë se Kina ka devijuar nga marksizëm-leninizmi, ajo është bërë mikja e ngushtë e Jugosllavisë titiste dhe Titoja do të shkojë në Kinë që të miqësohet nga ana shtetërore e në vijë partie dhe po bëhet një me grupin e Hua Kuo Fenit.

Tash Kina po merr masa për të pritur Titon. Për këtë qëllim botohen kryeartikuj, por jo pa hilerë kine-

ze. Lihet të kuptohet: «Titon vërtet do ta pres, do t'i bëj edhe nderime të mëdha shtetërore etj., por do të flas mirë për Stalinin, që ky ka bërë ashtu dhe ka bërë kështu, prandaj, edhe pse unë e pres Titon, i them këtij se kam admirim për Stalinin». E tërë kjo është një grusht tjetër me cukunidha [hithra] që i futet sallatës kineze. Po a do ta hajë Titoja këtë sallatë kineze? Me siguri që ai nuk i ha të tilla sallata.

Vajtja e Titos në Pekin nuk do të jetë një shëtitje turistike. Duke vajtur atje, Titoja ka për qëllim, në radhë të parë, të ngrejë prestigjin e tij, për t'i thënë botës se «Ja, edhe Kina ra në këmbët e mia, më njohu mua si liderin kryesor të lëvizjes komuniste ndërkombe-tare; Kina e Hua Kuo Fenit e hodhi poshtë vijën e Mao Ce Dunit, i cili dikur vërtet ka lëshuar disa shigjeta kundër meje, por ka thënë edhe fjalë të mira. Tash, me vajtjen time në Kinë, të gjitha ato që janë thënë kundër meje, rrëzohen».

Titoja, sigurisht, vete në Kinë edhe për dallavere të tjera, për ta futur Kinën akoma më thellë në rrugën e tradhtisë dhe të demaskimit, që të mos marrë dot frymë më tej. Titoja do të vërë shumë kushte për këtë vizitë, kushte politike, ideologjike, do të bëjë kërkesa ekonomike e do të flasë për çështje ushtarake. Ai do të bëhet interpret i imperializmit amerikan, do të bëhet ndërmjetës i sovjetikëve për probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me Kinën, dhe, për shumë nga këto probleme, ai do të marrë më parë mendimin dhe pëlqimin e «kryetarit të ri të madh» të Kinës, Hua Kuo Fenit, pastaj do të vejë në Kinë.

Titoja e bëri punën e vet, duke deklaruar se u thirr

nga udhëheqja kineze që të bëjë një vizitë në Kinë, dhe ai do ta bëjë këtë, po, se kur do ta bëjë, kjo akoma nuk dihet. Ai do ta bëjë vizitën pasi të marrë miratimin nga kinezët për shumë pikëpamje të tij. Ne mendojmë se Titoja nuk do ta pranojë kurrë teorinë kineze të «botës së tretë», ai ngul këmbë në formulën e tij të «vendeve të paangazhuara» dhe është i bindur në megalomaninë e tij, sepse këtë «botë të paangazhuar» po e dredh si atë unazën e famshme me xhevahirë që mban në gishtin e vet. «Po të dojë Hua Kuo Feni, me të ashtuquajturën botë e tretë, që nuk ekziston, — thotë Titoja, — le të futet në këtë botën tonë».

Një ambasador jugosllav i ka thënë një ambasadori tonë: «Është e qartë për ne përse pretendon Kina për ekzistencën e një «bote të tretë», që në fakt nuk ekziston. Me këtë ajo kërkon të bëhet lidërshipi i të gjitha vendeve të paangazhuara. Por udhëheqësit e vendeve të paangazhuara jemi ne. Jo vetëm kaq, por Kina është diskredituar në «botën e tretë». Të tilla pikëpamje kanë edhe korcanët, që kërkojnë të bëjnë pjesë edhe ata në botën e paangazhuar, sepse duan të luajnë një rol udhëheqës me teorinë e tyre «çuçe», por këto përpjekje s'pranohen nga ne jugosllavët».

Pra, ne shohim të zhvillohet një tragjikomedi në kurriz të popujve, në kurriz të proletariatit, nga një bandë tradhtarësh e revizionistësh kundërrevolucionarë, që kanë ardhur në fuqi me komplete e me diversione dhe që maskohen si përfaqësues të popujve dhe të proletariatit, që bëjnë punë diversioniste kundër çlirimit të popujve dhe revolucionit.

Karakteristikë e përbashkët e të gjithë revizionis-

tëve modernë që janë në fuqi, është puna diversioniste. E gjithë politika e tyre e jashtme është nën kontrollin e organeve të sigurimit të shtetit të tyre. Të ashtuquajturit diplomatë të vendeve revizioniste bëjnë punë agjenturore, vërshojnë ndër vende të botës, në gjirin e popujve të ndryshëm, atje ku kanë mundësi të infiltrojnë, dhe derdhin rubla, dollarë, juanë, dinarë, sterlina, që si e si të krijojnë situata të koklavitura për njerëzit që përpiqen të mobilizohen, të organizohen dhe të luftojnë. Diplomatët e vendeve revizioniste orvaten me çdo mjet që të dobësojnë rezistencën e popujve kundër shtypësve të brendshëm dhe kundër koncerneve e trusteve kapitaliste të shumë shteteve së bashku, për të krijuar atë monopol që skllavëron e shtyp proletariatin. Ashtu si sovjetikët, edhe kinezët po zhvillojnë në gjithë botën, në të gjitha shtetet ku kanë përfaqësi diplomatike, një punë agjenturore.

Mendoj se si sovjetikët edhe kinezët këtë organizim pune diversioniste e kanë bile më të zhvilluar se shumë shtete kapitaliste. Revizionizmi modern është një rrymë dekadente në mes rrymave borgjeze kapitaliste, që nuk ka as më të voglën forcë bindëse. Partitë revizioniste, si dhe partitë e tjera të kapitalit, nuk lidhen me masat. Revizionizmi modern, që është pjellë e tradhtisë ndaj marksizmit e që lufton të realizojë revizionimin e marksizmit, nuk mund të ketë kurrfarë influence politike, sepse nuk është aspak i sigurtë me masat e gjera të popujve. Masat e gjera të popujve, që kanë aspiruar dhe kanë luftuar për socializmin nën parullat e marksizëm-leninizmit, e kanë ndier dhe e kanë kuptuar drejtësinë e kësaj teorie dhe shohin se

tradhtarët e saj flasin ndryshe e veprojnë ndryshe. Prandaj atyre u ka humbur e po u humbet plotësisht besimi ndaj krerëve revizionistë dhe s'ka asnjë dyshim që agjitacioni e propaganda e tyre nuk zënë vend.

Deri tashti njihej njëfarë sallate, që quhet sallata ruse. Tash kemi edhe një sallatë tjetër, sallatën kineze. Kjo sallatë është aq e qelbur, saqë bie erë mijëra milje larg. «Zhenminzhibaoja» po shkruan artikuj redaksionalë, ku «mbro» Stalinin, por «mbrojtja» e Stalinit barazohet me mbrojtjen e Hua Kuo Fenit. Hua Kuo Fenit hiqet si «Stalini i Kinës». Aktualisht flitet boll se Stalini ishte një marksist-leninist i madh që luftoi kundër trockistëve e kundër buharinistëve, kundër Zinovievit, Kamenievit, iksit e ipsilonit. Këtë Stalin gjoja e ka dashur dhe e ka mburrur aq shumë Maoja etj., etj., dhe që këtej dilet në konkluzion që «shoku Hua Kuo Fen lufton kundër katërshes», e cila, thonë ata, është ashtu e është kështu si trockistët, buharinistët etj. Kjo është një tufë e barërave të sallatës kineze. Tjetër bar i keq i saj është miqësia me Titon. Te popujt e revolucionarët ka bërë një përshtypje shumë të keqe për Kinën lajmi për vizitën që do të bëjë Titoja në Pekin, ose më mirë të themi vajtja e Kinës tek Titoja. Gjithë këta thonë se Kina u bë mike me Titon, me revizionizmin, pra ajo ka devijuar nga rruga marksiste-leniniste, që në fakt s'ka qenë kurrë si duhet në këtë rrugë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Shënime për Kinën», vëll. II, f. 512*

*Marrë nga libri: Enver Hoxha, «Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm), nr. 9, f. 279*

# **ROLI UDHËHEQËS I KLASËS PUNËTORE — GARANCI PËR NDËRTIMIN ME SUKSES TË SOCIALIZMIT**

*Përshëndetje drejtuar Kongresit të 8-të të BPSH  
në emër të Komitetit Qendror të Partisë*

**20 qershor 1977**

**Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale  
të Shqipërisë**

**Të dashur shokë dhe shoqe,**

Është një gëzim i madh për Partinë, për Komitetin Qendror të saj dhe për mua personalisht që, me rastin e Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, të kësaj ngjarjeje të shënuar politike, t'ju dërgojmë juve, delegatëve të ardhur nga sektorët e industrisë, të bujqësisë, të arsimit e të kulturës, nga të gjitha frontet e punës e të luftës të ndërtimit të socializmit, dhe nëpërmjet jush gjithë punonjësve të vendit tonë, përshëndetjet më të zjarra revolucionare. Partia ju uron juve, shokë delegatë, Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, kësaj organizate luftarake, ku militojnë punonjësit e vendit tonë, ndërtues të shoqërisë së re socialiste e mbrojtës të atdheut tonë të lavdishëm, sukses të plotë në zhvillimin e punimeve të Kongresit.



Mbajtja e Kongresit tuaj të 8-të në qytetin historik e të bukur të Korçës ka një kuptim të madh. Korça është një qytet me një të kaluar të shquar patriotike, me tradita të pasura revolucionare në lëvizjen punëtore e komuniste. Ajo ka qenë bazë e fuqishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Korça i ka dhënë atdheut patriotë të shquar, që kanë luftuar me pushkë e me penë për liri e pavarësi, për dituri e kulturë. Në Korçë u krijuan organizatat e para punëtore, si dhe organizata e parë politike revolucionare e klasës punëtore shqiptare, Grupi Komunist i Korçës. Këtu kanë punuar e kanë luftuar militantë të shquar komunistë si Ali Kelmendi, shokët Miha Lako, Pilo Peristeri e shumë të tjerë. Këto tradita të mëdha patriotike e revolucionare i kanë frymëzuar dhe i frymëzojnë kurdoherë klasën punëtore dhe gjithë punonjësit e rrethit të Korçës për të qëndruar në ballë të luftës për ndërtimin e socializmit e përparimin e atdheut. Le të jenë këto tradita një tjetër frymëzim revolucionar për suksesin e Kongresit tuaj!

Kongresi i 8-të i Bashkimeve Profesionale dhe detyrat që do të caktojë ai kanë një rëndësi të veçantë jo vetëm për organizatën tuaj, por për gjithë vendin. Ai mblidhet vetëm pak kohë pasi zhvilloi punimet Kongresi i 7-të i Partisë sonë të lavdishme, që i bëri një analizë të thellë marksiste-leniniste gjendjes së brendshme e ndërkombëtare, përgjithësoi në mënyrë shkencore përvojën e pasur revolucionare të Partisë e të popullit tonë dhe shtroi një program të madh pune për të sotmen e për të ardhmen e vendit.

Ju, shokë e shoqe, sillni në Kongres vrullin dhe

entuziazmin e madh të punëtorëve tanë heroikë, të rinisë sonë revolucionare, të grave tona trimëresha, të inteligjencies popullore, të punonjësve të fermave dhe të fshatarëve patriotë, sillni mobilizimin dhe angazhimin e plotë me të cilët ata punojnë për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit të 7-të të Partisë.

S'ka asnjë dyshim se kjo frymë e gjallë, jetëdhënëse e revolucionare do të karakterizojë edhe punimet e Kongresit tuaj, i cili, në bazë të vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë, do të shqyrtojë punën e Bashkimeve Profesionale dhe do t'u ngarkojë atyre detyra të reja, më të mëdha, më të vështira e më frytdhënëse për t'i edukuar e për t'i mobilizuar punonjësit e vendit tonë në rrugën e ndritur të socializmit.

Partia, duke iu përmbajtur me besnikëri mësimëve të Leninit të madh se bashkimet profesionale janë shkolla të komunizmit, ka theksuar gjithnjë se detyra kryesore e tyre ka qenë dhe mbetet edukimi komunist i punonjësve. Bashkimet profesionale kanë dhënë e japin një kontribut të paçmuar për ngritjen e përgjithshme ideologjike, politike, kulturore e profesionale të punonjësve tanë. Ky kontribut e kjo punë e palodhshme shprehën në ndërgjegjen e lartë që karakterizon klasën punëtore e punonjësit e vendit tonë, në vendosmërinë e guximin e tyre për të ecur kurdoherë përpara në rrugën në të cilën i udhëheq Partia. Bashkimet profesionale kanë detyra të mëdha për edukimin e klasës punëtore, që ajo të qëndrojë e palëkundur në lartësinë e misionit të saj historik. Roli udhëheqës i klasës punëtore është një çështje e madhe parimore, një kusht

vendimtar për ruajtjen e forcimin e diktaturës së proletariatit, një garanci për ndërtimin me sukses të shoqërisë socialiste. Sot nuk ka problem me rëndësi të Partisë e të shtetit për të cilin klasa punëtore të mos e thotë fjalën e saj me besim e siguri të plotë. Ky realitet është sanksionuar në Kushtetutën e re të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e cila i garanton klasës punëtore të gjitha të drejtat dhe i njeh asaj rolin udhëheqës në shoqërinë tonë.

Kongresi i 7-të i Partisë shtroi detyrën që edhe në të ardhmen të rritet e të forcohet më tej roli udhëheqës i klasës punëtore, që ajo të marrë pjesë aktivisht në qeverisjen e vendit, që të ushtrojë, nën udhëheqjen e Partisë, kontroll të drejtpërdrejtë në të gjithë sektorët, që me shembullin e saj t'i japë tonin gjithë jetës së vendit.

Organizatat e bashkimeve profesionale në këtë drejtim kanë një fushë të gjerë veprimtarie edukative. Ato kanë, gjithashtu, detyra të mëdha për forcimin e çelikosjen e pandërprerë të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste, aleancë që përbën parimin bazë të diktaturës së proletariatit dhe themelin e unitetit të popullit rreth Partisë.

Plotësimi i detyrave ndaj shtetit dhe shoqërisë nga klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, zhvillimi i mëtejshëm i lidhjeve të ngushta e të gjithanshme midis qytetit e fshatit, forcimi i bashkëpunimit midis industrisë e bujqësisë, edukimi i punonjësve të qytetit me dashurinë për fshatin e punën në bujqësi, zbatimi i programit të Partisë për ngushtimin e dallimeve midis qytetit e fshatit janë faktorë që e fuqizojnë edhe më

shumë aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, që e bëjnë edhe më të pathyeshëm unitetin e popullit rreth Partisë.

Për kalitjen komuniste të njeriut të ri bashkimet profesionale duhet t'i kushtojnë një kujdes të veçantë edukimit të klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse me ideologjinë marksiste-leniniste, me mësimet e Partisë sonë. Është ideologjia proletare, është përvoja revolucionare e Partisë që i bëjnë punonjësit tanë luftëtarë të vendosur të revolucionit e të ndërtimit të socializmit, u zgjerojnë horizontin e u sqarojnë perspektivën, u forcojnë besimin në fitore. Krahas kësaj, edukimi me traditat revolucionare të klasës heroike punëtore, me virtytet e larta proletare të saj, njohja me luftën titanike që ka bërë vetë ajo, mbarë populli ynë për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, përbëjnë një forcë të madhe nxitëse e mobilizuese, një shembull që duhet ndjekur e pasuruar.

Bashkimet profesionale e lidhin Partinë me masat, çojnë tek ato vijën e direktivat e saj, u shpjegojnë me durim detyrat konkrete që shtron ajo, i sjellin Partisë zërin e punonjësve, mendimin dhe eksperiencën e tyre jetësore. Në punën e në përpjekjet e përditshme për zbatimin e vendimeve dhe të orientimeve të Partisë ato i edukojnë masat që ta mbajnë kurdoherë lart vigjilencën revolucionare, që të jenë të papajtueshme me armiqtë e brendshëm e të jashtëm, me shfaqjet e ideologjive të huaja borgjeze e revizioniste, me çdo shtrembërim burokratik e qëndrim liberal, që ta zhvillojnë drejt e me konsekuencë luftën e klasave.

Bashkimet profesionale kanë një rol të rëndësi-

shëm në fushën e prodhimit. Nga ato kërkohet të punojnë pa u lodhur dhe me një ndërgjegje të lartë politike e ideologjike që kudo, në ndërmarrje, në repart e brigadë, të ziejë mendimi i gjallë krijues i punonjësve dhe të mbahet lart fryma luftarake, të zhvillohet gjithnjë e më fuqishëm emulacioni socialist. Ato duhet të luftojnë që të shfrytëzohen të gjitha mundësitë e rezervat e brendshme, për t'u siguruar ekonomisë burime plotësuese, shtetit më shumë të ardhura, popullit më shumë mallra.

Populli ynë i është përveshur punës me një hov të paparë për realizimin e planit të gjashtë pesëvjeçar, i cili do t'i ngrejë ekonominë e kulturën e vendit tonë në një shkallë më të lartë, do ta rritë më tej mirëqenien e masave, do ta forcojë edhe më shumë aftësinë mbrojtëse të atdheut. Rezultatet që janë arritur deri më sot në të gjithë sektorët dëshmojnë se objektivat e caktuar nga Partia janë realistë dhe plotësisht të arritshëm. Që në vitin e parë të pesëvjeçarit u prodhua i gjithë drithi i bukës që i nevojitet vendit, filluan të derdhen giza e çeliku ynë, filluan të prodhohen shumë artikuj, pajisje e makineri, të cilat më parë i importonim, të hapen miniera të reja dhe të rritet prodhimi i mineraleve. Megjithëkëtë, vështirësitë që dalin në rrugën tonë të zhvillimit nuk janë të vogla, të meta e mungesa të ndryshme ekzistojnë akoma. Por Partia ka besim se klasa jonë punëtore, gjithë punonjësit tanë, ashtu si gjer më sot, do t'i mposhtin e do t'i kapërcejnë ato, do të luftojnë me frymë të lartë heroizmi e shpirt sakrificë që plani jo vetëm të realizohet, por edhe të tejkalohet.

Shoqëria jonë socialiste është e interesuar në mënyrë jetike që të realizohen plotësisht planet e prodhimit në të gjithë treguesit. Nafta, kromi, bakri, qymyrguri, hekur-nikeli, energjia elektrike, drithi e qumështi, pjesët e ndërrimit e makineritë që prodhojmë vetë, janë armë të fuqishme në duart e klasës punëtore dhe të popullit, për të forcuar ekonominë e mbrojtjen e vendit, për të rritur mirëqenien e popullit e begatinë e atdheut, për të përballuar bllokadën dhe për të çarë rrethimin.

Bashkimet profesionale, në tërë veprimtarinë e tyre edukative, organizuese e mobilizuese, të mbajnë mirë parasysh se realizimi me sukses i detyrave të mëdha të planit të gjashtë pesëvjeçar kërkon që të punohet kudo me frymë revolucionare e disiplinë proletare, me rendiment e cilësi të lartë, që të realizohen nga të gjithë normat e punës, që secili mbi çdo gjë të vërë interesin e përgjithshëm të shtetit e të popullit, që të mbrohet e të forcohet pareshtur prona e përbashkët, që në çdo fushë e nga kushdo të zbatohet një regjim i rreptë kursimi.

Populli ynë ndërton socializmin i rrethuar nga armiq të egër e të pabesë, imperialistët dhe revizionistët, të cilët bëjnë presion të vazhdueshëm e të gjithanshëm politik, ideologjik, ekonomik dhe ushtarak ndaj vendit tonë. Ata përpiqen të pengojnë zhvillimin e ekonomisë sonë, të shkatërrojnë diktaturën e proletariatit, të mbytin revolucionin në Shqipëri.

Këtyre orvatjeve të tërbuara klasa jonë punëtore, gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit, të udhëhequr nga Partia e tyre marksiste-leniniste, u përgjigjen duke

forcuar edhe më tepër unitetin e tyre rreth Partisë, duke rritur akoma më shumë patriotizmin e flaktë që karakterizon popullin tonë, duke rritur më shumë mobilizimin në punë, frymën e guximit, të vetëmohimit e të vendosmërisë, duke u stërvitur e duke u përgatitur sa më mirë ushtarakisht për mbrojtjen e atdheut. Ata u përgjigjen duke zbatuar me bindje të plotë, si në fushën e prodhimit ashtu edhe në atë të mbrojtjes, parimin e madh revolucionar të mbështetjes në forcat e veta.

Këto cilësi të rralla revolucionare e këtë karakter të paepur e të pamposhtur të njerëzve tanë bashkimet profesionale t'i ruajnë e t'i kultivojnë tek të gjithë punonjësit, tek të vjetrit e tek të rinjtë, te gratë e te burrat. Rritja e besimit në forcën e rendit socialist dhe të ekonomisë sonë popullore, forcimi i bindjes së duart e arta e mendja e ndritur e punonjësve tanë bëjnë të pamundurën, shumëfishojnë forcat për të kapërcyer çdo pengesë, për të mposhtur çdo vështirësi.

Shqipëria e re socialiste ka sot një bazë të fuqishme materialo-teknike, një ekonomi të zhvilluar e të stabilizuar, një industri moderne e bujqësi të përparuar, një arsim e kulturë të masave të gjera punonjëse. Ajo ka një klasë punëtore e një popull me përgatitje të lartë politike e ideologjike, me nivel arsimor, kulturor, teknik e profesional të ngritur. Ky nivel shprehet në talentin e punëtorëve, të teknikëve e të inxhinierëve tanë, që ndërtojnë vepra të tilla madhështore e komplekse si kombinati metalurgjik, Hidrocentrali i Fierzës, uzina e përpunimit të thellë të naftës e shumë vepra të tjera.

Por stadi i arritur dhe perspektivat e zhvillimit

ekonomik e shoqëror të vendit tonë kërkojnë ngritjen e mëtejshme të nivelit të përgjithshëm politik e ideologjik të punonjësve, rritjen e kulturës e të dijeve të tyre. Bashkimet profesionale t'u kushtojnë kujdes këtyre problemeve, të punojnë pa i kursyer forcat për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor në të gjithë sektorët, për përhapjen e përvojës së përparuar, në mënyrë që punonjësit tanë të jenë novatorë të prodhimit dhe militantë të ndërtimit socialist.

Shokë e shoqe,

Sot popujt e botës u janë nënshtruar një presioni të gjithanshëm, një kërcënim të përhershëm dhe një rreziku të madh për lirinë e pavarësinë e tyre, që vijnë nga politika agresive, ekspansioniste e hegjemoniste e imperializmit amerikan dhe e socialimperializmit sovjetik, nga manovrat e djallëzuara të borgjezisë ndërkombëtare dhe intrigat e reaksionit botëror.

Në të njëjtën kohë, fuqitë e mëdha imperialiste, e gjithë bota borgjezo-revizioniste është mbërthyer nga një krizë e gjithanshme ekonomike e financiare, politike e sociale. Inflacioni, rënia e prodhimit, papunësia, ngritja e çmimeve etj. karakterizojnë këtë botë në dekadencë. Borgjezia dhe aparatet e saj sunduese kërkojnë të dalin nga gjendja e rëndë duke rritur shtypjen e shfrytëzimin brenda dhe duke kërkuar aventura përjashta. Si rezultat, tensionet ndërkombëtare janë rritur dhe kërcënimet ndaj popujve janë shtuar.

Klasa punëtore, komunistët e kuadrot, të rinjtë e



gratë, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia jonë popullore duhet t'i shikojnë detyrat e tyre të lidhura ngushtë edhe me këto situata, të luftojnë që t'i realizojnë kudo planet, që të forcohen uniteti monolit i popullit rreth Partisë, diktatura e proletariatit, ekonomia socialiste, mbrojtja e atdheut, të mbahen lart kurdoherë fryma revolucionare dhe gatishmëria luftarake.

Të edukuar nga Partia me frymën e internacionalizmit proletar, klasa jonë punëtore, gjithë punonjësit tanë ndjekin nga afër dhe me simpati të madhe luftën që bën proletariati ndërkombëtar kundër shfrytëzimit kapitalist, kundër krizës e rrezikut të fashizmit, kundër garës së armatimeve e përgatitjeve të superfuqive për luftë. Ata gëzohen për sukseset që popujt e botës arrijnë në përpjekjet e tyre për të mbrojtur e për të fituar lirinë e pavarësinë, për të dëbuar neokolonializmin dhe për të vendosur sovranitetin e vet të plotë mbi pasuritë kombëtare.

Duke luftuar, si gjithnjë, me vendosmëri kundër imperializmit e socialimperializmit, borgjezisë monopoliste, revizionizmit modern dhe reaksionit, bashkimet profesionale të ruajnë e të forcojnë edhe më shumë solidaritetin internacionallist të punonjësve tanë me luftën e proletariatit botëror e lëvizjen çlirimtare të popujve, të përkrahin e të mbështetin të gjithë ata që në botë luftojnë për revolucionin e socializmin, lirinë e demokracinë.

Komiteti Qendror i Partisë shpreh bindjen se punimet e Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale dhe vendimet që do të marrë ai, do t'i japin një shtytje të re veprimtarisë së gjithanshme të tyre, do t'i shtojnë

edhe më shumë hovin dhe mobilizimin në punë klasës punëtore, do t'i rritin më tej ndërgjegjen dhe aksionin e saj revolucionar.

Le të ngrihen, të dashur shokë e shoqe, në një shkallë më të lartë fryma e vendosmërisë, shpirti i sakrificës dhe i heroizmit në punë i klasës sonë të lavdishme punëtore në të gjitha frontet! Le të shpërthejnë fuqishëm vrulli dhe entuziazmi i saj, i grave dhe i të rinjve, i masave punonjëse të qytetit e të fshatit, për të plotësuar e për të tejkaluar planin e vitit 1977 dhe të gjithë pesëvjeçarin, për ta bërë atdheun tonë socialist më të fortë, më të bukur, më të lulëzuar!

Rroftë klasa jonë punëtore heroike!

Rrofshin Bashkimet Profesionale të Shqipërisë!

Rroftë Partia!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Komiteti Qendror i PPSH

Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Dotuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 143 (9007), 21 qershor 1977*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për Bashkimet Profesionale» (Përmbledhje veprash), f. 625*

**SHPREH MIRATIMIN E PLOTË DIJE JAP VOTËN  
TIME PËR VENDIMET E RËNDËSISHME  
TË KONGRESIT**

*Letër drejtuar Kongresit të 8-të të BPSH*

*Korçë*

**23 qershor 1977**

Të dashur shokë dhe shoqe delegatë të Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale,

Me gjithë dëshirën time të zjarrtë për të marrë pjesë në këtë forum të lartë të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, duke qenë mjaft i zënë me punë, nuk munda të vij dot kësaj radhe. Ju siguroj se gjithë këto ditë plot veprimtari intensive dhe shumë të frytshme që po zhvillojnë për të analizuar punën e kryer dhe për të caktuar detyrat e mëdha që na presin për të ardhmen, mendjen e kam pasur dhe e kam aty, e kam ndier veten sikur të isha midis jush, shokë dhe shoqe delegatë të klasës sonë heroike punëtoresh dhe të punonjëseve të vendit tonë. Si delegat që kam nderin të jem zgjedhur në këtë Kongres që po zhvillon puni-

met në qytetin historik të Korçës në frymën luftarake dhe në dritën e mësimëve të mëdha të Kongresit të 7-të të Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë, si të gjithë ju që ndodheni aty, edhe unë e ndiej për detyrë të shpreh miratimin e plotë dhe të jap votën time për ato vendime të rëndësishme që po merrni, për gjithë punimet e Kongresit të 8-të të Bashkimeve Profesionale.

*Enver Hoxha*

Delegat në Kongresin e 8-të të Bashkimeve  
Profesionale të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 151 (9010). 24 qershor  
1977*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Letra të zgje-  
dhura», vëll. 3, f. 259*

# **TË LUFTOJMË ME KONSEKUENCË PËR PASTËRTINË E TEORISË MARKSISTE-LENINISTE DHE PËR MBROJTJEN E PARIMEVE TË SAJ**

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 2-të  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**29 qershor 1977**

Para se të filloj fjalën e mbylljes në këtë seancë të Plenumit të Komitetit Qendror, dëshiroj të them shkurtimisht disa fjalë. Pas tetë muajve nga koha kur zhvilloi punimet Kongresi i 7-të i Partisë, Byroja Politike mendoi që t'i paraqitë Plenumit të Komitetit Qendror një panoramë të situatës ndërkombëtare dhe të zhvillimit të ngjarjeve në botë, veçanërisht në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe posaçërisht në Republikën Popullore të Kinës.

Në Partinë Komuniste të Kinës është zhvilluar një situatë e rëndë jo vetëm për partinë e popullin kinëz, por edhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

---

1. Në këtë Plenum, që u mbledh më 28 dhe 29 qershor 1977, u diskutua rreth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e pritshëm të planit të gjashtëmujorit të parë dhe mbi masat për të plotësuar planin vjetor».

Partia Komuniste e Kinës ka filluar një polemikë të egër, tinzare dhe të hapët kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe kundër të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste. Këtë polemikë ajo e ka hapur brenda saj, por edhe në popull. Partia jonë, siç e dini, ka qenë e matur në këtë çështje. Deri në njëfarë shkalle ky qëndrim nga ne mbahej vetëm për arsye të ndonjë shprese për përmirësim të gjendjes. Por është fakt se Kina po shkon drejt kapitalizmit.

Byroja Politike mendoi që, duke qenë përpara këtyre fakteve, të vërë disa pika mbi i për sa i përket vijës revizioniste që po ndjekin Partia Komuniste dhe qeveria kineze. Jo vetëm udhëheqja e Partisë sonë, por edhe e gjithë Partia i kupton këto ndryshime, por nga ana e Byrosë Politike u pa e arsyeshme që të vëmë disa piketa, se të tilla ka shumë për të vënë. Ne mendojmë të vëmë disa piketa kryesore, që t'i kemi për orientim, veçanërisht udhëheqja e Partisë dhe kuadrot që janë ftuar të marrin pjesë në këtë mbledhje. Për sa i përket çështjes se si do t'u venë këto konkluzione organizatave-bazë të Partisë, t'ia lëmë Byrosë Politike të vendosë mënyrat dhe format.

Ne nuk do të shpejtohem për të bërë polemikë në arenën ndërkombëtare (kur themi polemikë, kuptojmë luftë, pse në greqishten e vjetër *polemos* do të thotë luftë), por do të ecim ngadalë, megjithëse udhëheqja kineze nuk po ngadalëson, por po ecën me hapa të shpejtë drejt revizionizmit dhe kapitalizmit. Ne do të mbrojmë haptazi vijën e Partisë sonë, pastërtinë e marksizëm-leninizmit, duke vënë në dukje tezat tona marksiste-leniniste dhe duke luftuar tezat e revizioni-

zmit modern në përgjithësi dhe tezat e Partisë Komuniste të Kinës në veçanti. Përgjithësisht, për këto çështje ju jeni në dijeni, por menduam që t'i theksonim një çikë më qartë.

Ju kërkoj ndjesë dhe durim, se fjalimi im i mbylljes do të jetë relativisht i gjatë, prandaj kemi menduar që të mbahet në dy seanca. Në qoftë se jemi dakord, fillojmë.

Shokë,

Jam dakord me raportin «Mbi plotësimin e pritshëm të planit të gjashtëmujorit të parë dhe mbi masat për të plotësuar planin vjetor» që u paraqit në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë. Diskutimet e vërejtjet e shokëve, si dhe mendimet që shprehën ata këtu, do të shërbejnë për plotësimin me sukses të detyrave të planit.

Me të dalë nga kjo mbledhje e Plenumit, secili prej nesh t'i përvishet punës për të zbatuar detyrat.

Për arsye se problemet e planit u trajtuan në gjersinë dhe në thellësinë e duhur, në fjalën time nuk do të zgjatem në to, por më lejoni, shokë, që, në vazhdim të tezave të Kongresit të 7-të të Partisë, të theksoj disa çështje të mprehta lidhur me rreziqet që paraqet aktualisht revizionizmi modern, me nevojën e një lufte të pamëshirshme kundër tij dhe me përkrahjen aktive që duhet t'i jepet lëvizjes marksiste-leniniste në botë. Mendoj se këto çështje kanë lidhje me problemin që diskutojmë, për arsye se ndërtimi i socializmit,

lufta për forcimin e diktaturës së proletariatit dhe për mbrojtjen e atdheut, sikurse dihet, janë të pashkëputur nga gjendja ndërkombëtare dhe nga procesi i përgjithshëm i zhvillimit botëror.

Sot janë ngritur në këmbë dhe po luftojnë kundër marksizëm-leninizmit forca të mëdha përfaqësuese të errësirës, të skllavërimit, të shfrytëzimit të proletariatit dhe të popujve — imperializmi amerikan dhe agjenturat e tij, socialimperializmi sovjetik dhe adeptët e tij, si dhe shtete të tjera të mëdha, të mesme dhe të vogla kapitaliste. Kundër ideologjisë sonë revolucionare janë ngritur edhe rryma të tilla ideologjike si socialshovinizmi, socialdemokracia, revizionizmi modern e shumë të tjera me pikëpamje antipopullore.

Në luftën kundër gjithë këtyre armiqve ne duhet të mbështetemi fort në teorinë marksiste-leniniste dhe në proletariatin botëror. Armën e teorisë sonë të dimë ta përdorim mirë. Lufta jonë në planin teorik realizohet me sukses kur u bëhet një analizë e drejtë dialektike situatës ndërkombëtare, ngjarjeve që zhvillohen, objektive dhe qëllimeve të të gjitha forcave shoqërore në lëvizje, që janë në kontradikta e në luftë me njëra-tjetrën. Pasi të bëhet analiza e situatës ndërkombëtare dhe të jetë qartësuar strategjia, përcaktohen edhe taktikat e drejta të luftës në rrethana të ndryshme, për të fituar betejë pas beteje. Kështu ka vepruar kurdoherë Partia jonë.

Bota socialiste është në luftë me botën kapitaliste, proletariati botëror është në luftë të pamëshirshme dhe të vazhdueshme me borgjezinë kapitaliste, popujt janë në luftë me shtypësit e tyre të jashtëm dhe të



brendshëm. Bota socialiste dhe proletariati botëror udhëhiqen në luftë nga ideologjia e tyre marksiste-leniniste që shpjegon domosdoshmërinë e kësaj lufte dhe mobilizon forcat në betejë. Kjo është arsyeja që kapitalizmi dhe imperializmi botëror, në çfarëdo periudhe dhe stad të zhvillimit të tyre, kanë organizuar një luftë të ashpër kundër teorisë së Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit.

Karl Marksi ka zbuluar ligjet e zhvillimit shoqëror, të transformimeve materialiste dialektike të shoqërisë nga një rend më i ulët në një rend më të lartë, ka analizuar e ka demaskuar pronën private mbi mjetet e prodhimit, mënyrën e shpërndarjes kapitaliste, mbivlerën që krijon kapitalin. Ai ka krijuar teorinë shkencore për klasat dhe luftën e klasave dhe ka përgjithësuar metodën e luftës që duhet të ndërmerret proletariati për të përmbysur borgjezinë, për të shkatërruar sistemin kapitalist, për të vendosur diktaturën e tij dhe për të ndërtuar shoqërinë socialiste.

Të gjitha këtyre tezave themelore të Marksit kapitalizmi dhe imperializmi u kanë kundërvënë «teoritë» e tyre. Një mori teoricienësh antimarksistë në të gjitha vendet e botës janë përpjekur me çdo mjet që ta denigrojnë teorinë e Marksit, t'i hedhin baltë, ta shtrembërojnë, ta luftojnë. Por kjo teori që është një shkencë e vërtetë, ka mundur të zotërojë mendimin përparimtar njerëzor dhe të bëhet një armë e fuqishme e proletariatit dhe e popujve në luftë kundër armiqve të tyre.

Duke zbatuar teorinë marksiste dhe duke e zhvilluar atë më tej, Lenini u dha proletariatit dhe parojave të tij, partive marksiste-leniniste, një teori të

pasur shkencore për kushtet e imperializmit dhe të revolucioneve proletare. Lenini e zhvilloi marksizmin jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, pse ai udhëhoqi revolucionin bolshevik në hallkën më të dobët të imperializmit evropian, në Rusinë cariste, duke zbatuar doktrinën e Karl Marksit.

Veprën e Leninit e zhvilloi më tej Stalini. Duke u konsoliduar shteti sovjetik, u arrit një fitore kolosale që bindi proletariatin dhe popujt se armiku që kishin përpara duhej luftuar, se ai mund të mposhtej dhe të shkatërrohej, se kjo gjë ishte plotësisht e realizueshme dhe prova e gjallë për këtë ishte Bashkimi Sovjetik.

Me krijimin e Bashkimit Sovjetik koalicioni imperialist e kapitalist botëror i përforcoi mjetet e luftës politike, ekonomike dhe ushtarake kundër këtij shteti të ri të proletarëve dhe kundër përhapjes në botë të ideologjisë marksiste-leniniste. Imperialistët, borgjezia reaksionare, socialdemokracia evropiane dhe botërore, së bashku me partitë e tjera të kapitalit, përgatitën luftën kundër Bashkimit Sovjetik. Ata, tok me hitlerianët dhe me fashistët italianë, përgatitën edhe Luftën e Dytë Botërore.

Pas fitores mbi hitlerianët bota pësoi ndryshime. Në Evropë dhe në Azi u krijuan shtete të reja socialiste. Shtete të fuqishme kapitaliste, pavarësisht se dolen fitimtare në luftë, u dobësuan, kurse imperializmi amerikan u bë lidheshipi i tyre, ai u fuqizua, u majm nga gjaku që derdhën popujt dhe politika e tij agresive u zhvillua me një temp të fuqishëm për të vendosur hegjemoninë e tij kudo, për të robëruar popujt dhe për të hedhur në dorë pasuritë e tyre. Imperializmi ameri-

kan kishte për qëllim nënshtrimin e botës. Me pak fjalë, kolonializmi i vjetër mori formën e kolonializmit të ri.

Natyrisht, imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror, që mëkëmbeshin pas Luftës së Dytë Botërore, kishin përpara një fuqi të madhe, kampin socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, prandaj atyre iu desh të bënin llogaritë me këtë forcë të madhe popujsh që udhëhiqej nga një politikë e drejtë dhe e qartë, nga një ideologji që do të fitonte zemrat e revolucionarëve, të klasës punëtore dhe të elementëve përparimtarë.

Imperializmi amerikan, duke mos harruar interesat e tij, nga njëra anë, bëri të gjitha përpjekjet që të fuqizonte aleatët e ardhshëm në luftën e ashpër kundër socializmit dhe, nga ana tjetër luftoi që popujt e kontinenteve të ndryshme të braktisnin rrugën e pavarësisë dhe të ecjes drejt socializmit. Për t'i arritur këta objektiva imperializmi amerikan e dinte që duheshin armatosur e forcuar prapavijat e tij, duhej zhvilluar një propagandë në përshtatje me kohën, me zhvillimin e pasluftës. Për këtë qëllim Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kapitali botëror mobilizuan të gjitha forcat e tyre njerëzore: mendimtarët, ekonomistët, sociologët, shkrimtarët e të tjerë, si dhe mjetet e propagandës për një luftë shurdhuese kundër marksizëm-leninizmit e në radhë të parë kundër Bashkimit Sovjetik, si forcë e madhe e socializmit, dhe kundër vendeve të demokracisë popullore të Evropës dhe të Azisë.

Për të mposhtur socializmin dhe për të luftuar ndikimin e madh të teorisë marksiste-leniniste, imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror përdorën dy

rrugë: rrugën e përgatitjes për luftë, duke parashikuar ndërhyrjen nga jashtë, dhe rrugën tjetër, propagandën dhe mjetet e subversionit për të infiltruar në vendet socialiste, për të inkurajuar atje rezistencën kundër socializmit, kundër partive komuniste, për t'i degjeneruar e për t'i përçarë këto vende dhe këto parti. Në këtë drejtim kapitali botëror punoi shumë, mjetet e tij të diversionit e të propagandës patën suksese dhe e dobësuan kampin e socializmit. Suksesi i parë i tyre ishin Titoja dhe titizmi.

**I. Titizmi është një agjenturë e kapitalit e përpunuar me kohë në ilegalitet nga Intelixhens Servisi dhe mbetet një armë e preferuar e borgjezisë imperialiste në luftën kundër socializmit e lëvizjeve çlirimtare**

Kjo agjenturë, duke përdorur parulla pseudomarksishte, mundi të mobilizonte popujt e Jugosllavisë në luftën për çlirim nga nazizmi gjerman. Popujt e Jugosllavisë luftuan për çlirim dhe për socializëm, arritën të krijojnë një shtet federativ, por udhëheqja jugosllave, me Titon në krye, që gjatë gjithë kohës së luftës hiqej sikur kishte ruajtur tiparet kryesore të një partie të Internacionales së Tretë, kishte pikëpamje të tjera, në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe me ndërtimin e një shoqërie me të vërtetë socialiste në Jugosllavi.

Pas Luftës së Dytë Botërore, partia që erdhi në

fuqi në Jugosllavi dhe që kishte seksionin e vet në Komintern, trashëgoi në bilancin e veprimtarisë së saj edhe gabime të natyrës deviacioniste, ajo manifestoi tipare të theksuara nacionalshoviniste dhe u largua jo vetëm nga Bashkimi Sovjetik ose nga Stalini, por sidomos nga ideologjia marksiste-leniniste.

Sistemi i demokracisë popullore, që u vendos në Jugosllavi, ishte i përkohshëm, se ai nuk i përshtatej klikës në fuqi, megjithëse kjo klikë vazhdonte të vetëquhej marksiste. Titistët nuk qenë për ndërtimin e socializmit, ata nuk ishin dakord që Partia Komuniste e Jugosllavisë të udhëhiqej nga teoria marksiste-leniniste dhe nuk e pranonin diktaturën e proletariatit. Këtu e kishte burimin konflikti që shpërtheu midis Byrosë Informativë të partive komuniste e punëtore dhe Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ishte ky një konflikt ideologjik midis marksizëm-leninizmit e revizionizmit dhe jo një konflikt midis personash për arsye «dominimesh», siç duan ta paraqesin revizionistët. Stalini mbronte pastërtinë e teorisë marksiste-leniniste, Titoja mbronte rrymën deviacioniste, revizioniste, antimarksiste.

Analizën e titizmit si ideologji antimarksiste që e profesionon klika e Titos në Jugosllavi, Partia jonë e ka bërë shumë herë dhe historia e ngjarjet që kanë ndodhur kanë vërtetuar drejtësinë e analizave tona, prandaj unë nuk do të zgjatem në këtë drejtim, por do të theksoj veprimtarinë e shumanshme të kësaj agjente në bashkëpunim me kapitalin botëror. Kjo klikë renegatësh, në vitet e para të Çlirimit, hiqej sikur po merrte si shembull ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sov-

jetik dhe shpalli se gjoja po ndërtonte socializmin në Jugosllavi. Kjo bëhej për të mashtruar popujt e Jugosllavisë që kishin derdhur gjak dhe aspironin për socializmin e vërtetë.

Në fakt, klika titiste as ishte e as mund të ishte për rendin shoqëror socialist dhe për formën e organizimit të shtetit sovjetik, sepse Titoja, si agjent i kapitalizmit, që për sistemin kapitalist dhe për një shtet në thelb demokratiko-borgjez, ku të ishte në fuqi klika e tij. Ky shtet do të shërbente për të krijuar idenë se në Jugosllavi po ndërhohej socializmi, veç një «socializëm specifik» i një tipi «më human», pikërisht ai farë «socializmi» që do të shërbente si një kolonë e pestë midis vendeve socialiste. Gjithçka ishte e llogaritur dhe e koordinuar mirë nga imperialistët anglo-amerikanë dhe agjenti i tyre, Titoja. Kështu titistët, duke bërë lojën e imperializmit dhe të kapitalizmit botëror e duke ardhur në ujdi me ta, u vunë në kundërshtim me Bashkimin Sovjetik.

Ishte një fat i madh për kapitalizmin botëror që një vend i quajtur i demokracisë popullore vinte në kundërshtim dhe hynte në konflikt të hapët ideologjik e politik me Bashkimin Sovjetik, sepse brenda në gjirin e kampit socialist një pjesëtar i tij ngrinte krye. Kësaj ngjarjeje kapitalizmi botëror i dha një bujë të madhe që i shërbeu në luftën e tij kundër kështjellës së socializmit. Imperializmi anglez dhe më pas ai amerikan, në vazhdim të planeve të tyre të vjetra, që në kohën e luftës antifashiste nacionalçlirimtare e më vonë, e ndihmuan Titon jo vetëm që të shkëputej nga Bashkimi Sovjetik, por edhe që të ndërmerre veprime

sabotimi kundër tij e sidomos të punonte për të shkëputur nga kampi socialist edhe vende të tjera të demokracisë popullore, me qëllim që ta izolonte Bashkimin Sovjetik nga të gjitha këto vende, të cilat duhej t'i bashkonte me Perëndimin. Kjo ishte politika e kapitalizmit botëror dhe e agjenturës së tij, titizmit.

Titoja veprroi me energji aq të madhe, sa Çerçilli, duke ia çmuar shërbimet e mëdha këtij agjenti, i pati deklaruar: «Unë tash e kuptoj që ju kishit të drejtë, prandaj jam me ju, unë ju dua shumë e më shumë nga ç'ju kam dashur përpara». Nuk ka si të bëhen deklarata më të ngrohta nga një dashnor për dashnoren e tij. Titoja ishte, pra, dashnorja e kapitalizmit, që mori prej tij ndihma të mëdha e të shpeshta ekonomike, ushtarake dhe në platformën politike, të cilat erdhën duke u shtuar vazhdimisht, sidomos nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por financimi i ekonomisë jugosllave duhej të bëhej me kusht që sistemi ekonomik dhe shteti i këtij vendi të merrnin tipare krejtësisht të ndryshme nga ato socialiste të parashikuara nga Lenini dhe Stalini. Në këtë drejtim borgjezia reaksionare jugosllave dhe ajo botërore sajuan një formë të re sistemi ekonomik që u quajt «vetadministrim jugosllav» dhe për ta maskuar e veshën me etiketën «marksiste-leniniste», duke pretenduar që ky sistem ruan format socialiste, proletare.

Titoja adoptoi në Jugosllavi ato forma qeverisjeje që u përpoqën të adoptonin në kohën e Leninit në Bashkimin Sovjetik trockistët dhe elementët e tjerë anarkistë të nxitur nga borgjezia kapitaliste për të sabotuar atje ndërtimin e socializmit. Duke adoptuar këto

forma, Titoja, ndërsa fliste se ndërtonte «socializmin», u dha një ngjyrë krejt të ndryshme parimeve marksiste-leniniste të ndërtimit të ekonomisë, të industrisë, të bujqësisë etj.

Ai mbajti fshehtësinë e partisë ose gjysmëlegalitetin e saj. Titoja e vuri partinë nën varësinë e nën kontrollin e UDB-së, e ktheu atë në një organizatë fashiste, kurse shtetin në një diktaturë fashiste. Rrezikshmërinë e madhe të këtyre veprimeve ne e njohim mirë, sepse të njëjtën gjë synoi të realizonte edhe në Shqipëri agjenti i titistëve, Koçi Xoxe.

Titoja braktisi shpejt kolektivizimin e bujqësisë që gjoja kishte nisur të bëhej në vitet e para, krijoi fermat shtetërore kapitaliste, nxiti pronën private në fshat, la të lirë shitblerjen e tokave, rehabilitoi kulakët, i la fushë të lirë lulëzimit të tregut privat në qytet e në fshat, bëri reformat e para që forconin kapitalizmin në ekonominë në përgjithësi dhe ishte në kërkim të një forme «të re» maskimi për të vazhduar më thellë në rrugën kapitaliste.

Me pak fjalë, republikat e Jugosllavisë morën një fizionomi të atillë administrimi dhe drejtimi organizativo-politik, sa që centralizmi demokratik u likuidua, roli i Partisë Komuniste të Jugosllavisë u venit. Partia Komuniste e Jugosllavisë ndërroi emër, ajo u shndërrua në «Lidhje e Komunistëve të Jugosllavisë», në dukje marksiste nga emërtimi, po antimarksiste në përmbajtje, në norma, në kompetenca dhe në qëllime. Ajo u bë një front pa kolonë vertebrore, u zhvesh nga tiparet dalluese të një partie marksiste-leniniste, ruajti formën e vjetër, por nuk luante më rolin e pararojës



së klasës punëtore, nuk ishte më forcë politike që udhëhiqte Republikën Federative të Jugosllavisë, por kryente gjoja, siç thoshin revizionistët, vetëm funksione «edukuese» të përgjithshme për punonjësit jugosllavë.

Elementët e shtresës së re borgjezo-kapitaliste, që morën fuqinë në dorë në Jugosllavi, u lidhën ngushtë dhe fuqimisht me kapitalizmin e jashtëm. Titoja, Rankoviçi dhe agjentura e tyre likuiduan çdo gjë që mund të kishte ngjyrën e vërtetë të socializmit. Një luftë e rreptë u bë nga ana e titizmit kundër orvatjeve të atyre elementëve të brendshëm që kërkonin ta hidhnin në erë këtë agjunkturë kapitalisto-revizioniste, si dhe kundër gjithë propagandës marksiste-leniniste që zhvillohej jashtë dhe që demaskonte këtë regjim që e hiqte veten socialist.

Në një kohë relativisht të shkurtër Jugosllavia u bë zëdhënësja «socialiste» e imperializmit amerikan, një agjunkturë diversioniste në ndihmë të kapitalit botëror. E gjithë periudha e titizmit në fuqi, që nga viti 1943 e deri tash, është karakterizuar dhe në vazhdim do të karakterizohet nga një veprimtari e ethshme kundër marksizëm-leninizmit, për organizimin kudo në botë të një fushate propagandistike që ta paraqesë sistemin jugosllav si formën e një rendi «socialist të vërtetë», si një «shoqëri të re», një «socializëm të paangazhuar», që nuk është më si ai që kishin ndërtuar Lenini e Stalini në Bashkimin Sovjetik, por një rend socialist «me fytyrë njerëzore», që provohet për herë të parë në botë dhe që jep «rezultate të shkëlqyeshme». Kjo propagandë mundohet të futë në rrugë pa krye popujt që luftojnë për liri e pavarësi kudo në botë.

Me gjithë kreditë e shumta që morën dhe marrin nga jashtë dhe me gjithë shfrytëzimin në palcë që u bëjnë popujve të Jugosllavisë për interesat e klasës në fuqi dhe për interesat e fuqive imperialiste që kanë bërë investime në atë vend, titistët nuk i provuan dhe nuk po i provojnë dot «rezultatet e shkëlqyera» të «socializmit» të tyre «specifik», përkundrazi, në Jugosllavi ka një kaos politik dhe ideologjik, atje mbretëron një sistem anarkosindikalist që krijon papunësi të madhe brenda dhe emigracion të madh të krahut të punës jashtë, gjë që e bën Jugosllavinë krejtësisht të varur nga fuqitë imperialiste.

Shtetit jugosllav nuk i bëhet vonë kur çmimet ngrihen çdo ditë, kur varfëria e masave punonjëse shtohet vazhdimisht dhe kur vendi është zhytur thellë jo vetëm në borxhe, por edhe në krizën e madhe të përgjithshme të botës kapitaliste. Jugosllavia, e cila ka një pavarësi formale dhe një sovranitet fals, nuk ka një potencial ekonomik të vetin veç atij të përbashkët me firma dhe me shtete të ndryshme kapitaliste, prandaj ajo nuk mund veçse të provojë në kurrizin e saj efektet shkatërrimtare të krizës dhe të shfrytëzimit të huaj që bien mbi një vend gjysmëkolonial.

## II. Strategjia e socialimperializmit sovjetik

Revizionizmi sovjetik përfaqëson teorinë dhe praktikën më të plotë e më të përpunuar të kundërrevolucionit dhe revizionimit të teorisë marksiste-leniniste në të gjitha fushat.

S'ka asnjë dyshim që ardhja e hrushovianëve në krye të Bashkimit Sovjetik ishte një fitore tjetër edhe më e madhe politike dhe ideologjike për kapitalizmin botëror, për arsye se revizionizmi modern hrushovian do të merrte përsipër, sikundër mori, shkatërrimin e diktaturës së proletariatit në Bashkimin Sovjetik dhe zëvendësimin e saj me diktaturën fashiste, me shtetin socialimperialist. Kështu Bashkimi Sovjetik, nga një vend i fuqishëm socialist, do të shndërrohej në një vend socialimperialist, për arsye se jo vetëm do të ndërronte rrugën ideologjike, politike dhe sistemin, por do të bëhej edhe një fuqi e madhe, që do të konkurronte me superfuqinë tjetër për ndarjen e tregjeve dhe për shtypjen e popujve.

Edhe ardhjes në fuqi të hrushovianëve në Bashkimin Sovjetik Partia jonë ia ka bërë analizën. Në radhë të parë, Hrushovi dhe grupi i tij, mbasi konsoliduan pozitën pas vdekjes së Stalinit, ndërmorën sulmin kundër ideologjisë marksiste-leniniste, domethënë luftën për të shkurorëzuar leninizmin, duke atakuar Stalinin dhe duke i ngarkuar atij të gjitha ato shpifje që kishte fabrikuar prej kohësh propaganda e ndyrë e borgjezisë kapitaliste botërore. Hrushovianët u bënë kështu zëdhënësit dhe ekzekutuesit e dëshirave të kapitalit kundër ideologjisë marksiste-leniniste dhe revolucionit në Bashkimin Sovjetik. Ata në mënyrë sistematike ndërmorën likuidimin e gjithë strukturës socialiste në vend, luftuan për liberalizimin e sistemit sovjetik, për transformimin e shtetit të diktaturës së proletariatit, për transformimin e industrisë dhe të bujqësisë socialiste.

Bashkimi Sovjetik, që u shndërrua në një vend revizionist, në një shtet socialimperialist, ndërtoi një strategji dhe një taktikë të tij.

Edhe hrushovianët, sikurse titistët, hartuan një politikë të atillë që të kishin mundësi ta maskonin gjithë veprimtarinë e tyre me frazeologji leniniste. Ata e përpunuan ideologjinë e tyre revizioniste në atë mënyrë që ta kalonin përpara proletariatit dhe popujve si një «marksizëm-leninizëm të periudhës së re», që t'u thoshin komunistëve brenda dhe jashtë vendit se «në Bashkimin Sovjetik po vazhdon revolucioni në kushtet e reja politike, ideologjike dhe ekonomike të zhvillimit botëror» dhe që ky revolucion jo vetëm po vazhdon atje, por ky vend gjoja është duke kaluar në fazën e ndërtimit të një shoqërie komuniste pa klasa, ku partia dhe shteti po shuhen.

Partia edhe atje u zhvesh nga atributet e saj si pararojë e klasës punëtore, si forcë e vetme politike drejtuese e shtetit dhe e shoqërisë, dhe u shndërrua në një parti që e sundojnë aparatçikët dhe agjentët e sigurimit. Revizionistët sovjetikë e quajtën partinë e tyre «parti të të gjithë popullit», dhe e katandisën aq keq, sa ajo nuk mund të jetë më e klasës punëtore, por e borgjezisë së re sovjetike.

Hrushovianët bënë të gjitha përpjekjet që këtë vijë të tyre antimarksiste, këtë revizionim të teorisë marksiste-leniniste në të gjitha fushat, t'ua impononin tërë marksistë-leninistëve në botë, ata donin që të gjitha partitë komuniste dhe punëtore të inkuadroheshin në këtë vijë revizioniste dhe të shndërroheshin në parti kundërrevolucionare, në vegla qorre të diktaturës

borgjeze për t'i shërbyer rivendosjes së kapitalizmit. Por kjo nuk u arrit plotësisht siç dëshironin ata, për arsye se, në radhë të parë, Partia e Punës e Shqipërisë qëndroi e patundur në zbatimin me konsekuencë të marksizëm-leninizmit dhe në mbrojtjen e pastërtisë së tij. Në ato momente u gjendën edhe parti të tjera që, për arsyet e tyre jo të kulluara marksiste-leniniste, u lëkundën, nuk i pranuan plotësisht orientimet hrushoviane, disa i pranuan me gjysmë goje, por më pas u nënshtruan. Kishte në ato momente edhe ndonjë parti, siç ishte Partia Komuniste e Kinës, që i kundërshtoi hrushovianët, por për qëllime dhe objektiva krejt të kundërt nga ata që shtynë Partinë e Punës të Shqipërisë të hidhej në luftë kundër revizionizmit hrushovian.

Një Bashkim Sovjetik revizionist duhej të përgatiste po ashtu edhe platformën e politikës së jashtme revizioniste. Kjo platformë konsistonte në bashkekzistencën paqësore hrushoviane dhe në futjen e Bashkimit Sovjetik në «garën paqësore me imperializmin amerikan». Bashkimi Sovjetik revizionist deklaroi, gjithashtu, se «revolucioni proletar kishte hyrë në një fazë të re», se «ai mund të triumfojë edhe në rrugë të tjera, të ndryshme nga ajo e luftës së armatosur të proletariatit». Kështu, sipas tyre, pushteti mund të merrej me rrugë parlamentare dhe demokratike nëpërmjet reformave.

Kjo kthesë e Bashkimit Sovjetik, ky orientim ideologjik dhe politik i tij, u leverdisi shumë imperializmit amerikan dhe fuqive të tjera kapitaliste, jo se Bashkimi Sovjetik ishte futur në shërbimin e tyre të drejt-

përdrejtë, siç qe futur klika e Titos, por sepse shteti më i fuqishëm socialist po braktiste rrugën marksiste-leniniste dhe revolucionin proletar, po krijonte një teori dhe praktikë më të plotë dhe më të përpunuar të kundërrevolucionit.

Imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror, duke pasur përballë një fuqi socialimperialiste me një ideologji kapitaliste, e cila në rrethanat aktuale do të bëhej konkurrente e fortë në tregjet botërore, do të kishte ekzigjencat e saj, do ta bënte rivalizimin më ekstensiv dhe do të shkaktonte konflikte deri në përleshje të armatosura, duhej të perfeksiononin strategjinë dhe taktikat e tyre.

### III. Strategjia e imperializmit amerikan

Imperializmi amerikan dhe borgjezia kapitaliste, socialimperializmi sovjetik, revizionizmi modern dhe socialdemokracia kërkojnë një «shoqëri të re» hibride për të shpëtuar kapitalizmin nga katastrofa.

Imperializmi dhe kapitalizmi arritën të kuptonin se nuk mund t'i shfrytëzonin më popujt e botës me metodat e mëparshme, prandaj në shumë çështje, për sa kohë që nuk kërcënohej sistemi i tyre, ata duhej të lëshonin diçka pa zarar për t'i mbajtur nën zgjedhë masat që shtypnin dhe shfrytëzonin. Këtë gjë imperializmi dhe kapitalizmi do ta bënin me investime e me kreditë që u ndanin atyre shteteve dhe klikave ku kishin vendosur influencën e vet me anën e armëve, domethënë nëpërmjet luftërave të pjesshme, ose duke

marrë vetë pjesë drejtpërdrejt në to, ose duke nxitur një shtet kundër një tjetri. Luftërat lokale shërbenin për t'ia nënshtruar më mirë hegjemonisë së kapitalit botëror ato vende që binin në grackën e tij.

Imperializmi amerikan dhe shtetet e tjera kapitaliste kanë luftuar dhe po luftojnë për të ruajtur hegjemoninë në botë, për të mbrojtur sistemin kapitalist dhe neokolonialist botëror, për të dalë me sa më pak humbje nga kriza e madhe që i ka mbërthyer dhe, gjatë kësaj kohe, bëjnë përpjekje për të mos i lënë popujt dhe proletariatin të realizojnë aspiratat për çlirim. Ata duan të krijojnë përshtypjen se nga ndryshimet që kanë ndodhur në botë dhe nga humbjet që ka pësuar socializmi, janë krijuar rrethana krejt të ndryshme nga ato të mëparshmet.

Elementët e klasës së re, që kishin përqafuar revizionizmin modern dhe kishin marrë fuqinë në vendet ish-socialiste, dhe socialdemokracia në vendet kapitaliste, atje ku ajo mernte pjesë në drejtimin e një shteti kapitalist, duhej të hynin në marrëveshje.

Partitë revizioniste në botë kanë konkurruar dhe konkurrojnë për shfrytëzimin e situatave, që, në bashkëpunim me socialdemokracinë, të krijojnë një gjendje të re për bashkëjetesën e kapitalizmit dhe të të ashtuquajturit rend socialist, të veshur me petka revizioniste dhe me përmbajtje kapitaliste.

Pra, qofshin imperializmi amerikan dhe borgjezia kapitaliste botërore, qofshin socialimperializmi sovjetik, revizionizmi modern dhe socialdemokracia, megjithëse janë në luftë me njëri-tjetrin, janë vënë në kërkim të një *modus vivendi* të ri, të një «shoqërie të re»,

hibride për të mbajtur në këmbë sistemin borgjezo-kapitalist, për ta shpëtuar nga katastrofa, nga krizat e nga revolucioni dhe për të vazhduar shtypjen e shfrytëzimin e popujve me forma e mënyra të reja.

Të gjithë «teoricienët» në shërbim të kapitalit botëror, qofshin këta nga vendet e Evropës Perëndimore ose të Evropës Lindore, po përpiqen të gjejnë formulimet e kësaj «shoqërie të re». Aktualisht ata e kanë gjetur këtë formë «të re» në shoqërinë kapitaliste të Bashkimit Sovjetik, e cila nuk është veçse një shoqëri e degjeneruar, e kanë gjetur në sistemin kapitalist të vetadministrimit jugosllav dhe në regjimet e ndryshme kapitaliste të vendeve të «botës së tretë». Një «shoqëri të re» të këtij tipi ata do ta gjejnë edhe në variantin kinez, që do të kristalizohet në të ardhmen.

Në bazë të deklaratave që bëri presidenti Karter muajin e kaluar për vijën e një «politike të re» të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, del se karakteristika e përgjithshme e kësaj «politike të re», në kushtet aktuale, është lufta e kësaj superfuqie për t'i bërë ballë revolucionit proletar dhe, në përgjithësi, luftërave nacionalçlirimtare të popujve që aspirojnë të çlirohen nga zgjedha e kapitalit të madh botëror, veçanërisht nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik.

Bota kapitaliste, sikurse vura në dukje pak më parë, kërkon të gjejë një rrugëdalje nga humnera, qoftë edhe të përkohshme. Këtë rrugëdalje të përkohshme, natyrisht, imperializmi amerikan përpiqet ta gjejë dhe ta koordinojë mundësisht tok me socialimperializmin sovjetik, me aleatët e tij të NATO-s, me Kinën (pa e



zënë këtë në gojë), si edhe me vende të tjera kapitaliste të industrializuara. Karteri u bëri thirrje dhe u kërkoi vendeve të Lindjes, të Perëndimit dhe vendeve të OPEK-ut që të punojnë së toku dhe «të ndihmojnë efektivisht vendet më të varfra». Këtë bashkëpunim presidenti amerikan e quan si të vetmen alternativë të shkëlqyeshme dhe të vetmen rrugë për ndalimin e luftërave.

Karteri në fjalimin e tij theksoi se sot «ne jemi çliruar nga ajo frikë e përhershme prej komunizmit, e cila dikur na tërhiqte të përqafojm çdo diktator që kishte po këtë frikë».

Natyrisht, Karteri, ky përfaqësues besnik i imperializmit më gjakatar të kohës, kur flet për «çlirim nga frika e komunizmit», nuk ka parasysh «komunizmin» ala jugosllav, ala hrushovian, apo ala kinez, që vetëm maskat kanë komuniste, por ai e ka fjalën për frikën e borgjezisë kapitaliste nga komunizmi i vërtetë, nga e cila ajo as është çliruar e as do të çlirohet kurrë. Përkundrazi, frika e madhe nga komunizmi i vërtetë i ka tmerruar e do t'i tmerrojë akoma më tepër imperializmin e socialimperializmin. Kjo frikë i detyron imperialistët dhe revizionistët të puqen me njëri-tjetrin, të koordinojnë planet e të kërkojnë forma sa më të përshtatshme për t'i zgjatur jetën sundimit të tyre shtypës e shfrytëzues.

Çështja, pra, është që, në këto momente të një krize të thellë ekonomike, politike dhe ushtarake, fitoret e imperializmit, të arritura me tradhtinë e revizionizmit modern në Bashkimin Sovjetik, në vendet e ish-demokracisë popullore e tash së fundi edhe në Kinë,

presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës përpiqet t'i konsolidojë që të shërbejnë si një barrierë për të penguar revolucionin dhe luftën çlirimtare të proletariatit dhe të popujve.

Presidenti amerikan pohon, po ashtu, se nga frika e komunizmit kapitalistët dhe imperialistët kanë përqafuar e kanë përkrahur në të kaluarën diktatorët fashistë si Musolinin, Hitlerin, Hirohiton, Frankon e të tjerë, pse diktaturat fashiste të vendosura nga ana e tyre në vendet përkatëse kanë qenë arma e fundit e borgjezisë kapitaliste dhe e imperializmit botëror kundër Bashkimit Sovjetik të kohës së Leninit e të Stalinit dhe kundër revolucionit proletar botëror. Sipas Karterit qeveria amerikane do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ruajtur statukuonë. Kjo do të thotë që si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe shtetet e tjera imperialiste duhet t'i ruajnë dhe t'i forcojnë pozitat e tyre në botë, ndërsa mosmarrëveshjet që mund të ekzistojnë, dhe që në fakt ekzistojnë me vendet mike dhe aleate të tyre, duhet t'i zgjidhin së toku brenda kësaj statukuoje. Me njëfarë sigurie presidenti amerikan deklaroi se shtetet komuniste (kuptohet revizioniste) kanë ndryshuar pamjen, dhe këtu ai nuk gabohet. Ai thotë se «ky sistem nuk mund të zgjaste gjithë jetën pa u ndryshuar». Natyrisht, ai konfondon tradhtinë revizioniste me sistemin e vërtetë socialist, me komunizmin. Karteri dhe imperializmi amerikan e konsiderojnë sistemin sovjetik hrushovian të ndryshuar si një fitore të kapitalizmit botëror dhe këndeje dalin me deduksionin se kërcënimi i konfliktit me Bashkimin Sovjetik është bërë më pak intensiv, megjithëse ata nuk i mohojnë

kontradiktat dhe zgjatjen e thonjve në botë për hegjemoni me superfuqinë tjetër.

Si konkluzion, thotë Karteri, «politika amerikane duhet të bazohet në një mozaik të ri e më të gjerë të interesave globalë rajonalë dhe të dyanshëm», dhe, pasi e zbërthen këtë «mozaik», ai riafirmon se «të gjitha angazhimet që kanë marrë Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndaj NÁTO-s, e cila duhet të jetë një organizatë e fortë, do t'i mbajnë, se aleanca e tyre me demokracitë e mëdha të industrializuara është e domosdoshme, pse ruan të njëjtat vlera, dhe për këtë ne duhet të luftojmë të gjithë për një jetë më të mirë».

Siç shihet, edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkohen me përpjekjet e revizionistëve modernë sovjetikë, të atyre kinezë dhe të «demokracive të mëdha të industrializuara» për krijimin e një «realiteti të ri», të një «bote të re» që gjoja po zgjohet politikisht. Me fjalë të tjera, duke bërë demagogji, politika amerikane duhet t'u adaptohet situatave të krijuara. Kjo nënkupton që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të ruajtur statukuonë, për t'i prerë hovin hegjemonizmit sovjetik, për ta dobësuar socialimperializmin sovjetik dhe për ta tërhequr Kinën me vete, që kjo të futet gjithnjë e më thellë në kampin imperialist për të shuar luftërat revolucionare të proletariatit dhe të popujve, duhet të mendojnë për të bërë disa lëshime të gënjeshtërtat politike, por asnjë lëshim në fushën ushtarake, asnjë lëshim në politikën e mbajtjes nën zgjedhë dhe nën kontroll të të gjitha shteteve e popujve, në politikën e shfrytëzimit të pasurive kombëtare të vendeve të tjera në dobi të tyre dhe të vendeve të industrializuara.

Kjo është sipas Karterit «politika e re» e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por për ne është e qartë se kjo nuk përbën aspak një politikë të re, por një politikë të vjetër imperialiste grabitqare, neokolonialiste, robëruese dhe shfrytëzuese deri në palcë të popujve dhe të pasurive të tyre, politikë të shuarjes së revolucioneve dhe të luftërave nacionalçlirimtare. Kësaj politike të vjetër e të përhershme imperializmi amerikan kërkon t'i japë tash një bojë të re, gjoja të freskët: ai kërkon t'u japë armë elementëve kundërrevolucionarë në pushtet ose jo në pushtet që të përçajjnë vendet socialiste dhe të luftojnë komunizmin që i ngre popujt dhe proletariatin në luftëra çlirimtare dhe në revolucion.

**Ç'synime kanë mbi popujt e botës strategjitë e superfuqive?**

Imperializmi amerikan me një shkathtësi diplomatike përpiket t'i thellojë gjithnjë e më shumë ganxhat e tij në ekonominë e popujve të tjerë, kurse socialimperializmi sovjetik, që porsa i ka hapur thonjtë e vet, përpiket t'i ngulë ato në vende të ndryshme të botës për të krijuar e për të forcuar edhe ai nga ana e vet pozita neokolonialiste socialimperialiste. Natyrisht, gjatë këtij procesi do të thellohen vazhdimisht kontradiktat ndërmjet imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, dhe sido që këta përpiqen t'i shmangen ballafaqimit, se e dinë që lufta do të sjellë fundin e tyre, prapëseprapë nga etja për hegjemoni ecin drejt luftës.

Para se të arrihet në luftën midis superfuqive, sigurisht, do të kalohet më parë nga shumë luftëra të

pjesshme, të cilat, qoftë njëra, qoftë tjetra superfuqi, do t'i nxitë midis shteteve të ndryshme të «botës së tretë», të «vendeve të paangazhuara», ose të «vendeve në zhvillim».

Presidenti Karter shprehu mendimin se lufta mund të ndodhë vetëm në dy pika të globit tokësor: Në Lindjen e Mesme dhe në Afrikë, dhe kuptohet pse, sepse pikërisht në këto dy rajone të botës aktualisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë interesa më të mëdhenj, në Lindjen e Mesme ndodhet nafta, domethënë janë vendet e OPEK-ut, dhe në Afrikën e pasur përplasen aktualisht interesat ekonomikë dhe strategjikë neokolonialistë për ndarjen e tregjeve dhe të zonave të influencës midis dy superfuqive, të cilat kërkojnë të ruajnë e të forcojnë pozitat e tyre dhe të fitojnë pozita të tjera.

Afrika është një kontinent me shtete të ndryshme, ku të dyja superfuqitë, plus Kina, përpiqen të depërtojnë, të vendosin zonat e tyre të influencës dhe të ndajnë tregjet. Kjo përpjekje për ndarjen e tregjeve dhe për krijimin e zonave të influencës, të koncerneve krijon kontradikta dhe konflikte, shkakton alternativa të vështira si për njërin, ashtu edhe për tjetrën superfuqi, të cilat herë pas here kthehen në luftëra lokale, që nuk kanë aspak për qëllim çlirimin e popujve, por vendosjen ose zhvendosjen e klikave sunduese të kapitalit vendas, të cilat janë herë me një superfuqi dhe herë me tjetrën. Të gjitha këto luftëra do të kenë për qëllim jo vetëm mbrojtjen e zonave të influencës, por mundësisht edhe shtimin e tyre në dobi të secilës superfuqi. Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik janë dy kuçedra tek të cilat popujt nuk kanë

as më të voglin besim. Qëllimi i tyre është të ruhen tregjet që disponon gjithsecili, të ruhen klikat borgjezo-kapitaliste në krye të shteteve që janë nën ndikimin e tyre dhe, në momentin e një konflagracioni botëror, popujt e këtyre vendeve të futen në rrugën e superfuqive dhe të bëhen mish për top.

Balanca midis superfuqive nuk e ka arritur ekulibrin. Ne mendojmë se imperializmi amerikan, qoftë nga ana e armatimeve, qoftë nga ana ekonomike, është më i fuqishëm se socialimperializmi sovjetik. Sipas të dhënave amerikane të botuara zyrtarisht në shtyp, imperializmi amerikan u ka dhënë deri sot vendeve të «botës së tretë» 180 miliardë dollarë kredi, kurse vendeve të KNER-it u ka akorduar deri në 30 miliardë. Kjo do të thotë se forca ekonomike e imperializmit amerikan është shumë më e madhe nga ajo e socialimperializmit sovjetik dhe se gjithë këto investime për imperializmin amerikan nuk janë pa fitime ekonomike, ushtarake, por edhe politike.

Çështja që ka ngritur presidenti amerikan Karter në lidhje me «të drejtat e njeriut» nuk është një çështje sporadike, që ka të bëjë me disa disidentë etj. Jo, ajo tregon qartë kontradiktat e thella midis superfuqive. Imperializmi amerikan, duke vepruar kështu, po e kërcënon socialimperializmin sovjetik mu në strofkën e tij dhe po i bën këtij thirrje që t'i mbajë premtimet që ka dhënë në Helsinki, apo kur ka kërkuar dhe i është akorduar ndihmë ekonomike, se përndryshe imperializmi amerikan ia pret. Me këto presione imperializmi amerikan dëshiron ta vërë në kushte të vështira socialimperializmin sovjetik.

Kur të vijë koha që superfuqitë të mos arrijnë t'i realizojnë interesat e tyre grabitqarë me mjetet ekonomike, ideologjike dhe diplomatike, kur kontradiktat të jenë acaruar në kulm, kur propaganda dhe «reformat» të mos jenë në gjendje t'i zgjidhin këto kontradikta, atëherë do të fillojë lufta ndërmjet tyre. Popujt që do të gjakosen në këtë luftë, do të shohin se kasap-hana u shkakton dëme kolosale atyre, prandaj ata duhet të përpiqen me të gjitha forcat që të mos kapen në befasi, por luftën grabitqare ndër imperialiste ta sabotojnë, që ajo të mos marrë përmasa botërore, dhe, në qoftë se s'ia arrijnë dot kësaj, atëherë ta kthejnë në luftë çlirimtare e të fitojnë.

Revizionistët sovjetikë aktualisht vazhdojnë të mbrojnë ideologjinë, politikën, strukturën shtetërore dhe strukturën e ekonomisë që krijuan dhe ndërtuan me ardhjen e hrushovianëve në fuqi. Ata mbajnë në zgjedhë vendet e ish-demokracisë popullore, që bëjnë pjesë në KNER dhe në Traktatin e Varshavës. Nëpërmjet këtyre organizmave socialimperializmi sovjetik i ka pushtuar këto shtete ushtarakisht dhe ekonomikisht dhe bën ligjin në to. Kjo forcë e madhe, duke përdorur maskën e marksizëm-leninizmit dhe të revolucionit proletar, si dhe frymën gjoja të internacionalizmit proletar (se këto parulla, siç thashë, revizionistët, për demagogji, nuk i hedhin poshtë), përpiqet të zaptojë tregje në kurriz të fuqive të tjera imperialiste dhe të kapitalizmit botëror, si dhe të gënjejë e të shfrytëzojë popujt.

Revizionizmi modern sovjetik, titizmi, aktualisht edhe maoizmi, duke gjykuar se kampi socialist nuk

ekziston më, kanë krijuar emërtime të reja. Natyrisht, këto emërtime ndryshojnë nga njëri-tjetri vetëm nga emrat, kurse qëllimin e kanë të njëjtë: të luftojnë revolucionin dhe ndërtimin e socializmit, që këta të mos zhvillohen në bazë të teorisë së Marksit dhe të Leninit.

Titizmi, si agjunkturë e imperializmit, është për-pjekur dhe po përpiqet t'u tregojë popujve dhe përfaqësuesve të atyre shteteve që e besojnë, se «Republika Federative e Jugosllavisë ndjek politikën e një bashkëzistence paqësore me të vërtetë leniniste», se «politika e Jugosllavisë është një politikë krejt e pavarur dhe sidomos e paangazhuar».

Termi «i paangazhuar» nuk ka asnjë kuptim, pse shtetet që gjoja janë të paangazhuara, që bëjnë pjesë në njëfarë organizimi pa organizim dhe që mblidhen herë pas here për të bërë llafe e për të gënjyer opinionin botëror dhe opinionin e tyre të brendshëm, nuk janë veçse shtete kapitaliste, shumica e të cilave kanë në krye grupe monopolesh të lidhura me monopolet e fuqishme të vendeve imperialiste dhe të shteteve të tjera kapitaliste, që sundojnë në vende të ndryshme dhe që shtypin politikisht dhe ekonomikisht popujt e tyre. Edhe këto shtete, ashtu si Jugosllavia, kanë një pavarësi formale politike, pse, në fakt, janë të angazhuara krejtësisht ose me fuqitë imperialiste, ose me socialimperializmin sovjetik, dhe veprojnë nën diktatin e tyre. Në çdo moment fuqitë imperialiste i kanë duart deri në bërryl brenda në këto vende dhe, në kurrrizin e popujve të tyre, kur të duan, mund të bëjnë diellin ose shiun. Është e vërtetë që në disa nga këto shtete ka rryma politike që përpiqen për pavarë-



sinë e vendeve të veta, por përfaqësuesit e këtyre rrymave nuk janë në gjendje të realizojnë qëllimet që i kanë vënë vetes, ose për arsye se ushqejnë iluzione lidhur me pavarësinë, ose se nuk kanë krijuar mbështetjen te populli. Kjo gjendje do të vazhdojë gjersa ndër-gjegjja këtyre popujve t'u zgjohet në atë shkallë sa të hedhin tej çdo formë skllavërimi të superfuqive dhe të shteteve të tjera kapitaliste.

Për t'u ruajtur nga shpërthimi i luftës popullore që po ndizet në këto vende, për ta shtrirë e për ta zgjatur në to sa më tepër sundimin e tyre, imperialistët amerikanë përditë e më shumë u bëjnë thirrje vendeve imperialiste e revizioniste që të bashkojnë përpjekjet dhe mjetet që disponojnë për ta bërë zap «realitetin e ri të atyre vendeve që po zgjohen politikisht». Këtë ata, si kurdoherë, vazhdojnë ta quajnë «ndihmë për një jetë më të mirë për të gjithë», por popujt e dinë mirë se ç'është fshehur dhe ç'fshihet prapa «ndihmës» amerikane e sovjetike. Dhe si për ta bërë edhe më të qartë karakterin skllavërues të kësaj «ndihme» imperialiste, Karteri, pa u druajtur aspak, deklaroi hapur se ajo «është një alternativë e shkëlqyeshme ndaj luftës».

Imperializmi amerikan, shtetet e tjera kapitaliste dhe socialimperializmi sovjetik i kanë lidhur me një mijë fiye pas vetes së tyre klasat që sundojnë në «vendet e paangazhuara». Këto klasa, natyrisht, duke qenë të skllavëruara e të varura nga monopolet e huaja, duke dashur të zgjatin sundimin e tyre mbi masat e gjera të popujve të vet, përpiqen të japin përshtypjen sikur gjoja formojnë një bllok demokratik shtetesh të pavarura, që ka për qëllim t'u bëjë presione imperializ-

mit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik dhe, gjoja, të pengojë ndërhyrjet në punët e tyre të brendshme.

Gjendja e këtyre «vendeve të paangazhuara», ngjarjet e përditshme që vërtetohen brenda tyre dhe në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, ndërhyrjet e ndryshme në punët e brendshme dhe krijimi i konflikteve vërtetojnë se gjithë kjo formë organizimi nuk është tjetër veçse një bluf, një orvatje për t'i mbajtur të lidhur popujt e këtyre vendeve, të ashtuquajtura të pavarura, te padroni i tyre i fuqishëm. Propaganda që zhvillohet në favor të një grumbullimi të tillë shtetesh shërben për të krijuar përshtypjen sikur të gjitha këto luftojnë për çlirimin politik, ekonomik dhe ushtarak të tyre nga neokolonializmi, nga fuqitë imperialiste e nga socialimperializmi. Një organizim i tillë nga ana e kapitalit botëror ka për qëllim të largojë popujt liridashës nga rruga e çlirimit kombëtar dhe e revolucionit proletar. Titoja dhe klika e tij kanë marrë përsipër një rol të veçantë në këtë detyrë për të çoroditur proletariatin dhe popujt e gjithë këtyre vendeve dhe për të shuar përpjekjet që ata duan të bëjnë dhe bëjnë kundër shtypësve të brendshëm që janë në aleancë me shtypësit e jashtëm.

#### **IV. Strategjia e Partisë Komuniste dhe e Republikës Popullore të Kinës**

**Kina ka devijuar nga marksizëm-leninizmi, ajo po përgatit një kthesë regresive si Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavia.**

Një grupim tjetër, përballë atij të «shteteve të paangazhuara», është edhe ai i «botës së tretë», që e ka marrë Kina në «patronazh», duke deklaruar se edhe vetë bën pjesë në të. Ky grupim konfondohe me grupimin e parë të «të paangazhuarve», ku «udhëheq» tizmi. Midis këtyre dy grupimeve, që udhëhiqen nga e njëjta politikë dhe ideologji, nuk ka ndonjë ndryshim, njëri grup interferohet në tjetrin. Është e zorshme të dallosh cilat shtete janë të «botës së tretë», dhe ç'i dallojnë këto nga «vendet e paangazhuara». Sido që t'ua vësh emrin, këto janë të njëjtat shtete, që kanë në krye grupe kapitalistësh, që, në një mënyrë ose në një tjetër, janë të varura nga superfuqitë dhe marrin kredi prej tyre, që nuk ndjekin një politikë të drejtë dhe që gëzojnë një pavarësi formale. Në këto rrethana, grupimi i shteteve, qoftë në «të paangazhuara», qoftë në «botën e tretë» është një bluf. Këto ndarje kanë për qëllim të mbulojnë karakterin klasor të forcave politike që veprojnë sot në botë, të fshehin kontradiktat themelore të epokës sonë dhe luftën që zhvillohet midis botës borgjezo-imperialiste, nga njëra anë, dhe socializmit, proletariatit botëror e aleatëve të natyrshëm të tij, nga ana tjetër.

Në ndarjen e botës marksistë-leninistët nuk nisen nga disa interesa të ngushtë koniunkturalë të një vendi, duke lënë mënjanë interesat e lëvizjes revolucionare e çlirimtare të vendeve të tjera, por nisen nga epoka historike në të cilën ndodhet bota aktualisht, nga rendi ekonomik-shoqëror, nga klasat kryesore që qëndrojnë përballë njëra-tjetrës dhe nga politika që ndjekin këto klasa. Pikërisht këtë kriter klasor zbatoi

Lenini, kur përcaktoi, pas Revolucionit Socialist të Teorit, se tani në botë ka dy botë: bota e vjetër — kapitalizmi dhe bota e re që po rritet — socializmi. Ndarja e botës sipas kriterit klasor nuk është vetëm një problem teorik me shumë rëndësi, por është një problem serioz që ka të bëjë drejtpërdrejt me strategjinë dhe me taktikat e partive marksiste-leniniste e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Partia Komuniste e Kinës po braktis haptazi leninizmin dhe afirmon se «bota e tretë është forca e madhe lëvizëse që çon përpara rrotën e historisë». Edhe ky afirmim është një bluf, që vërteton se kinezët pranojnë që bota karakterizohet vetëm nga kontradikta midis popujve e imperializmit, kurse kontradiktat e tjera kryesore të botës së sotme, e sidomos ato midis proletariatit e borgjezisë dhe midis socializmit e kapitalizmit, «harrohen» dhe braktisen jo pa qëllim. Shtetet, që kinezët i futin në «botën e tretë», nuk luftojnë as imperializmin, as socialimperializmin, përkundrazi, ato janë në ujdi ose me njërin ose me tjetrën superfuqi. Nuk mund e nuk duhet të konfondohen dëshirat, aspiratat dhe lufta për çlirim e popujve dhe e proletariatit të këtyre vendeve, me politikën e udhëheqësve borgjezë e kapitalistë të shteteve të tyre. Këto çështje Kina i ngatërron me qëllim, por ngatërrimi dhe përzierja e tyre e fut atë në një rrugë kundërrivolucionare dhe antimarksiste, revizioniste.

Që ka kontradikta midis shteteve të «botës së tretë» ose shteteve të «vendeve të paangazhuara», nga njëra anë, dhe imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik, nga ana tjetër, ky është një fakt që nuk

mund të mohohet. Këto kontradikta, që burojnë nga shtypja dhe shfrytëzimi i egër që ushtrojnë të dyja superfuqitë mbi këto shtete, duken sheshit, por nën pretekstin e shfrytëzimit të kontradiktave të këtyre vendeve me dy superfuqitë, nuk duhet të injorohen kursesi ose të kalohen në plan të dytë kontradiktat midis popujve dhe regjimeve reaksionare, shtypëse, fashiste, që ekzistojnë në një numër vendesh, të cilat kinezët i futin në «botën e tretë». Shtypja e shfrytëzimi nuk mund të zhduken pa një luftë revolucionare të udhëhequr nga proletariati botëror dhe nga aleatët e tij të natyrshëm kundër kapitalit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Këtu, pra, qëndron devijimi parimor, faji i madh i Partisë Komuniste të Kinës, se ajo, duke mbështetur nocionin e «botës të tretë» gjoja si një fuqi e madhe në luftën kundër imperializmit dhe socialimperializmit, përkrah pa rezerva borgjezinë shtypëse në këto shtete.

Kina, duke u futur edhe vetë në «botën e tretë», do të ndjekë atë rrugë që ndjekin edhe shtetet e tjera, të cilat bëjnë pjesë në këtë grupim, mirëpo rruga e këtyre shteteve nuk është ajo e revolucionit, e socializmit. Në këtë mënyrë Kina e errëson qenien e vet socialiste. Këtë ajo e bën për arsye se ka devijuar nga rruga marksiste-leniniste dhe tani është duke përgatitur një kthesë regresive, sikurse u bë më parë në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi e gjetkë. Ajo, në fakt, është duke u futur në rrugën e ndërtimit të një shoqërie të tillë kapitaliste, ku rolin udhëheqës ta ketë jo klasa punëtore në aleancë me fshatarësinë, por fshatarësinë në aleancë me kapitalistët dhe me borgjezinë kompradore.

Për të realizuar këtë transformim, Kinës do t'i duhet të zhvillojë një politikë tjetër, që të sigurojë, në radhë të parë, alcatin e saj, imperializmin amerikan, ashtu si edhe vetë imperializmi amerikan, siç deklaroi Karteri, dëshiron «të bashkëpunojë ngushtë me kinezët», duke nënvizuar se «ne i konsiderojmë marrëdhëniet amerikano-kineze si një element qendror të politikës sonë globale dhe Kinën e konsiderojmë një forcë kyç për paqen». Kina, pra, nuk është më për revolucionin proletar, por për një bashkekzistencë paqësore sa më të afrueshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kundër socialimperializmit sovjetik, të cilin e konsideron armikun kryesor.

Për proletariatin dhe për revolucionin proletar nuk shtrohet problemi që të bëhet dallimi i rrezikshmërisë së imperializmave, por vihet detyrë përmbysja e çdo imperializmi dhe në mënyrë të veçantë e dy superfuqive imperialiste. Çdo imperializëm, nga natyra e tij, është kurdoherë armik i egër i revolucionit proletar, prandaj ndarja e imperializmave në më shumë a më pak të rrezikshëm, nga pikëpamja strategjike e revolucionit botëror është e gabuar. Me këto pikëpamje Kina radhitet me ato shtete borgjezo-kapitaliste që qenien e tyre si shtet e mbështetin tek imperializmi amerikan.

Derisa udhëheqja kineze ka të tilla pikëpamje, atëherë, në mos sot, nesër, Kina do të hyjë në varësinë ekonomike dhe në ujdin politik me imperializmin amerikan. Kjo gjë ka filluar të bëhet, ajo po merr kredi nga SHBA dhe nga shtete të tjera të fuqishme kapitaliste të Evropës e të Azisë. Kreditë Kina i merr për të fuqizuar ekonominë dhe mbrojtjen e saj. Të mendosh që impe-

rializmi amerikan dhe fuqitë e tjera kapitaliste i japin Kinës kredi pa interes, është një absurditet. Imperializmi ka interesa të mëdhenj që Kina ta braktisë rrugën e revolucionit, të katandiset në një shtet demokratiko-borgjez dhe të futet në brazdën e atyre vendeve që nuk luftojnë më për revolucionin. Dhe kjo kthesë e Kinës drejt imperializmit, ashtu siç vepruan më parë Bashkimi Sovjetik e të tjerë, tanimë çdo ditë e më shumë po bëhet realitet. Këtë e shohin edhe vetë imperialistët, të cilët, të gëzuar nga ky «realitet i ri» dhe pa kurrfarë demagogjie, deklarojnë se «konfliktet ideologjike që ndanë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën në vitet 50-të janë më pak të dukshme sot dhe ka një nevojë gjithnjë në rritje për bashkëpunim midis superfuqive».

Për mendimin tonë, në esencë, asnjëfarë ndryshimi nuk ka midis pikëpamjeve kineze dhe atyre titiste për sa i përket ndarjes së botës në ato grupime që përmenda më lart. Ndërsa titistët, si marifetçinj në politikë, nuk angazhohen të deklarojnë se grupimi i «të paangazhuarve» është kundër imperializmit amerikan ose kundër socialimperializmit sovjetik dhe mjaftohen me parullën që «vendet e paangazhuara duhet të forcojnë unitetin për t'u bërë presion fuqive imperialiste dhe hegjemoniste, për t'u rezistuar shtypjes dhe shfrytëzimit nga ana e tyre», kinezët kanë pikëpamjen që «bota e tretë duhet të forcohet dhe të organizohet për t'i bërë ballë rrezikut kryesor që sot është socialimperializmi sovjetik». Pra, nëpërmjet «botës së tretë» Kina predikon një aleancë me Shtetet e Bashkuara të

Amerikës dhe bie në ujdi me këtë fuqi grabitqare imperialiste neokolonialiste.

Po t'i shikojmë me vëmendje mendimet politike që udhëheqin Kinën dhe titizmin, del se midis tyre nuk ka diferenca të mëdha. Është për këtë arsye që Kina aktualisht zhvillon marrëdhënie shumë miqësore me Jugosllavinë titiste. Pikëpamjet e kinezëve për Titon dhe për titizmin kanë qenë dashamirëse me kohë. Që më 1956 Mao Ce Duni na ka thënë neve se «Titoja në veprimet dhe në vijën e tij nuk ka gabuar, po ka gabuar Stalini». Kjo do të thotë se që në atë kohë, bile edhe më përpara, Mao Ce Duni ishte dakord me shkëputjen e Jugosllavisë nga kampi socialist dhe me luftën joparimore që ka pasë zhvilluar Titoja kundër Bashkimit Sovjetik për shkurorëzimin e marksizëm-leninizmit. Kjo do të thotë se ai ishte dakord, gjithashtu, edhe me luftën e Titos kundër sistemit socialist të ngritur nga Lenini dhe të vazhduar nga Stalini e nga Partia Bolshevike.

Në qoftë se udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës në disa momente është parë të ketë mbajtur edhe qëndrime antititiste, këtë nuk e ka bërë nga bindjet e saj ideopolitike, por duke u nisur nga situatat koniunkturale. Fondi i pikëpamjeve të udhëheqjes kineze ka qenë pro devijimit titist nga marksizëm-leninizmi. Dhe aktualisht ne shohim se Kina po ndjek të njëjtën rrugë.

Kohët e fundit, kandidati i Byrosë Politike të Partisë Komuniste të Kinës, Sajfudin, vajti për vizitë në Jugosllavi në krye të një delegacioni parlamentar. Nga takimet e shumta që pati dhe nga fjalimet që mbajti ai, duket fare qartë qëndrimi kinez në mbrojtje të Titos,



ndaj personit të të cilit, dhe regjimit antipopullor që kryeson ai, u thurën elozhe.

Në kundërshtim me faktet që provojnë në mënyrë të pakontestueshme se Jugosllavia ka kohë që është kthyer në një shtet ku sundojnë revizionizmi modern, kaosi politik e ideologjik dhe se ekonomia jugosllave, e varur kokë e këmbë nga kapitali i huaj, mbahet nga kreditë e vazhdueshme që merren, kinezi Sajfudin deklaroi: «Me kënaqësi konstatojmë se kombet dhe kombësitë e Jugosllavisë, nën udhëheqjen e presidentit Tito, duke u mbështetur në forcat e veta... kanë arritur suksese të mëdha në ndërtimin e vendit, në zhvillimin e kulturës, të ekonomisë, të shëndetësisë e në fusha të tjera».

Të deklarosh botërisht se ekonomia e Jugosllavisë qenka zhvilluar duke u mbështetur në forcat e veta, kjo do të thotë, veç të tjerave, të marrësh në mbrojtje të ashtuquajturin socializëm vetadministrues dhe të bësh përpjekje për të fshehur faktin që ky farë socializmi e ka kushtëzuar ekonominë jugosllave nga kreditë dhe nga lëmoshat e imperializmit e të kapitalizmit. Deklarimin se Jugosllavia titiste «mbështetet në forcat e veta» s'ka guxuar ta bëjë me zë të lartë deri sot as vetë Titoja. Ky qëndrim e vë udhëheqjen kineze në pozitën qesharake të një avokati sharlatan, i cili, pa pasur asnjë argument, mohon atë faj që vetë i akuzuari e ka pranuar.

Kinezët më parë e kanë konsideruar «lëvizjen për mosangazhimin» si një mjet në duart e shteteve kapitaliste për sundimin e popujve. Tani, duke kthyer pllakën, ata e vlerësojnë këtë si një lëvizje që gjoja drejto-

het kundër imperializmit e kolonializmit, kurse Titon, këtë renegat të lëvizjes komuniste e punëtoje ndërkom-bëtare, e prezantojnë si themelues të «mosangazhimit». Duke shprehur ndryshimin e kursit kinez edhe ndaj kë-saj të ashtuquajture lëvizje të mosangazhimit, Sajfu-dini theksoi: «Jemi të gëzuar, gjithashtu, që mund të konstatojmë se Jugosllavia, si një nga themelueset e lë-vizjes së mosangazhimit, i përmbahet fort politikës së mosangazhimit, mbron me vendosmëri sovranitetin dhe pavarësinë e vet, bën përpjekje të palodhshme për for-cimin e unitetit të vendeve të paangazhuara dhe të ve-ndeve të tjera në zhvillim në luftë kundër imperializ-mit, kolonializmit dhe hegjemonizmit» etj.

Këto deklarata s'kanë nevojë për koment dhe pro-vojnë se kinezët përpiqen të fshehin faktin që titizmi, kjo rrymë oportuniste ideologjike dhe politike, kryen një punë sabotuese midis forcave përparimtare të ve-ndeve që luftojnë për liri e pavarësi dhe çorienton përp-jekjet e tyre për të zhdukur mbeturinat koloniale etj.

Dihet botërisht se vetadministrimi titist, përveç shumë të këqijave të tjera, i solli Jugosllavisë edhe the-llimin e grindjeve e të përçarjeve serioze midis kombe-ve. Borgjezia e re jugosllave, me Titon në krye, ka ndje-kur kurdoherë politikën e shtypjes kundrejt pakicave kombëtare. Kjo politikë ka çuar në mosbesimin dhe në armiqësinë midis kombeve e popujve të Jugosllavisë dhe ka përhapur ideologjinë e nacionalizmit borgjez.

Rrezikun e politikës së thellimit të grindjeve mi-dis kombeve, që bëjnë pjesë në shtetin federativ ju-gosllav, e ka njohur edhe vetë Titoja, i cili, me gjithë masat e shtrëngimit shtetëror që ka marrë për të pa-

randaluar shpërbërjen e federatës së tij dhe me disa të drejta të cunguara që u ka njohur kombësive për të qetësuar trazirat qoftë edhe përkohësisht, është jashtë-zakonisht i shqetësuar se ç'do të ndodhë me këto kombe pas vdekjes së tij.

Për t'i ardhur në ndihmë Titos në një drejtim shumë delikat, për një pikë shumë të dobët, siç është problemi i pakicave kombëtare të Jugosllavisë, kinezi Sajfudin tha se në këtë vend «problemet kombëtare zgjidhen në përputhje me parimet marksiste dhe me kushtet konkrete»!

Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës, kur është çështja për rektifikimin e kufijve të vendosur që në kohën e carëve midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, këtë e reklamojnë, bile me zë të fortë. Por, kur ngrenë çështjen që të prishen marrëveshjet e Luftës së Dytë Botërore, për arsye se «kufijtë e shteteve janë caktuar gabim», kuptohet, nga Stalini, ata e gjejnë «të drejtë» dhe «marksiste-leniniste» që shqiptarët e Kosovës duhet të heshtin për shtypjen që u bëhet dhe për shkeljen e të drejtave. Kjo zgjidhje qenka vënë në rrugën «marksiste» edhe sipas kinezit Sajfudin, kështu që midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk ekzistoka problem në këtë drejtim.

Më shumë se kaq kinezët s'kanë si e mbajnë Titon nën sjetull, dhe Sajfudini s'kishte ç'të thoshte më tepër për të kënaqur ata që e dërguan në Jugosllavi për t'i puthur dorën Titos. Sido që të dëshmojnë kinezët, sado të përpiqen për zbukurimin e titizmit, llafet e tyre nuk mund ta shërojnë federatën jugosllave nga kjo sëmundje kronike që po i zë frymën.

Qëllimi i vizitës së delegacionit parlamentar kinez në Jugosllavi ishte jo vetëm për të mbrojtur Titon dhe titizmin, për të vërtetuar se zhvillimi i Jugosllavisë «mbështetet në forcat e veta» dhe se «politika e mosangazhimit drejtohet kundër imperializmit e kolonializmit», por edhe për të forcuar lidhjet shtetërore dhe të partive, për të trashur miqësinë, për të bashkëpunuar si shokë idealesh të përbashkëta, duke hequr maskat. Këtë qëllim nuk e fshehu aspak kryetari i delegacionit parlamentar kinez në Jugosllavi, i cili u shpreh kështu: «...Kina dhe Jugosllavia ndahen nga mijëra male e lumenj, por... janë të lidhura së bashku nga përvoja e përbashkët historike dhe nga lufta e përbashkët që na pret sot. Ne simpatizojmë, përkrahim dhe inkurajojmë njëri-tjetrin... Ju urojmë të arrini suksese të reja akoma më të mëdha nën udhëheqjen e presidentit Tito...». Është krejt evidente të merret vesh se kinezët duan të luftojnë së bashku me titistët. Po çfarë lufte do të jetë kjo dhe kundër kujt do të drejtohet? S'ka asnjë dyshim se kjo luftë do të jetë si ajo e Titos, që është përkrahur nga imperializmi, dhe do të drejtohet kundër marksizëm-leninizmit, socializmit dhe lëvizjeve çlirimtare. Udhëheqja aktuale kineze do të ecë në këtë rrugë, se po të ishte ndryshe, ajo nuk do të kërkonte shokë, miq e bashkëpunëtorë si Titoja dhe nuk do ta vinte veten në një front me të. Logjikë tjetër në vlerësimin e këtyre fakteve nuk mund të ketë.

Kina mbështet Rumaninë dhe mban lidhje miqësore me të. Se cila është Rumania, gjendja dhe vija e saj politike dhe ideologjike, Partia jonë e ka analizuar me kohë këtë çështje dhe ka provuar se Rumania ësh-

të një shtet i vënë tërësisht në shërbim të socialimperializmit sovjetik, por që lejohet, për aq sa duhet, të zhvillojë edhe një «politikë botërore», gjoja të sajën, që u shërben socialimperializmit sovjetik edhe imperializmit amerikan. Ajo, duke qenë anëtare e KNER-it dhe e Traktatit të Varshavës, domethënë në suazën e socialimperializmit sovjetik, merr kredi edhe nga imperializmi amerikan, edhe nga shtetet e tjera kapitaliste të botës.

Rumania nuk bën pjesë as në grupimin e shteteve «të paangazhuara», as në ato të «botës së tretë», ajo kërkon të asistojë si dëgjuese në këto grupime dhe ka shpallur se është për një grupim me një emër tjetër: «vende në zhvillim», ku futen në një thes si vendet e «botës së tretë», ashtu dhe «të paangazhuarit», pse që të gjitha këto «vende në zhvillim» kanë nevojë të zhvillohen dhe ky zhvillim i tyre kushtëzohet nga ndihma e imperializmit amerikan, e kapitalizmit botëror dhe e socialimperializmit sovjetik. Pra rumunët predikojnë një grupim të tillë të shumanshëm të shteteve të pazhvilluara, që s'është gjë tjetër veçse një shpikje dhe orientim i revizionistëve sovjetikë për hegjemoni.

Rumunët nuk flasin për luftën kundër sistemit të shfrytëzimit kapitalist, se ata janë për mbulimin e kontradiktave klasore, por vetëm kërkojnë ndihma nga cilido që u del përpara. Sipas revizionistëve rumunë mund të qëndrohet në statukuonë ekzistuese, që imperializmit, socialimperializmit dhe fuqive të tjera kapitaliste të mos u hyjë asnjë ferrë në këmbë, me kusht që ata të japin lëmosha për ngritjen e ekonomisë së vendeve në zhvillim. Sipas tyre, fuqitë e mëdha lypset të bëj-

në disa «sakrifica», të japin diçka për të uriturit, që edhe këta të mund të rrojnë disi dhe të mos ngrënë krye. Kështu do të gjendet, thonë ata, një rrugë e mesme, do të vendoset «një rend i ri ndërkombëtar» në të cilin të tërë, të pasur e të varfër, shfrytëzues e të shfrytëzuar, do të rrojnë «pa luftëra», «pa armatime», «në unitet», «në një paqe klasore», në bashkekzistencë ala hrushoviane, ala titiste, ala kineze.

Kinezët janë plotësisht dakord me këto pikëpamje rumune, vetëm se ata tashmë janë angazhuar në «botën e tretë», e cila nuk ka parime të ndryshme nga ato të pranuar prej rumunëve dhe prej titistëve.

Pikëpamjet dhe veprimet amerikane kundër Bashkimit Sovjetik Kina i duartroket, pse do të tregojë që ato i shërbejnë «revolucionit», i shërbejnë «dobësimit të fuqisë së madhe më të rrezikshme në botë, socialimperializmit sovjetik». Nga ana e vet imperializmi amerikan i duartroket pikëpamjet dhe veprimet aktuale të Kinës kundër Bashkimit Sovjetik revizionist, pse, siç është shprehur një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Karterit, «konflikti kino-sovjetik krijon një lloj strukture globale më pluraliste», të cilën imperializmi amerikan e preferon, e konsideron të pajtueshme me nocionin e vet «si duhet të organizohet bota», pra si të ndërsehen shtetet për t'i ngrënë kokën njëri-tjetrit e pastaj SHBA të sundojnë më lehtë mbi gjithë botën. Ja, pra, ku të çojnë pikëpamjet dhe vlerësimet e gabuara, antimarksiste të Kinës, të cilat për këto probleme nuk kanë asnjë ndryshim nga pikëpamjet dhe qëndrimet e imperialistëve amerikanë. Duke vazhduar vlerësimin e armiqve me pikëpamje të tilla të lëku-

ndshme dhe oportuniste, në rast se Kina do të shikojë se imperializmi amerikan do t'ia arrijë qëllimit të vet për dobësimin e socialimperializmit sovjetik, pra kur të shohë sipas mënyrës së vet se imperializmi amerikan po forcohet, atëherë, meqenëse mbështetet te një imperializëm për të luftuar imperializmin tjetër, do ta vazhdojë luftën në krahun e kundërt. Në këtë rast do të bëhet imperializmi amerikan më i rrezikshëm dhe atëherë Kina, automatikisht, duhet të kthehet në të kundërtën e qëndrimit të mëparshëm, të mbështetë socialimperializmin sovjetik, derisa t'ia arrijë edhe ajo qëllimit të saj që të bëhet një fuqi e madhe kapitaliste botërore, që tok me të dy superfuqitë e tjera të luajë një rol të dukshëm në botë, sepse kjo politikë është pjesë përbërëse e strategjisë së saj. Ç'rol do të luajë në këtë rast Kina në arenën ndërkombëtare? Kuptohet se roli i Kinës nuk do të jetë revolucionar, po regresiv, kundërrevolucionar.

Partia Komuniste e Kinës është shmangur nga vija marksiste-leniniste dhe lufton ato parime të domosdoshme, zbatimin në jetë të cilave çon në forcimin e unitetit marksist-leninist të komunistëve të botës. Vepërimtaria që zhvillon Partia Komuniste e Kinës kundër përpjekjeve tona të mëdha për forcimin e unitetit në marrëdhëniet midis partive marksiste-leniniste, është një luftë në prapaskenë, ajo bëhet prapa krahëve, duke denigruar partitë e vërteta marksiste-leniniste që u qëndrojnë besnike mësimëve të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit dhe që kritikojnë veprimet e gabuara antimarksiste të Partisë Komuniste të Kinës e të vetë Mao Ce Dunit.

Një veprimtari antimarksiste shohim të ndiqet edhe nga disa parti politike që janë në fuqi në disa vende të Azisë. Atje vihet re dëshira e madhe e disa udhëheqësve që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Japonia dhe Bashkimi Sovjetik të ndihmojnë me kredi. Kësaj i thonë: imperializmi të financojë ndërtimin e socializmit!

Kur filluam luftën kundër titizmit dhe kundër revizionizmit modern hrushovian, kurrë nuk e ndjemë veten të izoluar. Ne njohëm se lëvizja komuniste ndërkombëtare pësoi një disfatë të përkohshme, por menduam të punonim e të luftonim, të mobilizoheshim totalisht dhe t'i bënim ballë gjithë kësaj rryme të tërbuar antimarksiste në rrethanat që përmenda më lart. Aktualisht, krahas revizionizmit titist, sovjetik etj., siç thamë, po shohim të ngrihet një rrymë tjetër e re revizioniste që është e po atij karakteri, e po atij potenciali politiko-ideologjik dhe jo më pak e rrezikshme, e cila nuk është demaskuar. E kam fjalën për revizionizmin kinez. Natyrisht, kundër këtij oportunizmi të ri të rrezikshëm partitë marksiste-leniniste duhet të ecin me njëfarë kujdesi, për arsye se «fama» e Kinës është e madhe, pse deri tash Kina maoiste ka kaluar në histori si «bastioni», si «luftëtari i vendosur» për marksizëm-leninizmin.

Kthesa nga ana e oportunistëve kinezë është bërë dhe po bëhet, kurse kthesa e partive marksiste-leniniste dhe e proletariatit botëror në mendimet e formuara qysh më parë ndaj Kinës kërkon një kohë, ajo lyp një periudhë sqarimi, një taktikë të zgjuar, por të vendosur, për të hedhur poshtë njërin pas tjetrës kalbëzimet



dhe qelbëzimet që po shihen në veprimtarinë e Partisë Komuniste të Kinës.

## V. Partitë revizioniste të botës janë futur tërësisht në rrugën e kompromisit me borgjezinë

Në këtë lojë të madhe e të rrezikshme kundërrevolucionare, që zhvillohet për të shuar luftën e proletariatit botëror dhe të popujve që luftojnë për çlirim, nuk marrin pjesë vetëm revizionistët sovjetikë, titistët dhe oportunistët e rinj kinezë, por luajnë një rol shumë negativ edhe partitë e tjera revizioniste të shteteve të Evropës, në radhë të parë, si dhe të vendeve të tjera në të gjitha kontinentet.

Partitë revizioniste të vendeve të Evropës Perëndimore po bëjnë përpjekje për të ngritur në këmbë një «shoqëri të re» të ashtuquajtur socialiste, me të cilën të arrihet në socializëm me «reforma strukturore» dhe në koalicion të ngushtë me partitë socialdemokrate, deri edhe me partitë e djathta. E gjithë kjo shoqëri, sipas tyre, do të ndërtohet në baza të reja, me «reforma sociale», me «paqe sociale», me «rrugë parlamentare», me «kompromisin historik» me partitë borgjeze.

Partitë revizioniste të Evropës, si ajo e Italisë, e Francës dhe e Spanjës, e pas tyre të gjitha partitë e tjera revizioniste të Perëndimit, janë futur të tëra në një rrugë kompromisi me borgjezinë kapitaliste. Kjo vijë e tyre antimarksiste cilësohet nga kapitalizmi botëror me termin «eurokomunizëm». Eurokomunizmi

është një rrymë e re pseudokomuniste, që edhe vihet në kundërshtim me bllokun revizionist sovjetik, edhe nuk vihet. Ky qëndrim i lëkundshëm shpjegohet me qëllimet e tyre për të pasur një bashkekzistencë idesh me socialdemokracinë evropiane, me të gjitha pikëpamjet e ndryshme që ziejnë në kazanin e Evropës. Eurokomunistët mund të bashkohen me cilindo, me përjashtim të atyre që luftojnë për triumfin e revolucionit dhe për pastërtinë e ideologjisë marksiste-leniniste.

Të tria partitë revizioniste që përmenda, ajo e Italisë, e Francës dhe e Spanjës, i kanë shtruar haptazi pikëpamjet e tyre të «paqes shoqërore», të «bashkëpunimit të singertë» për të zgjidhur kontradiktat jo vetëm midis tyre, por edhe midis secilës nga këto parti dhe partive të tjera të kapitalit në vendet e tyre.

E ashtuquajtura Parti Komuniste e Francës, siç e dimë, la të kuptohet në kongresin e vet se ajo i ka fshirë diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave, se në socializëm do të shkohet nëpërmjet reformave dhe parlamentit borgjez. Natyrisht, kjo teori revizioniste i leverdis si kapitalit francez, ashtu edhe atij ndërkombëtar, pse nënkupton që, po të futet Partia Komuniste e Francës në vallen e pushtetit borgjezo-kapitalist, siç është futur, do të bashkëpunojë singërisht dhe do t'i shërbejë besnikërisht kapitalit francez, ashtu siç bënë partitë e Internacionales së Dytë, veçanërisht Partia Socialiste Franceze, e cila ka marrë pjesë herë pas here në pushtetin e kapitalit, bile edhe e ka udhëhequr atë. Duke marrë pjesë në radhët e shërbëtorëve të kapitalit, së bashku me ta, partia re-

vizioniste franceze do të vihet kundër proletariatit francez që të shuajë revolucionin.

Pavarësisht nga disa ndryshime formale që pretendon, të njëjtën vijë ka edhe Partia Komuniste e Italisë, e cila e ka shpallur me kohë programin e vet revizionist.

Këtë lojë po zhvillon aktualisht edhe partia pseudokomuniste e Ibarrurit dhe e Karriljos, që u legalizua në Spanjë. Në këtë vend po tregohet një butësi e theksuar ndaj saj. Qeveria aktuale, që është një qeveri e djathtë reaksionare e udhëhequr nga mbreti Huan, për të rehabilituar Partinë Komuniste të Spanjës, pranoi deri edhe dorëheqjen e disa ministrave ultra të djathtë, që e kundërshtuan këtë rehabilitim. Sigurisht, qeveritarët borgjezë spanjollë e bënë këtë lëshim pse janë të bindur që partia e Ibarrurit ka hequr dorë nga revolucioni dhe, siç deklaroi sekretari i përgjithshëm i saj, Karriljo, në mbledhjen e parë të Komitetit Qendror të kësaj partie që u zhvillua në Madrid, Luftën e Spanjës ata e kanë kaluar në histori, çka do të thotë se kanë hequr dorë nga lufta revolucionare e proletariatit. Pra, edhe partia revizioniste spanjolle, si edhe dy motrat e saj gjitone, do të fillojë tash një lojë aleancash me partitë e majta dhe të djathta për t'u zgjedhur në parlament dhe për të bërë përpjekje të përbashkëta për krijimin e një qeverie koalicioni, që të ndër marrë disa reforma me të cilat të shuhet lëvizja revolucionare e proletariatit spanjoll, dëshirat separatiste të pjesëve të ndryshme të Spanjës, si dhe t'i vihet një kapak çlirimit të Spanjës nga reaksioni i brendshëm dhe nga zgjedha e imperializmit

amerikan, i cili ka ndërtuar baza ushtarake dhe ka investuar shuma të mëdha në ekonominë spanjolle.

Të gjithë revizionistët, oportunistët, socialdemokratët punojnë si e si që të ndihmojnë të dyja superfuqitë në veprimet djallëzore grabitqare për shtypjen e revolucionit, duke i nxjerrë këtij një mijë e një pengesa materiale, politike, ideologjike. Ata përpiqen të çoroditin e të përçajnë proletariatin dhe aleatët e tij, se të ndarë e të përçarë në luftëra fraksioniste këta nuk do të mund të krijojnë as brenda një vendi, as në platformën ndërkombëtare atë unitet ideologjik, politik dhe luftarak që është i domosdoshëm për të përballuar sulmet e kapitalizmit botëror në kalbëzim.

Koalicioni i revizionizmit modern dhe i oportunizmit të ri bashkë me socialdemokracinë dhe me kapitalin do të mundohet të evitojë ardhjen e fashizmit në fuqi në disa vende që kërcënohen nga e djathta ekstreme. Për t'ia arritur kësaj, duhet të bëhen patjetër përpjekje për «zbutjen» e kontradiktave që ekzistojnë midis masave të popullit dhe proletariatit, nga njëra anë, dhe borgjezisë kapitaliste, nga ana tjetër. Pra, që të shfrytëzojnë masat punonjëse në një «paqe shoqërore», këto subjekte të koalicionit duhet t'i bëjnë lëshime njëri-tjetrit. Që të arrijnë këtë objektiv, borgjezia kapitaliste dhe partitë e saj vazhdojnë luftën e tyre të hapët kundër komunizmit, kurse partitë revizioniste përpiqen po ashtu të shtrembërojnë marksizëm-leninizmin, ideologjinë udhëheqëse të revolucionit, duke bërë kompromis me borgjezinë kapitaliste, duke rënë në ujdi me të për njëfarë regjimi të përshtatshëm për ta.

Mbështetja e partive revizioniste të Evropës janë

bërë sindikatat reformiste të edukuara dhe të stërvitura posaçërisht në kompromise me patronatin dhe vetëm për reklamime lëmshash ekonomike e jo për greva me kërkesa politike dhe me synime për marrjen e pushtetit nga proletariati. Natyrisht, pazarllëku drejtohet në balancimin e kërkesave dhe të ofertës, një pjesë kërkon lëmoshë dhe pjesa tjetër përcakton masën e kësaj lëmoshe. Të dyja palët, sindikatat reformiste e partitë revizioniste, nga njëra anë, dhe patronati me partitë, me pushtetin dhe me sindikatat e tij, nga ana tjetër, kërcënohen nga revolucioni, nga proletariati, nga partitë e tij të vërteta marksiste-leniniste dhe nga ideologjia e tyre. Prandaj janë në kërkim të një kompromisi reaksionar, zgjidhje kjo që nuk mund të jetë e njëjlojtë në të gjitha vendet kapitaliste, për arsye të ndryshimit të forcës së kapitalit, të përmasave të thellimit të krizës dhe të gjerësisë së kontradiktave që i brejnë nga brenda.

## VI. Lufta e Partisë sonë dhe e partive marksiste-leniniste të botës

Lufta e pamëshirshme kundër kapitalizmit e revizionizmit është garanci për bashkimin e proletariatit botëror dhe për fitoren e marksizëm-leninizmit.

Në «Manifestin e Partisë Komuniste» Marksi dhe Engelsi kanë shkruar:

*«Një fantazmë sillet nëpër Evropë — fantazma e komunizmit. Të gjitha forcat e Evropës*

*plakë... janë bashkuar për t'i bërë luftën e shenjtë kësaj fantazme».<sup>1</sup>*

Ky konstatim i Marksit dhe i Engelsit është aktual edhe në ditët tona. Imperializmi dhe socialimperializmi mendojnë se rreziku i komunizmit është eliminuar për ta, sepse, duke kujtuar se goditja e rëndë që ka pësuar revolucioni është e pandreqshme, ata e nënvleftësojnë forcën e marksizëm-leninizmit, mbivlerësojnë forcat materiale ushtarake shtypëse dhe forcën ekonomike që kanë në dispozicionin e vet. Ky është vetëm një iluzion i tyre.

Marksizëm-leninizmi është ideologjia revolucionare që ka hyrë thellë në ndërgjegjen e proletariatit dhe po ushtron ndikim në masat e gjera të popujve që kërkojnë çlirim. Aq i fortë është ndikimi i kësaj teorie, sa edhe mendimtarët borgjezë nuk mund të mos e llogaritin, kur orvaten të gjejnë forma dhe mënyra për ta shtrembëruar. Sado që janë munduar armiqtë ta falsifikojnë ideologjinë e proletariatit, prapëseprapë nuk kanë mundur t'ia arrijnë qëllimit. Historia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare ka eksperiencën e saj të pasur në këtë drejtim.

Partitë marksiste-leniniste të proletariatit, që janë formuar dhe që do të formohen në të ardhmen, do të gjejnë përpara armiq të egër, të cilët do të bëjnë të gjitha përpjekjet që, me forcë, me politikë dhe me ideologji, t'i dobësojnë, t'i çoroditin dhe t'i shkatë-

---

1. K. Marks e F. Engels, «Manifesti i Partisë Komuniste», f. 13. Tiranë, 1974.

rrojnë. Në këto situata marksistë-leninistëve në të gjithë botën u nevojitet uniteti revolucionar. Duhet të forcohen lidhjet mes partive marksiste-leniniste, duke u frymëzuar nga internacionalizmi proletar. Në veprimet tona të ndihmojmë njëri-tjetrin reciprokisht, prandaj është e domosdoshme të organizohen kontakte të shpejta, të shpeshta dhe të shumanshme midis partive marksiste-leniniste.

Titizmi, revizionizmi hrushovian, aktualisht edhe oportunizmi që po shfaqet në Partinë Komuniste të Kinës, i kanë bërë, po i bëjnë dhe do t'i bëjnë shumë dëm lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në asnjë mënyrë dhe për asnjë moment nuk duhet të nënvleftësojmë koalicionin e madh armiqësor që është ngritur në botë kundër revolucionit dhe teorisë marksiste-leniniste. Prandaj duhet të mobilizohemi totalisht dhe të marrim parasysh sakrifica të panumërta për t'i bërë ballë dhe për ta mposhtur këtë armik të egër e të bashkuar, me potencial ekonomik e ushtarak, por edhe politik e ideologjik të shumanshëm, që synon shtypjen e revolucionit dhe degjenerimin e ideologjisë marksiste-leniniste që udhëheq e do të udhëheqë proletariatin drejt triumfit të revolucionit.

Komunistët, kudo në botë, me ato forca që kanë, nuk duhet të tremben nga mitet false që kanë predominuar në mendimin revolucionar për një kohë, por të luftojnë për të fituar ata që gabojnë, me qëllim që t'i ndreqin, duke bërë përpjekje të mëdha, natyrisht, pa rënë vetë në oportunizëm. Në procesin e luftës parimore, në fillim do të ketë disa reperkusione lëkundjesh, po lëkundjet do të duken në të lëkundurit,

kurse tek ata që janë të vendosur dhe e zbatojnë drejt teorinë marksiste-leniniste, që i shohin drejt interesat e proletariatit të vendit të tyre, të proletariatit botëror dhe të revolucionit, nuk do të ketë lëkundje, përkundrazi, kur të shohin se shokët qëndrojnë të patundur në mendimet e tyre revolucionare marksiste-leniniste, ata do të forcohen më tej.

Në rast se e zbatojmë drejt teorinë marksiste-leniniste, të jemi të bindur se do t'i kapërcejmë të gjitha vështirësitë që do të hasim në rrugën tonë, qofshin këto edhe shumë të mëdha. Marksizëm-leninizmi me parimet e tij të pavdekshme të zbatuara si duhet, do të sjellë në mënyrë të pashmangshme shkatërrimin e kapitalizmit botëror dhe fitoren e diktaturës së proletariatit, me anën e së cilës klasa punëtore do të ndërtojë socializmin dhe do të shkojë drejt komunizmit.

Nga të gjitha sa thamë mund të konkludohet në mënyrë të përmbledhur:

1. Titizmi, ose tradhtia revizioniste jugosllave, nuk filloi më 1948. Ai nuk lindi si një «konflikt midis Stalinit dhe Titos», siç kanë dashur ta përcaktonin titistët, por si një agjenturë e kapitalit e përpunuar me kohë.

Çarja që erdhi më 1948 mes titizmit, kësaj rryme revizioniste që ishte në pushtet, dhe përkrahësve të shumtë të marksizëm-leninizmit ishte shprehje e thellimit në kulm të kontradiktave midis tyre. Pas 1948-s titizmi kaloi hapur dhe në mënyrë galopante në revizionizëm. Në Jugosllavi u forcua diktatura fashiste dhe u vendos forma anarkosindikaliste e vetad-



ministrimit. Ky shndërrim regresiv u paraqit nga armiqtë e lëvizjes komuniste botërore si një «rrugë e sprovuar» e ndërtimit të socializmit, që, në fakt, e ktheu Jugosllavinë në sistemin kapitalist, në një vend ku është në fuqi një klikë renegatësh të marksizëm-leninizmit, që maskohet si marksiste-leniniste.

Vetadministrimi titist vërtetoi rrugën e vendosjes së kapitalizmit pa pengesa serioze, rrugën e një kapitalizmi kaotik, që duhej të ndiqej sidomos nga vende të tilla si Bashkimi Sovjetik revizionist, nga vendet e tjera ku kanë ardhur në fuqi klikat revizioniste, si edhe nga ato vende kapitaliste që nga presioni i revolucionit gjenden në udhëkryq dhe klikat borgjeze kapitaliste të tyre kërkojnë një *modus vivendi* për të gënjyer masat e për të vazhduar shfrytëzimin kapitalist.

Kapitalizmi botëror dhe agjentura e tij, titizmi, e propaganduan dhe e propagandojnë vetadministrimin jugosllav jo vetëm si një «formë të re të sprovuar të ndërtimit të socializmit», por edhe si një «sistem të ri që po depërton në vendet e paangazhuara», të cilat, pavarësisht nga sistemi kapitalist i tyre, vetëquhen socialiste, ose pretendojnë që ndërtojnë socializmin, siç bëjnë, për shembull, Libia, Egjipti, Pakistani, India etj.

I ashtuquajturi sistem i vetadministrimit jugosllav mund të jetë një atu për imperializmin amerikan dhe për shtetet e tjera kapitaliste në krizë. Ai, në rrethana të ndryshme dhe për vende të ndryshme, mund të shërbejë si një sistem rezervë për t'i zgjatur jetën kapitalizmit botëror, që nuk jep shpirt kollaj, por përpiqet të gjejë forma të ndryshme qeverimi në kurriz të

popujve. Ja cila është arsyeja që titizmi është përdorur dhe po përdoret nga imperializmi amerikan si një mjet grumbullimi rreth Jugosllavisë Federative të një sërë shtetesh, që gjenden në pozitë politike të Jugosllavisë dhe që vetëquhen të paangazhuara.

Titizmi është zjarrfikës i revolucionit, ai nuk favorizon ekspansionin socialimperialist sovjetik, por ndihmon ekspansionin imperialist amerikan, përkrah kapitalizmin perëndimor për shuarjen e revolucionit botëror. Në këtë funksion ai qëndron në një radhë, ka të njëjtat qëllime dhe është në unitet ideologjik me revizionizmin modern në përgjithësi dhe me variantet e ndryshme të tij, siç është revizionizmi sovjetik, kinez, italian, francez, spanjoll, kuban, korean etj. Rrugët, format, taktikat mund të jenë të ndryshme, por strategjia është e njëjtë.

**2. Sistemi aktual revizionist sovjetik dhe ideologjia që e drejton atë, janë antimarksiste në përmbajtje dhe në formë.**

Marksizmi u revizionua në Bashkimin Sovjetik, por për ta maskuar pengimin total të zhvillimit të socializmit në vendin ku ka pasë qenë zhdukur për të parën herë shfrytëzimi i njeriut nga njeriu, si dhe për të fshehur kthimin e tij prapa në një vend kapitalist, u ruajtën disa shprehje socialiste të deformuara apo të cinguara.

Partia në këtë vend u zhvesh nga atributet e saj si pararojë e klasës punëtore, si forca e vetme politike drejtuese e shtetit dhe e shoqërisë, atë e shpallën «parti të të gjithë popullit». Kjo kthesë solli si rrjedhim

zhdukjen formale të klasave dhe të luftës së klasave. «Teoria» e zhdukjes së klasave dhe e luftës së tyre ka pasur si objektiv zhdukjen e hegjemonisë së klasës punëtore dhe vënien e saj në një platformë të barabartë me kooperativistët, me shtresën e inteligjencies etj. Pra, për revizionistët sovjetikë, «u niveluan klasat», u zhduk, natyrisht, diktatura e proletariatit, të cilën e shndërruan në «shtet të të gjithë popullit».

Shpallja e partisë dhe e shtetit të të gjithë popullit mohon karakterin klasor të tyre. Lenini thoshte se nocioni i diktaturës së proletariatit ka kuptim vetëm atëherë kur klasa e di

*«... se është duke e marrë ajo vetë pushtetin politik në duart e saj dhe nuk gënjen as veten, as të tjerët me fjalë rreth pushtetit të «të gjithë popullit»... Njerëz, të cilëve u pëlqen të merren me fjalë të tilla ka shumë... por, sidoqoftë jo nga radhët e proletariatit, sepse proletarët e kanë kuptuar dhe kanë shënuar në Kushtetutë, në ligjet themeltare të republikës, se është fjala për diktaturën e proletariatit»<sup>1</sup>.*

Po të ballafaqojmë këto mendime të Leninit me dispozitën përkatëse të projektkushtetutës së shpallur në Bashkimin Sovjetik që deklaroi se «Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike është një shtet socialist i të gjithë popullit», duket qartë kursi antileninist i klikës së Brezhnjev, që ka tradhtuar diktaturën e

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 318-319.

proletariatit. Pikërisht për të mos u ekspozuar si antileninistë, revizionistët sovjetikë, sado që i kanë propaganduar «partinë e gjithë popullit» dhe «shtetin e gjithë popullit», gjer sot nuk kishin guxuar ta kodifikonin revizionizmin, kurse tani ata e çorën maskën, hoqën dorë ligjërisht nga leninizmi dhe nga diktatura e proletariatit. Ata e shndërruan shtetin e tyre në një diktaturë fashiste, që forcon vazhdimisht funksionin e dhunës mbi kurrizin - e popujve sovjetikë dhe ndjek politikën agresive kundër popujve të botës.

Tërë ky revizionim i doktrinës marksiste-leniniste, kjo tradhti e madhe dhe kjo politikë reaksionare është shoqëruar me një propagandë shurdhuese, për ta paraqitur si një «kalim nga etapa e ndërtimit të shoqërisë socialiste në etapën e ndërtimit të komunizmit».

Kështu, sipas antimarksistëve sovjetikë, Bashkimi Sovjetik gjoja po kalon në komunizëm, në një shoqëri pa klasa, ku Partia dhe shteti po shuhen. Por realiteti atje qëndron krejt ndryshe. Me ardhjen në fuqi të revizionistëve modernë, u ndërmer likuidimi i fitoreve të revolucionit bolshevik dhe i shoqërisë socialiste që po ndërtohej, por që ishte akoma larg ndërtimit të saj të plotë. Ky ndryshim i sistemit socialist mund të bëhej, sikurse u bë, vetëm duke ndjekur rrugën kapitaliste dhe duke vendosur një diktaturë fashiste.

Në të vërtetë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik nuk u bë dhe nuk mund të bëhej parti e gjithë popullit, por u shndërrua në një organizatë kundërrivolucionare për t'i shërbyer kauzës së restaurimit të kapitalizmit. Në Bashkimin Sovjetik nuk u lejua pluralizmi i partive si në vendet borgjeze. Revizionistët

ndërtuan atje një ideologji të re antimarksiste dhe, për demagogji, për të treguar se gjoja janë duke ruajtur vazhdimësinë, mbajtën disa forma, disa norma, disa tradita të partisë së vjetër komuniste. Kuptohet që edhe këtyre ata u ndryshuan tiparet dhe, çka është më me rëndësi, u hoqën brendinë revolucionare për t'i kthyer në norma kundërrevolucionare. Gjithë kjo parti revizioniste është kthyer tash në një vegël qorre të diktaturës borgjezo-kapitaliste, që i ka zënë vendin diktaturës së proletariatit dhe që, për opinionin, është quajtur «shtet i gjithë popullit». Objektivat dhe qëllimet e këtij shteti të egër kapitalist nuk janë tjetër veçse kundërrevolucionare. Bashkimi Sovjetik është bërë një armik i revolucionit botëror, një superfuqi botërore imperialiste, një konkurrent i fuqishëm i imperializmit amerikan.

Kthesa e Bashkimit Sovjetik është regresive, prandaj i pëlqen kapitalizmit botëror dhe në radhë të parë imperializmit amerikan. Me këtë kthesë iu shkaktua një dëm i madh revolucionit botëror dhe një fitore e madhe, megjithëse e përkohshme, kapitalizmit dhe ideologëve të tij, në të cilët bëjnë pjesë dhe revizionistët modernë. Kjo solli të mira për kapitalizmin botëror, pse largoi për një kohë revolucionin, por në asnjë mënyrë nuk zhduku perspektivën e tij, as realitetin e përditshëm; ajo nuk zhduku luftën e klasave, që është motori i historisë, dhe as krizën e përgjithshme të kapitalizmit botëror, të cilën, përkundrazi, e acaroi më shumë; nuk zhduku kontradiktat antagoniste midis shteteve kapitaliste, midis borgjezisë dhe pro-

letariatit, midis të shtypurve dhe shtypësve, përku-ndrazi, i acaroi edhe më shumë këto kontradikta.

Në platformën kombëtare dhe ndërkombëtare po acarohen dhe po thellohen kontradiktat, për arsye se kriza e regjimeve kapitaliste dhe revizioniste është e madhe, pse imperializmi, qoftë ai amerikan, qoftë ai sovjetik, është në kalbëzim dhe në luftë me socializmin si sistem dhe ndodhet në kërkim të një rrugëdaljeje nga kjo krizë e thellë vdekjeprurëse që e ka mbërthyer.

Imperializmi amerikan dhe shtetet e tjera kapitaliste po përdorin çdo mjet për ta dobësuar Bashkimin Sovjetik. Ata i japin atij kredi për ta minuar nga brenda, i bëjnë presione politike për liberalizim të mëtejshëm, për ta sjellë në sistemin borgjez perëndimor dhe në dislokimin e bashkimit të kombësive.

Nga ana e tyre Bashkimi Sovjetik, bashkë me shtetet e tjera revizioniste, shtrëngojnë zinxhirët brenda vendit. Në kuadrin ndërkombëtar Bashkimi Sovjetik përpiqet të dobësojë rivalin ose rivalët e tij për ndarjen e botës.

**3. Qëndrimet ideologjike dhe politike të Partisë Komuniste të Kinës janë revizioniste dhe ndihmojnë për dobësimin e revolucionit, ose që revolucionin të shtyhet në «kalendat greke».**

Përpjekjet kineze puqen me pikëpamjet titiste. Synimi kryesor i tyre është që të mbështeten me të gjitha mjetet e mundshme dhe pa rezerva ato vende kapitaliste që, për arsye koniunkturale, mbajnë qëndrim kundër Bashkimit Sovjetik.

Oportunizmi kinez do të përpiqet të përçajë partitë

marksiste-leniniste që janë krijuar aktualisht, pse këto akoma nuk e kanë formuar si duhet personalitetin e tyre, nuk janë kalitur në luftëra dhe në beteja klasore, nuk e kanë akoma mbështetjen që nevojitet në radhët e proletariatit dhe në masat e gjera të popujve të tyre.

Për Partinë Komuniste të Kinës aktualisht ka rënë teoria e Leninit për përcaktimin e epokës, i cili thoshte se sot është epoka e shembjes së imperializmit dhe e revolucioneve proletare. Për kinezët nuk është aktual as revolucioni demokratiko-borgjez, por lufta për të ruajtur statukuonë. Kina ka deklaruar se social-imperializmi sovjetik është agresiv dhe në sulm, kurse Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në pozita mbrojtjeje dhe luftojnë për statukuonë. Ajo, pra, është solidare me këtë «tigër prej letre», që, sipas saj, kërkon të ruajë tregjet dhe perandorinë e vet, prandaj ndikon që Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'i ruajnë këto privilegje. Kjo është arsyeja që në krah të Kinës ndodhen Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Teoria e «botës së tretë» dhe ajo e «vendeve të paangazhuara» ngjajnë me njëra-tjetrën si dy pika uji. Të dyja këto synojnë që të pengohet revolucioni dhe të mbrohet kapitalizmi botëror, i cili të mos ndalet në ushtrimin e hegjemonisë së tij, por të praktikojë disa forma sundimi pak më të pranueshme nga proletariati botëror dhe nga popujt. Ky qëndrim i përshtatet pozicionit tjetër oportunisto-revizionist rumun, «botës së vendeve në zhvillim», që kërkon kredi nga superfuqitë, pavarësisht se nga cilat anë vijnë, sepse «paraja nuk bie erë».

Si për çudi «lidershipët» e «botës së tretë», të «vendeve të paangazhuara» dhe të «vendeve në zhvillim» janë në harmoni të plotë ndërmjet tyre, ata veprojnë me mënyrat dhe me format specifike për të gënjyer masat, proletariatin dhe partitë e vërteta të revolucionit.

#### **4. Partitë revizioniste të Evropës Perëndimore ndjekin haptazi rrugën e partive të Internacionales së Dytë.**

Në themel të programit të tyre është kompromisi me partitë e borgjezisë kapitaliste, është pjesëmarrja në pushtetin e kapitalit. Këto parti revizioniste, siç është, për shembull, Partia Komuniste e Francës, kanë mohuar haptazi diktaturën e proletariatit, luftën e klasave dhe revolucionin. Edhe partitë e ashtuquajtura komuniste të Italisë, të Spanjës etj., që predikojnë pajtimin social, «vëllazërimin në divergjenca», hiqen sikur nuk kanë hequr dorë nga ndërtimi i socializmit, por, në fakt, ato janë për një socializëm surrogato, për një socializëm hibrid me pluralizëm partish të çdo ngjyre, që, së toku dhe «në harmoni», të shkojnë në «socializëm» nëpërmjet «reformave të strukturës», nëpërmjet «reformave politiko-ekonomike». Këto parti, siç kanë deklaruar partitë revizioniste franceze dhe italiane, janë për statukuonë e regjimeve të vendosura nga kapitali, janë për republikën demokratike borgjeze, ose edhe për monarkinë, me të cilën është dakord Partia Komuniste e Spanjës, krerët e së cilës, Karriljo-Ibarruri, deklaruan publikisht se kanë hequr dorë nga republika dhe pranojnë monarkinë.

Partitë revizioniste të Evropës Perëndimore, për



t'i zgjatur jetën kapitalit dhe për të luftuar revolucionin, janë në kërkim të një kompromisi, të një sistemi të shartuar kapitalisto-tredunionist.

Kapitali botëror dhe pushteti i tij e ndiejnë dobësimin e vet dhe janë përpara alternativës: o të vendosin diktaturën më të egër të tyre, fashizmin, o t'u bëjnë disa lëshime oportunistëve revizionistë. Forcat e djathta fashiste, siç shohim në Itali, në Spanjë e gjetkë, veprojnë për të mos u arritur ky kompromis dhe përpiqen të infiltrojnë në partitë e kapitalit për të vendosur diktaturën e tyre të kamufluar.

**5. Partisë sonë i bie barra e rëndë të luftojë me konsekuencë për pastërtinë e teorisë marksiste-leniniste dhe për mbrojtjen e parimeve të saj.**

Lufta jonë po zhvillohet dhe do të zhvillohet e ashpër kundër rrymave të fuqishme oportuniste-revizioniste, trockiste, socialdemokrate. Arsenali i armiqve të marksizëm-leninizmit është i madh, por edhe forcat e revolucionit janë kolosale. Janë pikërisht këto forca që ziejnë, që ndeshen, që luftojnë, që ua kanë prishur gjumin dhe ua bëjnë të pamundur jetën botës kapitaliste dhe reaksionit.

Proletariati botëror po i mbledh forcat. Aktualisht po ndodh ai fenomen i kohës së Leninit, kur ndarja nga Internacionalja e Dytë u pasua nga krijimi i partive të reja marksiste-leniniste. Tradhtia revizioniste ka sjellë dhe do të sjellë doemos krijimin e partive të vërteta komuniste. Për Partinë tonë ka rëndësi që ajo, me qëndrimet e saj të patundura dhe parimore marksiste-leniniste, të ndihmojë për ngritjen e këtij hovi të madh

revolucionar që ka shpërthyer, të ndihmojë formimin, mëkëmbjen dhe kalitjen e partive komuniste (marksiste-leniniste).

Duke qëndruar e palëkundur në parimet, Partia jonë duhet të kuptojë vështirësitë e rritjes të partive motra, ekzistencën brenda në to të hezitimeve për demaskimin e oportunizmit të ri të rrezikshëm që shfaqet në shumë forma, të kuptojë zigzagët taktike të tyre për të bindur dhe për të fituar të lëkundurit, për të formuar aleancat me elementët demokratë e përparimtarë kundër superfuqive dhe borgjezisë reaksionare. Të gjitha këto kushte të reja të krijuara ne duhet t'i kanalizojmë për ngritjen dhe fuqizimin e revolucionit botëror dhe për shkatërrimin nga themelet si ideologji, si sistem dhe si praktikë të kapitalizmit, imperializmit dhe socialimperializmit.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TREGUESIT**



## TREGUESI I LËNDËS

### A

*Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj* — 315-318.

*Aleanca, kuptimi marksist-leninist i tyre* — 58-57, 104-105, 196, 199, 204-205.

*Ambasadat e RPS të Shqipërisë në vende të ndryshme* — 93, 189-190, 361, 364.

*Ambasadat e vendeve të ndryshme dhe ambasadat e RP të Kinës në RPS të Shqipërisë dhe në vende të tjera* — 362, 363, 364, 367, 368.

*Analiza klasore; mohimi i saj nga revizionistët* — 6-9, 55-58, 61-63, 194-197, 199-201, 205-206, 209-210, 386-396, 410-412, 413-417.

*Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm; veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre* — 28-29, 59, 79-80, 102-103, 281, 327-329, 338, 344-345, 346, 352, 354.

*Arsimi në RPSSH* — 90, 133-134, 135.

*Shih edhe: Grupet armiqësore...* — grupi armi-

qësor në fushën e ideologjisë, të arsimit e të kulturës. *Arsimi në Shqipërinë e paraçlirimit* — 244, 249-250.

*Arti Ushtarak i Luftës Popullore*

— përmbajtja, studimi dhe përvetësimi i tij; strategjia dhe taktika e luftës popullore — 17, 22-23, 27, 157, 158-161;

— faktorët që kushtëzojnë rritjen e aftësisë mbrojtëse të vendit; roli i njeriut dhe i armëve në luftë. *Terreni* — njohja dhe përgatitja e tij për mbrojtje — 21-28, 117.

### B

*Bashkimet Profesionale të Shqipërisë; detyrat dhe roli i tyre; organet udhëheqëse dhe kuadrot. Kongresi i 8-të i BPSH* — 138-146, 273-274, 370-380, 381-382.

*Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë, rinia në RPSSH; detyrat e organizatës së rinisë.*

*Kongresi i 7-të i BRPSH —*  
25, 80, 92-93, 324-334.

*Bashkimi Sovjetik (1917—1953)*  
— 388, 389, 390, 393.

*Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik, socialimperializmi sovjetik*

— ardhja e tij në fuqi; strategjia dhe taktikat; politika e jashtme e agresionit, hegjemoniste dhe ekspansioniste — 2-3, 4, 65, 69-70, 103, 218-220, 396-400, 406-410, 411-412, 436-440;

— degjenerimi i partisë, i shtetit, i jetës ekonomiko-shoqërore dhe likuidimi i diktaturës së proletariatit — 397-399, 436-439;

— roli përçarës dhe lufta e tij kundër lëvizjes komuniste marksiste-leniniste botërore dhe lëvizjeve revolucionare e nacionalçlirimtare. Qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë — 3, 102, 398-399, 439.

*Shih edhe: Superfuqitë...*

*Blegtoria në RPSSH — politika e Partisë për zhvillimin e saj. Traditat blegtorale* — 85-86, 307-308;

— përmlrësimi racor; bagë-

titë e lmeta, derri, bagëtitë e oborreve kooperativiste. Baza ushqimore e bagëtive — 86, 96, 125-127, 287, 307, 308.

*Bujqësia në RPSSH; vendi dhe roli i bujqësisë në ekonominë popullore. Organizimi dhe drejtimi i punës në bujqësi. Kuadrat, specialistët* — 36-37, 82-83, 86, 90-91, 309;

— zbatimi i shkencës agroteknike dhe i përvojës së përparuar. Mekanizimi; veprat bonifikuese dhe ujitëse — 86-91, 95, 305-307, 308-309, 316-317;

— struktura e degëve të bujqësisë. Rendimentet e bimëve bujqësore; dritërat — sigurimi i bukës në vend — 35-36, 37, 83-84, 85, 96-97, 304-308;

— bimët industriale, panxhar sheqerl, ulliri; pemëtaria, perimet, farërat — 37, 87-89, 306-307, 308-309.

*Burhetti i shtetit, shpenzimet për sferën joproduhëse* — 131, 134.

## D

*Dallimet në socializëm; ngushtimi i dallimeve thelbësore ndërmjet fshatit dhe qytetit* — 94-95, 373-374.

*Demokracia socialiste dhe centralizmi demokratik* — 41-45, 106-107, 108, 114, 356.

*Diktatura e proletariatit* — 99, 114, 160, 170, 329, 354-355, 356-358, 437-438.

*Disiplina proletare* — 142-146, 156-164, 352-353, 356.

*Dituritë, studimi individual* — 33-34, 133, 251, 331.

*Drejhtësia; organet dhe punonjësit e drejtësisë në RPSSH* — 275, 278, 336-337.

## E

*Edukimi komunist; edukimi ideopolitik, patriotik, ushtarak e tekniko-shkencor* — 17-23, 25-27, 31, 41-42, 47-48, 108-109, 114, 144-145, 157-164, 262-263, 326-327, 330-331, 355, 356-357;

— studimi i teorisë dhe i praktikës revolucionare të Partisë — 34, 326-327, 360, 374;

— bindjet; rrugët, format, mjetet e edukimit; puna e diferencuar me njerëzit — 31, 93, 139-140, 165-174.

*Ekonomia popullore* — zhvillimi i saj; drejtimi dhe organizimi shkencor i ekonomisë dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja në të — 14, 30-39, 311-313, 321-322, 375-376.

*Shih edhe: Grupet armiqësore... — grupi armiqësor sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit etj. në ekonomi. Ekspozitat, monumentet e kulturës, muzetë* — 112, 133, 225, 233-234, 240-241.

*Engels, Fridrih* — 104, 194, 197, 204, 208, 302, 357, 353, 387, 425, 431-432.

*Enver Hoxha* — të dhëna autobiografike — 11, 77-79, 80, 109, 125-126, 226-227, 229, 230, 231-232, 233, 234, 233, 243-244, 246-248, 253, 331-382.

*Epoka, përcaktimi leninist i saj. Kontradiktat themelore të epokës. Kontradiktat në kapitalizëm; qëndrimi i marksistë-leninistëve ndaj kontradiktave* — 55, 56, 63-64, 72, 195, 205, 386-387, 413-415, 439-440, 441.

## F

*Faktori objektiv dhe subjektiv — roli i tyre në shoqëri* — 23-27, 83.

*Fashizmi, rreziku i fashizmit, lufta kundër tij* — 72, 73, 404, 430, 443.

*Financat, kontrolli financiar. Kreditë dhe krediti agrar; degët dhe prodhimet që subvencionohen nga shteti* — 45-47, 288-292, 314.

*Fronti Nacionalçlirimtar, Fro-*

*nti Demokratik i Shqipërisë* — 105, 106.

*Fshatarësia, fshatarësia kooperativiste* — 84, 85, 91, 121-122, 126-127, 282.

*Fshati socialist* — 92-95.

*Furnizimi, shpërndarja e produkteve; stoqet dhe mallrat me qarkullim të ngadalshëm; masat për parandalimin dhe evadimin e tyre* — 43, 122-124, 309-310, 319-321.

## G

*Grupet armiqësore dhe lufta kundër tyre*

— grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes etj. në ushtri — 29, 59, 162-163, 278-280, 284-285, 336-337, 339, 342-343;

— grupi armiqësor sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit etj. në ekonomi — 34-35, 116-117, 278-280, 284-285, 336-337, 339-340, 342;

— grupi armiqësor në fushën e ideologjisë, të arsimit e të kulturës — 278-280, 284-285, 336-337, 340-343;

— strategjia dhe taktikat e grupeve, lidhjet ndër-

mjet tyre; agjentura në shërbim të shteteve të huaja; zbulimi, gjykimi dhe dënimi i tyre — 29, 59, 278-281, 284-285, 286, 336-340, 348-349, 350-351, 352, 355-356.

## GJ

*Gjeologjia, gjeologjia e naftës dhe e gazit. Studimet gjeologjike, gjeologët, specialistët, hartat gjeologjike* — 114-120, 221-223.

*Gjuhët e huaja* — 48, 185, 190, 192.

## H

*Historia e Shqipërisë; studimet historike, trajtimi materialist-dialektik i historisë; lufta kundër shtrembërimeve të historiografisë së huaj për Historinë e Shqipërisë* — 147-154, 236;

— Rilindja Kombëtare Shqiptare, rilindësit. Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881). Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 nëntor 1912) — 97-98, 147-151, 152-154, 236-237, 241, 244-245, 246, 251;



- regjimi feudalo-borgjez i Zogut — 107, 247-248;
- shoqëritë dhe klubet patriotike para vitit 1939 — 245-246, 251, 252.

## I

*Imperializmi, borgjezia, partitë borgjeze dhe reaksioni ndërkombëtar, strategjia dhe taktikat; lufta kundër tyre* — 5-6, 59-61, 102-104, 201-202, 213, 300-301, 385, 387, 388-390, 392-393, 400-405, 409, 411, 415, 416-417, 430-431, 443-444.

*Industria e lehtë dhe ushqimore në RPSSH* — 37-38, 319-321.

*Industria e rëndë në RPSSH; industria minerare* — 317-319.

*Industrializimi socialist, përpunimi i lëndëve të para në vend* — 34-35, 122-124.

*Interesi i përgjithshëm dhe interesi vetjak, lokal e dikasterial* — 31, 33, 40-41, 42-43, 49-50, 141-145, 150-157, 166, 285, 331.

*Internacionalja e Dytë* — 428, 443.

*Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni)* — 61, 62, 390, 391.

## J

*Jetesa në shoqërinë tonë socialiste* — 85, 94-95, 293.

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav. Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë* — 394-395;

— revizionizmi jugosllav; strategjia dhe taktikat — 295-300, 365-368, 390-396, 410, 412, 434-436;

— socializmi vetadministrues jugosllav. Degjenerimi i partisë, i shtetit dhe i jetës ekonomike e shoqërore; konfliktet nacionale në Jugosllavi — 54, 149-150, 391-392, 393-396, 419-421, 434-436;

— qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë; marrëdhëniet me Kinën dhe me Korenë — 149-150, 154, 295-300.

## K

*Kapitalizmi, sistemi kapitalist; kriza, kontradiktat, shfrytëzimi dhe varfërimi i masave punonjëse. Kreditë* — 33, 61-65, 72, 102-103, 195-196, 329, 345, 378, 386-387, 388-390, 392-393, 400-405, 410-412, 413-417, 435-436, 439-440, 442-443.

*Kërkesa dhe oferta në socia-*

*lizëm* — 122-124, 319-321.

*Këshillat popullore dhe komitetet ekzekutive të tyre. Komitetet ekzekutive të Korrçës dhe të Lushnjës* — 37, 48-49, 127-128, 260, 269-270, 272.

*Këshilli i Mbrojtjes, Tezat e Këshillit të Mbrojtjes* — 17, 19, 26, 343.

*Këshilli i Ministrave (Qeveria)* — 39, 127-128, 176, 264, 310, 318.

*Kina, oportunitizmi i ri kinez; Partia Komuniste e Kinës* — 69, 353, 399;

— gjendja e brendshme, degjenerimi kapitalist, depërtimi i kapitalëve të huaja; lufta e grupeve për pushtet — 1-2, 3-4, 216-217, 295-296, 353, 364, 365, 415, 416-417;

— strategjia dhe taktikat; politika e jashtme, lidhjet dhe bashkëpunimi me imperiaлизм amerikan, kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 1-9, 194-197, 199-200, 202, 207-220, 295, 297, 301, 363-365, 407, 416-418, 424-425, 441;

— tradhtarë të marksizëm-leninizmit; roli sabotues i saj në lëvizjen komuniste marksiste-leniniste dhe në luftërat na-

cionalçlirimtare e revolucionare të popujve; lufta kundër oportunitizmit kinez — 3, 6-9, 63-64, 70, 194-202, 203-205, 209-210, 212-213, 219, 364-365, 368-369, 383-384, 412-417, 422, 425, 426-427, 440-442;

— qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPS të Shqipërisë — 63-69, 194-195, 208-209, 361-364, 384, 421;

— marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë e rumunë, me borgjezinë dhe me klikat fashiste e reaksionare — 7-8, 9, 199, 200, 295-296, 297, 298-299, 363-364, 365-367, 369, 418-422, 424.

*Kinematografia, filmi në RPSSH* — 187-188, 228.

*Klasa punëtore, roli i saj në ndërtimin e socializmit* — 34-35, 315, 372-373.

*Kolonializmi, neokolonializmi* — 195, 205, 388-389, 411-412.

*Komunisti, roli pararojë, detyrat; edukimi i tij* — 71, 139, 166, 168, 263-264, 347-349, 355, 356-357.

*Kontradiktat antagoniste dhe joantagoniste në socializëm* — 99, 166-174, 280, 281-286, 328.

*Kontrolli i Partisë, i shtetit dhe i masave punonjëse. The-*

*Ibi, detyrat dhe roli udhëheqës i Partisë në kontrollin punëtor e fshatar* — 19, 178, 183, 255-277, 280.

*Kooperativat bujqësore — politika e Partisë për forcimin e gjithanshëm të tyre; marrëdhëniet me shtetin, kooperativat e tipit të lartë* — 120-127, 288-292;

— të ardhurat, fondet, shpërblimi i punës; kuadrot në kooperativat bujqësore — 127, 287-293, 313.

*Kosova dhe viset e tjera me popullsi shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi* — 149-150, 154, 238, 239.

*Kostoja e prodhimit, domosdoshmëria e uljes së saj* — 42-43, 45, 287, 314.

*Kreditë, ndihmat ndërmjet vendeve, kuptimi marksist-leninist i tyre* — 1-2, 3-4, 32, 362-363, 416-417.

*Kritika dhe autokritika, kërkesa e llogarisë* — 44, 105-106, 144, 167, 272, 283-284, 347-348, 350.

*Kuadrot, specialistët; vendosja, shpërndarja dhe edukimi i tyre* — 13, 51, 125, 129-137, 179, 186, 187, 192, 351-352.

*Kultura dhe njeriu i kulturuar. Kultura kombëtare popullore dhe qëndrimi ndaj trashëgimisë kulturore. Folklori.*

*Etnografia* — 94, 190, 191, 224-242, 243-253.

*Kushtetuta e RPSSH* — 99, 114, 372.

## L

*Lenin, Vladimir Iliç* — 17, 55, 56, 57, 59, 61, 62, 63, 64-65, 98, 104, 157, 194, 195, 197, 204-205, 203, 209, 260, 261, 262, 267, 269, 272, 274, 275, 302, 345, 356, 357, 358, 372, 387-388, 393, 395, 404, 410, 414, 418, 425, 427, 441, 443.

*Letërsia dhe artet në RPSSH. Artet figurative dhe të aplikuar* — 225, 232-233, 234-235, 237.

*Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare — diferencimi në lëvizjen marksiste-leniniste; strategjia dhe taktikat e partive; forcimi i unitetit të lëvizjes marksiste-leniniste* — 5-6, 55-61, 71-72, 193, 204-208, 207-208, 212-214, 300-302, 359-360, 413-414, 415, 416, 426-427, 432-434, 443-444.

*Shih edhe: Revizionizmi modern...*

*Liria, pavarësia dhe sovraniteti kombëtar* — 15-18, 17, 201-202, 205, 410-412.

*Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar* — 105, 193, 248, 249, 252.

*Lufta e klasave në shoqërinë tonë socialiste; lufta e klasave në frontin ideologjik* — 165-174, 327-329, 354, 356-357.

*Shih edhe:* PPSH — lufta e klasave në Parti.

*Lufta — shkaqet dhe shkaktarët e shpërthimit të luftërave; qëndrimi i marksistë-leninistëve ndaj luftërave. Luftërat e drejta dhe të padrejta* — 4-6, 16, 24, 28-29, 60-61, 69-71, 162, 201-202, 400-401, 406-409.

## M

*Marksizëm-leninizmi, busull dhe udhëheqje për veprim; zbatimi krijues i tij. Mbrojtja nga shtrembërimet oportuniste* — 55-58, 59, 61-62, 64-65, 72, 93, 100-101, 104-105, 160, 194-195, 197, 209-201, 203-205, 207-208, 252, 274, 301, 326-327, 356-360, 368-369, 374, 386-388, 431-434; — *lufta e borgjezisë, e revizionizmit dhe e reaksionit kundër teorisë dhe praktikës së marksizëm-leninizmit dhe socializmit shkencor* — 203-205, 386-388, 397, 403, 431-434.

*Marks, Karl* — 93, 100, 104, 160, 194, 197, 204, 203, 302, 357, 358, 387, 393, 410, 425, 431-432.

*Marrëdhëniet socialiste në prodhim; marrëdhëniet e pronësisë dhe të shpërndarjes* — 203-293.

*Mbështetja në forcat tona* — 32-33, 34-35.

*Mbrojtja e atdheut — përgatitja e ushtrisë, e popullit dhe e të gjithë vendit për mbrojtje* — 10, 11, 13-33, 101-102, 157, 163.

*Ministritë dhe kuadrot e tyre; detyrat, kompetencat; metoda dhe stili në punë* — 48-49, 50, 122, 127, 130, 175-179;

— *Ministria e Punëve të Jashtme* — 185, 193;

— *Komisioni i Planit të Shtetit* — 134-135, 322;

— *Ministria e Industrisë dhe e Minierave* — 118, 124, 317, 318, 319;

— *Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore* — 48, 180, 182, 319-320, 321;

— *Ministria e Bujqësisë* — 304, 316-317;

— *Ministria e Ndërtimit* — 315, 316.

*Mirëqenia në shoqërinë tonë socialiste* — 30-31, 37-23, 82-33, 85, 87, 313-314.

## N

*Nafta dhe gazi; zonat dhe fushat naftë e gazmbajtëse* —

114-116, 120, 221-223, 317-318.

*Ndërgjegjja, veprimtaria e ndërgjegjshme* — 22-25, 63, 143-146.

*Ndërmarrjet socialiste; drejtimi ekonomik i tyre (ekonomistët). Ndërmarrjet e grumbullimit* — 40-43, 45-48, 122-124, 181, 256-257.

*Ndërtimet; organizimi, drejtimi dhe kontrolli i punës në ndërtim* — 226, 230, 314-317, 362-363.

*Ndërtimi i socializmit, revolucionit socialist në Shqipëri. Karakteristika, parime të ndërtimit socialist; rëndësia ndërkombëtare e tij* — 30-31, 38-39, 82, 99-101, 193, 260-261, 281-282, 327-328, 330, 354, 358-359, 377-378, 385-386.

## O

*Organet shtetërore dhe ekonomike, aparatet shtetërore* — 50-51, 121, 177, 178-179, 354.

*Organizata-bazë e Partisë; detyrat e saj, lufta kundër shfaqjeve të huaja. Organizatat-bazë të Partisë në dikastere dhe në ndërmarrjet ekonomike* — 113-114, 139, 167, 168, 173, 174, 175-179, 256-257, 263-264, 265, 269.

*Organizatat e masave* — 142-143, 171, 256-257, 273-274.  
*Organizimi dhe drejtimi* — 17-18, 25, 28, 50-51, 97.

## P

*Paga, parimi i shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës* — 132-133, 289-293.

*Paraja dhe qarkullimi monetar* — 111-112, 288, 309-310.

*Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhe jeta e brendshme*

— vija e Partisë në LANÇ dhe në ndërtimin e socializmit; strategjia dhe taktikat — 11-13, 52-54, 65-69, 73-82, 84-85, 105, 108, 197-198, 203-205, 214, 252-253, 279-290, 285-286, 334-335, 358-359;

— roli udhëheqës, vendimet, direktivat; njohja dhe zbatimi i tyre — 113-114, 121, 174, 175-179, 252, 255-256, 258, 264-266, 270, 273, 274, 282, 313, 323, 346-347, 349, 353-355;

— normat e Partisë; karakteristikat e saj: besnikëria ndaj marksizëm-leninizmit, mbrojtja dhe zbatimi krijues i tij — 52-53, 197-198, 203-205, 207-

- 208, 285, 346-349, 356-360;
- metoda dhe stili i punës së Partisë, ndihma dhe kontrolli për bazën; puna dhe roli udhëheqës në organizatat e masave — 12-13, 138-139, 293-294, 324, 332-334;
  - materialet e Partisë, studimi dhe përvetësimi i tyre; materialet, studimet për organet udhëheqëse — 11-13, 34, 111-112, 129-130, 136-137, 168-170, 258-260, 270.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- organet udhëheqëse qendrore dhe në rrethe
    - Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 11-13, 15, 30, 34, 59, 61, 65, 66, 68, 73, 74, 84, 89, 112-113, 117, 169-170, 197, 201, 207, 208, 209, 210, 212, 317, 371, 372, 373;
    - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 12, 17, 19, 39, 84, 111-112, 125, 130, 136-137, 156, 176, 182, 185, 255, 264, 265, 266, 273, 274, 310, 313, 318, 323, 337, 338, 343, 383-384;
    - Plenumi i 8-të i KQ (26-28 qershor 1969); Plenumi i 2-të i KQ (28-29 qershor 1977) — 342, 383-444.
  - aparati i KQ të Partisë — 185, 191, 274;
  - komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe — 167, 172, 173, 256, 257, 258, 260, 262-263, 264, 265-268, 270, 272, 276-277, 354;
  - Organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Vlorës; komitetet e Partisë të rretheve të Lushnjës dhe të Korçës — 10, 11, 111-112;
  - organizatat e Partisë në ushtri dhe në terren. Roli udhëheqës i Partisë në ushtri, vija ushtarake e Partisë — 17-18, 19-20, 21-29, 156, 162, 167-164.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- lufta e klasave në Parti
    - lufta kundër fraksionizmit dhe grupeve antiparti; lufta kundër fraksionit të Sadik Premtes dhe grupit të Koçi Xoxes — 78-79, 214, 339, 345;
    - lufta kundër grupeve antiparti në ushtri, në ekonomi dhe në fushën e ideologjisë, të arsimit e të kulturës — 278-281, 284-285, 286, 336-346, 349-352;

- qëndrimi i Partisë ndaj të metave dhe gabimeve dhe ndaj njerëzve që gabojnë dhe bëjnë faje — 165-174, 281-286, 347-352.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- *politika e jashtme*
    - strategjia dhe taktikat; analiza klasore marksiste-leniniste e situatës ndërkombëtare. Lufta e saj kundër imperializmit, revizionizmit, borgjezisë dhe reaksionit — 16, 51-52, 54-74, 103-104, 200-202, 207-220, 385-444;
    - qëndrimi internacjonalist ndaj lëvizjes marksiste-leniniste dhe luftërave nacionalçlirimtare. Kontributi i PPSH në lëvizjen komuniste ndërkombëtare — 9, 52, 60, 65-67, 70-71, 201-202, 207-220, 357-360, 443-444;
    - marrëdhëniet, kontradiktat dhe qëndrimi parimor ndaj PK të Kinës — 67-69, 194-202, 207-220, 383-385;
    - lufta e saj për demaskimin e revizionistëve sovjetikë, jugosllavë dhe eurokomunizmit — 53-54, 73, 102, 399.
- Partia Komuniste (revizioniste) e Italisë, e Francës dhe e Spanjës* — 427-430, 442-443.
- Planifikimi*
- metodologjia e planifikimit. Kontrolli dhe ndihma, lufta kundër të metave dhe gabimeve në planifikim; organet e planifikimit — 39-51, 142-143, 310-314;
  - plani i 6-të dhe i 7-të pesëvjeçar; realizimi i planeve në sasi, cilësi dhe asortiment; realizimi i planeve në bujqësi dhe blegtori — 30-31, 32-33, 35-37, 39-43, 45, 49, 84, 122-124, 303-323, 375-376.
- Politika e jashtme e RPSSH*
- 5-8, 67, 73-74, 100, 101, 236;
  - rritja e prestigjit dhe autoritetit të RPSSH në botë. Të huajt për vendin tonë; solidariteti dhe përkrahja e popujve të botës për Shqipërinë — 38-39, 52, 65-67, 71, 72, 73, 99-101, 184-193, 225, 228.
- Shih edhe: Partia e Punës e Shqipërisë — politika e jashtme.*
- Politika dhe ideologjia, politika në plan të parë; politika ekonomike* — 21, 41-42, 97, 108-109, 124, 175-179, 310-311.
- Populli shqiptar; luftërat e tij*

për liri, pavarësi dhe përparrim shoqëror. Cilësitë dhe traditat patriotike e arsimdashëse — 15-16, 24, 84, 97-98, 109, 152-153, 230-233, 238, 239, 243-253, 330-331, 375-377.

*Prodhimi material; prodhimi dhe riprodhimi socialist, rritja e pandërprerë e të mirave materiale* — 287-289, 292-293, 313-314;

— prodhimi i mjeteve të prodhimit dhe i mallrave të konsumit; sasia, cilësia e produkteve; asortimenti — 32, 33, 40-41, 42-43, 50, 122-124, 130-182, 309-310, 319-321.

*Proletariatit* — 72, 100-101, 199, 200, 204, 208, 209-210, 300-302, 358-359, 386-387, 415.

*Prona* — *prona shtetërore dhe ajo e grupit; qëndrimi socialist ndaj tyre* — 126-127, 142, 170, 269-261, 275-276.

*Propaganda dhe shtypi borgjezo-revizionist* — 3, 8, 36, 53, 54, 203, 365-366, 369, 389, 390, 395, 412.

*Propaganda dhe shtypi përparimtar botëror* — 66, 73, 95-97.

*Propaganda e prodhimit* — 41, 47, 112.

*Propaganda, propagandistët. Propaganda për botën e jashtme* — 39-39, 41, 47, 66, 103,

146, 165-160, 169, 171-172, 173, 184-193, 210, 228.

*Psikologjia, psikologjia mikroborgjeze dhe lufta kundër shfaqjeve të saj* — 85, 96, 166-167, 168-169, 170-171, 172-173, 174, 345-346.

## R

*Regjimi i kursimit; normativat e harxhimit të materialeve* — 32-33, 320-321.

*Revizionizmi modern, eurokomunizmi, oportunizmi; roli sabotues në lëvizjen komuniste dhe në luftërat revolucionare e nacionalçlirimtare të popujve; lufta kundër tyre* — 59-61, 71-72, 103-104, 203-205, 300-301, 357, 367-369, 399, 401-402, 409-410, 426-431, 432-434, 436, 442.

*Revolucioni socialist, proletar dhe revolucioni demokratikoborgjez; luftërat nacionalçlirimtare të popujve* — 60, 62, 63-64, 194-197, 198, 199-200, 203-205, 208, 209-210, 214, 218-219, 300-301, 415, 416, 439, 443-444.

*Rezervat shtetërore* — 31-33, 35, 38.

## RR

*Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-revizionist dhe*



*Lufta për përballimin dhe çarjen e tyre* — 14-15, 29, 38-39, 51, 52-53, 66, 101, 321-322, 355, 376-377.

## S

*Socialdemokracia, sindikatat reformiste* — 401-402, 430-431.

*Socializmi, sistemi socialist* — 386-389.

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 54, 61, 62, 64-65, 104, 194, 197, 204, 208, 230, 298, 302, 357, 358, 369, 387, 388, 391, 393, 395, 397, 404, 418, 421, 425.

*Superfuqitë; politika e luftës, e agresionit, hegjemoniste e ekspansioniste; aleancat dhe kontradiktat ndërmjet tyre* — 2, 4-5, 59, 60, 297-298, 378, 406-409.

## SH

*Shfaqjet e huaja dhe mbeturinat e së kaluarës, lufta kundër tyre* — 98-99, 140-146, 158, 162-163, 165-174, 260-261, 272, 281-286, 348, 350-351.

*Shkenca në RPSSH; studimet shkencore; institucionet shkencore dhe punonjësit shkencorë* — 118-120, 221-222, 235-236, 239.

*Shkenca ushtarake* — 21-22, 157, 158-159, 160-161.

*Shkollat e Lira Ushtarake* — 17-23.

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës; strategjia dhe taktikat; politika e jashtme ekspansioniste e hegjemoniste* — 1-2, 3-4, 65, 69, 197, 388-390, 392-393, 400-408, 411-412, 416, 424, 440.

*Shih edhe: Superfuqitë.. Shtypi dhe botimet në RPSSH; përkthimet, përkthyesit* — 46-47, 48, 188, 192, 225, 228-229.

## T

*Teoria dhe praktika; uniteti dialektik i tyre* — 12-13, 22-23, 24-25, 26, 90-91, 144-146, 157, 160, 161-162, 326-327.

*Teoritë borgjezo-revizioniste dhe kritika ndaj tyre* — 104, 401-402, 423-424;

— të revizionistëve kinezë; teoria e «tri botëve» dhe falsiteti i saj — 6-9, 61-65, 68, 194-197, 199-200, 203-205, 209-210, 214, 215-217, 219, 299-300, 301, 367, 413-418, 424-425, 441-442;

— të revizionistëve sovjetikë dhe të eurokomunistëve. Teoria e «vendeve në zhvillim» — 63, 218, 397-398, 399, 423-424, 427-

-430, 436-439, 441-443;

- të revizionistëve jugosllavë; teoria e «vendeve të paangazhuara» dhe falsiteti i saj — 62-63, 300, 367, 391-392, 393-396, 410-412, 413, 417, 419-420, 434-436, 441-442.

*Të ardhurat kombëtare — fondi i akumulimit dhe fondi i konsumit* — 287-292.

*Tregtia e jashtme; eksporti, importi* — 36, 38-39, 96-97, 180-183, 315-316, 319, 320.

## U

*Uniteti Parti-popull, uniteti i popullit* — 97-93, 166, 167-168, 169, 170-171, 173, 344, 376-377.

*Ushtria Popullore, roli dhe detyrat e ushtrisë, cilësitë. Lidhjet dhe bashkëpunimi ushtri-terren* — 19-21, 23, 160; — armatimi, stërvitja ushtarake; disiplina në ushtri, urdhrat, vendimet; kuadrot, ushtarët; prapavijat në ushtri, rezervat — 18-23, 26, 31-32, 156-164;

— edukimi, lufta kundër të metave e gabimeve, kundër shfaqjeve të huaja; liberalizmit, arrogancës, prepotencës — 155-164.

*Shih edhe: Grupet armiqësore...* — grupi armiqësor, komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Dumes etj. në ushtri.

## V

*Vështirësitë — lufta për kapërcimin e tyre* — 304, 309-310, 331-332, 375.

*Vigjilenca revolucionare* — 16, 28-29, 280, 281, 328-329, 346-352, 353-355.

## Z

*Zgjedhjet për këshillat dhe gjykatat popullore; të zgjedhurit, detyrat e tyre* — 106-107, 108, 114

## ZH

*Zhvillimi dialektik* — 11-12, 13, 17-18, 81-82, 91, 280, 285.

## TREGUESI I EMRAVE

### A

- Alia, Ramiz — 153, 194, 203,  
207, 218, 231, 235, 236, 240,  
303.  
Agolli, Dritëro — 225, 234,  
238.  
Anaksagora — 88.  
Angoni, Idriz — 251.  
Ariosto, Ludoviko — 152.

### B

- Balluku, Beqir — 59, 278, 279,  
284, 336, 337, 339, 340, 342,  
343, 355-356.  
Bembo, Pietro — 152.  
Blanki, Lui — 204.  
Boceja, Elmaz — 251.  
Brezhnjev, Leonid — 298, 437.  
Buda, Aleks — 224, 225, 226,  
227, 228, 231, 232, 233, 235-  
-236, 237-238, 239, 240, 241-  
-242.  
Buduku, Aziz — 247.  
Bulka, Epaminonda — 234.

### C

- Cara, Kujtim — 257.

- Ceretel, Irakli — 55.  
Curri, Bajram — 238.

### Ç

- Çuko, Lenka — 112, 121, 124.  
Çabej, Eqrem — 228-229.  
Çajupi, Andon Zako — 246.  
Çako, Hito — 284, 336, 337.  
Çerçill, Uinston — 393.  
Çheixe, Nikolai — 55.  
Çipi, Asaf — 249.

### D

- Dari I — 89.  
Deliana, Thoma — 341-342.  
Desai, Morarj — 107, 108.  
Donatelo — 152.  
Dume, Petrit — 284, 336, 337,  
342.

### F

- Forlani, Arnaldo — 295.  
Franko, Françisko — 65, 296,  
404.  
Frashëri, Abdyl — 241.  
Frashëri, Faslli — 105.  
Frashëri, Mithat (Lumo Skën-  
do) — 105.

Frashëri, Naim — 151, 241.  
Frashëri, Sami — 151, 241.

**G**

Gandi, Indira — 107, 108.  
Grameno, Mihal — 244.  
Guri, Idriz — 245, 247-248.

**GJ**

Gjoni, Hasan — 77.  
Gjoni, Xhelil — 233.

**H**

Hoxha, Nexhmije — 111, 227-  
-228, 231, 232, 233.  
Hasani, Sherif — 78.  
Hashorva, Velj — 245.  
Hirohito — 299, 404.  
Hitler, Adolf — 299, 404.  
Hoxha, Hysen — 245, 251.  
Hoxha, Iljaz — 249.  
Hoxha, Tahir — 79, 105.  
Hoxhi, Koto — 249.  
Hrushov, Nikita — 3, 397.  
Hua Kuo Fen — 216, 295, 296,  
297, 299, 353, 363, 365, 366,  
369.

**I**

Isal, Hekuran — 156, 287, 288,  
289.  
Ibarruri, Dolores — 429.  
Ipsilant, Aleksandër — 223.

**K**

Kapo, Hysni — 77, 78.  
Kameniev, Lev — 369.  
Karlos, Huan — 429.  
Karter, Xhimi — 299, 402-  
-405, 403, 407, 408, 411, 416.  
Karriljo, Santiago — 429.  
Kati, Vasil — 234, 286, 336.  
Kelmendi, Ali — 371.  
Kerenski, Aleksandër — 265.  
Këlcyra, Ali — 105.  
Këllezi, Abdyl — 135, 273, 279,  
284, 286, 336, 337, 339-340,  
342, 356.  
Kim Ir Sen — 296, 299-300.  
Konomi, Andrea — 240.  
Kutra, Sokrat — 250.

**L**

Lako, Miha — 371.  
Lepenica, Hysni — 79, 105.  
Libkneht, Karl — 55.  
Li Hsien Nien — 301.  
Lubonja, Todt — 338, 340.

**M**

Myftiu, Manush — 232.  
Majani, Zahari — 227.  
Makiaveli, Nikolo — 152.  
Malo, Javer — 184, 189.  
Mao Ce Dun — 3, 67, 69, 193,  
199, 200, 211, 215-216, 217,  
296, 298-299, 301, 366, 369,  
418, 421, 425.

Meksl, Polo — 245.  
 Mikelanxhelo Buonaroti —  
 152.  
 Mobutu, Sese Seko — 200,  
 206.  
 Montenj, Mishel — 152.  
 Muçi, Rexho — 249.  
 Musal, Selam — 246.  
 Musolini, Denito — 404.

## N

Nehru, Khavaharjal — 108.  
 Nesturi, Kozma — 77, 87, 89.  
 Nesho, Gaço — 10, 11, 77.  
 Ngjeia, Kifo — 284, 286, 336.  
 Niko, Petrit — 125.  
 Nimeir, Xhafar — 301.  
 Noll, Fan — 115.

## P

Peristeri, Pilo — 371.  
 Paçrami, Fadli — 278, 284,  
 336, 340.  
 Pahlevi, Mohamed Reza — 65.  
 Papa Julius II — 152.  
 Papapano, Thoma — 249, 251.  
 Perikliu — 83.  
 Pinoçet, Augusto — 64, 65,  
 296.  
 Pislj, Lezan — 79.  
 Pollo, Stefanaq — 224, 225,  
 226, 227, 229, 230, 231, 233,  
 237, 238, 239.  
 Poshi, Xhafo — 249.  
 Premte, Sadik (Xhepl) — 78,  
 79.

## Q

Qemali, Ismail — 97-98.

## R

Rankoviç, Aleksandër — 395.  
 Rumbo, Urani — 249.  
 Rustemi, Avni — 245, 246.

## RR

Rrapo, Miti — 125.

## S

Stefani, Simon — 129-130.  
 Skënderbeu, Gjergj Kastrioti —  
 233.  
 Sajfudin — 418, 419, 420, 421,  
 422.  
 Selfo, Aqif — 250.  
 Sino, Hasan — 245.  
 Sotiri, Pandeli — 249.

## SH

Shaplo, Siri — 250.  
 Sheperi, Ilia Dilo — 249.  
 Shkurti, Spiro — 229-230.  
 Shtino, Emin — 250.

## T

Ten Hsiao Pin — 68, 216, 217.  
 Tito, Josip Broz — 62, 295,  
 296-299, 300, 363, 365, 366-  
 -367, 369, 390, 391, 392-393,  
 394, 395, 400, 412, 418-419,  
 420-421, 422.  
 Toptani, Esat pashë — 246.  
 Topulli, Bajo — 244, 245.

Topulli, Çerçiz — 244, 247,  
251.

### TH

Theodhosi, Koço — 34-35, 116,  
117, 278, 279, 284, 286, 336,  
337, 340.

### U

U Ne Vin — 7, 8.

### V

Vasa, Pashko — 151.  
Veqilharxhi, Naum — 151.

Vjero, Gogo — 76, 77.  
Vreto, Jani — 151.

### X

Xoxe, Koçi — 339, 345, 394.

### XII

Xhiku, Hasan — 245.

### Z

Zinoviev, Grigori — 369.  
Zogu, Ahmet — 214, 245, 247,  
248.

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

Afrikë — 100, 195, 201, 365, 407.

Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë — 235, 236.

Algjeri — 201.

Amerika e Veriut — 199.

Amerika Latine — 195.

Antantë — 205.

Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara — 63.

ATSH (Agjencia Telegrafike Shqiptare) — 186.

Athinë — 228.

Azi — 4, 69-70, 195, 388, 426.

### B

Baldushk (Tiranë) — 267.

«Bashkimi» (gazeta ~) — 46.

Belgjikë — 203.

Berat — 229, 258.

Beteja e Termopileve (480 para e.r.) — 89.

Birmanë — 7-8.

Bolonjë (Universiteti ~, Itali) — 102.

Brazil — 65.

Bregu i Detit (krahina ~, Vlorë—Sarandë) — 92.

Britania e Madhe — 115, 392-393.

Bukuresht — 364.

Byroja Informative e Partive Komuniste e Punëtore — 391.

### D

Diaspora shqiptare (arbëreshët) — 228-229.

Dibër — 307.

Dukat (Vlorë) — 77, 79-80, 90, 93, 94.

Durrës — 317.

### E

Egjypt — 435.

Ekspozita etnografike «Kultura popullore shqiptare» — 224-242.

Etiopi — 365.

Etruskët — 227.

Evropë — 1, 4, 69, 70, 148, 199, 328, 402, 403, 430-431.

## F

Fabrika e Plastmasës [Fabrika e Lëndëve Plastike], Durrës — 122.

Fabrika e Prodhimit të Artikujve prej Plastmase [Uzina e lëndëve Plastike], Lushnjë — 43, 124.

Francë — 152, 188, 189, 203, 231, 232.

Fusha e Çajupit (Gjirokastrë) — 244.

## G

Greqi — 66, 73, 228.

Grupi Komunist i Korçës — 371.

## GJ

Gjermani — 205.

Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 212.

Gjirokastrë — 243-253.

## H

Helsinki — 408.

Hydrocentrali i Flerzës [Hydrocentrali «Drita e Partisë»] — 363, 377.

Himarë (Vlorë) — 76, 95.

Iloxharë (Fier) — 317.

HSINHUA (Kina e Re) — 186, 203, 362.

## I

Indi — 107-108, 435.

Instituti i Lartë Bujqësor i Korçës — 90.

Instituti i Lartë Bujqësor i Tiranës — 90.

Itali — 72, 73, 96, 102, 115-116, 152, 212, 443.

Izrael — 74.

## J

Japoni — 2.

## K

Kanada — 35.

Karaburun (Vlorë) — 102.

Kavajë — 233.

Kinostudio «Shqipëria e re» — 92, 93, 187-188.

Klubi «Drita», Gjirokastrë — 251.

KNER (Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke) — 408, 409, 423.

Kombinati i Tekstileve, Berat — 320.

Kombinati i tekstileve «Stalin», Tiranë — 320.

Kombinati Metalurgjik [Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë»], Elbasan — 362, 377.

Komiteti Shqiptar për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme — 184, 185, 193.



Komuna e Parisit (1871) — 204.

Koncernet italiane «ENI», «FIAT», «Montedison» dhe «Siderurgica» — 364.

Koncertet e Majit (1977) — 234.

Konferenca I Nacionalçlirimtare e Pezës (16 shtator 1942) — 105.

Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Dukat—Tragjasit, Vlorë — 75, 78, 95, 96.

Korçë — 37, 112, 234, 371, 381-382.

Kore (RDP e Koresë), Partia e Punës e Koresë — 295, 296, 299-300, 367.

Krujë — 289.

Ksamil (Sarandë) — 80, 92-93.

Kuçovë [Qyteti Stalin] — 115.

Kuç (Vlorë) — 96.

Kukës — 307.

## L

Leusë (Përmet) — 234.

Libi — 115-116, 435.

Libohovë (Gjirokastër) — 249.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë — 192.

Lindja e Mesme — 407.

Lufta e Dytë Botërore (1939 - 1945) — 388.

Lufta e Vlorës (1920) — 246.

Lukovë (Sarandë) — 80.

Lunxhëri (Gjirokastër) — 92.

Lushnjë — 111, 112-113, 120, 121-122, 124-126, 127-128.

## M

Mali i Tragjasit (Vlorë) — 78.

«Manifesti i Partisë Komuniste» (K. Marks — F. Engels, vepra ~) 204, 431-432.

Mashkullorë (Gjirokastër) — 249.

Mat — 229.

Mazhar (Vlorë) — 78.

Mbledhja e partive komuniste e punëtore në Bukuresht (qershor 1960) — 67.

Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë (10 nëntor—1 dhjetor 1960) — 67.

Mesaplik (Vlorë) — 96.

Moskë — 295.

## N

NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) — 70, 402, 405.

Ndërmarrja bujqësore «Rinia», Vlorë — 75-78, 80, 92, 95.

## O

Obelisku i Arsimit dhe Qendra e Re Muzicale, Gjirokastër — 244, 248-249, 252, 253.

OPEK (Organizata e Vendeve

Eksportuese të Naftës) — 403,  
407.

## P

Pakistan — 435.  
Paqja e Erest-Litovskit (3 mars 1918) — 204-205.  
Paris — 188, 246.  
Partia Komuniste e Birmanisë — 7-8.  
Partia Socialiste Franceze — 428.  
Pekin — 295, 296, 297.  
Peraudoria Osmane — 147,  
148, 149, 152.  
Përmet — 229.  
Phenian — 295, 296, 300.  
Portugall — 212.  
Prizren — 148, 149.  
Pukë — 307.

## Q

Qestorat (Gjirokastrë) — 249.

## R

Revolucionet e vitit 1848 në Evropë — 204.  
Revolucioni grek (1821) — 228.  
Revolucioni i Madh Socialist i Tetorit (1917) — 195.  
Rilindja në Evropë — 151-152.  
Romë — 102, 364.  
Rumani — 422-424.  
Rusi — 388.

## S

Sazan (ishulli ~) — 102.  
«Sëmundja foshnjore e «maj-  
tizmit» në komunizëm» (V.I.  
Lenin, vepra ~) — 57.  
Spanjë — 429, 443.

## SII

Shambor (Francë) — 189.  
Shkofta «Asim Zeneli», Gjir-  
rokastrë — 253.  
Shkolla «Drita», Gjirokastrë  
— 243, 249-250.  
Shkolla «Liria», Gjirokastrë  
— 249-250.  
Shoqëria «Studenti», Gjiroka-  
strë — 253.  
«Shqipëria e re» (revista ~)  
— 192.  
«Shqipëria sot» (revista ~)  
— 192.

## T

TANJUG (Agjencia Telegra-  
fike e Jugosllavisë së Re) —  
295.  
Tiranë — 243, 245.  
Tragjas (Vlorë) — 79, 93.  
Traktati i Varshavës — 218,  
409, 423.  
Turqi — 68.

## U

UDB (Drejtoria e Sigurimit  
Shtetëror) — 394.

Universiteti i Janinës, Greqi  
— 66.

Universiteti i Kozencës, Itali  
— 229.

Universiteti i Tiranës [Universiteti i Tiranës «Enver Hoxha»]  
— 120.

Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës, Ballsh — 262, 377.

Uzina e Polivinilkloridit [Uzina e Sodës dhe PVC], Vlorë  
— 43, 122.

Uzina e Telave dhe e Kablove Elektrike, Shkodër — 43.

## V

Valbonë (Tropojë) — 238.

Vlorë — 11, 79, 80, 88, 92, 93, 95, 98, 102, 109, 115, 120-121.

Vuno (Vlorë) — 76.

## Z

Zagori (Gjirokastrë) — 92.

Zaire — 200, 205, 365.

«Zëri i popullit» (gazeta ~).  
— 46, 87, 228-229.

## ZH

«Zhenminzhibao» (gazeta ~).  
— 369.



## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 61-TË ..... V—IX

1977

KINA SYNON TË BËHET SUPERFUQI — Shënime  
(5 mars 1977) ..... 1—9

ATDHEU MBROHET JO VETËM KUR PËRGATI-  
TEMI USHTARAKISHT, POR KUR JEMI TË FORTE  
EDHE POLITIKISHT, IDEOLOGJIKISHT DHE EKO-  
NOMIKISHT — Fjala në aktivin e Partisë të rrethit  
të Vlorës (21 mars 1977) ..... 10—74

NJERIU I EDUKUAR NGA PARTIA E BËN VEN-  
DIN KOPSHT TË LULËZUAR — Nga biseda me kua-  
dro dhe punonjës të ndërmarrjes bujqësore «Rinia»  
si dhe me një grup kuadrosh e kooperativistësh të  
kooperativës bujqësore të bashkuar të Dukat-Tragja-  
sit të rrethit të Vlorës (23 mars 1977) ..... 75—110

ME PUNË MUND TË REALIZOHEN DETYRA MË  
TË MËDHA — Nga biseda me disa shokë të byrosë  
dhe sekretarët e Komitetit të Partisë të Rrethit të  
Lushnjës (26 mars 1977) ..... 111—120

PËRGATITJA E KUADROVE KA NJË RËNDËSI TË  
JASHTËZAKONSHME PËR ZHVILLIMIN E VEN-  
DIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH (6 prill 1977) ..... 129—137

REZULTATET E PUNËS EDUKATIVE TË ORGANIZATËS SË BASHKIMEVE PROFESIONALE TË SHOHIM NË PRAKTIKË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 prill 1977) .....	138—140
IDETË E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT JANË IDE TË RILINDJES E TË KONSOLIDIMIT TË KOMBIT SHQIPTAR — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 prill 1977) .....	147—154
KUSH E DO ATDHEUN, DUHET TË MESOJË EDHE SI TA MBROJË ATË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 prill 1977) .....	155—164
PROPAGANDËN DHE EDUKIMIN TË MATIM ME REZULTATET — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 prill 1977) .....	165—174
UNITETI I PUNËS SHITETËRORE ME PUNËN E PARTISË JEP REZULTATE TË MIRA — Shënime (14 prill 1977) .....	175—179
NË PRODHIMET PËR EKSPORT KRYESORE MBE-TET CILËSIA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 prill 1977) .....	180—183
PROPAGANDA PËR BOTËN E JASHTME ËSHTË NJË PROBLEM I MADH PARTIE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 prill 1977) .....	184—193
KESAJ I THONË: TË HARROHET UJKU DHE TË LUFTOHET HIJA E TIJ — Shënime (29 prill 1977)	194—202
PËR NJË ARTIKULL ME TITULLIN «TEORIA DHE PRAKTIKA E REVOLUCIONIT» — Teza (30 prill 1977) .....	203—206

- MENDIME PËR OPORTUNIZMIN E RI (REVIZIONIZMIN KINEZ) — Shënime (12 maj 1977) ..... 207—220
- STUDIMET T'I NËNSHTROHEN NJË DISKUTIMI SHKENCOR — Shënime (18 maj 1977) ..... 221—223
- SHKENCA ETNOGRAFIKE TË BËHET NJË PASQYRË E SHKËLQYESHME E KULTURËS SONË POPULLORE — Nga biseda gjatë vizitës në ekspozitën etnografike «Kultura popullore shqiptare» (23 maj 1977) ..... 224—242
- PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPULLIT TË GJIROKASTRËS ME RASTIN E INAUGURIMIT TË QENDRËS MUZEALE DHE TË OBELISKUT (24 maj 1977) ..... 243—254
- KONTROLLI PUNËTOR E FSIATAR, I DREJTUAR NGA PARTIA, NDIHMON QË TË ZBULOHEN DHE TË KORRIGJOHEN TË METAT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSII (25 maj 1977) ..... 255—277
- ARMIQTË I MERITOJNË PLOTËSISHT DËNIMET QË U DHA GJYKATA POPULLORE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSSH (31 maj 1977) ..... 278—286
- NIVELI I JETESËS SË KOOPERATIVISTËVE NGRIHET DUKE PUNUAR MË SHUMË — Nga biseda në takim ditë të sekretarëve të KQ të PPSH (1 qershor 1977) ..... 287—294
- PSE SHKON TITOJA NË KINË? — Shënime (7 qershor 1977) ..... 295—302

<b>TË MARRIM MASA TË MËTEJSHME PËR TË FORCUAR PUNËN DHE KONTROLLIN</b> — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 qershor 1977) .....	303—323
<b>RINIA I JEP ATDHEUT JETË E GJALLËRI, PARTISË GJAKUN E RI</b> — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 qershor 1977) .....	324—335
<b>SHPATA E MPREHTË E DIKTATURËS SË PROLETARIATIT RA MBI ARMIQTË DHE U DHA DËNIMIN QË MERITONIN</b> — Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 qershor 1977) .....	336—360
<b>KINEZËT PO ZHVILLOJNË NJË PUNË AGJENTURORE</b> — Shënime (18 qershor 1977) .....	361—369
<b>ROLI UDHËHEQËS I KLASËS PUNËTORE</b> — GARANCI PËR NDËRTIMIN ME SUKSES TË SOCIALIZMIT — Përshëndetje drejtuar Kongresit të 8-të të BPSH në emër të Komitetit Qendror të Partisë (20 qershor 1977) .....	370—380
<b>SHPREH MIRATIMIN E PLOTË DIJE JAP VOTËN TIME PËR VENDIMET E RËNDËSISHME TË KONGRESIT</b> — Letër drejtuar Kongresit të 8-të të BPSH (23 qershor 1977) .....	381—382
<b>TË LUFTOJMË ME KONSEKUENCË PËR PASTËRTINË E TEORISË MARKSISTE-LENINISTE DHE PËR MBROJTJEN E PARIMEVE TË SAJ</b> — Fjala e mbylljes në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH (29 qershor 1977) .....	383—444
<b>Treguesi i lëndës</b> .....	447
<b>Treguesi i emrave</b> .....	461
<b>Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera</b> .....	465



Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1988